INSTITUTE FOR SCIENTIFIC RESAEARCH AND DEVELOPMENT
INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM
INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ
ULCINJ-ULQIN
Registarski broj 80024813; Maticni broj 02910977

Buletini i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare
Zbornik Naučnih Radova Međunarodne Konferencije
International Scientific Conference Proceedings

**ZBORNIK RADOVA XI MEĐUNARODNE NAUČNE KONFERENCIJE**

**BULETINI I KONFERENCËS XI SHKENCORE NDËRKOMBTARE**

Strategija za ekonomski razvoj lokalnih samouprava balkanskih zemalja sa posebnim naglaskom na stavove, izazove i mogućnosti razvoja

Strategjia për zhvillim ekonomik - lokal të komunave në vendet e ballkanit me theks të veçantë pikëpamjet, sfidat dhe mundësitë e zhvillimit

**ZBORNIK RADOVA III MEĐUNARODNE NAUČNE KONFERENCIJE**

**BULETINI I KONFERENCËS III SHKENCORE NDËRKOMBËTARE**

*Odgovornost i podrška susjednih zemalja u očuvanju i unapređenju kulture,jezika i književnosti u Crnoj Gori*

*Përgjegjësitë e shteteve amë në funksion të ndihmës për ruajtjen dhe avancimin e kulturës gjuhës dhe letërsisë;*

**April, 2019**

**Redakcija/Redaksija**

*Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi*(Predsjednik/Kryetari)

*Dr.Ylvije Kraja*

*Phd.Nazli Tyfekqi*

*MA.Elmedina Bajgora*

*MA.Kastriot Blakaj*

***Urednik*  Zbornik Radova Međunarodne Naučne Konferencije**

***Redaktori  i* Buletinit  të Konferences Shkencore Ndërkombëtare**

*Ma.Yllka R.Imeri*

**Štampa/Shtypshkronja:**

Euro Project –Montenegro

***Izdavač/Botuesi Institut za Naučna Istraživanja i Razvoj -Ulcinj:***

***Instituti për kërkime shkencore dhe zhvillim-Ulqin***

***ISSN 1800-9794 (Print)***

***ISSN 2337-0521 (Online)***

ISSN 0311-175X

9 770311 175001 17

***Bordi Editorial***

- Acad. Slobodan Nešković, (Serbia)
- Acad. Konstantin Pochivalov, (Russia)
- Acad.Dragoljub Mirjanić, (Serbian Rep
- Prof. Dr. Marko Todorović (Serbia)
- Prof. Dr. PredragGoranović,
- Prof. Dr. Edmond Beqiri (Kosovo)
- Prof. Dr. Nevenka Ž. Joksimović, (Serbia)
- Prof. Dr. Robert Dimitrovski (Macedonia)
- Prof.Dr.Armand Krasniqi(Kosovo)
- Prof. Dr. Akhter Alam( India)
- Prof. Dr. Anatoly Avdenko (Ukraina)
- Prof. Dr. Valentin Nedeff (Romania)
- Prof. Dr. Vladimir P. Sergienko (Belorus)
- Prof. Dr. Predrag Dašić (USA)
- Prof. Dr. Laszlo Karpati (Hungary)
- Prof. Dr. Michael Minch (USA)
- Prof. Dr. NikéWentholt (Netherland)
- Prof. Asoc. Dr. DarkoLacmanović (MNE)
- Prof. Dr. Daniel Dobrev, (Bulgaria)
- Prof. Dr. Andrej Raspor (Slovenia)
- Prof. Dr. Zoran Mastilo (B&H)
- Prof. Dr. Tibor Petres (Hungary)
- Prof. Dr. El Thallasinos ( Greece)
- Prof. Dr. Heinrich Meister (Switzerland)
- Prof. Dr. KelesGulbahar (Turkey)
- Mr. Sampurna  Mehta (India )
- Prof. Dr.Arben Malaj (Albania)
- Doc. dr. sc. Dean Sinkovic, (Croatia)
- Prof. Dr. Sonja Vitanova (Macedonia)
- Prof. Dr. Drita Kruja (Albania)
- Prof. Dr. Marko Todorović (Serbija
- Prof. Dr. Slađana Benković FON (Serbia)
- Prof. Dr. Robert Dimitrovski (Macedonia)
- Prof. Dr. Edmond Beqiri (Kosovo)
- Prof. Dr. Akhter Alam( India)
- Prof. Dr. Dragoljub Jankovic (Montenegro)
- Prof. Dr. Tonin Gjuraj(Albania)
- Prof. Dr. Anatoly Avdenko (Ukraina)
- Prof. Dr. Valentin Nedeff (Romania)
- Prof. Dr. Vladimir P. Sergienko (Belorus)
- Prof. Dr. Predrag Dašić (USA)
- Prof. Dr. HidajetShehu (Albania)

- Prof. Asoc. Dr. FahrushRexhepi (Kosovo)
- Prof. Dr. Laszlo Karpati (Hungary)
- Prof. Ass. Dr. Shefket Jakupi, (Kosovo)
- Prof. Dr. Diana Shehu (Albania)
- Prof. Dr. Michael Minch (USA)
- Prof. Dr. ArmendKadriu (Macedonia)
- Prof. Asoc. Dr. Blerta Dragusha (Albania)
- Prof. Dr. NikéWentholt (Netherland)
- Prof. Dr. Drita Kruja (Albania)
- Prof. Dr. Miodrag Brzaković (Serbia)

**PËRMBAJTJA**


**Marta Muqaj ... 6**

**Manjola Xhahysa Striniqi, Servete Ligataj Lleshi ... 17**

**Behije Ibrahimi ... 24**

**Dr.sc Mustafë Haziri, Ph.D Naim Seferi, M.sc Milazim Hajra ... 32**

**Romeo Terolli ... 40**

**Ibrahim Mala, Shkelqesa Citaku ... 47**

**Shpëtim Memishi ... 52**

**Ilire Dauti ... 64**

**Arlind Vokshi ... 75**

**Dr. Sc. Refik Havolli, Bastrie Uka Havolli ecc.dip ... 85**

**Vlora Dulatahu ... 106**

**Elza Qorraj ... 113**

**Ermonda Foniqi, Edita Dembogaj, Liresa Kastrati ... 124**

**Albulena Desku ... 131**

**Dafina Olloni ... 139**

**Edmond Racaj ... 145**

**Doc.Dr.Llokman Hebibi, PhD Cand.Armend Asllani ... 150**

**Dr.Ylber Dyli, Enes Alushi ... 155**

**Msc. Marigona Lahu ... 160**

**Hana Bahtijari Jakupi ... 170**

**Phd (c) Rialda Muharemi ... 174**

**Msh.Liridona Sinishtaj ... 193**

**Fitor Ollomani ... 198**

**Ma.Fahrije Lushi ... 210**

**Dr. Ilir Sallata, Dr. Menada Petro ... 218**

**Saranda Buzhala ... 225**

**Msc. Ajeta Memishaj ... 243**

**Dr. Orneda Gega ... 253**

**Dorentina Xhafa ... 260**

**MSc. Matej Bushaj, Brikenë Elshani, Islam Sejdiu ... 268**

**Dr. Nexhat Çoçaj ... 281**

**Zog Çoçaj ... 289**

**Prof. asoc. dr. Haki Hysenaj ... 304**

**Jola Male ... 312**

**Ma. Sc. Sami Gashi ... 326**

**Lulzim Nika ... 331**

# MENAXHIMI I RESURSEVE HUMANE, KAPACITETET QARKULLUESE NË UNIVERSITETET KOSOVARE

**Marta Muqaj (PHD "Universiteti Evropian I Tiranes)**

Abstrakti

Kohët e fundit komuniteti i biznesit, sherbimet publike, organizatat joqeveritare, sektori publik dhe privat, te të gjitha profileve fokusin kryesorë e kan te Burimet Njerëzore (BNJ). Politikat dhe Praktikat e Menaxhimit të burimeve Njerëzore (MBNJ)kan rol pothuajse ryesorë në përmbushjen e objektivave, misionin dhe vizionin e organizates. Rëndësinë e hartimit të politikave dhe sigurimi i kuadrove prraktike e lehtëson në mas suksesin e organizates. Kapacitetetve Humane të pergatitura për të bër ndryshimet e nevojshme pozitive i shtojnë vlerë organizates, duke i pershtatur Burimet Njerëzore me nevojat e organizates. Derisa globalizimi ka perfshin çdo segment te jetes, atëher jan Burimeve Njerëzore dhe politikat e organizates ato që bëjnë diference. Hartimi i politikave dhe praktikave n♪7 përputhje me kapacitetet qarkulluse, dhe Burimet Njerëzore, ësht një proqes sa i vështirë aq edhe i domosdoshëm, në boten e konkurences së pa imagjinueshme, në një shoqëri ku dita dites, nevojat dhe obligimet sa vijn e ndryshojnë, shijet dhe mundesit jan në disproporcion të vazhdueshem. Menaxhimi i Burimeve Njerzore (MBNJ) është një strategji ecila në shekullin njëzet ka evoluar dhe e cila ka per qellim investimin në RH, trajnimin dhe zhvillimin e tyre, si resurs primar në organizatë, duke konsideruar si resurs e jo më si investim.
Ky dokument përshtat një qasje cilësore-dominante të metodës së përzier duke përdorur dokumentet e politikave, praktikave, intervistat gjysmë të strukturuara,

*Fjalë kyqe: Burime nerëzore, politika, praktika**, organizata, investim.***

## 1. Hyrje

Specialistët e Resueseve Humane, shkojn përtej praktikave dhe obligimeve të drejtuesve të linjes, duke përshtatur dhe shperndar ato tek punonjësit përkatës. Këta specialistë ushtrojnë dhe zbatojnë praktikat e vlerësimit nga menaxherët e linjes, zbatojnë dhe delegojnë praktika të tilla të cilat synojnë hartimin e strategjive të parashikuar nga menaxhmenti i lartë, e ecila perfshin transparenc, barazi, drejtësi në të gjith proçesin.
Menaxherët e linjës janë veçanërisht të rëndësishme për praktikat e MBNJ si vlerësimi për arsye të rrënjosura në teoritë e shkëmbimit social. Rëndësia e menaxherëve të linjës në teorizmat aktuale në vlerësim lidhet me supozimet që "përvojat e punonjësve të këtyre [praktikave] lidhen në mënyrë të pashmangshme me marrëdhëniet e tyre me Detyrat e Menaxherit te Linjes (DML), sepse DML shihet si agjent i organizatës, dhe në shumicën e rasteve dërguesi i praktikave të BNJ "(Purcell & Hutchinson, 2007: 16).*("Doing it for themselves? Performance appraisal in project-based organisations, the role of employees, and challenges to theory" Anne Keegan D. Hartog p.3)*
Sociologët dhe psikologët industrialë u muren me Menaxhimin e Resurseve Humane, (HRM). Kjo ka ndryshuar në mënyrë dramatike në dy dekadat e fundit. Menaxhimi i Resurseve Humane (HRM) është tani një fushë e rendesishme në ekonominë e punës. Shenjë dalluese e kësaj pune është që të përdorin mjete standarde ekonomike aplikuar në rrethanat e veçanta të menaxhimit të

punonjësve brenda kompanive. Ekonomia e MRH-së ka një ndikim të madh në botë përmes mësimdhënies në shkollat e biznesit dhe në fund të fundit atë që praktikohet nëshumë organizata.
“Mennaxhimi I Burimeve dhe Talentëve, si aktivitete të tjera të BNJ, duhet të përqendrohen në mbështetjen e organizates në arritjen e objektivave strategjike të saj”

Resurset humane kanë një rol jetik në hartimin e politikave dhe praktikave, kultivimin e një kulture të fortë, realizimin e një misioni të fortë, planifikimin dhe realizimin e një planifikimin dhe realizimin e objektivave të organizates, duke filluar me rekrutimin dhe përzgjedhjen e aplikantëve që do të punojnë në realizimin dhe ndarjen e besimit të organizates, do të lulzojnë në atë kulturë, ti japin frymë misionit dhe vizionit, dhe ti japin krah objektivave strategjike, të sigurojnë resusrse të cilat i shtojnë vlerë organizates.

## 2. Kuadri teorik

Organizat e suksesshme ësht ajo organizatë që ka gjet çelsin e kultures së bazuar në një grup besimi të fuqishem dhe të shpërndar në mënyrë transparrente, të mbështetur në strukturë dhe strategji.Një kulturë e rrënjosur e një organizate bën që:Punonjësit e vlerësojnë se si menaxhmenti ka nevoi që ata te reagojnë në situata te caktuara, ata e dijnë se cila do të jetë pergjigjja e duhur në momente te caktuara, dhe ne te njejten kohë e kuptojnë se do të shperblehen per mundin dhe angazhimin e tyre në organizatë, ata e shofin deshtimin dhe suksesin e organizates so personal.

Koncepti i "performancës" kërkohet të përcaktohet nga shumë variabla. Mund të referohemi nga njëra anë në rezultate, prandaj çfarë mund të arrihet nga aktivitete të caktuara, por në të njëjtën kohë i konsiderojmë konceptet e efektivitetit, efikasitetit, respektivisht në nga njëra anë, nevojës për të kryer një seri të tërë objektivat, nga ana tjetër idenë e vlerësimit të kostos / rezultatit. Në literaturë autorët kanë studiuar se si performanca mund të përcaktohet, llogaritet, se si krijohen marrëdhënie apo lidhje midis faktorëve të ndryshëm që kontribuojnë në ndikimin e veprimtarisë së një ndërmarrjeje. Youndt, Snell, Dean, Lepak, Lepak, 1996) kanë përshkruar idetë që sigurojnë një lidhje të drejtpërdrejtë në mes të performancës dhe strategjive të arritura, ndërsa autorët e tjerë (Purcell, Guest) lidhje direkte midis performancës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore si një e tërë.
Ekzekutivigjithashtu duhet të jetë i vetëdijshëm për çështjet ekonomike, teknologjike, sociale dhe ligjore që prekin burimet njerëzore dhe, nga ana tjetër, lehtësojnë ose kufizojnë përpjekjet për të arritur objektivat strategjike.
Përkundër përpjekjeve të tyre më të mira, drejtuesit shpesh dështojnë në MRH sepse ata punësojnë njerëz të gabuar ose nuk motivojnë ose zhvillojnë stafin e tyre. Hulumtimtregon se mënyra në të cilën kryeni përgjegjësitë e burimeve njerëzoree punës suaj të menaxhimit-rekrutimi, përzgjedhja, trajnimi, vlerësimi dhe shpërblimi-vullnetitë jetë çelësi i efektivitetit tuaj si menaxher i kujdesit shëndetësor.
Dallimet mes modeleve të MBNJ egzistojnë vetëm në perceptimin e njerzve. Modelet e MBNJ shfaqin ngjashmëri qoftë në tiparet epërgjtihshme, qoftë në tiparin e tyre kryesor. I vetmi dallim që mund të përmëndet është ai i cilësisë sëpolitikave të MBNJ në aspektin e kapaciteteve dhe qarkullimit të burimeve njerëzore. Tek entet private, kjocilësi rezulton më e lartë se tek entet publike.Ndryshimet e shpejta në mjedisin e biznesit të shkaktuara nga risitë teknologjike; zhvillimi socio-kulturor, luhatjet ekonomike dhe faktorë të tjerë kanë kërkuar përgjigje të reja, qasje inovative dhe të menduarit e freskët. Vendimi i Menaxhimit ka siguruar vazhdimisht një burim të gatshëm dhe informativ të të gjitha këtyre elementeve.

Profesionistët e burimeve njerëzore gjithmonë flasin për kulturën e kompanisë, përmirësimin e kulturës së kompanisë, ndryshimin e kulturës së kompanisë, etj. Por e vërteta e çështjes është se RH nuk mund ta bëjë këtë ndryshim të ndodhë më vete. Ajo merr të gjithë organizatën, duke punuar së bashku me RH, për ta bërë atë të ndodhë. Një organizatë me performancë të lartë është

një organizatë që arrin rezultate financiare qëjanë më të mira se ato të konkurentëve për një periudhë më të gjatë kohe. Për profesionistët e burimeve njerëzore që të kenë ndonjë ndikim në kulturën, ata së pari duhet të kenë një kuptim të plotë të asaj që kultura është në kuptim i përgjithshëm dhe çfarë është kultura specifike e organizatës së tyre. Në nivelin më të thellë, kultura e një organizate bazohet në vlerat që rrjedhin nga supozimet bazë për sa vijon:Natyra e njeriut. A janë njerëzit në thelb të mi ose të këqinjë, të ndryshueshëm ose të pandryshueshëm, proaktivë apo reaktive? Këto supozime themelore çojnë në besime se si punonjësit, konsumatorët dhe furnizuesit duhet të ndërveprojnë dhe si duhet të menaxhohen. Një organizatë do të jetë efektive vetëm kur kultura mbështetet nga një strategji e përshtatshme e biznesit dhe një strukturë që është e përshtatshme për biznesin dhe kulturën e dëshiruar.

## 3. Cilsia e MBNJ në kapacitete dhe qarkullim tek Universitetet

Ky punimhulumton cilësinë e MBNJ në Kapacitete dhe Qarkullim në universitetet në përgjithësi dhe ato publike e private në veçanti. Analiza heton nëse egzistojnë apo jo dallime mes universiteteve publike dhe private dhe nëse po, sa të rëndësishme janë ato. Ajo eksploron gjithashtu edhe faktorët që kanë lidhje me cilësinë e MBNJKQ.

- *Pytje kerkimore: Fushat e Veprimtarisë së Organizatës ku reflektohen Politikat dhe Praktikat e MBNJ*

Këtu reflekton një karakter edhe më specific, pasi ka të bëjë me faktin e shkallës së njohjes nga njërëzit të modeleve të MBNJ dhe tipareve të tyre. Pavarëisht se nuk përjashtohet mundësia që persona të veçantë të kenë njohuri më të avancuara për modelet, tiparet, praktikat, dhe politikat e MBNJ, shumica e njerëzve që shprehën gatishmërinë dhe plotësuan pyetësorin as pritej, dhe as besohej që të kishin njohuri për modelet dhe tiparet e MBNJ. Prandaj, nëse do të përjashtonim rastet kur përgjigjet e dhëna, janë qëllimisht ekstreme, dmth personi që ka plotësuar pyetësorin e ka bërë formalisht, sa për hatër plotësimin e përgjigjeve, një pjesë e përgjigjeve që nuk arrijnë të dallojnë, i ngatërrojnë, ose i përziejnë tiparet e modeleve me njëri-tjetrin, reflektojnë pikërisht mungesën e e njohurive nga njerëzit rreth modeleve dhe tipareve të MBNJ. Dhe ndonëse njerëzit nuk mund të bëhen me faj për këtë, përsëri, ngatërrimet që gjenerohen në përgjigjet e tyre, mund të shihen edhe si një ndër kontribuesit e rezultateve që janë marrë në përfundim të analizës.

Në stidim janë përfshi tetë universitete prej tyre: 4 universitete publike dhe kater universitete private"1) kampion me të paktën 796 vetë,

2) marzh gabimi 5%, dhe

3) nivel besimi 95%!

*3.1 Cilësia e MBNJKQ në Universitete dhe Niveli që Shfaq*

Cilësia e MBNJKQ u hetua me një analize "Cosstabs." Rezultatet janë përmbledhur në Tabelën - Çfarë tregojnë ato? Dy vëzhgime mund të bëhen.

**Tabela 1.1 – Analizë Crosstabs, Cilësia e MBNJ në Kapacitete & Qarkullim në Universitete.**

| MBNJ në Kapacitete & Qarkullim | Universitetet në Përgjithësi | Universitetet Publike | Universitetet Private |
|---|---|---|---|
| është shumë i mirë dhe cilësor | 45.8 % | 34.2 % | 53.4 % |
| nuk është as i mirë, as i keq, por i një cilësie mesatare | 41.7 % | 60.5 % | 29.3 % |
| është shumë problematik dhe i një cilësie të dobët | 9.4 % | 5.3 % | 12.1 % |

**Shënim:** Tek universitetet private 5.2% e personave të pyetur nuk ishin në gjëndje të jepnin një vlerësim të cilësisë së MBNJ në Kapacitete dhe Qarkullim. Tek universitetet në përgjithësi vetëm 3.1 % e personave të pyeturnuk ishin në gjendje të bënin një vlerësim të cilësisë së MBNJKQ.

Vëzhgimi i parë është që ndonëse tek universitetet në përgjithësi cilësia "shumë e mirë" e MBNJKQ zë vendin e parë (rreth 46%), kur vjen puna tek universitetet publike dhe private ato shfaqin dallime. Niveli "shumë i mirë" i cilësisë së MBNJKQ zë vendin e parë tek universitetet

private me rreth 53.4%, ndërsa tek universitetet publike zë vendin e dytë, me rreth 34.2%. Niveli i cilësisë së MBNJKQ tek universitetet publike dhe private shfaq një diferencë rreth 20%. Universitetet Private duket sikur janë më të mira se ato Publike në raport me MBNJKQ.
Vëzhgimi i dytë është që kur universitetet publike dhe private shihen veç e veç diferencat mes niveleve "shumë i mirë" dhe "mesatar" janë të ngjashme, me rreth 26% tek Universitetet Publike dhe rreth 25% tek Universitetet Private. Çfarë mund të shpjegojë këtë që vëzhgohet?
Rezultatet, ashtu si tek spitalet, mund të shpjegohen me tendencën e enteve private për të qënë më efiçente se ato publike si dhe faktorë ndikues që përcaktojnë cilësinë e MBNJKQ. Por a janë dallimet mes universiteteve publike dhe private vërtet aq të rëndësishme dhe serioze?

- *Hipoteza: Universitetet Publike dhe Private shfaqin Cilësi të Ndryshme në MBNJKQ*

Për testimin e hipotezës bazë se "universitetet publike dhe private dallojnë në cilësinë e MBNJKQ," në analizën Crosstabs u kërkua edhe kryerja e Chi Square Tests. Rezultatet e analizës i përmbledh Tabela 1.2. Çfarë tregojnë ato?

**Tabela 1.2 Chi-Square Tests, Dallimet mes Universiteteve Publike dhe Private ne Cilesine e MBNJKQ**

| | Value | Df | Asymptotic Significance (2-sided) |
|---|---|---|---|
| Pearson Chi-Square | 10.323[a] | 3 | .016 |
| Likelihood Ratio | 11.391 | 3 | .010 |
| Linear-by-Linear Association | .623 | 1 | .430 |
| N of Valid Cases | 96 | | |

a. 3 cells (37.5%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.19.

Koeficieni Asymptotic Sig 0.016 është shumë më i vogël se kufiri 0.05 dhe tregon se rezultatet dhe dallimet janë të rëndësishme. Pra, si pohim i vërtetë duhet konsideruar hipoteza bazë se "*Universitetet Publike dhe Private dallojnë në cilësinë e MBNJKQ"*!

Shpjegimet për këtë dallim mund të jenë të ndryshme. Një arsye mund të gjendet tek vete dallimet në karakterin e tyre publik dhe privat. Por një shpjegim alternativ mund të kërkohej dhe lidhej me rolin dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm. Ndaj hapi tjetër është hetimi i marrëdhënieve të cilësisë së MBNJKQ me dy grupe faktorësh:

1) të natyrës së brendshme, dhe
2) të natyrës së jashtme.

### *3.2. Cilësia e MBNJKQ në Universitete dhe Faktorët me të cilët ka lidhje*

Për të patur në një ide më të mirë se cilët faktorë mund të kontribuojnë në nivelin e cilësisë së MBNJKQ, u krye një analize "Correlation" ndërmjet MBNJKQ dhe tetë variablave:

1) Modelit të MBNJ,
2) Tiparit të MBNJ,
3) Premisave të konceptimit dhe zbatimit të politikave të MBNJ,
4) Praktikave të MBNJ,
5) Cilësisë së stafit të universiteteve,
6) Faktorëve Organizativë,
7) Faktorëve Socio-Kulturorë dhe
8) Faktorëve Politikë. Marrëdhëniet u vlerësuan në tre drejtime:

a) drejtimit dhe karakterit të marrëdhënies,
b) fortësisë së marrëdhënies, dhe
c) faktorëve më të spikatur ndikues. Vlerësimi u bë duke u mbështetur në koeficientët "Pearson" dhe "Spearman's Rank". Edhe këtu, ashtu si në rastin e analizës së spitaleve, përdorimi dhe mbështetja tek të dy koeficientët u bë për dy arsye:

1) ngaqë "Pearson Correlation" në kampione me numër të vogël mund të mos arrijë të identifikojë në mënyrë të saktë marrëdhëniet e mundshme të MBNJKQ me variablat e tjerë duke i nënvleftësuar ato, dhe
2) ngaqë "Spearman Rank" është më i volitshëm për ato raste kur kampioni shfaq shkelje dhe nuk respekton supozimeve bazë që kërkon aplikimin e një analize statistikore. Rezultatet janë përmbledhur në Tabelën 1.3, 1.4 dhe 1.5. Çfarë tregojnë ato?

a. Ka të bëjë me drejtimin dhe karakterin e marrëdhënieve mes MBNJ dhe variablave të tjerë.Tabela 1.3, tregon se *tek Universitetet, cilësia e MBNJKQ shfaq përgjithësisht një*

*marrëdhënie pozitive me pothuajse të gjithë variablat, përjashtuar marrëdhënien me "Premisat", drejtimi i së cilës shfaqet negativ (-0.123, -0.118).* Pra nëse në rastin e marrëdhënieve me variablat e tjerë, rritja apo ulja e vlerave të variablave të pavarur sjell rritjen apo uljen e vlerave tek Cilësia e MBNJKQ, në rastin e marrëdhënies mes Cilësisë së MBNJKQ dhe Premisave të MBNJKQ rezulton që kur vlerat shkojnë në drejtime të kundërta: kur vlerat e variablit të pavarur "Premisa" rriten apo ulen, vlerat e variablit të varur "Cilësia e MBNJKQ" ulen ose rriten!

**Tabela 1.3 – Marrëdhëniet e Cilësisë së MBNJKQ me Faktorët tek Universitetet**

| **MBNJKQ** | **tek Universitetet në Përgjithësi** | | **tek Universitetet Publike** | | **tek Universitetet Private** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Me | Pearson R | Spearman Rho | Pearson R | Spearman Rho | Pearson R | Spearman Rho |
| Modelin MBNJ | 0.197 | 0.372** | 0.292 | 0.376* | 0.208 | 0.372** |
| Tiparin e MBNJ | 0.247* | 0.403** | 0.330* | 0.381* | 0.254 | 0.396** |
| Premisat e MBNJ | 0.081 | 0.141 | -0.123 | -0.118 | 0.149 | 0.258 |
| Praktikat e Përditshme | 0.122 | 0.246* | 0.208 | 0.241 | 0.130 | 0.249 |
| Cilësinë e Stafit | 0.163 | 0.290** | 0.326 | 0.398* | 0.160 | 0.228 |
| Faktorët Organizativ | 0.194 | 0.151 | 0.145 | 0.161 | 0.240 | 0.137 |
| Faktorët Socio-Kulturorë | 0.223* | 0.449** | 0.332* | 0.370* | 0.263 | 0.474** |
| Faktorët Politikë | 0.111 | 0.171 | 0.212 | 0.241 | 0.133 | 0.132 |

**Shënim 1:**(*) tregon që korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.05 (2-bishtor).
(**) tregon që korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.01 (2-bishtor);

**Shënim 2:**Koeficientët që rezultojnë shënojnë këtë nivel fortësie të marrëdhënies:
nëse vlera është 0, mes dy variablave nuk egziston ndonjë marrëdhënie;
nëse vlera është -/+ 0.001 deri 0.099, marrëdhënie me fortësi shumë të dobët, me drejtim negativ ose pozitiv;
nëse vlera është -/+ 0.100 deri 0.299, marrëdhënie me fortësi të dobët, me drejtim negativ ose pozitiv;
nëse vlera është -/+ 0.300 deri 0.499, marrëdhënie me fortësi mesatare, me drejtim negativ ose pozitiv;
nëse vlera është -/+ 0.500 deri 0.699, marrëdhënie është e forte, me drejtim negativ ose pozitiv;
nëse vlera është -/+ 0.700 deri 0.999, marrëdhënia është shumë e forte, me drejtim negativ ose pozitiv;
nëse vlera është -/+ 1, mes dy variablave egziston një marrëdhënie perfekte, me drejtim negativ ose pozitiv.

**Tabela 1.4. – Fortësia e Marrëdhënies së Cilësisë së MBNJKQ me Faktorët tek Universitetet**

| **Fortësia** | **tek Universitetet në Përgjithësi** | | **tek Universitetet Publike** | | **tek Universitetet Private** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **E** | Pearson | Spearman | Pearson | Spearman | Pearson | Spearman |
| **Marrëdhënies** | MBNJKQ me: | MBNJKQ me: | MBNJKQ me: | MBNJKQ me: | MBNJKQ me: | MBNJKQ me: |
| **-/+ 0.001 – 0.099 (shumë e dobët)** | Premisat | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. |
| **-/+ 0.100 – 0.299 (e dobët)** | Model<br>Tipar<br>Cilësia Stafit<br>Organizativ<br>SocioKulturor<br>Politik | Premisat<br>Praktika<br>Cilësia Stafit<br>Organizativ<br>Politik | Model<br>Premisat<br>Praktikat<br>Cilësia Stafit<br>Organizativ<br>Politik | Premisat<br>Praktikat<br>Organizativ<br>Politik | Model<br>Tipar<br>Premisa<br>Praktika<br>Cilësia Stafit<br>Organizativ<br>SocioKulturor<br>Politik | Premisat<br>Praktikat<br>Cilësia Stafit<br>Organizativ<br>Politik |
| **-/+ 0.300 – 0.499 (mesatare)** | n.a. | Model<br>Tipar<br>SocioKulturor | Tipar<br>SocioKulturor | Model<br>Tipar<br>Cilësia Stafit<br>SocioKulturor | n.a. | Model<br>Tipar<br>Socio-Kulturor |
| **-/+ 0.500 – 0.699 (e fortë )** | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. | n.a |
| **-/+ 0.700 – 0.999 (shumë e fortë)** | n.a | n.a. | n.a | n.a. | n.a. | n.a |

a. Ka të bëjë me fortësinë e marrëdhënieve mes Cilësisë së MBNJKQ dhe variablave të tjerë. Tabela 1.4 tregon se *tek Universitetet, fortësia e marrëdhënieve mes Cilësisë së MBNJ dhe*

*variablave të tjerë shfaqet midis niveleve "e dobët" dhe "mesatare."* Pavarësisht koeficientit Pearson apo Spearman që është përdorur për të matur fortësinë e marrëdhënieve,rezulton se shumica e marrëdhënieve shfaqin një fortësi të dobët (midis 0.100 dhe 0.299) dhe shumë pak marrëdhënie shfaqin një fortësi mesatare (midis 0.300 dhe 0.499). Cilësia e MBNJKQ shfaq një marrëdhënie të fortësisë mesatare vetëm me variablat "Modeli MBNJ", "Tipari MBNJ" dhe "Faktorin SocioKulturor."

b. Ka të bëjë me faktorët më të spikatur ndikues mbi Cilësinë e MBNJKQ.Tabela 5.19 tregon se *tek Universitetet variabli më ndikuess shfaqet "Faktori SocioKulturor".*

**Tabela 1.5.– 4 Faktorët më të Spikatur Influencues mbi Cilësinë e MBNJKQ tek Universitetet**

| | **tek Universitetet në Përgjithësi** | | **tek Universitetet Publike** | | **tek Universitetet Private** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pearson | Spearman | Pearson | Spearman | Pearson | Spearman |
| 1 | 33.2% SocioKulturor | 44.9% Socio-Kulturor | 33.2% SocioKulturor | 39.8% Cilësia Stafit | 26.3% SocioKulturor | 47.4% SocioKulturor |
| 2 | 33.0% Tipari MBNJ | 40.3% Tipari MBNJ | 33.0% Tipari MBNJ | 38.1% Tipari MBNJ | 25.4% Tipari MBNJ | 39.6% Tipari MBNJ |
| 3 | 32.6% Cilësia Stafit | 37.2% Modeli MBNJ | 32.6% Cilësia Stafit | 37.6% Modeli MBNJ | 24.0% Organizativ | 37.2% Modeli MBNJ |
| 4 | 29.2% Modeli MBNJ | 29.0% Cilësia Stafit | 29.2% Modeli MBNJ | 37.0% SocioKulturor | 20.8% Modeli MBNJ | 25.8% Premisat |

Nga të tetë variablat e analizuar, vetëm katër prej tyre shfaqen në katër "vendet e para"

1) Faktori SocioKulturor,
2) Modeli MBNJ,
3) Tipari kryesor i MBNJ, dhe
4) Cilësia e Stafit.

Faktori i parë bën pjesë në grupin e faktorëvë të "jashtëm" ndërsa tre të tjerët në grupin e faktorëve të "brendshëm". Pavarësisht matjes me koeficient "Pearson" apo Spearman", faktori "Socio-Kulturor" shfaqet ndikues në 26% deri në 47% të rasteve, i pasuar nga shfaqja e faktorit "Tipari Kryesor i MBNJ" në 25% deri 39% të rasteve. Çfarë tregojnë këto tre gjetje?

Konkluzioni që mund të nxirret është se tek universitetet, *pavarësisht nëse bëhet fjalë për universitete Publike apo Private,cilësia e politikave të MBNJ në aspektin e Kapaciteteve dhe Qarkullimit të njerëzve, reflekton një një masë të konsiderueshme zakonet socio-kulturore të pronarëve, drejtuesve, apo menaxhuesve të institucionit.* Pra, fakti kur punësohet, kush lëviz nga një pozion pune në një pozicion tjetër reflekton setin e vlerave dhe besimeve sociale dhe kulturore që karakterizon pjestarët e institucionit dhe qëndron në bazë të vendimeve dhe veprimeve të tyre.

## 3.3 Faktoraktorët më me ndikim mbi MBNJ në Universitetet Kosovare

Ky seksion analizon faktorët që ndikojnë dhe përcaktojnë Modelin e MBNJ tek universitetet kosovare. Ashtu si edhe në rastin e spitaleve, analiza heton dhe sqaron tre çështje:

1) Cilët janë faktorët më ndikues mbi Modeli e MBNJ në universitete,

2) Si e ushtrojnë ndikimin e tyre faktorët ndikues mbi Modelin e MBNJ, vetëm apo në kombinim, dhe

3) nëse pesha e faktorëve ndikues dhe mënyra e ushtrimit të ndikimittë tyre ndryshon nga universitetet publike tek ato private.

## 3.4 Faktorët më me ndikim mbi tipin e Modelit të MBNJ tek Universitetet

Analiza e faktorëve më ndikues shqyrton marrëdhëniet mes Modelit të MBNJ dhe gjashtë faktorëve:

1) Organizativë,
2) Socio-Kulturorë,
3) Politikë,
4) Premisave të konceptimit të Politikave MBNJ,

5) Praktikave në materializimin e politikave MBNJ, dhe
6) Cilësisë së stafit. Këtu studimi mban parasysh edhe ndikimin e tre faktorëve të fundit. Rezultatet e analizës "Correlation" përmblidhen në Tabelat 1.6, 1.7, dhe 1.8 Çfarë tregojnë ato? Vëzhgimi i parë mund të bëhet për fortësinë e marrëdhënieve. Siç shihet në Tabelat 5.20 dhe 5.21, pavarësisht nëse korrelacioni dhe fortësia e marrëdhënies është matur me koeficient Pearson apo Spearman, *Modeli MBNJ tek Universitetet tregon se ka një marrëdhënie "të fortë"*

**Tabela 1.6 – Modeli MBNJ & Faktorët Influencues - Analizë "Correlations" e Marrëdhënieve**

| Marrëdhënia | tek **Universitetet në Përgjithësi** | | tek **Universitetet Publike** | | tek **Universitetet Private** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Model MBNJ me:** | Koeficienti Pearson | Koeficienti Spearman | Koeficienti Pearson | Koeficienti Spearman | Koeficienti Pearson | Koeficienti Spearman |
| **Faktorët Organizativ** | 0.626** | 0.602** | 0.586** | 0.584** | 0.652** | 0.579** |
| **Faktorët SocioKulturor** | 0.571** | 0.534** | 0.514** | 0.538** | 0.621** | 0.545** |
| **Faktorët Politik** | 0.611** | 0.497** | 0.561** | 0.578** | 0.480** | 0.482** |
| **Premisat** | 0.459** | 0.449** | 0.343* | 0.359* | 0.539** | 0.479** |
| **Praktikat** | 0.676** | 0.659** | 0.589** | 0.626** | 0.735** | 0.670** |
| **Cilësinë e Stafit** | 0.664* | 0.693** | 0.660** | 0.701** | 0.668** | 0.710** |

**Shënim:** (*) tregon që koeficienti është i rëndësisshëm në nivelin 0.01, ose 99% të rasteve
(**) tregon që koeficienti është i rëndësishëm në nivelin 0.05, ose 95% të rasteve

**Tabela 1.7 – Fortësia e Marrëdhënies së Modelit të MBNJ me Faktorët tek Universitetet**

| **Fortësia** | **Universitetet nëPërgjithësi** | | **UniversitetetPublike** | | **UniversitetetPrivate** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **E** | Pearson | Spearman | Pearson | Spearman | Pearson | Spearman |
| **Marrëdhënies** | Modeli MBNJ me: | Modeli MBNJ me: | Modeli MBNJ me: | Modeli MBNJ me: | Modeli MBNJ me: | Modeli MBNJ me: |
| **-/+ 0.001 – 0.099 (shumë e dobët)** | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. |
| **-/+ 0.100 – 0.299 (e dobët)** | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. | n.a. |
| **-/+ 0.300 – 0.499 (mesatare)** | n.a. | Politik<br>Premisat | Premisat | Premisat | Politik | Politik<br>Premisat |
| **-/+ 0.500 – 0.699 (e fortë )** | Praktikat<br>Cilësia Stafit<br>Organizativ<br>SocioKulturor<br>Politik | Cilësia Stafit<br>Praktika<br>Organizativ<br>SocioKulturor | Cilësia Stafit<br>Praktikat<br>Organizativ<br>Politik<br>SocioKulturor | Praktikat<br>Organizativ<br>Politik<br>SocioKulturor | Cilësia Stafit<br>Organizativ<br>SocioKulturor<br>Premisa | Praktikat<br>Organizativ<br>Socio-Kulturor |
| **-/+ 0.700 – 0.999 (shumë e fortë)** | n.a | n.a. | n.a | Cilësia Stafit | Praktika | Cilësia Stafit |

**Tabela 1.8 – Renditja sipas fortësisë së marrëdhënies e Faktorëve influencues mbi Modelin e MBNJ**

| Renditja Faktorëve sipas Koeficientit "Pearson" | | | | Renditja Faktorëve sipas koeficientit "Spearman" | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Universitetet në Përgjithësi | Universitetet Publike | Universitetet Private | | Universitetet në Përgjithësi | Universitetet Publike | Universitetet Private |
| 1 | 67.6% Praktikat | 66.0% Cilësia Stafit | 73.5% Praktikat | 1 | 69.3% Cilësia Stafit | 70.1% Cilësia Stafit | 71.0% Cilësia Stafit |
| 2 | 66.4% Cilësia Stafit | 58.9% Praktikat | 66.8% Cilësia Stafit | 2 | 65.9% Praktikat | 62.6% Praktikat | 67.0% Praktikat |
| 3 | 62.6% Organizativ | 58.6% Organizativ | 65.2%Organizativ | 3 | 60.2% Organizativ | 58.4% Organizativ | 57.9% Organizativ |
| 4 | 57.1% SocioKultur | 56.1% Politik | 62.1% SocKulturor | 4 | 53.4% SocioKultur | 57.8% Politik | 54.5% SocioKultur |
| 5 | 51.1% Politik | 51.4% SocioKultur | 53.9% Premisat | 5 | 49.7% Politik | 53.8% SocioKultur | 48.2% Politik |
| 6 | 45.9% Premisat | 34.3% Premisat | 48.0% Politik | 6 | 44.9% Premisa | 35.9% Premisat | 47.9% Premisat |

*me shumicën e variablave.* Modeli i MBNJshfaq një marrëdhënie "të fortë" me katër faktorë:

1) Organizativ,
2) SocioKulturor,
3) Politikë, dhe
4) Praktikat.

Ai shfaq gjithashtu një marrëdhënie "shumëtë fortë" me "Cilësinë e Stafit" dhe i vetmi faktor me të cilin Modeli i MBNJ shfaq një marrëdhënie me fortësi mesatare është faktori "Premisat."

Vëzhgimi i dytë mund të bëhet për faktorët që spikasin në marrëdhëniet e tyre me Modelin e MBNJ. Siç tregon Tabela 5.22, pavarësisht matjes me koeficient Pearson apo Spearman, dhe pavarësisht faktit nëse bëhet fjalë për universitet publik apo privat, *tek universitetet, faktorët që spikasin më shumë në raport me Modelin e MBNJ janë "Cilësia e Stafit" dhe "Praktikat" në materializimin e politikave të burimeve njerëzore*. Po ashtu, edhe faktorët e natyrës "Organizative", "Socio-Kulturore", dhe "Politike" shfaqin një marrëdhënie të rëndësishme me Modelin MBNJ. Ndaj një analizë e dinamikave të Modelit të MBNJ bën të nevojshme marrjen parasysh të rolit dhe ndikimit të të pesë këtyre faktorëve.

## 3.5 Mënyra e ndikimit të Faktorëve në Modelin e MBNJ tek Universitetet

Mënyra se si ndikojnë mbi Modelin e MBNJ pesë variablat e identifikuar më sipër dhe si ata që shfaqin një marrëdhënie të rëndësishme me Modelin e MBNJ mund të sqarohet me një analizë regresioni. Analiza krijon një ide më të qartë cili është kontributi i pesë faktorëve mbi variancën që vëzhgohet në variablin e varur "Modeli MBNJ" dhe nëse ky kontribut realizohet vetëm individualisht apo edhe në kombinim. Ashtu si edhe në rastin e spitaleve, analiza regresive që kryhet është ajo "CATREG", e cila njihet ndryshe edhe si "Analiza e Regresionit për Variablat Kategorikë"..Kjo analizë u krye për universitetet në përgjithësim dhe universitetet publike dhe private në vecanti. Tabela 1.9 dhe Tabela 1.10 përmbledhin rezultatet e analizës. Çfarë tregojnë ato?

Siç shihet në Tabelën 1.9, *kur variablat shihen nga pikëpamja e kontributit individual* mbi

variancën e variablit të varur Modeli MBNJ, *variabli me peshë më të madhe kontribuese*

**Tabela 1.9 – Kontributi Individual i Faktorëve mbi Variancën e "Model MBNJ"**

| | **Pesha e Kontributit Individual të Variablave mbi Variancën e Variablit të Varur "Modeli MBNJ"** | | |
|---|---|---|---|
| **Koefiecienti R2 (part2)** | tek Universitetet në Përgjithësi | tek Universitetet Publike | tek Universitetet Private |
| Organizativ | 14.2 % | 44.6 % | 33.5 % |
| Praktika | 5.3 % | 0.2 % | 11.9 % |
| Cilësia e Stafit | 17.6 % | 18.6 % | 16.5 % |
| Socio-Kulturor | 8.5 % | 28.7 % | 13.0 % |
| Politik | 17.3 % | 7.2 % | 6.1 % |

**Shënim:**Kontributi individual i secilit faktor është kalkuluar mbi bazën e koeficientëve "part" që përmban tabela "Correlations and Tolerance" që gjenerohet nga CATREG.

**Tabela 1.10 – Kontributi i Faktorëve mbi Variancën e "Modeli MBNJ" në Kombinim me Njëri-Tjetrin**

| | **Renditja sipas Fortësisë** | **Kombinimet e Variablave të Pavarur sipas Fortësisë së Marrëdhënies** | **Fortësia e Marrëdhënies** | **Kontributi i Ndikimit në kombinim me njëri-tjetrin** |
|---|---|---|---|---|
| **Universitetet** | 1 | Praktikat & Stafi | 0.418 | 60.2 % |
| | 2 | SocioKulturor & Politik | -0.401 | 57.3 % |
| | 3 | SocioKulturor & Staf | -0.349 | 57.0 % |
| | 4 | SocioKulturor & Praktikat | -0.308 | 69.3 % |
| | 5 | Politik & Staf | 0.244 | 48.2 % |
| | 6 | Organizativ & Staf | 0.153 | 51.3 % |
| | 7 | Organizativ& Politik | 0.134 | 51.6 % |
| | 8 | Politik & Praktikat | 0.120 | 60.5 % |
| | 9 | Organizativ & Praktikat | -0.035 | 63.6 % |
| | 10 | SocioKulturor & Organizativ | -0.010 | 60.3 % |
| **U-Publike** | 1 | Politik & Staf | -0.683 | 74.2 % |
| | 2 | SocioKulturor & Politik | -0.581 | 64.1 % |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 3 | Praktikat & Staf | -0.440 | 81.2 % |
| | 4 | SocioKulturor & Staf | 0.372 | 52.7 % |
| | 5 | Politik & Praktikat | 0.363 | 92.6 % |
| | 6 | SocioKulturor & Organizativ | -0.238 | 26.7 % |
| | 7 | SocioKulturor & Praktikat | 0.213 | 71.1 % |
| | 8 | Organizativ & Politik | 0.146 | 48.2 % |
| | 9 | Organizativ & Staf | -0.146 | 36.8 % |
| | 10 | Organizativ & Praktikat | -0.034 | 55.2 % |
| **U-Private** | 1 | Organizativ & Praktikat | 0.395 | 47.3 % |
| | 2 | SocioKulturor & Staf | -0.336 | 63.2 % |
| | 3 | SocioKulturor & Politik | -0.164 | 73.6 % |
| | 4 | SocioKulturor & Praktikat | -0.153 | 67.8 % |
| | 5 | Praktikat & Staf | 0.118 | 64.3 % |
| | 6 | Organizativ & Politik | -0.085 | 53.1 % |
| | 7 | Organizativ & Staf | -0.062 | 42.3 % |
| | 8 | Politik &Staf | 0.039 | 70.1 % |
| | 9 | Organizativ & SocioKulturor | -0.016 | 46.2 % |
| | 10 | Politik & Praktikat | 0.015 | 74.7 % |

**Shënim:**Kontributi i faktorëve në kombinim me njëri-tjetrin është kalkuluar mbi bazën e koeficientëve "part" dhe "R Square"që përmbajnë tabelat "Correlations & Tolerance" dhe "Model Summary" që gjenerohen nga analiza CATREG

*shfaqet faktori "Organizativ," me 44.6% tek universitetet publike dhe 33.5% tek ato private.* Tek universitetet publike, dy variabla të tjerë që shfaqin një kontribut të konsiderueshëm janë faktori "SocioKulturor" (29%) dhe "Cilësia e Stafit" (19%). Ndërsa tek universitetet private variablat e tjerë kontribues janë tre: "Cilësia e Stafit" (16.5%), faktorët e natyrës SocioKulturore (13%), dhe "Praktikat" (12%). Nisur nga këto shifra, universitetet publike dhe private shfaqin dy gjëra të përbashkëta:

1) faktorët e "brendshëm" shfaqen më aktivë dhe japin një kontribut individual më të madh se faktorët e "jashtëm", dhe

2) roli i faktorit "Cilësia e Stafit" rezulton i rëndësishëm për variancën në Modelin e MBNJ si tek universitetet publike edhe tek ato private.

*Kur variablat shihen nga pikëpamja e kontributit në kombinim me njëri-tjetrin mbi variancën e variablit të varur "Modeli MBNJ", kombinimet me peshë më të madhe janë ato që përmbajnë variabla "Praktikat" dhe "Cilësia e Stafit".* Tek universitetet Publike, janë katër kombinime, ose 40% e gjithë kombinimeve, që përmbajnë variablat "Praktikat" dhe "Cilësia e Stafit" dhe që shfaqin një kontribut të përbashkët midis 71% dhe 93%: "Praktikat+ Politik" (92.6%), "Praktikat+Cilësia Stafit" (81.2%), "Staf+Politik" (74.2%), "Praktikat+SocioKulturor" (71.1%). Ndërsa tek universitetet Private, janë tre kombinime, ose 30% e gjithë kombinimeve, që përmbajnë variablat "Praktikat" dhe "Cilësia Stafit" dhe që shfaqin një kontribut të përbashkët midis 70% dhe 75%: "Praktikat+Politik" (74.7%), "SocioKulturor+Politik" (73.6%), "Cilësia Stafit+Politik" (70.1%).

Çfarë mund të na thonë këto vëzhgime? Së pari, ato na thonë që Modeli i MBNJ tek universitetet është produkt i rolit dhe ndikimit jo vetëm individual, por edhe në kombinim i variablave të përzgjedhur. Së dyti, ato na thonë që *tek universitetet, Modeli i MBNJ ndikohet dhe përcaktohet kryesisht nga faktorët e brendsh*ëm. Kjo duket jo vetëm në numrin më të madh të variablave të "brendshëm" që shfaqen aktiv qoftë individualisht, qoftë në kombinim, por edhe në kontributin dhe prezencën e faktorëvë të brendshëm edhe tek kombinacionet që shfaqin një kontribut të rëndësishëm ndikues mbi Modelin e MBNJ.

- *Hipoteza: Universitete Publike dhe Private dallojnë në raport me Faktorët Ndikues*

Për të parë nëse mes universiteteve publike dhe private egzistojnë dallime në raport me rolin dhe indikimn e faktorëve ndikues, përdoret informacioni që gjeneron analiza CATREG. Ky informacion sqaron tre gjëra:

1) nëse faktorin kryesor ndikues është i njëjtë apo i ndryshëm;

2) nëse faktorët janë ose jo të gjithë të rëndësishëm, dhe

3) nëse ndikimi i faktorëve të "brendshëm" dhe të "jashtëm" mbi Modelin e MBNJ është e njejtë apo e ndryshme.

Kur universitetet krahasohen mes tyre nga pikëpamja e faktorit kryesor ndikues, *tek universitetet publike dhe ato private nuk ka ndonjë dallim; faktorët e natyrës "Organizative" rezultojnë si faktori më ndikues mbi Modelin e MBNJ*. Siç mund të shihet më lart në Tabelën 5.23, i vetmi dallim është masa e ndikimit: tek universitetet publike faktorët e natyrës organizative kontribuojnë në masën 45% ndërsa tek universitetet private në masën 34%.
Kur universitetet krahasohen mes tyre nga pikëpamja e rëndësisë së rolit të faktorëve ndikues, *universitetet publike dhe private dallojnë nga njëri-tjetri*. Sa i rëndësishëm është një faktor në rolin e vet e tregon koeficienti "Sig". Faktorët të rëndësishëm në mënyrë kritike janë ata që shfaqin një Sig = 0.000. Siç mund të shihet në Tabelat 5.25 dhe 5.26, tek universitetet publike shfaqen të rëndësishëm në mënyrë kritike vetëm tre faktorë, specifikisht ata "Organizativ", "Socio-Kulturor", dhe "Cilësia e Stafit", ndërsa tek universitetet private mund të konsiderohet i një rëndësie kritike vetëm faktori "Organizativ", ndërsa katër faktorët e tjerë nuk rezultojnë të tillë.

Kur universitetet krahasohen nga pikëpamja e peshës së rolit dhe ndikimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, universitetet Publike dhe ato Private dallojnë nga njëri-tjetri.

**Tabela 1.11 – Koeficentët CATREG: Rëndësia e FaktorëvetekUniversitetet Publike**

| | Standardized Coefficients | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Beta | Bootstrap (1000) Estimate of Std. Error | df | F | Sig. |
| Organizativ | .690 | .154 | 5 | 20.152 | .000 |
| SocioKulturor | .813 | .184 | 4 | 19.472 | .000 |
| Politik | .457 | .209 | 5 | 4.789 | .011 |
| Praktikat | .053 | .141 | 5 | .142 | .979 |
| Cilesia Stafit | .624 | .203 | 5 | 9.401 | .001 |

Dependent Variable: ModeliMBNJ

**Tabela 1.12 – Koeficentët CATREG: Rëndëisa e Faktorëve tek Universitetet Private**

| | Standardized Coefficients | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Beta | Bootstrap (1000) Estimate of Std. Error | df | F | Sig. |
| Organizativ | .638 | .303 | 5 | 4.424 | .005 |
| SocioKulturor | .393 | .240 | 5 | 2.672 | .046 |
| Politik | .253 | .255 | 5 | .987 | .445 |
| Praktikat | .384 | .291 | 5 | 1.733 | .164 |
| Cilesia Stafit | .437 | .267 | 5 | 2.675 | .045 |

Dependent Variable: ModeliMBNJ

Si mund të shihet në Tabelën 1.11, *tek Universitetet Publike masa e ndikimit të faktorëve të "jashtëm" është më e madhe se ajo e faktorëvë të "brendsh*ëm*", ndërsa tek universitetet private, masa e ndikimit të faktorëvë të "brendsh*ëm*" është më e madhe se ajo e faktorëvë të "jashtëm"*. Tek universitetet publike faktorët "SocioKulturor" dhe "Politik" kontribuojnë së bashku mbi variancën në Modelin e MBNJ me 36% përkundër 33% që është kontributi i përbashkët i faktorëve "Organizativ," "Praktikat", dhe "Cilësia e Stafit". Tek universitetet private faktorët "Organizativ", "Praktikat" dhe "Cilësia e Stafit" kontribuojnë së bashku me 62% në variancën e Modelit të MBNJ përkundër vetëm 19% që kontribuojnë faktorët "SocioKulturor" dhe "Politik."

**Tabela 1.12– Dallimet mes Universiteteve Publike dhe Private për Kontributin e Faktorëve Influencues**

| | | Universitetet Publike | Universitetet Private |
|---|---|---|---|
| Faktorët | | Kontributi Individual (R2) në Variancën e "Modeli MBNJ" | Kontributi Individual (R2) në Variancën e "Modeli MBNJ" |
| të Brëndëshëm | Organizativ | 14.2 % | 33.5 % |
| | Praktikat | 0.2 % | 11.9 % |
| | Cilësia Stafit | 18.6 % | 16.5 % |
| | **Totali** | **33.0 %** | **61.9 %** |
| të Jashtëm | SocioKulturor | 28.7 % | 13.0 % |
| | Politik | 7.2% | 6.1 % |
| | **Totali** | **35.9 %** | **19.1 %** |

Nisur nga fakti që universitetet publike dhe private e kanë të njëjtë faktorin kryesor ndikues por dallojnë nga pikëpamja e rëndësisë dhe peshës kontribuese të faktorëve kryesorë, mund të thuhet

se *Hipoteza dytësorese mes universiteteve publike dhe atyre private egzistojnë dallime në raport me faktorët ndikues është e vërtetë.*

- *Hipotezë: Tipi Modelit të MBNJ në Universitet pasqyron Tipin e FaktorëveNdikues*

Përtej sqarimit të vërtetësisë së Hipotezës dytësore, tre vëzhgimet më sipër e shtrijnë vlerën e tyre edhe në sqarimin e Hipotezës Kryesore të studimit. hipotezohet se çfarë Tipi të Modelit të MBNJ vëzhgohet në universitet, kjo reflekton në një masë të konsiderueshme faktin se cilët faktorë, të brendshëm apo të jashtëm, ushtrojnë ndikim më të madh. Analiza CATREG tregoi se universitetet Publike ndikohen më shumë nga faktorë të jashtëm ndërsa universitetet Private ndikohen më shumë nga faktorët e brendshëm.
Fakti që tek Universitetet Publike Modeli i MBNJ ndikohet më shumë nga faktorë të jashtëm si ata "Politik" dhe "SocioKulturor" shtyn drejt konkluzionit që *tipi i Modelit të MBNJ tek universitetet publike ngjason më shumë me modelin "Harvard".* Ndërsa fakti që tek Universitetet Private, janë faktorët e brendshëm "Organizativ", "Praktikat," dhe "Cilësia e Stafit" që ushtrojnë ndikim më të madh, shtyn drejt konkluzionit që *tipi i Modelit të MBNJ tek Universitetet Private ngjason më shumë me modelet "Michigan", "Guest", apo "Storey".*

## 4. Konkluzione

Nisur nga sa më sipër, në rastin e Universiteteve Private *duket se rezultatet shkojnë në harmoni me perceptimin e njerëzve se në universitetet Private Modeli i MBNJ ngjason në tipare me atë të Modelit Guest.* Në seksionin e parë që diskutoi tipin e Modelit të MBNJ tek universitetet, 44.8% e personave të pyetur e shihnin modelin që aplikonin universitetet private të ngjashëm me Modelin "Guest." Ndërsa në rastin e Universiteteve Publike, duket se rezultatet e mësipërme nuk përputhen me perceptimin e njerëzve.

- Këtu analiza tregoi se midis universiteteve Publike dhe atyre Private ka një dallim të rëndësishëm në cilësinë e MBNJKQ, qoftë nga pikëpamja e shkallës, qoftë edhe nga pikëpamja e peshës. Universitetet publike dhe private, tregojnë sidoqoftë që tek të dy tipet, cilësia e MBNJKQ ndikohet shumë nga faktorët e natyrës SocioKulturore. Pra, ndikohet nga faktorë të jashtëm si zakonet sociale që karakterizojnë sjelljen dhe të menduarit e drejtuesve dhe menaxherëve të universiteteve.
- Faktori kryesor ndikues, si tek universitetet Publike edhe ato Private rezulton ai i brendshëm "Organizativ". Edhe faktorët "Socio-Kulturorë" dhe "Politikë" janë të rëndësishëm, por ata sidoqoftë, nuk shfaqen më të rëndësishëm se faktorët "Organizativë". Roli, pesha, ndikimi i tyre mbi dinamikat dhe cilësinë e Modelit të MBNJ është i rëndësishëm realizohet sa individualisht, aq në kombinim me njëri-tjetrin ose me disa faktorë të tjerë të brendshëm si "Praktikat" dhe "Cilësia e Stafit". Analiza tregoi se mes universiteteve publike dhe atyre private egziston një dallim nga pikëpamja e marrëdhënieve me faktorët e brendshëm dhe te jashtëm. Universitetet Publike dhe Modeli i tyre i MBNJ janë më të ndikuar nga, dhe po ashtu më të ndjeshëm, ndaj ndikimit të faktorëve të jashtëm "SocioKulturorë" dhe "Politikë." Universitetet Private janë më të ndikuar nga, dhe po ashtu më të ndjeshëm, ndaj ndikimit të faktorëve të brendshëm si ata të natyrës "Organizative". Kjo mund të shpjegojë edhe përse modeli i MBNJ tek universitetet private perceptohet nga njerëzit, dhe po ashtu rezulton edhe nga analiza, të ngjasojë më shumë në tipare me Modelin Michigan apo Guest ndërsa tek universitetet publike të ngjasojë më shumë me Modelin Harvard.

# MENAXHIMI I ASETEVE PUBLIKE NË NIVEL VENDOR, FORCIMI KAPACITETEVE TË NJËSIVE TË VETË-QEVERISJES VENDORE PËR MENAXHIMIN E ASETEVE VENDORE, RASTI I BASHKISË SHKODËR

**MANJOLA XHAHYSA STRINIQI(Master në Financë)**

**Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës, Sp.Kontabiliteti**

**Servete Ligataj Lleshi (Master ne Turizem)**

**As.Prof.Universiteti UVA**

Konsolidimi iReformës Administrative dhe Territorale me shtrirje në 61 bashki të Shqipërisë, ka sjellë rritjen në numër dhe në vlerë të portofolit të aseteve për bashkitë tona. Nga ana tjetër bashkitë janë përpara një procesi të vazhdueshëm transferimi asetesh nga qeveria qëndrore,ligji nr.115, dt.31.07.2014, Për ndarjen administrative territoriale, të njësive të qeverisjes vendore,në vijim të detyrave që mbart zbatimi i VKM Nr.510, dt.10.06.2015, Për Miratimin e Procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe të çdo dokumentacioni tjetër në njësitë e qeverisjes vendore që preken nga riorganizimi administrativo territorial, Kreu VI-te "Transferimi i pasurive dhe rregjistrimi i Pasurive te Pajuajtshme, pika, 1,2,

Sipas një vlerësimi PEFA (vlerësim i shpenzimeve publike dhe përgjegjshmërise financiare), bashkitë kryejnë disa procese që kanë të bëjnë me menaxhimin e aseteve të tyre, por që nuk janë të mjaftueshme.

***Pika I- Asetet bashkiake, kategoritë dhe rregjistrimi i tyre:***

1-Përse nevojitet menaxhimi efektiv i aseteve

Objektivi kryesor i punimit është të mundësojë qeverisjen vendore/bashkinë në arritjen e një niveli të shërbimit të aseteve në mënyrën më të mirë të mundshme përsa i përket efektivitetit të kostos.

Qëllimi kryesor është zgjatja e jetës së pritshme të shërbimit të aseteve dhe në këtë mënyre ruajtja e performancës së tyre.

2-Cilat janë asetet tipike bashkiake dhe karakteristikat sipas kategorive

Asetet janë pasuria e një njësie ekonomike.

***Asetet kryesore bashkiake ndahen sipas klasifikimit kontabël në:***

-Toka, Troje, Terrene

-Ndërtesa (shkolla, kopshte, konvikte)

-Pyje, Kullota, Ujësjellësa

-Automjetet

-Orendi dhe paisje të pastrimit, të gjelbërimit

-Asetet infrastrukturore/rrjete kanalizimesh

-Paisje zyre të administrimit

-Paisje teknologjike software, etj

***Asetet bashkiake mund të ndahen edhe sipas natyrës së shërbimit:***

-Asete infrastrukturore (janë pjesë e një sistemi/rrjeti, jane të pa luajtshme, janë objekt ndërtimi dhe shkatërrimi), për shembull: rrjetet rrugore, rrjetet e kanalizimeve, rrjeti i ujësjellësave etj

-Asetet Komunitare (janë asetet që kontribuojnë në mirëqënien e komunitetit të tilla si parqet, librari, stacione zjarrfikëse

-Asetet e lehtësirave komunitare (përfshihen asetet që sigurojnë një shërbim direkt për komunitetin si për shembull: objektet sportive, varrezat publike, landfill të përpunimit të mbeturinave)

-Asetet e trashëgimisë kulturore janë burimet kulturore që shërbejnë si objekte arti, psh.ndërtesat historike, statuja etj

-Investimet në prona që janë siguruar për qëllime të përfitimeve ekonomike dhe kapitale, të tilla si ndërtesat për zyra të dhëna me qera nga ana e bashkise, toka të pa zhvilluara me qëllim rishitje në të ardhmen, etj

-Asetet Atraktive

3-Rregjistrimi i aseteve, numri i identifikimit individual të aseteve

Në këtë punim jemi fokusuar më tepër në analizimin e aseteve afatgjata materiale (asetet fikse)Asetet afatgjata materiale janë asete të identifikueshme që kontrollohen nga bashkia e cila mbart edhe riskun për to, janë asete jo monetare, kanë përmbajtje fizike. Asetet afatgjata materiale zhvlerësohen gradualisht gjatë jetës së tyre duke humbur vlerën e përdorimit të tyre. Asetet afatgjata materiale kane një jetë të dobishme më shumë së nje vit kontabël.

4-Rolet në menaxhimin e aseteve bashkiake dhe përgjegjësite e secilit

Menaxhimi i aseteve bashkiake është procesi i inventarizimit, vlerësimit, përdorimit, shqyrtimit strategjik të portofolit, raportimin dhe auditimin e pasurive bashkiake si pjesë e procesit të vendimmarrjes së qeverisë lokale.Asetet afatgjata materiale fikse mund të menaxhohen në menyrë të drejtëperdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në dobi të ofrimit të shërbimeve lokale. Asetet bashkiake menaxhohen mirë kur ato i shërbejnë një shpërndarjeje të qëndrueshme të shërbimeve bashkiake. Ai është njëprocesi integruar imonitorimit, mirëmbajtjes, përmirësimit, vlerësimit, rivlerësimit dhe të asgjësimit të aseteve në mënyrë efektive nga pikëpamja e kostos, duke ruajtur një nivel të dëshiruar të shërbimit .

***Pika II-Aspekte të menaxhimit të aseteve:***

1-Sistemi i kontrollit për menaxhimin e aseteve, asetet kritike dhe menaxhimi i riskut

Asetet kanë një jetë të caktuar të shërbimit të tyre dhe më pas fillon degradimi i gjendjes së asetit dhe performancës së përdorimit të tij, duke rritur kostot e mirëmbajtjes së tij. Për ta shmangur këtë me investim strategjik në kohë mund të zgjatet cikli i përgjithshëm i jetës së aktivit. Çelësi është të ndërhyhet përpara se degradimi të ketë arritur një pikë të caktuar, kur është më shumë ekonomike zëvendësimi i aktivit.

2-Modelet e riskut dhe aktiviteteve të kontrollit për menaxhimin e aseteve

Rakordimi dhe kontrolli periodik i tyre për të dhënë siguri që asetet janë të mbrojtura mire nga çdo humbje apo shpërdorim.

3-Menaxhimi i aseteve për ofrimin e qendrueshëm të shërbimeve për qytetarët

Arritja kryesore e mirë menaxhimit të aseteve është sigurimi i banoreve lokale me sherbime të përmiresuara, tërheqjen e më shumë investitoreve vendas dhe të huaj, përmirësimi i cilësisë së jetesës të banorëve të komunitetit.

4-Menaxhimi Financiar i Aseteve perfshin,

*Buxhetimin, prokurimin, financimin, kostimi, vlerësimi, rivlerësimi, kontabilizimi dhe nxjerrja jashtë përdorimi (shitja, dhurimi, transferimi, këmbimi etj)

***Pika III -Struktura e Menaxhimit Strategjik të Aseteve:***

1-Hartimi i politikave, programeve, planeve dhe strategjive të menaxhimit të aseteve bashkiake

Këtu përfshihen politikat dhe praktikat e mbajtjes së inventarit të saktë të tyrenëpërmjet rregjistrimit të tyre, organizimit dhe mirëmbajtjes së rregjistrit të tyre.Plotësimi i formulareve individual për çdo lloj aseti (ID e asetit), është një identifikues unik i cili caktohet për cdo aset. Mënyra e identifikimit ndryshon sipas natyrës së asetit. Nëse një aset është bashkim i disa të tillave, përdoret një ID, por specifikohet secili element më vete për shkak se ka natyrë, vlerë dhe kohë blerje të ndryshme, këto quhen asete të lidhura.Bashkitë duhet të specifikojnë koordinatat për secilin aset, që është vendndodhja hapsinore/gjeografike, për të dalluar asetet e ngjashme.

2-Hartimi i Planit Financiar Strategjik të menaxhimit efektiv të aseteve

Të gjitha bashkitë duhet të kenë një plan të menaxhimit të aseteve të tyre kapitale, plani duhet të përfshijë minimalisht:

- ✓ Një inventar të plotë të të gjithë aseteve
- ✓ Një raport mbi gjendjen fizike të aseteve
- ✓ Një listë prioritetesh për menaxhimin e ciklit të jetës
- ✓ Strategjinë e menaxhimit
- ✓ Strategjinë e financimit

Afati kohor minimal i planifikimit është normalisht 10 vjet. Ai mbështetet në parimet e menaxhimit dhe miratohet nga kryetari i bashkise dhe më tej nga këshilli bashkiak. Gjithashtu plani financiar afatgjatë duhet të konsiderojë, kostot e zhvlerësimit të aseteve dhe burimet e të ardhurave për tju përshtatur këtyre kostove.

Hapat e inventarizimit të aseteve:

- ✓ Plotësimi i formularëve individual për çdo lloj aseti
- ✓ Plotësimi i rregjistrit të aseteve
- ✓ Plotësimi i formularit të inventarizimit
- ✓ Hartimi i raportit mbi inventarin dhe gjendjen e aseteve

***Pika IV-Teknikat e menaxhimit te aseteve:***

1-Inventarizimi, mirëmbajtja e aseteve

Çdo bashki duhet të ketë një plan të mirëmbajtjes në lidhje me çdo aset të rregjistruar në rregjistrin e aseteve, I cili miratohet nga Këshilli i Bashkisë, afati i miratimit të tij mund të jetë njëherazi me projekt buxhetin, ndërsa për asetet ekzistuese që tejkalojnë një vlerë të caktuar,

mund të kërkohet raport për të analizuar kostot e mirëmbajtjes që kanë ndodhur gjatë vitit financiar.

Ka dy lloje mirëmbajtje te asetit:

-mirëmbajtje e shfrytëzimit, e cila nuk e shton vlerën e asetit por përmirëson dobinë e tij dhe

-mirëmbajtje e përgjithshme, e cila e shton vlerën e asetit , jetën dhe dobishmërinë

2-Menaxhimi i ciklit të jetës së aseteve

Jeta e dobishme e asetit është një element i rëndësishëm për përcaktimin e kohës së zëvendësimit të tyre, ajo është koha gjatë së cilës aktivi pritet të jetë i disponueshëm për përdorim.

3-Hartimi i raportit të vlerësimit fizik të aseteve

Raporti vjetor (inventarizimi) i verifikimit të aseteve duhet të përfshijë

- ✓ Listën e plotë të aseteve për periudhën e verifikimit
- ✓ Nëse të gjitha rregjistrimet janë mbajtur korrekt dhe cilat asete duhet të ishin gjetur gjatë verifikimit
- ✓ Çdo mospërputhje midis rregjistrimeve dhe aseteve të gjetura në fakt
- ✓ I përcillet me shkresë departamenteve përkatëse për diferencat e gjetura gjatë verifikimit nëse ka.

4-Identifikimi i kostove dhe amortizimit të aseteve

Të gjitha asetet fikse, përveç tokës, pasuritë në ndërtim dhe asetet e trashegimisë do të konsumohen ose amortizohen. Zhvlerësimi mund të përkufizohet si matja monetare e masës në të cilën përdoret një aktiv fiks ose konsumohet për sigurimin e përfitimeve ekonomike ose në ofrimin e shërbimeve, zhvlerësimi në përgjithësi merr formën e një shpenzimi të llogaritur (zakonisht çdo fund viti). Në llogaritjen dhe rregjistrimin e amortizimit mbahen parasysh

- ✓ Jeta e dobishme e aktivit në vite
- ✓ Norma e Amortizimit-një tregues në % që zbatohet mbi vlerën kontabël të asetit për çdo vit, për të llogaritur shumën vjetore të amortizimit
- ✓ Metoda e amortizimit që përdoret-lineare, progressive ose regresive

5-Nxjerrja jashtë përdorimi i aseteve dhe zëvendesimi i tyre.

Kostoja e zëvendësimit mund të gjendet duke përdorur një sere metodash, si psh

- ✓ Kostoja e kapitalit progresiv, psh duke perdorur koston e ndërtimit të asetit dhe duke i shtuar nga viti në vit koston, nga viti i ndërtimit në vitin aktual
- ✓ Kostoja e sigurimit të zëvendësimit, diskutohet me ofruesin e aseteve për të përcaktuar atë që ata konsiderojnë të jetë kostoja e parashikuar e zëvendësimit
- ✓ Kostoja e vlerësimit, përcaktohet duke u konsultuar me një kontraktor ose inxhinjer për të përcaktuar se sa do të ishte kostoja që aseti të rindertohej plotësisht.
- ✓ Jetëgjatësia e shërbimit, një vlerësim në vite për sa kohë aktivi do ti shërbejë bashkisë, kjo gjendet duke përdorur moshën aktuale të asetit dhe duke e krahasuar atë me jetëgjatësinë mesataretë shërbimit të aseteve të ngjashëm.

6-Bazat e vlerësimit dhe rivlerësimit

Kostoja historike është kostoja e sigurimit të tyre në hyrje

Kostoja korente është kostoja që do të sigurohej nësë i njëjti aktiv do të blihej sot, ose një detyrim do të shlyhej sot.

Vlera e realizueshme është vlera që do të merrej nëse aktivi do të shitej ose detyrimi do të paguhej me vlerën e shlyerjes, pas skontimit.

Vlera aktuale është vlera e skontuar e flukseve të hyrjes neto ëe ardhme të mjeteve monetare që aktivi pritet të krijojë gjatë jetës.

7-Problemet e vlerësimet në hyrje të aktivit

- ✓ Përcaktimi i sakte i vlerës në hyrje
- ✓ Përcaktimi i pjesës që përfshihet në shpenzim çdo periudhë kontabël
- ✓ Përcaktimi i përdorimit të aktivit në të ardhmen (ose përcaktimi i vlerës së mbetur të pa konsumuar ende)
- ✓ Përcaktimi i jetës së dobishme të asetit, koha gjatë të cilës aktivi pritet të jetë i disponueshëm në përdorim

  Sa më sipër,

***Kosto historike*** është kostoja e sigurimit në fillim të aktivit, dhe përbëhet nga çmimi i blerjes së aktivit, plus taksat doganore dhe taksat e tjera të pa rimbursueshme në blerje, plus kosto të tjera direkte të transportit deri në vënien në punë të aktivit (siguracione, instalime, testime, etj). Nëse aktivi blihet ose prodhohet me hua, interesi kapitalizohet deri në momentin e mbylljes së blerjes ose të prodhimit, më tej konsiderohet si shpenzim.

***Vlera kontabël*** e aktivit është vlera që paraqitet në kontabilitet e aktivit

**Vlera kontabël=vlera fillestare e aktivit + rivlerësimet**

**Vlera kontabël neto= vlera kontabel –amortizimin**

Në një bashki asetet mund të hyjnë në disa mënyra:

- ✓ Të blera nga të tretët
- ✓ Prodhuar ose ndërtuar vetë
- ✓ Të marra në këmbim të aktiveve të tjera
- ✓ Të marra dhuratë ose të transferuara

Sidoqoftë mënyra e hyrjes, vlerësimi në hyrje përbën vlerën fillestare të aktivit

8-Aktivet objekt dhurimi

Qeveria qëndrore (ose donator të tjerë) i dhuron bashkisë asete si rezultat i kalimit të një funksioni, ose kundrejt disa marrëveshjeve dypalëshe me karakter social, këto asete vlerësohen në hyrje me vlerën e drejtë në momentin e dhurimit, dmth çmimin që pranohet për tu tregtuar një aset. Nëse kjo nuk është e mundur, me vlerën kontabël të dhuruesit, nëse as kjo nuk është e mundur me një vlerë të çmuar të tyre nga ekspertë vlerësues.

Qeveria qëndrore mund ti japë asaj vendore grante për aktive, dmth mund ti japë mjete financiare që bashkia të blejë ose të ndërtojë një aktiv. Asetet në këtë rast njihen me koston e blerjes/prodhimit, granti për AAM, njihet si e ardhur e shtyrë (si detyrim), dhe do të njihet gradualisht në të ardhura gjatë jetës së dobishme të aktivit të marrë nga granti

9-Rivlerësimi i aseteve

Rivleresimi i aseteve bëhet kryesisht në fund të periudhës (vitit kontabel), por edhe gjatë saj. Rivlerësimit i nënshtrohen të gjitha asetet fikse. Me vlerë të rivlerësuar kuptojmë vlerën e tregut

që rezulton nga rivleresimi më i fundit minus amortizimin e akumuluar minus humbjet e akumuluara nga zhvlerësimet e vlerës së mëparshme. Eshte mirë që rivlerësimi të bëhet çdo vit.

Rritjet nga rivlerësimi kontabilizohen në mënyrë që asetet të dalin me vlerën e tyre reale të rivlerësuar. Kur vlera e mbartur ulet nga rivlerësimi i aktiveve, kjo kalon në humbje në bilancin kontabël. Ndërsa kur vlera e mbartur rritet nga rivlerësimi, shtohet vlera e aktivit dhe kontabilizohet më vete plus vlerën e shtuar të aktivit.

Ka dy metoda të kontabilizimit të rivlerësimit Bruto dhe Neto.

10-Vlerësimi i aktiveve në dalje (nxjerrja jashtë pasurisë së bashkisë)

- ✓ Asetet mund të shiten
- ✓ Asetet mund të dhurohen
- ✓ Asetet mund të dalin jashtë përdorimit, ose nga dëmtimi ose ngaqë nuk kontribuojnë më në shërbime për qytetarët dhe nuk gjenerojnë të ardhura

Shitja e aseteve mund të realizohet

- ✓ Me mjete monetare me arkëtim të mëvonshëm ose me arkëtim të menjëhershëm
- ✓ Me këmbim me një aset tjetër
- ✓ I kombinuar (të holla+këmbim)

11-Jeta e dobishme kundrejt jetës reale të përdorimit

Asetet kanë jetën e tyre të parashikuar të dobishme , pas të cilës ato zëvendësohen.

Sugjerojmë që duhet të fokusohemi më tepër në gjendjen reale të asetit sesa në moshën e tij, duke nxitur nevojën për rehabilitimin e tij, shpesh vendimet duhet të bazohen në analizën e kosto-përfitimit dhe në një sërë arsyesh të tjera që lidhen me cilësine e ofrimit të shërbimit nga asetet.

Lind pyetja: Kur asetet nuk mund të shiten, a mund ti nxjerrim jashtë përdorimit, në cilat raste?

Po, në rastet kur ato as nuk përdoren (dmth kur janë jashtë funksioni) dhe as nuk kanë vlerë tregu.

12-Tjetërsimi i shfrytëzimit dhe transferimi i aseteve fikse

Transferimi i pronësisë së çdo aseti fiks duhet të jetë i drejtë dhe transparent, konkurrues dhe në përputhje me politikën e menaxhimit të tyre nga ana e bashkisë.

Çdo drejtues departamenti Brenda institucionit të bashkisëduhet ti dorezoje Kryetarit të Bashkisë listat e aseteve që do të nxirren jashtë bashkisë ose të hidhen, si edhe arsyet e kësaj.

Listat do të verifikohen për saktësinë e tyre nga personat pergjegjës dhe pas konsolidimit të informacioneve në një raport përmbledhës i paraqitet Këshillit të Bashkisë sëbashku me rekomandimet mbi procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aseteve. Pasi asetet fikse të tjetërsohen ose të transferohen, njësia e menaxhimit të aseteve i heq ato nga rregjistri i aseteve.

Nëse të ardhurat e tjetërsimit/asgjësimit të aseteve janë më të vogla sesa vlera e mbartur e rregjistruar në rregjistrin e aseteve fikse, diferenca do të njihet si një humbje në pasqyrën e të ardhurave të institucionit të bashkisë. Nëse të ardhurat e tjetërsimit janë më të mëdha sesa vlera kontabël e aktivit fiks, të ardhurat nga shitja e tyre duhet së pari të aplikohen për të kryer ndonjë huamarrje ndaj atij aseti në datën e riblerjes, diferenca nëse ka, do të njihet si fitim në pasqyrën e të ardhurave të institucionit.

Vendimi i tjetërsimit te aseteve fikse duhet të marrë parasysh

- ✓ Vleresimin e interesave të institucionit të bashkisë dhe të palëve të interesuara
- ✓ Vazhdimësinë në ofrimin e shërbimit, nuk mund të ketë ndërprerje në shërbimet që ofron bashkia kur një aset që është në përdorim nga ajo, transferohet ose shitet
- ✓ Rreziku që lidhet me pronësinë e asetit do të transferohet me transferimin e këtij aseti
- ✓ Bashkia duhet të nxisë politikat për ruajtjen e pasurisë së saj dhe të prarandalojë transferimin e aseteve

***Pika V-Informimi dhe vendimmarrja:***

Menaxhimi i informacionit dhe dokumentimi kërkon njohuri specifike për një menaxhim efektiv të aseteve

- ✓ Njohuri te standarteve teknike dhe te legjislacionit
- ✓ Standarteve te informimit
- ✓ Menaxhimit të sistemit të informacionit dhe menaxhimi i të dhënave

Pa informacion të mirë është e pamundur të marrësh vendime të mira, kjo ndikon direkt në efikasitetin dhe performancën e bashkisë. Strategjia e menaxhimit të informacionit duhet të përfshije objektiva që duhet të jenë SMART.

# TRASHËGIMIA KULTURORE ETNITET DHE URË LIDHËSE MES TRI SHTETEVE(KOSOVË, SHQIPËR, MAQEDONI )

**PHD.Behije Ibrahimi**

**Affiliation : South East European University**

## Abstract

This study focuses on the challenges and advantages that are directly related to cross-border cooperation with prospects for visitors and private entrepreneurs in this region. The theme is designed with the aim of promoting natural and cultural heritage, qualified human resources

and trained in public and private sector.to serve the tourism industry steadily and competitively in accordance with international standards, to improve human resource management capacities.One of the priorities of tourism development is the preservation of national identity, worth which often in the frame of globalization is lost so in this case i refer to the UN statement. "Every culture has a dignity and a special value that must be preserved and respected "and" that every nation has the right and the duty to develop and to preserve its culture. "Let us not forget the fact that heritage is a universal inheritance in defense of which the entire international community should cooperate.

In this scientific work, our study will be an important contribution to the identification, protection and preservation of this heritage and at the same time ethnicity and bridge between the three countries of Kosovo, Albania and Macedonia in the benefit of its socio-economic development.

**Keywords:** Cultural Heritage, Natural Heritage, Gastronomy,dance and folklore, economic-social development, etc.

## Hyrje

Promovimi i trashëgimis kulturore ndërkufitare është bërë gjithnjë e më popullor në dekadat e fundit dhe sidomos brenda Bashkimit Evropian përmes programeve e projekteve të ndryshme. Të mos harojm dhe faktin se trashigimia njëherazi paraqet trashigimi univerzale në mbrojtjen e të cilës duhet të bashkpunojne e tërë Bashkimi Evropian.Gora është një zone malore që shtrihet ne rajonin kufitar Kosov-Shqiperi –Maqedoni.

Goranët janë popullsi që flasin gorançe, një dialekt sllavofone që përngjet me maqedonishten, por ka dhe fjalë shqipe e turke. Goranët jetojnë në krahinën e Gorës, që sot ndahet mes shteteve të Shqipërisë, Kosovës e Maqedoni, krahinë nga ku e marrin dhe emrinGora. Gora si krahinë me 55 fshatra, ka pasur si qendër administrative Vranishtin deri në vitin 1923, që në dokumentet arkivore kjo qendër është trajtuar me emrin e “Kazaja e Gorës dhe Opojës” në të cilën kjo e fundit ka 19 fshatra.




Harta: Rajoni i Gorës

Burim: Artan Mehmeti

Në një botë globale, ku globalizmi konsiderohet si një rol i madh që rrafshon vlera, rol kryesorë në identitet kombëtar, rajonal, lokal zë dhe trashëgimia natyrore dhe kulturore e një vendi në përgjithësi, dhe krahinës së Gorës në veçanti. Për me tepër, sikurse dihet, bashkëpunimi kufitar është motivuar kryesisht nga dëshira për të arritur standardet të larta të jetesës, sigurimin e paqes, kapërcimin e barrierave doganore dhe frenimin e faktorëve të tjerë, të cilët pengonin lëvizjen e lirë të njerëzve për qëllime ekonomike, sociale dhe politike. Në kushtet ku politikat e shteteve po ndryshojnë me ritme të shpejta për tu përshtatur proceseve integruese brenda Bashkimit Evropian, kanë konsideruar bashkëpunimin kufitar si një element kyç në këtë proces.

**Komponentet kryesore në të cilat është hulumtuar nga studimi ynë janë:**

1. **Atraksionet turistike te krahinës Gorës (Bazuar tek Natyra, Kultura, Ngjarjet, Aktivitetet)**
   Përfshijnë tiparet natyrore dhe ato të bëra nga dora e njeriut, te cilat janë me interes për turistet dhe përbejnë arsyet për te cilën ata vijnë. Shembuj mund te jene dyqane unike, vende historike, muzeume, bukuri natyrore te veçanta, përvjetorë, festivale, ngjarje sportive dhe kulturore, kuvende/konferenca si dhe pjesëmarrje ne aktivitete te tjera
2. **Mikpritja ndaj vizitorëve**
   I referohet se si vizitorëve u është shërbyer, si janë pritur dhe trajtuar nga stafi pritës, menaxheret/operatoret dhe banoret ndërsa ata janë duke vizituar zonën. Kjo përcakton

nëse vizitoret kane pasur një eksperience të këndshme dhe te kënaqshme dhe nëse ata do te rikthehen serish apo do ju thonë edhe te tjerëve për një vizite.

3. **Shërbimi Turistik**
   Përfshijnë të gjitha shërbimet qe plotësojnë nevojat baze të turisteve në zonën tone; hotele/motele/resorte, kampingje, restorante, dyqane, shërbime operatore/guida, etj.

**Qëllimi dhe objektivat e studimit**

Qëllimi i këti studimi eshte që të promovohet trashigimia kulturore si etnitet dhe urë lidhëse në mes tri shteteve, mekaniëm i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik social të komuniteti në rastin tonë Krahina e Gorës, gjeografikisht lidhë ngusht bashkjetesën ndërkufitare.

Përmes këti studimi përcaktohet roli dhe rëndësia e trashigimis kulutore si element unifikues i një vendi.Tema **„***Trashëgimia kulturore etnitet dhe urë lidhëse mes tri shteteve(Kosovë, Shqipër, Maqedoni)'',* ka objekt studimi:

- Të evidentojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Krahinës së Gorës
- Të promovojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore si pjesë të ofertës turistike.
- Të nxisë/hartojë projekte ndërkufitare me objektivë turizmin dhe rritjen e bashkëpunimit mes shteteve ku shtrihet krahina e Gorës.
- Të propozojë instrumentet e marketingut të destinacionit dhe zhvillimin e produktit turistik

**Roli i pozitës gjeografike në trashëgiminë natyrore dhe kulturore të krahinës së gorës si mundësi për zhvillimin e turizmit.**

Pozita gjeografike e Gores, si qendër e pjesës qendrore të Gadishullit Ballkanik, trashëgimia kulturore dhe natyrore, elementet hidrografike, klima, relievi, flora dhe fauna janë faktorë që kanë krijuar kushte për zhvillimin e turizmit. Vështruar në bazë të tri grupeve të faktorëve (faktorëve nxitës, ndërmjetësues dhe pritës) që ndikojnë në zhvillimin e turizmit, Gora mund të konsiderohet si vend që ka kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit por duhet ende ndërhyrje për të pasur një ofertë tërheqëse turistike.

Faktorët turistikë natyrorë janë krijuar në mënyrë natyrale dhe pasqyrojnë mjedisin gjeografik të një vendi. Bukuritë natyrore, kushtet klimatike, ujërat termo-minerale, shpellat, format gjeomorfologjike, gjeologjike, flora dhe fauna, paraqesin lëndën e parë turistike, e cila e ka vlerësimin e vet në turizëm dhe shërben si bazë për zhvillimin e turizmit të një vendi.

Gora shtrihet në trevat e Prizrenit, Kukësit dhe Tetovës në trekëndëshin Shqipër-Kosovë-Maqedoni. Ajo kufizohet në veri me malin e Zercës 1347m, në lindje me Kaçina 2204m , dhe Gemitash 2118m, në jug-perendim me Gjallicen 2397m, dhe perendim me Koritnikun 2397m . Gora ka rrjet lumor relativisht të dendur.

**Trashigimia gjeografiko- kulturore:** përfshihet e gjithë trashigimia material shpirtërore e një vendi. Ndonëse objektet kulturore dhe historike janë pjesë e histories e një populli të caktuar, vlera e tyre kulturore I tejkalon kufit nacional nepërmjet promovimit të trashigimis kulturore.

Ndër monumentet kulturore të mbrojtura të rajonit të Gorës përmendim: -Gërmadha e Kalasë, Kodra Hisar, që i përkasin shekullit II-IV, Krushevë.

**Aspektet e trashigimis kulturore**

**Objektet kulturore:** Sa i takon objekteve kulturore, në rajonin e Gorës, ekziston shtëpia e kulturës në qytetin e Dragashit, Një objekt tjetër publik që do të mund ta kryente funksionin e Shtëpisë së Kulturës është zyra e Bashkësisë Lokale dhe Rinisë në fshatin Krushevë Biblioteka dhe dhomat që do të përdoreshin nga komuniteti janë aktualisht në dispozicion, ndonëse nuk ka sallë kryesore teatrale për përformanca më të mëdha. Ekzistojnë 6 biblioteka në komunën e Dragashit, 4 nga të cilat gjenden në rajonin e Opojës me nga një bibliotekë në secilën rrugë kryesore që të shpien në jug të qytetit të Dragashit (në Krushevë, rrugës për Restelicë dhe në Brod). Aty gjinden libra në gjuhën boshnjake-sërbe që i numërojnë diku 5200, dhe në Brod I ka rreth 3500 libra.[1] Ndonëse objektet kulturore dhe historike janë pjes e histories së një populli të caktuar, vlera e tyre kulturore i tejkalon kufijtë nacional nepërmjet turizmit.[2]
**Gastronomi :** Në kohë më të hershme Gora, është e shquar për mjeshtër të guzhinës në disa specialitete. Historikisht ata janë njohur si gjellëbërës dhe si zejtar ëmbëltorësh. Zeja e ëmbëltoreve, gjatë shekujve më parë e kanë ushtruar goranët, në territorin e Perandorisë Osmane. Ata shërbyen edhe në kuzhinat e sulltanëve në Topkapi Saraj, si ahqixhinjë dhe ahqibashë të dalluar.[3] Banorët e disa fshatrave të Gorës kanë një histori të vjetër në rritjen e bletëve dhe pr

odhimin e mjaltit, gjithashut kjo zone është e njohur për prodhimin e bylmetit i cili përpunohet në kushtet shtëpiake ( kryesisht djathi deles dhe i dhisë).

**Resurset turistike :** Pozita gjeografike, kushtet klimatike, hidrografija, flora dhe fauna mjaftë e pasur, janë elemente mjaft të rëndësishme , që keti rajoni me potencial të lartë turistik, krijojnë mundësin për zhvillimin e turizmit sportive, rural, ekoturizmit, turizmit të gjuetis etj.

**Festat lokale:** Rajoni i Gorës është i njohur edhe për festivalet e saj të veçanta që demonstrojnë sinkronizimin e ritualeve pagane dhe fetare, të trashëguara.

Ndër këto festa përmendim:

1. **Shën Gjergji** festohet për çdo vit në disa zona të rajonit nga data 5 – 15 Maj. Është
festa më e madhe dhe më e famshme e tubimeve, që tërheq vizitorë nga e gjithë Shqipëria veriore dhe Kosova si dhe nga diaspora që vinë për ta festuar me familjet e tyre
2. **Dita e Goranëve** mbahet më 6 Maj në rajonin e Gorës, një festim me muzikë dhe veshje tradicionale. Vendi kryesor i tubimit është Vlaska, afër fshatit Vranisht.
3. **Pelivan**, festivali i mundjes tradicionale, është mbajtur për çdo vit në qytetin e Dragashit më datën 1 Maj, ku pjesëmarrësit dhe spektatorët vijnë nga Kosova, IRJM, dhe Turqia.

4. **Festivali i të rinjve** mbahet në fund të Majit në Shtëpinë e Kulturës në qytetin e Dragashit, me pjesëmarrje të gjitha shkollave në komunë, të cilat organizojnë shfaqje teatrale, muzikë, pikturim dhe recitim të poezive.
5. **Festivali i Pranverës** Verza mbahet më 14 Mars, për përgatitjen e fushave për sezonin e ri të mbjelljes.
6. **Kampionati i skive**, në Shishtavec. Ky kampionat zhvillohet çdo vit në muajin Shkurt dhe ka pjesëmarrje të skijatorëve nga rajoni por edhe nga përtej tij.

---

[1]Komuna Dragash
[2]Dhimitër Doka ,, Gjeografija e Turizmit, Tiranë, 2009, fq 61
[3]Bala Z. (2007)''Historia dhe tradita: Monografi'', Erik, fq 86.

7. **Festa e patates**. Data 1 Tetor, është caktuar në kalendarin e eventeve lokale të qarkut, si "Dita e Patates". Në këtë datë, në Shishtavec organizohet aktiviteti "Festa e Patates" me qëllim promovimin e këtij produkti tipik të zones.
8. Festivalet nacionale që janë të rëndësishme në Dragash përfshijnë **Ditën e Pavarësisë** (17 Shkurti) dhe **Dita Ndërkombëtare e Gruas** (8 marsi).

Përveç festivaleve dhe festimeve, një numër i tipareve tjera të Gorës ofrojnë burim të vlefshëm të trashëgimisë së paprekshme kulturore. Ato përfshijnë:

- Lyerja tradicionale e fytyrës së nuseve
- Traditat e gatimit të ëmbëlsirave
- Rrëfimet dhe legjendat, veçanërisht ato që ndërlidhen me peizazhin natyror
- Traditat rurale bujqësore

**Dasmat , vallet dhe folklori:** Dasmat në rajonin e Gorës, ka një domethenje të veçantë për komunitetin e saj. Gjashtë muaj para ditës së dasmës vazhdojnë pregaditjet. Kohzgjatja e dasmës kryesishtë është dy deri pesë ditë.Karakteri ritmik në to është i dukshëm, gjë që, ndërmjet të tjera vrehet në dyfyshimin me nga dy hapa të vegjël në hapat katër dhe gjashtë të motimit me ndertim asimetrik.[4]

***Mundja*** është një ndër sportet kryesore që zhvillohet në ditën e fundit të dasmës. Në dasmën e Gorës njerëzit marrin pjes edhe pa u ftua. Tradicionalisht si në festen e Shën Gjergjit, Ditës së Verës, ashtu edhe në dasëm flirtet dhe takimet në mes vajzave dhe djemve beqarë jane nje praktik e zakonshme.

***Vallet :*** Në pëgjithsi vallet e burave karakterizojne nga e njejta gjalleri dhe dinamik, si e valleve të Lumës.[5]

***Veshja:***Gora dhe zonat rreth tyre jan të njohura për rritjen e deles rude. Sipas gojëdhënave thuhet se kan pasur lidhje tregtare me Stanbollin dhe Selanikun. Veshjet tradicionale kryesisht është qendisur nga grat. Dallimi i veshjes në mes të vajzave dhe grave evidentohet tek ngjyra e tyre , dhe tek perdorimi i disa elementeve zbukurues.. Veshja e grave të Gores është e tipitballkanik dhe ngjason me veshjet e popujve fqinjë. Veshja e burave dallohet per larmin e saj, kolorit te veçanta ku bejn pjes : tirqet, opingat, gjamadanietj.

## Përllogaritja e madhësisë së kampionit

Caktimi i kampionit të popullsisë lokale luan një rol të rëndësishëm, sepse lidhet me saktësinë e studimit në rajon. Për zgjedhjen e tij janë përdorur studime të ndryshme të realizuara në këtë fushë. Bazuar në të dhënat e grumbulluara, popullsia e Gorës sipas karakteristikave të studimit jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabla 1.Popullësia e Gorës sipas shteteve

| **Shteti** | **Popullsi total** | **Popullsia mbi 18** |
|---|---|---|
| Shqipëri | 5,040 | 3,486 |

[4]Bogdan R. ( 2011-2012), ''Vallet e krahinës së Gorës e rrethit të Kukësit'', Revista Sharri'', fq 57
[5]Krahina Etnogafike e Qarkut Kukës

| | | |
|---|---|---|
| Kosovë | 14,726 | 9,571 |
| Maqedoni | 1,355 | 880 |
| **Total** | **21,121** | **13,937** |

**Intervisim për destinacionin**

Pyetjes për interesiminndaj destinacionit, nga të dhënat e përpunuara viher re % e njejtë sa ju takon turistëve që janë të interesuarpër aventurën meqenëse se kjo zonë fal pozitës gjeografike ofron forma të ndryshme të relievit malor të lakmueshme për të apasionuarit e aventurës dhe atyre që duan të njihen me një kulturë të re, kjo sepse se krahina e Gorës njihet për karakteristikat e saj etnografike e kulturore që e bëjnë të dallueshme dhe të veçantë për tu vizituar .

Konkretisht e ndarë sipas përqindjes, kemi:

27 % janë të interesuar për aventurë

27 % për tu njohur me kultura të reja

8 % për arsye shëndetësore (kilma)

8 % për shkak të natyrës (trashëgimisë natyrore)

16 % për të pushuar ( në bjeshkë)

8 % për sport ( ski, alpinizëm, gara me kuaj etj)

6% për të vizituar miq




Grafiku 2**Interesimi për destinacionin**

Burim: Rezultatet e përpunimit

**Faktorët tërheqës të Rajonit të Gorës, e shtrir në tri shtete: Kosovë-Shqipëri-Maqedoni**

**Argëtimi**

- **Organizimi i festave lokale**, si: Shëngjergji; Dita e Goranëve, Festivali folklorik, Aulona etj
- **Panaire**, si: panairi i patates
- **Lojra**, si: gara me kuaj; mundje; ski etj
- **Objekte argëtimi:**

**Bukuri Natyrore**

- Bjeshkët
- Guri i Mëngjesit
- Guri i Shqipes
- Pylli i Mështeknës
- Mali i Kallabakut
- Mali i Sharrit
- Liqeni Shutman

**Çështjet e Veçanta**

- **Dy gjuhësia** e banoravë të rajonit të Gorës dhe **origjina** e tyre
- **Ritet** e veçanta të dasmave
- Lyerja tradicionale e fytyrës së nuseve
- Stili i jetesës
- **Gatimet** tradicionale
- **Rrëfimet** dhe legjendat

**Objektet kulturore**

- Gërmadhat e **Kalasë**, "Kodra Hisar", Krushevë.
- **Biblioteka** në Krusheve dhe Brod

**Përfundimi dhe rekomandimi**

Ndër qëllimet më të rëndësishme të kësaj teme po synohet mundësija për zhvillimin ekonomik të rajonit, nëpërmjet promovimit të trashigimis kulturore, si pasuri unike e komunitetit, dhe urë lidhëse të komuniteti të shtrirë në tri shtete.

Krahina e Gorës ka kushte shumë të mirra për zhvillimin ekonomik. Egziston një bashkpunim i qëndrueshëm ndërmjet gores në Kosovë dhe Shqipërisë, mirpo mungon bashkpunimi me pjesën e Maqedonisë. Është shumë e rëndësishme që aktivitetet e përbashkëta të përfshihen dhe fshatrat e Gores në pjesën e Maqedonisë. Trashigimia kulturore dhe ajo natyrore e luajnë një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e identitetit dhe proçesit të zhvillimit të një vendi, si dhe përmban vlera historike dhe educative me rëndësi. Menaxhimi efektiv në mbrojtje dhe ri-jetësimin e kësaj trashigimie, përbën njëherazi burim përfitimi dhe zhvillimi, si ekonomik ashtu edhe social. Në parim, ruajtja dhe mbrojtja e trashigimise natyrore dhe kulturore përfaqëson një veprim publik dhe për këtë arsyje, vendimet që meren në këtë fushë duhet të pranohen si veprime në favor të publikut dhe të shoqërisë. Për çdo vit bëhen organizime të përbashkëta sa i takon promovimit tëzonëssi: panaire, koncerte lojra sportive etj. Rajoni i Gorës ka klube sportive dhe kulturore, por i mundojnë ambientet për ti zhvilluar aktivitet kulturore dhe sportive.

Problemi vendimtar për ruajtjen e trashigimisë natyrore e kulturore, ka të bëjë edhe me informim publik. Vetëdija e publikut mbi vlerën e kësaj trashigimije, bënë që ky publik të jetë më pak i vullnetshëm për shkaktimin e dëmeve ose shkatrrimeve, dhe një publik i till gjithashtu mund të përgaditet të ofroj resurse për nxjerrjen e informacioneve të më tejme lidhur me trashigimin.

## Referenca

1. DokleN. 2002,, Për Gorën dhe Goranët'', Prizren fq 25

2. Gjergji, A . 2005. '' Veshja shqiptare në shekuj'', fq 109

3. Bogdan R. 2011-2012. ''Vallet e krahinës së Gorës të rethit të Kukësit.Revista Sharri , fq 57

4. Kosova P. 2007,, Gora dhe veshja tradicionale e saj gjate shekullit XX, fq 1-22

5. Halimi B. 2012.'' Goranët, fq 284,285

6. Komuna Dragash

7. DhimitërDoka,, Gjeografija e Turizmit, Tiranë, 2009, fq 61

8.Bala Z. (2007)''Historia dhe tradita: Monografi'', Erik, fq 86.

# ZHVILLIMET SOCIALE NE MINIEREN E TEPCES NE STANTERG NE MES TE DY LUFTRAVE BOTERORE

**Dr.sc Mustafë Haziri**

**Ph.D Naim Seferi**

**M.sc Milazim Hajra**

**Abstrakt**

Rëndësia historike e Minierës së Trepçës në Stanterg është aq e madhe dhe me vlerë saqë është e pamundur që vetëm në kete punim shkencor të përfshihet në mënyrë të përgjithësuar e gjithë ajo që duhet thuhet mbi rendesine e zhvillimeve sociale ne minieren e Trepces ne Stanterg.

Megjithatë, unë jam përpjekur që në mënyrë kronologjike të paraqes, një vështrim shkencor të karakterit historiografik, ekonomik, dhe social të Trepçës nga e kaluara e largët historike, duke u ndalur me theks të veçantë në periudhën e shekullit XX, kur në Trepçë filluan hulumtimet e para në vitin 1926, nga anglezët, ndërsa pak më vonë në vitet e '30-ta të këtij shekulli filloi eksploatimi modern i Trepçës. Që nga fillimi i punëve u përcoll me disa lëvizje sindikale, nga grevat e vitit1936 e deri ato të vitit 1939.

**(Fjalët kyçe: *Trepça, Miniera e Trepçës, Greva e minatorëve, punëtorët e Trepçës)***

Përpjekjet e para për një luftë politike të organizuar kishin filluar qysh ne vitin 1930. Më 1931, u mbajt një konferencë e xehetarëve të Trepçë me të cilën u zgjodh drejtoria e re e Lidhjes se Xehetarëve. Në vitin 1932, në Mitrovicë u mbajt edhe një tubim i punëtorëve lidhur me çështjen e shtrenjtësisë dhe të pozitës ekonomike të rëndë. Për bashkimin e punëtorëve shfrytëzoheshin format e aktiviteteve dhe punës së SHKA "Abrashoviq" në Mitrovicë. Kjo shoqëri artistike ishte themeluar më 25 korrik 1933.

Në vitin 1933, u bënë përpjekje për të themeluar një shoqatë me emrin LNJSP (Lidhja e njësuar sindikale e punëtorëve të "Trepçës". Policia dhe organet lokale e penguan këtë iniciativë. Në shkurt te vitit 1934, u mbajtën zgjedhjet për komisar punëtorë në Stanterg në të cilat më së shumti vota fitoi lista e kuqe e 14 punëtorëve përparimtarë. Ndërsa në korrIk te vitit 1934, organizata e PKJ e Kralevës ushtronte ndikim mbi minatorët e Trepçës dhe insistonte për formimin e një organizate të PK-së. Është me rëndësi të potencohet se më 25 prill 1936, në LNJSP, ishin anëtarësuar mbi 400 veta. Kështu, gradualisht organizata sindikale shkoi duke u forcuar, ku më se 1/3 e punëtorëve ishin anëtarë të saj[6].

Gazeta "Radnicke novine" e 4 gushtit të vitit 1933, shkruante: "Në këtë kofenrencë në të cilën u themelua shoqëria, u paraqit një referat i gjerë për artin proletar.

Duke filluar nga viti 1935, ne Trepçë u formua arka e vëllazërimit, e cila atë vit kishte një milion e treqind mijë dinarë. Në veprimtarinë e vet arka ishte shumë e varur nga drejtoria e Trepçës sidomos nga drejtori i përgjithshëm. Në bazë të dokumenteve dhe procesverbaleve të arkës së vëllazërimit shihet se gjysma e këshillit drejtues të kësaj arke i kishte dërguar

[6]Minir Dush, "Sistemi inegral..", Prishtine, 2002, fq.14

personalisht drejtori i përgjithshëm HOWIE. Në dokumente shihet se punëtorët e Trepçës kishin edhe disa shoqëri sportive. Njëra ndër to ishte aeroklubi, i cili fillimisht kishte 117 punëtorë dhe nëpunës të "Trepçës".

Kjo ishte përgjigja ndaj eksploatimit të egër, mirëpo, për të trajtuar në mënyrë kronologjike këtë ngjarje, ne i jemi referuar shtypit të kohës. i cili më së miri i pasqyron këto lëvizje të rëndësishme të punëtorëve[7].

Gazeta tjetër "Politika"[8] e 31 marsit 1936, sjell një shkrim të gjerë, ku, ndër të tjera, thuhet: "Në Mitrovicë filloi gjykimi i punëtorit xehetar Ilia Neshkoviq, i cili e ka vrarë inxhinierin e Trepçës Marko Jurevic".

Sipas gazetës *"Vereme"*[9] të 1 prillit 1936, shkruan, midis tjerash, se vrasësi i inxhinierit Marko Jureviq u dënua me 14 vjet burg të rëndë. Në vitin 1936, ne kodrën e bardhë punëtorët u përpoqën ta vrasin inxhinierin Longston. Gazeta *"Pravda"*[10] e 27.06.1936, solli gjithashtu një shkrim në të cilin thuhet: "Në gjyqin e Qarkut iu shqiptua aktgjykimi xehetarit Idriz Luci, i akuzuar me 18 mars të këtij viti, i cili ishte përpjekur që të vriste inxhinierin Shirokin.

Gjendja në këtë kohë sa kishte filluar të përkeqësohet edhe më shumë. Kështu, më 31 shtator 1931, në Stanterg humbën jetën:.Rade Mandiq, Anton Gjuriqi, Zhivko Baloviqi dhe Hetem Muharremi. Ne raportin e vet më 21 shtator 1931, drejtuesit e Stantergut këtë rast mezi e quanin një rast serioz fatkeqësie. Drejtuesve në Stanterg nuk u ngutej që t'i nxirrnin kufomat. Shtypi i përditshëm ishte plot me shkrime për vuajtjet e punëtorëve në xeheroret e "Trepçës". Per eksploatimin ne Trepce shfryezoheshin puntoret te burgosurit dhe te internuarit.[11] Gazeta *"Politika"*[12] e 13 nëntorit 1936, me titullin "Nga një minë e pashkrehur pësuan 6 punëtorë në xeheroren e Trepçës. Shtypi shkruante për pakujdesinë e drejtorisë për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së punëtorëve. Në anën tjetër, gazeta *"Radniçke novine"*[13] nr. 32 të dt. 10. 08. 1934, shkruante se më 21 korrik nga "Humanizmi i drejtorisë së Trepçës" vdes punëtori-xehetari Branko Pejnoviq, të cilit më vonë kishin penguar edhe ceremoninë e varrimit të tij. Atë e kishin varrosur pas gjashtë oreshë pa praninë e askujt. Më vonë drejtoria e Trepçës kishte pushuar nga puna 300 puntorë. Nga kjo lë të kuptojmë se punëtorët e Trepçës të pranishëm në raste të fatkeqësive, nuk guxonin të tregonin të vërtetën se si ndodhnin ato. Kjo tregon që udhëheqja e Trepçës gjatë asaj kohe kishte aplikuar masa represive ndaj punëtorëve të Trepçës, duke mos dhënë asnjë llogari për të gjitha ngjarjet që ndodhnin në Trepçë.

## 2. Greva e minatorëve të Trepçës e vitit 1936

Për të kaluarën historike të minierës së Trepçës dhe lëvizjen punëtore të saj, vend me rëndësi të veçantë kanë grevat e punëtorëve të minierës të organizuara për shkak të shfrytëzimit të fuqisë punëtore nga anglezet[14].

Më 14 maj 1936, ne ora 7.00 të mëngjesit është shpallur greva e punëtorëve, e cila konsiderohet si greve e parë dhe e organizuar mirë. Sipas planit të paraparë, greva shpërtheu

---

[7]"Rilindja., "Fejton, Bogdan P.Ivonovic,"Trepca qe nga Romaket e deri ne luften e prillit " Prishtinë, 01.04.1979 fq.15.

[8]Gazeta "Politika", dt.31.03.1936

[9]Gazeta "Vreme" , dt.01.04.1936

[10]Gazeta "Pravda", dt.27.06.1936

[11]ASH-AK, Fondi, Dr. MinirDushi, annex 11, kutia nr.5.

[12]Gazeta "Politika" dt.13.11.1936

[13]Gazeta "Radniçki Novine", 10.08.1934

[14]Minir Dushi, vep., cit.22.

fillimisht në Tunelin e parë. Punëtorët u nisën në drejtim të Stantergut për t'u bashkuar me punëtorët tjerë.

Brenda një kohe atje i prisnin afro 1000 punëtore të tjerë, të cilët e kishin ndërprerë punën. Më vonë kemi ndërhyrjen e xhandarmërisë për të penguar ardhjen e punëtorëve në afërsi të minierës. Si rezultat i kësaj ndërhyrjeje, u plagos punëtori Danesh Koriqi, të cilin xhandarët e detyruan të tërhiqeshin ndërkaq grevistet arritën në vendin e duhur. Në grevë morën pjesë afër 2000 punëtorë.

Drejtoria e Trepçës u paraqit menjëherë me premtime dhe përpiqej t'ua mbushte mendjen punëtorëve që të kthehen në punë. Të pranishmëve u foli Mirko Vuksanoviq, i cili propozoi që të zgjidhet një këshill grevist që do të përfaqësonte punëtorët para drejtorisë së ndërmarrjes. Propozimi u pranua dhe anëtarët e këshillit u zgjodhën: Dane Uzellaci, Mirko Vuksanoviq, Shaban Osmani etj. Kërkesat e punëtorëve ishin Këto: 8 orë kohë pune; rritje të fitimit ditor; ngritje të banesave për punëtorë; mbrojtje e pjesëmarrësve të grevës; mbrojtjen dhe mundësinë e punës së komisarëve punëtorëve, bashkimin e lirë të punëtoreve në organizata punëtore; sigurimin e udhëtimit të punëtorëve deri në vendin e banimit, sapun falas për larje pas punës, ndriçim elektrik në banesa, dhe ndërtimin e banjave në Tunelin e Pare për punëtorët[15].

Greva kishte për qëllim, para së gjithash, përmirësimin e gjendjes ekonomike, por kishte edhe kërkesa për liritë politike dhe bashkim të lirë në aksione politike.

Për këtë grevë vend të rëndësishëm i dha shtypi jugosllav, sidomos gazeta *"Pravda"* e dt. 25.05.1936, e cila paraqiti mendimin e drejtorisë së Trepçës për grevën: Për mendimin tonë, kjo grevë në minierën e Trepçës ishte rezultat i një aksioni nëntokësor të disa elementëve ekstremistë me prapavijë politike qartësisht të shprehura dhe të përgatitura me muaj dhe që janë kundër marrëdhënieve te mira të punëdhënësve dhe punëtorëve[16].

Për këto aksione organet e shtetit kane prova, kështu mendonin në drejtorinë e Trepçës për grevën. Nga ana tjetër, Gazeta *"Politika"*[17] e 30 majit 1936, boton një shkrim të Velibor Gligoreviqit me titull "Punëtoret dhe punëdhenësit", në të cilin thuhet se "në opinion kanë arritur pamje të jetës së mirë të punëtorëve të Trepçës". Pastaj edhe gazeta *"Vreme"*[18] shkruante se xehetarët e Trepçës kërcënonin se do ta mbysin në ujë xeheroren nëse mbyllen kantinat. Gazeta *"Pravda"*[19] e 26 majit te vitit 1936, shkruan, ndër të tjera, se "keshilltari i ndërmarrjes "Trepça" kishte deklaruar se për shkak të ndërprerjes së punës, për çdo ditë kemi humbje nga gjysmë milioni dinarë".

Në korrespodencën ndërmjet legatës britanike në Beograd dhe Foreign office në Londër, vërehet rëndësia e madhe që tregonin zyrtarët britanikë për "Trepçën". Ekzistonte "marrëveshja e mëhershme" që ishte lidhur ndërmjet kompanisë "Trepça" dhe Bankës.

Ne vitin 1929, Kompania Trepca kishte hatuar, gjendjen dhe raportin,e dy viteve te kaluara ku edhe u njohtua per sukseset ne pune.[20]

Ne fund viti 1938, u ndertua shkritorja e pare e plumbit ne Zvecan. Furra e pare e shkritores u vu ne shfrytezim me 21 dhjetor e vitit 1939.[21]

---

[15]"RILINDJA ", Fejton, Bogdan P.Ivonovic,"Trepca qe nga Romaket e deri ne luften e prillit " Prishtinë, 01.04.1979 fq. 17.

[16]Gazeta "Pravda" dt.25.05.1937

[17]Gazeta "Politika, 30.05. 1936

[18]Gazeta "Vreme", 1936

[19]Gazeta "Pravda" e 26 .05 1936

[20]DautDauti, "Lufta per Trepcen", Prishtine 2002, fq,22.

3. Lëvizjet sindikale në Trepçë gjatë vitit 1939

Fillimisht Shoqata e lidhjes se xehetarëve në Stanterg, në krye me Ibrahim Pervizit, kryetar dhe Stevan Popoviqin, sekretar, më 22 shurt 1939, i bënë një kërkesë drejtorisë së xeherores së Trepçës, ku, në kërkesën nr 7, kërkohej përmirësimi i kushteve të punës dhe pozita e punëtorëve në Minierë.

Edhe pse kishte përpjekje për pajtim në realizimin e kërkesave, megjithatë bisedimet nuk patën sukses. Drejtoria e xeherores u përpoq në të gjitha mënyrat t'i shmangej rritjes së meditjeve si dhe plotësimit të kërkesave të xehetarëve, ku në procesverbale shihet qartë Drejtoria e ndërrmarrjes "Trepça" dëshironte t'i shmangej marrëveshjes për të fituar kohë.

Bisedimet vazhduan edhe më 8 korrik 1939, por pa rezultate konkrete. Gjate bisedimeve me 17 korrik përfaqësuesit e punëtorëve ndërruan deri diku kërkesat e veta të para për ngritjen e pagave etj. Në vend të ngritjes lineare në 10 dinarë të gjithë punëtorëve, ata propozuan: "Meditjet nistore të arkës sipas kategorive të përcaktohen lartësinë e meditjeve të sotme".

Në pikat e tjera kontestuese kërkohej që të gjithë punëtorët që nuk kanë banesë të drejtorisë, t'u paguhet qiraja 150 dinarë në muaj[22]. Me gjithë kërkesat e parashtruara nga ana e lëvizjes sindikale të punëtorëve, drejtoria e Trepçës nuk aprovoi asnjë kërkesë, duke u justifikuar se "pagat edhe ashtu janë të mëdha dhe se kemi rënie të çmimeve të plumbit në tregun botëror".

Meqë gjithë përpjekjet dhe bisedimet me drejtorinë e Trepçën dhe lëvizjeve punëtore nuk dhanë rezultatet e pritura, atëherë e vetmja zgjidhje për realizimin e kërkesave të punëtoreve mbeti Greva, e cila filloi me 19 korrik te vitit 1939. Në mëngjes, duke filluar nga ora 7:00, filloi Greva e Xehetarëve të Trepçës. Edhe komitetit lokal i PKJ-së në Mitrovicë ishte vazhdimisht në lidhje me përfaqësuesit e punëtorëve dhe kishte ndikim në momentet vendimtare te saj.

Ata i sugjeruan shoqatës së punëtorëve që me anë të Grevës të detyrojnë drejtorinë e Trepçës t'ua plotësojë kërkesat e tyre.

Udhëheqësja social-demokrate e Beogradit u përpoq t'i qetësonte punëtorët dhe te pengonte shpërthimin e Grevës, por pa sukses.

Në gusht të vitit 1939, Drejtoria e Trepçës bëne një shpallje në të cilën paralajmronte pranimin e një fuqie punëtore të re dhe rifillimin e punës së xeherores.[23]

Kjo drejtori mendonte që në mënyrë demagogjike t'i fusë udhëhëqesit në përçarje mes veti.

Në grevën e minatoreve te Trepçës, e organizuar nga lëvizja sindikale ne vitin 1939 nga fotoja shihet se mbi 90% e perbenin minatoret shqiptar[24]. Në grevën e 19 korrikut, e cila ishte masive, morën pjesë mbi 3000 punëtorë. Përveç minatorëve, në greve kanë marrë pjesë edhe punëtorët e flotacionit të Zveçanit[25]. Duke parë vendosmërinë e punëtorëve, pronarët e Trepçës nuk kishin rrugëdalje tjetër, prandaj dhe filluan bisedimet e serishme. Në bisedimet rreth lidhjes

[21]Jubilarnamonografia, 1974, fq. 18.

[22]Bogdan Ivanoviq, Gazeta e përditshme "Rilindja", më 08.05.1979, fq. 13 .

[23]Po aty, fq. 13.

[24]Mustafë Haziri, "Greva e Minatorëve të Trepçës në Stantrëg, 20-28 shkurt 1989, Prishtinë, 2011, fq.17.

[25]Minir Dushi,"Trepça – Sistem integral, teknik – teknologjik", botoi ASHAK, Dukagjini, Pejë, Prishtinë 2002. fq,24

së kontratës së re kolektive që u nënshkrua dhe hyri në fuqi më 4 shtator 1939, me të cilën përfundoi greva.

Në kontratën kolektive Drejtoria e Ndërmarrjes "Trepça" u obligua me sa vijon:

**1.** Për të gjithë punëtorët në xeheroren e Trepçës të caktohet 24 orë koha tetorëshe e punës;

**2.** Punëtorët e inkuadruar në punë në xeherore do ta kenë për çdo javë një ditë pushimi, përpos festave shtetërore;

**3.** Që orët e vazhduara të punës me të cilët punëtorët detyrohen të paguhen 50% më shumë sesa orët e kohës normale;

**4.** Që pagat e punëtorëve të mbesin të njëjta siç kanë qenë deri në lënien kolektive të punës, d.m.th më 19 korrik 1939;

**5.** Drejtoria e xeheroreve t'u japë punëtorëve të martuar dhe të pamartuara banesë nëse ka banesa të lira dhe që ato të jenë të pajisura me ndriçim elektrik;

**6.** Në ndërmarrje nuk do të përzihet në punët e brendshme të organizatave punëtore, pasi që me ligje është lejuar bashkimi i lirë me organizatat e tyre sindikale;

**7.** Që, nëse do të bëhet punë me akord, te parashikohet që me punën në akord, (bonus) të ketë fitime mesatare të arritjes 25% mbi mëditjen;

**8.** Për punëtorët, të cilët janë të martuar jetojnë në familje dhe nuk jetojnë në ndërtesa të ndërmarrjes, por me qira, t'u paguhet qiraja;

**9.** Drejtoria e ndërmarrjes së xehrores t'u japë falas ndriçim elektrik të gjithë punëtorëve që banojnë në ndërtesat e ndërmarrjes;

**10.** Punëtorët nuk lejohen të modifikojnë kurrfarë instalimesh (të ndriçimit elektrik, të ujësjellësit dhe të kanalizimit) qoftë në banesat e ndërmarjes, apo banesave vetjake pa lejen e drejtorisë së ndërmarrjes.

**11.** Drejtoria e ndërmarjes t'u japë të drejta punëtorëve që të mund të shfrytëzojnë pushimin vjetor të paguar.

**12.** Që drejtoria e ndërmarrjes t'iu lejojë transportin e punëtorëve nëpër puse dhe galeri të thella, vetëm në rastin e ardhjes në punë dhe kthimin nga puna të atyre punëtorëve që punojnë në Stanterg, por që nuk banojnë aty;

**13.** Ndërmarrja i vë ne dispozicion kooperativës së furnizimit dhe te konsumit te xeherores së Trepçës, hua pa kamatë në vlerë prej 300 mijë dinarë dhe të përmirësojë veprimtarinë e vet;

**14.** Punëtorët do të marrin nga drejtoria e xeherores sapunë në masë të caktuar;

**15.** Qe punëtorët të mos ndërhyjnë në cilëndo formë në çështjet e brendshme të ndërmarrjes dhe të gjithë punëtorët që kanë marrë pjesë në ndërprerjen e punës që nga 19 korriku 1939, të kthehen në punë dhe ndaj tyre të mos merren masa.[26]

[26]Gazeta e përditshme "Rilindja", Prishtinë, 1979, fq. 16.

Siç shihet, nga kjo kontratë kolektive përfundoi greva. Drejtoria e Trepçës aprovoi shumicën e kërkesave të punëtorëve dhe, në përgjithësi, kjo grevë e Minatorëve të Trepçës, e treta me radhë, u mbyll me fitoren e punëtorëve.

Por, prapëseprapë, me gjithë obligimet e drejtorisë dhe të organeve policore, më se 320 punëtorë, për arsye të ndryshme, kanë qenë të detyruar ta braktisin Trepçën[27].

Aksionet e lëvizjeve punëtore në Trepçë dhe grevat e Minatorëve patën ndikim te madh jo vetëm te punëtorët e Minierës, por edhe te qytetarët e vendbanimeve përreth, prandaj organizimet sindikale të filluara gjate vitit 1936-1939, ndikuan pozitivisht në përmirësimin e pozitës së punëtorëve në Minierën e Trepçës.

Greva e Minatorëve përfundoi me 3 dhjetor 1939, me fitoren e plotë të grevistëve, ndërsa kapitalit anglez në "Trepçë" i solli humbje të mëdha[28].

Gjermania ka qenë e interesuar qysh më herët që ta pushtojë Trepçën. Tash, në kohën e grevës së minatorëve iu ofrua mundësia më e mirë për ta realizuar këtë me sukses[29]. Plani i gjermanëve për Trepçën nuk u realizua pasi që kompania angleze arriti marrëveshje me Organizatat sindikale të Minatorëve, në shtator të vitit 1939, ku përsëri filloi puna në xeherore[30].

Pas mbarimit të Grevës së vitit 1939, meqenëse Drejtoria e shoqatës së punëtorëve ishte dëbuar, kryetari i ri u zgjodh Mirko Vuksanoviq, ndersa sekretar Mile Studenti.

Më vonë, më 29 tetor 1939, u zgjodhën edhe komisarët e punëtorëve që ishin: Mirko Vuksanoviq, Iso Brankoviq, Daut Bekteshi, Osman Ramoviq etj . Njëkohësisht u zgjodhën edhe 40 nënkomisarë. Organet lokale policia dhe drejtoria e Trepçës kishin vazhdimisht frikë nga aksionet e reja të punëtorëve.

Aktiviteti i shërbimeve informative të vendeve të huaja intensifikohej vazhdimisht pas shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore.

Vlen të ceket një letër e komandantit të togës së xhandarmërisë së Vuçitërrnës , i cili në një numër tepër sekret, më 21 janar 1940, njofton drejtorin e ndërmarrjes "Trepça" se të gjithë punëtorët që do të pranoheshin, duhej t'i dërgonte më parë në stacionin e xhandarmërisë në Stanterg me qëllim verifikimi dhe mbledhje e të dhënave se a janë besnikë e të sigurt për vendin tonë.

Që shtetasit e huaj të mos pranohen mundësisht në kurrfarë detyrash të punës.

Është interesante logjika prej xhandarmërie e togerit Gjuriq, i cili popullsinë shqiptare lokale e quan shtetas të huaj, kurse komunistët i krahason me spiunë.

Për këtë arsye dhe rrethanat të krijuara në vend, komisariati i Policisë ndaloi me aktvendim të 1 Janarit 1941, punën e shoqatës së Lidhjes së Xehetarëve të Stantergut, konfiskoi pasurinë e shoqatës, ndërsa ndalesën ia kumtoi kryetarit të atëhershëm, Mirko Voksanoviqit.

---

[27]Po aty, fq. 16.

[28]Minir Dushi, vep e cit., fq.23

[29]Branko Dikic, "Dva strajka rudara Trepce", Beograd 1954.

[30]Branislav Buzovic , " Çeta e Mintorëve " , Beograd 1974.

Prej këtu filloi një vit i kobshëm i vitit 1941, kur në mars filluan aktivitetet dhe demonstratat e punëtorëve të organizuar më 27 mars 1941, kundër paktit 3 palësh[31].

Në fund Divizioni i 60-të i motorizuar gjerman që depërtoi nga drejtimi i Kralevës nëpër luginën e Ibrit, theu rezistencën e ushtrisë së Sanxhakut, duke depërtuar në Mitrovicë, të cilën e mori më 16 prill 1941.

Pritjen e ushtrisë gjermane dhe okupatorëve në Mitrovicë e pritën, siç thuhej disa agjentë besnikë të Gjermanisë të kryesuar nga Xhafer Deva për t'ua dorëzuar gjermanëve pushtetin dhe isntalimet e padëmtuara të Trepçës.

Popullsia vendase ishte e pakënaqur jo vetëm me drejtorinë e Minierës së Trepçës që udhëhiqej nga anglezet, por edhe me pushtetin antipopullor dhe xhandarmërinë që popullatën shqiptare e trajtonin si të dorës së dytë. Shqiptarët gjatë periudhës midis dy luftërave botërore kanë qenë të privuar nga të gjitha të drejtat më elementare: shkollimi, shëndëtesia, kultura, të drejtat sociale, madje edhe për të jetuar në tojet stërgjyshore.

Kështu, forcat e ushtrisë Jugosllave ishin të pamjaftueshme për t'i bërë rezistencë njësive elite të motorizuar gjermane, prandaj qyteti i Mitrovicës, bashkë me Minierën e Trepçës, ranë përfundimisht nën sundimin gjerman. Prandaj, nga kjo që potencuam më lart, rezulton konkluzioni se hulumtimet e para e me këtë edhe eksploatimi modern në Trepçë, filloi nga britanikët me koncesionet, të cilat i nënshkruan me Mbretërinë Serbe - Kroate - Sllovene (SKS), të cilat, përpos shfrytëzimit të minierës së Trepçës në Stanterg kemi edhe zhvillime të rëndësishme ekonomike dhe sociale, të cilat u shoqëruan me greva të mëdha, të cilat fillimisht kishin karakter social, por që më vonë, të kushtëzuara nga rrethanat e kohës, evoluan dhe morën karakter politik. Këto zhvillime ndikuan që Gjermania naziste pa ndonjë rezistencë të madhe të vejë kontrollin mbi Trepçë

## PERFUNDIMI

Duke i bërë një analizë shkencore burimeve arkivore, dhe duke u bazuar në referencat akademike dhe publicistike, mund të konkludojmë se rëndësia historike e Minierës së Trepçës në Stan-Tërg, ishte e madhe si në aspektin ekonomik e politik, ashtu edhe atë historik dhe social, duke filluar nga periudhat e hershme të historisë e deri në ditët e sotme e me theks të veçantë në shekullin e XX.

Ne pergjithesi, greva e minatoreve te Trepcës ne Stanterg, kishte me shumë karakter social sesa politik. Megjithatë duke u nisur nga perspektiva e atëhershme politike grevat e minatorëve gjatë viteve 1936-39, kishin një rëndesi të madhe për vetë faktin sepse ato ndikuan në proceset e mëvonëshme politike në pergjithësi në vendë dhe me gjerë. Marrë ne pergjithësi, në bazë të analizës së burimeve arkivore dhe litraturës historiografike, rezultateve shkencore të studimeve që kanë tajtuar këte prblematike, te shtypit vendor dhe te huaj rezulton se këto greva kan ndikuar dukshëm në përmiresimin e kushteve të punes se minatorëve, dhe në rritjen e prodhimtarsë në minierë, e me këtë rrjedhimishtë edhe në mirëqenien sociale të minatorëve.

[31]Bogdan P.Ivonovic, **"**Rilindja, "Fejton,"Trepça qe nga Romaket e deri ne luftën e prillit " Prishtinë, 01.04.1979 fq. 18.

## I. Burimet arkivore

1. ASHAK, Agjencioni shtetëror – Arkivi i Kosovës

Fond për Trepçën

2. ASHAK, Agjencioni shtetëror – Arkivi i Kosovës

- Fondi i Prof. Dr. Minir Dushi

3.ASHAK, Agjencioni shtetëror – Arkivi i Kosovës

- Fondi i LK-së Kosovës

4. Arkivi ekonomik i Trepçës, Zveçan

Fondi, hapja e horizonteve

5. Arkivi nderkomunal në Mitrovicë

6.AKK, Agjensioni Kadastral i Kosovës

## Literatura

7.Bogdan P.Ivonovic, **“**Rilindja, “Fejton,”Trepça qe nga Romaket e deri ne luftën e prillit “ Prishtinë, 01.04.1979 .

8.Branko Dikic, “Dva strajka rudara Trepce”, Beograd 1954.

9.Branislav Buzovic , “ Çeta e Mintorëve “ , Beograd 1974.

10.Mustafë Haziri, “Greva e Minatorëve të Trepçës në Stantrëg, 20-28 shkurt 1989, Prishtinë, 2011.

11.Dushi,“Trepça – Sistem integral, teknik – teknologjik”, botoi ASHAK, Dukagjini, Pejë, Prishtinë 2002**.** fq,24 Gazeta “Radniçki Novine”, 10.08.1934

12. Daut Dauti, “Lufa per Tepce”, Prsshtine, 2002.

13. Osmani Jusuf, “Vendbanimet e Kosoves”PRISHTINE, 2003.

14. Grup autoresh, “Mitrovica gjate shekujve”, 1971.

15.Grup autiresh, “Trepca- Jubilarna Monografia”, 1974

# ZHVILLIMI TURISTIK NË BASHKINË KORÇË-PRESPEKTIVË E SËARDHMES

**Romeo Terolli**

**UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”**

**Abstrakt**

Qyteti i Korçës ndodhet në juglindje të Republikës së Shqipërisë. Korça është një nga qarqet më të mëdha, ku në ndarjen e saj administrative ndodhen 6 bashki kryesore. Bashkia e Korçës është qyteti më i madh i rajonit i themeluar në shekullin XV. Gjatë 10-vjeçarit të fundit Qarku i Korçës në përgjithësi dhe bashkia e Korçës në veçanti ka njohur zhvillim në fushën e turizimit. Për këtë arsye ky punim do ta ketërrafshin kryesor të tij zhvilliminturistik si prespektivë e së ardhmes në këtë rajon. Qyteti i Korçës ndodhet në kryqëzimin e rrugëve që lidhin Republikën e Shqipërisë me dy shtete fqinj. Për këtë arsye (në thelb tregtare), por edhe për shkak të vendbanimit të hershëm tëzonës,ky rajon ka vlera si nga ana kulturore ashtu edhenga ana historike. Bashkia e Korçës dallohet për traditat e saj të veçanta, të ndryshme nga çdo zonë tjetër e Shqipërisë; dallohet për pasuritë e shumta natyrore dhe për trashëgiminë kulturore. Për këto arsye qyteti i Korçës dhe rrethinat janë një nga zonat me numër më të madh të turistëve në të gjitha stinët e vitit. Mundësia për të zhvilluar të gjithë llojet e turizmit në një hapësirë gjeografike jo shumë të madhe dhe me një infrastrukturë të mirë rrugore e bën tërheqëse dhe çlodhëse për turistët vendas dhe të huaj. Në kuadër të rritjes sëinteresit ndaj turizmit dhe prespektivës për të ardhmen,Bashkia Korçë në përgjithësi dhe zonat e veçanta si Voskopoja, Dardha, Vithkuqi, Boboshtica, paraqesin disa elemente shumë të rëndësishëmpër përmirësimin e mëtejshëm me qëllim arritjen e standardeve më të mira në fushën e turizmit.
Në pjesën e parë të punimit ka një vështrim të përgjithshëm të Bashkisë Korçë për të identifikuar pozitën gjeografike, ekonomike, ndarjen administrative, zonën klimatike, besimet dhe popullsinë e zonës.
Në pjesën e dytë do të evidentohen resuret turistike, pikat më të rëndësishme që janë pasuri kulturore e Bashkisë Korçë.
Në pjesën e tretë do të identifikohen llojet e ndryshme të turizmit, të cilat mund të zhvillohen në zonë duke u bazuar në pasuritë natyore dhe kulturore.
Në pjesën e katërt do të zhvillohet një analizë SWOT e faktorëve që ndikojnë direkt apo indirekt, për mirë apo që janë kërcënim për turizmin në Bashkinë e Korçës.
Në përfundim të punimit do të kryhet një përmbledhje për të dhënat e nxjerra dhe rekomandime të mundshme për pëmirësimin e gjendjes së turizmit në këtë bashki.

Fjalët kyçe: KORÇA, TURIZMI, ANALIZA SWOT, RAJON, SFIDA.

Qëllimi kryesor i punimit është të identifikojë aspektet më të rëndësishme të zhvillimit të turizmit nëBashkinë Korçë,si edhe të përcaktojë aspektet më të mira dhe ato që duhen përmirësuar me qëllim zhvillimin e qëndrueshëmnë sektorine turizmit.

Objektivat e punimit janë:

- Njohja e pozitës gjeografike, ekonomike, traditave, zakoneve, klimës, besimeve dhe ndarjes administrative-territoriale tëBashkisë Korçë.
- Njohja me pikat më të rëndësishme turistike nëBashkinë Korçë.
- Llojet e turizimit që mund të zhvillohen nëBashkinë Korçë.

- Kryerja e një analize SWOT lidhur me gjendjen e turizimit.
- Rekomandimet për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit.

Hipotezat:

1. Bashkia Korçëka pasuri të shumta natyrore dhe kulturore për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.
2. Zhvillimi i turizmit ka nevojë për vlerësimin real të aspekteve që e kërcënojnë atë.

Metodologjia e kërkimit:
Ky punim paraqet një punim cilësor i cili është bazuar në literaturën online, strategjitë e turizmit tëBashkisë Korçë, si edhe të dhëna të tjera të gjetura në dokumente origjinale.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË KORÇË

Bashkia e Korçës shtrihet në juglindje të Republikës së Shqipërisë. Shrtirja gjeografike është veri-jug 32 km dhe lindje-perëndim 40 km. Korça ka një sipërfaqe prej 730 km². Korça kufizohet me shtetin e Greqisë dhe me shtetin e Maqedonisë së Veriut. Pozita e favorshme e ka vendosur në kryqëzim rrugësh nga lindja në perëndim nga veriu në jug. E gjithë zona ka një infrastrukturë të zhvilluar rrugore pasi bashkia lidhet me kryeqytetin e Tiranës përmes rrugës nacionale Korçë-Tiranë si edhe ndodhet në afërsi të zonave doganore si ajo e Kapshticës, eGoricës dhe e Tushemisht.




Bashkia e Korçës përbëhët nga tetë njësi administrative në bazë të ligjit nr. 115/2014"Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"[32], respektivisht:

1. Njësia Korçë
2. Njësia Voskopojë
3. Njësia Lekas
4. Njësia Vithkuq
5. Njësia Voskop
6. Njësia Drenovë
7. Njësia Mollaj
8. Njësia Qendër- Bulgarec

Qendra e Korçës ka një rol thelbësor në disa fusha kryesore. Korça është një qendër e zhvillimit ekonomik rajonal, qendër e zhvillimit të turizmit, qendër e zhvillimit të kulturës dhe qendër administrative e arsimore.
Korça ka një klimë mesdhetare-kontinentale me ndryshime të mëdha të temperaturave gjatëstinës së verës dhe gjatëstinës së dimrit. Për këtë arsye qyteti është i vizitueshëm në të katër stinët e vitit duke ofruar mundësi të shumta atraksioni.
Popullsia[33] e Qarkut të Korçës është220196 banorë, ndërkohë bashkia ka rreth 110000 banorë ku pjesa me e madhe janë të kombësisë shqiptare dhe një pakicëështë e përbërë nga vllehët dhe rumunët.

[32] http://prefektitirane.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Ligj_115-2014_31.07.2014.pdf
[33] http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2

Besimi është orthodoks dhe mysliman në pjesën më të madhe. Në një masë të vogël ka besime të tjerë. Njësoj si gjithë Shqipëria edhe Korça njihet për bashkëjetësën fetare të popullsisë.
Sa i takon elementëve të veçantë Korça është lehtësisht e identifikueshme për shkak të traditave dhe zakoneve, tipi i banesave, llojet e veshjeve popullore, kuzhinën, pijet dhe serenatat e njohura në gjithë trevat shqiptare dhe jo vetëm.

TURIZMI NË BASHKINË KORÇË

Bashkia e Korçës mund të vizitohet në të katërta stinët e vitit. Për këtë arsye mund të zhvillohen disa lloje të turizmit. Llojet e turizmit që mund të zhvillohen janë: turizmi kulturor, turizmi rural, turizmi dimër, turizëm kulinar, turizmi etnografik, turizmi agro-ushqimor. Përveç qendrës së Bashkisë Korçë janë edhe rrethinat që njihen për një numër të madh vizitorësh. Për këtë arsye, në vijim do njihemi me disa prej këtyre pikave turistike. Në Korçë zhvillohen një sërë festash që njihen ndërkombëtarisht si: Festa e Birrës, Karnavalet e Korçës, Panairi i Pranverës, Festa e Lakrorit, Festa e mollës, Panairi i Fundvitit dhe Festivali i Dimrit.

Pikat turistike

Bashkia e Korçës mund të vizitohet për një sërë elementësh që e veçojnë nga zonat e tjera siç janë ndërtesat, veshjet, traditat, zakonet, kuzhina, serenatat etj. Krahas të gjithë elementëve të mësipërm në Korçë pikat më të rëndësishmë turistike janë:

- **Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar.**
- **Muzeu Kombëtar i Arsimit**
- **Muzeu i Gjon Milit**
- **Muzeu Arkeologjik**
- **Muzeu Oriental “Bratko”**
- **Tuma e Kamenicës**
- **Pazari i Vjetër i Korçës**
- **Parku Rinia**
- **Katedralja “Ringjallja e Krishtit”**
- **Xhamia e Iljaz Bej Mirahorit**
- **Shtëpia Rumune**
- **Kulla Panoramike**
- **Zona Këmbësore**
- **Lëndina e Lotëve**
- **Bashta “Themistokli Gërmenji”**
- **Bulevard Republika**
- **Lagjet me Kalldrëm**
- **Sheshi i Mitropolisë**
- **Çezma e Amzos**
- **Fabrika e “Birra Korçës”.**

Llojet e turizmit në bashkinë Korçë.

Llojet e turizmi nëBashkinë e Korçës janë të shumta. Kjo vjen si pasojë e vendbanimit të hershëm të zonës, trashëgimisë kulturore që i ka rezistuar kohës, natyrës së pasur dhe të shumëllojshme e cila ndryshon të varësi të ngjitjes në lartësi (psh. ndryshon natyra në qytet me lartësitë e Dardhës), zhvillimit të bizneseve turistike pritëse si bujtinat apo shtëpitë e pushimit, ruajtjes së traditave në gatim dhe përgatitjen e materiale bazë të ushqimit gjatë sezonit të dimrit. Për të gjitha arsyet e mësipërme nëBashkinë e Korçës mund të zhvillosh:

- turizmin kulturor (turizëm i trashëgimisë, i artit, kreativ, kulturor-urban, kulturor-rural, kulturor popullor)
- turizmin rural,
- turizmin dimëror,
- turizmin kulinar.

Turizmi kulturor mund të zhvillohet si brenda ashtu edhe jashtë qytetit të Korçës. Muzetë e shumtë, objektet e kultit dhe lagjet e vjetra janë atraksione të prekshme në qytet. Përreth Korçës gjenden kishat e hershme të cilat i kanë rezistuar kohës, apo tuma e Kamenicës e cila është dëshmi e vendbanimit të hershëm të kësaj zone. Voskopoja, Vithkuqi, Dardha dhe Boboshtica janë zonat përreth Korçës ku mund të hulumtohet rreth historisë ndër shekuj.
Krahas turizmit kulturor zonat e lartpërmendura pra Voskopoja, Dardha, Vithkuqi, Kamenica, Booshtica janë zona me një natyrë të pasur, shpendë dhe kafshë karakteristike të zonës, me klimë tipike malore dhe me ujra të pasura nën dhe mbitokësorë që në disa raste janë edhe kurativë. Në këto zona mund të zhvillohet turizmi sportiv dhe i aventurës për shkak të natyrës siedhe hapësirave të pafund me terrene të hapura.
Në bazë të stinëve turizmi dimëror është periudha kur Bashkia e Korçës ka numrin më të madh të vizitorëve. Kjo lidhet me faktin se gjatë dimrit bie borë me një trashësi të konsiderueshme. Kjo e bën qyetin më atraktiv dhe ofron mundësi të shumta për pushime të shkurtra (kryesisht në fundjavë) ose pushime të gjata. Në bashkinë e Korçës, respektivisht në zonën e Dardhës ndodhet pista e vetme ku mund të zhvillohet ski në të gjithë Republikën e Shqipërisë.
Zona e Korçës dallohet për gatime specifike, të veçanta, autentike dhe përgatitjen e tyre në mënyrë artizanale. Kjo është një shtysë shumë e madhe për turistët që të vizitojnë bashkinë e Korçës. Për këtë arsye vitet e fundit janë zhvilluar së tepërmi edhe ato që njihen si bujtina të zonës tek të cilat mund të provohen ushqimet karakteristike të zonës. Turizimi kulinar është baza e ekonomisë për një sërë biznesesh familjare në qytet dhe në rrethina.

Atraksione turistike në rrethinat përreth Korçës.

Në njësinë administrative të Voskopjës, e cila është vetëm 20 km larg Korçës,ndodhen 22 kisha ku pjesa më e madhe dhe e rëndësishme janë të hapura për publikun.
Ndër të tjera mund të përmenden: Kisha e Shën Athanasit, Manastiri i Shën Prodhomit, Kisha Katedrale “Fjetja e Shën Mërisë”, Kisha e Kryeëngjëjve Gabriel dhe Mihal,Kisha e Shën-Kollit.
Voskopoja mund të vizitohet për kulinarinë e pasur, shtigjet natyrore, arkitekturën post-bizantine, rrugët karakteristike me kalldrëm dhe shëtitjet me kuaj.

Njësia administrative e Vithkuqit ndodhet 26 km larg nga qendra e Korçës. Kjo zonë ka tradita të hershme dhe e njohur për kuzhinën e pasur. Vithkuqi njihet si një nga zonat më të hershme të banuara. Dëshmi për këtë janë kalatë si ajo e Bellovodës dhe Leshnjës, tumat e Vithkuqit dhe kisha e Shën Thanasit. Në këtë zonë ndodhen edhe 17 kisha të tjera dhe 3 Manastire.

Dardha është një nga fshatrat më të njohur tëBashkisë Korçë. Njihet për historinë e pasur dhe klimën malore. Fshati është 20 km larg qendrës së Korçës dhe është vendosur në një gropë. Atraksionet më të rëndësishme janë shtëpitë karakteristike të zonës të mbulura më plloça tëhirta, rrugët karakteristike me kalldrëm, Muzeu i Dardhës si edhe burimet me ujra kurativë ku më i dëgjuari është Uji i Qelbur. Në Dardhë mund të kryesh ngjitje në mal dhe të aplikosh sportin e skive pasi aty ndodhet e vetmja pistë e skive në Shqipëri.

Analiza SWOT e turizmit në bashkinë Korçë.

Nisur nga pikat turistike dhe atraksionet e përmendura më sipër, kushtet që ka Bashkia e Korçës për mundësintë e zhvillimit dhe tërheqjes së turistëve, mundësitë e shumta për të vizituar, resurset e pasura të zonës dhe objekteve natyrore e të trashëgimisë kulturore është kryer një analizë SWOT për të përcaktuar pikat e forta, pikat e dobta, mundësitë dhe kërcënimet për turizminnë Bashkinë Korçë.

PIKAT E FORTA

- **Peisazh i mahnitshëm: përfshirë zonat e zhvilluara në qytet, zonat e Voskopojës, Dardhës dhe Vithkuqit.**
- **Atraksione: muzetë, teatri, zona pedonale, pazari i vjetër i Korçës, parqet, njësitë administrative turistike me aktraksione natyrore dhe kulturore.**
- **Shumëllojshmëri e biodiversitetit.**
- **Shumëllojshmëri e aktiviteteve.**
- **Organizim dhe arkitekturë: lagjet e vjetra të qytetit dhe njësitë administrative turistike.**
- **Mundësi për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit.**
- **Trashëgimi e pasur materiale dhe jomateriale: e pasur me vendbanime, arkeologji, arkitekturë, kostume, punime, zakone, histori.**
- **Kuzhinë tradicionale shumë e pasur**
- **Cilësi shumë e mirë e ujrave nën dhe mbitokësore.**
- **Cilësi shumë e mirë e produkteve bujqësore dhe blektorale.**
- **Agro-turizmi i zhvilluar me bujtina që ofrojnë standarte më të mira.**
- **Ajër shumë i pastër: një nga qytetet me ndotje më të ulët në rang republike.**
- **Prania e rrugëve me cilësi shumë të mirë që lidhin qytetin me njësitë administrative turistike: mundësi e lehtë lëvizshmërie.**

PIKAT E DOBTA

- Objekte të trashëgimisë kulturore që kanë nëvojë për investime sidomos në zonat e Voskopojës dhe Dardhës.
- Ndërtimet e fundit në qytet nuk i përshtaten arkitektureës së vjetër të qytetit.
- Gjuetia e pakontrolluar
- Prerja e pyjeve
- Shfrytëzim i pakontrolluar i burimeve
- Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara.
- Largimi i popullsisë drejt kryeqytetit ose në emigrim.
- Mungesa e ndriçimit dhe menaxhimit të mbetejeve në njësitë administrative të bashkisë.

MUNDËSITË PËR ZHVILLIM

- **Kërkesat në rritje për turizmin dimëror në veçanti.**
- **Aktivitete të shumta: shfaqje teatrale të përjavshme, aktivitete sportive alpine në dimër, zhvillimi i ditëve festive që identifikojnëBashkinë e Korçës etj.**
- **Përmirësimi i infrastrukturës rrugore sipas parametrave europiane.**

KËRCËNIMET

- Ndërtimet e reja që nuk përshtaten me strukturën e vjetër të qytetit.
- Menaxhimi jo i mirë i mbetjeve të njësive administrative.
- Prerja e pyjeve
- Gjuetia e pakontrolluar
- Shfrytëzimi i burimeve pa kriter.
- Migrimi
- Emigrimi
- Informaliteti
- Keqpërdorimi i burimeve natyrore.

| | |
|---|---|
| • **Çertifikimi i produkteve të zonës.**<br>• **Çertifikimi i infrastrukturës akomoduese.**<br>• **Mbështetja e turizmit tek produktet artizanale.**<br>• **Kualifikimi i burimeve njerëzore.**<br>• **Ruajtja e raportit: ndërtime të reja-natyrë.**<br>• **Organizimi i sa më shumë eventeve për tërheqjen e turistëve.**<br>• **Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve të njësive administrative.**<br>• **Pajisja me sinjalistikë të zhvilluar për infrastrukturën turistike.** | • Raporti ndërtime-mjedis në zonat kryesore të qytetit Korçë. |

Përfundime

Bashkia e Korçës është një nga qytetet më të hershme të banuara në Republikën e Shqipërisë. Ajo është një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike, turistike, kulturore të rajonit Jug-Lindor. Për shkak se kjo bashki ndodhet në afërsi me disa shtete të tjera dhe rrugëve kryesore që lidhin kryeqytetin me shtetet fqinj e bën një qytet mjaft të rëndësishëm nga pikëpamja ekonomike, kulturore dhe turistike.
Në bashkinë e Korçës dhe në njësitë administrativë pjesë të saj mund të zhvillohen lloje të ndryshme të turizmit. Respektivisht në Korçë mund të zhvillohet turizmi kulinar dhe kulturor për shkak të numrit të madh të elementeve të trashëgimisë historike. Ndërkohë që në zonat përreth qyetit si Dardha, Voskopoja e Vithkuqi mundësitë janë edhe më të mëdha. Krahas turizmit kulinar e kulturor në këto zona mund të zhvillohet turizimi sporteve të aventurës, turizëm në natyrore e turizëm agro-ushqimor. Sa i takon numrit të turistëve stina në të cilën këto zona frekuentohen është stina e dimrit për shkak të rreshjeve të borës dhe mundësive për zhvillimin e sporteve dimërore.

Bashkia e madhe e Korçës është e avantazhuar në zhvillimin turistik për shkak të peisazhit natyror shumë të pasur, atraksioneve të shumta të karakterit historik e natyror, shumëllojshmërisësë biodiversitetit, shumëllojshmërisësë veprimtarive që mund të kryen në çdo stinë të vitit, organizimitdhe vendosjes strategjike të qytetit, mundësisë për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, trashëgimnsë së pasur materiale dhe jomateriale, kuzhinës tradicionale shumë të pasur dhe aksesueshmërinë shumë të lehtë të zonave rreth qytetit me qendrën e Korçës.
Sa më sipër, krahas elementeve avantazhuese të zonës, qëndrojnëdisaaspekte të tjera që janë mundësitë dhe sfidatqë ka bashkia e Korçës për të rritur në mënyrë konstante numrin e turistëve.
Në Korçë gjatë periudhës së dimrit vihet re një tendencënë rritje e turistëve. Zhvillimii veprimtarivegjatë periudhës së dimrit janë një mundësi reale për të tërhequr turistë vendas dhe të huaj, përmirësimi i infrastrukturës rrugore sipas parametrave evropianë, certifikimi i produkteve vendase, mbështetja tek produktet artizanale, ruajtja e arkitekturës së qytetit nga ndërtimet e reja si edhe kualifikimi i burimeve njerëzore janë mundësi reale, të prekshme dhe të realizueshme në një kohë jo shumë të gjatë me qëllim rritjen e mëtejshme të numrit të turistëve.
Për të gjithë elementet që e bëjnë Korçën një nga zonat më të veçanta, më të pasura, më të vizitueshme në Republikën e Shqipërisë dhe mundësive të kësaj zonë për zhvillimin e mëtejshëm sugjerohen disa rekomandime:

1. Duhen rivlerësuar programet e shkollimit në raport me nevojat e tregut në fushat e menaxhim-turizmit me qëllim përgatijen e burimeve njerëzore të aftë dhe profesionale në këtë fushë.
2. Duhen ndaluar ndërtimet e reja në zonat karakteristike të qytetit me qëllim ruajtjen e qytetit me ndërtesat dhe rrugët karakteristike.
3. Duhet kryer një menaxhim më i mirë i mbetjeve urbane sidomos në njësitë administrative të Bashkisë së Korçës.
4. Duhen rritur masat për të ruajtuar biodiversiteti e zonës nga prerja e pyjeve dhe gjuetia e pakontrolluar.
5. Duhet kushtuar një rëndësi e veçantë rritjes së investimeve në infrastukturën rrugore me standardet më të mira evropiane dhe përmirësimin e sinjalistikës turistike.

Duke ndjekur strategji reale, programe të mira kualifikimi, menaxhim më të mirë të burimeve dhe rritje të investimeve në turizëm prespektiva si një nga degët kryesore të zhvillimit në Bashkinë e Korçës do të jetë e prekshme në një kohë shumë të shkurtër. Prespektiva për një ardhme ku turizmi do të jetë faktori më i rëndësishëm social-kulturor dhe ekonomik për Bashkinë e Korçës duket shumë e afërt në kushtet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe adaptimit të strategjive më të mira për turizmin.

Bibliografia


1. Qiriazi, Perikli, Gjeografia fizike e Shqipërisë, Botimet Ideart, Tiranë 2006.
2. Qiriazi, Perikli, Gjeografia Fizike e Shqipërisë. Botimet Ideart, Tiranë 2010.
3. Plan Strategjik - Zhvillimor i Bashkisë 2016 – 2031: http://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Dokumenti%20i%20strategjis%C3%AB%20Bashkia%20Kor%C3%A7%C3%AB%281%29.pdf
4. Plani i Përgjithshëm Vendor (2016 – 2031) i Bashkisë Korçë: http://bashkiakorce.gov.al/files4users/files/Plani%20i%20P%C3%ABrgjithsh%C3%ABm%20Vendor%20-%20Bashkia%20Kor%C3%A7%C3%AB.pdf
5. Strategic document for an integrated, innovative and sustainable development of the region 3 (2017-2020): http://azhr3.gov.al/wp-content/uploads/2017/04/RDA-3_2017-2020_WEB.pdf
6. Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative- territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë": http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf
7. Guida Turistike e Bashkisë Korçë: http://bashkiakorce.gov.al/site/articles.php?cid=198&t=

# GOODS IN TRANS INSURANCE

# CARGO

**Ibrahim Mala**[34]

**Shkelqesa Citaku**[35]

## Abstract

The goods insurance or freight insurance in transit compensates the owner or Transport agjents who eventualy lost or damages their goods during road transportation. Depends from the natyre of insured object, whether it's international of national transportation, type of goods, etc. But,what we are going to analise is the responsibility of any potential damage that could be caused during the transportation. Many have argued the fact that responsible for insurance of the goods in trans is between the owner of the good and the transportation company. Following the above we will analise and compare the national and national trans insurance.

**Keywords:** Insurance, cargo, goods

While transporting goods by road, the liability for any damage caused is usually relied upon on the lease carrier if it is used, although the owners may wish to buy the additional cover themselves. The required insurance cover depends on the terms agreed between the carrier and the owner of the goods. - the most commonly used conditions are the Standard Road Transport Conditions: these define the carrier's responsibility for any loss, non-delivery or damage to the goods (except for some items that can be placed or for which are carried at the owner's own risk models) occurring during transit transport, with a small number of exceptions including losses due to war, riots, confiscation, property owner mistakes and gauging packaging. If a large number of shipments are transported, the carrier and / or the owner of the goods can purchase the cargo on the basis of the declared goods.

Freight transport on international routes is usually provided by the marina insurance market. Naval and aviation security coverage can generally be expanded to include land transport from port or airport to final destination. Under the terms of the so-called CMR conditions (Contra de Merchan-disé par Route), the goods transported internationally through the road are under the responsibility of the carrier, but only up to a certain limit.

Freight insurance in TRANSPORT - CARGO covers the risks to which the insured goods are exhibited during the journey. The main forms of coverage are:

### (1) Risk covering C

***This insurance covers losses, damages, and malpractice insurance costs incurred by:***

[34]PhD C. University of Prizren, Rep. of Kosovo. Email.ib_mala@hotmail.com
[35]Phd C. University of Pristina, Rep.of Kosovo. Email. Shkelqesa@gmail.com

(a) Fire, (b) Accidents of the means of transport (crash, sinking, deadlock, flood, escaping),
(c) Discharge of goods at the port or in the place of disaster etc.

**(2) Risk coveringB**

***In addition to risk coverage "C", this type of insurance also covers:***

(a) Earthquake, volcanic eruption, lightning, (b)The fload on board of the ship, (c) Total loss of special packs during loading and unloading etc.

**(3) Risk coveringA**

No dangers are named but all risks of loss or damage caused by any unforeseen, accidental, and unexpected event are covered.

**Insurance of goods during transport**

Cargo - insurance includes the carriage of goods by means of different means of transport. Consequently, according to the means of transport, the cargo insurance includes: Marine cargo, railway, river, trucks, airplane, and insuranceof postal deliveries, which also have their specifics, no matter what means of transport are.

Cargo - insurance includes both the cargo itself being transported and the driver's liability for damage caused to the cargo that he carries.

In cargo[36] insurance, various forms of coverage are also possible:

- *Against the dangers;*
- *Against the underlying risks;*
- *Against the special risks that depend on the type, in the risk that is to be covered by insurance.*[37]

Insurance types that are part of cargo insurance are grouped into two groups:

1. *Insurance of the country cargo (insurance at the margins of national economy), and;*
2. *Insurance of international cargo (when the insured goods cross the border).*

**Insurance of the country cargo**

As mentioned, the provision of goods transported to the borders of the national economy is called the cargo insurance of the country. This insurance covers all losses and damages of goods that will be presented during the transport provided by the insured case.

Coverage in the country cargo insurance can be contracted in three ways:

1. *With the connection of the general policy for securing the cargo of the country;*
2. *The connection of individual cargo insurance in transport;*
3. *Incorporating the driver from the liability and insurance of the aviotransporter*[38].

**Insurance of international cargo**

[36] Kargo rrjedh nga fjala spanjolle ‘Cargo’ dhe do të thotë barrë anijesh.
[37] Dr. sc. Xhevat Bakraçi: Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimi, Prishtinë, 2004, f. 285
[38] Prof. Dr. Mehdi Hetemi: E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste, Prishtinë, 1996, fq. 377

When it comes to securing a shipment that crosses the state border, this shipment is accompanied by customs documents and is transported by an international transport document (the shipment invoice refers to foreign currency). In the framework of international cargo insurance, four basic insurance groups are also included:

1. *Insurance of import cargo (insurance of imported goods);*
2. *Insurance of export cargo (insurance of exported goods);*
3. *Insurance re-export cargo;*
4. *Insurance of transit cargo (insurance of goods which is transported through the territory of the national economy, with or without a ban on the economy of that country).*[39]

Dangers of Damage for Any Reason: In cargo - providing the widest coverage of the risk, which can be secured, is the compensation of damages, which will eventually arise from any risk. This in practice is often called 'all risks' (expanded cover against all risks).

Freight Rates: Machinery, Apparatus, Parts, Equipment. Në % over SI.

CATEGORY OF GOODS c 01

| **Zone Nr** | **Place** | **Road** | | | **Marin/sea** | | | **Airplane** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Cover** | | | **Cover** | | | **Cover** | | |
| 100 | Evropa | A | B | C | A | B | C | A | B | C |
| 101 | Shqipëria | 0.20 | 0.15 | 0.10 | 0.25 | 0.18 | 0.15 | - | - | - |
| 102 | Itali, Greqi, ishYugos, Turqi, Bullgari, Rumani | 0.26 | 0.20 | 0.16 | 0.29 | 0.22 | 0.18 | 0.21 | 0.17 | 0.14 |
| 103 | Hung., Aus., Zvicer, Çeki, Slovaki, Poloni, Gjermani | 0.27 | 0.23 | 0.19 | 0.31 | 0.25 | 0.21 | 0.21 | 0.17 | 0.14 |
| 104 | Dan., Hol., Bel., Fran., Spanj, Portu., | 0.29 | 0.25 | 0.21 | 0.34 | 0.29 | 0.25 | 0.25 | 0.18 | 0.16 |
| 105 | Fin., Su, Nor., Rusi, M. Bashkuar | 0.32 | 0.28 | 0.25 | 0.35 | 0.31 | 0.27 | 0.27 | 0.20 | 0.18 |

[39] Nevruz Koçi, Sherif Bundo dhe Zenel Shalari, Pasiguria dhe sigurimet, 2002, fq. 143

**Insurance of international marine cargo**

In international freight transport and commodity exchange, in general, maritime transport is very important. Maritime transport of goods is related to naval deals, and is secured by a maritime insurance agreement. Cargo shipping can be contracted by regular boat or by free ship. Following the introduction of the goods on board, the ship's helmsman, the subject who has the goods in transit on the vessel, is obliged to provide the transport document, which may be on his behalf, and this is the document that the goods are in the future ship. If the burden is secured, conosman is one of the key documents for realizing the rights to insurance.

Most commonly, the English maritime security pole is used in securing the international maritime cargo. The English insurance policy uses insurers that are linked to the London market, when required by the terms of the sale or the insurance contractor. The London security market conditions are based on Lloyd's insurance policy, which may be supplemented by some institutional clauses. The insurance policy called Lloyd's S.G. Policy has begun to be used in England since the beginning of the 17th century, and in 1779 it was accepted as a typical policy for all of the insured, members of Loyd. This pole serves for maritime security, both for the provision of ships and the provision of burden on shipping. This can be seen from the signs "S.G", in the name of the "S" pole marks the Ship, the ship, while "G" marks Goods, the merchandise. This policy is now used in maritime security, with the same text that it used several centuries ago. Anachronism and non-enforceability of certain provisions of this policy during practice have been avoided by the addition of so-called institutional holes. These clauses, which are added to the insurance policy, prepare, approve and redact the Association of Insurers in London, called Insurance Insitute of London.[40]

**Insurance of non-marine international cargo**

Insurance of non-marine international cargo include: road, rivers, postal, airtransport .[41]

Each of these types of transport has its own features, according to which cargo insurance in these transports also has its own specifics. For these reasons, when concluding an international cargo insurance agreement, account is taken of the specifics in the field of international maritime cargo and international non-cargo.

## Conclusion

Through cargo insurance, it is understood that all the risks to which the goods are transported are covered, including all accidental or unintentional or malicious losses or damages; fire, explosion; accidents of transport vehicles; discharge of goods at another port in case of disaster; general waste damage, burden-saving costs, earthquake damage, volcano, lightning, damage to goods from water aboard the ship, damage and total loss of luggage during loading and unloading.

This insurance starts from the time the goods move (loaded on the first means of transport) from the warehouse or place of storage to the place specified in the contract for the start of transport or transit, continues along the normal transit route and ends with the delivery to

[40] Adem Selmani, Ilir Prapashtica: Bazat drejt suksesit në sigurime, Pejë, fq. 137
[41] Ksenija Klasiq & Ivo Andrijaniq: bazat e sigurimit, parimet dhe praktika, Prishtinë, 2009, fq. 249

the owner of the goods in the final warehouse or place of storage at the destination specified in the contract for the completion of the shipment.

Like all other insurance, the insurance of the goods must be paid through insurance periods. It is usually calculated depending on the value of the goods, its type, destination and means of transport used in other specific hazards. The rates themselves are not the same for all types of transport.

Good in transit is an important part of the business as it protects property against any damages while the goods are in tranasit from one place to another.

**Literature:**


1. Dr. sc. Xhevat Bakraçi: Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimi, Prishtinë, 2004.
2. Crawford M. L., “Laë and Lile Insurance Contract”, 1994.
3. Prof. Dr. Mehdi Hetemi: E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste, Prishtinë, 1996.
4. Nevruz Koçi, Sherif Bundo dhe Zenel Shalari, Pasiguria dhe sigurimet, 2002.
5. Klauzolët institucionale (1/1/82) për sigurimin e mallrave nga rreziqet e luftës dhe grevës.
6. Picard, M et Besson, A: Les enterprises d’assurance, Paris, 1977.
7. Bower L. J., Mjeshtëria e drejtimit të përgjithshëm, botim i SHBL’usë, Tiranë.
8. Adem Selmani, Ilir Prapashtica: Bazat drejt suksesit në sigurime, Pejë.
9. D. Pavic: “Pomorsko osiguranje”…
10. Ksenija Klasiq & Ivo Andrijaniq: bazat e sigurimit, parimet dhe praktika, Prishtinë, 2009.
11. Dr. Sc. Xhevat Bakraçi: Menaxhmenti i rrezikut dhe sigurimet, Prishtinë, 2007.
12. Mr. sc. Sherif Gashi: Analiza e tregut të sigurimeve, Prishtinë, 2011.

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

# ZHVILLIMI DHE RREGULLIMI I TURIZMIT NDËRKUFITAR

**Shpëtim Memishi**
**Kolegji AAB – Prishtinë,**

## ABSTRACT

Coastal States like everywhere in Europe and in the world are very important to tourism and also in our case study, such as Montenegro and Albania, they should work harder in this regard, since they have the posit very good strategic and also its limitation with the neighboring countries makes it to be with many visitors and tourists.

In this paper we will analyze the development and regulation of tourism for the state of Montenegro by taking examples and strategies of the neighboring state of Albania, Greece and Turkey, what have these countries done to have greater tourism and also so many visitors. What are the benefits and disadvantages of investing in the tourism of this country, what have these countries made for tourism and what their benefits are in tourism investment as well as in hotel investment and providing more conditions good at night as well as in their safety during the holidays whether they are individual or family. Montenegro also has a strategy for several years from offering vacation visitors to its coast, but with all that though there are plenty of good places to visit and vacation it will still have to work much to develop and regulate tourism thanks to the competition of other countries and also the conditions offered by the neighboring countries from here we can mention one week, two weeks holiday, as well as the organization of tourists from the airport to the hotel where will cease and also turn the converse vice versa.

It also invests in infrastructure both on the streets and in its airports as well as in the areas such as: parking lots, different stations in different municipalities, taxi drivers at different times and their arrival in time, different children's points for beaches and also at the center and their hotels, the center of visitors where the evening would have to spend more expansive and more regular time such as the small beach that does not meet the conditions for visitors different and for the time of the break, as well as the big beach has the same position.

**Key words: Coast, tourism, Albania, Turkey, children, airport, etc.**



## Hyrje

Tradicionalisht kufijtë – qoftë fizik apo konceptualë janë konsideruar ne mes “nesh” dhe “atyre” si demokraci për të përcaktuar dallimin në mes të vendit të civilizuar dhe asaj të pa civilizuar.

Mali i Zi ka një bregdet piktoresk dhe gjithashtu një rajon malor verior. Ky vend ka qenë i njohur për turistët që nga vitet 1980.Edhe pse, luftërat Jugosllave që u luftuan në vendet fqinje gjatë viteve 1990, dëmtuan industrinë turistike si dhe imazhin e Malit të Zi për vite me radhë.

Sipas të dhënave Mali i Zi ka gjithësejt **644.578** banorë nga prej tyre:

| | |
|---|---|
| **Musliman** | **19.10%** |
| **Ortodoks** | **72.10%** |
| **Katolik** | **3.40%** |
| **Të pa përcaktuar** | **3%** |
| **Të tjerë** | **1.50%** |
| **Ateist** | **1.20%** |

| | |
|---|---|
| **0-14 vjet** | 16 % (meshkuj 52,645/femra 54,8469) |
| **15-64 vjet** | 70.3% (meshkuj 244,9491/femra 227,794) |
| **65 e më tepër vjet** | 13.76 % (meshkuj 11,37,217/femra 54,7298) (2009 vler.) |

Tabela 1. Të dhënave Mali i Zi ka gjithësejt **644.578** banorë

Me një total prej 1.6 milion vizitorësh, ky destinacion është renditur në vendin e 36 si një ndër vendet më të vizituara të Europës.

Për fat të mirë republika e Malit të Zi, tani është ndër republikat që shum vite më parë ka kaluar këtë fazë të zhvillimit dhe njëherit njihet si shteti më demokratik dhe me një infrastrukturë dhe popullatë të zhvilluar dhe me toleranc ndër etnike.

| Kombi | Nr. i banorëve | % |
|---|---|---|
| Malazezë | 267.669 | **43,16%** |
| Serb | 198.414 | **31,99%** |
| Boshnjak | 48.184 | **7,77%** |
| Mysliman | 55.761 | **9%** |
| Shqiptar | 31.163 | **5,03%** |
| Kroat | 6.811 | **1,1%** |

| | | |
|---|---|---|
| Rom | 2.601 | **0,42%** |
| Yugoslav | 1.86 | **0,3%** |
| Maqedon | 819 | **0,13%** |
| Slloven | 415 | **0,07%** |
| Hungarez | 362 | **0,06%** |
| Rus | 240 | **0,04%** |
| Egjiptas | 225 | **0,04%** |
| Italian | 127 | **0,02%** |
| Gjerman | 118 | **0,02%** |
| Të Tjerë | 2.18 | **0,35%** |

Burimi: https://sq.wikipedia.org/wiki/

Punimi synon të paraqesë rëndësinë që ka turizmi në shtetin e Mali të Zi, përkrah degëve tjera të ekonomisë. Në ditët e sotme zhvillimi i turizmit gjithënjë e më tepër po bellafaqohet me problemet e globalizmit, krizave politike dhe financiare që ka prekur ekonominë botërore. Nga po ndikon që turistët të orientohen nga vendet dhe destnacionet më pak të njohura. Duke marrë parasysh hapsirën e madhe të problemeve që i përkasin fushës së gjeografisë së turizmit, ky punim bën përpjekje për të pasqyruar ato ide, mendime, përkufizime dhe përpjekje që kanë të bëjnë me teorinë mbi turizmin, lëvizjet turistike dhe me zhvillimet dhe ndryshimet që ka përjetuar turizmi gjatë pjesës së dytë të shek.XX-të dhe fillimin e mijëvjeqarit të ri.

Zhvillimi i turizmit është një nismë që trajton çështjen e papunësisë në Mal të Zi nëpërmjet ndërhyrjeve që promovojnë krijimin e vendeve të punës si dhe ndërmjetësimin e efektshëm për vende pune për të rinjët.

**Rëndësie e turizmi në ekonomine e shtetit** – udhëtimi dhe turizmi është sektori mëi rëndësishëm s në aspektin e punësimit ashtu edhe parashikime pozitive për rritje në ekonominë e sajë.Ekonomia e Malit të Zi është shum i varur nga turizmi, pjesëmarrja e drejpërdrejt në PBB në vitin 2016 është vlerësuar në 11%, ndërsa pjesmarrja indirekte vlerësohet të jetë 22.15%. Pjesëmarrja në zonat e mbrojtura është 172 milionë euro.

Nga numrii përgjithëshëm i vizitorëve në këtë vit shin 1.713,109 më shumë se 400.000 turistë kanë vizituar zonat e mbrojtura në Mal të Zi, nga aktualisht mbulojnë 9.05%( rreth 125.000 hektar) të territorit të sajë. Të ardhurat për menaxhimin e parqeve ishin rritur nga vitet paraprake rreth 500.000 euro nga viti 2009 deri në vitin 2013 për shkak të shitjes së biletave dhe rritjes së numrit të vizitorëve.

Ndërsa në Shqipëri sipas PBB në vitin 2013, 68.1 miliardë(4.88% e PBB), nga e cila në vitin 2014 ështëparashikuar të rritet me 5.5% në 71.9 miliardë, të cilat të përfshirë veprimtaritë e ndërlidhura të industrive të resturantit dhe pushimeve. Kontribut i ndikimit të ardhurave të tërthorta në vitin 2013 ishte 239.8 miliardë, çka korospondon shifër prej 16.7% të PBB. Nga kjo shifër është rritur me 4.6% në 250.8 miliardë ose 71% të PBB në vitin 2014, duke konsolduar turizmin si industri në rritje me kontribute domethënëse në punësim dhe gjenerim të ardhurash.







Burimi: Këshilli botëror i udhëtimeve dhe Turizmit WTTC[42]

Këto shifra pasqyrojnë veprimtarinë e konsiderueshme ekonomike që gjenerohet ngaindustri tëtilla si hotele, agjencione udhëtimesh, linja ajrore si dhe shërbime të transportit. Si industringa shërbimet janë interesante për gratë dhe rininë për të ilustruar shërbimet. Rinia në këto shërbime janë nën moshën 21 vjeqare nga gjysma e njerëzve si në Shqipëri ashtu edhe në Mal të Zi jetojnë nën vijën e varfërisë[43]. Gratësidomos përbëjnë pjesen më të madhe të forcës së punës në Turizëm formal dhe informal. Në fakt, 85% e bizneseve të drejtuara nga gratë janë të vendosura në zona urbane dhe vetëm 15% në zonat rurale. Gratë drejtojnë vetëm 18.2% të organizatave joqeveritare dhe janë të keqpërfaqësuara në postet drejtuese: vetëm 17% e posteve drejtuese mbahen prej tyre. Rreth gjysma e punësimit për gratë përbëhet nga 30% vende pune profesionale (financë, llogaritare, etj.) dhe 20% vende pune si punonjëse shërbimi (kuzhiniere, kamariere, pastruese, guida turistike, etj.).

**Rinia** në Shqipëri dhe Mal të Zi është e angazhuar dhe e mirëpërfaqësuar në të gjithë zinxhirin e vlerave të Turizmit në poste të ndryshme brenda shërbimeve të mikpritjes të tilla si guida turistike, akomodim, shërbime ushqimi dhe pijeje, transport; të rinjtë dhe të rejat janë më pak të përfaqësuar në artizanat dhe prodhim suveniresh. Vlerësimet kanë treguar se turizmi nga zonat e mbrojtura ka kontribuar gjithësejt 172 milion euro duke krijuar ekuivalentin e 7700 vendeve të punës me orar të plotë[44].Mali I Zi ka gjithësejt 22- komuna nga prejt tyre janë më të zhvilluara ato komuna që prekin buzë detit dhe duke i përfshirë dy pllazhet e njohura në Ulqin si pllazha e vogël dhe pllazha e madhe. **Komuna e Ulqinit** është komunë në Mal të Zi, e cila gjendet në pjesën më jugore të rajonit bregdetar të Malit të Zi dhe kufizohet me Shqipërinë në lindje, me Detin Adriatik në jug e perëndim dhe me Komunën e Tivarit në veri. Qendër e kësaj komune është qyteti i Ulqinit, ndërsa popullsia e komunës është 19,921 banorë (2011) dhe ka një sipërfaqe prej 255 km2.

## Metodat e aplikuara shkencore:

Metodat e përdorura për këtë punim shkencor është duke metodat primare dhe sekondare. Tek të dhënat primare do të jenë burimet e marra nga qytetarët, ministria dhe turistët përmes pyetësorit.Pas marrjes se përgjigjeve nga ana e tyre, përpunimi i të dhënave do të bëhet në excel, ku të gjitha rezultatet e dala nga pyetësori do të parqiten permes grafikoneve, si dhe do të bëhet komentimi i tyre.Tek tëdhënat sekondare do të jetë e paraqitur literatura nga autorë të huaj dhe ata vendorë.Në intervistën me banorët lokal apo rezident dhe me vizitorët që kemi gjetur gjat pushimeve në sezonin e tyre. Prej tyre kemi nxjerrë një rezultat se sa janë të kënaqur banoret (resident) me punën që kanë bërë komuna e tyre e po ashtu edhe nga vizitoret se sa janë të

[42] WTTC, Travel & Tourism: Economic Impact 2014, Albania, www.wttc.org
[43] Rural Poverty Portal; Rural poverty in Albania; http://www.ruralpovertyportal.org/country/home/tags/albania
[44]https://natureforpeople.org/al/montenegro/

kënaqur me kushtet që ju ofrojnë këto vende turistike me kërkesat e tyre. Në bazë të këtyre intervistës kemi marë rezultatet që do të trajtohen më poshtë.

| Banoret Rezident / vizitorë në intervistë 80 persona | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sa jeni të kënaqur me investimet e bëra nga ministria e infrastrukturës | | | | | | | | | |
| shum pak i kënaqur | | i kënaqur | | mesatarisht | | shumë i kënaqur | | tepër i kënaqur | |
| banorë | vizitor | banorë | vizitor | banorë | vizitor | banorë | vizitor | banorë | vizitor |
| 1 | | 2 | | 3 | | 4 | | 5 | |
| 1.10% | 5.00% | 2.30% | 22% | 9.75% | 35.00% | 30.23% | 31% | 56.62% | 11.50% |

Tabela 2. Banoret Rezident / vizitorë në intervistë 80 persona




Grafiku 1. Banoret Rezident / vizitorë në intervistë 80 persona

Tabela 3. Sa jeni të kënaqur me investimet e bëra nga komuna e juaj




Grafiku 2. Sa jeni të kënaqur me investimet e bëra nga komuna e juaj

Vlen të theksohet se gjat intervistës kemi mare përgjigjet e sinqerta dhe të cilët kanë marë kohën e duhur për tu përgjigjur dhe duke mos pasur hezitime në përparësit dhe mangësit që kanë për qytetet e tyre dhe udhëheqësit e komunave të tyre.

**Gjetjet dhe analizimi i sajë:**

Duke i vizituar dhe takuar shumë banorë të këtyre trojeve e po ashtu edhe gjat bisedimeve me ta kemi marur shumë përgjigje dhe shum gjetje për qytetet e tyre se qka në fakt kishte me qenë me rendësi përata qytetar dhe sipas tyre qka do të ndryshonte per jeten e tyre e po ashtu edhe për vizitorët që do të vizitojnë këto qytete. Nga kemi marë kërkesa se qytete e tyre kanë shumë mangësi në menagjimin si në rrymë, ujë të pijës, rrugët dhe po ashtu edhe hapsirat gjelberuese dhe relaksuese për fëmijët e tyre dhe po ashtu edhe për vizitorët që vinë në banesat e tyre nga këto këta i shfrytëzojnë në sezone për t'ju dhënë me qera.

Nga një pjes e tyre janë deklaruar se është ky sezon qëata mbajnë familjet e tyre dhe egzistencen e tyre. Po ashtu kanë shumë kërkesa që qytetet e tyre të ken edhe më shumë siguri gjat sezoneve të pushimit dhe të vënë në dispozicion edhe shërbimet kujdestare edhe më shumë që të kenë intervenime me të shpejta dhe me te leta në rast të ndonjë intervenimi.

Në kohën e pushimeve të ken më shumë vend për fëmijët e tyre dhe të vizitorëve se ku do të munden të lozin dhe me një siguri prej rrezikut nga automjetet apo ndonje tragjedi tjeter, të jenë të vendosura këto vende ne periferi ku nuk do të pengonin qarkullimin e komunikacionit dhe atyre që dëshirojnë të vizitojnë nga plazha e vogël në atë të madhen dhe anasjelltas.

Duke i analizuar këto dhe po ashtu edhe duke i vizituar këto vende kemi parë se që në hyrje të këtij shteti dhe shtetit fqinjë Shqipërisë, kemi shumë vizitorë që presin me orë për të hyrë në këto shtete e nga se në këtë kohë punojnë vetem një pjes për të hyrë e nga edhe kontrollohen nga përgjegjësit kufitarë siq janë policët dhe doganjerët, po ashtu ka mundësi dhe ka hapsirë që të hapen edhe më shumë pikë kontrolli si në hyrje nga Shqipëria e po ashtu edhe nga Maqedonia dhe pikat tjera kufitare, ku do të mundësojë që të kënë pika tre deri në pesë dhe do tëmunden që të redutkojnë kohën e pritjes dhe lodhjen e mërzitjen e vizitorëve apo pushuesve që kanë mësyer këto shtete.

Nga mbasi të kalohet pika kufitare do të hasim edhe në rrugë që janë shumë të ngarkuar dhe nuk janë autoudhë që të jet mundësia e qarkullimit më të letë.Po ashtu mungojnë edhe shenjat dhe sinjalizimi i rrugëve e po ashtu edhe vendet ku do të munden të kenë një pushim apo një ndales të shkurtër prej vizitorëve.

Duke parë se çdo vit kemi donacione të ndryshme e në anën tjeter edhe pse kemi vizitorë të shumtë prap këto shtete nuk punojnë të bëjnë ndryshime si në infrastruktur apo edhe në shërbime të tjera shtetërore e komunale. Vizitoret e ndryshëm kan gjithmonë kërkes që sa më let të akomodohet dhe të sigurohet për vendet më të preferuara për ta dhe po ashtu që gjat udhëtimit mos të kenë problem me akomodim apo gjetjes së hoteleve, restoranteve dhe plazhave më të rregulluar dhe me kushte më të mira, për këtë qytetet turistike në Mal të Zi dhe Shqipëri do të duhej të kenë sa më shumë reklamime dhe vizita në shtetet e ndryshme që t'ju bëhet ofertë për pushimet e qytetarëve të shteteve të ndryshme dhe që numri i tyre është shum i madhë për pushime që dëshirojnë ti kalojnë. Përmes ofertave dhe vizitave nga ministria e turizmit ata do të duhej të punojnë shumë në prezentimet e tyre dhe sa më shumë të jenë më bindëse se për çfar

arsye qytetarët e atyre shteteve duhen ti kalojnë pushimet në këto dy shtete dhe si do të jenë kushtet më të leta për qytetar e tyre dhe për sigurinë e tyre.

Këto dy shtete do të duhej të bëjnë njëanalizë shumë të gjërë dhe po ashtu me ekipe shumë profesionalizuar që kanë të bëjnë me turizmin dhe po ashtu edhe me analistat shtetëror nga do të duhej edhe të thirren bizneset private dhe ato shtetërore për konsultimin e tyre e po ashtu edhe për propozimin e tyre se qysh do t'i joshin vizitorët sa më shumë për ti vizituar këto troje. Mbas çdo takimi ministria dhe po ashtu bizneset do të duhej të dalin me një qëndrim me ofertat dhe përgaditjen për sezonat e pushimit duke përfshi këtu akomodimin e turistëve prej momentit që do të hyn si në pikat kufitare rrugore, ajrore e po ashtu edhe detare.

Nëse turistët do të vinë me anë të pjesës detare, të jet i përgaditur ekipi për pritjen e tyre nga porti deri në hotelin apo shtëpin e përzgjedhur nga ana e pushuesit. Nga do të ju mundësohet qasja shum e letë në akomodim e po ashtu edhe pjeset tjera përcjellëse si të sigurisë në vendin ku do të qëndron e po ashtu edhe kryerja e rexhistrimit në ministrin e punëve të mbrendëshme në qytetin ku dëshiron të bëjë pushimin nga ministria e mbrendëshme të ket informacion dhe të dhanat e turistit. Po ashtu edhe vendi i qëndrimit do të jet i sigurtë si fizikisht ashtu edhe për makinën apo pajisjen qarkulluese nësë do të ket vet pushuesi(turisti), që sa më shumë të ndihet i sigurt dhe i relaksuar me shërbimet dhe sigurimin tonë.

Vlen të theksohet se kohët e fundit apo vitet e fundit trafiku me tren është në zhdukje apo në mos funksionimin e sajë, nga na bën që edhe ne të kemi humbje të madhe si shtet apo vend turistik. Nga përmes trafikut të rrugës me binare e cila që në zanafillen e sajë ka buz detit apo liqenëve ku kjo na jep një pejsazh shumë të bukur dhe me një pamje marramendëse si nga ana e gjelbrimit të sajë e po ashtu edhe pozitave që ka kjo rrugë. Sot në vendet e zhvilluara trafiku rrugor përmes shinave është shum e preferuar dhe po ashtu e organizuar me trafikun tjetër si rrugor(autobus,minibus,tranvaj), nga janë aq të organizuar që në sekondat e fundit që do të arrijë treni në stacion aty është duke e pritur autobusi apo tranvaji për stacionin e ardhëshëm që ka planifikuar vet personi apo pushuesi.

Duke parë se kërkesat më të mëdha janë që turistët të kenë një ofertë eksluzive prej hoteleve apo bizneseve private kjo na bën ne si shtet të kemi më shumë njohuri se sa vizitorë do të kemi në vite dhe se sa janë arritjet tona me investimet e bëra në vitet e fundit, nga duke marë shembull vitet e më hershme nëse kemi pasur: se nëvitin 1985 kemi pasur 895,000 vizitor dhe me shpenzime minimale prej 320 euro dhe asaj maksimale prej 450 euro për një familje. Nëvitin 1999 ka pasur 1,600,000 vizitor dhe kanë shpenzuar minimalisht një familje 320 euro dhe maksimalisht prej 450 euro, ndërsa në vitin 2001 ka pasur 1,610,000 vizitor dhe kanë shpenzuar minimalisht 320 euro dhe maksimalisht 450 euro.nëse shohim vitin 2016 kemi pasur 1,713,000 vizitor me shpenzime minimale prej 320 euro dhe shpenzime maksimale prej 450 euro, dhe viti 2018 ka pasur 1,720,000 vizitor me shpenzime 320 euro minimale dhe maksimale me 450 euro.

| Nr. | Viti | Vizitor | shpenzime | | Totali € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1985 | 895,000 | 320 € | mesatarja | 635,200.00 € |
| | | | 450 € | minimalja | 893,250.00 € |
| 2 | 1999 | 1,600,000 | 320 € | mesatarja | 639,680.00 |
| | | | 450 € | minimalja | 899,550.00 |
| 3 | 2001 | 1,610,000 | 320 € | mesatarja | 640,320.00 |
| | | | 450 € | minimalja | 900,450.00 |
| 4 | 2016 | 1,713,109 | 320 € | mesatarja | 645,120.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | 450 € | **minimalja** | **907,200.00** |
| **5** | **2018** | **1,720,000** | 320 € | **mesatarja** | **6,405,760.00** |
| | | | 450 € | **minimalja** | **9,008,100.00** |

Tabela 4. Mesatarja e shpenzimeve të vizitorëve, minimale 352€ dhe ajo maksimale 450€




Grafiku 3. Mesatarja e shpenzimeve të vizitorëve, minimale 352€ dhe ajo maksimale 450€

Në tabelen Nr.5 kemi të ardhurat nga shpenzimet e vizitorëve që do të ishin të arsyeshme me çmimet e ofertës enkluzive dhe me të hyra të deklaruara për shtetin dhe qytetet që do të ishin vizituar nga pushuesit dhe turistët.

| Nr. | Viti | Vizitor | shpenzime | | Totali € |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **1985** | **895,000** | 550 € | **mesatarja** | **1,091,750.00** |
| | | | 1,250 € | **minimalja** | **2,481,250.00** |
| **2** | **1999** | **1,600,000** | 550 € | **mesatarja** | **1,099,450.00** |
| | | | 1,250 € | **minimalja** | **2,498,750.00** |
| **3** | **2001** | **1,610,000** | 550 € | **mesatarja** | **1,100,550.00** |
| | | | 1,250 € | **minimalja** | **2,501,250.00** |
| **4** | **2016** | **1,713,109** | 550 € | **mesatarja** | **1,108,800.00** |
| | | | 1,250 € | **minimalja** | **2,520,000.00** |
| **5** | **2018** | **1,720,000** | 550 € | **mesatarja** | **11,009,900.00** |
| | | | 1,250 € | **minimalja** | **25,022,500.00** |

Tabela 5. Mesatarja e shpenzimeve të vizitorëve, minimale 550€ dhe ajo maksimale 1,250€




Grafiku 4. Mesatarja e shpenzimeve të vizitorëve, minimale 550€ dhe ajo maksimale 1,250€

**Rezultatet kryesore:**

Zhvillimi i rregullimit të turizmit është njëri ndër rezultatet më të kërkuar për rregullimit të turizmit është njëri ndër rezultatet më të kërkuar për çdo shtet nga përmes asaj mund të shuhet se sa do të ketë ndikim turizmi në vitet e më parëshme dhe ato që do të jenë në të ardhmen.

- Pabarazi rajonale në aspektin e zhvillimeve social-ekonomike dhe struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërkohë që rajonet shqiptare mbështeten në bujqësi, shërbime, tregje me shumicë dhe pakicë, rajonet malazeze shfaqin një industri më të zhvilluar, si dhe niveli i turizmit është shumë më i zhvilluar. Të dyja rajonet janë nën potencialin e tyre të zhvillimit, pasi ata ende duhet të gjejnë mënyra dhe mundësi për të përfituar nga avantazhet e tyre krahasuese.
- Konkurrenca e biznesit është e ulët në të dyja anët e kufirit. Struktura e operatorëve ekonomikë në zonën e programit është e dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Produktiviteti më i lartë dhe investimet e mëtejshme në ekspertizën dhe përdorimin e teknologjive të inovacionit, janë një parakusht për t'u bërë më konkurrues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në të dyja anët operojnë në sektorin e shërbimeve. Forcimi i mekanizmave mbështetëse të biznesit mbetet një sfidë.
- Në përgjithësi, ekonomia rurale është e fragmentuar, në një shkallë më të lartë në zonën shqiptare të programit. Por, pronarët e vegjël bujqësorë përballen me vështirësinë për të hyrë në tregjet e vendit dhe ato rajonale. Përmirësimi i aksesit në treg dhe forcimi i sistemit ushqimor dhe organeve përkatës të inspektimit do të jenë të rëndësishëm për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë.
- Papunësia është relativisht e lartë, si në Mal të Zi ashtu edhe Shqipëri, dhe vazhdon të jetë një problem i madh ekonomik. Papunësia mbetet një problem i mprehtë veçanërisht për grupet e ndjeshme sociale siç janë të rinjtë, gratë dhe popullsia rurale. Varfëria është bërë një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërkohë që ripërtëritja e potencialit urban tashmë të përdorur është bërë e domosdoshme për të udhëhequr rritjen ekonomike. Niveli i pabarabartë arsimor është i pranishëm në zonën e programit, me një rritje të analfabetizmit në zonat e thella. Të rinjtë me arsim të lartë kanë tendencë për t'u larguar drejt rajoneve që ofrojnë më shumë

mundësi apo jashtë vendit. Sistemi i arsimit të mesëm është më pak tërheqës dhe i aksesueshëm, veçanërisht për popullsinë e re në zonat rurale të programit.

- Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshëm të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit që mbështetet kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja dhe ruajtja mjedisore e tyre është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, i kontrollit të ndotjes dhe përmirësimi i menaxhimit të tokave janë ndër prioritetet kryesore për t'u adresuar. Vleftësimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës.
  - GDP për frymë është 5.063 euro në vitin 2012[45], pak më e ulët në krahasim me 5.211 euro e regjistruar në vitin 2011, por më e lartë se në gjashtë vendet e tjerë të rajonit.

    Ekonomia e Malit të Zi ka hyrë në recesion në vitin 2008, dhe ka filluar të ngrihet pjesërisht në vitin 2010 dhe 2011 me një mesatare prej 2.9%. Megjithatë, rritja ka ndaluar përsëri pasi GDP ka regjistruar një rritje negative prej 2.5%, ndërsa papunësia ka arritur në rreth 19.7% në vitin 2012 nga 16.5% që ishte në vitin 2010[46].

    Shtyllat kryesore ekonomike të vendit mbeten turizmi, i ndjekur nga prodhimi, ndërsa sektorë të tjerë si ndërtimi dhe industria janë kontraktuar gjatë vitit 2012. Inflamacioni është rritur nga 0.5% në vitin 2010, në rreth 3.6% në vitin 2012 dhe borxhi publik është rritur nga nën 30% e GDP-së në vitin 2007 në mbi 54% të GDP-së në vitin 2012.

    Nga ana tjetër, kredia për ekonominë vazhdon të mbetet në nivele shumë të ulëta, ndërkohë që disa banka kanë ndaluar së dhëni hua për sektorin privat. Sfida kryesore në të ardhmen mbetet fuqizimi i konkurrencës së ekonomisë së Malit të Zi, duke përmirësuar produktivitetin dhe duke tërhequr IHD të tjera në më shumë sektorë sesa vetëm turizmi dhe pasuritë e patundshme.
  - Rritja e GDP-së së Shqipërisë është ngadalësuar nga një kulm i normës së rritjes prej 7.5% në vitin 2008, në një normë më të ulët të rritjes prej 1.6% në vitin 2012[47]. Sektori i shërbimeve është kontribuuesi kryesor në GDP, duke përbërë më shumë se gjysmën e GDP-së së vendit. Shqipëria cilësohet si një vend me të ardhura të ulëta deri në mesatare me një GDP për frymë, e cila në vitin 2012 qëndron në 3.415euro[48]. Shkalla e papunësisë me një mesatare prej 13% është ndër më të ulëtat në rajon. Borxhi publik i përgjithshëm i Shqipërisë ka arritur në 60.6% të GDP-së deri në fund të vitit 2012[49]. Ekonomia mbetet e brishtë për shkak të dobësive të brendshme strukturore dhe paqëndrueshmërisë ekonomike globale.

    Sfida kryesore në të ardhmen mbetet sigurimi i rritjes së qëndrueshme afatgjatë, duke ndjekur politika të matura fiskale dhe monetare dhe reformat strukturore. Shqipëria duhet të punojë për reduktimin e niveleve të larta të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Ajo duhet të përmirësojë parashikimin fiskal duke hequr dorë nga mbivlerësimi i të ardhurave dhe duke përmirësuar në mënyrë të

[45]MONSTAT, GDP-ja e Malit të Zi, Publikimi nr. 246, shtator 2013.
[46] MONSTAT, Sondazhi i Fuqisë Punëtore 2012.
[47] INSTAT, GDP-ja tremujore 2012.
[48] Banka Botërore, të dhënat e shtetit 2008–2012
[49] Ministria e Financave, 2012

konsiderueshme përputhjen e taksave. Përmirësimi i mëtejshëm i mjedisit të biznesit dhe investimeve është thelbësor për diversifikimin e ekonomisë dhe nxitjen e potencialit të saj të rritjes afatgjatë.




| Viti | PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI I ZI - SHQIPËRI | | | | | | | TOTALI( EURO) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2014/2020 |
| Operacionet BNK të gjitha prioritetet tematike | 1,190,000.00 | 1,700,000.00 | 1,700,000.00 | 1,190,000.00 | 1,700,000.00 | 1,700,000.00 | 1,530,000.00 | 10,710,000.00 |
| Asistenca Teknike | 51,000.00 | 0 | 0 | 510,000.00 | 0 | 0 | 170,000.00 | 1,190,000.00 |
| Totali ( EURO) | 1,700,000.00 | 1,700,000.00 | 1,700,000.00 | 1,700,000.00 | 1,700,000.00 | 1,700,000.00 | 1,700,000.00 | 11,900,000.00 |

Tabela 6. Alokimet indikative financiare në vit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014–2020

**Rekomandimet:**

Çdo shtet ka synime të mëdha për të ardhmen e rinisë dhe po ashtu edhe qytetarëve të sajë edhe në rastin tonë që kemi Malin e Zi dhe Shqipërinë, kemi shum rekomandime për zhvillimin e turizmit dhe bashkëpunimin më të madhë si në aspektin shtetëror ashtu edhe privatë.

I. Rekomandimi i pareështë se këto dy shtete do të duhet të punojnë më shumë në bashkëpunimin e tyre për të arritur sa ma shumënumrin e vizitoreve e po ashtu edhe vet nga qytetarët e tyre të kenë më shumë liri në lëvizjen e tyre e po ashtu edhe të jenë të rregulluara nga shteti që bizneset të kenë mundësi sa më të leta të bëritbiznes në mes tyre dhe po ashtu edhe lehtësime në doganë e në kufirin e tyre.

II. Rekomandimi i dytë është që të mundësohet vizitorëve nga shtetet tjera të kenë qasjen sa më të letë për vizitën e tyre dhe të bëjnë pushimet e tyre sa më të mira dhe sa më komodë. Vizitorët do të kërkonin kushte më të mira si në infrastrukturë e po ashtu edhe në vendet ku do të bëjnë pushimet e tyre këtu hynë si dhomat e hotelëve, ushqimi, mundësia e wifi-së më të mirë dhe pa pasur problem në qasjen e sajë, plazhet të jenë të pastërt dhe vendet ku do të pushojnë të jenë më standard Evropiane dhe më të mira. Ata do të kërkojnë që të kenë mundësin e sjelljëve të pijëve e po ashtu edhe pajisjeve përcjellëse në plazhë të bëhen sëpaku dy herë mbrenda kohës së pushimit pra ndrrimi i( peshqirëve, shamponëve, etj.), pijet të jenë të ftofta dhe të jenë me standarde dhe të kenë afatet e sajë të përdorimit.

III. Rekomandimi i tretë është se këto dy shtete do të duhen të bashkëpunojnë në menaxhimin e lehtësimit të kufirëve që qasja të jet sa më e letë dhe që në kufi të kuptojnë

se mundësit e tyre do të jen më të leta për vendin apo qytetin ku dëshrojnë të pushojnë duke i pajisur me broshura dhe informata sa më shumë rreth shtetit dhe cilët vende janë që ofrojnë kushte më të mira e gjithashtu edhe vendet që do të duhen të vizitohen për të kuptuar kulturën dhe traditat e shtetit, duke filluar nga muzet e ndryshme, pastaj kalat e ndryshme, pavendet që kanë historin e tyre shumë vjeqare dhe ku do të kenë një cicerone(person që udhëzon vizitorët) nga i njofton edhe vet ai për historin dhe ngjarjen e atj vendi. Nga këto shumë visitor e turistë do të ndahen të kënaqur dhe sëpaku duke njohur historinë dhe vendin se ku janë duke i kaluar pushimet e tyre.

IV. Rekomandimi i katërt është se shteti do të duhet të investoj edhe më shumë në infrastrukturën si në rrugë ashtu edhe në pjesen e parqëve dhe parkingjeve sa më shumë që të kemi mundësin më të let për shkuarjen në plazhë e po ashtu edhe në rast se do të kemi nevojë për furnizim me ushqim vet apo sëpaku për të bërë një takim me ndonjë biznesmen të huaj ku kemi planifikuar të bëjmë takimin. Qasja dhe arritja e kohës sa më e let për takime apo edhe për vet shkuarjen në plazhë na bën që të kemi sa ma shumë turistë dhe biznesmen të ndryshëm për të investuar në shtetin e Mali të Zi dhe Shqipërisë e po ashtu edhe sa më shumë joshjen dhe tërheqjen e biznesmenëve për të investuar në këto dy shtete. Gjithashtu edhe organizimet me mërgimtarët dhe konferencat e ndryshme për turizëm na bën që të kemi më shumë vizitorë dhe po ashtu edhe inkasime jo vetem në sezonin e verës por edhe në sezonat tjera të vitit, nga edhe do të kemi më shumë rini të punësuar, më shumë familje që do të qëndronin në vendlindjen e tyre, më shumë hapje të bizneseve të reja dhe vet shteti do të ket më shumë inkasime prej taksave, rritje të GDP, rritje të punësimit dhe zvoglim të papunësisë, rregullim më shumë në infrastrukturë, nëshëndetësi, parqe, plazha, hotele, resturante të ndryshme e ajo qka është më e rëndësishme është zhvillimi i shtetit dhe forcimi i popullatës dhe kushte më të mira për ta dhe për vet turistët dhe për vet shtetin.

**Literatura:**

Dwyer,L& Forsyth,P(2006). INTERNATIONAL HANDBOOK ON THE ECONOMICS OF TOURISM. Public sector investment in tourism infrastructure.

https://www.botasot.info/turizem-lajme/921170/turizmi-sektor-me-rritje-te-shpejte-ne-ekonomine-shqiptare/

https://natureforpeople.org/al/montenegro/

file:///C:/Users/Sektori-i-Turizmit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-dhe-pengesat-e-biznesit-p%C3%ABr-rritje.pdf

file:///C:/Users/Strategjia-e-Turizmit-18-22-draft-1.pdf

https://www.scribd.com/doc/210101033/Rendesia-e-zhvillimit-te-turizmit-ne-ekonomi-Importance-of-tourism-development-in-the-economy

# PAPUNËSIA DHE NDIKIMI I SAJ NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

**Ilire Dauti**[1]

Ilire Dauti -PhD Candidate-Ss.Cyril and Methodius University in Skopje-Fakulty of Economics, Bul. 'Goce Delcev' nr. 9B 1000 Skopje, R. of Macedonia

## Abstrakt

Papunësia si problem makroekonomik është rezultat i disbalancit që mbizotron në tregun e punës, dhe vjen në shprehje atëherë kur oferta për punë është më elartë se kerkesa. Si rezultat kemi papunësisinë qëështë karakteristikë për shumë vende, sidomos i atyre që nuk kan arritur të gjejnë ekuilibrin ekonomik. Si rezultat pjesë e kapitalit të tyre njerëzor mbetet e pashfrytëzuar me çka humbin shansin e gjenerimit të vlerës, për të qenë pjesë e trendeve progresive të cilat vetëm kapitali njerëzor në koordinim ma faktorët tjerë të prodhimit mund ta bëjnë të mundur.

Republika e Maqedonisësë Veriut disponon me fuqi pune që karakterizohet nga nivele të larta të shkollimit por, në të njëjtën kohë edhe me shkallë të lartë të papunësisë, poashtu edhe nga kjo kategori e kapitalit të saj njerëzor. Pikërisht shkalla e papunësisë, karakteristikat e saj si dhe ndikimi që ka në vlerën ekonomike të shtetit është objektiv i këtijpunimi.Këto karakteristika të fuqisë punëtore munden të na shërbejnë si mjet për kuptimin e kompleksitetit të njeriut si resurs për të cilin palët e interesuara mund të bien vendime të bazuara në informacione.Analiza rrjedh nga disa dilema të paraqitura ne formë të pyetjeve kerkimore të cilat detajisht janë hulumtuar.

Për shtjellimin e temës në fjalëështë përdorur literaturë nga autorë vendor dhe ndërkombëtar si dhe janë shfrytëzuar të dhënat nga qendrat prestigjoze siç janë: Banka Botërore, Fondi Ekomik Botëror dhe Enti Shtetërorpër Statistikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Fjalët kyçe: ***shkalla e papunësisë, zhvillim ekonomik, treg i punës, kapital njerëzor***

## 1. Hyrje

Shiquar historikisht kapitali njerëzor ka qenë gjithmonë promotori zhvillimit shoqëror dhe faktorë vendimtar në ekonominë globale, e cila është nën presionin e ndryshimeve të shpeshta dhe konkurencës së jashtëzakonëshme. Përgjigje ndaj rrethanave të tilla mund të jep kapitali njerëzor me talentin si faktorë kyç që sjell risi, është konkurues, qoftë shiquar si vlera individuale apo grupore tënjohurive, shkathtësive, ekspertizës, kreativitetit dhe inovacionit, kompetencave dhe aftësive, që shfrytëzimi nuk i harxhon ato, por përkundrazi sa vjen e shtohet vlera e tyre. Ky burim ka në vete një fuqi unike dhe tënatyrshme për të gjeneruar vlerë.

Të gjitha ato vende që në politikat e tyre zhvillimore trajtojnë me kujdes këtë burim si nga këndi i investimeve në to për përgaditjen profesionale të tyre poashtu edhe në shpërndarjen dhe shfrytëzimin adekuat, janë në avantazh kundrejtë shteteve të cilat vazhdojnëtë notojnë në pasiguri të mëdha dhe vështirësi ekonomike.

Shfrytëzimi ose jo i fuqisë punëtore në korniza të ekonimisë nacionale analizohet nëpërmjet shkallës së punësimit respektivisht papunësisë të cilat janëdrejtëpërdrejtë të lidhura me zhvillimin ekonomik. Prandaj në fokus të ketij punimi do të jenëshkalla e papunësisënë Republikën e Maqedonisë së Veriut, struktura e papunësisë për nga niveli i shkollimit dhe gjinia, karakteristikat e tregut të punës që duke ndjekur raportet në mes fuqisë aktive dhe pasive të

mundemi të vërtetojmë sa është reale rënia e shkallës së papunësisë dhe cili është impakti i saj në zhvillimin ekonomik të shtetit. Edhe pse ngrehen disa dilema krejt ato janë në shërbim të hipotezës kryesore:

H1: Shkalla e papunësisësë qytetarëve me nivele të ndryshme të shkollimit ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik të shtetit, për aq sa është lartësia e pjesëmarrjes së papunësisë së këtyre kategorive në papunësinë e përgjithshme.

Analiza do ishte më e kompletuar nëse analizohen edhe karakteristika tjera strukturore të tregut të punës siç janë: të punësuarit, struktura sipas moshës, gjendja martesore, shkalla e shkollimit e të gjitha kategorive që përbëjnë tregun e punës, si dhe karakteristika tjera që janë të lidhura me to. Për shkak se është e pamundur ti trajtojmë të gjitha këto kategori të fuqisë punëtore kësaj here theksin do ta vëmë mbi papunësinë si pjesë e popullsisësë përgjithshme aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut që kërkon zgjidhje institucionale dhe që përmasat e këtij problemi nuk janë vetëm ekonomike por edhe sociale dhe politik. Ajo parqet një nga shkaktarët bazë të varfërisë duke mos ju mundësuar sejcilit individ të jetonte nga puna dhe mundi i vet.

## 2. Literatura e konsultuar

Njeriun si qenie të vetëdijshme mjafton ta krahasojmë me çdo burim material, cilado qoft ajo: para dhe kredi, energji, makineri apo pajisje do të kuptojmë që vlera e secilës nga ato variabla do të del në pah vetëm atëherë kur një person e ve atë në funksion. Punën si faktorë prodhimi,duhet parë jo vetëm si sasi por edhe cilësinë e asaj sasie që disponon një shtet shiquar nga njohuritë, dhe shkathtësitë e mishëruara në individ që shfrytëzimi sa më i lartë i këtyre kapaciteteve do të ndikontë në krijimin e vlerës ekonomike.

Për papunësinë si fenomen socio-ekonomik kan shkruar shumë autorë, dhe për shkak të aktualietit që ka vazhdon të trajtohet edhe tani. Ajo që vlen të theksohet është që në periudha tëndryshme është trajtuar ndryshe. Kështu sipas modelit klasik ndërhyrja e shtetit në ekonomi nuk ëshë e nevojshme sepse tregu nëpërmjet mekanizmit të vetërregullimitpër kohë të shkurtër mund të kthehet në baraspeshë. Modeli klasik kundërshtohet fuqishëm nga Kejnsi sipas të cilit papunësia është problem kyç makroekonomik, prandaj është e nevojshme të detektohen determinantat që ai i quan variabla e që e kushtëzojnë papunësinë, dhe pastaj të kalohet në zgjedhjen e këtijë problemi (më gjërësisht nëTrpeski, 2011, fq.7,9). Që atëherë e në të gjitha periudhat më vonë si në neoliberalizëm, neokejnzianizëm apo edhe neokejnzianizmin e e ri nëpërmjet modele të ndryshme tentohet ti jepet përgjigje problemit kompleks të papunësisë.

Sipas Bankës Botërore (https://data.worldbank.org/indicator/SL.UEM.TOTL.ZS)papunësia i referohet pjesës së fuqisë punëtore që është pa punë, por që kërkon punë dhe është e gatshëme për të punuar. Përkufizimi standard i personave të papunë është ai qëindividë tëpa punë i llogarit gjithë ata që në një të kaluar të afërt kërkojnë punë dhe aktualisht janënë dispozicion për punë, duke përfshirë edhe ata që kanë humbur punën ose që kanë lënë vullnetarisht punën. Në çdo kohë disa punonjës janë përkohësisht të papunë, pasi punëdhënësit kërkojnë punëtorët e duhur dhe punëtorët kërkojnë punë më të mira. Të papunë llogariten forca e punës ose pjesa ekonomikisht aktive e popullsisë që shërben si bazë për këtë tregues, por jo edhe për popullatën e përgjithshme.

Sipas Eftimoskit (2009), koncepti i papunësisëështë i lidhur me konceptin e nevojave elememtare si një nga konceptet që e përshkruan varfërinë. Ky koncept kujdes të veçant i jep nevojës për punësim dhe participim të njerëzve në trendet shoqërore, që llogaritet një nga parakushtet kryesore për zvoglim të varfëris.

Sipas Uzunov,Georgiev dhe Nedanovski (2003, fq.137) funksioni bazëi tregut të organizuar të fuqisë punëtore është informimi në kohë për ofertën dhe kërkesën e fuqisë punëtore.

Edhe pse ky duhet të jetë funksioni bazë, duket që nuk funksionon ky mekanizëm përderisa Republika e Maqedonisë së Veriut vazhdon të mbetet një nga vendet me shkallë më lartë të papunësisë si në Evropë poashtu edhe në rang global.Edhe pse lakorja e papunësisë tregon rënie

përsëri ajo vazhdon të jetë në disekuilibër në mes ofertës dhe kërkesës të mallit specifik që ofrohet në këtë treg, siçështë puna.

## 3. Trendi i papunësisë nëRepublikën e Maqedonisë së Veriut dhe vendeve tjera të rajonit

Papunësia parqet çrregullim dhe pengesë për zhvillim ekonomik me të cilin qëndron në proporcion të zhdrejtë, ashtuqë sa më e lartë qëështë papunësia aq më i ulët është zhvillimi ekonomik dhe anasjelltas. Lartësia e saj përshkruan ekuilibrin ekonomik të tregut të punës dhe shfrytëzimin e kapacitetve njerëzore të një shteti, regjioni apo edhe më gjërë.

Për të pasur pasqyrim më të qartë mbi lëvizjen e papunësisë si fenomen sa social poashtu edhe ekonomik qëështë prezent diku më shumë e diku më pak, mvarësisht nga ajo se sa shteti përkatës ka gjetur ose jo baraspeshën në mes kapaciteteve njerëzore që disponon dhe shfrytëzimit të tyre, trendii papunësisëqëka në Republikën e Maqedonisë së Veriut sikurse edhe në shtete të ndryshme të rajonit, pasqyron realitetinjo vetëm mbi shkallën e shfrytëzimit të kapitalit njerëzor por dhe fuqinë ekonomikë të asaj popullsie që rrjedh nga lartësia e pagës që merr fuqia punëtore si shpërblim për punën e bërë.

*Grafikoni 1: Shkalla e papunësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe vendeve të Rajonit nga viti 1992-2018*




Burimi :www.worldbank.org.

Nga grafikoni më lartë lakorja që shpreh shkallëne papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut qëndron më lartë nga të gjitha vendet e rajonit.Ajo që bie në sy është se pas rritjes së shkallës së papunësisë të Greqisënga viti 2010,dhe rënies të lakores së Maqedonisë së Veriut, takohen në vitin 2016 për të vazhduar edhe më tej Maqedonia e Veriut të mbajë primatin për papunësi. E dyta për nga shkalla e papunësisëështë Mali i Zi, që vlen të theksohet periudha nga 2005 kur papunësia ishte 30,3% gjer në 2008 ka pësuar një rënie intenzive ashtuqë në2008 ka zbritur në 17,1%, ndërsa në 2018 shënon 16,2% dhe renditet e trete pasi Greqia ka shënuar rritje të shkallës së papunësisë. Shkallë më të ulët të papunësisë ka Sllovenia, që arritje më të mirë për papunësi ka shënuar në vitin 2008 me 4,4% papunësi dhe me më shumë papunësi në 2013 me 10,1%. Vlen të theksohet që Bullgaria ka arritur të zbret nën lakoren e Sllovenisë gjatë viteve 2017 dhe 2018 duke shënuar kështu papunësi më të ulët nga vendet e paraqitura në grafikon me vetëm 4,9% papunësi.

Shkallë më të lartë të papunësisëse RMV nga vendet e rajonit ka vetëm Republika e Kosovës qësipas Agjencisë së Statististikave të Kosovës 2018), shënon 26.5 % në tremujorin e parë të 2018 ndërsa ne tremujorin e tretë të 2018 ishte 30,7%.

## 4. Karakteristikat e tregut të punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut

E drejta për pune si një e drejtë natyrore në shumë shtete është prezente e sidomos më e theksuar është tek ata që jobaraspesha në mes ofertës dhe kerkesës në dobi të ofertës në tregun e punës është më i madh. Republika e Maqedonisë së Veriut është e shquar për disbalanc të tillë ku dominon oferta kundrejt kërkesës për këtë mall specifik siç është puna, duke vazhduar edhe sot e kësaj dite të jetë një nga shtetet me papunësi më të lartë në rajon.

*Grafikoni 2: Shkalla e papunësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuartale nga viti 1992-2018.*




Burimi: Raportet nga lëmia:Tregu i punës, (2009q1-2018q4), www.stat.gov.com

Nga grafikoni më lartë shihet që lakorja e shkallës se papunësisë nga kuartali i parë i vitit 2009 gjer në kuartalin e katër të 2018, parë në përgjithësi ka shënuar trend të rënies mirëpo në periudhë afatshkurtër ka shënuar edhe rritje. Gjatë gjithë periudhës që është marrë në shqyrtim kuartali i parë i vitit 2010 paraqet periudhën kur shkalla e papunësisë ka shënuar nivelin më të lartë 33,5% dhe shkallë më të ulët ka shënuar në kuartalin e katër të vitit 2018 kur shkalla e papunësisë ka aritur në 19,4%, kur edhe për herë të parë ka rënë nën 20%.

*Grafikoni 3. Popullsia aktive, joaktive dhe pjesëmarrja e popullsisë së papunësuar në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut*




Burimi: Raportet nga lëmia:Tregu i punës, (2009q1-2018q3), www.stat.gov.com

Një dukuri tjetër që vlen të përmendet qëështë paraqitur si fenomen shqetësues në tregun e punës të Republikës së Maqedonisë së Veriut është rënia e numrit të fuqisë aktive me ç'rast na bën të mendojmë që renia e papunësisë nuk parqet zvoglim real të papunësisë por është rezultat i zvoglimit të fuqisë aktive me ç'rast shteti po humb njërin nga kapitalet më të çmueshme që ka. Sipas Raportetve të tregut të punës të Entit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut kuartali i katër i vitit 2014 kur popullsia aktive shënonte 961416 persona, ndërsa kuartali i tretë i 2018 shënon 958770 persona.Duke ju referuar dy viteve më lartëështë rritur numri i popullsisë pasive nga714782 persona sa ishte në kuartalin e katër të 2014 në724127 në kuartalin e tretë të 2018, ndërsa në kuartalin e fundit të vitit 2018 është rritur në 725 539 persona joaktiv. Nëse ky trend i këtyre dy kategorive të popullsisë pra asaj aktive dhe pasive do vazhdojn me këtë tepmo ajo aktive me rënie ndërsa ajo pasive me rritje ekziston reziku që Republika e Maqedonisë së Veriut të bëhet vend i njerëzve pasiv.

*Tabela1: Lëvizjae numrit të popullsisë aktive dhe pasive në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

| | Popullsia e përgjithshme e aftë për punë -Total ëorking age populatio | Popullsia e përgjithshme joaktive -Inactive population (of total ëorking age population ) | Popullsia e përgjithshme aktive - Total labour force | Të papunësuar nga popullsia e përgjithshme aktive -Unemployed of total labour force |
|---|---|---|---|---|
| 2014/IV | 1676198 | 714782 | 961416 | 265370 |
| 2018/III | 1682897 | 724127 | 958770 | 199325 |
| 2018/IV | 1 683 148 | 725 539 | 957 609 | 185 803 |

Burimi: Shih grafikonin nr.2.

Nga tabela më lartë në tre kuartalet që janë marrë për krahasim shihet që popullsia totale e aftë për punë shënon rritje, mirëpo kjo rritje shkon në llogari të popullsisë joaktive, përderisa popullsia aktive ka shënuar rënie. Kjo si rezultat i paaftësis së shtetit për të menaxhuar me kapitalin e saj njerëzor që duke u ballafaquar në rend të parë me shkallë të lartë të papunësisë, mungesë të shërbimeve cilësore, nepotizëm të jashtëzakonshëm, shpërndarje joadekuate të BNJ me ç'rast është evidente mungesa e shërbimeve cilësore, ka detyruar sidomos atë pjesë të popullsisë që është me kualifikime dhe nivele të larta të shkollimit të mërr vendim për tu larguar drejt shteteve tjera.

## 5. Papunësia dhe karakteristikat e saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Njeriu,është resurs në të cilin patjetër duhet të investohet që më pas në mënyrë efikase të

shfrytëzohet, e gjithë kjo me qëllim që gjeneroj kthim – si për njerëzit e involvuar ashtu edhe për ekonominë si tërësi. Ky lloj kapitaliështëi një rëndësie të veçantë jo vetëm për produktivitetin e një ekonomie nacionale dhe shteti, por edhe për funksioniin e insitucioneve politike, sociale dhe shoqërore, ashtu edhe për ta kuptuar kapacitetin dhe gjendjen momentale.

Në fuqinë punëtore aktive me kualifikime të larta duhet parë si parakusht për produktivitet dhe zhvillim, shiquar si nga aspekti mikro ashtu edhe nga ai makro ekonomik. Për fat të keq disponimi i fuqisë punëtore me kualifikime të larta, pa mos qenë ata të mobilizuar ashtu siç ndodh realisht në shumë vende të botës (aty ku Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është përjashtim), jo vetëm që nuk iu jep mundësinë shteteve ta kthejnë investimin e bërë në këtë kapital, por jep mundësi për emigrimin e tyre drejt shtetve tjera, për shërbime dhe kushte më të mira për jetë. Nga ana tjetër shtetet që pranojnë fuqi të kualifikuar punëtore hapin perspektiva të reja bazuar në përvoja të ndryshme sidomos kur bëhetfjalë për njerëz me kualifikime të larta.

*Grafikoni 4: Të papunësuarit në bazë të niveleve të shkollimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në kuartale gjatë viteve 2009-2018*




Burimi: Raportet nga lëmia:Tregu i punës, (2009q1-2018q3), www.stat.gov.com

Nga grafikoni më lartë shihet që të papunësuarit në masë më të madhe janë nga kategoria, të papunësuar me 4 vite shkollim të mesëm nga popullsia e përgjithëshme aktive. Kategoria, të papunësuar me shkolim fillor është kategoria e dytë për nga pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të papunëve, lakorja e të cilës kategori shënon trend rënës më të theksuar duke u afruar me kategorinë, të papunësuar me shkollim universitar. Lakoret e këtyre dy kategorive presin njëra tjetrën në dy vitet e fundit ashtuqë në kuatalin e tretë të 2018 të papunësuarit me shkollim universitar janë në numër më të madh se ato me shkollim fillor. Numri i të papunësuarve me 3 vite shkollim të mesëm poashtu ka pësuar rënie. Nga të gjitha kategoritë e të papunësuarve në bazë të nivelit të shkollimit vëtëm të papunësuarit me shkollim universitar kanë shënuar rritje. Ndërsa tre kategoritë tjera,të papunësuarit me shkollim të lartë, me shkollimfillor të papërfunduar dhe të pashkolluar nuk kanë paraqitur as trend rritës as rënës por karakterizohen me një ecuri standarde për periudhën nga 2009-2018 qëështë marrë në analizë.

Për të parë strukturën e të papunësuarëve sipas gjinisë nga papunësia e përgjithshme në mënyrë grafike është paraqitur si më poshtë.

*Grafikoni 5: Struktura e të papunësuarëve sipas gjinisë dhe pjesëmarrja e tyre në popullsinë e përgjithshme aktive*




Burimi: Raportet nga lëmia:Tregu i punës, (2009q1-2018q3), www.stat.gov.com

Nga grafikoni më lartë mund të shihet që papunësia te meshkujt është më e theksuar pasi ato zënë vend me shkallë të papunësisë që sillet nga 57,7% në kuartalin e III/2013 dhe ka shënuar shkallë më të lartë në kuartalin e I/2016 me 66,3%, ndërsa e dhëna e fundit mbi shkallën e papunësisë e rregjistruar nëvend arrinë62,3%. Përderisa papunësia te femrat sillet nga 33,7% në I/2016 si përqindjë më e ulët, ajo më e larta është e shënuar në III/2013 me 42,3%. E dhena e fundit mbi papunësisnë e femrave në IV/2018 shënon shifrën 37,7 % femra të papuna.

Vlen të theksohet fakti që përqindja më e ulët e papunësisë te femrat është, jo si pasojë e punësimit më të madh të tyre sepse në kuartalin e fundit të 2018 punësimi i grave arrinë në 39,5% ndërsa e meshkujve 60,5%. Pjesëmrrja e ulët e femrave në popullsisë aktive i bën ato që të kenë shkallë më të ulët të papunësisë. Kështu në kuartalin e fundit të 2018 femrat zën 39,1% në popullsinë aktive ndërsa meshkujt 60,9. E kundërta ndodh me popullsinë pasive ku pjesëmarrja e femrave në këtë kategori është shume e lartë. Në kuartalin e fundit të 2018 pjesëmarrja arrinë në 64,2% për femra dhe 35,8% për meshkuj.

## 6. Rezultatet e hulumtimit të zbatuar

Në hulumtimet ekonomike shpesh praktikohet analiza e regresionit. Variabla qëështë objekt i parashikimit ka statusin e variablës së varur, ndërsa variablat që shfrytëzohen për parashikim thiren variabla te pavaruara.

Në modelin tonë ekonometrik si variabël e varuar është futur BPV, i cili në bazë të paragjykimit në momentin e dhënë “t” varet prej faktorëve siç janë: të papunësuarit me 4 vite shkollim të mesëm, të papunësuarit me shkollim universitar (nga popullsia e përgjitshme aktive).

Formula e analizës së regresionit e dhënë nëpërmjet funksionit matematikorëështë:

$$\boldsymbol{Y(GDP) = \beta_0 + \beta_1(X1) + \beta_2(X2) + U_t}$$

Sipas kësaj formule do ta analizojmë lidhjen në mes variablave të pavarura, $X_{1-2}$ të cilat në modelin tonë janë:të papunësuarit me 4 vite shkollim të mesëm, të papunësuarit me shkollim universitar (nga popullsia e përgjitshme aktive), dhe nga ana tjetër variablës së varur Y (Bruto produkti vendor-BPV). Në model është marrë, BPV-rë, sipas metodës së shpenzimeve me të cilin tregohet konsumi final d.m.th konsumi final i prodhimeve dhe shërbimeve, bruto-investimet dhe neto-eksportet e mallrave dhe shërbimeve.

***LOG_GDP***–Bruto-produkti vendor sipas metodës së shpenzimeve, çmimeve rrjedhëse.

**LOG_PAP_4V_SH**–Të papunësuarit me 4 vite shkollim të mesëm (prej popullsisë së përgjithshme aktive).

**LOG_PAP_SH_U**–Të papunësuar me shkollim të lartë dhe universitar (prej popullsisë së përgjithshme aktive).

$\boldsymbol{\beta_0}$ – constant.

Të dhënat e shfrytëzuara për llogaritje të regresionit janë nga raportet e kuartaleve për fuqinë e punës të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Enti Shtetëror për Statistika) gjatë

periudhës prej kuartalit të parë të 2009 gjer në kuartalin e tretë të vitit 2018. Pasi variablat e shfrytëzuara në model kishin trend, stacionimi i serive është siguruar me transformimin logaritmik (log).

*Tabela 2.Rezultatet e korelacionit të zbatuar në mes variablave të modelit*

| | LOG_DGDP | LOG_PAP_4V_SH | LOG_PAP_SH_U |
|---|---|---|---|
| LOG_DGDP | 1.000000 | -0.127680 | -0.019248 |
| LOG_PAP_4V_SH | -0.127680 | 1.000000 | -0.312719 |
| LOG_PAP_SH_U | -0.019248 | -0.312719 | 1.000000 |

Burimi: llogarite personaleduke shfrytëzuar paketën statistikore Ewius

Nga tabela 2, shihet se në mes variablave të pavaruara nuk ekziston multikolinaritet. Rezultatet e fituara nga analiza janë parqitur në tabelën në vazhdim.

*Tabela 3. Ndikimi i shkallës së papunësisë të të papunësuarve me 4 vite shkollim tëmesëm dhe të papunësuarit me shkollim universitar në shkallën e BPV të RMV.*

Dependent Variable: LOG_GDP1
Method: Least Squares
Date: 03/20/19 Time: 09:37
Sample: 2009Q1 2018Q3
Included observations: 39

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| C | 7.068137 | 1.217169 | 5.807028 | 0.0000 |
| LOG_PAP_4V_SH | -0.413604 | 0.078320 | -5.280911 | 0.0000 |
| LOG_PAP_SH_U | 0.270347 | 0.053392 | 5.063449 | 0.0000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.686273 | Mean dependent var | 5.105728 |
| Adjusted R-squared | 0.668844 | S.D. dependent var | 0.071116 |
| S.E. of regression | 0.040925 | Akaike info criterion | -3.480359 |
| Sum squared resid | 0.060294 | Schëarz criterion | -3.352393 |
| Log likelihood | 70.86700 | Hannan-Quinn criter. | -3.434446 |
| F-statistic | 39.37479 | Durbin-Ëatson stat | 1.412521 |
| Prob(F-statistic) | 0.000000 | | |

Burimi: Hulumtim vetanak sipas të dhënave nga Enti Shtetërorpër Statistika i Republikës së Maqedonisë së Veriut duke shfrytëzuar paketën statistikore Ewius.

Prej tabelës ku është treguar rezultati iregresionit mund të vërejmë qëmodeli ekonometrik multifaktorial linear e fiton këtë formë:

$$\left(\boldsymbol{log}\widehat{(\boldsymbol{GDP})}\right) = 7.068137 - 0.413604\boldsymbol{log}(\mathbf{LOG_PAP_4V_SH}) + 0.270347\boldsymbol{log}(\mathbf{LOG_PAP_SH_U})$$

Të gjitha variablat statistikisht janë të rrëndësishme në nivel prej 5% α vlerë. Prej modelit mund të përfundojmë që shkalla e rritjes së BPV është pozitivisht e lidhur me shkallën e papunësisëme shkollim universitar ndersa negativisht e lidhur me shkallën e papunësisë me 4 vite shkollim të mesëm.Për 1% rritje të shkallës së rritjes sëLOG_PAP_4V_SH,shkalla e BPV do të zvoglohet për0.41% ceteris paribus. Për 1% rritje të shkallës së rritjes sëLOG_PAP_SH_U, shkalla e BPV do të rritet për0.27% ceteris paribus. Statistika e Durbin–Watson-ittregon indikacion për autokorelacion pozitiv të regresionit, pasi është më e vogël se 2, Koeficienti i determinantës na tregon se 68% të variabilitetit të shallës së rritjes së BPV sqarohet me variabat e pavarura të përfshira në model.

Për prezencën e heteroskedasticitetit në këtë regresion kemi përdorur testine White-it.

*Tabela 4. Testimi i heteroskedasticitetit të variablave të shfrytëzuara në model*

Heteroskedasticity Test: White

| | | | |
|---|---|---|---|
| F-statistic | 0.487763 | Prob. F(4,34) | 0.7446 |
| Obs*R-squared | 2.116518 | Prob. Chi-Square(4) | 0.7143 |
| Scaled explained SS | 1.054784 | Prob. Chi-Square(4) | 0.9014 |

Burimi: shih tabelën nr.2

Siaps testit të White-it, F-statistika është 0,48 ndërsa propabiliteti i F-statistikës është 0,74 me ç'rast pranohet hipoteza 0 e cila thot që variancat janë homoskedastike perkundër hipotezës që thot se variancat janë heteroskedastike atëherë kur gabimet nuk kanë variancë konstante. Pra regresioni në fjalë nuk vuan nga heteroskedasticiteti.

## 7. Përfundime dhe rekomandime

Kapitalit njerëzor i duhet menaxhim i kujdesëshëm për shkak të kompleksitetit që ka. Ky kujdes njëherë duhet shprehur gjatë fazës së profesionalizmit të tijë ashtu që të jetë sa më i gatshëm për tregun e punës, dhe më pas duhet dhënë mundësia që nëpërmjet vendit të punës të vë në zbatim njohuritë e fituara duke bërë në këtë mënyrë kthimin e investimit në të. Shfrytëzimi adekuat i kapitalit njerëzor si në aspektin mikro poashtu edhe makro ekonomike duhet parë dhe trajtuar me kujdesë edhe nga aspekti i kombinimit të tij me faktorët e tjerë të prodhimit.

Përfundimet e nxjera në këtë punim mund të përshkruhen në mënyrë të*përmbledhur si vijon:*

- Papunësia si formë drastike e pabarazisë sociale çon kah tensionet sociale, që së bashku me inflacionin, bilancin e pagesave dhe rritjen e prodhimit janë arsye dhe indikatorë për mostabilitet makroekonomik.
- Republika e Maqedonisë së Veriut nga pavarësia e vitit 1992 e gjer në ditët e sotme është e shquar për mos baraspeshë nëmes ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, ku dominon oferta kundrejt kërkesës për këtë mall specifik siç është puna. Ky trend ka vazhduar gjer në ditët e sotme duke bërë që të jetë një nga shtetet me papunësi më të lartë në rajon dhe më gjërë. Nga vendet e rajonit prapa vetes ka vetëm Republikën e Kosovës që poashtu ka normë të lartë të papunësisë.
- Rënia e shkallës së papunësisë që paraqitet vitetve të fundit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është duke u shoqëruar me rritje të popullsisë totale të aftë për punë, mirëpo kjo rritje shkon në llogari të popullsisë joaktive, përderisa popullsia aktive ka shënuar rënie. Nëse ky trend i këtyre proporcioneve në mes popullsisë aktive dhe pasive do vazhdoje me të njëjtën tempo, Republika e Maqedonisë së Veriut rezikon të bëhet vend ku do të dominoj popullsia pasive. Kjo si rezultat i paaftësisë së shtetit për të menaxhuar me kapitalin e saj njerëzor që duke u ballafaquar në rend të parë me shkallë të lartë të papunësisë, mungesë të shërbimeve cilësore, nepotizëm të jashtëzakonshëm, shpërndarje joadekuate të BNJ me ç'rast është evidente mungesa e shërbimeve cilësore, ka detyruar sidomos atë pjesë të popullsisë që është me kualifikime dhe nivele të larta të shkollimit të merr vendim për tu larguar drejt shteteve tjera.
- Në Republikën e Maqedonisë së Veriut numri më i madh i të papunësuarëve janë nga kategoria, të papunësuar me 4 vite shkollim të mesëm nga popullsia e përgjithshme aktive. Kategoria, të papunësuar me shkolim fillor është kategoria e dytë për nga pjesëmarrja në numrin e përgjithëshëm të papunëve, lakorja e të cilës kategori shënon trend rënës më të theksuar duke u afruar me kategorinë, të papunësuar me shkollim univerzitar.Jo ekulibri ekonomik në mes ofertë dhe kërkesës në tregun e punë në favor të ofertës ka bërë që numër i konsiderueshëm i të papunësuarve me shkollim universitar të jenë të papunësuar.Kjo kategori qytetarësh në vend që t'u jepet mundësia të venë në përdorim kapacitete e tyre ata janë të papunë.
- Për strukturën e papunsisë sipas gjinisë vlen të theksohet fakti që përqindja më e ulët

e papunësisë te femrat është, jo si pasojë e punësimit më të madh të tyre, por si rezultat i pjesëmarrjes më të ulët të tyre në popullsinë aktive kurse kanë pjesëmarrje të lartë në popullsisë pasive.

- Rezultatet nga analiza e regresionit tregojnë që variabla y, në rastin tonë BPV me njërën variabël të pavarur $X_i$është e lidhur pozitivisht ndërsa me tjetrën negativisht. Nga modeli mund të përfundojmë që shkalla e rritjes së BPV është pozitivisht e lidhur me shkallën e papunësisë me shkollim universitar ndersa negativisht e lidhur me shkallën e papunësisë me 4 vite shkollim të mesëm.Ndikimi negativ i shkallës së të papunëve me shkollim të mesëm është më evident në Republikën e Maqedonisë së Veriut sepse numri i të papunësuarëve me 4 vite shkollim të mesëm është rreth 3 herë më i madh nga të papunësuarit me shkollim universitar e cila kategori viteve të fundit ka shënuar rritje të të papunëve nga kjo kategori. Prandaj sa më i madh qëështë mos shfrytëzimi i kapitalit njerëzoraq më e madhe do jetë lidhja negative mes tyre dhe BPV të shtetit.
- Hapja e vendeve të reja të punës nëpërmjet rritjes së investimeve të huaja ashtu siç pritet të ndodh pas integrimit të Maqedonisë së Veriut në Nato, mund të jetë shans për rritje ekonomike, sigurisht nëse gjer sa të binden investitorët e huaj për të sjellë kapitalin e tyre, vendi nuk zbrazet edhe më shumë nga punëtorët e aftë për punë. Sigurisht në këtë situatë kanë mbetur dy zgjidhje, ose nëpërmjet investimeve të huaja të hapen vende të reja të punës duke shfrytëzuar at kapital njerëzor që i ka mbet në dispozicion, ose të shkoj fuqia e aftë punëtore të investimet ashtu siç edhe është duke ndodhur realisht.

## Literatura e shfrytëzuar


1. Gareth R. Jones, George M. Jennnifer (2008)*Sovremen menaxhment,*(përkthim), Shkup.
2. http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=32&rbr=2442, http://www.stat.gov.mk/Publikacii/RegioniteVoRM2015.pdf
3. Матис, Р. Џексон, Џ. (2010). Upravuvanje so çoveçki resursi, (perkthim), Shkup.
4. Patrick J. Kiger (2006), "*Research Back Up HR's Impact on Value*", *Workforce Management*, June 26.
5. Robbins, S., DeCenzo, D. (2012). *Bazat e menaxhimit - koncepte dhe aplikime themelore*, (përkthim në shqip),Tiranë.
6. World Economic Forum (2017), The Global Human Capital Report 2017, Comity to improving the state of the ëorld, Geneva.http://reports.weforum.org/human-capital-report-2016.
7. Bollander, Xh.,Snell, C. (2011),*Upravuvanje so çoveçki resursi* (përkthim në maqedonisht), Koçan.
8. Bucevska, V. (2016), Ekonometrija so promena na Ewieus, Ekonomski fakultet, Shkup.
9. Enti Shtetëror për Statistika (2018) Raportet nga lëmia *: Bruto-produkti vendorë-Bruti produkti vendorë në Republikn e Maqedonisë së Veriut gjatë viteve2009-2018* – të dhënat paraprake.
10. Enti Shtetëror për Statistika (2018) Raportet nga lëmia : *Tregu i punës (2009-2018) Popullsia aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, prej Anketës për fuqi punëtore prej kuartalit të parë gjer në kuartalin e III, të 2018- të dhënat paraprake, http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=98&rbr=2824
11. Enti Shtetëror për Statistikai Republikës së Maqedonisë së Veriut, Raport vjetorë rajonal, *Rajonet në Republikën e Maqedonisë së Veriut*(2014-2017),
12. Eftimovski D. (2009), *Ekonomski rast, osnovni Ekonomski koncepti i metodi*, Sv.Kliment Ohridski, Manastir.
13. Petreski, G. (2002), *Ekonomski rast i razvoj, teori, metodi i megjunarodni iskustv*a, Fakulteti ekonomik, Shkup.
14. Risteski, S. Nestorovska, M. (2014), *Demografija-metodi i analizi*, Fakulteti ekonomik, Shkup.
15. Trpeski, P. (2011), Pazar na trud vo Republika Makedonija, Makedonsko nauçno drushtvo, Shkup.
16. Uzunov, N., Georgiev, A.,Nedanovski, P. (2003), *Primeneta ekonomija*, Fakulteti ekonomik, Shkup.

Burimet elektronike


17. https://data.worldbank.org/indicator/SL.TLF.ADVN.ZS?locations=MK, konsultuar më: 17.01.2019
18. https://data.worldbank.org/indicator/SL.TLF.INTM.ZS?locations=MK, konsultuar më: 17.01.2019
19. https://data.worldbank.org/indicator/SL.TLF.TOTL.IN?locations=MK, konsultuar më: 21.09.2018
20. https://data.worldbank.org/indicator/NV.AGR.TOTL.ZS?locations=MK,konsultuar më: 13.01.2018
21. https://data.worldbank.org/indicator/SL.AGR.EMPL.ZS?locations=MK,konsultuar më: 27.09.2018
22. https://data.worldbank.org/indicator/SL.TLF.CACT.ZS,konsultuar më: 10.07.2019.
23. https://data.worldbank.org/indicator/SL.TLF.BASC.ZS?locations=MK,konsultuar më: 13.01.2019.

# ASPEKTI SOCIAL I ORGANIZIMIT TË NDËRMARRJEVE – KULTURA ORGANIZATIVE

**Arlind Vokshi**

University "Haxhi Zeka", Peja, Kosovo

**Abstrakti**

Hulumtimimundohet të zbulojmë marrëdhënien mes përkushtimit organizativ dhe kushteve në mjedisin e punës, i trajtuar në dimensionin e vazhdueshëm, emocional dhe normativ, ashtu dhe në dimensionin fizik, social dhe psikologjik. Respekti dhe paanësia, dialogu i hapur, fuqizimi, dhe njohja e arritjeve, kujdesi dhe poashtu edhe ofrim i ambientit të sigurt dhe të shëndoshë janë fundamentale për ndërtimin e përkushtimeve dhe pjesëmarrjen e njerëzve në rrugëtimin organizativ të përsosmërisë.Hulumtimi synon të prezantojë rëndësinë që ka angazhimi i punonjësve në produktivitetin dhe kontributin për suksesin e organizatës. Punonjësit e angazhuar e shprehin tërësisht vetveten fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht gjatë kryerjes së roleve që kanë në organizatë. Ka patur një përhapje dhe përkrahje të gjerë të literaturës për rezultate që mbështesin fuqishëm idenë se punonjësit e angazhuar kanë ndikim pozitiv në performancën dhe qëndrueshmërinë e organizatës. Qëllimi i këtij hulumtimi është ndërlidhja dhe kombinimi i njohurive tona dhe njohja konceptit të kulturës së organizatës dhe nevojave të diagnostifikimit përmes matjes së tij rezulton se studiuesit e kësaj fushe bien dakort se Kultura ka natyrë komplekse dhe shfaqet e shtresëzuar në atë që do të quhet shtresa "e dukshme" dhe ajo "e padukshme". Duke u nisur nga vështirësia për t‟a vrojtuar dhe matur kulturën e organizatën punimi i adresohet pjesës së "dukshme", e cila lidhet drejpërdrejtë me cilësinë dhe pjesës së "padukshme", e cila në vetvete është edhe shtresa më e vështirë për t‟u matur dhe analizuar nga pikëpamja sasiore pasi vlerësimet në këtë shtresë janë të natyrës psikometrike.

***Fjalët çelës*** : *organizatë, motivim, kompetenc, performancë*

## 1. Hyrje

Është e vështirë të japësh një përkufizim të plotë dhe shterues mbi aspketin social në punë. Menaxhimi i organizatës dhe menaxhimi i njerëzve është shumë i rëndësishëm në kohëra të ndryshimeve. Përmirësimi i zhvillimit të lidershipit, menaxhimi i talentit dhe fuqia strategjike e punës janë kritike pasiqë njerëzit janë shpesh investimi më i madh organizativ. Menaxhimi efektiv i resurseve njerëzore lejojnë organizatën të arrijë objektivat e saja strategjike dhe të përfitojë nga fuqitë e njerëzve dhe aftësive të tyre për të kontribuar në arritjen e objektivave strategjike. Menaxhimi i suksesshëm i resurseve njerëzore dhe i lidershipit promovojnë angazhimin e njerëzve, motivimin, zhvillimin dhe përqendrimin. Në kontekst të menaxhimit të përgjithshëm të cilësisë është me rëndësi të kuptohet se vetëm njerëzit e kënaqur mund të sjellin organizatën drejtë klientit të kënaqur. Të jesh një menaxher i mirë, do të thotë të kesh shumë cilësi të cilat të ndihmojnë në këtë profesion duke filluar nga komunikimi I mirëfillt me punëtorët,e deri tek arritja e rezultateve që secili udhëheqës i'a parashtron vetes menjëherë pas pranimit të punës së re. Ashtu siç të gjithë njerëzit gabojnë, edhe drejtuesit ndonjëherë nuk janë të kujdesshëm në gjërat bazë që duhet t'i kenë parasyshë për të pasur suksese dhe rezultate më të mira në punën që bëjnë.Aftësite komunikuese janë disa nga aftesite me të rëndësishme të menaxhmentit. Se sa jemi të komunikueshem me te tjeret tregon sa e suksesshme do të jete

karriera jone. Për te arritur këtë duhet të njihemi me koceptin e sjelljes organizative ,të dijme si te mbledhim fuqi, të nderlidhemi në politike dhe te menaxhojme konfliktet e stresin. A keni menduar ndonjehere pse njerezit sillen në menyre te caktuar ne vendin ku ata punojne?Pse disa njerez janë me të shoqerueshem e disa me te turpshem, disa me temperamente e disa me te qete, disa me agresive te tjeret me pasive? Të gjitha këto jane karakteristika të personalitetit. Personaliteti është kombinim I karakteristikave që e identifikojne një individ siç jane: sjellja, sistemi mental, dhe karakteristikat emocionale.Rrjeti është proces I zhvillimit të mardhënieve me qëllim të socializimit dhe berjes se politikave. Reciprociteti perfshin krijimin e obligimeve dhe zhvillimin e aleancave/unioneve te cilat sherbejne per te arrtitur qellimet e caktuara. Qëndrime e menaxheret luajne nje rol te rendesishem ne performanca. Qendrimet ndikojne gjithashtu ne knaqesine ndaj punes.Njerezit me karakteristika optimiste te personalitetit dhe me vetebesim shfaqin knaqesi me te madhe ndaj punes.Motivimi paraqet gatishmerin e individit qe te perpiqet per arritjen e objektivave te organizates duke vene ne perdorim nje sasi energjish dhe perpjekjesh, me kusht qe keto perpjekje te sjellin plotesimin e qellimeve individuale.

## 2. Rishikimi i literatures

Në përgjithësi, përkushtimi i vazhdueshëm është përcaktuar si vullnet për të qëndruar në organizatë dhe është shkaku kryesor i investimit personal për punën në atë organizatë, pasi ka të bëjnë më shumë me investimin për karrierë, përfshirjen në komunitet me aftësitë e fituara dhe përfitimet e tjera. Të gjitha këto e rrisin seriozisht koston e të vepruarit ndryshe, duke e lënë punën (Abdul M. M., 2011)Sipas kësaj teorie, (Galotti, 2006) thotë që lidhja që krijohet mes punonjësit dhe organizatës bazohet kryesisht në këta elementë të rëndësishme, të cilët mbajnë fuqishëm këtë relacion mes tyre. Të gjithë këta faktorë reflektojnë indirekt përkushtimin e vazhdueshëm të punonjësit, si tendencë për të vijuar në të njejtën punë. (Greenberg, 1987) e ka definuar dëshiren e palëkundur të punëtorit për të punuar në organizatë si rezultat i identifikimit të tij me llojin e punës që kryen, ka të bëjë me përkushtimin emocional. Përkushtimi emocional është përcaktuar si shtojcë emocionale, identifikim, përfshirje, që një punëtor e ka me organizatën e tij në realizimin e qëllimeve të saj (Figen, 2011)

Lidhur me përkushtimin organizativ, Morrou ka theksuar se një individ mund të jetë i përkushtuar ndaj pikave kyçe të punës së tij, organizatës dhe profesionit që ka. Një profesion përfaqëson aftësitë e nevojshme, njohuritë dhe detyrat, që janë të ndryshme nga profesionet e tjera të transferueshme nëpër organizata të tjera brenda të njëjtit profesion. Sipas tij, lidhja emocionale, që një person e ndjen ndaj profesionit të vet, është zotim profesional. Po kështu, nga autorë të tjerë, përkushtimi cilësohet si gatishmëria e aktorëve socialë për të dhënë energji dhe besnikëri ndaj organizatës (Ornstein, 1989), ndërsa sipas (Maureen, 2010)përkushtimi organizativ tregon veprimet e punonjësve në kohë dhe funksionin e sjelljeve të tyre të përshtatshme për organizatën. Lidhur me sjelljen, e cila rezulton nga përkushtimi i vazhdueshëm,(Masih, 1990) i paraqesin karakteristikat e modelit të kësaj sjellje si pjesë e përkushtimit organizativ dhe, në këtë rast: 1. Punëtori duhet të pasqyrojë sakrifica personale që bëhen për hir të organizatës. 2. Sjellja e punëtorit duhet të tregojë qëndrueshmëri, nuk duhet të varet nga kontrollet mjedisore (përforcime apo ndëshkime). 3. Punëtori duhet të tregojë një preokupim personal ndaj organizatës, duke kushtuar një pjesë të madhe të kohës personale për veprimtari të organizatës lidhur me punën.

**Teoria e D.McGregorit** është teori e kundërt ndaj qëndrimit për njeriun si punëtorë. McGregor ka konstatuar se menaxherët, zakonisht duke u përpjekur që t'i motivojnë punëtorët, shërbehen me metoda të ndryshme. Ai është i thirrur në teorinë X dhe teorinë Y.

Teoria X paraqet mënyren tradicionale të menaxhmentit sipas së cilës menaxherët, duke u përpjekur që t'i motivojnë punëtorët, shërbehen me detyrim kontroll, kërcënim.

Teoria e Z e McGregorit është teori e cila ka besim në të punësuarit, se janë të pjekur, të aftë për ti kryer detyrat. Prandaj, këta njerëz nuk kanë nevojë për kërcenim, detyrim dhe kontroll në punën e tyre.

Kultura organizative përbën thelbin, që mban të bashkuar organizatën dhe nxit punonjësit që të përkushtohen dhe të rrisin performancën. Kultura në një organizatë përfaqësohet nga mënyrat e veçanta, që përdor organizata gjatë ecurisë së saj normale, në realizimin e funksioneve kryesore, mënyra të cilat ndryshojnë dhe zhvillohen me kohën. Këto metoda të realizimit të funksioneve reflektojnë njohuritë e përbashkëta dhe kompetencat e një organizate(Wilderom, 1999) Më së shumti individët anëtarë të organizatës, perceptojnë si më përfaqësuese të kulturës atë çka theksohet dhe promovohet më tepër në organizatë(Macey W. H., 2009). Vlerat dhe besimet janë dy elemetet kyçe të cilat përbëjnë thelbin e kulturës në një grup(Drucker, 1995). Për të shprehur lidhjen që mund të ekzistojë mes performancës, punonjësve dhe kulturës, nga studiues të ndryshëm është marrë në konsideratë studimi i kulturës në disa dimensione pjesë të "strukturës" së saj. Këto dimensione (Wilderom, 1999) mund të jenë: toleranca ndaj ndryshimit; toleranca ndaj riskut, prirja për risi, fryma e bashkëpunimit; puna në grup mes departamenteve, theksimi i detyrimeve, shkalla e formalitetit, theksimi i strukturës dhe lloji i saj, rëndësia e kontrollit, theksi tek konsumatori, mjedisi i jashtëm, komunikimi, motivimi, dhe transparenca në organizatë etj.

## 3. Pesha e problemit për audiencë

Kjo temë është mjaft dobiprurese së pari për organizaten ku kam zhviluar hulumtimin, por edhe për organizata të tjera, sepse ky hulumtim është shembull në ndërtimin e politikave që përdor një organizatë. Përmes rezultateve të arritura mund t'I jepim një pasqyre të cultures organizative se ku duhet të ketë permiresime. Vendi I dyte ku do të kishte vlere ky hulumtim janë edhe organizatat jo qeveritare, sepse ne mesin e gjetjeve të tyre nder tjera do të ju duhet edhe ky, pasi qe ata jane matesit e shume sferave nder to edhe pikave të ekonomise e me këtë projekt do t'I nxjerrnin disa rezultate per shembull si të rinjet e sapo diplomuar kan filluar të vleresohen mjaft shume nga organizatat private sepse perspektiven ndërmarrjet private po e shohin nga kapacitetet e të rinjeve, njëherit me nuk është në trend vetëm pervoja dhe mosha për një vend të mire pune.

### 3.1. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Për realizimin e projektit janë shtruar këto pyetje kërkimore, ku pjesa më e rëndësishme e studimit është kryesisht shtjellim sa me detaj i temës qendore.Ky punim do t'i japë përgjigje pyetjes kërkimore:
**A ka ndikim kultura organizative dhe komunikimi në angazhimin e punonjësve?**

**$H1^0$: Kultura organizative nuk ka ndikim në angazhimin e punonjësve**

**$H1^1$: Kultura organizative ka ndikim në angazhimin e punonjësve**

**$H2^0$ : Komunikimi nuk ka ndikim në angazhimin e punonjësve**

**$H2^1$ : Komunikimi ka ndikim në angazhimin e punonjësve**

Të lidhesh teorinë dhe praktiken jo çdo herë është e lehtë, atë qe e thotë teoria jo doemos e zbaton realiteti , i njejti ligj vlen edhe te bizneset posaqërisht tek aspekti social i organizimit dhe motivimit.

Kjo pjesë jo vetëm paraqet morinë e autorëve që kanë përkrahur dhe analizuar teorinë / pikëpamjen e bazuar në burime empirikisht por gjithashtu fokusohet edhe në faktin se kjo teori shërben si bazë për këtë studim .

## 4. Socializmi dhe rëndesia e socializmit në organizatë

Ne nuk mund të theksojmë sa duhet rëndësinë e komunikimit në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Komunikimi i duhur bën dallimin në mes të punëtorit të suksesshëm dhe atij jo të suksesshëm, në mes të raporteve të mira sociale dhe raporteve të mjerueshme, si dhe ndonjëherë në mes të jetës dhe vdekjes. Komunikimi i mirë nuk ka të bëjë vetëm me fjalët apo me gramatikën që përdoren për të komunikuar. Komunikimi i mirë është rezultat i vetëbesimit, respektit për të tjerët dhe njohjes së kufijve personale. Komunikimi kualitativ i personit me këto karakteristika është spontan dhe automatik. Ju mund të gjeni informata dhe këshilla të shumta për atë se çfarë është komunikimi i mirë dhe si bëhet, por ju nuk do të mund të praktikoni atë pa pasur vetëbesim, respekt për palën tjetër, si dhe njohje të territoreve personale. Komunikimi i mirë dhe parakushtet e tij lidhen direkt me socializimin. Për t'u shoqëruar me dikë, juve ju nevojitet që së pari të respektoni personin me të cilin dëshironi të shoqëroheni. Por shoqërimi me atë person nuk ka të bëjë vetëm me të, por edhe me ju, prandaj ju duhet të respektoni edhe veten. Kur ju arrini të respektoni të tjerët dhe veten në mënyrë të barabartë, atëherë ju keni balancën e duhur, e cila ju nevojitet për t'u shoqëruar në mënyrë të shëndoshë me të tjerët. Njohja e kufijve personale është jashtëzakonisht i rëndësishëm gjatë socializimit. Në çdo situatë sociale ekzistojnë 3 territore: territori juaj personal, territori i përbashkët (neutral), si dhe territori personal i të tjerëve. Në punë, të gjithë punëtorët gjenden në një mjedis të përbashkët. Ne mund të argumentojmë se tavolina juaj e punës ka natyrë më personale për ju dhe ai është territori gjysmë-personal i juaji. Ju keni të drejtë të rregulloni dollapët e tavolinës sipas dëshirës suaj, por ju nuk keni të drejtë ta bëni atë në tavolinat e të tjerëve. Menaxherët janë të autorizuar të përkujdesen për hapësirën e përbashkët, prandaj ata kanë të drejta shtesë për menaxhimin e kësaj hapësire. Nëse ju i njihni mirë këta kufij, ju do të keni shumë pak probleme sociale në punën tuaj. Shumica e konflikteve sociale burojnë nga njohja e dobët e kufijve personale. Më herët ne kemi përmendur se çdo grup social ka kodet e veta të sjelljes, veshjes dhe komunikimit. Kur ju punësoheni në një punë të re, ju do të ballafaqoheni me grupe të ndryshme sociale brenda kompanisë në të cilën punoni. Për shumë njerëz shoqërimi është proces spontan, por për shumë të tjerë shoqërimi nuk është proces i tillë. Sidoqoftë, shoqërimi mund të bëhet i lehtë nëse ju njihni kodet e grupeve me të cilat dëshironi të shoqëroheni. Përpos kësaj, njohja e kufijve personale do t'ju ndihmojë të mbani balancën sociale në mes vetes dhe të tjerëve në atë grup.Jo të gjithë njerëzit kanë nevojat e njëjta për socializim. Mirëpo studimet tregojnë se raportet shoqërore kualitative me njerëzit e tjerë, përmirësojnë mirëqenien tuaj. Prandaj ne ju rekomandojmë që ju të krijoni raporte miqësore dhe me respekt reciprok me kolegët në punën tuaj.(Ilozor, 2000)

### 4.1. Kushtet në mjedisin e punës

Në këtë pjesë do të paraqiten faktorët kryesorë, të cilët u referohen kushteve në mjedisin e punës. Kushtet, në vetvete, mund të jenë të natyrës së kushteve fizike në punë, klimës sociale dhe psikologjike. Kushtet normale në punë rezultojnë në një mjedis lehtësues dhe të sigurt, të cilat i tërheqin punonjësit për të kënaqur nevojat e tyre, pasi vetëm një mjedis lehtësues dhe i përshtatshëm në punë rrit nivelin e përkushtimit dhe produktivitetin e punonjësve. (Joanna, 2010) Njëherësh, këta studiues kanë arritur në përfundim se mjedisi lehtësues i punës ndihmon në vetë-monitorimin, i cili është pjesë e rëndësishme e personalitetit në ndërmjetësimin mes mjedisit të punës dhe përkushtimit organizativ, pasi një mjedis i tillë mundëson ndjenjë të rehatshme dhe tërheqëse, siguri dhe mjedis të shëndetshëm pune.Ka shumë përkufizime mbi

kënaqësinë në punë nga shumë autorë. Kënaqësia në punë është një reagim emocional ose afektiv ndaj një sërë aspektesh të situatës së punës të një punonjësi dhe është përshkruar si një reagim emocional pozitiv që rezulton nga vlerësimi i punës së një punonjësi. (Judy, 2004)Kënaqësia në punë përfshin një sërë aspektesh të ndryshme të punës dhe është shuma totale e përbërësve të ndryshëm. Kënaqësia në punë përfshin përgjigje shumëdimensionale psikologjike ndaj punës së një individi dhe këto përmbajnë komponentë të njohjes, emocionalë dhe sjelljes. Një person mund të kënaqet në mënyrë të arsyeshme me një pjesë të punës së tij por mund të jetë i pakënaqur me një pjesë tjetër. Një punonjës mund ta pëlqejë pagën e vet dhe të kolegëve të tij por në të njëjtën kohë ai mund të mërzitet nga mbikqyrësi i tij i drejtpërdrejtë etj. Një individ, i cili nuk është i kënaqur me situatën aktuale të punës së tij, ka mendime negative rreth punës, ndërsa një individ që është i kënaqur me situatën e tij aktuale në punë ka mendime pozitive për të. Pra, si përfundim, nëse aspektet negative të punës së dikujt janë më shumë se ato pozitive, rrjedhoja logjike është që punonjësi do të kërkojë një punë më të mirë. Praktikisht kënaqësia në punë është ndryshimi midis asaj çfarë ka punonjesi aktualisht dhe çfarë pret të ketë. Një punonjës do të jetë i kënaqur kur realiteti barazohet me pritshmëritë. (Khawaja, 2013)

4.2. Kushtet e natyrës sociale në punë

I referohen aspketit social në mjedisin e punës, duke inkuadruar disa faktorë, të cilët janë në lidhje me interaksionin e punonjësve, punës dhe organizatës së tyre. Bazuar në studime të ndryshme, që kanë trajtuar faktorët social të mjedisit të punës, në këtë studim janë përfshir këta faktorë:

- Cilësia e komunikimi mes kolegëve
- Sinqeriteti në komunikim
- Komunikimi i vazhdueshëm kolegial
- Informimi i qartë
- Informimi në kohë për ndryshimet
- Sjellja e mbikëqyrësve
- Raportet e ndërsjellta mes kolegëve
- Sjellja korrekte ndaj kolegëve
- Diskriminimi gjinor ndaj moshës.

## 5. Metodologjia

Secili punim ka metodologjinë e tij, me anë të së cilës është hartuar punimi dhe është ardhur deri te nxjerrja e qëndrimeve apo përgjigjeve të pyetjeve të punimit. Në këtë pjesë shkruhet qartë cila është metodologjia e përdorur cilat ishin teknikat dhe argumentet , popullacioni. Cilat ishin hipotezat dhe arsyetimet dhe pse është vepruar në këtë metodologji. Qëllimi ynë primar ka qënë që nga intervista të marrim informata sa më të sakta për hulumtimin, kjo tezë analizon se deri në cfarë mase punonjësi është i angazhuar me organizatën dhe më tej ekzaminon rolin influencues që ka kultura organizative dhe praktikat e komunikimit në angazhimin e punonjësve. Konkurrentët sot mund të maten me performancën e shërbimit të ofruar, por ata nuk mund të përsëritin në mënyrë perfekte energjinë, përkushtimin dhe përthithjen, absorbimin e punonjësve të tyre në vendin e punës.

Për të siguruar të dhënat primare janë hartuar pyetësorë, të cilët janë plotësuar nga të gjithë të intervistuarit. Si metodologji ne kemi shkuar në atë menyrë që të jemi sa më të thjeshtë dhe më të qartë përmes pyetësorit duke parashtruar pyetje dhe, në bazë të përgjigjeve që janë dhënë ndonjëherë duke parashtruar edhe nënpyetje për të marrë sa më shumë informacione për t'a indentifikuar rolin e kulturës në angazhimin e punonjësve. Për këtë janë hartuar pyetesorë të

plotësuar në mënyrë te planifikuar nga 50 respondent të moshave, gjinisë dhe përvojes së ndryshme që punojnë në ndërmarrje publike dhe private. Teknika e përdorur është me intervistë të drejtëpëdrejtë, ku pyetësorët janë plotësuar bazuar në deklarimet individuale të mënaxherëve.

## 6. Analiza e gjetjeve




***Diagrami 1.*** *Paraqitja grafike për informacionet e bizneseve të anketuara*

Organizatat e biznesit të marra në studim paraqesin karakteristika të ndryshme për sa i përket llojit të aktivitetit që ata ushtrojnë, numrit të punonjësve dhe viteve të operimit në treg. Kështu, nga 50 kompanitë e marra në studim, 37 prej tyre merren me aktivitete tregtare, 8 me aktivitet shërbyese, 5 me aktivitete prodhuese.




***Diagrami 2.*** *Paraqitja grafike për numrin e puntorëve në bizneset e anketuara*

Ngatë dhënat e mësipërme shohim shpërndarjën e bizneseve sipas numrit të punonjësve ku (20) firma kanë më pak se 10 punonjës ,10- 49 punonjës (27). Ndërkaq 50-250 janë (3) dhe mbi 250 punonjës nuk kishte ndonjë nga firmat e intervistuara.




***Diagrami 3.*** *Paraqitja grafike për komunat e bizneseve te anketuara*

Sa i përkëtë komunave për shkak të lehtësirave kemi intervistuar firma në tri komuna. Duhet cekur se kemi hasur në mirkuptimin e secilës firmë, na kanë mirëpritur si dhe nuk kemi hasur në vështirësi sa përkëtë transparencës së tyre gjatë plotësimit të pyetësorëve.




***Diagrami 4.*** *Paraqitja grafike e nivelit te kualifikimit te respodenteve te anketuara*

Për sa i përkëtë nivelit arsimor apo kualifikimit të menaxhërëve të intervistuar: Bachelor ishin 30 prej tyre, më nivel kualifikimi master ishin 15 prej tyre, kurse më nivel shkollime tjera kishte 5 respondent.




***Diagrami 5.*** *Paraqitja grafike e pozicionit te respodenteve te anketuara*

Roli dhe ndikimi i menaxherit ne zhvillimin e veprimtarisë së ndërmarrjes varet shumë edhe nga pozicioni i tij në nivelin e strukturës organizative përkatësishtë detyrat dhe përgjegjësitë e tij varen nga niveli funksional sa i përkëtë pozicionit të respondentëve në kompanitë e intervistuara menaxher financiar ishin 5, menaxher prodhimi ishin 5, kurse menaxher marketingu ishin 5 respondent dhe punonjes ishin 35.

## 6.1. **Analiza e korrelacionit**

Korrelacioni është një matje e ndërlidhshmërisë ndërmjet dy variablave. Koeficienti i korrelacionit na jep një vlerë matematikore për të matur fuqinë e ndërlidhjes lineare ndërmjet dy variablave. Ne punim është shqyrtuar korrelacioni (ndërlidhja ) ndërmjet disa variablave të cilat ne kemi menduar se kanë më tepër lidhje njëra më tjetrën. Nga rezultati shohim se koeficienti i korrelacionit ndërmjet energjisë në punë dhe lirisë se punonjësve të veprojnë jashtë rregullave është 0,707 dhe vlera-p (p-value) për testin two-tailed të signifikancës është më e vogël se 0.05 (0.000). Nga këto shifra ne mund të konkludojmë se ka një korrelacion pozitiv ndërmje energjisë në punë dhe lirisë se punonjësve për të vepruar jashtë rregullave dhe ky korrelacion është signifikant të niveli i signifikancës 0.05 (0.000). Pra, kjo nënkupton nese punonjesit kanë liri të veprojnë jashtë rregullave të punës ata do të ndihen të tejmbushur me energji. Tani të shohim një korrelacion tjetër i cili ka rezultuar poashtu pozitiv është *ndërmjet energjisë në punë si dhe informacioneve të punonjësve për punën qe e kryejn.* Vlera e korrelacionit Pearson është 0.844 ndërsa vlera e signifikancës së dyanshme është 0.000, pra një vlerë më e vogel se niveli standard i konfidencës (0.05). Kjo nënkupton se nëse punonjesit kanë informacion mbi punën qe e kryejn do të jenë me energjik në punë.

**Correlations**

| | | Ne.punen.time.ndihem.i.tejmbushur.me.energji | Ka.liri.per.punonjesit.te.veprojne.edhe.jashte.rregullave | Punonjesit.kane.info.e.duhur.per.punen.qe.kane.per.ta.kryer |
|---|---|---|---|---|
| Ne.punen.time.ndihem.i.tejmbushur.me.energji | Pearson Correlation | 1 | .707** | .844** |
| | Sig. (2-tailed) | | .000 | .000 |
| | N | 50 | 50 | 50 |
| Ka.liri.per.punonjesit.te.veprojne.edhe.jashte.rregullave | Pearson Correlation | .707** | 1 | .709** |
| | Sig. (2-tailed) | .000 | | .000 |
| | N | 50 | 50 | 50 |
| Punonjesit.kane.info.e.duhur.per.punen.qe.kane.per.ta.kryer | Pearson Correlation | .844** | .709** | 1 |
| | Sig. (2-tailed) | .000 | .000 | |
| | N | 50 | 50 | 50 |

**Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

** Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

***Tabela 1.*** *Tabela e koeficienteve të korrelacionit për variablat kontrulluese të pytjeve kërkimore.*

## 6.2. Testimi i hipotezave dhe interpretimi i pyetjeve kërkimore

**ANOVA**[a]

| Model | | Sum of Squares | df | Mean Square | F | Sig. |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Regression | 20.961 | 3 | 6.987 | 48.269 | .000[b] |
| | Residual | 6.659 | 46 | .145 | | |
| | Total | 27.620 | 49 | | | |

a. Dependent Variable: Ne.punen.time.ndihem.i.tejmbushur.me.energji

b. Predictors: (Constant), U.kushtohet.vemendje.identifikimit.te.nevojave.te.klienteve, Punonjesit.kane.liri.te.planifikojne.personalisht.punen.e.tyre, Ka.liri.per.punonjesit.te.veprojne.edhe.jashte.rregullave

Duke iu referuar tabeles **Anova**, shohim se në bazë të signifikances e cila ka dalur 0.000, hipoteza bazë refuzohet, ndërsa hipoteza alternative pranohet, kjo d.m.th se **Kultura organizative** ka ndikim në**Angazhimin e punonjësve**.

**ANOVA**[a]

| Model | | Sum of Squares | df | Mean Square | F | Sig. |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Regression | 23.062 | 6 | 3.844 | 36.257 | .000[b] |
| | Residual | 4.558 | 43 | .106 | | |
| | Total | 27.620 | 49 | | | |

a. Dependent Variable: Ne.punen.time.ndihem.i.tejmbushur.me.energji

b. Predictors: (Constant), Konfliketet.zgjidhen.permes.kanaleve.te.duhura, Marr.info.se.si.vleresohem.nga.te.tjeret, Info.rreth.politik.qellim.dep.ndahet.me.mua, Grupi.ku.une.punoj.eshte.kompakt, Supervizioni.ofron.mbesht.udhezon.per.zgjidhjen.prob, Une.gjithmone.kam.info.per.progresin.e.punes

Duke iu referuar tabeles **Anova**, shohim se në bazë të signifikances e cila ka dalur 0.000, hipoteza bazë refuzohet, ndërsa hipoteza alternative pranohet, kjo d.m.th se **Komunikimi organizativ** ka ndikim në **Angazhimin e punonjësve**.

## 7. Konkluzione dhe rekomandime

Si konkluzion cekim se konceptet e lirisë për të vepruar jashtë rregullave të organizatës, liritë për të planifikuar vet punën, liritë për marrjen e vendimeve, janë dimensione që ndikojnë në formëzimin e niveleve organizative. Komunikimi mund të mendohet si një proces ose rrjedhë. Problemet e komunikimit ndodhin kur devijimet ose bllokimet e ndërpresin rrjedhen. Suksesi total i komunikimit të dikujt përfshinë të folurit, të lexuarit, të degjuarit dhe gjithashtu aftësitë e të arsyetuarit.

- Kompanitë të cilat nuk ishin pjesë të paktikës se tyre, matjen e angazhimit të punonjësve, duhet të futin në praktikat e tyre. Identifikimi i secilit dimension të angazhimit është i rëndësishëm. Konkluzionet e studimit forcojnë këtë rekomandim.
- Kultura organizative e duhur e kompanisë dhe komunikimi i shëndetshëm ndikojnë në rritjen e angazhimit të punojësve, prandaj nëse dëshirojmë të rrisim angazhimin e tyre në punë duhet të përqëndrohemi të kultura dhe komunikimi organizativ.
- Komunikimi organizativ ka një ndikim shumë të fuqishëm të angazhimi i puonjësve, ku rolin kryesor dhe impaktin më të madh e ka komunikimi i supervizorëve. Roli i supervizorëve duhet rishikuar dhe orientuar më fokus rritjen e angazhimit të punonjësve.

## Bibliografia


Abdul M. M., A. S. (2011). *Work-Family Psychological Contract as a Mediator in the Relationships between WorkFamily Factors and Organizational Commitment*, 228-235.

Aiyegbusi, J. T. (2000). *Communication of effective classroom instruction*, 31-35.

Benard, C. I. (1938). *"Functions of the Executive".* Cambridge: Harvard University Press.

Davis, M. (1994). *"Managing corporate culture".* Cambridge Ma: fq. 12-25.

Deel, & Kenny. (1982). *"Corporate Cultures".* Usa Mass: Addison-Wesleu.

Drucker. (1995). *"Managing in a time of great change,".* Dutton: Tureman Talley Books

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

# BRENDET BOTËRORE QË PRODHOHEN NË SERBI DHE EFEKTI I TAKSËS 100% PËR IMPORTET E TYRE NË KOSOVË
# WORLDWIDE GOODS PRODUCED IN SERBIA AND THE 100% TAX EFFECT ON THEIR IMPORTS TO KOSOVO

**Dr. Sc. Refik Havolli**

**Bastrie Uka Havolli ecc.dip**

**Abstract:** The imposition of a 10% defensive measure by the Kosovo Government, pursuant to Decision No. 01/74 dated 06.11.2018, for product imported from Serbia and Bosnia Herzegovina, had a big impact on the brands trademarks of Serbia and Bosnia and Herzegovina.

On 21.12.2018, the Government of Kosovo raised the tax rate from 10% to 100% as well as for the international brands it produces in these countries. Only a few of these international brands had been deployed.

On December 28, 2019, the Kosovo Government also took the decision to ban all non-produced trademarks produced in Serbia and Bosnia and Herzegovina, which entered into force on 01.01.2019. So to supplement and amend the decision No. 01/76 dated 21.11.2018 was passed, from which paragraph 2 of the basic decision was removed.

The reason why the government of Kosovo took the decision for 100% tax was the wartime campaign for denying the state and the fights against Kosovo for the membership in Interpol.
This tax was decided without any analysis, benefiting only the intersects of different groups. Where is the lack of coordination between MTI-Customs, Finance Ministry, Government of Kosovo (Prime Minister).

There were statements against this matter for the imposition of this tax. Making this decision had positive effects on politics, but had far greater impact on the economy.

The pressure to remove the tax from the international community fell when the government decision banned the import of international trademark

The reasons why international brands were deployed in Serbia, and none of them in Kosovo was because there was much greater institutional support, while in Kosovo there was a deficiency in the privatization process

**Key words**: Tax, Government, Trademark

## Hyrje

Kosova, edhe pse ishte anëtare në CEFTA, këto dy shtete nuk e kishin respektuar atë duke vendosur pengesa të natyrave të ndryshme për të penguar lëvizjen e lirë të mallrave. Një nga pengesat ishin transporti, analizat e produkteve etj. Qeveria e Kosovës tha se kjo taksë u vendos për të mbrojtur interesat ekonomike dhe politike të Republikës së Kosovës.
Taksa pati një përkrahje të madhe nga shumica e partive politike, medieve, shoqëria civile dhe kjo ndikoj edhe në përkrahjen e popullit. Edhe pjesa që u atakua më së shumti nga taksa, shtresa e varfër, nuk e kundërshtoi vendimin. Vendimi u kundërshtua nga komuniteti serb që jeton në veri të Kosovës me protesta në rrugë, por pas disa javësh u qetësuan, ata vazhduan furnizimet përmes kanaleve ilegale. Kryetarët e katër komunave në veri të Kosovës dhanë dorëheqje dhe shkëputen çdo lloj komunikimi me pushtetin qendror e me këtë kontrolli i veriut është jo i plotë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka takuar ambasadorin e Kinës dhe atë Rusisë, si dhe ambasadorët e vendeve të "Quint"-it në Beograd, pas vendimit për rritjen e taksave nga ana e Qeverisë së Kosovës ndaj produkteve serbe, nga 10 në 100%.[50]

[50] https://www.youtube.com/watch?v=tp3oTTNxfYs

Serbia, duke u ankuar më tepër sesa është efekti real i taksës, luan rolin e viktimës dhe gjoja të palës konstruktive, duke kushtëzuar vazhdimin e bisedimeve me heqjen e taksës.Sipas Serbisë, vendosja e Taksës është kundër rregullave të CEFT-as.

Edhe përfaqësuesja e Bashkimit Evropian, Federica Mogerini, i kërkoi Qeverisë së Kosovës të tërheqë vendimin për rritjen e taksës. Këtë vendim ajo e konsideroj si shkelje të marrëveshjes për tregti të lirë CEFTA.

Presioni për heqjen e taksës 100% dita ditës u shtua nga përfaqësues të BE-së, SHBA-ve dhe shteteve të tjera në mënyrë individuale.

Qeveria e Kosovës dhe analistë të ndryshëm politikë, e komentojnë në mënyra të ndryshme vendosjen e taksës dhe shumica i përmendin efektet pozitive, që në fakt edhe i ka arritur, por harrojnë të japin sqarime ***përse bashkësia ndërkombëtare po bën presion në largimin e taksës***.

Vendosja e taksës 100% ndaj produkteve që importohen nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina më tepër është pengesë që të hyjnë në tregun e Kosovës markat ndërkombëtare, të cilat prodhohen në Serbi, por që pronarë të tyre janë kompanitë ndërkombëtare. Produktet apo markatserbe pothuajse nuk janë ndaluar e ato janë, kryesisht, gruri, mielli, materiali ndërtimor,të cilat ripaketohen në Maqedoni, Mal të Zi dhe përsëri futen në Kosovë me një çmim më të lartë për shkak të paketimit dhe transportit. Këto mallra shumë lehtë barten nga prodhuesit deri në veri të Kosovës edhe me ambalazhin ekzistues. Markatndërkombëtare eksportet i bëjnë në formë legale dhe kjo ndikon që ata të mos kenë mundësi të tjera, prandaj ata të ankohen në shtetet prej nga vijnë.

**Arsyet që shtyn Qeverinë e Republikës së Kosovës për vendosjen e taksës 100%**

Fushata agresive e Serbisë, lufta diplomatike për heqjen e njohjeve nga shtetet që e kanë njohur më herët Kosovën dhe fushata kundër anëtarësimin e Kosovësnë Interpol,e cila dhe pati sukses, ishin ndër arsyet që e shtyn Qeverinë e Kosovës të vendoste taksën ndaj produkteve serbe dhe boshnjake.

**Vlera e Importeve dhe Eksporteve në Kosovë për vitet 2016, 2017, 2018**

Vlera e Importeve dhe Eksporteve sipas Entit të Statistikave të Kosovës është si në tabelë:

| Viti | 2016: | | 2017: | | 2018: | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| PartnerC \ Flow | 1:Import | 2:Export | 1:Import | 2:Export | 1:Import | 2:Export |
| **99: BOTË** | 2,789,491,159 | 309,627,125 | 3,047,017,521 | 378,010,429 | 3,339,263,621 | 367,254,898 |
| **BA:Bosnja dhe Hercegovina** | 79,112,106 | 8,405,262 | 81,673,648 | 8,793,057 | 69,054,171 | 8,448,749 |
| **XS:Serbia 06/2005** | **387,646,998** | **41,330,530** | **449,918,383** | **48,245,970** | **388,114,996** | **33,532,221** |




Importit e mallrave nga Serbia, kryesisht ishin mallra të industrisë ushqimore dhe të materialit ndërtimor.

Pas Serbisë, për import, prijnë Gjermania me rreth 300 milionë euro, Turqia me 251 milionë, Kina në vlerë prej 233 milionë, Italia me 162 milionë, Shqipëria me 152 milionë, Maqedonia me 129 dhe Greqia me 88 milionë.

**Taksa u vendos pa një analizë dhe parapërgatitje ose u bë me nguti për përfitime të një grupi të interesit**

Taksa, megjithë efektet pozitiv, pati edhe dobësitë e saj. Taksa u vendos për një periudhë shumë të shkurtër kohore dhe nuk ishte bërë një analizë e mirëfilltë për mënyrën e e zbatimit. Në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, në departamentin ku regjistrohen markat tregtare, mungonte një bazë e mirëfilltë e të dhënave për markat ndërkombëtare. Shënimet ishin gjysmake dhe linte shumë për të dëshiruar. Nuk ishin vendosur kriteret se çfarë nënkuptonte marka ndërkombëtare.

Në fillim vendosja e taksës ishte e vogël, 10%, dhe nuk i atakonte markat ndërkombëtare. Efekti ishte i papërfillshëm dhe kjo u bë në 100 % për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Pika 2 e vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.01/76 të datës 21.11.2018 ka këtë përmbajtje:

2. Pavarësisht origjinës së mallit të paraparë në paragrafin 1 të këtij vendimi, masa prej 100 % nuk aplikohet për markat e njohura tregtare të vendeve të tjera të cilat prodhohen në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë, të cilat janë pjesë e aneksit të bashkangjitur me këtë vendim.

Në këtë regjistër ishin futur vetëm 8 biznese që lënëpër të dyshuar se: ose ishte bërë në marrëveshje nga zyrtarët qeveritarë ose ishe padituri e tyre. Hipoteza e dytë u argumentua më vonë se nuk ishte shkaktari i seleksionimit diskriminimi i bizneseve, pasi në bazën e të dhënave ishin të regjistruar edhe shumë e shumë marka tregtare ndërkombëtare, të mbrojtura, por nuk ishin lejuar të importonin.

Qeveria nuk e respektoj vendimin që e kishte marrë vetë dhe bëri shkelje,sepse pas datës 21.11.2018, me vendimin nr.01/76 kishte futur në aneks vetëm 8 biznese me të drejtë importi, nëntë marka tregtare ndërkombëtare që lejoheshin të importonin.

Disa biznese kishin në depot e tyre doganore sasi të mëdha të mallit që pastaj me një vendim tjetër u lejuan ta zhdoganonin ato mallra pa taksën 100% në muajin shkurt 2019.

Qeveria nuk ka pasur një plan që t'i informonte importuesit në Kosovë për të gjetur tregje alternative për furnizimet e tyre.

**Mungesë koordinimi MTI-Dogana, Ministria e Financave, Qeveria e Kosovës (kryeministria)**

Në një aneks të vendimit të Qeverisë u vendosen 8 biznese që merren me importimin e markave ndërkombëtare, kurse ishin lënë jashtë kësaj me dhjetëra e dhjetëra biznese që importonin markat ndërkombëtare deri në marrjen e vendimit.

Mbetet e paqartë përse kjo listë ka vetëm 9 marka, që mund të tregtojnë me Serbinë pa taksa shtesë. As Qeveria as instititucionet e tjera përkatëse nuk kanë dhënë ndonjë sqarim në lidhje me këtë, as neve as Odës Ekonomike të Kosovës. Berat Rukiqi e ka të paqartë përse lista e markave është e pakompletuar. [51]

Ky veprim nga disa u kuptua si favorizim i disa bizneseve të cilat patën mundësi të bënin importimin e sasive të mëdha të mallrave dhe me këtë mënyrë të rritnin fitimet e tyre.

Dogana fillon aplikimin e vendimit të Qeverisë për taksën ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës sipas aneks vendimit.

Shumë biznese të tjera dërguan dëshmitë se markat që importonin ishin ndërkombëtare, disa nga këto marka ishin të regjistruara edhe në bazën e të dhënave të MTI-së, por nuk lejoheshin të hynin pa paguar taksën 100%. Zyrtari përgjegjës nga Agjensia e Pronësisë Industriale, pjesë e MTI-së, përgjegjës për regjistrimin e Markës Tregtare, në regjistrin e Markave Tregtare, tregonte se ka njoftuar doganën për kriteret dhe si të vendoste dhe se si të cilësohej një produkt i importuar markë ndërkombëtare. Dëshmi ishte edhe e-maili zyrtar drejtuar personave përgjegjës në Doganë. Dogana bënte përgjegjëse MTI-në, Ministrinë e Financave dhe Qeverinë dhe ishin të traumatizuar nga kërcënimi që kishin marrë nga Qeveria nëse lejoheshin të hynin mallra jashtë listës që ata kishin lëshuar me aneksvendim.

**Deklarimet për dhe kundër taksës dhe si ndikoj ajo**

Shumica e partive politike dhe e qytetarëve ishin pro vendosjes së taksës 100% për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, pasi vendimi 1/76 të datës 21.11.2018, lironte markat e vendeve të tjera që prodhohen në këto dy vende nga kjo taksë.

Shumica e prodhuesve vendorë e pritën me entuziazëm vendosjen e taksës 100% ndaj markave serbe dhe boshnjake. Taksa bëri të mundur të rriten e sasitë e prodhimit, të rritet konsumi i prodhimeve vendore.

Taksa e arriti efektin politik dhe e bëri që Serbia të ndëshkohej për të bëmat e saj.

Disa nga prodhuesit të cilët lëndën e parë e importonin nga këto dy vende u prekën nga vendimi sepse i gjeti të papërgatitur.

Taksa ndikoj sidomos në rritjen e çmimeve të disa produkteve, si miellit dhe produkteve të tij.Vendosja e taksës ndikoj në rritjen e theksuar të kontrabandës, sidomos në komunat ku jetojnë komuniteti serb.

Disa analistë ekonomie, pasi kritikuan mënyrën e vendosjes së taksës, u etiketuan dhe u fyen në rrjetet sociale dhe kështu ata u tërhoqën nga vlerësimet e tyre.

Berim Ramosaj, profesor në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, e ka quajtur fëmijëror, të pamenduar mirë dhe të ngutur vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e taksës për importimin e mallrave serbe në vlerë prej 100 për qind.[52]

Pas këshillave të shteteve mike që taksa të pezullohet për një afat të caktuar dhe t'i jepet mundësi dialogut, shumica e opinionit publik pajtohet me këto këshilla, por ka edhe një pakicë e cila mendon se, pavarësisht këshillave të shteteve mike dhe presioneve, të mos suspendohet taksa derisa Serbia të bëjë njohjen e Kosovës.

---

[51] https://www.dw.com/sq/taksa-100-e-kosov%C3%ABs-a-preken-markat-e-njohura/a-46524167

[52]https://www.koha.net/arberi/130180/ramosaj-e-quaj-femijeror-vendimin-e-qeverise-per-taksen-ndaj-serbise/

## Presioni për heqjen e taksës nga bashkësia ndërkombëtare

Vendosja e këtaj takse ka nxitur reagimin e Bashkimit Evropian, vërtet të përfaqësueses së lartë, Federica Mogherini, e cila ka kërkuar nga Kosova të shfuqizojë menjëherë këtë vendim.[53]

Zyrtarët ndërkombëtarë që kërkuan heqjen e taksës ishin të shumtë dhe e cilësuan si shkelje në Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA). Disa nga zyrtarët më me ndikim ishin Sekretari i Shtetit i SHBA-ve, Mike Pompeo, nënsekretari amerikan për Çështje Politike David Hale, Qeveria Gjermane dhe shefja e diplomacisë evropiane, Frederica Mogherini.

Arsyeja kryesore përse bashkësia ndërkombëtare filloi të bënte presion për heqjen apo pezullimin e përkohshëm të taksës është sepse shumë prodhues-marka ndërkombëtare prodhohen në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë. Me ndryshimin e vendimit 01/76 të datës 28.11.2018 ishe bërë një kufizim me aneksin e këtij vendimi, i cili jepte dykuptimësi vendimit. Paragrafi dy lejonte të gjitha markat ndërkombëtare të importoheshin pa iu nënshtruar pagesës së taksës 100 %, kurse aneksi i vendimit i lejonte vetëm disa nga markat ndërkombëtare të prodhuara në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë dhe vendim u plotësua me vendimin e datës 28.12.2018,i cili ndalonte pa përjashtim të gjitha markat tregtare serbe dhe ndërkombëtare që prodhohen në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë. Kjo bëri që presioni ndërkombëtar të fillojë e pastaj edhe të rritej që taksa të hiqej apo të pezullohej përkohësisht.

## Arsyet perse markat ndërkombëtare u vendosen në Serbi e asnjëra në Kosovë

Përderisa Kosova, procesin e privatizimit e bëri në mënyrën më të keqe të mundshme, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina vepruan logjikshëm, duke ftuar prodhuesit e markave ndërkombëtare të investonin në vendet e tyre.

Shumë investitorë të huaj u larguan nga investimet e tyre në Kosovë, sepse zyrtarë të lartë të pushtetit u kërkonin favore dhe haraç në mënyrë që ata të ishin fitues në procesin e privatizimit.

Korupsioni në Kosovë është endemik dhe pengesë për investime të huaja dhe zhvillim ekonomik.

Gati të gjitha ndërmarrjeve që u privatizuan në Kosovë iu ndërrua destinimi, punëtorët u dëbuan nga puna. Në Serbi investitorët e huaj u favorizuan me qëllimin që këto favorizime të sillnin përftime të mëdha ekonomike më vonë. Numri i të punësuarve në këto kompani ndërkombëtare është shumë i lartë, ndërkaq tatimet dhe taksat e tjera që vjel shteti janë shumë të dobishme për rritjen e buxhetit.

## Disa nga markat ndërkombëtare që prodhohen në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë

| Prodhuesi | Vendi i origjinës | Disa nga markat | Disa komente |
|---|---|---|---|
| Coca-Cola HBC Hellenic Bottling Company) | | Coca-Cola, Sprite, Schweppes, Fanta, Ultra Energy, Monster Energy, next, Rosa | https://rs.coca-colahellenic.com/en/about-us/coca-cola-hbc-serbia-and-montenegro-at-a-glance/ *Importues për Kosovë Coca Cola HBC* |
| PEPSICO | |  | https://www.pepsico.com/brands/product-information |
| | |  | Dr August Oetker (6 janar 1862 - 10 janar 1918) ishte një shpikës gjerman, shkencëtar i ushqimit dhe biznesmen, ai krijoi pluhurin e pjekjes si një produkt i gatshëm |

[53] https://www.evropaelire.org/a/rritet-taksa-per-produktet-serbe-/29613129.html

<table>
<tr><td>Dr.Oetker</td><td></td><td>

Rum, Cimet sheqer, Dekor, Vanil sheqer, Ciobar, Krem puding, Risturante Pizza...</td><td>për të përdorur dhe themeloi kompaninë Dr Oetker.[54]

*Importues dhe distributor për Kosovë Passable sh.p.k.*</td></tr>
<tr><td>Nestle</td><td></td><td>NESCAFE, NESCAFEDolce Gusto, Nesquik, MAGGI, ThOMY, Nestle ushqim për fëmijë, PURNA ushqim për qen, Nestle Profesional</td><td>https://www.nestle.rs/<br>Historija e Nestle fillon më 1866 me themelimin e kompanisë anglo-zvicrane per prodhimin e qumështit të konservuar. Hendi Nestle filloj prodhimin.</td></tr>
<tr><td>PHILIP MORRIS</td><td></td><td>
</td><td>Investim mbi 800 milionë euro në fabrikën në Nish.<br>*Importues dhe distributor për Kosovë Buçaj sh.p.k.*</td></tr>
<tr><td>FIAT</td><td></td><td>
</td><td>https://www.fiatsrbija.rs/<br>Fiat u themelua në vitin 1899 në Torino të Italisë.</td></tr>
<tr><td>RAUCH SEIT 1919.</td><td></td><td>Bravo, Hapy Day, My Tea, Juce Bar, Yipi, Cafe mio

</td><td>https://www.rauch.cc/sr/<br>*Importues dhe distributor për Kosovë Meridian Corporation*</td></tr>
<tr><td>nectar GROUP</td><td></td><td>FRUCTAL, Nectar, Heba<br>1945 FRUCTAL in cooperation with nature</td><td>https://www.nectar.rs/en/about-us/<br>*Importues dhe distributor për Kosovë Albi Commerce*</td></tr>
<tr><td>Henkel</td><td></td><td>Ceresit, Bref, Persil, Perwol,Fa
</td><td>*Importues dhe distributor për Kosovë Elkos Group-Prishtinë*</td></tr>
<tr><td>Hemofarm STADA GROUP</td><td></td><td></td><td>http://www.hemofarm.com/eng/proizvodi<br>Lider në industrin farmaceutike në Serbi. Mbi 79.1% të prodhimit e eksporton dhe ka 57 vjet traditë.<br>*Importues dhe distributor për Kosovë Exclusiv, Gjilan*</td></tr>
</table>

[54] https://en.wikipedia.org/wiki/August_Oetker

| | | | |
|---|---|---|---|
| Heineken | |  | Kompania holandeze e birrës Heineken International hyri në tregun serb në korrik të vitit 2007.<br>*Importues dhe distributor për KosovëLiridoni-Pejë* |
| MANN FILTER | | Filtera per automjete, ajri, vaj etj.<br> | https://www.mann-filter.com/mann-filter/footer-menu/contact/bosnia-and-herzegovina/<br>*Importues për Kosovë*<br>*Burak Automotive-Prizren*<br>*NT Profi Auto- Prishtinë* |
| MEGGLE | |  | https://www.meggle-foodsystems.com/en/contact/locations/europe/serbia/<br>Në 1887, Josef Anton Meggle I. themeloi qumështoren e tij...[55]<br>*Importues dhe distributor*<br>*Delfin LTD. Prishtinë* |
| ARGETA | |  | *Importues dhe distributor për Kosovë Buçaj Prishtinë* |
| YTONG | | <br>Material ndërtimor-blloka | https://www.xella.com/en/ytong.php<br>*Importues për Kosovë Ymalko* |
| Dukat | | Qrumësht dhe prodhime nga qumështi | *Importues për Kosovë*<br>*Lactalis shpk* |
| TUBORG | |  Birra | *Importues dhe distributor për Kosovë Meridian Corporation* |
| gorenje | | Teknikë, shtëpiake | *Importues dhe distributor për Kosovë Gorenje Niki-Tiki* |
| FLUIDI | | Pije jo alkooloike | *Importues dhe distributor për Kosovë Fluidi* |
| Batagon International A.G | | | http://dahlia.rs/ko-smo-mi/<br>Në tetor 2017. Dahli-në e blen kompanija "Batagon International" me seli në Zvicër. |

[55]https://www.meggle-foodsystems.com/en/about-us/meggle-group/

| | | | |
|---|---|---|---|
| ELIAS LUXEMBOURG |  | Galenika a.d. | Galenika a.d. kompani për prodhimin e produkteve farmaceutike. Galenika ka më tepër se 2500 të punësuar. |

**Disa nga markat tregtare serbe më të shiturat në Serbi**

| Prodhuesi | Origjina e markes | Marka | Informata shtesë |
|---|---|---|---|
| bambi -**Banat a.d.** Beograd,Pozharevc |  |  | *Importues dhe distributor për Kosovë Elkos Group-Prishtinë* |
| ALCO GROUP | | Pionir, hissar, TIPOPLASTIKA, ALFAPLAM | http://www.agroupm.com/ |
| Swisslion Takovo Beograd | | Eurokrem... | *Importues dhe distributor për Kosovë Gllareva Klinë.* |
| Banini Kikinda | | Noblice... | *Importues dhe distributor për Kosovë Albi-Commerce.* |
| aleva 70 godina Novi Kneževac | | **Aleva paprika (spec i bluar)** | *Importues dhe distributor për Kosovë Elkos Group.* |
| Vital Vrbas | | **Vital stoni margarin** | *Importues dhe distributor për Kosovë Elkos Group* |
| simpo A.D Vranje | | Mobilje | http://www.simpo.rs/osnovni-podaci.html |

## Konkluzione

Vendimi i taksës ishte vendosur pa bërë një parapëgatitje të mirëfilltë nga Qeveria.
Ka munguar një koordinim ndërmjet Qeverisë, MTI-së dhe Doganës përzbatimine taksës 10% e pastaj asaj 100%.Mënyra si u vendos taksa dhe futja e vetëmnëntë bizneseve dhe vetëm disa markave tregtare ngrit dyshimet për kurdisje dhe keqpërdorime nga zyrtar të lartë shtetërorë.
Shumë biznese të tjera dërguan dëshmitë se markat që importonin ishin ndërkombëtare, disa nga këto marka ishin të regjistruara edhe në bazën e të dhënave nga Agjencia e Pronësisë Industriale, pjesë e MTI-së, përgjegjës për regjistrimin e Markës Tregtare, në regjistrin e Markave Tregtare, të MTI-së, por nuk lejoheshin të hynin pa paguar taksën 100%, gjë që ishte shkelje e vendimit që vetë Qeveria e kishte marrë.
Zyrtari përgjegjës nga Agjencia e Pronësisë Industriale, pjesë e MTI-së, përgjegjës për regjistrimin e Markës Tregtare, në regjistrin e Markave Tregtare, e kanë njoftuar Doganën për kriteret dhe si të vendoste dhe se si të cilësohej një produkt i importuar markë ndërkombëtare.
Vendosja e taksës ka pas disa efekte pozitive dhe disa negative.
Efekte pozitive sepse janë rritur shitjet e produkteve dhe të shërbimeve vendore dhe është krijuar një ngritje e vetëdijes që të konsumohen më shumë produktet vendore.
Vendosja e taksës ka bërë që eksportet edhe ashtu të vogla të Kosovës në Serbi të pësojnë rënie për 50% gjatë muajve të parë krahasuar me vitin paraprak.Te bizneset prodhuese apo shërbyese, të cilat kanë pasur eksporte nga këto dy vende, ka pasur reduktim të numrit të punëtorëve dhe vendosja e taksëska pasur efekt negativ. Taksa ka ndikuar në rritjen e çmimeve të një numri të madh të produkteve dhe shërbimeve, është rritur kostoja e lëndës së parë, është rritur dukshëm kostoja e transportit të mallrave. Vendosja e taksës ka ndikuar në rritjen etheksuar të kontrabandës. Kryetarët e komunave në veri të Kosovës nga komuniteti serb, në shenjë proteste dhanë dorëheqje dhe kështu shkëputi bashkëpunimin me pushtetin qendror të Kosovës.
Taksa e ka pasur efektin për heqjen e vëmendjen së publikut nga skandalet dhe abuzimet që janë duke ndodhur në shumë sektor publik.

Vendosja e taksës 100% për të gjitha markat që prodhohen në Serbi pa dallim edhe për ato 8 biznese që ishin lejuar fillimishtduke u bazuar në paragrafin 2 të vendimit Nr.01/76, është më e drejtë për bizneset-importuesit në Kosovë, edhe pse është shkelje dhe ndëshkim ndaj markave tregtare ndërkombëtare.

**Rekomandime**

Në hartimin e vendimit është dashur të konsultohen ekspertë nga fusha e ekonomisë, të shihen se cilat mund të jenë efektet pozitive dhe ato negative.
Kur merret një vendim i caktuar bizneset duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Importuesit dhe prodhuesit që kanë importuar nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina është dashur të informohen dhe njëkohësisht t'iu kufizohet sasia e importeve që të mos kalojë vlerat e vitit paraprak të importeve në mënyrë që të hulumtoheshin tregje të reja dhe të mos keqpërdorej nga bizneset dhe prodhuesit me importin e sasive të mëdha të mallrave.
Më mirë do të ishte zbatimi i reciprocitetit në dokumentet dhe procedurat e shkëmbimeve tregtare shumë vjet më parë me këto dy shtete, sepse presioni i ndërkombëtarëve do binte mbi palën serbe dhe atë boshnjake. Njohja e tabelave të automjeteve, dokumentacionit dhe produkteve të prodhuara në Kosovë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina do të ishte një hap drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës, si dhe eksportet e produkteve nga Kosova do të rriteshin.

Qeveria aktuale duhet të punojë më shumë dhe të bëjë përpjekjetë krijojë kushte për joshjen e prodhuesve që kanë marka të njohura të produkteve të investojnë në Kosovë, edhe pse koha për këtë gati ka përfunduar.

# STRATEGJIA E BIZNESEVE DHE NDRYSHIMET ORGANIZATIVE

**Phd © Arian Tahiri**

**Universiteti i EJL - Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomise**

**MSc.Egzon Zariqi**

**Universiteti UHP - Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomise**

Abstarkti

*Strategjia e ka prejardhjen nga terminologjia greke. Sot secila ndërmarrje përdor strategjitë e saj për të realizuar objektivat dhe zhvilluar biznesin. Disa biznese kanë sukses dhe disa të tjera edhe falimentojnë krejt. Burimet e suksesit dhe të dështimit për një biznes mund të jenë të natyrave të ndryshme në të cilin ndikojnë shumë faktorë, mirëpo një pikë shumë e rëndësishme për bizneset është menaxhimi i strategjive biznesore. Precesi i menaxhmentit strategjik duhet shikuar si një proces kompleks, menaxherët strategjikë për të realizuar strategjinë e caktuar dhe detyrat që rrjedhin prej saj, jenë të ndikuar nga kultura e organizatës, struktura e saj.*

*Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë rëndësinë e strategjive të ndërmarrjeve në Kosovë, ndërlidhjen e objektivave të ndërmarrjes me strategjitë e saj si dhe implementimin e tyre nga ndërmarrjet.*

*Hulumtimi në pjesën hyrëse përmban përshkrimin e shkurtër të hulumtimit, dhe paraqet pytjet hulumtuese, hipotezat dhe përcakton metoden e kërkimit.*

*Modeli i hulumtimit përdorë kombinim e metodave cilësore dhe sasiore në mënyrë që të shqyrtohet problemi më thellësisht. Poashtu modeli përfshin teorinë si dhe pjesën praktike e cila është realizuar në sektorin e ndërmarrjeve të vogla.*

Fjalët e rëndësishme: strategjia, menaxhimi strategjik, planifkimi, ndërmarrje, struktura organizative.

1. Hyrja

Qëllimi i këtij punimi është të vlerësojë dhe analizojë rëndësinë e strategjive të ndërmarrjeve në Kosovë dhe implementimin e strategjive nga këto ndërmarrje.

Zhvillimi i ndërmarrjeve sektori ka një rol kyç në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës, i cili si faktorë do të ndikonte në stabilitetin ekonomik dhe mirëqenien sociale të qytetarëve.

Në Kosovë, strategjitë dhe menaxhimet strategjike të ndërmarrjeve kanë filluar më vonë të aplikohen, madje në shumicën e ndërmarrjeve këto strategji ende nuk kanë filluar të integrohen në planifikimet dhe proceset e tyre biznesore, si një ndër faktorë kryesorë mund të jenë kosto e lartë e zhvillimit të strategjive dhe njohuritë e nevojshme për zbatimin apo menaxhimin e tyre.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është analiza dhe dhënia e rekomandimeve për rëndesin e strategjise në bisnese. Për të arritur në fazën finale, pra në dhënien e rekomandimeve, ky punim ka disa synime të rëndësishme ku mund të përmendim:

- Evidentimin e sfidave dhe faktorëve të tjerë përcaktues me të cilat janë përballur bizneset ne Kosovë.
- Të studiojë rolin dhe ndikimin e strategjisë, si një faktor kyç për zhvillimin e kompanisë.

Pasi të kemi evidentuar dhe analizuar pikat e mësipërme, vetëm atëherë mund të japim rekomandime të sakta dhe me vlerë, duke shpresuar në një ndikim pozitiv në situatën aktuale ku operojnë kompania në fjalë.
Ky studim fokusohet në rëndësinë e strategjisë për aplikim nga ndërmarrjet, me synim që të kemi një pasqyrë më të qartë se cilët janë sfidat e ndërmarrjeve dhe si ndikon strategjia efikase për rritjen e ndërmarrjeve.

**Pytjet hulumtuese:**

- Të prezentohet rëndesia e strategjisë te bizneset?
- Si ndikon financimi nga jashtë ne forcimin e bizneseve dhe implementimin e strategjive për zhvillimin e tyra?
- Te identifikohen sfidat dhe veshtërsitë e bizneseve ne Kosovë?
- Si ndikojnë problemet politike në Kosovë në zhvillimin e bizneseve, çfarë lidhje ka me bizneset situata politika?
- Te zbulohet se sa ju kushtojnë rëndesi strategjive bisneset në Kosovë?
- Të vlërësohet se si ndikon planefikimi I strategjisë në përformancën e biznesit?

## 2. Hipotezat

***H1:*** *Nëse bizneset e vogla kanë qasje në financim nga jashtë si psh nga: bankat, subvencionet dhe mbështetjet qeveritare, investitorët etj, mund të implementojnëstrategji që ndikojn në rritjen e tyre.*

***H2:*** *Problemet politike dhe destabiliteti ekonomik kanë ndikuar në performancën e zhvillimit të bizneseve.*

***H3:*** *Bizneset të cilat hartojnë plane strategjike janë më stabile dhe të suksesëshme se sa ato të cilat nuk kanë strategji të planefikuara.*

## 3. Metodologjia e hulumtimit

Ky hulumtim përbehët nga dy pjesë, i cili përfshin pjesën teorike dhe atë praktike. Pjesa teorike e hulumtimit përfshin literaturen, artikujt nga revistat shkencore dhe informatat e shfrytëzuara nga ëebi, ndërsa pjesa praktike e hulumtimit përfshin intervistat e realizuara me ndërmarrjet e vogla. Punimi është mbështetur duke i shfrytëzuar të dhëna primare dhe të dhëna sekondare, duke shfrytëzuar literaturë bashkëkohore nga fusha e menaxhmentit strategjik si dhe hulumtimeve e punimeve të cilat janë realizuar rreth këtaj fushe.

Hulumtimi është realizuar përmes pesë intervistave, ku si mostër janë marrë biznese të cilat i takojnë fushave të ndryshme të veprimtarive biznesore. Intervistat janë realizuar në bizneset që veprojnë në Mitrovicë dhe Prishtinë. Intervista është e tipit të strukturuar, e cila përmban pyetje të hapura, të mbyllura dhe me alternativa. Intervistat kanë zgjatur nga 40 minuta për secilën ndërmarrje.

## 4. Kuptimi dhe rëndësia e menaxhmentit strategjik

Termi “strategji” e ka prejardhjen nga terminologjia ushtarake greke, ku fjala strtegos ( stratus + ago) ka kuptimin e udhëheqësit ushtarak, gjeneralit.[56]

Menaxhmenti strategjik përkufizohet si përmledhje e vendimeve dhe veprimeve, të cilat i përkasin formulimit dhe zbatimit të strategjive për arritjen e qëllimeve të organizatës. detyrat

[56] Prof.Dr.Izet Zeqiri, 2016, Menazhmenti Strategjik, Shkup,7

kryesore të menaxhmentit strategjik janë: a) formulimi I misionit të organizatës, b)dirigjimi dhe analiza e gjendjes së brendshme dhe mundësive të oranizatës, c)vlerësimi I ambientit të jashtëm të organizatës, duke përfshirë factorët konkurrues dhe factorët e përgjithshëm kontektstual, ç) analiza e alternativave të organizatës më të dëshiruar, duke e vlerësuar çdo alternativeë në suazat e misionit të organizatës, dh) zgjedhja dhe drejtimi I objektivave afatgjatë dhe strategjisë kryesore, nëpërmjet të cilës do të realizohet alternative përkatëse, e) zhvillimi I objektivave vjetore dhe strategjive afatëshkurtra, ë) implementimi I strategjisë së zgjedhur, f)vlerësimi i suksesit të procesit strategjik si input për vendimmarrjet e ardhëshme.

Menaxhmenti strategjik në ndërmarrje realizohet në një seri hapash, duke përfshirë shumë aktivitete të ndërlidhura në drejtim të realizimit të qëllimeve të organizatës. Procesi I menaxhimit strategjik konsiderohet sin jë sekuencë e fazave të definuara qartë: duke filluar nga formulimi dhe zbatimi, (ndertimi I agjendës).[57]

Tri fusha kryesore të strategjisë së korporatës janë analiza strategjike, zhvillimi I strategjisë dhe zbatimi I strategjisë.[58]

### 4.1. Komponentët e menaxhmentit strategjik

Precesi i menaxhmentit strategjik duhet shikuar si nje proces kompleks, realizimi i të cilit përfshinë shumë komponntë, duke filluar nga rrethina e jashtme me të gjithë faktorët e jashtëm dhe faktorët e brendshëm.

Menaxherët strategjikë për të realizuar strategjinë e caktuar dhe detyrat që rrjedhin prej saj, duhet të jenë të ndikuar nga kultura e organizatës, struktura e saj. Ata, për të vepruar varen nga sistemet e shërbimit, mekanizmat e kontrollit, dhe klima e organizatës. strategjia e menaxhmentit duhet t'i marrë parasysh të gjitha këto elemente.

Për të rritur shanset për sukses dhe marrjen e rezultateve që ne dëshiojmë, organizata duhet shikuar sin dërveprim I tetë componentëve: detyrat, njerëzit, sistemet e shpërblimit, sistemet e kontrollit, sistemet e informacionit, kultura, procesi I vendosjes, struktura.[59]

Strategjia është treguar si timonier, që ndërvepron me elementet tjera organizative, të cilat së bashku japin rezultate.

### 4.2. Planefikimi strategjik

Me njohjen e qëllimeve të organizatës fillon formulimi I planeve të aksioneve të cilat do të definojnë mënyrën e realizimit të qëllimeve. Menaxheri I një organizate afariste duhet të formulojë strategjinë konkrete e cila mundëson realizimin e qëllimeve – qëllimit të fundit.

Strategjia tregon qasjen e përgjithshme të realizimit të qëllimeve, gjersa ajo ndërtohet në krahët e fortë të organizatës. Strategjia I bën të mundur një menaxheri të krijojë përparësi ndaj konkurrentëve, përkatësisht ia mundëson përqëndrimin e resurseve të neojshme me qëllim që ato të shfytëzohen në menyrë efikase.

Definimi i qëllimeve, procesi I vendosjes dhe aktivitetet tjera të vetëdijshme paraqesin procesin kreativ në fushën e menaxhmentit. menaxherët krijojnë tipe të tilla organizative të cilat iu mundësojnë realizimin e qëllimeve. Menaxheri me qëllim që t'I sigurojë firmës positë të mirë në një mjedis të caktuar, zgjedh pikën, fushën e caktuar në të cilën organizata me së miri mund të ekzistojë. Zgjedhja e positës së caktuar përfshin atë që ne e quajmë luftë për përparësi diferenciale.[60]

---

[57] Bala Chakravarthy, Guenter Mueller-Stewens, Peter Lorange And Christoph, Lechner, Strategy Process, 2003
[58] Richard Lynch Corporate Strategy Fourth edition 2006,Prentice Hall, 48
[59] David Hussey: Strategic Management From theory to implementation Fourth edition 1998, 46
[60] Prof.Dr.Berim Ramosaj, Management, Universiteti I Prishtinës, 2007, 63

### 4.3. **Nivelet e menaxhmentit strategjik**

Gjykuar sipas strukturës formale të kompanisë dhe sipas dizajnimit të strukturës organizative, nivelet e menaxhmentit strategjik janë: menaxhmenti strategjik në nivel të kompanisë, menaxhmenti strategjik në nivel të sektorit dhe menaxhmenti strategjik në nivel te funksionit.

Menaxhmenti strategjik në nivel të kompanisë mban llogari për rezultatet financiare të kompanisë si dhe për zgjedhjen e problemeve të shumta të natyrës jo financiare. Ky nivel, gjithashtu mban llogari edhe për ndërtimin, ruajtjen dhe përmirësimin e imazhit të kompanisë, si dhe për përgjegjësinë sociale të saj. Në këtë nivel përcaktohen biznesi, në të cilin pëfshihen firmat, vendosen objektivat dhe formulohen alternativat strategjike për secilin biznes, si duhet t2 alokohen resurset që të realizohen qëllimet etj.

në nivelin më të lartë, vendimet karakterizohen me risk më të madh, ato janë të orientuara në vlera, janë më konceptuale dhe më të përgjithshme në krahasim me ato në nivel biznesi apo funksional.

Menaxhmenti strategjik në nivel të sektorit përbëhet kryesisht nga menaxherët e njësive të biznesit dhe të korporatës. menaxherët e këtij niveli kontribuojnë në realizimin e strategjisë së përgjithëshme, por edhe në kuader të çdo sektori zhvillohet strategjia e vacantë.

Ky menaxhment kërkon t'u japë përgjigje pytjeve të mëposhtme: çfarë produktesh duhet të prodhohen?, cilët do të jenë klientët?, si mund të përmirësojë konkurrimin në segmentin e saj të prodhimit apo shërbimit?, si mund të kordinohet dhe sinkronizohen aktivitetet e sektorit me ato të kompanisë?, si mund të shpërndahen resurset në nivel të sektorit?

Menaxhmenti strategjik në nivel funksional ka për detyrë të përkrahë strategjitë në nivel të sectorëve dhe në nivel të kompanisë. menaxherët e këtij niveli zhvillojnë objektivat afatshkurtër dhe strategitë afatshkurtra për fushat funksionale, si♪5 janë funizimi, prodhimi, marketing, financa, burimet njerzore, plan dhe analizë, funksioni I sistemeve informative etj.

Vendimet në nivel funksioni janë vendime afatshkurtër dhe përgjegjësisht kanë të bëjnë me maksimizimin e rezultateve dhe realizimin e detyrave në mënyrë efektive dhe efikase.[61]

### 4.4. **Ndikimi i strategjisë dhe strukturës në vendimmarrjen operacionale të organizatës**

Duke ditur së operacionet shërbejnë për realizimin e strategjisë së organizatës, për realizimin e objektivave strategjike, është e kuptueshme së varësisht nga lloji i strategjisë që zhvillohet në një organizatë, duhet të zhvillohen edhe operacionet përkatëse të cilat përputhen më strategjinë dhe janë në funksion të strategjisë.

Gjithashtu këto së bashku duhet t'i përshtaten edhe strukturës së ndërmarrjes.

Kështu, strategji të ndryshme konkurruese do të kërkonin struktura të ndryshme organizacionale dhe operacione të ndryshme. Organizatat që ndjekin një strategji të udhëheqjës së kostos, do të përpiqëshin të siguronin operacione sa më efiçente, më qëllim kontrollin e kostos dhe një strukturë mekanistike e cila do të ishte më e centralizuar, ndërsa organizatat që do të ndiqnin strategjinë e diferencimit, do të kërkonin një shkallë më të lartë krijueshmërie dhe ndoshta një

përgjigje të shpejtë ndaj shanseve të mjedisit duke i përshtatur dhe duke i ndryshuar operacionet në mënyrë të shpejtë, për të cilën do të ishte e nevojshme një strukturë organike dhe e decentralizuar.

---

[61] Prof.Dr. Izet Zeqiri: Menaxhmenti Strategjik, 2016, 30

Varësisht nga strategjia e organizatës dhe mënyra e organizimit të saj, zhvillohen dhe funksionojnë proceset dhe operacionet e saj, të cilat duhet të përshtaten në atë mënyre që vazhdimisht të mbështesin realizimin e objektivave strategjike të organizatës, çka edhe mundësohet përmes zhvillimit dhe implementimit të strategjive të mirëfillta.

Nga hulumtimi i BSCK Survey[62], 2014 vërejmë se bizneset kosovare operacionet e tyre më së shumti i kanë të lokalizuar në vendin në të cilin veprojnë, do të thotë aty ku operojnë, dhe nuk vërehen shumë shtrirje në vende të tjera (fshatra, qytete, rajone), gjegjësisht duke përfshirë shtrirjet edhe jashtë vendit në shtete tjera. Pra qëllimet e tyre për zgjerim të tregut dhe aspiratat globaliste nuk shprehen shumë.

### 4.5. Ndryshimet në organizim

Ideja mbi ndryshimet më organizim është vazhdimësi e shqyrtimit dhe e analizës së dinamikës së organizimit.

Njohja e parasupozimit se asgjë nuk është e dhënë njëherë e përgjithmonë është pikëmbështetja thmelore për të hulumtuar ndryshimet në organizim.

Burimet e ndryshimeve janë të shumta, por me qëllim të shqyrtimit më të thjeshtë ne do t'i ndajmë në dy grupe:

Ato që janë krijuar në kuadër të organizatës dhe

Ato që janë të kushtëzuara nga forcat e jashtme – jashtë organizatës.

Burimi kryesor i ndryshimeve të brendshme rrjedh nga procesi I shtimit të organizatës. ndryshimet që bëhen qoftë në përcaktimin e qëllimeve, planeve, politikës, qasjeve, buxhetit dhe mjeteve të tjera përkat2se janë burime të brendëshme për ndryshime.

Burimet e jashtme si bazë elementare të ndryshimeve janë shumë. karakteristikë e tyre është se këto më vështërsi mund të kontrollohen. në këtë grup të burimeve hyjnë kryesisht të gjitha ndryshimet që vijnë nga rrethi ekonomik, shoqëror dhe politik.

Organizata për të jetuar dhe vepruar patjetër duhet të ketë një shkallë relativisht të lartë të stabilitetit, ashtu që të ketë aftësi për të vepruar në menyrë efikase ndaj ndrrimeve që vijnë qoftë nga Brenda, qoftë nga paftësia e mbajtjes së gjendjes stabile sigurisht se do të sillte kaos apo dezorganizim nën ndikimin e factorëve që shpiejnë tea to gjendje.

Kuptimi që rrjedh nga nje mendim I vjetër se, " ndaj çdo ndryshimi ka rezistencë", mund të na shërbejë si bazë elementare për shqyrtimin e rezistencës ndaj ndryshimeve.

Duke u mbeshtetur në qasjen relative të rezistencës që bëhet ndaj ndryshimeve, ekzistojnë 4 grupe të arsyeve për rezitencë ndaj ndryshimeve:[63] (Tradita , Frika, Kapitali, Interest personale).

### 4.6. Udhëheqja me ndryshime

Ekzisojnë dy mënyra të udhëheqjes me ndryshime.

- ✓ Intuitive dhe
- ✓ vetëdijshme (racionale)

Metoda e parë është mjaft e shpeshtë në praktikën e udhëheqjes me ndryshime. Kryesisht bazohet në parimin intuitive "çka të dalë le të dalë" kur të paraqitet nevoja për ndryshime. Vetë

[62]Entrepreneurship and Small Business Development in Kosovo, Research report, Prishtinë,Mars 2011
[63] Prof.Dr.Berim Ramosaj, Management, Universiteti I Prishtinës, 2007, fq 125

esenca e kësaj metode ngërthen në vete mjaft dobësi dhe kufizime, andaj paraqitet nevoja e mendimit dhe udhëheqjes së vetëdijshme.

Sipas metodës së vetëdishme apo racionale, udhëheqja me ndryshime bëhet sipas orientimit në qëllime. për të udhëhequr ndryshimet në mënyrë të vetëdijshme dhe aconale, padyshim kërkohet njohja e tri aspekteve themelore të udhëheqjes së ndryshimeve:

- ✓ mekanizmat për njohjen e ndryshimeve
- ✓ strategjitë, dhe
- ✓ metodat.

Mekanizmat për zbulimin apo njohjen e ndryshimeve paraqesin lidhjet dhe mjetet e tjera të nevojshme, të cilat ju bëjnë t2 mundëshme që vijnë qoftë nga Brenda apo jashtë.

Strategjite e ndryshimeve organizative – moment I njohjës së ndryshimit të mundshëm, paraqet kohën vendimtare kur duhet bërë angazhimet e nevojshme për udhëheqjen e ndryshimeve.

Strategjitë apo qasja e ndryshimeve ndahen në tri kategori themelore. E para, ndryshimet që I inicon menaxhmenti realizohen nëpër nivelet hirarkike të organizatës, zakonisht nga niveli më I lartë. E dyta, strategjia duke shfrytëzuar konsultat nga jashtë. Menaxhmenti mund të zbulojë kërkesat apo nevojen për ndryshime, por shpesh këtë më së miri mund ta bëjnë konsultantët e jashtëm qoftë si kuadër I specilizuar, miq afaristë apo si bashkëpuntoë, të cilët në moment të caktuara janë azhuar me kohën dhe me ndryshimet. E treat, paraqet strategjinë që realizohet me punën e përbashkët apo qasjen e përbashkët njohjes apo realizimit të ndryshimeve.

Hapi I fundit në procesin e udhëheqjes së ndryshimeve padyshim që është zbatimi I metodave përkatëse të cilat mund të shfrytëzohen ashtu që t2 bëhen me lehtësi realizimi I ndryshimeve.

## 5. Prezantimi dhe analiza e rezultateve

### Tabela 2: Rezultatet e pytjeve të mbyllura

| Pytje gjatë intervistes | Firma 1 | Firma 2 | Firma 3 | Firma 4 | Firma 5 | Përqindja PO | JO |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A keni pasur biznes plan para se të hapëni firmen | Po | Jo | Po | Jo | Po | 0.8 | 0.2 |
| Gjatë planefikimit të strategjive, a I përdorni teknikat e analizave dhe matricave | Po | Po | Jo | Jo | Jo | 0.4 | 0.6 |
| pjesëmarrja e depertamenteve dhe punëtorëve në planefikim strategjik | Jo | Po | Po | Jo | Po | 0.5 | 0.5 |
| A keni njohuri të mjaftueshme mbi klientët dhe target grupin tuaj | Po | Po | Jo | Jo | - | 0.5 | 0.5 |
| A keni informacione mbi konkurencën | Po | Po | Po | Po | - | | |
| A përdorni softver kompjuterik në planefikim dhe në kontrollin strategjik | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo | | 1 |
| Periudhat e rishikimit të implementimit të strategjive | Vjetore | 6Mujore | 3Vjeçare | Vjetore | vjetore | | |
| Çfare prisni në vitin 2019 | më I mirë | më I mirë | Më I mire | më I mirë | njejtë | | |
| Profiti I ndërmarrjes tuaj është | Rritur | rënie | I njejtë | rënie | | | |
| A keni marrë kredi nga bankat | Subvencion | Jo | Jo | Jo | Donacione | 0.4 | 0.6 |

Burimi: Autori

***Firma 1 – është kompania, Vision Agency Sh.P.K. Prishtinë**

***Firma 2 – është kompania, Global Phone DSH Mitrovicë**

***Firma 3 – është kompania, Skandora AB – Dega në Kosovë Sh.P.K. Mitrovicë**

***Firma 4 – është kompania, Income Consulting Sh.P.K. Prishtinë**

***Firma 1 – është Organizat jo qeveritare, Instituti për studime dhe zhvillim – ECOPOL , Mitovicë**

Nga tabela mund të vërejmë se 80% e bizneseve të intervistuara kishin biznes plan kur e kanë filluar biznesin, ndërsa 20% prej tyre nuk kishin. Përveç këtyre pyetjeve, në intervistë janë trajtuar dhe analizuar të dhënat cilësore të bizneseve që kanë të bëjnë më çështjët:

**Strukture organizative e ndërmarrjeve:** Përgjithësisht këto biznese shfrytëzonin strukturën Piramidë apo hierarkike, dmth përdorin një strukturë të thjeshtë organizative, që fillontë me pronarin në krye të biznesit, duke pasuar më menaxherët dhe drejtorët dhe në fund të piramidës janë punëtorët.

**Përdorimi i teknikave analitike dhe matricave gjatë planifkimit strategjik:** 40 % të bizneseve të intervistuara kanë përdorur matricat, matrica epërdorur nga të dy bizneset ka qenë SWOT analiza, ndërsa Matricen e vlerësimittë faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm e ka shfrytëzuar një biznes. Tribizneset e tjera nuk i përdornin matricat dhe teknikat tjera për planifikim tëstrategjive dhe biznesit, duke konsideruar që nuk kanë njohuri në aplikimin ekëtyre matricave dhe analizave biznesore.

**Pritjet për vitin 2019:** Sa i përket pritjeve të bizneseve, 60% prej tyre janë më optimiste duke parashikuar që ky vit do të jetë më i mirse sesa viti paraprak, ndërsa ndërsa 20% prej tyre kanë deklaruar që pritjet për vitin e ardhshëm janë pesimiste për shkak të rënieve në kërkesë më të cilat ato janë ballafaquar këtë vit. Pritje të njëjta për vitin e ardhshëm kanë deklaruar 20% e respondentëve, pasi që ato nuk shohin as përmirësim as përkeqësim të gjendjes.

**Përdorimi i softuerëve për planifikim strategjik:** Vërehet qartë nga tabela se integrimi i softuerëve për planifikim strategjik ende nuk ka filluar. Bizneset vlerësohen të jenë faktorët kyç dhe kryesorë të cilat shtynë zhvillimin e teknologjive të reja për të arritur përparësi strategjike në zhvillimet e suksesshme [64]fitimprurëse.

**Kreditë nga Banka:** Nga tabela mund të konstatojmë se kredi nga banka nuk kanë marrë 60% prej tyre, mirëpo 40% e bizneseve tjera kanë marrë subvencione nga ministria dhe donacione të ndryshme, që do të thotë se kredi nuk kanë shfrytëzuar asnjë nga bizneset për shkak të interesit të lartë që është edhe një kufizim për veprimtarinë biznesore.

**Strategjitë që kanë prioritet me të lartë nga ndërmarrjet:** Nga kjo tabelë mund të vërejmë qartë se ndër strategjitë më të rëndësishme të bizneseve kanë të bëjnë me:

**Tabela 3: Strategjitë më të rëndësishme të ndërmarrjes**

| | Firma 1 | Firma 2 | Firma3 | Firma4 | % |
|---|---|---|---|---|---|
| Përmirësimi I cilësisë së produkteve/shërbimeve | - | + | _ | + | 50% |
| Diferencimi i produkteve/ shërbimeve | - | + | - | + | 50% |
| Marketing dhe aktivitetet reklamuese | + | + | + | - | 75% |
| Investimi në teknologji | - | - | - | + | 25% |
| Trajtimi i të punësuarve | - | - | - | - | 0.00 |

[64]Mustafi, Skender. Matured and still emerging: The Changing Position of The Internet in Business Strategies of Companies Since the DotCom Hype, FHNW, Olten, 2011

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Kostot më të ulëta | + | - | + | + | 75% |

Burimi: Autori

1. *Përmirësimi i cilësisë së produkteve/shërbimeve*, e cila ka ndikim direkt në rritjen e fitimeve të bizneseve, dhe që këto fitime mund të shfrytëzohen për aktivitete tjera apo të investohet në diçka të re. Kjo strategji synohet nga 50% e bizneseve të intervistuara.

2. *Marketingu dhe aktivitetet reklamuese,* definimi dhe implementimi i një strategjie të fortë të marketingut është pothuajse faktori i vetëm më I rëndësishëm qe kontribuon në drejtim të suksesit të qëndrueshëm afatgjatë të çfarëdo biznesi[65]. Sipas të dhënave të marra nga këto biznese theks të veçantë është duke u dhënë aktiviteteve reklamuese të cilat i informojnë konsumatorët

më ofertat e reja të këtyre bizneseve, dhe format që shfrytëzohen më së shumti nga këto biznese janë reklamat në vet objektin e biznesit dhe mediumet. P.Drucker[66] ka theksuar qartë rolin e marketingut për suksesin e ndërmarrjes dhe qëndrueshmërinë e saj i cili është i pakontestueshëm.

3. *Përmirësimi i cilësisë së produkteve/shërbimeve*, rreth 50% e këtyre bizneseve deklarojnë që kjo është njëra ndër strategjitë më të rëndësishme dhe vazhdimisht shihet tendenca e realizimit të kësaj strategjie për arsye të tërheqjes së konsumatorëve të rinjë dhe mbajtjen e atyre ekzistues.

4. *Diferencimi i produkteve/shërbimeve,* po ashtu rezultojë si strategji e rëndësishme e bizneseve, ku 50% prej tyre theksuan që një diferencim i mirë I produkteve do të rritë fitimin e biznesit dhe do të sjellë klient të ri. Nga diferencimi mund të krijohen përparësitë konkurruese[67], të cilat janë thelbësore për suksesin afatgjatë të ndërmarrjes.

5. *Trajnimi i të punësuarve (stafit),* nga intervistat me këto biznese, kjo strategji ende mbetet e parëndësishme dhe nga to nuk është duke u bërë diçka në ndryshimin e kësaj çasje. Ende vazhdon qasja tradicionale për mos trajnimin e stafit dhe duke mos e konsideruar RH si faktorin kryesorë. Gjithashtu nga një hulumtim i zhvilluar në lidhje me programet edukuese të bizneseve të vogla[68], ka evidentuar që këto programe për trajnimin dhe edukimin e stafit kanë hasur në rezistence nga pronari-menaxheri i biznesit të vogël.

6. *Kostot më të ulëta*, si një strategji shumë e rëndësishme, 75% deklaruan që kjo është njëra nga strategjitë që përpjekën të arrijnë vazhdimisht që ndikon direct në profitin e ndërmarrjeve. Përveç kësaj, arritja e kësaj strategjie mund të sigurojë edhe përparësi konkurruese në krahasim më bizneset e tjera.

| **Objektivat** | **Firma1** | **Firma2** | **Firma3** | **Firma4** | **Firma5** | **%** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| cilësia e produktit | **+** | **+** | **+** | **+** | **-** | **80%** |
| imazhi / reputacioni | **+** | **+** | **+** | **+** | **+** | **100%** |
| Pjesa e tregut | **-** | **-** | **-** | **+** | **-** | **20%** |
| Globalizimi | **-** | **-** | **-** | **-** | **+** | **20%** |
| Pozicionimi në industry | **-** | **-** | **-** | **--** | **-** | **0%** |

[65]A & C Black Publishers Ltd: *Choosing Your Marketing Strategy*, UK, 2006
[66]Drucker, P.: *The Practice of Management*, Harper & Row, New York, 1954, citat në faqën 37 të librit Evans, J.R.& Berman, B,: Marketing, New York, 1987
[67]Fred R. David, *„Menaxhimi Strategjik – Koncepte dhe rastet studimore“,* Botimi i 13-të, Prishtinë, Janar 2014, (Përkthimi Shqip), fq. 10
[68]Gary Gorman, Dennis Hanlon, Wayne King, *Some research perspectives on entrepreneurshipeducation, enterprise education and education for small business management: a ten-year literature review*. International Small Business Journal, April-June 1997 v15 n3 p56(22), fq. 13

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Tregjet e reja | **+** | **+** | **+** | **-** | **-** | **60%** |

**Tabela 4: Objektivat strategjike më të rëndësishme në ndërmarrje:**

Burimi: Autori

Nga tabela, vërehet qartë se reputacioni është si objektivë strategjike e të gjitha bizneseve të intervistuara, me theksin që jë reputacion I mirë siguron kërkesë të lartë për produktin / shërbimin dhe është çdo herë zgjedhja e parë të cilën e bën konsumatori.

Gjithashtu, në bizneset e vogla cilësia e produktit/shërbimit është një nga objektivat strategjike më të rëndësishme, e cila përveç tjerash e bën edhe produktin/shërbimin më të diferencuar nga të tjerat dhe ka efekt në rritjen e kërkesës për to.

**Tabela 5: Faktorët e rritjes së profitit**

| | Firma1 | Firma2 | Firma3 | Firma4 | % |
|---|---|---|---|---|---|
| Rritja e shitjes | + | - | - | - | 25% |
| Rritja e produktivitetit | + | - | - | - | 25% |
| Produkte te reja | - | - | - | - | 0% |
| Reduktimi i shpenzimeve | + | - | + | - | 50% |
| Trajnimi I stafit | - | - | - | - | 0% |

Burimi: Autori

Nga tabela, vërehet tendenca që bizneset e vogla gjithnjë e më shumë në strategjitë e tyre po përfshijnë reduktimin e shpenzimeve, e cila tani po ka efekt pasi që 50% e bizneseve të intervistuara kanë vlerësuar që rritja e profitit të tyre është për shkak të reduktimit të shpenzimeve të tyre.

**Tabela 6: Faktorët e zvogëlimit të profitit**

| | Firma1 | Firma2 | Firma3 | Firma4 | % |
|---|---|---|---|---|---|
| zvogëlimi I shitjeve | - | + | - | + | 40% |
| Ritja e kostove | _ | _ | + | _ | 20% |

Burimi: Autori

40% e bizneseve kishin rënje duke vlerësuar si faktorë kyç zvogëlimin e shitjeve apo uljen e kërkesës, gjithashtu edhe rritja e kostove ka shkaktuar ulje të fitimeve tek 20% e bizneseve

**Tabela 6: Barrierat e implementimit të strategjisë**

| | Firma1 | Firma2 | Firma3 | Firma4 | % |
|---|---|---|---|---|---|
| Konkurrenca | - | - | - | - | 0% |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Korrupsioni | - | - | - | - | 0% |
| Ekonomia joformale | - | + | + | _ | 50% |
| Konkurenca jo lojale | _ | _ | + | _ | 25% |
| Taksat dhe tatimet | _ | _ | - | _ | 0% |
| Jostabiliteti politik | + | + | _ | + | 75% |
| Kerkesat e tregut | _ | + | + | + | 75% |
| Mjedisi biznesor | _ | _ | + | _ | 75% |
| Profesionet jashtëformale | _ | _ | _ | _ | 0% |
| Ligjet jo të favorshme | + | + | _ | _ | 50% |
| Ptoblemet me energji elektrike | _ | _ | - | + | 25% |
| Migrimet e populates | _ | + | _ | + | 50% |
| Fuqia punetore e pa pergatitur profesionalishtë | - | - | - | - | - |

Burimi: Përshtatur nga autori

Nga kjo tabelë, mund të shihet qartë se faktori më ndikim më të madh si barrier për implementimin e strategjisë ka qenë Kërkesa e tregut, e cila sipas bizneseve ka qenë më e ulët. Në këtë fazë të rënies së shitjeve është e nevojshme të verifikohen të gjitha shpenzimet e parashikuara[69].

Në vitin 2014, po ashtu çka ka qenë shqetësuese për bizneset përveq migrimit të popullatës, ka qenë edhe jo stabiliteti politik i cili ishte njëri ndër faktorët me një peshë të madhe ndikuese në veprimtarinë e bizneseve, të cilin faktorë 75% e bizneseve të intervistuara e vlerësuan si barrierë në implementimin e strategjisë së tyre.

Kërkesat e tregut gjithnjë kanë rolin vendimtar në implementimin e strategjive, sepse pothuajse e çdo gjë varët nga tregu dhe kërkesat e tij, 75% e bizneseve vlerësuan si pengesë kryesore në implementimin e strategjive të tyre këtë faktorë, gjithashtu nga tabela e mëparshme vërejtën se edhe shkaku kryesor i rënies së profitit ishte rënja e shitjeve apo kërkesave të tregut.

Gjithashtu edhe ekonomia formale është vlerësuar si një barrierë nga 50% prej bizneseve të intervistuara. Në Kosovë thuhet se pjesëmarrja e ekonomisë informale dhe e tregut të zi sillet prej 39% deri 50% të të hyrave kombëtare të vendit.[70]

## 6. Përfundime

Nga ky hulumtim mund të vijmë në përfundim se strategjitë dhe menaxhimit strategjik i ndërmarrjeve të vogla në vendin tonëi kushtohet shumë pakrëndësi dhe vendimet mbi udhëheqjen e biznesit nuk bazohen në strategji dhe analiza perms teknikave dhe metodave të planifikimit strategjik, mirëpo më shumë janë të bazuara mbi intuitën dhe vendimet e pronarëve të biznesit. Hulumtime të ndryshme kanë ardhur në përfundim se menaxhmenti strategjik ka efekt në performancën e bizneseve, gjithashtu implementimi i menaxhmentit strategjik ka një lidhje pozitive me pjesën e tregut të kompanisë. Për me tepër, faktorët infrastrukturorë,

[69]Graham Beaver & Caroline Ross, Strategic Change 8, (1999) 251-261
[70]Government programme for prevention of informal economy in Kosovo 2010 – 2012, fq.3

mjedisorë dhe socio-kulturorë në mënyrë significant kanë impakt në menaxhimin strategjik të bizneseve të vogla.

Përfundimet e nxjerra nga hulumtimi janë:

- Në mungesë të strategjive dhe planeve, mekanizmi i kontrollit nuk mund të realizohet në mënyrë adekuate dhe që të gjitha këto së bashku ndikojnë direkt mbi performancën e bizneseve.

- Zhvillimi i strategjive adaptive dhe i strategjive participative janë të lidhura direkt me performancën e biznesit të vogël. Modeli mbështet kërkimin që firmat të cilat shfrytëzojnë kombinime të proceseve për zhvillim të strategjive në vend të fokusimit tek një proces ekskluzivisht, janë më premtuese që të kenë sukses.

- Posedimi me një strategji të mirëfilltë nga biznesi i vogël, implementimi dhe kontrolli saj do të ishin kruciale për suksesin e biznesit dhe ngritjen e performancës së tij, gjithashtu udhëheqja efektive dhe arritja e qëllimeve do të ishte më e realizueshme për këto biznese se sa ato të cilat nuk posedojnë fare strategji.

- Ndërmarrjet të cilat i lidhin objektivat e tyre me planifikimin dhe menaxhimin strategjik në tërësi, kanë probabilitet shumë më të lartë që ti arrijnë ato, në krahasim më ndërmarrjet të cilat nuk kanë objektiva të qarta dhe të cilat nuk I menaxhojnë strategjitë e tyre.

### 6.1. Rekomandime

Që të përmbushet misioni dhe objektivat e bizneseve në drejtim të rritjes dhe profitabilitetit, menaxhmenti duhet të ketë një rimendim pozitiv në drejtim të përdorimit të menaxhmentit strategjik duke ditur se suksesi i biznesit së pari varet nga vlera e gjykimit, energjia, shkathtësia e top menaxherëve dhe e implementimit strategjik.

Disa rekomandime të tjera për bizneset e që operojnë në vendin tonë janë:

-Posedimi i strategjive dhe mekanizmave të kontrollit të strategjive,

-Përdorimi i analizave dhe matricave gjatë procesit të vendimmarrjes,

-Investimi në marketing dhe aktivitete reklamuese më shumë,

-Trajnimi i stafit dhe lejimi i pjesëmarrjes për të gjitha vendimet e biznesit,

-Rritja e njohurive për planifikim strategjik nga ana e pronarëve dhe menaxherëve,

-Njohja e klientëve, e konkurrencës dhe target grupit të cilit i shërbehet më shumë dhe monitorimi i tyre në vazhdimësi,

-Sjellja e risive, ofertave të reja dhe produkteve më të diferencuara,

-Shfrytëzimi i softuerëve për planifikime strategjike dhe integrimi i teknologjive informatike në bizneset e tyre.

# Referencat

1. Barritt, Ch. & Alderman, F. Lee, *Creating a Reusable Learning Objects Strategy.* San Francisco, USA: Pfeiffer, 2004.

2. Ben, Etim Udoh and Agu. O. *The impact of strategic management on corporate performance of selected small business enterprises in cross river state,* International Journal of Current Research Vol. 4, Issue,11, pp.152-158, November, 2012.

3. Burnes, Bernard, *Managing Change*. 4th ed. London, UK: Pearson Educated Limited, 2004, fq. 207

4. Drucker, P.: *The Practice of Management*, Harper & Roë, Neë York, 1954.

5. Entrepreneurship and Small Business Development in Kosovo, Research report, Prishtinë, Mars 2011

6. Enver A. Kutllovci, *Menaxhimi i resurseve njerëzore (Qasja strategjike*), Prishtinë, Qershor 2014.

7. Fred R. David, „*Menaxhimi Strategjik – Koncepte dhe rastet studimore*“, Botimi i 13-të, Prishtinë, Janar 2014, (Përkthimi Shqip)

8. Gary Gorman, Dennis Hanlon, Ëayne King, *Some research perspectives on entrepreneurship education, enterprise education and education for small business management: a ten-year literature revieë*. International Small Business Journal, April-June 1997 v15 n3p56(22), fq. 13

9. Government programme for prevention of informal economy in Kosovo 2010 – 2012.

10. Graham Beaver & Caroline Ross, *Strategic Change* , (1999), 251-261

11.Martie-Louise Verreynne & Denny Meyer, *Small business strategyand the industry life cycle,* Springer Science+Business Media, LLC. 2008, Small Bus Econ (2010) 35:399–416, fq. 412

12. Peter M. Ginter, Ë. Jack Duncan, Linda E. Sëayne. *Strategic Management of Health Care Organizations.* 4th ed. Neë Jersey,USA: Blackëell Publishing, 2002.

13.Porter, E. Michael: *Ëhat is Strategy*, Harvard Business Revieë, Boston, USA,2001

14.Robert A. Blackburn, Mark Hart, Thomas Ëainëright, *"Smallbusiness performance: business, strategy and oëner-managercharacteristics",* Journal of Small Business and Enterprise Development, Vol. 20 Iss: 1, pp.8 – 27

15. Skokan Karel, Paëliczek Adam, Piszczur Radomír, *Strategic Planning and Business Performance of Micro, Small and Medium- Sized Enterprises,* Journal of Competitiveness, Vol. 5, Issue 4, pp.57-72, December 2013.

16. Vasilika Kume, *“Manaxhimi strategjik”,* Pegi, Tiranë , 2010.

17. Wood, B. Marian, 2005. *The Marketing Plan Handbook***.** 2nd ed. Neë Jersey, USA: Pearson Prentice Hall 20 Iss 1 pp. 8 – 27.

**"PAPUNËSIA STRUKTURORE TEK TË RINJËT"**

**Vlora Dulatahu – Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë**


## Abstract

Unemployment in our country is becoming a more pronounced phenomenon, given the length of transition. We have many young graduates, but we can't find a job. These graduates, after leaving the university banks, try to find a job by matching the tire qualification. But those desperate, certainly disappointed, curse themselves that they can't reward their parents for the ass for years for financial sacrifices to be educated. It follows many young people who finish high school, choose abandoned school, and attempt to emigrate in search of a job as simple as to survive. And how to find a solution for hiring young people is the right question for this phenomenon without solutions. And perhaps the answer lies in the creation of a program, even the government, the political parties during the electoral campaign, which has a positive effect and at the same time employing viable employment policies and not slogans like "opening up thousands of jobs to young people "etc.Structural unemployment occurs due to the discrepancy between available jobs and workers. Technological progress has led to people being replaced by cars, and as a result, unemployment has increased. In this paper we will examine the causes of structural unemployment, its benefits and its evil, problems and policies for overcoming this unemployment.


***Keywords:Unemployment, structural unemployment, youth, etc.***

### Hyrje

Problemet e papunësisë janë sa sociale, aq komplekse, sa të pazgjidhura, aq me pasoja, kryesisht tek të rinjët, por edhe për të ardhmen e vendit tonë. Papunësia shkakton zhvlerësimin e kapitalit human. Një papunësi e zgjatur ulë në mënyrë serioze vlerën e një investimi të kryer në kapitalin human. Ekonomistët shqetësohen shumë për papunësinë strukturore. Në thelb kjo bie poshtë për individët e papunë të cilët nuk kanë aftësitë e nevojshme për punët në dispozicion, kështu që ata mbeten të papunë (ose braktisin fuqinë punëtore). Zgjidhja e problemeve strukturore të papunësisë është shumë më sfiduese. Kjo kërkon rikualifikimin e punëtorëve, ndoshta duke përfshirë zhvendosjen, që është edhe kohë dhe e shtrenjtë. Njerëzit të cilët nuk janë duke punuar, por janë në kërkim dhe janë në dispozicion për punë në çdo kohë, konsiderohen të papunë. Njerëzit strukturorë të papunë zakonisht kanë aftësi që nuk janë të nevojshme në treg ose kanë një sfond ose eksperiencë të specializuar që nuk mund të përdoret në tregun aktual. Zakonisht është rezultat i një ndryshimi në gjendjen ekonomike të një industrie ose rajoni, shpesh një fatkeqësie natyrore ose futja e një konkurrenti apo tregu të ri. Fatkeqësitë natyrore, të tilla si uraganet, kanë fshirë të gjitha industritë në rajonet gjeografike duke e lënë të papunësuar strukturën e fuqisë punëtore. Papunësia strukturore shpesh konsiderohet e përhershme pasi që shumë punëtorë janë të vështirë për të mësuar një set të ri të aftësive ose për të shkuar në një fushë ku aftësitë e tilla ende janë në kërkesë. Politikat dhe programet e qeverisë mund të vendosen për të parandaluar ndonjëherë papunësinë e tillë; megjithatë, politikat e stimuluara (p.sh. aktivitetet për të rritur nivelin e aktivitetit të biznesit) zakonisht nuk eliminojnë ose pakësojnë papunësinë strukturore - tregu thjesht nuk mund të shfrytëzojë më aftësitë. Papunësia

strukturore është forma më e zakonshme e papunësisë. Heqja e këtyre vendeve të punës nga tregu do të thotë hapja e vendeve të reja të punës që kërkojnë aftësi të ndryshme.

**Definimi i papunësisë**

Papunësia paraqet përqindjen e të papunësuarve nga tërë kapaciteti i fuqisë punëtore në një territor të caktuar brenda një vendi apo në tërë vendin. Pra, ky indikator ekonomik tregon nivelin e fuqisë punëtore të pashfrytëzuar në proceset ekonomike në një territor gjeografik. Sipas klasifikimit të Bashkimit Evropian të papunësuar janë ata pjesëtarë të fuqisë punëtore të cilët nuk kanë pasur punë gjatë javës kur është bërë studimi, aktivisht kanë kërkuar punë gjatë asaj jave dhe janë të gatshëm të nisin një punë gjatë dy javëve të ardhshme. (Wikipedia, 2015). Papunësia është përcaktuar nga Byroja e Statistikave të Punës si njerëz që nuk kanë punë, kanë kërkuar në mënyrë aktive punën për katër javët e fundit dhe aktualisht janë në dispozicion për punë. Gjithashtu, personat që ishin përkohësisht të pushuar nga puna dhe ishin në pritje për t'u thirrur në atë punë janë përfshirë në statistikat e papunësisë. (Amadeo, the balance, 2018). Papunësia konsiderohet si një sëmundje e rëndë makroekonomike, për rrjedhojë ajo kërkon një vëmendje të veçantë. Papunësia është një problem themelor që i nënshtrohet analizave më të gjera në Ekonomiksin e punës. Kur norma e papunësisë në vendet e zhvilluara kapitaliste ishte në nivele të ulëta, deri në 4%, siç ishte deri në vitet e 1960, ajo nuk përbënte ndonjë problem shqetësues për ekonomistët e Ekonomiksit të punës. Por kur ajo filloi të rritet nga 6% në fillim të viteve 1970 në 7 apo 8% në fund të viteve 1970 dhe kur arriti në 10% në fillim të viteve 1980, ajo nuk mund të lihej jashtë vëmendjes së analizave të ekonomistëve që merreshin me problemet e tregut të punës. Në ditët e sotme pranohet pothuajse nga të gjithë ekonomistët se papunësia është një problem jashtëzakonisht kompleks dhe një dukuri tepër e ndryshueshme. (Qiriqi, 2005).

## 1.1. Papunësia tek të rinjtë

Papunësia ndër të rinjtë është një çështje shqetësuese pothuajse në të gjitha vendet në tranzicion. Norma e papunësisë për personat e moshës deri në 24 vjeq në vendet e Ballkanit është përafërsisht dy deri në tri herë më e lartë se sa norma e përgjithshme e papunësisë dhe kjo normë është prej 18% dhe 20.8% në Slloveni dhe Rumani respektivisht deri në 68.6% në IRJ Maqedonisë.[71] Viteve të fundit papunësia për të rinjtë e moshës deri në 29 vjeq përbëjnë rreth 50% të të papunëve në disa vende. Në Shqipëri rreth 58% të të papunëve janë deri në moshën 31 vjeqare derisa në Kroaci rreth 53.9% e të papunëve janë deri në këtë moshë. Të dhënat në disponim nga vendet në tranzicion tregojnë se norma e papunësisë për të rinjtë është rreth dy herë më e lartë se sa norma e përgjithshme e papunësisë. Në fillim të viteve të '90-ta (kur proçesi i tranzicionit filloi), mendohej se norma e papunësisë për të rinjtë ishtë një problem i përkohshëm sepse këta persona do të gjenin punë për shkak të aftësive të tyre për tu përshtatur kushteve të reja dhe aftësive të tyre për të përvetësuar lehtë njohuritë dhe aftësitë e reja që kërkoheshin nga tregu i punës. Më vonë u pa se norma e papunësisë për këta persona lidhet me nivelin e tyre të edukimit, sistemin e trajnimit dhe ritrajnimit në nivel kombëtar. Duke pasur parasysh natyrën e ngurtë (jofleksibile) të tregut të punës dhe kohën e nevojshme për reforma në sistemin e edukimit dhe trajnimit, papunësia për të rinjtë u bë një problem serioz dhe shumë të rinj të papunë u bënë të papunë afatgjatë. Në Kosovë ky problem duket të jetë më i rendë se në vendet tjera duke pasur parasysh popullsinë shumë të re. Siç shihet në tabelën më poshtë, norma e papunësisë për personat e moshës 16 deri 24 është afërsisht dy herë më e lartë se norma e përgjithshme e papunësisë. Raporti i normës së papunësisë për të rinjtë ndaj normës së përgjithshme të papunësisë është 1.46. Krahasuar me grupmoshat tjera, papunësia për të rinjtë është dy herë më e lartë se sa për ata të papunë të moshës 40-54 dhe 55-64. Bazuar në AFP-në e vitit 2015, 27.4% e të papunëve në Kosovë ishin të rinj (të moshes 15-24 vjeç) me pothuajse

[71] European Training Foundation (2000): Seminar regjional mbi papunësinë e të rinjëve në Evropën Juglindore; Velingrad, Qershor 2000

shtatë pike diferencë midis meshkujve dhe femrave. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së re është e papunë (57.7 %) dhe shkalla e papunësisë tek rinia e gjinisë femërore është më e lartë (67.2%) krahasuar me meshkujt (54.2%).

### 1.2. Papunësia Strukturore

Ekonomia e tregut është dinamike. Si pasojë e kësaj dinamike shfaqen mallra dhe shërbime të reja, duke reduktuar kërkesën për mallrat zëvendësues të tyre. Zhvillohen teknologji të reja të prodhimit, të cilat e ndryshojnë direkt kërkesën për punë. Rezultati i ndryshimeve është se niveli i punësimit do të rritet në disa degë të ekonomisë dhe do të bjerë në disa degë të tjera të saj. Për rrjedhojë faktori punë duhet të rishpërndahet nga njëra degë në tjetrën apo nga pikëpamja gjeografike nga njëri vend në tjetrin. Kur një individ bëhet i papunë në një sektor të ekonomisë që është në rënie nuk i përshtatet llojeve të punëve që lindin në degët që zhvillohen atëherë themi se kemi të bëjmë me llojin e papunësisë strukturore. (Qiriqi, 2005). Papunësia strukturore përshkruan një formë të papunësisë që del nga një mospërputhje ndërmjet aftësive të ofruara nga punëtorët dhe aftësive të kërkuara nga punëdhënësit. Kjo situatë zakonisht ndodh për shkak të ndryshimeve në demografi, riorganizim industrial, ose inovacion teknologjik. Për t'iu përshtatur këtyre ndryshimeve, firmat vazhdimisht kanë nevojë për aftësi të reja, ndërsa disa aftësi ekzistuese bëhen të vjetruara. Si rezultat, disa punonjës do ta kenë të vështirë të gjejnë një punë të re, sepse grupi i tyre i aftësive thjesht nuk është i nevojshëm. Për ta ilustruar këtë, mendoni për makinat. Përpara se automjeti të ishte shpikur, njerëzit udhëtonin me karroca me kuaj. Kështu, kërkesa për trajnerë ishte e lartë. Megjithatë, pas shpikjes së automobilave, tregu për karrocat me kuaj përfundimisht u rrëzua dhe u bë gjithnjë e më e vështirë për trajnerët të gjejnë punë. (Quickonomics, 2018). Çdo punëtor është i ndryshëm; çdo punë ka karakteristikat dhe kërkesat e tij të veçanta. Kualifikimet e punëkërkuesve mund të mos përputhen me ato që firmat kërkojnë. Edhe në qoftë se numri i të punësuarve firmat kërkojnë të barabartë me numrin e punëtorëve në dispozicion, njerëzit kualifikimet e të cilave nuk i plotësojnë ato që firmat kërkojnë, do të gjejnë veten pa punë. Papunësia që rezulton nga një mospërputhje ndërmjet kualifikimeve të punonjësve dhe karakteristikave që kërkojnë punëdhënësit quhet papunësia strukturore. Papunësia strukturore shfaqet për disa arsye. Ndryshimi teknologjik mund të bëjë disa aftësi të vjetëruara ose të kërkojnë ato të reja. Për shembull, prezantimi i gjerë i kompjuterave personal që nga viti 1980, ka ulur kërkesën për tipografët që nuk kishin aftësi kompjuterike. Papunësia strukturore mund të ndodhë nëse shumë ose shumë pak punëtorë kërkojnë trajnim ose arsimim që përputhet me kërkesat e punës. Nxënësit nuk mund të parashikojnë saktësisht se sa vende pune do të jenë në një kategori të caktuar kur ata të diplomohen, dhe ata nuk kanë gjasa të dinë se sa prej nxënësve të tyre po trajnohen për këto punë. Papunësia strukturore lehtë mund të ndodhë nëse studentët mendojnë gabim se sa punëtorë do të nevojiten ose sa do të furnizohen. Papunësia strukturore gjithashtu mund të rezultojë nga mospërputhjet gjeografike. Aktiviteti ekonomik mund të lulëzojë në një rajon dhe të zhytet në një tjetër. Do të duhet kohë që punëtorët e papunë të zhvendosen dhe të gjejnë punë të reja. Dhe transporti i dobët ose i kushtueshëm mund të bllokojë disa banorë urbanë nga marrja e punëve vetëm disa kilometra larg. (ER services). Një recesion i gjatë shpesh krijon papunësi strukturore. Nëse punëtorët qëndrojnë të papunë për një kohë të gjatë, aftësitë e tyre kanë gjasa të bëhen të vjetëruara. Nëse nuk janë të gatshëm dhe të aftë për të marrë një punë të pakualifikuar, ata mund të qëndrojnë të papunë edhe kur ekonomia të rimëkëmbet. Nëse kjo ndodh, papunësia strukturore çon në një shkallë më të lartë të papunësisë natyrore. (Amadeo, the balance, 2018).

#### 1.2.1. Shkaqet e papunësisë strukturore

- Mospërputhjet gjeografike - Kjo ndodh kur punëtorët nuk janë në gjendje të lëvizin nga zonat e papunësisë së lartë në zona me mungesa të krahut të punës. Kjo mund të ndodhë për shkak të vështirësive të blerjes / dhënies me qira të një shtëpie. Kjo gjithashtu mund të jetë për shkak të lidhjeve familjare në zonën e tyre aktuale.

- Imobilitet në punë. Kjo ndodh pas ndryshimeve në ekonomi, të cilat çojnë në zhvendosjen e kërkesës për punë të kualifikuar. Për shembull, nëse ka një mbyllje të firmave prodhuese, punëtorët me aftësi për këto lloje të punëve mund të përpiqen të zhvendosen në industri të reja ku kërkohen shkathtësi shumë të ndryshme (p.sh. aftësitë e TI, mësimdhënien, kontabilitetin). Duhen kohë që njerëzit të ritrajnojnë dhe punëtorët e moshuar mund të mendojnë se është shumë e vështirë.
- Zëvendësimi i fuqisë punëtore me makina etj.

Nga perspektiva individuale, papunësia strukturore shkaktohet nga:

- Pamundësia për të përballuar ose vendimin për të mos ndjekur shkollimin e mëtutjeshëm ose trajnimin për punë
- Zgjedhja e një fushe studimi e cila nuk ka prodhuar shkathtësi të tregut të punës
- Pamundësia për të lejuar zhvendosjen
- Pamundësia për të shitur një shtëpi
- Vendimi për të mos u zhvendosur, për të qëndruar me një bashkëshort, familje, miq, etj. (Report, 2013).

Nga një këndvështrim më i madh, mund të ketë një numër arsyesh për papunësinë strukturore në një numër të madh të punëtorëve:

- Vullneti teknologjik bën një ekspertizë të veçantë të padobishme. Për shembull, kërkesa për shkrimtarët manualë u zhduk me digjitalizimin e prodhimit të pllakave të shtypjes.
- Rritja e produktivitetit zvogëlon numrin e punëtorëve (me aftësi të njëjta ose të ngjashme) të nevojshme për të kënaqur kërkesën.
- Teknologjia e re rrit ndjeshëm produktivitetin, por kërkon një numër më të ulët të punëtorëve me kualifikim më të lartë. Për shembull, nevojiten më pak punonjës bujqësorë kur puna është e mekanizuar; ato që mbeten duhet të trajnohen për të përdorur pajisjet. Një tjetër shembull i zakonshëm është përdorimi i robotëve industrialë për të automatizuar prodhimin.
- Konkurrenca shkakton të njëjtat vende pune për të kaluar në një vendndodhje të ndryshme dhe punëtorët nuk mund të ndjekin.
- Globalizimi ka shkaktuar që shumë vende të prodhimit të zhvendosen nga vendet me paga të larta në vendet me paga të ulëta.
- Marrëveshjet e tregtisë së lirë mund të bëjnë që punët të lëvizin si ndryshime në avantazh konkurrues.
- Ndryshimet politike, për shembull shembja e Bashkimit Sovjetik etj. (Atlanta, 2012).

### 1.2.2. E keqja e papunësisë strukturore

Ashtu si shumica e burimeve të papunësisë, papunësia strukturore nënkupton vështirësitë personale dhe prodhimin e humbur.

- Vështirësitë personale: Problemi kryesor me papunësinë strukturore është vështirësitë personale që u shkaktohen punonjësve të papunë. Edhe nëse punëtorët e strukturuar pa punë marrin të ardhura nga kompensimi i papunësisë, mirëqenia dhe pagesa të tjera të transferimit, ata nuk mund të blejnë sa më shumë mallra dhe shërbime dhe kështu përjetojnë një rënie në standardet e jetesës. Ekzistojnë edhe vështirësitë psikologjike të përjetuara nga punëtorët e strukturuar të papunë. Njerëzit në përgjithësi nxjerrin një ndjenjë të "vetëbesimit" nga puna e tyre, që dikush e vlerëson punën e tyre dhe u pëlqen aq sa t'u japë atyre një pagesë pagash. Ndërsa të gjithë punëtorët e papunë e humbin këtë përforcim të vetëvlerësimit, për punëtorët e strukturuar të papunë humbja mund të jetë veçanërisht shkatërruese.
- Prodhimi i humbur: Sigurisht, kur një person bëhet i papunë, ekonomia humbet nga aktiviteti i tij produktiv. Dobësitë e papunësisë strukturore përgjithësisht janë më të këqija se ato të papunësisë ciklike apo fërkimit. Papunësia strukturore tenton të zgjasë dukshëm më shumë se llojet e tjera të papunësisë, jo vetëm disa javë ose muaj, por shpesh vite.

### 1.2.3. E mira e papunësisë strukturore

Prodhimi i humbur dhe vështirësitë personale sigurisht që janë të padëshirueshme, por duhet të peshohen kundër përfitimeve që lidhen me papunësinë strukturore. Papunësia strukturore është një pjesë e natyrshme e çdo ekonomie në rritje, zgjerim dhe prosperitet të nxitur nga përparimet teknologjike. Një progres i tillë teknologjik përmirëson standardet e jetesës për shumicën e anëtarëve të shoqërisë. Njerëzit janë më të mirë me teknologjinë e re se sa ishin me të vjetrën. Eliminimi i papunësisë strukturore mund të arrihet duke parandaluar çdo përparim teknologjik. Asnjë punëtor kurrë nuk do të bëhej i papunë, sepse aftësitë ekzistuese nuk përputhen me prodhimin e kërkuar. Sigurisht, kjo strategji parandalon gjithashtu përmirësimin e standardeve të jetesës. (AmosWEB).

### 1.2.4. Politikat për të kapërcyer papunësinë strukturore

- ***Arsimi / trajnimi.*** Këto skema trajnuese duhet të fokusohen në aftësitë dhe kualifikimet të cilat do t'u mundësojnë të papunëve të gjejnë punë në industri të reja. Kjo mund të përfshijë qeverinë që paguan skemat e trajnimit në aftësitë që janë në mungesë të furnizimit. Për shembull, trajnime profesionale si muratorë / hidraulik / elektricist ose pleqsh. Nëse punëtorët përfitojnë nga skemat e trajnimit, atëherë ata mund të shkojnë dhe të punojnë për firma të tjera. Nëse qeveria paguan koston e plotë ose subvencionon firmat, ajo ndihmon në kapërcimin e këtij dështimi të tregut.
- ***Subvencione për strehim***. Me papunësinë gjeografike, qeveria mund të ofrojë përfitime strehimi për të ndihmuar të papunët të marrin punë në zona të shtrenjta të punësimit të lartë. Megjithatë, kjo mund të jetë mjaft e shtrenjtë dhe mund të jetë e vështirë të vlerësohet se kush ka nevojë për përfitimet e strehimit dhe për sa kohë. Një zgjidhje afatgjatë ndoshta për qeverinë që të ndërtojë shtëpi në zona të shtrenjta.
- ***Subvencionet e punëdhënësit.*** Në vend që të inkurajojnë punëtorët për të lëvizur, qeveria mund të ofrojë stimuj për firmat që të zhvendosen në zonat në depresion.
- ***Fleksibiliteti i tregut të punës***. Ekonomistët e tregut të lirë vënë theks më të madh në përmirësimin e fleksibilitetit të tregut të punës. Për shembull, duke lejuar me kohë të pjesshme, puna e përkohshme siguron më shumë mundësi për të papunët për të fituar mundësi të reja. Sidoqoftë, këto vende pune janë më të pasigurta, shpesh të paguara më pak dhe çojnë në një formë të nënpunësimit.

## Përfundimi

Pra qëllimi i këtij hulumtimi ishte shpjegimi strukturor i papunësisë së të rinjve, i cili pohon se punët kanë kërkuar gjithnjë e më shumë punëtorë me aftësi ose atribute të tjera që zakonisht nuk posedohen nga të rinjtë dhe se të rinjtë nuk kanë arritur të përshtaten me këtë situatë. Ka arsye të mirë për të besuar se një pjesë e papunësisë është për shkak të problemeve strukturore afatgjata. Kjo do të thotë se një pjesë e papunësisë vjen nga firmat që kanë shkarkuar punëtorë nga vendet e punës që nuk ekzistojnë më. Kjo nuk është shkaktuar nga kërkesa e mangët; kjo ndodh kur një ekonomi kalon një ndryshim strukturor (më shumë globalizim, teknologji të re, taksat përgjithmonë më të larta) që çon në një ndryshim të përhershëm të kërkesës për punë dhe aftësi. Për të përmirësuar këtë lloj papunësie kërkon zgjidhje më delikate afatgjata. Shkaku kryesor i papunësisë duket të jetë paqëndrueshmëria e punës. Pra, problemi mund të zgjidhet duke rritur lëvizshmërinë e punës dhe aktivitetet e kërkimit (punë) në mënyrë që të ketë më shumë informacion. Megjithatë, zgjidhja e vërtetë qëndron në miratimin e politikave të menaxhimit të kërkesës, dmth., politikat monetare dhe fiskale. Në të kaluarën, qëndrueshmëria afatgjatë e punës nuk ka ardhur që kompanitë ekzistuese të punësohen përsëri, por nga kompanitë e reja, të

vogla që krijojnë vende pune. Firmat më të reja janë ata që krijojnë vende pune dhe për shkak se shumica e kompanive fillojnë të vogla, firmat e vogla kanë më shumë gjasa të krijojnë vende pune. Në shumë mënyra kjo nuk është lajm, ne e dimë se start-ups e mbajnë ekonominë dinamike, konkurruese dhe inovative

## Bibliography

Abdul M. M., A. S. (2011). *Work-Family Psychological Contract as a Mediator in the Relationships between WorkFamily Factors and Organizational Commitment* , 228-235.

Aiyegbusi, J. T. (2000). *Communication of effective classroom instruction* , 31-35.

Amadeo, K. (2018, Prill 03). *the balance*. Retrieved from https://www.thebalance.com/what-is-unemployment-3306222

Amadeo, K. (2018, Mars 14). *the balance*. Retrieved from https://www.thebalance.com/types-of-unemployment-3305522

*AmosWEB*. (n.d.). Retrieved from http://www.amosweb.com/cgi-bin/awb_nav.pl?s=wpd&c=dsp&k=structural+unemployment

Atlanta, F. R. (2012, Prill 9). Retrieved from https://en.wikipedia.org/wiki/Structural_unemployment

Benard, C. I. (1938). *"Functions of the Executive".* Cambridge: Harvard University Press.

Davis, M. (1994). *"Managing corporate culture".* Cambridge Ma: fq. 12-25.

Deel, & Kenny. (1982). *"Corporate Cultures".* Usa Mass: Addison-Wesleu.

Drucker. (1995). *"Managing in a time of great change,".* Dutton: Tureman Talley Books.

Edgar, S. (1991). *"Organizational Culture and Leadership".* San Francisko: Beass Pub, fq. 9, 36-47.

*ER services*. (n.d.). Retrieved from https://courses.lumenlearning.com/suny-macroeconomics/chapter/types-of-unemployment/

Figen, E. T. (2011). *Occupational Stress of Teachers.*

Fiore, D. J. (2004). *Introduction to educational administration: Standards,.* New York.

Galotti, K. M. (2006). "Decision-making styles in a real-life decision: Choosing a college major. Personality and. 629-639.

Gantasala, V. P. (2011). *Antecedent HRM Practices for Organizational Commitment.*

Greenberg, J. (1987). 157-159.

Ilozor, B. D. (2000). *The Impact of Work Settings on Organisational Performance Measures in Built Facilities.*

Ilozor, B. D. (2002). *The Impact of Work Settings on Organisational Performance Measures in Built Facilities.*

Imberman, W. (2003). What's your ROI on Human Assets? *Magazine of Foundry Management & Technology* , 35-38.

Isaiah O. Ugboro. (2006). *Organizational Commitment, Job Redesign, Employee Empowerment and Intent to Quit Among Survivors of Restructuring and Downsizing.* Carolina.

J. P. Meyer, L. H. (2001). Commitment in the Workplace Toward a General Model. *uman Resource Management Review* , 299-326.

Joanna, W. (2010). Influence of superiorsubordinate communication on employee satisfaction. *Journal of Positive Psychology* , 110-124.

Judy, G. a. (2004). *Improving the Measurement of Communication Satisfaction.*

Khawaja, J. A. (2013). Organizational Commitment and Turnover Intentions: Impact of Employee's Training in Private. *International Journal of Business and Management , 8*.

Krugman, P. (2015). *Economics.* New York.

Macey, W. H. (2009). *"Employment Engagement": Tools for Analysisk, practise and competetive advantage.* Valtera Coorporation.

Macey, W., & Schneider. (2008). The meaning of employee engagement. *Industrial and organizational psychology* , 3-30.

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

# ZHVILLIMI I NDËRMARRËSISË - NDRYSHIMET DHE REZISTENCA NDAJ NDRYSHIMEVE NË NDËRMARRJE

**Elza Qorraj**

**Universiteti Kadri Zeka - Gjilan - Fakulteti Ekonomik**

## ABSTRAKT

Duke e ndjerë nevojën dhe rendësinë e rritjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve, ne do të vlerësojmë elementet e përgjithshme që do të ndikonin tek rritja dhe zhvillimi i ndërmarrësisë, respektivist duke analizuar ndryshimet dhe rezistencën ndaj ndryshimeve në ndërmarrje.

Ndërmarrjet për të qëndruar në treg ato detyrohen ti përshtaten ndryshimeve të tregut.

Ndryshimi është një proces i zakonshëm, që ndodh në të gjitha organizatat, pavarësisht madhësisë, aktivitetit, vjetërsisë apo edhe sistemit ekonomik dhe juridik.

Përmes këtij studimi, do të hulumtojmë shkaqet praktike, teorike dhe shkencore, të cilat, si të tilla, janë të pranishme në Kosovë. Kërkimin tonë, e kemi realizuar duke përdorur një pytësorë për ndërmarrësit e regjioneve të ndryshme në Kosovë. Ndryshimi është një proces i zakonshëm, që ndodh në të gjitha organizatat, pavarësisht madhësisë, aktivitetit, vjetërsisë apo edhe sistemit ekonomik dhe juridik.

Pyetja qenësore, në këtë studim është: Si ndikojnë ndryshimet dhe rezistenca ndaj ndryshimeve në zhvillimin e ndërmarrjës?

Gjatë studimit tonë, kemi testuar hipotezat e ngritura që kryesisht qëndrojnë.

Përkatësisht, hipoteza 1: Zhvillimi i ndërmarrjeve në Kosovë dhe qasja zhvillimore e tyre ndikohen nga ndryshimet e ndërmarrësve dmth sipas analizes sonë ndryshimi ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillim e ndërmarrjes.

dhe hipoteza 2: Zhvillimi i ndërmarrjeve në Kosovë në masë të madhe ndikohet nga rezistenca ndaj ndryshimeve ndërmarrësve marrë parasysh strukturen e tregut dhe strukturen ekonomike të vendeve në tranzicion.

Si rrjedhojë, ky studim në masë të caktuar përpiqet që t'iu shërbejë Institucioneve publike, qeverise, institucioneve te arsimit te lartë, ndërmarrësve por edhe aktereve të tjerë gjithnjë duke i bërë të qartë rëndësinë imediate të nivelit të ndryshimeve në zhvillimin e ndërmarrësise.

***Fjalët kyqe:*** *Ndërmarrje, zhvillim, ndryshim, rezistencë, Kosovë.*

## HYRJE

Mjedisi biznesor është duke ndryshuar shpejt, kështu që edhe ndërmarrjet, gjithashtu, duhet të ndryshojnë me një dinamikë të shpejtuar, nëse dëshirojnë të jenë në hap me këto trende. Në botën perëndimore zhvillimi i ndërmarrjeve-bizneseve ka ndodhur duke u bazuar në "ndërmarrjen e lirë", "zhvillimin në bazë të kapitalit-kapitalizmit" dhe "tregun me konkurrencë".

Ndryshimi është një proces i zakonshëm, që ndodh në të gjitha organizatat, pavarësisht madhësisë, aktivitetit, vjetërsisë apo edhe sistemit ekonomik dhe juridik.

Pyetja qenësore, në këtë studim është: Si ndikojnë ndryshimet dhe rezistenca ndaj ndryshimeve në zhvillimin e ndërmarrjës?

Gjatë studimit tonë, kemi testuar hipotezat e ngritura që kryesisht qëndrojnë.

Përkatësisht, hipoteza 1: Zhvillimi i ndërmarrjeve në Kosovë dhe qasja zhvillimore e tyre ndikohen nga ndryshimet e ndërmarrësve dmth sipas analizes sonë ndryshimi ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillim e ndërmarrjes.

dhe hipoteza 2: Zhvillimi i ndërmarrjeve në Kosovë në masë të madhe ndikohet nga rezistenca ndaj ndryshimeve ndërmarrësve marrë parasysh strukturen e tregut dhe strukturen ekonomike të vendeve në tranzicion.

## NDËRMARRËSIA

Fjalandërmarresi vjen nga fjala frenge’’entrepreneur” që do të thotë të ndërmarrësh diçka R.Cantilon ishte i pari që e përdori këtë term.

Peter Drucker paraqitjen e ndërmarrësisë e quan si “ngjarjen me shpresëdhënëse” sepse ajo nxit ndryshimet e shpeshta, shfrytëzon shanset që të tjerët nuk i shohin, krijon diqka ndryshe dhe bënë që nevoja për risi (inovacione) të jetë e përhershme;

Ndërmarresia është një proces i krijimit të një gjëje që është ndryshe nga ajo që ekziston dhe që ka vlerë në sajë të dedikimit të kohës dhe të përpjekjeve, duke perfshirë rrezikun financiar, fizik dhe social për të ndërtuar një shpërblim financiar ose një kënaqesi personale.

Richard Cantillon, (1725): Ndërmarrësi është një person që paguan një çmim të caktuar për një produkt për ta rishitur atë me një çmim të pasigurt, duke marrë në këtë mënyrë vendime për sigurimin dhe përdorimin e burimeve e për pasojë duke pranuar edhe rrezikun e sipërmarrjes.

J.B. Thuaj (1803): Ndërmarrësi është një agjent ekonomik që bashkon të gjitha mjetet e prodhimit - tokën e dikujt, forcën punëtore të dikujt tjetër dhe kapitalin përsëri të dikujt tjetër dhe në këtë mënyrë prodhon një produkt.

David McClleland, (1961): Ndërmarrësi është një person me kërkesa të mëdha për të arritur diçka, është mjaft energjik dhe bartës i rrezikut.

Peter Drucker, (1964): Ndërmarrësi është në kërkim të ndryshimit, i përgjigjet atij dhe shfrytëzon mundësitë.

Albert Shapero, (1975): Ndërmarrësi merr iniciativën, pranon rrezikun e dështimit dhe ka një fokus të brendshëm të kontrollit të zhvilluar.

Ndërmarrës mund të konsiderohet ai person që krijon një biznes, duke u ballafaquar me rrezikun, duke synuar realizimin e fitimit dhe rritjen e biznesit, duke përfituar nga shanset dhe aftesia për të siguruar dhe menaxhuar resurset.

Ndërmarresi ka aftesi që një ide profitabile ta shnderrojë në realitet.

Alfred Marshall ishte i pari që njohu zyrtarisht rëndësinë e ndërmarrësisë si një faktor prodhimi. Ai tha: toka, puna, kapitali dhe organizimi janë faktorë prodhimi për ta zëvendësuar këtë të fundit me ndërmarrësinë.

Ndërmarrësia kontribonë në tërësinë e pasurisë shoqërore, duke krijuar tregje të reja, industri të reja, teknologji të reja, forma të reja institucionale, vende të reja pune dhe rritje neto të produktivitetit real.

Përfitimet socio-ekonomike nga ndërmarrësia janë:

*1. Ndërmarrësia krijon punësim*

*2. Ndërmarrësia përmirëson cilësinë e jetës.*

*3.Ndërmarrësia kontribuon për një shpërndarje më të barabartë të të ardhurave.*

*4. Ndërmarrësia përdor burimet.*

*5. Ndërmarrësia sjell përfitimet sociale përmes investimve qeveritare.*

## MODELE DHE KARAKTERISTIKA TË ZHVILLIMIT DHE RRITJES SË NDËRMARRJEVE

Teoria e ciklit të jetës së ndërmarrjes është një teori e rëndësishme për shkak të shpjegimeve që ajo sjell rreth karakteristikave të ndërmarrjes në faza të ndryshme zhvillimi të jetës së tyre (Miller & Friesen, 1984).

Si Mac an Bhaird (2010) ka përmbledhur modeli i fazave ose teoria e ciklit të jetës së ndërmarrjes e ka origjinën kryesisht prej literaturës së ekonomiksit (Penrose 1952, 1959; Rostow 1960), dhe përdoret zakonisht për të përshkruar evolucionin e ndërmarrjës së suksesshme gjatë fazave të rritjes.

Sipas një analogjie biologjike ky cikël i ekzistencës së ndërmarrjes mund të përshkruhet si lindja, rritja dhe rënia. Por ndonjëherë ndërmarrja mund të rizgjohen ose ndonjëherë edhe të zhduken krejt (Kimberly & Miles 1980; siç është cituar në Mac an Bhaird 2010).

Brankov gjithashtu shpjegon se evoluimi i ndërmarrjes përgjithësisht përshkruhet prej lindjes, në rritje, rigjenerim dhe deri në fazen e rënies (Miller & Friesen, 1984). Në fazën e lindjes një ndërmarrje e re duket se thjeshtë synon të bëhet një ndërmarrje ekzistente. Faza e rritjes karakterizohet nga një rritje e shpejtë e nivelit të shitjeve dhe krijimit të kompetencave dalluese, gjithashtu gjatë kësaj faze vihet re një strukturë funksionale, si dhe stile më të decentralizuara vendim-marrje dhe procedura më formale.

Brankov (2011) ka treguar se faza e maturimit ndodh kur niveli i shitjeve stabilizohet dhe niveli i inovacionit bie. Ndërmarrja në këtë fazë në vend që të përqendrohen tek inovacioni kërkon të mbrojnë atë çfarë kanë krijuar ndaj dhe menaxhimi ose drejtimi përqendrohet tek planifikimi dhe strategjia, ndërsa formalizimi dhe kontrolli në këtë fazë janë bërë tashmë një rregull.Faza e rënies është e karakterizuar nga rënia e rentabilitetit (fitimit) për shkak të sfidave të jashtme dhe mungesës së inovacionit, ndërsa kontrolli dhe vendimmarrja tentojnë të centralizohen (Lester & Parnell, 2008; Miller & Friesen, 1984).

Në kushtet e konkurrencës së sotme të gjitha ndërmarrjet pavarësisht moshës dhe jetëgjatësisë së tyre, në mënyrë që të mbijetojnë apo dhe të konkurrojnë duhet sigurisht të zhvillojnë dhe implementojnë strategji sipërmarrëse.Ndërsa ndërmarrja në thelb përqendrohet tek eksplorimi i oportuniteteve që shfaqen, lidhja me menaxhimin strategjik qëndron pikërisht në faktin se thelbi

i menaxhimit strategjik ka të bëj me mënyrën sesi këto oportunitete mund të shndërrohen në avantazhe konkurruese të qëndrueshme (siç është cituar në Kraus & Kauranen, 2009).

David Birch (1979) ka theksuar se ndërmarrjet e vogla krijojnë gati 90 përqind të vendeve të reja të punës, duke nxjerr edhe një herë në pah rolin e rëndësishëm që ka ndërmarrja dhe ndikimin e saj në rritjen ekonomike (siç është cituar në Kraus & Kauranen, 2009). Gjithashtu edhe të tjerë studiues (Brock & Evans, 1989; Carree & Thurik, 2000) e kanë përcaktuar ndërmarrjen si një nga faktorët kryesore të ekonomisë së çdo vendi, duke e konsideruar si një instrument të mirë për tu përballur me konkurrencën dhe ritmet e shpejta të ndryshimit të saj (Hitt & Reed, 2000).

Shpesh herë burimet e një ndërmarrje sipërmarrëse kanë gjasa të jenë jomateriale, si psh njohuri, dije apo teknologji e caktuar. Gjithashtu Ireland, Hitt, Camp & Sexton (2001), theksojnë se sjellja sipërmarrëse e ndërmarrjes identifikohet ose njehsohet përmes orientimit të sjelljes tek inovacioni, proaktiviteti dhe marrja e riskut (siç është cituar në Kraus & Kauranen, 2009).

## KONCEPTET THEMELORE TË MENAXHIMIT TËNDRYSHIMIT

*‘Sot ndryshimi është bërë pjesë e rëndësishme e manaxhimit strategjik në shumë organizata pasi liderat e kanë kuptuar që ne jetojmë në një shoqëri të përkohshme dhe duke sjellur vazhdimisht ndryshime mund t'i japim organizatës një avantazh konkurrues në ambjentin e brendshëm të biznesit dhe atë ndërkombëtar' (Stadtländer, 2006:17-18)*

Menaxherët duhet të ndërmarrin ndryshime organizative të moderuara të paktën një herë në vit dhe ndryshime të mëdha çdo katër apo pesë vite (Kotter & Schlesinger, 2008:132)

Ndryshimi është një proces i zakonshëm që ndodh në të gjitha organizatat, pavarësisht madhësisë, aktivitetit, vjetërsisë apo edhe sistemit juridik. Mjedisi biznesor është duke ndryshuar shpejt, kështu që edhe organizatat, gjithashtu, duhet të ndryshojnë me një dinamikë të shpejtuar, nëse dëshirojnë të jenë në hap me këto trende ndryshime të interferuara nga ndryshimi mjedisor, e sidomos ai sistemor. Koncepti i “menaxhimit të ndryshimeve” është diçka e njohur në shumicën e organizatave të sotshme.

Organizatat shfaqen në forma e madhësi të ndryshme, ofrojnë një shumëllojshmëri produktesh e shërbimesh dhe përballen me shumë sfida. ‘Ndoshta faktori i vetëm i përbashkët për të gjitha organizatat është ndryshimi' (Burnes 2009:397). Organizatat ndryshojnë sepse ambjenti rreth tyre asnjëherë nuk mbetet i njëjti (Hitt et al., 2009). Bërja e ndryshimeve dhe manaxhimi i këtij proçesi kanë qënë me rëndësi për organizatat gjatë gjithë kohës, e veçanërisht në ambjentin e sotëm. ‘Ndryshimi organizativ është aq i vjetër sa vetë organizatat. Ndoshta faraonët e Egjiptit të lashtë u përballen me nevojën për të ndryshuar organizatat që ndërtuan piramidat e tyre' (Burke, 2008:27).

Por, si i menaxhojnë organizatat (dhe sa të suksesshme janë ato) varet nga natyra e biznesit, njerëzit e përfshirë etj. Pjesa kyçe e kësaj varet nga ajo se sa njerëzit e përfshirë e kuptojnë procesin e ndryshimeve (Projekti ESTAK, Diana Osinski 2012, “Menaxhimi drejt rezultateve-menaxhimi i ndryshimit”).

Për të kuptuar më shumë procesin e menaxhimit të ndryshimeve është e nevojshme të kuptojmë se çka është menaxhimi?

Fjala menaxhim rrjedh nga fjala angleze “to manage”, për të cilën në gjuhën tonë përdoren shprehje si qeverisje, udhëheqje, drejtim etj. Nga kjo mund të nxjerrim edhe bazat e menaxhmentit, që do të thotë proces i orientimit të vetëdijshëm të aktiviteteve njerëzore kah realizimi i qëllimit të caktuar, gjegjësisht tërësinë e ndërlidhur të funksioneve si planifikimi,

organizimi, personeli, udhëheqja dhe kontrolli" (B. Ramosaj, "Bazat e menaxhimit", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2007).

Gjatë menaxhimit të organizatave të ndryshme shpeshherë lind nevoja për ndryshime. Këto ndryshime kanë për qëllim ose rritjen e vlerës aksionere të organizatës ose zhvillimin e aftësive njerëzore, duke rritur aftësinë e organizatës për t'iu përshtatur mjedisit afarist (B. Shedollari, "Ndryshimi në organizatë", disertacion i mbrojtur në Fakultetin Ekonomik të UT-së, Tiranë, 2009).

Organizatat duhet të ndryshojnë, sepse edhe ambienti ndryshon. Nga kjo del se ndryshimi nuk duhet të kuptohet si një konstantë (Victor&Franckeiss, 2002:35).

Sipas Rieley & Clarkson (2001:161), në organizata zakonisht mund të dëgjohen dyshqetësime, si: performanca nuk është në nivelet e dëshiruara dhe besimi se ndryshimi po bëhet konstant. Ndryshimi fillon me "incizimin" e gjendjes aktuale të organizatës dhe hartimin e strategjive që duhen ndjekur. Fokusi i menaxhimit të ndryshimit është në rezultatin se ndryshimi do të prodhojë marrëveshje të reja, që duhet të kuptohen.

Nga një strategji gjithëpërfshirëse, menaxhimi i ndryshimit duhet të çojë në objektivat e dëshiruara dhe për të krijuar një ndjenjë të pronësisë, për të mundësuar përmirësime të qëndrueshme dhe të matshme, si dhe për të ndërtuar aftësinë për t'iu përgjigjur ndryshimeve në të ardhmen (Leading change, transition & transformation,The U.of Adelaide, Australia).

Menaxhimi i ndryshimeve në organizatë garanton sukses, vetëm nëse aplikohen parime të thjeshta.Menaxhimi i ndryshimit përfshin planifikimin dhe zbatimin, mbi të gjithakonsultimin dhe përfshirjen e njerëzve që preken nga këto ndryshime. Nëse ndryshimi është i detyruar, në njerëz zakonisht lindin probleme. Ndryshimet duhet të jenë realiste, të arritshme dhe të matshme. Këto aspekte janë veçanërisht të rëndësishme për menaxhimin e ndryshimit personal. Para fillimit të ndryshimeve organizative, paraprakisht duhet t'i kemi të qarta disa pyetje që duhet t'ia bëjmë vetes: Çfarë duam të arrijmë me këtë ndryshim, pse duhet të ndodhë ndryshimi dhe si do ta dimë se ndryshimi është arritur? Kush duhet të preket nga ky ndryshim dhe se si do të reagojnë ata ndaj tij? Këto aspekte lidhen për menaxhimin e ndryshimit si në aspektin personal ashtu edhe atë organizativ (Modeli i komunikimit, Profesor Albert Mehrabian).

Ndryshimi përfshin dinamikën nga një gjendje e caktuar (e njohur) drejt një gjendjeje të re, që është e panjohur deri në një masë (Smith, 2005:519). Ndërsa, sipas autorëve Gioia&Chittipeddi (1991:433): ''Përgjithësisht ndryshimi paraqet një përpjekje për të ndryshuar mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit nga anëtarët e organizatës".

Që ndryshimi të japë efekt, njerëzit duhet të dinë se si duhet të lëvizin nga gjendja aktualedrejt një gjendjeje të së ardhshmes. Me gjendje të "ardhshme" nënkuptohet që organizata duhettë jetë në gjendje që të mbijetojë. Si rrjedhojë, ndryshimi në organizatë është esencial (Bridges &Bridges, 2000).

Rreth menaxhimit të ndryshimeve nuk ekziston përkufizim i prerë. Burnes (2009)shprehet se menaxhimi i ndryshimeve nuk është një disiplinë e veçantë me kufij të përcaktuarqartë. Sipas Duck (1993:110):''Të menaxhosh ndryshimin është të menaxhosh dialogunndërmjet njerëzve që udhëheqin përpjekjet për ndryshim dhe atyre që zbatojnë strategjitë e reja".

Pra, kuptimi i kësaj është ta menaxhosh kontekstin organizacional, në të cilin ndryshimimund të ndodhë, si dhe lidhjet emocionale, që janë esenciale për çdo transformim.

Sipas Kotter & Cohen (2002) dështimi në menaxhim të ndryshimit lidhet me çështjetnjerëzore dhe jo me ato teknike.

Lena & Barry (2000) theksojnë se organizatat aplikojnëndryshime për të përmirësuar përparësitë e tyre konkurruese dhe përshtatjen ndaj tregjeve tëlëkundshme. Duke parë shkallën e lartë të dështimit të iniciativave për ndryshim, natyrshëm lindpyetja: a është i menaxhueshëm ky ndryshim?

Sipas Palmer &Dunford (2002), përgjigja në këtëpyetje varet nga këndvështrimet dhe pamjet e ndryshme që njerëzit kanë mbi menaxhimin dhendryshimin. Ekzistojnë dy imazhe mbi menaxhimin: menaxhimi si kontroll i veprimeve dhemenaxhimi në kuptimin e aftësive.

Sipas Mercurio (2006), ndryshimi mund të menaxhohet në mënyrën më të mirë, duke komunikuar shpesh dhe me ndershmëri, duke sqaruar qëllimin e ndryshimit, duke siguruar një plan zbatimi të detajuar dhe të monitoruar. Në këtë rast lidershipi dhe komunikimi efektiv janë përcaktues kryesorë të procesit të ndryshimit dhe menaxhimi i ndryshimit është një kompetencë bazë në çdo nivel të biznesit. Edhe në këtë kohë ekzistojnë mendime të ndryshme rreth menaxhimit të ndryshimit (William T. Craddock, ESD, PR, PMP, Graddock & Associates, Inc, Mars 2015).

Sipas Armenakis et al. (1993), organizatat vazhdimisht duhet të përballen me nevojën përndryshime në strategji, strukturë, procese dhe kulturë, për shkak të ambienteve dinamike.

Pse ndryshimi organizativ është i vështirë për ta përmbushur? Mc Kinsey & Co (2006),Shaffer & Thompsom (1998) and Corporate Leadership Council (CLC, 2001).

Në përgjithësi, organizatat përballen me rezistencë të fortë për të ndryshuar,njerëzit kanë frikë të panjohur, shumë mendojnë se gjërat janë duke shkuar mirë dhe nuk ekuptojnë nevojën pse duhet të ndodhë ndryshimi.

Menaxherët janë mësuar për të menaxhuar proceset dhe burimet në mënyrë efektive.Ndryshimi, megjithatë, kërkon "menaxhimin" e njerëzve, ankthit dhe konfuzionin.Menaxhimi i procesit të ndryshimit dhe emocionet në tranzicion janë thelbësore përsuksesin e një projekti të orientuar të ndryshimit. Arsyet për rezistim ndaj ndryshimit janë tëndryshme. Arsyet mund të përfshijnë humbjen e perceptuar të sigurisë, parasë, krenarisë osekënaqësisë, miqve, lirisë, përgjegjësia, autoriteti i mirë, kushtet e punës, statusi, mungesa erespektit etj.“Nuk janë të forta speciet që mbijetojnë e as më inteligjente, por ato që janë tëpërgjegjshme për të ndryshuar” (Charles Darwin).

Në literaturë ka shumëllojshmëri të definimeve me fokus menaxhimin e ndryshimeve.Ata të gjithë mbulojnë koncepte të ngjashme, nganjëherë duke përdorur terminologji tëndryshme. Shpjegimi më i thjeshtë i menaxhimit të ndryshimit thotë: "Kjo e gjitha është në lidhjeme njerëzit".Autorinë fjalë e përdor përkufizimin e mëposhtëm të menaxhimit të ndryshimit:

Një proces i projektuar që faktorët njerëzorë në strukturë të përfshihen direkt jo vetëm në planifikim dhe në zbatim, por, përmes ndryshimit të sjelljes, në arritjen e përfitimeve tëparashikuara, të cilat e arsyetojnë projektin në vendin e parë.

Ndryshimi është sjellje e dëshiruar që arrihet duke ndihmuar njerëzit ta kuptojnë dhe tapërvetësojnë ndryshimin dhe duke i përgatitur ata që të jenë kontribuues të suksesshëm në shtetine ardhshëm (Claire McCarthy & Douglas Eastman, HIMSS, 2010).

Procesi i menaxhimit të ndryshimit është një procedurë e planifikimit, vlerësimit dhe zbatimit të ndryshimeve në sistem. Qëllimet kryesore në proces janë: ruajtja dhe mbështetja e procesit të ndryshimeve, duke lejuar kërkimin e ndryshimeve. Ai është një proces shumë I rëndësishëm, duke u dhënë përfitime të mëdha dhe duke zhvilluar sistemin tuaj dhe, si rezultat, duke sjellë kënaqjen e nevojave të klientëve tuaj (Gerard Blokdijk, Change management 100 sucess secrets, 2008).

Ekzistojnë shumë teori lidhur me mënyrën e menaxhimit të ndryshimit. Një ndër teoritë gjithëpërfshirëse është "Leading Change", e John Kotter, profesor në Harvard Business School dhe ekspert i njohur botëror për ndryshimet organizative.

Në një studim të realizuar nga "Change Management Learning Center" (Prosci 2007), me 426 pjesëmarrës nga 59 vende të ndryshme, rezultoi se pesë faktorët kryesorë të cilët kontribuojnë në suksesin e projekteve të ndryshimit ishin:

a. Mbështetja aktive nga ana e ekzekutiveve
b. Përpjekja e strukturuar e menaxhimit të ndryshimit
c. Komunikimi i shpeshtë dhe i hapur i nevojës për ndryshim
d. Burimet e dedikuara menaxhimit të ndryshimit dhe
e. Përfshirja e punonjësve

Një nga modelet më të përkrahura të procesit të ndryshimit është modeli tetëhapësh i Kotter (Alas 2007).

Modeli Kotter i botuar në një artikull në Harvard Business Review në 1995vlerësohet si një nga modelet më të njohura dhe që vlerësohet gjerësisht si klasik në këtë fushë (Palmer et al., 2009). Modeli u ndërtua nga studimi i mbi 100 organizatave të ndryshme nga njëra-tjetra sa i përket madhësisë dhe tipit të industrisë ku bënin pjesë. Sipas Mento et al. (2002), modeli Kotter është dizajnuar për nivelin strategjik të procesit të menaxhimit të ndryshimeve.

Duke iu referuar Kotter-it (2007:96), liderët që transformojnë bizneset në mënyrë të suksesshme bëjnë tetë gjëra të drejta dhe i realizojnë ato në radhën e duhur. Këto tetë veprime ngjasojnë me tepër me këshilla që duhet pasur parasysh gjatë procesit të ndryshimit.

Sipas Kotter-it (2007:97) procesi i ndryshimit kalon në një seri fazash, të cilat në përgjithësi kërkojnë kohë të konsiderueshme.




Figura 1. Modeli i Kotter-it (Burimi: Kotter 2007)

# REZISTENCA NDAJ NDRYSHIMIT

Menaxhimi i ndryshimit në kushtet bashkëkohore po bëhet një nevojë imediate, në mënyrë që një ndërmarrje të jetë koherente dhe e qëndrueshme në mjedisin afarist.

Të gjithë autorët pajtohen në një fakt se, ku ka ndryshim ka edhe rezistencë. Kjo rezistencë është edhe normale gjatë ndryshimeve dhe menaxherët në disa situata hasin në rezistencë (sado e lehtë qoftë ajo) edhe në rastet kur ndryshimi është i planifikuar mirë dhe janë marrë masat për menaxhimin e tij (Atkinson, 2005).

Sipas Kirkpatrick, menaxhimi i ndryshimit ka kuptim të dyfishtë: së pari çfarë ndryshimesh duhen bërë dhe, së dyti, të sigurosh pranimin e atyre që përfshihen në ndryshim. Në shekullin 21, që po konsiderohet si shekull i ndryshimeve të mëdha, edhe ndryshimi në organizatë po cilësohet si një imperativ strategjik për qëndrueshmërinë e organizatës. Pra, ndryshimi është një proces që duhet të menaxhohet. Ndryshimi që nuk ka ndikim në organizatë është i pakuptimtë. Por, ndryshimi nuk mund të ketë ndikim në një organizatë, nëse nuk prek edhe njerëzit brenda saj. Nëse njerëzit në organizatë preken dhe e pranojnë ndryshimin, atëherë mund të flitet për realizimin e qëllimit të ndryshimit (Esther Cameron and Mike Green, Making sense of change management: a complete guide to the models, tools and techniques of organizational change, Mars 28, 2015, www.trainingjournal.com).

Ndërsa, autori tjetër Coetsee (1999:204) tregon se menaxhimi i ndryshimit ka të bëjë me pranimin e ndryshimit dhe rezultateve të tij nga të gjithë ata që janë përfshirë dhe ndikohen prej tij, si edhe me menaxhimin efektiv të rezistencës ndaj ndryshimeve.

Në artikullin "Rezistenca për të ndryshuar" (Eric B. Dent & Susan Galloway Goldberg, Shkurt 2015), autorët shprehen se ekziston rezistenca për të ndryshuar, por ideja është se si ta kapërcejmë këtë. Rezistenca mund të përkthehet edhe si përgjigje e punonjësve ndaj trajtimit që ata marrin gjatë procesit të ndryshimit, si dhe ndaj kontrollit të menaxherëve (Coetzee&Stanz, 2007:76). Ndërsa, Zaltman&Duncan (1977:63) e përkufizojnë rezistencën si "çdo sjellje që shërben për të ruajtur status-quo-në përballë presionit për ta ndryshuar këtë status-quo". Rezistenca ndaj ndryshimit në vetvete nuk është as e mirë e as e keqe, mund të jetë me baze ose jo, por gjithmonë ajo është një sinjal i rëndësishëm që kërkon hetim të mëtejshëm nga menaxhimi (Lawrence, 2001:6). Torben Rick (2014) shkruan se nuk është problem ndryshimi, por rezistenca për të ndryshuar. Si arsye pse njerëzit i rezistojnë ndryshimit, ai radhit: nuk ka asnjë arsye reale për ndryshim, ndryshimi do ta vështirësojë punën e tyre, rreziku më i lartë se përfitimi, ata mendojnë se (punonjësit) nuk kanë aftësi për ta bërë ndryshimin, ata besojnë se ndryshimi do të dështojë, procesi i ndryshimit po udhëhiqet keq nga menaxhmentindryshimi nuk është në harmoni me vlerat (e organizatës, ata mendojnë se përgjegjësve për ndryshim nuk ubesohet(http://www.torbenrick.eu/blog/change-management/change-is-not-the-problemresistance-to-change-is-the-problem/).

Nëse njerëzit ndjehen të kërcënuar ndaj ndryshimit, atëherë ata do harxhojnë më shumë përpjekje për ta kapërcyer këtë problem sesa për të realizuar detyrat e tyre në organizatë. Rezistenca mund të kthehet në pengesë, por nëse menaxherët dëgjojnë ata që i rezistojnë ndryshimit (pra kuptojnë arsyet e rezistencës, jo thjesht të përpiqen ta kapërcejnë rezistencën), atëherë kanë një mundësi për t'i përfshirë ata në proces dhe mund ta kthejnë rezistencën në një avantazh e të arrijnë rezultate afatgjata më të mira (Smith 2005).

Në tregimin "Rezistenca për të ndryshuar dhe kreativiteti" (Ed Catmulles book, Creativity, Inc) flitet për një histori interesante në lidhje me inovacionin, fuqinë e imagjinatës dhe, në fund, për mënyrën se si zhvillimi i qëllimshëm i kulturës së një organizate përcakton dhe mundëson suksesin e saj.

Tre janë gjërat kryesore që duhet të bëhen sipas Catmull-së: (1) nevoja për të zhvilluar një kulturë njerëzore që aspiron gjithmonë në përsosmëri; (2) rëndësia jetike e ndërveprimit të ekipeve me mjedisin me të cilin duhet punuar dhe (3) nevoja për të kapërcyer rezistencën dhe për të ndryshuar është se duhet pranuar realitetin, se ndryshimi është i pashmangshëm dhe se si organizatat dhe individët brenda tyre të rriten dhe të arrijnë potencialin e tyre. "Për të mbajtur një... kulturë të gjallë, ne nuk duhet të kemi frikë nga pasiguria e vazhdueshme. Ne duhet ta pranojmë atë (ndryshimin), ashtu si e pranojmë motin. Pasiguria dhe ndryshimi janë konstante e jetës. ... Pas ndryshimit vjen nevoja për përshtatjen" (All About Culture: Resistenceto Change an Creativity, Janar 2015. www.crowleym.com)

## KONKLUZIONE

Gjatë procesit të tranzicionit ndodhin ndryshime të rëndësishme dhe komplekse në organizatë, të përfaqësuara kryesisht nga ndryshimet në lidership, kulturë, strukturën organizative, praktikat e menaxhimit, sistemet e shpërblimit dhe menaxhimit të informacionit dhe klima. Mënyra e perceptimit ndryshon varësisht prej pozicionit në punë.

Manaxhimi i ndryshimeve është një çështje e rëndësishme në ambjentin e sotëm të biznesit, i cili ndryshon vazhdimisht. Sot liderët po punojnë në një nga ambjentet më dinamike që kemi parë ndonjëherë, ku ndryshimi është i shpejtë dhe i shpeshtë (Robbins 2008). ‘Një fakt i padiskutueshëm që karakterizon jetën organizative është që ndryshimi është i pashmangshëm’ (Metcalfe & Metcalfe, 2005:27). Rritja e konkurrencës në tregje, globalizimi, reduktimi i barrierave të hyrjes në disa tregje si rezultat i internetit dhe biznesit elektronik, nevoja për t’iu përgjigjur më shpejt nevojave të konsumatorit, shkrirjet dhe blerjet, inovacioni, teknologjia, riorganizimi, rënia e shitjeve ose pjesës së tregut, etj, janë disa nga faktorët që nxisin ndryshimin (Victor & Franckeiss, 2002; Cao et al., 2003; Clegg & Walsh, 2004; Stanleigh, 2008).

Menaxherët janë të mendimit se ndryshimet në lidership, në strukturën organizative, në sistemet e informacionit dhe në klimën e organizatës, janë më të mëdha se nga vlerësimi i pjesës tjetër të stafit. Vlerat e rangimit mesatar janë më të larta për menaxherët sesa pjesa tjetër e stafit. Këto janë elemente më të prekshme për menaxherët, krahasuar me pozicionet e tjera, duke treguar edhe devijancat në informim të të gjithë stafit në organizatë. Modeli Kotter ofron një strukturë gjithëpërfshirëse në mënyrën e zhvillimit të ndryshimeve gjatë transformimit në organizatë, të cilat janë evidentuar/identifikuar edhe në rastin e ndërmarrjeve në Kosovë.

Nga përgjigjet e marra identifikohen nevoja për ndryshim, shohim se qëndron hipoteza1: Zhvillimi i ndërmarrjeve në Kosovë dhe qasja zhvillimore e tyre ndikohen nga ndryshimet e ndërmarrësve dmth sipas analizes sonë ndryshimi ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillim e ndërmarrjes kjo si rezultat i ndryshimeve në treg dhe nevojës për përmirësimin e cilësisë. Ndër të anketuarit vihet re se menaxherët janë më të vetëdijshëm për rëndësinë e ndryshimeve në treg, kjo pasi menaxherët janë më të informuar se pjesa tjetër e stafit.Kjo mund të jetë edhe rezultat i nivelit me të lartë arsimor të stafit, të cilët kanë pritshmëri më të lartë.

Rezistenca vjen si rezultat i ndryshimit në strukturën organizative, si rezultat i riskut në përshtatje ndaj strukturës së re. Këtij risku i shtohet edhe humbja e pozitave të mëparshme tek i punësuari. Nëse perceptohet se ndryshimi do ta ulë shkallën e pozicionit vendimmarrës në organizatë, atëherë do të krijohet rezistencë. Të punësuarit e shfaqin rezistencën edhe duke devijuar nga objektivat e vendosur nga drejtuesit për arsye të ndryshme. Burimi më i lartë i rezistencës shfaqet nga nënvlerësimi i punës së kryer nga i punësuari. Nëse nuk ndihet i vlerësuar, atëherë thjeshtësisht nuk përkrah ndryshimin dhe krijon rezistencë. Element reduktues në rezistencë vlerësohet rritja e përfitimeve ekonomike tek i punësuari.

**LITERATURA**

1. Alas R., ‘Organizational change from learning perspective ‘, Problems and perspectives in Management, (2007), 43-50.

2. Alas R., ‘Management in firms and organizations’, Problems and Perspectives in Management, (2007), 47-50.

3. Almaraz J.‘Quality Management and the Process of Change’, Journal of Organizational Change Management, (1994), 6-14.

4. Atkinson P.,Managing resistance to change, Management Services, Spring 2005, 14-19,

5. Balogun J., Hope Hailey V., Exploring Strategic Change, FT Prentice Hall, (2008), botimi i tretë.

6. Beer M. ‘Revitalizing Organizations: Change process and Emergent Model’, Academy of Management Executive, 51-55, February 1987.

7. B. Ramosaj, “Bazat e menaxhimit”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2007.

8. Caldwell R., ‘Employee involvëment and communication, strategies for managing change’, Journal of Strategic Management, (1993), 135-138.

9. Flamholtz E. & Randle Y., Leading strategic change: bridging theory and practice, (2008), Cambridge University Press, first edition.

10. Gill R., ‘’Change management –or change leadership’’, Journal of Change Management, (2003), 307-318.

11. Hinkin T.R., ‘A review of scale development practices in the study of organizations’, Journal of Management, (1995), 967-988.

12. Izet Zeqiri ‘ Menaxhmenti’ (2006)

13. Kotter J., Leading Change, Harvard Business School Press, Boston, MA (1996)

14. Kotter J.P., ‘Leading change, why transformation efforts fail’, Harvard Business Review, (2007), 96-103

15. Levy, A. & U. Merry ‘ Organizational Transformation: Approaches, strategies, theories, (1986), New York, Praeger.

16. Stainleigh M., (2008), ‘Effecting successful change management initiatives’, Industrial and Commercial Training, vol 40, no 1, 34-37.

*Web- bibliografi*

1. Almaraz J., 'Effective change leadership in small and medium-sized organizations',http://usasbe.org/knowledge/proceedings/proceedingsDocs/USASBE2003 proceedings-32.pdf.
2. Best Practices in Change Management, Prosci, 2007, www.change-management.com.
3. Gregory M., 'Resistance to Change in Organizations and how to deal with it', (2003), http://www.marygregory.com/docs/Managingresistance.pdf.
4. Kirkpatrick D, Managing Change, transfer learning to behaviour, Leadership Excellence,www.LeaderExcel.com.
5. Nickols F.Change Management 101: A Primer, (2007), http://home.att.net/nickols/change.htm.
6. Dealing With Resistance to Organizational Change, Mars 2015, www.vpsc.vic.gov.au
7. All About Culture: Resistenceto Change an Creativity, Janar 2015. www.crowleym.com

Kotter international, 2015, http

# VENDIMMARRJA EFEKTIVE NË PËRFORMANCËN E BIZNESIT

**Ermonda Foniqi –Universiteti„Haxhi Zeka„Pejë**

**Edita Dembogaj-Universiteti„Haxhi Zeka„Pejë**

**Liresa Kastrati –Universiteti„Haxhi Zeka„Pejë**

## Abstract

All small or large, private and public organizations, profitable or non-profitable, regardless of where you are doing, need to be managed. All organizations for achieving a goal engage a variety of resources: human, material, and financial. In this context, the manager in the work process, unites and coordinates all resources to achieve the goal. The manager uses the most appropriate forms to more effectively compete, and to be more successful in the market to increase organizational objectives. Practices have proved that the decisive factor for the success or failure of a business is the ability or inability of the management team. The responsibility of the manager in our society is crucial not only for the organization, but also for the public attitude towards management for its success and status, for the future of the economic and social system, and organizes survival as an independent institution. Decision-making refers to a specific act, or a general process. The person making the decision must understand that the decision is necessary and must identify a number of reasonable alternatives before choosing one of them. The decision-making process involves understanding and defining the nature of the situation, requiring decision-making, identifying alternatives, choosing alternatives, and implementing it. Effective decision-making takes place when decision making understands the situation that requires decision-making and problem solving. Effective decision is that decision that optimizes a variety of factors, such as profit, sales, employee welfare, etc.

**Keywords:***effective decision, choice of alternatives, decision, problem solving, etc.*

## 1. Hyrje

Gjatë gjithë këtij punimi do të vërtetojmë rëndësinë e vendimmarrjes në përformancën e organizatës. Punimi do të fillojë me mendimet e autorëve të ndryshëm të vërtetuara, duke i vendosur në pah këto mendime me njëra tjetrën.

Vendimmarrja brenda një organizate është një proces i përbërë nga mjaft elemente të caktuara të cilat bëjnë që ky proces të kryhet me përpikmëri. Disa nga elementet përbërëse që do t'i përfshijmë edhe në rastin tonë të studimit na ndihmojnë të kuptojmë më mirë se sa e rëndësishme është procesi i vendimmarrjes.

Gjatë pjesës së fundit të këtij punimi japim rekomandimet rreth ndërmarrjeve tona dhe ndërmarrjeve të tjera të rajonit, duke dhënë një pasqyrim rreth elementeve të cilat ndihmojnë që të marrim një vendim të drejtë. Përfundimi është një pasqyrim i hipotezave, duke e theksuar hipotezën e cila qëndron dhe pastaj

duke konstatuar nëpërmjet grafikonëve të mëhershëm, edhe arsyet se përse qëndron po kjo hipotezë dhe përse hipoteza tjetër bie.

Pra në mënyrë të përgjithsuar mund të themi se procesi i përzgjedhjes së vendimmarrjes ndikon në përformancën e ndërmarrjes qoftë duke e rritur suksesin e saj apo duke e zvogëluar atë dhe duke konstatuar dallimet ndërmjet këtyre elementeve.

## 2. Kërkesat e vendimeve efektive

Në përgjithësi problemet kërkojnë vëmendjen e drejtimit efektiv që kanë dimensionet e mëposhtme :

**Kërkojnë marrjen e vendimeve nga drejtimi i lartë**

.Meqenëse vendimet efektive kapin fusha tëveprimtarisë së firmës, ato kërkojnë doemos pjesëmarrjen e drejtimit të lartë si presidentit, shefit ekzekutiv, zv. presidentit dhe zv.presidentit ekzekutiv. Në përgjithësi vetëm drejtimi i lartëe ka të qartë prespektivën dhe ndikimine vendimeve të tilla në të ardhmen dhe gjithashtu është i pushtetshëm në shpërndarjën e burimeve tënevojshme.

**Kërkojnë sasira të burimeve të firmës**

Vendimet efektive për nga rëndësia e tyre kërkojnë burime të konsiderueshme në njerëz, mjete monetare e fizike që mund te sigurohen nga burimet e brendshme ose te jashtme të firmës. Ata gjithashtu angazhojnë firmën në aktivitete qëkapin një periudhë të gjatë kohe, pra që kërkojnë burime të bollshme.

**Ndikojnë në prosperitetin afatgjatë të firmës**

Megjithëse vendimet efektive organizojnë firmën për një periudhë të gjatë kohe, ndikimi i tyre në veprimtarinë e saj zgjat shumë më tepër. Kur një firmë përdor vendime të suksesshme ajo bëhet e njohur për disa tregje e produkte dhe për teknologjitë e përdorura.[72]

Ndryshimi i vendimeve efektive mund t'i shkaktojë asaj humbje të tregjeve dhe për rrjedhojë ulje të

fitimeve.

**Janë të orientuara nga e ardhmja**

Vendimet efektive vënë theksin në projekte te tilla që janë premtuese për të ardhmen. Një firmë që vepron në një ambient të turbullt dhe konkurues do të ketë sukses nëqoftëse ajo parashikon ndryshimet ambientale dhe ndërmerr masa mbrojtëse ndaj tyre.

**Ndikojnë në shumë fusha funksionale ose biznese te firmës**

Vendimet efektive për vendime te tilla si : përbërjën e konsumatorëve, avantazhin konkurues ose strukturën organizative, merren duke u bazuar në shume njesi strategjike, divizione apo njesi funksionale. Te gjitha keto fusha do te ndikohen nga vendosja ose rivendosjae përgjegjësive e burimeve që rrjedhin nga këto vendime.

### 2.1 Vendimi si proces i vazhdueshëm i vlerësimit

Vendimi është një proces i vazhdueshëm i vlerësimit tëalternativave për arritjen e një objektivi, ku marrësi i vendimeve zgjedh një kurs të caktuar veprimi, i cili mendohet se do të qojë në arritjen e objektivit.Të gjitha problemet vendimore duhet të kenë një objektiv-përndryshe asnjë problem nuk duhet

[72] Paul Banfield, "Hyrje në MBNJ",Press,Tiranë,2011, fq.365.

të ekzistonte.[73] Një nga aspektet më të vështira të një problemi është zakonisht zgjedhja e një objektivi të vecantë për t'u përdorur.

**Procedura e marrjës së vendimeve në lidhje me planifikimin strategjik duhet të përshijë:**

1.Vendime që kanë shtrirje kohore relativisht të shkurtër ( 2 vjet ose më pak );

2.Vendimet nuk duhet të jenë tërësisht të strukturuara;

3.Pjesëmarrjen e punonjësve në marrjen e vendimeve në lidhje me planifikimin, për të përfituar besueshmërinë dhe krijmtarinë e planifikimit të mëpasshëm.

4.Vendime të cilat nuk kanë objektiva të fryra e të paarritshme.

5.Vendime të përqendruara në mendimin strategjik.

## 2.2 Hierarkia e vendimeve ne drejtim

Hierarkia e vendimeve mund të paraqitet me anën e një piramide me nivele të ndryshme përgjegjësi




**Figure 1 Hierarkia e vendimeve**

**1.Veprimtaria e përditshme**nënkupton funksionimin e një sërë shërbimesh si p.sh marrja evendimeve ditore për sigurimin e ecurisë së mirë të punës në ndërmarrje. Për këtë drejtuesi jep një seri urdherash të përcaktuara mirë për të organizuar punën gjatë ditës.

2.Në nivelin e dytë kemi të bëjmë me marrjen e **vendimeve koniunkturore** në funksion të evoluimit të mjedisit. Kjo korrespondon me atë që quhet drejtim në kuptimin e ngushtë të fjalës, që lidhet me aspekte funksionale tipike si për drejtim rezervash, drejtim prodhimi etj.

3.Në nivelin e tretë, kemi të bëjmë me marrjen e **vendimeve më të rëndësishme** që kanë të bëjnë me të ardhmen e ndërmarrjes dhe që nënkupton në njëfarë mënyre modifikimin apo ndërtimin e sistemit. Bëhet fjalë për vendimet për investimet që sigurojnë zhvillimin në afatmesëm.

Vendimet në ndërmarrje si edhe në fushat tjera të jetës mund ti marrin individët dhe grupet. Në shumicën e ndërmarrjeve janë individët zakonisht të përcaktuar për marrjen e vendimeve. Numrin më të madh të vendimeve e marrin menaxherët të cilët gjenden në shkallët e ndryshme në ndërmarrje. Mirëpo vendimet i marrin edhe punëtorët ekzekutiv në vendet e tyre të punës.(Sikavica, Bebek, Skoko, & Tipuriq, 2008). Varësisht nga numri i pjesëmarrësve në procesin e vendimmarrjes, kemi vendimmarrjen individuale dhe atë grupore. Përcaktimi për vendimmarrjen grupore apo individuale varet nga ndërlikueshmëria e problemit për të cilin

vendoset. Sipas rregullit, për problemet e thjeshta vendimmarrja do të jetë individuale, kurse problemet e ndërlikuara kryesisht zgjidhen përmes vendimmarrjes grupore. Por në praktikë shpesh vihen re përjashtime nga ky rregull. Vendime që janë me rëndësi të madhe për ndërmarrjen, rrespektivisht nga të cilat varet ardhmëria e ndërmarrjes, merren përmes vendimmarrjes grupore, kurse ato të rëndësisë më të vogël merren përmes vendimmarrjes individuale.(Shiroka-Pula & Krasniqi, 2012).

### 1.1. Vendimmarrja Individuale

Vendimmarrja individuale është njëra na dy mënyrat kryesore të vendimmarrjes, nëse merret parasysh numri i pjesëmarrësve në procesin e marrjes së vendimve. Dallimi kryesor në mes të vendimmarrjes individuale dhe asaj grupore është numri i pjesëmarrsëve në vendimmarrje.

Individët nuk i shpëtojnë përgjegjësive. Ata janë të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe të performancës. Ndërsa në një grup nuk është e lehtë për të mbajtur çdo njeri përgjegjësi për një vendim të gabuar.(Sikavica, Bebek, Skoko, & Tipuriq, 2008). Edhe pse vendimmarrja individuale, sipas rregullit është më e shpejtë se ajo grupore, nëse e shikojmë nga aspekti i individëve të ndryshëm si marrës të vendimeve, ajo mund të jetë më e shpejtë por edhe më e ngadalshme, e kjo gjë varet në rend të parë nga njohuritë dhe aftësit e personit që e merr vendimin, por edhe nga karakteristika e individit si person. Sipas tipit të karakterit, shikimit në jetë dhe të ngjashme do të dallohen marrësit e posaçëm të vendimeve. Kështu, njerëzit me qëndrime dhe shikime të forta p.sh. do të vendosin më shpejtë dhe më sigurt, në vendimmarrje do të shqyrtojmë vetëm një numër të vogël të varianteve, për dallim prej atyre që janë të paduruеshëm dhe që marrin vendime shpejtë, por shpesh herë në bazë të numrit të informacioneve të pamjaftueshme dhe pa u munduar të kërkojnë informata shtesë. Përpos këtyre tipave të karakterit, ekzistojnë edhe njerëz të qetë dhe stabil, që janë më të përshtatshëm për vendimmarrjen afatgjatë.(Moorhead & Grifin, 1989).

Vendimmarrja individuale siç thekson R. L. Draft, e shikuar nga pozita e menaxherit që merr vendimet, mund të përshkruhet në dy mënyra:

**a)** E para është***qasja racionale***, e cila sygjeron mënyrën sipas të cilës menaxherët do të duhej të marrin vendime.

**b)** Kurse të dytën mund ta quajmë***perspektivë e kufizuar racionale*** e cila e përshkruan mënyrën e marrjes së vendimeve në afat të shkurtër dhe me mjete të kufizuara.

Qasja racionale do të thotë vendimmarrje në kushte ideale. Mirëpo, në praktikë, në shumicën e rasteve kushtet nuk janë ideale dhe nuk disponojmë me të gjitha informacionet e nevojshme. Po ashtu edhe të gjitha parametrat për vendimmarrje nuk janë të sigurta, prandaj në shumicën e rasteve marrin vendime në kushtet e racionalitetit të kufizuar.(Daft, 2004)

Sipas mendimit tjetër (shikuar nga qasja e vendimmarrjes), mund të flitet për katë lloje të personava të cilët marrin vendime individuale:

- Lloji i parë i marrësve të vendimeve përfaqësohet nga personi ***iracional***,i cili propozon një vendim të caktuar, përkundër frikës se cili mund të jetë rezultati i atij vendimi.
- Llojin e dytë të marrësve të vendimeve e paraqesin personat ***kreativë***. Vendimet te këta persona janë të udhëhequra nga dëshira për përparim dhe afirmim individual.
- Lloji i tretë janë personat ***klasikë ose racionalë***, respektivisht ekonomikë. Pra, personat që janë plotësisht të informuar dhe ekonomikisht të motivuar për marrjen e vendimeve në kushte objektive.
- Në llojin e katërt bëjnë pjesë personat ***administrativë*** të marrjes së vendimit në kushtet e ***racionalitetit të kufizuar***. Ata gjatë vendimmarrjes përcaktohen për alternativen e parë të pranueshme e jo për atë më të mirën.(Dunham & Pierce, 1989).

Varësisht nga rreziku, marrësit e vendimeve individual mund të klasifikohen në tri grupe,siq janë:

- ✓ ***Anashkalues të problemeve*** – Kanë tolerancë të ulët ndaj pasigurisë dhe rrezikut, e pasi që nuk dëshirojnë të rrezikojnë, e zgjedhin variantin e zgjidhjes së problemit me pasoja të sigurta.
- ✓ ***Zgjidhës të problemeve*** – ata që kanë nivel të mesëm të tolerancës ndaj pasigurisë dhe rrezikut dhe kur ballafaqohen me problemin nuk provojnë ta parandalojnë.
- ✓ ***Kërkues të problemeve*** – janë ata njerëz që e tolerojnë pasigurinë dhe rrezikun në vendimmarrje që për ta paraqet sfidë, kurse kënaqësinë e gjejnë në kundërshtimin e pasigurisë.(Dunham & Pierce, 1989).

## 1.2. Vendimmarrja Grupore

Vendimmarrja grupore paraqet një mënyrë të vendimmarrjes afariste, gjegjësisht vendimmarrjes në përgjithësi në të cilën vendimet i marrin grupet e njerëzve të strukturuar në baza të ndryshme. Baza për formimin e grupit mund të jetë pronësia, funksionet menaxheriale, puna e përbashkët në ndonjë detyrë e të ngjashme.(Sikavica, Bebek, Skoko, & Tipuriq, 2008).

Një numër i madh i vendimeve në ndërmarrje bëhet sipas parimit të vendimmarrjes grupore. Vendimet grupore i merr një numër i madh i individëve që punojnë bashkarisht në zgjidhjen e një problemi të caktuar. Numri më i madh i pjesëmarrësve në vendimmarrjen grupore në një anë e demokratizon vendimmarrjen, kurse në anën tjetër e bën atë më të ngadalshme dhe më të shtrenjtë. Vendimmarrja, si e grupeve formale ashtu edhe joformale është bërë rregull e përforcuar e vendimmarrjes në shumë kompani. Vendimmarrja e përbashkët është fakt i pamohueshëm i organizimit të kohës moderne. Vendimmarrja grupore nuk duhet të përzihet me participimin e punëtorit në procesin e vendimmarrjes, ngase kjo vendimmarrje nënkupton kyçje të numrit më të vogël apo më të madh të anëtarëve të organizatës, më së shpeshti menaxherëve të niveleve të ndryshme në procesin e vendimmarrjes, për dallim nga participimi i punëtorëve, i cili nënkupton kyçjen e punëtorëve në procesin e marrjes së vendimeve.(Reitz & Jewell, 1985).

Ekzistojnë pesë arsye kryesore pse vendimet duhet në merren në grup:

- ***Legjitimiteti***- Shpeshherë kur një individ e merr vendimin,ai mund të preceptohet si person që ka vepruar në mënyrë autokratike,pa i marrë parasysh interesat dhe ndjenjat e tjerëve.Nëse ai person perceptohet si i tillë nga grupi atëherë kjo mund të parqesë pengesë në zbatimin e vendimit.
- ***Cilësia e vendimit***-Edhe pse grupet mund të ndodhë që të marrin vendime jocilësore,në përgjithësi është e arsyshme të besohet se vendimet e marra nga grupi mund të jenë më cilësore si rezultat i sinergjisë së dijes, përvojave etj. që kanë mundësi të ofrojnë më shumë zgjidhje potenciale për problemet që ballafaqohet ndërmarrja.
- ***Nevoja për vendime innovative*** -Kjo ndodh në situata të cilat e parashtrojnë nevojën për ide të reja ose kur vendimmarrësit ballafaqohen me probleme të cilat kërkojnë zgjidhje kreative,të cilat nuk kanë ardhur në shprehje më parë.(Jennings & Wattamm, 1994).
- ***Informacionet***- Kur shtrohet çështja e nevojes për informacione,marrja e vendimeve në grup sjell më shumë informacione sesa vendimmarrja individuale.Bashkimi i individëve në grup i ekspozon ata në një qasje më të lehtë në informata.
- ***Morali*** - Nga shumë hulumtime është treguar që vendosja grupore ka ndërlidhje pozitive me moralin dhe kënaqjen në punë. Në grupe, njerëzit jo vetëm që do të përfitojnë satisfaksion social nga interaksioni me të tjerët, për më tepër ajo mundëson që të ngrisë mundësitë për vetërealizim dhe zhvillim personal.

### *1.2.1. Karakteristikat e vendimmarrjes grupore*

Karakteristikat themelore të vendimmarrjes grupore është ajo se vendimet i marrin dy apo më shumë persona, gjegjësisht grup më i vogël apo më i madh. Këto grupe i karakterizojnë gjërat si:

- Anëtarët e grupit i lidhinteresi i përbashkët.
- Anëtarët e grupit duhet të komunikojnë ndërmjet vete.

- Anëtarët e grupit i ndajnë rolet ndërmjet vetes për të realizuar qëllimet e përbashkëta të grupit.
- Secili grup është zakonisht nëngrup i një grupi më të madh, e njëkohësisht edhe ai vetë mund ti ketë nëngrupet e veta.
- Për arsyet e suksesit të vendimmarrjes, anëtarët e grupit duhet t'u përmbahen normave të përcaktuara të sjelljes në grup.(Moorhead & Grifin, 1989).

Anëtarët e grupit duhet të jenë të informuar mirë për problemin për të cilin vendosin. Gjatë vendimmarrjes grupore është me rëndësi që udhëheqësi i grupit të mund të kombinojë alternativa të ndryshme të disa anëtarëve dhe t'i koordinojë në drejtim të dëshirueshëm të qëllimit. Në vendimmarrjen grupore, rëndësi të madhe kanë edhe personat me autoritet të madh, të cilët kanë vend dhe forcë në ndërmarrje. Me mendimet e këtij anëtari të grupit shpesh ndodh që të shkojnë edhe anëtarët e tjerë të grupit. Kjo në të vërtetë paraqet edhe rrezikun për vendimmarrjen grupore, sepse nuk do të thotë që gjithmonë mendimi i udhëheqësit të grupit gjatë zgjedhjes së alternativave doemos të jetë më i miri.(Shiroka-Pula & Krasniqi, 2012).

Pra, për suksesin e vendimmarrjes grupore është me rëndësi përbërja e grupit që e merr vendimin, madhësia e atij grupi, normat e sjelljes në grup si dhe ekzistimi i kohezionit ndërmjet anëtarëve të grupit që vendos lidhur me ndonjë problem. Secili nga këta faktorë e përcaktojnë më shumë a më pak suksesin dhe kualitetin e vendimmarrjes grupore.(Moorhead & Grifin, 1989).

### 1.3. Përparësitë dhe mangësitë e vendimmarrjes individuale dhe grupore

***Përparësitëmë të mëdha të vendimmarrjes individuale janë:***

- Një individ në përgjithësi merr vendime të menjëhershme. Ndërsa një grup dominohen nga njerëz të ndryshëm, duke e bërë shumë kohë marrjen e vendimeve. Për më tepër, anëtarët e grupit grumbullojnë shumë kohë.
- Individët nuk i shpëtojnë përgjegjësive. Ata janë përgjegjës për veprimet dhe performancën e tyre. Ndërsa në një grup nuk është e lehtë të mbash një person të përgjegjshëm për një vendim të gabuar.
- Vendimmarrja individuale kursen kohë, para dhe energji si individë të marrin vendime të shpejta dhe logjike në përgjithësi. Ndërsa vendimmarrja në grup përfshin shumë kohë, para dhe energji.
- Vendimet individuale janë më të fokusuara dhe racionale në krahasim me grupin.

***Mangësitëpër vendimmarrjen individuale***

- Një grup ka potencial të mbledhë më shumë dhe informata të plota krahasuar me një individ gjatë marrjes së vendimeve.
- Një individ gjatë marrjes së ndonjë vendimi përdor intuitën dhe pikëpamjet e tij. Ndërsa një grup ka shumë anëtarë, kaq shumë pikëpamje dhe shumë qasje dhe si rrjedhim vendimmarrje më të mirë.
- Një grup zbulon talentin e fshehur dhe kompetencën bazë të punonjësve të një organizate.
- Një individ nuk do të marrë në konsideratë çdo interes të anëtarëve. Ndërsa një grup do të marrë parasysh interesin e të gjithë anëtarëve të një organizate.(Juneja, n.d.).

***Përparësitë e vendimmarrjes grupore***

Vendimmarrja grupore, sikur edhe ajo individuale, ka shumë përparësi, por edhe dobësi. Zakonisht ajo qëështë përparësi e njërës mënyrë, është dobësi e mënyrës tjetër. Vendimmarrja grupore ka përparësi të shumta ndaj vendimmarrjes individuale:

- ✓ Njëra nga më e rëndësishmet është se grupi zakonisht merr vendim më të mirë se individi
- ✓ Vendimin e marr nga grupi është më lehtë ta realizojmë se atë që e merr individi, thjesht për faktin se numri më i madh i anëtarëve të grupit si marrës të vendimeve do të thotë edhe numrin më të madh të atyre që e pranojnë vendimin.(Reitz & Jewell, 1985).

- ✓ Problemet më të vështira dhe më të ndërlikuara për të cilat duhet të vendoset mund të analizohen dhe t'u ndahen për zgjidhje anëtarëve të posaçëm të grupit sipas afinitetit dhe aftësive të tyre.
- ✓ Grupi gjeneron shumë më shumë ide për zgjidhjen e problemeve, gjë qëështë logjike ngase në process janë kyçur më shumë njerëz.
- ✓ Duke u bazuar në numrin e madh të anëtarëve që vendosin në grup, idetë mund të studiohen, hulumtohen më mirë, gjegjësisht të vlerësohen më mirë variantet e zgjidhjes se problemit
- ✓ Anëtarët e grupit janë jashtëzakonisht të motivuar për vendimmarrje ngase dinë mirë se vendosin të gjithë së bashku.(Moorhead & Grifin, 1989)
- ✓ Grupi posedon më shumë njohuri dhe ka më shumë informata të nevojshme për vendimmarrje, gjë që i mundëson kuptim më të mirë të problemit dhe gjenerim të numrit më të madh të varianteve për zgjidhjen e problemit.(Dunham & Pierce, 1989).

***Mangësitë e vendimmarrjes grupore***

- ➢ Si mangësi më e madhe e kësaj vendimmarrjeje është se ajo e ngadalëson procesin e vendimmarrjes, i cili kërkon më shumë kohë për marrjen e vendimit, e situatat në vendimmarrjen afariste jo rrallë janë të tilla që duhet të merret vendimi shpejt, gjegjësisht në afatin më të shkurtër të mundshëm.
- ➢ Mangësi tjetër ështëështë edhe rreziku nga mendimi grupor në procesin e vendimmarrjes që paraqitet si pasojë e imponimit të vendimit nga ndonjë anëtar i grupit që ka një autoritet të madh si dhe fuqi të madhe në organizatë, me ç'gjë margjinalizohen të gjithë anëtarët tjerë.(Gordon, Mondy, Sharplin, & Premeaux, 1990).
- ➢ Jo çdo zgjidhje e mundshme mund të vlerësohet për meritë. Për shkak se ka tendencë të jetë shtypje nga shumica e një opinioni të pakicave, zgjidhjet alternative nuk mund të hulumtohen edhe nëse ato janë të zbatueshme për organizatën. Kjo ndodh sepse përmes përkeqësimit të individit, zgjidhja më e lehtë e mundshme është shpesh ajo që kërkohet. Nëse nuk ekzistojnë politika dhe procedura për të parandaluar këtë, grupi që ndodh, sidomos në grupe që janë shumë kohezive, mund të bëhen shumë të dëmshme.

**Përfundimi**

Pra, siç e vërejtëm gjatë gjithë punimit, përcaktimin për vendimmarrjen grupore apo indviduale varet nga ndërlikushmëria e problemit për të cilin vendoset. Sipas rregullit, për problemet e thjeshta vendimmmarrja do të jetë individuale, kurse problemet e ndërlikuara kryesisht zgjidhen përmes vendimmarrjes grupore. Në çdo ndërmarrje ekzistojnë rregulla dhe norma mbi mënyrën e marrjes së disa vendimeve-individuale ose grupore. Mënyra e marrjes së vendimit varet nga lloji i vendimit, varësisht nga ajo a kemi të bëjmë me vendime strategjike, taktike, operative ose rutinore. Por gjithmonë duke mos harruar që vendimmarrja individuale është njëra nga dy mënyrat kryesore të vendimmarrjes, nëse merret parasysh numri i pjesëmarrësve në procesin e marrjes së vendimve. Ndërsa vendimmarrja grupore paraqet një mënyrë të vendimmarrjes afariste, gjegjësisht vendimmarrjes në përgjithësi në të cilën vendimet i marrin grupet e njerëzve të strukturuar në baza të ndryshme. Dallimi kryesor në mes të vendimmarrjes individuale dhe asaj grupore ishte pra, numri i pjesëmarrsëve në vendimmarrje. ***"Në momentin e vendimmarrjes, gjëja më e mirë që mund të bësh është të bësh gjënë e duhur. Gjëja me keqe është të mos bësh asgjë"***

Prandaj, duhet të kemi kujdes gjatë marrjes së vendimeve, si në jetët tona personale ashtu edhe në jetën e punës, që vendimet e marra të jenë adekuate, pasi ato inflencojnë dhe mund tëndryshojnërrënjësisht jetën tonë.

# ANALIZA E PUNËS

**Edmond Racaj**

Universiteti,,Haxhi Zeka,,Pejë

## Abstract

Nowadays, where business can be termed a "minefield", a strategy for overcoming this minefield, which has been undermined by a serious competitor, is indispensably needed.Today every company can have access to different technologies, while the only competitive point can be Human Resources.So this competitive point to makes you more competitive with companies operating in the market, you have to get the best out of human resources.For human resources to be able to make the best of them, they must adapt to the work and the company, namely the company's objectives.Work analysis is what shows who are the most suitable employees for that job, so who is likely to be capable and has the skills to do that job and adapt to that job.This is achieved by describing and specifying the job.At the same time through the results obtained from the job analysis you can adjust the work so that it is easy for the employee, so adjust the interests of the employee to the company's interests, namely the objectives of the company.

***Keywords:*** *Human Resources, job Analysis, Job Specification, Job Descriptions.*

## Hyrja

Çdo organizatë në botë, çofshin ato fitim prurës apo edhe jo fitim prurës, publik apo privat, pa dallim në kohën të cilën kanë operuar, ato kanë të bëjnë me burimet njerëzore. Burimet njerëzore janë kushti themeltarë për të operuar si ndërmarrje apo për të ekzistuar, sidomos në kohët e sotme ku pothuajse e vetmja pikë konkurruese janë pikërisht burimet njerëzore. Kur flasim për burimet njerëzore, një ndër vështirësitë e mëdha është edhe identifikimi i personit të duhur (Kompetent) për vendin e lirë të punës, (Prien, et al, 2009). Nga kjo mund të themi se fokusi primar i departamentit të burimeve njerëzore është pikërisht puna e individëve në organizatë. Vështirësinë për të gjetur një person kompetent për punën në organizatë, e rritë mosha e vjetruar e punonjësve, kulturat e ndryshme, besimet e ndryshme fetare, e mbi të gjitha fuqia e konkurrencës globale. Detyrat (si proces) të gjetjes së personit kompetent, vështirësohen nga ngritja e internetit dhe vërshimit të ortekut virtual të përgjigjeve për publikimet e konkursit të punës (Prien, et al, 2009). Pikërisht nga një ndryshim i tille dhe nga një vështirësim i tillë, mund të themi se, pothuajse të gjithë menaxherët e burimeve njerëzore pajtohen se është e nevojshme një kujdes i shtuar në projektimin dhe analizën e punës. Analiza e punës mund të themi se është themeli i një përzgjedhje të mirë për vendin e punës. Analiza e punës bënë identifikimin e aftësive, zotësive dhe njohurive të nevojshme për kryerjen e një pune. Njohja e aftësive, zotësive dhe njohurive është e nevojshme para se të filloj përzgjedhja (Greer, 2003). (Prien, et al, 2009)janë të mendimit se, punësimi i njerëzve të gabuar në organizatë paraqet një rrezik serioz për të gjitha organizatat, qofshin ato të vogla apo edhe korporata të mëdha shumëkombëshe. Sipas këtyre autorëve, kostoja e një gabimi në punësim mund të jetë nga një e gjysmë deri në dhjetë herë paga vjetore e një individi.

## Rishikimi i Literaturës

Çdo organizatë në botë, pa dallim veprimtarie apo sektori, përbëhet nga pozita që duhet të jenë me personel. Për plotësimin e këtyre pozitave me personel, ekzistojnë disa procedura të cilat përcaktojnë detyrat e këtyre pozicioneve dhe kompetencat të cilat duhet të kenë personat që punojnë në këto pozicione. Në kompani këto procedura njihen me emrin analiza e punës. Ekzistojnë shumë definicione mbi analizën e punës, por një më e përgjithshme është se: Analiza e punës janë procedura për caktimin e detyrave, aftësitë e kërkuara për një punë dhe llojin e

personit që duhet të punësohet për të. Analiza e punës bënë identifikimin e aftësive, zotësive dhe njohurive të nevojshme për kryerjen e një pune (Greer, 2003). Ndërsa analizën e punës si një proces sistematik për grumbullimin dhe analizimin e informacionit rreth vendeve të punës, e cilëson autori (Hartley, 1999). Duke e ndare analizën e punës në dy grupe, ato që lidhen me përshkrimin e punës dhe ato të cilat lidhen me specifikimet e personit, autoret (Torrington, Hall, & Taylor, 2008) analiza e punës e cilësojnë si procesi nëpërmjet të cilit paraqiten kriteret individuale të punës, të përfshira në përshkrimet e punës dhe specifikimet e personit. Të menaxhosh me burimet njerëzor duhesh të njohësh punën në organizatë, gjegjësisht punën e individit. Sipas (Sharif & Karim, 2017) është pikërisht analiza e punës ajo e cila shqyrton pothuajse çdo gjë që lidhet me punën, dhe si e tillë ndihmon shumë për të kuptuar punën e dikujt. Pra një analizë e punës përfshinë aktivitetet (detyrat e punës), përgjegjësitë, mjedisin e punës, kualifikimet që kërkohen dhe vlerën e punës karshi arritjes së objektivave të organizatës. Siç edhe po shihet shumica e autorëve, në esencë kanë të njëjtat mendime dhe vlerësime mbi analizën e punës, mirëpo dallojnë në mënyrën e formulimit të definicionit dhe karakteristikave që ata i përmendin. Mirëpo (Sharif & Karim, 2017) krahas atyre karakteristikave përmendin edhe atë se analiza e punës është ajo që vlerëson se si të organizohet puna në drejtimin e realizimit të objektivave të organizatës dhe aspektin tjetër, vlerësimin se a janë detyrat të organizuara në atë formë që të arrihen objektivat e organizatës. Por ka edhe nga ata si (Baker, 2016)që janë të mendimit se termat "analizë e punës" dhe "përshkrim i punës" së shpejti për disa arsye do të zëvendësohen me termat "analiza e roleve" dhe "profili i roleve".

## Pse i analizojmë punët

Menaxheret janë persona që çdo ditë marrin vendime. Vendimet e menaxherëve janë të natyrave të ndryshme dhe përmasave të ndryshme. Të gjithë këta menaxher vendimet e tyre i marrin mbi bazën e informacioneve që kanë. Pra informacioni për menaxherët është një burim jetik i cili zoglën apo edhe eliminon probabilitetin e rrezikut për të gabuar. Ndërsa, rëndësia e informacionit rritet edhe më shumë kur bëhet fjalë për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me burimet njerëzore. Në esencë burimet njerëzore janë mjaftë komplekse për shkak të natyrës së tyre të ndryshueshme. Një njëri mund të sillet ndryshme në situata të ndryshme, dhe dy njerëz sillen ndryshe në situatë të njëjtë. Por një burim i mirë i informacionit që lidhet me burimet njerëzore është vet analiza e punës. Analiza e punës bëhet për të marr informacione që lidhen me punën, njerëzit dhe vlefshmërinë e tyre në arritjen e objektivave të organizatës. Këto informacione përdorën për punët e përditshme, për përshkrimin e punës, për specifikimin e punës, për procesin e rekrutimit, për procesin e seleksionimit, për procesin e shoqërimit (Orientimit) në punë, për procesin e menaxhimit të performancës, procesin e trajnimeve dhe zhvillimit. Ka edhe nga ata të cilët nuk kanë dëshirë të bëjnë përshkrimin e punës, si proces i analizës së punës. Sipas (Prien, et al, 2009)janë këto arsyet të cilat shtyjnë njerëzit të mos dëshirojnë të jenë pjesë e analizës së punës, arsyet janë:

- Është shumë punë, dhe unë kamë gjëra më të rëndësishme për të bërë;
- Është një humbje kohe: njerëzit e mi e dinë se cilat janë punët e tyre;
- Punët tona ndryshojnë shpejtë për të shkruar përshkrime;
- Një përshkrim i punës është shumë e kufizuar, unë dua që punonjësit e mi të jenë fleksibil.

Me gjithë këto arsye, informacionet që ne marrim nga analiza e punës e të cilat qojnë në përshkrim të punës janë thelbësore për çdo veprimtari të burimeve njerëzore. Po e lëmë se punonjësit e asaj kompanie po e dinë se çfarë do të punojnë, prapë se prapë është nevojshme për ato informacione të cilat do të ndihmojnë po ata punonjës në aspektin e trajnimeve dhe zhvillimeve. Është e vërtetë se në ditët e sotme shpejtësia e ndryshimit të punëve është evidente, po çfarë nëse ai punonjës e lë punën, a do të na nevojitën ato informacione për procesin e punësimit të një punëtori të ri, sigurisht qe po (Prien, et al, 2009).

## Përshkrimi i punës

Lidhjen mes analizës së punës dhe përshkrimit të punës e tregon edhe vet (Hartley, 1999) i cili thotë se nëse organizata juaj po fillon të identifikojë pozicionet kryesore të punës dhe t'i analizojë ato, kjo metodë është jashtëzakonisht e dobishme për krijimin e përshkrimit të vendeve të punës. Sipas po këtij autori përshkrimi i punës mund të rendis fushat e detyrave si të përgjithshme dhe më pas të përfshij disa apo edhe të gjitha detyrat për të specifikuar në një nivel më të detajuar. Krahas autorëve që kanë dhënë shpjegime për përshkrimin e punës dhe e cilësojnë si të nevojshme ka edhe nga ata autorë të cilët kanë opinione më ndryshe. Sipas (Sostrin, 2013) jo gjithmonë ajo se çfarë kërkojnë organizata dhe ekipi nga ju përshtaten me atë se çfarë del nga përshkrimi i punës. Ka edhe nga ato opinione si te (Baker, 2016) i cili në librin e tij thotë se përshkrimi i punës është një relikt i vjetruar, por prapë se prapë ne mbërthehemi me këtë mjet të vjetruar të menaxhimit të burimeve njerëzore. Përshkrimi i punës nuk është më relevant dhe i ka skaduar afati, e të cilin duhet ta hedhim në plehrat industriale e ta zëvendësojmë me diçka tjetër. Sipas këtij autori ajo që do të duhet ta zëvendësoj përshkrimin e punës është përshkrimi i roleve, dhe e mohon të jetë vera e vjetër në shishe të re. Shpjegimi i tij është se për dallim nga përshkrimi i punës i cili fokusohet drejt punës, përshkrimi i roleve fokusohet drejtë performancës.

## Specifikimi i punës

Shumë autor flasin për specifikimin e punës si proces i menaxhimit të burimeve njerëzore. Një specifikim i punës përpilohet duke përdorë informacionet që kanë dalë nga një përshkrim i punës (Kleynhans, et al, 2007). (Andrews, 2006) thotë se një specifikim i punës përcakton llojin e personit që kërkohet për një punë e cila është përcaktuar nga përshkrimi i punës. Sipas (Deb, 2006) një specifikim i punës është një deklaratë e cila përcakton shkathtësitë, kualifikimet, tiparet, karakteristikat mendore dhe fizike të individit, e të cilat nevojiten për të kryer një punë apo detyrë në mënyrë efektive. Një mendim të përafërt kanë edhe (Kleynhans, et al, 2007) por me një logjikë të grupimit, e të cilët thonë se specifikimi i punës është dokumenti i cili përmban kualifikimet minimale të pranueshme të personit për të kryer punën. Këto kualifikime autorët i ndajnë në tri grupe, si zotësitë, njohuritë dhe aftësitë. Specifikimet e punës gjithashtu ndihmojnë në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit (përzgjedhjes) së punonjësve në kompani (Andrews, 2006).

## Roli i analizës se punës ne trajnime

Në një organizatë punëtorët punësohen për të kryer punë të ndryshme. Sa më mirë, që jemi në gjendje të lidhim punëtorin me punën, si menaxher, aq më të suksesshëm jemi. Analiza e punës na ofron të dhëna mbi punën dhe punëtorët, ndërsa trajnimet i mbajnë të përditësuara lidhjet ndërmjet punës dhe punëtorit. Ato detyra që përzgjidhen nga analiza e punës për përfshirje në programin fillestar të trajnimit duhet që të analizohen edhe me tej për të identifikuar informacionin e nevojshëm që duhet të përdoret në dizajnimin dhe zhvillimin e trajnimit (Wolfe, et al, 1991). Ndërsa (Buckley & Caple, 2007) thonë se shumë përfaqësime diagramatike të një qasjeje sistematike të trajnimit tregojnë analizën e punës si një fazë e hershme në procesin e dizajnimit të trajnimeve. Pra çdo ndryshim në procedurat e punës ose pajisjet etj, duhet të futën në sistem me qellim që informacioni i mbajtur nga trajnerët të përditësohet. Duhet të kenë kujdes menaxherët e burimeve njerëzore, të masin nëse trajnimi i mbajtur ka ofruar rezultatet e pritura. Kjo mund të arrihet duke vlerësuar rezultatet pas trajnimit nëse përputhen me karakteristikat e dala nga analiza e punës për at vend të punës.

## Metodat e analizës se punës

Në çdo proces, ekzistojnë edhe metodat e zhvillimit dhe funksionimit të atij procesi. Edhe analiza e punës ka metodat e analizës së punës. Ata që bëjnë analiza të punës duhet gjithmonë të kujtojnë qëllimin për të cilin informacioni do të përdorët, pasi ky qëllim siguron kontekstin si në mbledhjen e të dhënave ashtu edhe në përshkrimin e punës(Prien, et al, 2009). Ekzistojnë përparësi dhe dobësi në secilën prej metodave që ju përdorni, por duhet të vlerësoni mirë gjendjen tuaj gjatë përgatitjes për analizën e punës dhe mbledhjen e të dhënave me rendësi

(Hartley, 1999). Sipas (Prien, et al, 2009) janë pesë metoda të ndryshme për mbledhjen e të dhënave për analizën e punës. Këto metoda janë:

1. Vet-raportimet;
2. Vëzhgimet direkte;
3. Intervista;
4. Shqyrtimet e dokumenteve;
5. Pyetësorët dhe anketimet.

## Vet-Raportimet

Burimet më të dukshme dhe më lehtë të qasshme për të marrë informacion në lidhje me një punë janë ata të cilët aktualisht mbajnë atë punë. Natyrisht, kjo qasje është e përshtatshme vetëm për punë mjaft të thjeshta, që nuk kërkojnë ndonjë aftësi specifike apo një numër të madh trajnimesh(Prien, et al, 2009).

## Vëzhgimet Direkte

(Prien, et al, 2009) thonë se shumë punë mund të studiohen duke vëzhguar një nëpunës duke kryer punët. Ata rekomandojnë se nëse do vendosej një kamerë për të vëzhguar punën e një personi, kjo do e zvogëlonte “Efektin e Audiencës”. Nëse do vendosej një aparat fotografik kjo jo vetëm që do e zvogëlonte efektin e audiencës por edhe do të na mundësonte të ruajmë fragmente kohore të sjelljeve të individit në punë.

## Intervista

Kufizimet e vet-raportit dhe vëzhgimit të drejtpërdrejtë, kanë quar pikërisht në përdorimin e intervistës si qasja më e përdorur në analizën e punës. Këto intervista duhet të kryhen nga një person i aftë dhe i trajnuar, që e njeh punën, din të bëjë pyetje dhe të kërkoj përgjigje më të hollësishme në raste të nevojshme. (Prien, et al, 2009). Këta autorë po ashtu theksojnë se janë dy lloj intervistash: Intervista Grupore dhe individuale.

## Shqyrtimet e dokumenteve

Në shumicën e arkivave nëpër ndërmarrje ekzistojnë dokumente të rëndësishme, të cilat janë të dobishme për kryerjen e analizës së punës. Memorandumi i brendshëm për ngjarjet e pazakonshme, rekomandimet e auditorëve të brendshëm, vështirësitë e një pune të hasur nga punëtorët, problemet në rekrutimin e aplikantëve për një punë të caktuar, regjistrat e kohës dhe frekuentimit etj, janë të rëndësishme për analizën e punës (Prien, et al, 2009).

## Pyetësorët dhe Anketimet

Në përdorimin e një pyetësori, analisti i punës zakonisht i kërkon të intervistuarit që të vlerësoj një sërë detyrash që lidhen me punën. Hapi i ardhshëm është krijimi i një liste me kërkesat e nevojshme për punën, dhe së fundmi për të identifikuar gamen e performancës së punës duke përdorur një shkallë të vlerësimit (Prien, et al, 2009).

## Përfundim

Në çdo biznes ka probleme te natyrave të ndryshme, por një nder problemet më të mëdha që kompanitë përballën është identifikimi i personit adekuat (Kompetent) për atë punë. Janë disa faktorë që e vështirësojnë identifikimin e personit adekuat për punën dhe ato janë: mosha e vjetruar e punonjësve, kulturat e ndryshme, besimet e ndryshme fetare, e mbi të gjitha fuqia e konkurrencës globale. Për një përzgjedhje të mirë duhet të dihen aftësitë, zotësitë dhe njohuritë e nevojshme të individit e të cilat duhet të dihen para se të filloj përzgjedhja. Një përzgjedhje e gabuar mund të qoj në një dëm të madh financiar dhe organizativ. Një analizë e punës është e lidhur edhe më objektivat e organizatës si në përcaktimin e tyre ashtu edhe në orientimin për arritjen e tyre. Ekzistojnë edhe disa arsye që punonjësit nuk dëshirojnë të përfshihen në analizën e punës, edhe pse shumica e autorëve e cekin se është e nevojshme një analizë e punës. Ekzistojnë edhe mendime të kundërta që e vlerësojnë si të vjetruar dhe të nevojshme për zëvendësim më procese të tjera. Procesi i analizës së punës ndihmon në procesin e rekrutimit,

seleksionimit, Trajnimit deri tek menaxhimi i performancës. Ekzistojnë pesë metoda për mbledhjen e të dhënave në analizën e punës.

**Rekomandime**

- Të shfrytëzohet analiza e punë, si mjet për minimizimin e problematikës së identifikimit të individit kompetent për at pozicion pune.
- Ti kushtohet një trajtim i veçanet në analizën e punës, faktorëve që vështirësojnë identifikimin e personave kompetent për punën.
- Në analizën e punës të përfshihen pika që identifikojnë aftësitë, zotësitë dhe njohurit minimale të nevojshme për të kryer at punë.
- Të përdorët analiza e punës si bazë e informacionit për punën dhe kompetencat e individit, me qellim të  minimizimit të rrezikut për gabim, gjatë përzgjedhjes se punonjësve.
- Analiza e punës të jetë një dokument, i cili shfrytëzohet për të marrë informacion në përcaktimin e objektivave të organizatës dhe orientimin drejt arritjes së tyre.
- Punonjësit e organizatës, të lënë anash teket e tyre dhe të angazhohen në realizimin e analizës së punës.
- Të shfrytëzohet analiza e punës në procesin e rekrutimit, seleksionimit dhe menaxhimit të performancës.
- Të shfrytëzohet analiza e punës në evidentimin e nevojave për trajnim dhe në hartimin e përmbajtjes së trajnimit.

# BORXHI PUBLIK DHE MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK NE REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

**Doc.Dr.Llokman Hebibi**

**PhD Cand.Armend Asllani**

## ABSTRAKT

Politika fiskale ka për qëllim që në mënyrë të arsyeshme t'i balancojë dy qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës Maqedonia e Veriut, të cilat janë ruajtje e stabilitetit makroekonomik dhe motivim i aktivitetit ekonomik nëpërmjet rritjes së cilësisë në financat publike, para së gjithash nëpërmjet të dalave kapitale për përmirësimin e infrastrukturës dhe përforcimin e kapaciteteve në sektorin privat për rritje dhe hapje të vendeve të reja të punës.

Duke e marrë parasysh pasigurinë e madhe globale, ekonomike dhe financiare, me rëndësi të veçantë është vlerësimi i qëndrueshmërisë së pozitës së jashtme dhe qëndrueshmëria financiare e vendit. Nevoja për këtë lloj vlerësimi është akoma më e rëndësishme kur punohet për ekonomi të vogël dhe të hapur me kurs fiks të këmbimit, Maqedonia e Veriut .

Qëndrueshmëria e nivelit të borxheve nuk varet vetëm nga borxhi i vlerave nominale, por edhe nga zbatimi i politikave të suksesshme për zmadhimin e rritjes ekonomike e gjithashtu nga qeverisja e mirë me borxhe. Në këtë kontekst të përgjithshëm, politikat fiskale janë të një rëndësie të madhe, meqë menaxhimi i borxhit mund të arrihet vetëm nëpërmjet një kuadri fiskal të arsyeshëm. Njëkohësisht, zbatimin e një politike makroekonomike më efikase dhe reforma strukturore do të rezultojnë në një klimë më të mirë investimi dhe përshpejtimin e rritjes i cili do të ishte më pak i varur nga financimi zyrtar afatgjatë.

Fjalët kyçe: Borxhi publik,Politika Fiskale,BPV,norma e interest

## Borxhi Publik dhe menaxhimi i borxhit publik ne Republikën e Maqedonisë së veriut

Analiza kohore fillon me shqyrtimin e dinamikës së borxhit publik në ekonominë Maqedonase dhe vazhdon me analizë më detale në strukturën e re nga pikë vështrimi i rreziqeve të ndërlidhura me menaxhimin e tyre. Analiza mbaron me shqyrtim të dinamikës së rritjes ekonomike në vend dhe strukturës së saj sipas metodës shpenzuese.




Grafikon 1: Lëvizja e borxhit shtetëror dhe publik (në % të BPV) Në Maqedoninë e Veriut në periudhë prej 2008 - 2017

Në periudhën e vitit 2008 gjer më v. 2017 është vërejtur rritje e konsiderueshme si në borxhin shtetëror po ashtu edhe publik në Maqedoninë e Veriut. Nga niveli më i ulët prej 19,1% në v. 2008, borxhi shtetëror në v. 2012 për herë të parë e ka tejkaluar nivelin prej 30%, e në v. 2016 ka arritur nivelin prej 40,6% në raport me BPV. Borxhi publik, nga niveli më i ulët prej 21,4% në v. 2008 për herë të parë e ka tejkaluar nivelin prej 30% në v. 2011, niveli prej 40% në v. 2013 për v. 2016 që t'a arrijë nivelin më të lartë prej 48,9% në raport me BPV. Por, edhe krahas rritjes së konsiderueshme të borxhit publik, niveli i tyre në gjithë periudhën e analizuar ka mbetur sipas kritereve të Mastrihtit për borxh publik prej 60% në raport me BPV. Rritja e konsiderueshme në periudhën e analizuar shënon edhe borxhin e garantuar, i cili prej 2,2% në v. 2008 ka arritur 8,8% në raport me BPV në v. 2016, që ka të bëjë me rritje të shumës së borxheve të ndërmarrjeve publike për të cilën pagesë garanton shteti.

Duke marrë parasysh origjinën, borxhi i brendshëm shënoi pjesëmarrje më të vogël në strukturën e borxhit shtetëror në gjithë periudhën dhe kjo e fundit në mesatare është rreth 35%.




Grafikon 2: Struktura e borxhit shtetëror në Maqedoninë e Veriut sipas origjinës në v. 2008 - 2017

Pjesëmarrja shënon rënie në periudhën prej 2008-2011 nga niveli mbi 30% deri në nivel më të madh prej 24,4% në v. 2011. Në periudhën 2012 – 2104 është shprehur lëshim i madh i letrave shtetërore afatshkurta, edhe atë në shënimet tremujorësh shtetërore gjatë vitit 2012 dhe tremujori i parë i vitit 2013, pastaj në shënimet shtetërore të gjashtëmujorit gjatë vitit 2013 dhe gjysma e parë e vitit 2014. Si pasojë e saj, borxhi i brendshëm në v. 2014 e ka arritur pjesëmarrjen prej 44,1%. Në periudhën pas vitit 2014, pjesëmarrja në borxhin e brendshëm ka shënuar rënie deri në nivelin prej 35 – 40%.

Struktura e interesit të borxhit shtetëror aludon në pjesëmarrjen më të madhe të borxhit me normë fikse të interesit në gjithë periudhën analizuese.



Grafikon 3: Struktura e interesit të borxhit shtetëror në Maqedoninë e Veriut në periudhë e v. 2008 - 2017

Pjesëmarrja e saj në periudhën e v. 2008 – 2010 qarkullon në nivelin mbi 60%, ku pjesëmarrja më e madhe është arritur në v. 2009 të 77,4%. Në periudhën e v. 2011- 2014 është vërejtur rritje e borxhit me normë variabël të interesit, kështu që ajo me interes fiks ka pësuar rënie nën 60% edhe në v. 2012 e ka arritur pjesëmarrjen më të ulët prej 50,9%. Rritje të sërishme të pjesëmarrjes së borxhit me interes fiks dhe mbajtja e nivelit të saj mbi 60% është vërejturnë periudhën e v. 2014 – 2017. Duhet të merret parasysh se në periudhën e v. 2011 – 2014 është vërejtur rënie e konsiderueshme të normave referuese të interesit si bazë për llogaritjen e normës variabël të interesit, kështu që rritja e pjesëmarrjes së borxhit me normë fikse të interesit në këtë periudhë paraqet politikë të arsyeshme ekonomike në drejtim të zbutjes së rrezikut të interesit.

Sipas strukturës valutore të borxhit shtetëror, veçanërisht është vërejtur rritja e borxhit të shndërruar në denarë dhe euro për llogarinë e uljes së pjesëmarrjes me të drejtat e veçanta për tërheqje, ndërkaq pjesëmarrja e borxhit të shndërruar në dollarë amerikan dhe valuta të tjera është i parëndësishëm.




Grafikon 4: Struktura valutore e borxhit shtetëror në Maqedoninë e Veriut në periudhën e v. 2008 – 2017

Pjesëmarrja e borxhit e shndërruar në denarë dhe euro ka qenë më e ulët në v. 2012 prej 76.4, por që atëherë lëvizja është në rritje e sipër që për vitin 2017 të arrihet në 92,6%. Kjo politikë e menaxhimit të borxhit është më e volitshme në pikëpamje të zbutjes së rrezikut valutor për shkak të politikës të kursit fiks revizor e denarit me euro. Efekti më i pafavorshëm i rrezikut valutor është vërejtur në v. 2011, kur pjesëmarrja e borxhit në SDR ka qenë më e lartë, gjegjësisht në nivel prej 25%, ndërsa vlera e 1 SDR ka shënuar rritje. Megjithatë, pjesëmarrja e borxhit në SDR ka filluar konsiderueshëm të bie nga v. 2012 dhe në v. 2017 ka rënë në nivelin prej 5,9%.

Prodhimi bruto – vendor në periudhën e analizuar shënon rritje mesatare nominale prej 2,4%, në të cilën rritja negative është vërejtur në 7 mujorin. Normat më të larta të rritjes janë vërejtur gjatë vitit 2008, kur BPV në nivelin vjetor është rritur për 5,5%, që ka të bëjë me nivelin e lartë të të kërkesës vendore, e cila pjesëmarrje në strukturën e BPV ka qenë në nivel prej 125%. Dinamika e rritjes ekonomike në periudhën prej 2009 – 2012 ka qenë nën ndikim të madh të rreziqeve të jashtme, ku është vërejtur rënia e neto importin nga njëra anë, por edhe rënie e konsiderueshme e kërkesës vendore nga ana tjetër. Kjo është periudhë në të cilën shteti nuk ka arritur që borxhin e rritur ta ul me motivim të konsumatorit dhe investimeve. Por, në periudhën e viteve 2013 – 2016 është vërejtur stabilizimi i dinamikës së rritjes ekonomike dhe përshpejtimit të saj, që në masë të madhe është pasojë e kërkesës së përforcuar vendore nëpërmjet rritjes së bruto investimeve të bilancit tregtar nëpërmjet rritjes së eksportit. Bruto – investimet kanë arritur nivel mbi 30%, ndërsa neto – eksporti është ulur për rreth 10 – 15% në raport me BPV. Prishja e

dinamikës së qëndrueshme të rritjes ekonomike ka pësuar në vitin 2017, ku vjen deri tek rënia e konsiderueshme e bruto – investimeve.

Borxhi publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të vitit 2017 përmban shumë prej 4.786,9 milion euro që paraqet 47,6 në raport me BVP. Borxhi i jashtëm publik ngërthen rreth 3.187,5 milion euro, ndërsa borxhi publik i brendshëm është 1.599,4 milion euro. Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së veriut në fund të vitit 2017 qarkullon 3.958,5 milion denarë gjegjësisht 39,3% në raport me BPV. Me këtë nivel të borxhit shtetëror, Republika e Maqedonisë së Veriut edhe më tej mbetet vend me borxh të moderuar me borxh shtetëror i cili është më i ulët nga niveli mesatar i vendeve të EU 28, i cili në fund të vitit 2017 ngërthen 81,6%[78] . Borxhi shtetëror i jashtëm në fund të vitit 2017 është 2.376,8 milion euro dhe në raport të vitit 2016 zvogëlohet për 69,8 milion euro, ndërsa borxhi i brendshëm shtetëror është 1.581,7 milion euro, që paraqet rritje për 176,8 milion euro në raport me vitin e kaluar. Nga aspekti i strukturës valutore të borxhit shtetëror, në fund të vitit 2017 pjesëmarrje dominuese ka borxhi i shndërruar në euro i cili merr pjesë me 71,6% në portfolio të përgjithshme dhe është i zmadhuar për 1,7 p.p në raport me vitin 2016. Borxhi në valutën vendore në të njëjtën periudhë ulet për 0,36 p.p, gjegjësisht nga 21,7% në 21,4% në fund të vitit 2017. Borxhi i normave fikse të interesit rritet për 0,3 p.p në krahasim për 2016, dhe në fund të vitit 2017 ngërthen 72,3%. Rritja e borxhit me normë fikse është rezultat i nivelit të zmadhuar të bonove shtetërore të nxjerra në tregun vendor që kanë normë fikse të interesit, ndërkaq borxhi i jashtëm shtetëror me normë fikse të interesit ka vërejtur ulje të nivelit vjetor. Në raport me realizimin e limiteve të përcaktuara në Politikën për menaxhim të borxhit publik si pjesë integruese nga “Strategjia fiskale e vitit 2017 – 2019”, mund të konstatohet se borxhi publik është në kuadër të limiteve të verifikuara, gjegjësisht Ministria e financave menaxhon me borxhin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me autorizimin nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të “ Strategjisë fiskale 2017 – 2019” ka qenë e definuar në nivel maksimal të borxhit publik prej 60% të BPV në afat të mesëm dhe afat gjatë, ndërsa e verifikuar ka qenë edhe niveli i borxhit të garantuar publik prej 13% të BPV. Në fund të vitit 2017, borxhi publik dhe i garantuar janë në kuadro të vendosura, në të cilën borxhi publik është 47,6% të BPV, ndërsa borxhi i garantuar është 8,2% të BPV. Më tej, në mbështetje të limitit për strukturë valutore të borxhit shtetëror, euro borxhi në portfolio të borxhit në valutë të huaj duhet të jetë i përfaqësuar me më së paku 80%, e duke e përfshirë 31 – dhjetor të vitit 2017, euro borxhi është 91%. Gjithashtu, realizimi i limitit për normë të interesit është e suksesshme. Me fjalë të tjera, me “Starategji fiskale 2017 – 2019” ka qenë i verifikuar limiti për strukturë fikse të interesit të borxhit shtetëror sipas së cilës borxhi me normë fikse të interesit duhet të jetë i përfshirë me së paku 50% të portfolios së borxhit , ndërsa në fund të viti 2017 borxhi me normë fikse ka marrë pjesë me 72,3% në strukturën e borxhit shtetëror. Në mbështetje të targetëve për verifikim të nivelit optimal dhe strukturës së portfolios së borxhit publik, me “Strategji Fiskale 2017 – 2019” kanë qenë të përkufizuara dhe limite afatshkurta që kanë të bëjnë vetëm për vitin 2017. Kështu që, limiti maksimal për neto – borxhin (vendor dhe të huaj) në bazë të borxhit shtetëror në v. 2017 ka qenë e vërtetuar në 500 milion euro, përderisa ka qenë e realizuar borxhi – neto prej 107 milion euro, kryesisht për shkak të lëshimit të pezulluar të euro bonove të planifikuara në tregun ndërkombëtar të kapitalit për fillimin e vitit 2018.

Me qëllim të uljes së rrezikut nga obligimi potencial në portfolion e borxhit publik, me Strategjinë ka qenë e përkufizuar shuma maksimale vjetore e neto - borxhit në bazë të borxhit të garantuar të ndërmarrjeve publike prej 180 milion euro për v. 2017. Për shkak të krizës politike dhe realizimi i ngadalësuar i projekteve, në v. 2017 ka qenë e realizuar huamarrja – neto negative prej 31,5 milion euro. Me këtë neto – huamarrje në v. 2017 në bazë të borxhit të garantuar shtetëror të ndërmarrjeve publike kanë qenë në kuadër të limiteve të vendosura me strategji fiskale. Me pretendim që të mbrohet portfolio e borxhit të qeverisë qendrore nga rreziku për ri financim, është definuar limiti sipas së cilës niveli minimal i

[78]Eurostat (2018), Eurostat news release euro indicators No. 70/2018

indikatorit" Koha mesatare e dërgimit" në vitin 2017 duhet të jetë 3 vjet. Duke e marrë parasysh se duke e përfshirë 31 – dhjetorin e v. „Koha mesatare e dërgimit është 4,6 vjet, dhe mund të konstatohet se ky indikator është në kuadër të limitit të përcaktuar. Më tej, për " kohë mesatare të ndryshimeve të normave të interesit" duhet ta mbrojë portfolion e borxhit të qeverisë qendrore nga rreziku i ndryshimit të normave të interesit me çka është përcaktuar niveli minimali i këtij indikatori në v. 2017 të jetë 2 vjet. Në fund të vitit 2017

## Konkluzion

Krijimi i borxhit publik mund të jetë vegël e dobishme në duart e shtetit, nëse kjo shfrytëzohet me të drejtë dhe nëse shërben për motivimin e rritjes ekonomike afatgjate dhe afat shkurtër, për udhëheqjen e politikës makroekonomike e cila gjatë kohës së recesionit do ta kthejë ekonominë në gjendje të rritjes. Ekonomistët aludojnë edhe në atë se borxhi publik duhet të menaxhohet shumë kujdesshëm, meqë nevoja e saj jashtë mase mund të sjellë tek problemet me shlyerjen e financave publike, veçanërisht të buxheteve lokale apo qendrore të shteteve. Ai mund ta motivoj inflacionin, e me të t'i rris edhe interesat në ekonomi, e madje edhe ti rrënojë edhe tregjet financiare nëpërmjet fenomenit të ashtuquajtur " zhvendosjen e sektorit privat" nga fusha e investimit. Gjatë ekzistimit të fenomenit të fundit, investitorët privat i drejtojnë parat e tyre në financim të jo shpesh shpenzimeve joproduktive të shtetit.

Borxhi publik e ul kursimin në ekonomi, sepse ajo paraqet një lloj të kursimit rrjedhës negativ të shtetit, gjegjësisht është neto huadhënës, ndaj kthimi i atij borxhi do të shkaktojë kursime të zvogëluara në ekonomi në të ardhmen. Borxhi i jashtëm publik mund të sjellë deri tek rrënimi më i madh serioz të marrëdhënieve në bilancin arkëtues në vend dhe mos shlyerja e jashtme e saj deri në shkallën e shpalljes së falimentimit formal.

Kur flitet për shanset e R. së Maqedonisë së Veriut për realizimin e rritjes së shpejtuar ekonomike dhe administrimi me të hyrat dhe të dalat publike, është e nevojshme të përmendet se në vazhdimësi rriten apetitet për rritjen e të hyrave publike dhe ngarkesës së shpenzimeve publike në ndërmarrje por edhe të qytetarëve. Edhe krahas normave të qëndrueshme tatimore, rritet baza tatimore, gjegjësisht përfshirje tatimore. Edhe krahas asaj që R e Maqedonisë së Veriut është vend mesatarisht në borxh me aspirata për mbajtjen e nivelit të mesëm të borxhit dhe shërbimi i detyrimeve të borxheve, dalë ngadalë hyn në grackën e borxheve, me gjoja deficite të kontrolluara, të cilët disi sikur të dalin nga kontrolli dhe nga viti në vit janë jashtë nivelit të projektuar. Deficiti duhet gjithnjë e më tepër të financohet nga vendorët, në vend të burimeve të huaja të huamarrjes dhe me të borxhi publik të vendoset nën kontrollin afatgjatë. Gjithashtu, norma e rritjes ekonomike duhet të ngritët në nivel mbi 4 – 5 për qind në vit për dhe sipas këtij motivi të ulet pjesëmarrja e borxhit publik në BPV në vend.

### Literatura e shfrytëzuar


- Ligji i borxhit publik – Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 165/2014
- Ligji i buxheteve (versioni i azhurnuar)
- Raporti i progresit IRJMV 2016
- Eurostat (2018), Eurostat news release euro indicators No. 70/2018
- Ministria e financave dhe Banka popullore e RMV

ISSN 1800-9794 (Print) ISSN 2337-0521 (Online)

# ASETET ETNO-KULTURORE NË HAPËSIRËN NDËRKUFITARE ANA E MALIT, POTENCIALE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT KULTUROR.

**Dr.Ylber Dyli**

**Medreseja "Haxhi Sheh Shamia"**

**Enes Alushi**

**Abstrakt**

Turizmi kulturor është një veprimtari turistike në të cilën asetet e trashëgueshme kulturore paraqiten për konsum nga turistët. Proçesi i aderimit të vendeve të Ballkanit perëndimor në familjen europiane ka nxitur dhe kthyer në domosdoshmëri procesin e bashkëpunimit në shumë fusha ndërmjet shteteve, veçanërisht në hapësirat ndërkufitare.Sot politikat e Bashkimit Europian në krijimin e planeve strategjike për zhvillimin e hapësirave ndërkufitare, një vend të veçantë i kushtojnë zhvillimit të turizmit kulturor.

Sipërfaqja e hapësirës ndërkufitare Ana e Malit është159.85 Km$^2$ prej së cilës70.3% i përket Malit të Zi ndërsa 29.7% i perket Shqipërisë.Hapesira malazeze banohet nga 97% shqiptarë,të cilet pavarësisht nga politika asimilusese dhe shkombëtarizuese ruajtën identitetin e tyre etnik dhe kulturor të të qenurit shqiptar.

Hapësira ndërkufitare Ana e Malit e trajtuar në këtë studim përmban asete mjaft të rëndësishme si potenciale për zhvillimin e turizmit kulturor.Këto resurse përfshijnë elemente të kulturës material dhe asaj shpirtërore të kultivuara ndër shekuj dhe të trashëguara deri në ditët e sotme. Shasi antik dhe mesjetar,arkitektura e urës së Klleznës, mullinjtë për bluarje si dhe arkitektura e banesave janë dëshmi e gjallë e trashëgimisë arkitekturore.Trashëgimia e kulturës material pasurohet edhe me veshjet karakteristike, orendi shtëpiake etj.Trashëgimia shpirtërore pasurohet me element të folklorit si këngë dasmash, ninulla dhe festa.

Pozicioni i ndërmjetëm i Anës së Malit midis Shkodres dhe Ulqinit si qëndra ekonomike dhe kulturore, dogana e përbashkët Sukobin-Muriqan, lëvizja e një numri të konsiderueshëm turistësh të huaj prej kësaj pike doganore ( mesatarisht mbi 320 mijë turistë në vit) bën që kjo hapësirë të ketë vëmendjen e duhur në zhvillimin e turizmit kulturor.

Fjalë kyçe: *Hapësira ndërkufitare, Trashëgimi, Monumente arkitekturore, Muze, Turizëm*

Hyrje

Turizmi kulturor dhe arkeologjik në ditet e sotme ka marrë një fokus të veçante në ditët e sotme mes popujve. Ai shihet si udhëtim i motivuar i turistëve nga kultura dhe historia e njërajoni apo hapësire të caktuar e pasur me objekte arti,monumente, zona arkeologjike tradita apo zakone të trashëguara ndër shekuj. Turizmi kulturor sot shihet i fokusuar në dëshirën për të njohur kulturën e popujve fqinjë apo më gjerë nëpërmjet vizitimit të komuniteteve tradicionale të cilët kanë formësuar praktika sociale të veçanta të artit,dokeve,zakoneve të ndryshme,monumenteve dhe hapësirave arkeologjike.

Ndasitë dhe urrejtjet e vjetra mes popujve, sot në periudhën e globalizmit, po zëvëndësohen nga dëshira për të njohur kulturën, traditat dhe zakonet e popujve,duke e bërë mjaft popullor turizmin me destinacion kulturën dhe historinë e popujve.Trashëgimia kulturore dhe natyrore po thyen kufijtë ndërshtetërorë të krijuar nga njerëzit shekuj më parë.

Në kuadër të procesit të Integrimit të shteteve të Ballkanit perëndimor në familjen evropiane,krijimit të politikave të reja ndërshtetërore me bazën e reciprocitetit dhe marrëdhënieve të përbashkëta të fqinjësisë se mirënjohja e historisë dhe e kulturës së popujve sot eshte bazike në ndërtimin e të ardhmes së përbashkët.Në këtë kontekst hapësirat ndërkufitare sot nuk shihen si më parë si hapësira dhe llogore lufte por pikat e takimin mbi të cilën të ndërtohet e ardhmja e përbashkët.Hapësira ndërkufitare Ana e Malit e pasur me tradita dhe kulturë mijëravjecare mund të vendoset dhe ka potenciale për zhvillimin e turizmit kulturor dhe të shërbejë në afrimin mes popujve larg ndasisë dhe urrejtjes.

Materialet dhe metodat

Për realizimin e këtij studimiështë hulumtuar dhe janë marrë në konsideratë burime arkivore,historike në tëdy hapësirat,atë shqiptare dhe malazeze.Nëpërmjet metodës statistikore dhe asaj hartografike dhe krahasuese është mundësuar, besoj,një prezantim serioz me vlera dhe I dobishëm për të ardhmen.Vëzhgimi dhe ekspeditat në terren të këtyre aseteve historiko-kulturore I kanë bërë më të prekshme dhe reale në funksion për destinacion turistik në tëardhmen.

Rezultati

Hapësira ndërkufitare Ana e Malit ndodhet në brezin kufitar Shqipëri-Mali i Zi dhe ka një sipërfaqe prej 159,85 km$^2$ dhe në një pozitë mjaft të favorshme gjeografike, pasi ndodhet ndërmjet dy qëndrave të rëndesishme urbane dhe kulturore Shkodrës dhe Ulqinit. Prezenca e pikës së përbashkët doganore Muriqan-Sukobin që shërben për kalimin e njerëzve mundëson njohjen nga afër të kësaj hapësire dhe vlerave të saja historike dhe kulturore.Kjo pikë doganore po shfrytëzohet nga shtetas të huajpër hyrje dhe dalje ku numri i të cilëve po rritet vit pas viti. Në vitin 2017 kanë hyrë nëpërmjet kësaj dogane 364 253 shtetas të huaj të në territorin shqiptar,ndërsa në vitin 2018 kanë hyrë 376 816 shtetas të huaj[79],ose 12 563 persona më tepër se viti paraardhës. Ana e Malit mbart vlera mjaft të rëndësishme historike,arkeologjike,tradicionale dhe kulturore.Popullsia në hapesirën malazeze pavarësisht sëkaluarës së hidhur dhe politikave për asimilim sot banohet nga 97 % shqiptarë[80], të cilët kanë ruajtur gjuhën,historinë, kulturën, traditën dhe zakonet e vjetra[81].

Objektet etno-kulturore me destinacion turistik.

Fondi i trashëgimisë etno-kulturore është shumë i pasur dhe përfshin mjaft objekte dhe pasuri të kulturës materialë dhe shpirtërore.Në këtë fond bëjnë pjesë monumente arkeologjike,banesa tradicionale,pazare, hane, trashëgime etnografike (veshjet popullor,punime artizanale,tekstile etj),të kulturës shpirtërore(folklori,dasmat,ninullat,festat).

***Shasi***, sot përfaqëson një vendbanim në krahinën etno-kulturore të Anës së Malit në hapësiren malazeze. Ai shtrihet në veri-lindje të Ulqinit në një largësi prej 22 km.Shasi ka njëtë kaluar historike dhe religjoze mjaft interesante.Zbulimet arkeologjikeme karakter njohës portëcunguara, të ndërmara në vitin 1985[82], dëshmojnë për një vendbanim prehistorik të epokës neolitike.Qeramika e kësaj epoke,gjurrmët e një fortifikimi të hershëm,rruga antike Ulqinjum-Svacium-Scodra,janë dëshmi e gjallë e këtij vendbanimi prehistorik i cili arriti kulminacioni në mesjetë duke u kthyer në një qendër urbane mjaft e rëndësishme për kohën.Qyteti iShasit në periudhën ndërmjet shekujve VI-XVI luajti rolin e një qëndre urbane mjafttë zhvilluar edhe në aspektin tregtar,duke patur edhe monedhën e tij’’Sovaci Civitas’’[83].Gjatë kësaj periudhe, Shasi u kthye në një qëndër e rëndësishme fetare në një peshkopatë,madje sipas dorëshkrimeve të vjetra

---

[79] Dogana shqiptare Muriqan.

[80] Monstat 2011,Montenegro.

[81] Çagjenoviç,Jovan,”*Jeta dhe zakonet e shqiptareve*”,Koha Janar-Shkurt 1/1979,Titograd,fq 74-80.

[82] Çilikov,Aleksander,”*Rezultatet dhe rendesia e hulumtimeve arkeologjike te qytetit te vjeter te Shasit*”, Shasi I lashte monument i kultures,Ulqin 2009,fq23-32.

[83] Draga Nail,”*Ulqini qytet antik me transformim bashkohes*”,Kerkime Gjeografike,Prishtine 1987,fq 111-122

ISSN 1800-9794 (Print) ISSN 2337-0521 (Online)

kishte 365 kisha[84].Për rëndësinë që ka patur,Shasi u bë preh e pushtimeve të Duklës dhe Zetës, madje edhe më keq, u shkaterrua dhe u dogj nga sulmet shkatërrimtare të mongolëve në vitin 1242.Ekzistenca e mureve të kishave,hapësira arkeologjike,historia e Shasit përbën një destinacion mjaft të rëndësishem turistik.

***Ura e Klleznës***,është ndërtuar në fundin e shekullit XVII,në vitin 1696 mbi përroin e Megjyrecit.Historia e ndërtimit,arkitektura dhe funksioni që pati në lidhjen e Ulqinit me Shkodrën deri në vitin 1954 e bejnë interesante dhe të vizitueshme.Ura e Klleznës ka një gjatësi prej 12 m,gjeresi 3,60 m dhe lartësi nga fundi i perroit 9,26 m[85].Sot ura e Klleznës ka nevojë për statusin e një monumenti kulture sidhe përrestuarimin pasi në vitin 1982,pësoi dëmtim për shkak të vendosjes së tubacioneve të ujësjellësit Mille - Ulqin.Vlerat arkitektonike të kësaj ure mesjatare duhet të jenë në qendër të vëmendjes nga institucionet përgjegjëse të komunës së Ulqinit për restaurimin dhe mirëmbajtjen e saj duke e kthyer në një atraksion turistik.




***Mullinjtë.***Mullintë me ujë përbëjnë një nga pasuritë më të rëndësishme të së kaluarës me të cilët popujt kanë siguruar bukën. Pasuria ujore e fshatrave të Anëës së Malit, veçanërisht në shpatin e Taraboshit I ka mundësuar ndërtimin e tyre me funksion bluarjen e drithit.Pavarësisht se në ditët e sotme këto objekte me karakter ekonomik,në kushte globalizmi kanë dalë jashtë funksionit, për shkak të rëndësisë që kanë patur ,ndërtimi dhe funksionimit të tyre, mullinjtë përbëjnë objekte me vlera turistike që duhet të njihen nga më afër.Në shumë vendbanime të Anës së Malit ka patur mullinj uli për bluarje , veçanërisht në fshatrat Millë dhe Kosiç numri I tyre ka qenë i madh, rreth 24 të tillë[86].Mullinjtë e bluarjes kanë funksionuar deri në fundin e shekullit të kaluar por edhe në ditët e sotme disa prej tyre janë mirëmbajtur .

***Muzetë etnografikë***.Trashëgimia e kulturës material dhe shpirtërore si pjesë e ekzistencës dhe bashkëshoqëruese e anamalasve në jetën e tyre të përditshme është mjaft e larmishme.Kjo pasuri e shpërndarë në gjithë hapësirën, e shumtë në llojë ka arritur deri në ditët e sotme duke mundësuar njohjen e të kaluarës së anamalasve. Në hapësirën shqiptare me iniciativën dhe përkushtimin e intelektualëve anamalas u bë e mundur ngritja e një muzeu "Oda Anamalase"[87] me objekte të trashëguara nga jeta e përditshme. Në mungesë të një objekti, kjo pasuri etno-kulturore është vendosur në ambjentet e shkollës së mesme Oblikë.

Iniciativa e intelektualëve anamalas në hapësirën shqiptare u pasua nga përkushtimi ndër vite I familjes Kovaçi ne Draginë dhe në sajë të këtij përkushtimi objektet me vlera etno-kulturore në

[84] Ushaku Ruzhdi''*Ulqini ne gjurmet e shekujve",*fq 50
[85] Draga Nail "*Ura e Kleznës, monument I pambrojtur*", Koha javore,14 prill 2009. (http://www.visit-ulcinj.com/blog/2009/04/14.ura-e-klleznes-monument-i-pambrojtur/)
[86] Dragaj Shevqet "*Ngjarje dhe ndodhi në Anën e Malit*",Art klubUlqin 2016,Fq 332
[87] Muzeu etnografik "*Oda Anamalase*",Shkolla e mesme Oblikë

të gjithë hapësirën janë mbedhur si pjesë e muzeut etnografik. Muzeu etnografik I familjes Kovaçi dita-ditës po e rrit fondin e objekteve duke kaluar mbi 500 të tillë dhe po bëhet më i vizitueshëm nga turistë vendas dhe të huaj.







***Banesat***,e vjetra tipik ishin te ndertuara prej guri,kjo e favorizuar nga ekzistenca e vrgut shkembor Tarabosh –Rumi.Shtëpite më tipike ishin kullat dy kateshe me mure guri ku kati I parë në pjesën më të madhe shërbente edhe për ahur të gjësë së gjallë.Veçimi në komoditet brenda banesës sëdhomës me oxhak dhe asaj të miqve ishin te veçanta.

***Veshjet,*** përbëjnë një nga manifestimet më tërëndësishme të kulturës popullore dhe element i rëndësishëmnë specifikën etnike të një populli. Veshja në Anën e Malit ka ruajtur origjinalitetin etnik shqiptar në teknikën e punimit dhe të motiveve, pavarësisht nga politika që shoqëroi popullsinë shqiptare në hapësiren malazeze.Karakteristikë e veshjeve anamalase shfqet mbizotërimi i ngjyrës së bardhë,e cila për moshat me status të caktuar civil-shoqëror ,thyhet e ndërthuret me spektër të gjerë ngjyre,duke i dhënë veshjes njëatraktivitet,një gjallëri, kolorit shumë të këndshëm.Shumëllojshmeria e veshjes sipas gjinisë,format e tyre,materiali qëështë përdorur,klasifikimi i tyre sipas stinës,grupmoshave,statusit shoqeror,elementët zbukurues i kanë dhënë vlera dhe i kanë bërëtë veçanta veshjet në Anën e Malit.Motivet dhe ngjyrat e përdorura nëveshjet e këtij krahine janë origjinale.[88]Veshjet e grave si xhubleta, xhamadani i zi me mëngë të gjata, këmishat e gjata, fanela, bohcet,u ruajtën dhe u pasuruan ndër vite.Një veçori interesante ka patur kemisha e cila sipas materialit dhe ngjyrës përcaktonte edhe dallimin shoqeror.Këmishat për përdorim tëpërditshëm ishin pëlhura prej liri ose pambuku,ndërsa për raste ceremoniale ishin fije pambuku dhe të zbukuruar me qenore prej mëndafshi.Brekeshat dhe brendaveket ishin veshje si për gratë dhe për burra por që ndryshonin nga mënyra e punimit dhe materiali. Këto lloje veshjesh kanë vazhduar së përdoruri deri ne vitet 80 të shekullit XX.

Sot këto rroba janë bërë simbol kombëtar dhe është ruajtur tradita e punimit të tyre si veshje të cmuara duke i pajisur vajzat me rastin e martesës.Veçori interesante kanë edhe veshjet e burrave,si fustanella,veshje me tirqe ose çakçir ,xhamadani prej shajaku të bardhë sidhe qeleshja,përbejnë element mjaft të rëndësishem kulturor.Ato klasifikoheshin edhe sipas stinës,verore apo dimërore si dhe tregues i statusit shoqëror.

Kultura materiale në Anën e Malit bashkëshoqërohet me pasuri edhe në aspekti e kulturës shpirtërore,si këngët,vallet, ninullat të cilate plotësojne njëra –tjetrën duke rritur gamën e pasurisë kulturore me destinacion turistik.

Përfundime dhe sugjerime.

Nga studimi dhe vlerësimi I aseteve etno-kulturore të trashëfuara deri në ditët e sotme për krahinën Ana e Malit arrijmë në përfundimin se ato janë të shumta dhe me poptenciale për

[88] Onuzi,A.,"*Disa konsiderata për veshjet popullore të Anës së Malit*",Ulqini në rrjedhat ekohës ,Artclub,Ulqin 2000,Fq 273,(fq 271-274).

destinacion turistik.Ekzistenca e Anës së Malit si zonë ndërkufitare Shqipëri-Mali I Zi, dogana Muriqan-Sukobinë, fluksi në rritje I turistëve të cilët përdorin magjistralet Ulqin-Shkodër dhe Tivar-Shkodër janë faktorë mjaft të rëndësishëm për ti dhënë hapësirës mundësi në zhvillimin e turizmit kulturor.

Planet strategjike të BE-së drejt nxitjes së zhvillimit të turizmit kulturor shihen si premisa në përfitimin e fondeve në kuadër të zhvillimit të hapësirës ndërkufitare Ana e Malit për zhvillim të qëndrueshëm.Bazuar në këto potenciale etno-kulturore për zhvillimin e turizmit kulturor në të ardhmen rekomandojmë:

- Bashkëveprimin e DRKK-së Shkodër me qëndrën kulturore Ulqin për vlerësimin dhe shfrytëzimin e aseteve etno-kulturore të hapësirës.
- Ndërmarrjen e projekteve të përbashkëta afatshkurtra dhe afatgjata të arkeologëve për vendbanimin antic të Shasit.
- Përfshirjen e vendbanimit të Shasit dhe urës së Klleznës si monumente kulture të mbrojtura nga shteti.
- Aplikimin në kuadër të programeve ndërkufitare të Bashkimit Europian për grante në funksion të ruajtjes dhe të rehabilitimit të objekteve etno-kulturore.
- Ruajtjen dhe vitalizimin e mullinjve të ujit ne fshatin Millë për vlerat arkitekturore dhe funksionale.
- Ngritjen e një muzeu etnografik në shtëpi tipike anamalase në hapësirën shqiptare me objektet etno-kulturore që ndodhen pranë shkollës së mesme Oblikë.
- Subvencionimin e muzeut etnografik në Draginë nga qendra kulturore Ulqin.
- Promovimin e aseteve etno-kulturore pranë agjensive turistike që operojnë në hapësirën Shkodër-Ulqin.
- Sensibilizimin e komunitetit anamalas në mërgim për sigurimin e fondeve të ndyshme për ruajtjen e trashëgimisë dhe të identitetit kulturor.

Bibliografi.

[1.]Dogana shqiptare Muriqan.
5.Draga Nail,”*Ulqini qytet antik me transformim bashkohes*”,Kerkime Gjeografike,Prishtine 1987,fq 111-122
7.Draga Nail ”*Ura e Kleznës, monument I pambrojtur*”, Koha javore,14 prill 2009. (http://www.visit-ulcinj.com/blog/2009/04/14.ura-e-klleznes-monument-i-pambrojtur/)
9.Dragaj Shevqet “*Ngjarje dhe ndodhi në Anën e Malit*”,Art klub Ulqin 2016.
3.Çagjenoviç,Jovan,”*Jeta dhe zakonet e shqiptareve*”,Koha Janar-Shkurt 1/1979,Titograd,fq 74-80.
4.Çilikov,Aleksander,”*Rezultatet dhe rendesia e hulumtimeve arkeologjike te qytetit te vjeter te Shasit*”, Shasi I lashte monument i kultures,Ulqin 2009,fq23-32.
2.Monstat 2011,Montenegro.
8.Muzeu etnografik “Oda Anamalase”,Shkolla e mesme Oblikë
10.Onuzi,A.,”*Disa konsiderata për veshjet popullore të Anës së Malit*”,Ulqini në rrjedhat e kohës ,Artclub,Ulqin 200(fq 271-274). 6.Ushaku Ruzhdi”*Ulqini ne gjurmet e shekujve”. Ulqin 2006*

# RRITJA E SHPEJTË E SUPERMARKETEVE KUNDREJT DYQANEVE TË VOGLA NË KOSOVË

**Msc. Marigona Lahu**
Universiteti i Prizrenit

**Abstrakt:** Supermarketet po luajnë një rol tejet të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, dhe padyshim mund të themi se janë ndërpunëdhënësit më të mëdhenj të sektorit privat në vendin tonë. Supermarketet në Kosovë po udhëheqin ofertën për furnizim të sektorit ushqimor dhe joushqimor, duke ndikuar kështu në tkurrjen e pjesës së tregut që dyqanet e vogla zotëronin dikur. Qëllimi i këtij punimi është të jepen arsyet, të cilat çuan në paraqitjen dhe zhvillimin e hovshëm të supermarketeve në Kosovën e pasluftës, të jepet një pasqyrë më e qartë se si ndikoi kjo te dyqanet e vogla , si dhe të arrihen përfundime e të jepen konkluzione se si të veprojnë dyqanet e vogla, në mënyrë që t'i mbijetojnë shuarjes. Ky punim jep arsyet pse qytetarët preferojnë më shumë supermarketet sesa dyqanet e vogla ushqimore, krejt kjo duke u bazuar në anketën e bërë me 200 konsumatorë nga rajoni i Prishtinës. Rritja e supermarketeve në Kosovë ndodhi si pasojë e krijimit të kapitalit nga njerëz të fuqishëm dhe si përqafim i trendeve evropiane në këtë segment. Supermarketet janë më të suksesshme për shkak të madhësisë dhe stafit menaxherial që kanë,që fatkeqësisht te dyqanet e voglanuk e hasim. Konsumatorët preferojnë blerjet në supermarkete për shkak të çmimeve më të ulëta, gamës së gjerë të produkteve, kualitetit, shërbimit më të mirë, parkingjeve, këndit të lojërave etj. Ky punim do t'iu ndihmojë dyqaneve të vogla ushqimore që të përmirësojnë mënyrën e tregtimit dhe të bëhen më garuese në treg.

*Fjalë kyçe : Supermarket, Dyqan i vogël, Punësim, Produkt, Blerje*

## 1. HYRJE

Në të kaluarën blerjen e gjërave të domosdoshme ushqimore e bënim nëpër dyqanet e vogla ushqimore, të cilat kishin pak artikuj në asortimanin e tyre, dhe kjo ishte mënyra e vetme e furnizimit me gjëra ushqimore. Sot mënyra e blerjes ka ndryshuar, dhe për shumicën tonë blerja nëpër dyqane të vogla i përket së kaluarës. Të nxitur nga ndryshimet teknologjike dhe ekonomike, supermarketet kanë marrë në zotërim furnizimin me gjëra ushqimore dhe joushqimore. Në vitet e nëntëdhjeta në Kosovë , ekzistonin vetëm dyqane të vogla ushqimore, dhe kështu familjet tona ishin në njëfarë forme të detyruara që blerjen e gjërave elementare për shtëpi, ta bënin te këto dyqane.Pas luftës ndryshoi gjithçka edhe Kosova përqafoi trendin e paraqitjes së supermarketeve, ndaj sot kemi një numër mjaft të madh të tyre. Familjet priren të blejnë në supermarkete pasi është shumë më e përshtatshme për ta. Duke e parë këtë rritje dhe zgjerim të hovshëm të tyre, unë vendosa që t'i studioj faktorët që çuan në këtë mënyrë tregtimi në Kosovë.

### 1.1Objektivat e punimit

Objektivi i këtij punimi është përshkrimi i arsyeve , që çuan në paraqitjen e shpejtë në Kosovën e pasluftës të supermarketeve, analizimi i faktorëve pse ato e dominojnë tregun dhe se si dyqanet e vogla preken nga kjo. Gjithashtu përmes këtij punimi synohet të jepen edhe rekomandime se si të sillen dyqanet e vogla , në mënyrë që të vazhdojnë jetën e tyre në treg.

### 1.2 Rëndësia e punimit

Duke pasë parasysh që Kosova është vend në tranzicion dhe në shumë fusha është duke përqafuar trendet botërore, as në fushën e zinxhireve të marketeve nuk ka mbetur jashtë këtij hapi. Një zhvillim i shpejtë i supermarketeve në Kosovë, meriton të jetë në fokus të studiuesve. Kjo fushë studimi në Kosovë ka mbetur mjaft e patrajtuar, dhe është mjaft e vështirë të gjesh ndonjë shkrim për këtë zhvillim. Përmes këtij punimi mendoj të ndikoj sadopak që paraqitja e supermarketeve në Kosovë të fillojë të trajtohet. Ky punim do t'iu ndihmojë edhe investitorëve të mundshëm në këtë fushë që të shohin mundësitë për kyçje në treg dhe të ndikojë pozitivisht te konsumatorët, duke përfituar nga konkurrrenca mes rrjeteve të marketeve.Ky punim do t'iu shërbejë edhe pronarëve të dyqaneve të vogla, që të ndikojnë pozitivisht në performancën e tyre.

## 2.PARAQITJA E SUPERMARKETEVE DHE MËNYRA E OPERIMIT TË DYQANEVE TË VOGLA NË KOSOVË

Fillimisht supermarketet e para u paraqitën në SHBA mes viteve 1920-1930 , ndërsa fituan rolin dominant në fund të viteve 1950.Derinë praqitjen e supermarketeve, mënyra e blerjes ishte e organizuar në formë të: (1) Tregu ku shiteshin gjëra të freskëta si mishi,peshku etj. (2) Shitoret e vogla, (3) Shitësit ambulantivë,(4) Shpërndarësit e qumështit. Paraqitja e rrjeteve të dyqaneve filloi në fund të viteve 1870, shumë para se mënyra e vetëshërbimeve të mëdha u organizua në formë të supermarketeve. Rrjetet moderne të marketeve filluan me rrjete të vogla të dyqaneve , të cilat filluan të blenin artikuj ushqimorë në sasi më të mëdha dhe t'i shisnin me zbritje. Më pas ato vazhduan me reduktimin e kostove të tyre duke shkuar drejt ofrimit të vetëshërbimit për blerës.Rrjeti i dyqaneve A&P, një rrjet i vogël që shisnin kafe dhe çaj, u bë rrjeti i parë i marketeve në vend, ndërsa në vitin 1900 numëronte 200 dyqane. Në vitet e hershme 1920 Amerika kishte 3 rrjete të marketeve si A&P,Woolworth's dhe United Cigars Store. Në vitin 1936 , A&P e hapi supermarketin e parë.Karakteristikë e A&Pështë se në vitin 1950 ishte shitësi i dytë më i madh në Botë. Në vitet 2000 ky rrjet për shkak të mospërshtatjes së strategjisë blerëse dhe shitjes, humbi dominimin e tij dhe mbeti një rrjet i vogël i marketeve në krahasim me supermarketet që u krijaun gjatë viteve 1970-1980 si Wal-Mart.(Reardon and Berdegué 2007).

Sam Walton paraqet një shembull mjaft të mirë se si një biznes i vogël mund të shndërrohet në një biznes miliardësh. Në vitin 1962 ai hapi supermarketin WalMartduke i paraprirë një mëyre krejtësisht të re të tregtimit. Ai ishte i pari , që filloi blerjen drejtpërdrejt nga furitorët dhe krijimin e qendrave shpërndarëse, në mënyrë që të zvogëlonte kostot. Në vitet 1970 ai hapi supermarketet e mëdha , të cilat shtriheshin në pjesë më të varfëra të Amerikës dhe kishin produkte të lira.Supermarketet WalMart në vitet 2002 bëhen punëdhënësi më i madh i sektoritprivat në Botë, me 2 milionë të punësuar. Aktualisht WalMart ka 11,3348 markete anembanë Botës.

Supermarketet në vendet në zhvillim në fillimet e tyre u hapën kryesisht në qytetet e mëdha, fokus kishin konsumatorët e pasur dhe ishin rrjete të marketeve me kapital vendor.Supermarketet e para te vendet në zhvillim filluan të paraqiten mes viteve 1990-2000 .

Paraqitja e supermarketeve ka 3 valë. Vala e parë përfshin supermarketet e para të mes viteve 1990, ku këtu përfshihen vendet si Amerika Jugore dhe Azia Lindore. Në këto vende pjesëmarrja e supermarketeve në treg nga 10-20% në fillim të viteve 1990 , u rrit në 50-60% në fillim të viteve 2000.(Reardon and Berdegué 2007).

Vala e dytë e vendeve përfshin Meksikën ,Azinë Juglindore, Amerikën Qendrore dhe Europën Jugqendrore, ku pjesëmarrja në treg e marketeve nga 5-10% në vitet 1990, u rrit në 30-50% në vitet 2000. Në valën e tretë të vendeve bëjnë pjesë Afrika, Rusia India, ku supermarketet e para u paraqitën në fillim të viteve 2000, dhe zënë 20% të tregut.(Reardon and Berdegué 2007).

Në Kosovë duke pasë parasysh zhvillmet e kohës,paraqitja e supermarketeve filloi pas periudhës së luftës. Në vitet e 90-a në Kosovë mbizotëronin dyqanet e vogla, në të cilat familjet shqiptare furnizoheshin me artikujt e domosdoshëm. Gjatë këtyre viteve paraqiten edhe disa dyqane më të mëdha të cilat njiheshin si vetëshërbime.Këto dyqane për dallim nga dyqanet e vogla, u mundësonin konsumatorëve marrjen e gjërave nga raftet pa ndërmjetësimin e shitësit. Këto vetëshërbime ishin më shumë në qytetet e mëdha, ndërsa më pak nëpër qyteza e pothuajse fare nëpër vende rurale.

Dyqanet e vogla në Kosovë ishin biznese individuale, që zotëroheshin kryesisht nga familje ,të cilat kishin standard më të lartë. Nga këto dyqane familjet kosovare arrinin që të mbanin veten dhe të krijonin një jetë më të mirë për veten dhe të afërmit e tyre.Gjatë viteve 90 dyqanet karakterizohshin me mungesë të theksuar të shumëllojshmërisë së artikujve dhe mbanin nëpër raftet e tyre vetëm artikujt më të rëndësishëm , të cilët mund t'i siguronin, pasi periudha për të cilën po flasim ishte periudhë e rëndë socio-ekonomike dhe politike për shqiptarët. Këto dyqane furnizimin me artikuj e bënin përmes depove të mëdha, të cilat shërbenin si furnizues të tyre.Mënyra e shërbimit te këto dyqane , për dallim nga vetëshërbimet , bëhej nga ana e shitësit.Kosova si një vend në tranzicion , menjëherë pas luftës filloi mehapa të shpejtë që të jetë në hap me vendet e tjera të rajonit, pavarësisht të kaluarës së dhimbshme.Pas luftës filluan të ndryshonin gjërat, ndikim këtu kishte edhe numri i madh i qytetarëve të vendeve të huaja , të cilët punonin në Kosovë.Supermarketet e para në Kosovë u paraqitën në vitet 2000. Ndër shkaqet kryesore , që ndikuan në paraqitjen e supermarketeve në Kosovë ishin :1) Mundësia e tregtisë së lirë, 2) Zhvillimi që po e përjetonin vendet në zhvillim, sidomos ato të rajonit,3) Disa njerëz të fuqishëm ekonomikisht kishin mjaft kapital në duart e tyre, dhe vendosën që këtë kapital të lirë ta kanalizojnë.

Shumë supermarkete të tanishme në Kosovë, u shndërruan nga dyqane të vogla në supermarkete, krejt kjo falë përqafimit të trendit të ri dhe falë kapitalit të krijuar gjatë operimit si dyqan i vogël.Pronarët e tyre filluan të zhvilloheshin dhe nga dyqane të vogla, të cilat i gjeje nëpër lagje u shndërruan në supermarkete duke ofruar një gamë të gjerë të artikujve, e cila ishte risi, pasi po ofrohej mundësia që konsumatorët të kishin një ofertë më të gjerë të produkteve ushqimore dhe joushqimore, pastaj çmime më të lira që do të ndikonin direkt në mirëqenien e tyre, pasi do të shpenzonin më pak. Këto supermarkete ndikuan edhe në rritjen e të të punësuarve në Kosovë, me përafërsisht 6000 të punësuar vetëm në rrjetet kryesore të marketeve. Duke i shtuar edhe një numër mjaft të madh të të punësuarve nëpër supermarkete anembanë Kosovës, pa dyshim mund të themi se Supermarketet janë punëdhënësi më i madh i sektorit privat në Kosovë.

Një ndër supermarketet e para ,e hapur ishte Maxi supemarket në vitin 2000. Në Kosovë rrjete vendore të supermarketeve janë këto: Maxi,Interex, Superviva,Vivafresh,Albi Market,ETC, Emona Center, Meridian Express etj.

Njëri ndër rrjetet më të mëdha të supermarketeve në Kosovëështë Viva Fresh Store, me afër 60 pika shitëse ,me prezencë në 18 qytete, me përafërsisht 1600 punëtorë. Ky rrjet u hap më 2003.

Superviva, është rrjet tjetër i marketeve , i cili u hap në vitin 2004, ka 20 pika shitëse me 500 të punësuar.

Interex u hap në vitin 2004 ku fillimisht ishte pjesë e rrjeteve të marketeve franceze Intermarche. Në vitin 2017 u ble nga kompania Emona, dhe aktualisht kanë 18 pika shitëse, me një numër mjfat të madh të punësuarish.

ETC, është rrjet i marketeve, i cili u hap në vitin 2005, në Pejë e duke u zgjeruar më vonë edhe në qytetet tjera të Kosovës. Ky rrjet punëson 1500 punëtorë dhe është i shtrirë në 17 qendra.

Maxi market, u hap në vitin 2000, aktualisht ka 16 pika.

Emona center është një rrjet tjetër i fuqishëm i marketeve, i cili ka 8 pika në Kosovë.

Albi market, ka gjithsej 15 pika shitëse.

Përveç këtyre zinxhirëve të marketeve, në Kosovë ekziston edhe një numër i madh i supermarketeve, të cilat kanë shrirje lokale.Gjithashtu kemi edhe një numër të madh të supermarketeve të cilat nuk janë në formë të zinxhireve, por operojnë si të vetme.

Kohëve të fundit, kemi edhe paraqitjen e supermarketeve me kapital të huaj si Conad, Kam, Spar.

## 3.PËRPARËSIA E SUPERMARKETEVE NDAJ DYQANEVE TË VOGLA

Dita-ditës ne shohim hapjen e pikave të reja shitëse apo supermarketeve. Derisa menjëherë pas luftës ishte karakteristikë që pothuajse çdo lagje të kishte një dyqan, i cili i plotësonte nevojat e banorëve të asaj lagjeje, sot në vitin 2019 karakteristike është prirja që në secilën lagje të hapet së paku nga një supermarket, që t'i plotësojë më mirë nevojat e konsumatorëve. Kjo luftë e ashpër mes supermarketeve të mëdha ka ngulfatur dyqanet e vogla, të cilat janë zvogëluar në numër dhe në sipërfaqe shitëse. Shtrohet pyetja si arritën supermarketet të pushtojnë tregun dhe të largojnë nga loja dyqanet e vogla?

Ndër faktorët kryesorë ,të cilët ndikuan që supermarketet të jenë liderë në shitjen e produkteve ushqimore dhe joushqimore qëndron te kapitali që zotërojnë pronarët e këtyre supermarketeve. Ky kapital u mundësoi atyre ndërtimin e objekteve me sipërfaqe të mëdha, ku do të vendoseshin produkte e do të ofronin një gamë të gjerë produktesh , që do të ofronin mundësi zgjedhjeje e do t'i plotësonin nevojat e secilës familje. Supermarketet u krijuan në atë mënyrë, që të gjitha gjërat që më herët i kemi blerë në vende të ndryshme, të mund t'i blenim në një vend. Kjo ndikoi pozitivisht në kursimin e kohës për klientët. Sipërfaqet e mëdha operuese me llojllojshmëri artikujsh , u mundësuan supermarketeve që të ofronin çmime më të lira, për shkak tëmundësisë sëblerjes së sasive të mëdha të artikujve, këtyre bizneseve u mundësohej të merrnin edheextra zbritje nga furnitorët, të cilën më vonë e përkthenin në çmim për konsumatorë. Dyqanet e vogla për shkak të hapsirave të vogla operuese nuk e kanë këtë mundësi. Këto çmime më të ulëta ndikuannëxhepat e konsumatorëve dhe në tërheqjen e tyre, duke i shndërruar në klientë besnikë.

Fuqia financiare e këtyre bizneseve, ndikoi në tërheqjen e njerëzve , të cilët kishin shkollim adekuat dhe njohuri për këtë fushë, të cilët në mënyrën më të mirë të mundshme plotësonin nevojat e konsumatorëve dhe i plotësonin më çmime mjaft konkurruese. Te dyqanet e vogla , menaxher është pronari i dyqanit, dhe kjo shihet si mangësi pasi pronari nuk e ka ekspertizën dhe njohurinë e nevojshme për ta drejtuar atë biznes. Te shumë dyqane në Kosovë shohim se pronarët e tyre kanë shkollim tjetër , i cili nuk lidhet me biznesin që kanë në pronësi.

Këto janë shkaqet kryesore që çuan në paraqitjen , jetëgjatësinë dhe evoluimin e supermarketeve në Kosovë.




***Fig.1 Shtrirja sipas pikave***

Nga figura më lart shihet se numri i supermarketeve rritet dita-ditës, e kjo rritje vjen për shkak të shfrytëzimit të përparësive të të qenit i madh.




* Tw dhwnat janw nga Ministria e Financave

***Fig.2 Të hyrat nga shitja për 4 vite***

Në figurën 2 janë paraqitur grafikisht të hyrat e 4 rrjeteve të supermarketeve , të deklaruara në pasqyrat e tyre financiare e të dorëzuara në Ministrinë e Financave. Nga grafiku shihet qartë se të katër kompanitë për 4 vitet ë hulumtimit, kanë arritur që të kenë rritje pas secilit vit të operimit. Kjo ka ardhur për shkak të rritjes në numër dhe përmirësimit të operimit të tyre dhe plotësimit më të madh të nevojave të klinetëve.

**Rezultatet**




***Fig.3 Gjinia e të anketuarve***

Në anketën e organizuar me konsumatorë nga rajoni i Prishtinës, është marrë një mostër prej 200 konsumatorësh, zgjedhje rastësore. Në këtë anketë 130 kanë qenë femra ndërsa 70 meshkuj.




***Fig. 4% e blerjes në supermarkete dhe dyqane***

Siç edhe shihet në grafikun e mësipërm, në pyetjen e parashtruar ndaj të anketuarve se ku blejnë furnizimet e tyre ushqimore , 85% e tyre janë përgjigjur se i bëjnë blerjet në supermarkete, ndërsa vetëm 15% e tyre nëpër dyqane të vogla .




*Fig.5 Arsyeja kryesore e blerjes në supermarket*

Në pyetjen e parashtruar ndaj të anketuarve, se cila është arsyeja primare që vendosin të blejnë në supermarket, 55% e të anketuarve janë përgjigjur që çmimi më i lirëështë faktori kryesor,27% janë përgjigjur që asortimani i gjerë ndikon, 7% kualiteti më i madh, 5% shërbimi më i mirë, më profesional, 3% blejnë në supermarkete për shkak të parkingut, 2 % zgjedhin supermarketet për shkak se kanë kënd lojrash për fëmijë, gjë që u mundëson blerje të qetë, dhe vetëm 1 % e tyre për shkak të restoranteve.

Në bazë të anketimit në pyetjen e parashtruar se cka blejnë më shumë nëpër supermarkete , të anketuarit janë përgjigjur , që blerjet më të shpeshta janë produktet e freskëta, produktet ushqimore dhe pijet, higjiene si dhe artikuj të tjerë.




*Fig.6 Përmbajtja e shportës së konsumatorit*




***Fig. 7 Blerja e konsumatorëve të Sm në dyqane të vogla***

Siç edhe shihet në figurën 7, kur konsumatorët , të cilët blejnë nëpër supermarkete janë pyetur se në rastet kur blejnë nëpër dyqane tëvogla, 41% e tyre kanë deklaruar se blejnë kur iu duhet ndonjë produkt domosdoshmërisht e shpejt, 23 % e tyre kur janë në lëvizje dhe blejnë gjëra të vogla si ujë, 18% e tyre blejnë bukë dhe cigare.




***Fig. 8 Arsyeja e blerjes në dyqan të vogël***

Te konsumatorët , të cilët janë deklaruar se blejnë në dyqane të vogla gjithsej 30 e të anketuarve, ata na kanë treguar se arsyet që i shtyjnë ata që të blejnë në dyqane të vogla janë afërsia e dyqanit me vendbanimin e tyre apo 50% e të anketuarve, blerja më e shpejtë për shkak se nuk kanë nevojë të presin në radhë për pagesë , gjegjësisht 44% e të anketuarve dhe si arsye tjetër kemi edhe mbështejen për këto dyqane , përgjigje të cilën e kanë dhënë 6% e të anketuarve.

## 4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga studimi ynë, kemi arritur në përfundimin se shkaqet kryesore , që çuan në paraqitjen e hovshme të supermarketeve në Kosovë, sidmos pas luftës janë mundësia e tregtisë së lirë, kapitali në duar të të fuqishmëve, ecja në hap me kohën me vendet botërore.

Konsumatorët blejnë shumë më shumë nëpër supermarkete sesa në dyqane të vogla për shkak të çmimeve më të mira për xhepat e tyre, gamës së gjerë të artikujve, shërbimit më cilësor, kualitetit të produkteve, parkingjeve dhe kjo i bën supermarketet që të kenë përparësi shumë të madhe ndaj dyqaneve të vogla.

Nga 200 e të anketuarve, 85 % e tyre blejnë nëpër supermarkete, ndërsa 15 % nëpër dyqane të vogla.

Nga anketa jonë del se faktori kryesor që ndikon në zgjedhjen e supermarketit për blerje dhe që i krijon atij avantazh të dukshëm krahasuar me dyqanet e vogla, është çmimi, apo 55% e të anketuarve, që blejnë në supermarket.

Faktori i dytë , del të jetë asortimani i gjerë, në bazë të 27 % të përgjigjeve nga anketa.Faktori i tretëështë kualiteti dhe freskia e produkteve sipas 7% të të anketuarve.

50% e të anketuarve, të cilët blejnë nëpër dyqane të vogla, e bëjnë blerjen për shkak të afërsisë së dyqanit me vendbanimin e tyre, 44% për shkak shpejtësisë së blrejes dhe 6% për shkak të mbështetjes ndaj dyqaneve të vogla.

Nga anketa del se 41% e blerjeve nëpër supermarkete shkon për ushqim dhe pije,35% për artikuj të freskët,18% higjienë dhe 6% artikuj të tjerë.

Ky punim vë në pah mangësitëdhe problemet me të cilat ballafaqohen dyqanet ushqimore, siç janë : Çmimet më të shtrenjta të artikujve, mungesa e asortimanit të gjerë, kualiteti më i ulët i artikujve, mungesa e trajnimeve për pronarët.

REKOMANDIME

Nga vënia në pah e mangësive të dyqaneve të vogla , iu rekomandohet përmirësimi i mënyrës së tregtimit, duke u bërë më konkurrues në treg. Kjo arrihet duke ndjekur trajnime të vazhdueshme pronarët, duke u munduar që të kenë çmime më konkurruese , produkte të freskëta dhe të ofrojnë përmbushje në baza ditore të nevojave të konsumatorëve.

5. BIBLIOGRAFIA

1. Ceku,B.,Reshidi, N.(2006) Marketingu. Universiteti Mbretëror Iliria. Prishtinë

2. Gorton, M. , Zarić, V. Lowe,P. and Quarrie ,S. (2011) Public and private agri-environmental regulation in post-socialist economies: Evidence from the Serbian Fresh Fruit and Vegetable Sector, *Journal of Rural Studies*, 27, 2, (144).

3. Lawrence Busch,L.(2007) Performing the economy, performing science: from neoclassical to supply chain models in the agrifood sector, *Economy and Society*, 36, 3, (437).

4. Maruyama, M and Wu,L.(2014) Quantifying barriers impeding the diffusion of supermarkets in China: The role of shopping habits, *Journal of Retailing and Consumer Services*, 21, 3, (383).

5. Minten,B.(2008) The Food Retail Revolution in Poor Countries: Is It Coming or Is It Over?, *Economic Development and Cultural Change*, 56, 4, (767).

6. Reardon, T. and Berdegué, J. A. (2002) 'The Rapid Rise of Supermarkets in Latin America: Challenges and Opportunities for Development', Development Policy Revieë20 (4): 317-34.

# THE LEGAL SYSTEM FOR STRATEGIC INVESTMENTS IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Hana Bahtijari Jakupi**

**PhD Student, Faculty of Law,**

**University of Pristina,**

## Abstract:

The main objective of the legal system in the area of strategic investment is presence of many strategic investments in the State of Republic of Kosovo. Main purpose placed by state is the absorption of as much Strategic Investments, as these investments have a longer investments plan, should invest a large sum of financial means, depending on which field, Law No. 05/L-079 for strategic investments in the Republic of Kosovo (*Official Gazette of Republic of Kosovo No. 6/08, February 2017, Prishtina*), the amounts are allocated for certain fields. The other character of these investments is number of the employees which are employed, increasing competitiveness, economic growth and overall economic development. However, all developing countries are competing to have as many types of strategic investment as possible: in energy, mining, transport, tourism, health, agriculture etc. In order to gain the status of a strategic investor, the legal system should also be regulated, which means to have a consistency between the Law and sub-legal acts. Many authors have analyzed investments in a general way, without sharing investments, especially Strategic Investments that are less compared to direct foreign investments. The main purpose of this work is to summarize the legislation in this area, in a way that strategic investor have a legal package and not the frequent change of Investment Package including also and sub-legal acts.

**Key words: Strategic Investments, Administrative Instruction, Procedures, Status.**

## Introduction:

Law for the strategic investments is the first law for strategic investments which is approved in Republic of Kosovo, after the Law for Foreign Investments, but the latter of a different nature compared to the Law on Strategic Investments. This law is aimed at encouraging attracting and creating the conditions for realizing strategic investments, as well to define administrative procedures and evaluation criterias, election, implementation and supervision of strategic projects[89]. The main purpose of strategic investment laws is to facilitate administrative procedures in an expeditious manner. A good feature of this law is respecting the principle of free movement of goods and capital, the principle of free competition, equal treatment and mutual respect. It is worthy to emphasize that in the Law on Strategic Investment Status can also take projects that are carried out under the Interstate Agreements. Based in the law, it is mentioned that first sub-legal law which should be extracted it is for the methods of verifying the fulfillment of the criteria, while the last sub-legal act has actually been issued.

[89] Law No. 05/L-089. For Strategic investments in Republic of Kosovo, Official gazette of Republic of Kosovo / No. 6/08, February 2017, Prishtina, page 1.

**Content**

## 1. Law for the Strategic Investments

The Law on Strategic Investments provides a great deal of support to these investments, where in paragraphs 4 and 5 quoted that Government of Kosovo can enter to the direct negotiations with the investment with entities to enter the Strategic Investment Agreement without undergoing the procedures for obtaining the status of strategic investment and public procurement procedures if such a thing is foreseen on the basis of an international agreement between the Republic of Kosovo and one or more other States or international organizations[90].

Proposed investments to be considered strategic in the sense of this law should fulfill criteria's as below: [91]

1. Investment entity at the moment of applying for the status of strategic investment must submit evidence, proving its financial capability to fulfil the investment;

2. Proposed investments must be in compliance with environmental standards defined by legislation of the Republic of Kosovo and European Union;

3. Proposed investments must not be in contradiction to the Constitution and obligations of the Republic of Kosovo defined by international conventions and agreements.

For the strengthening of this article it is issued also and Administration Instruction by the Government of Republic of Kosovo for the way and methods of verification of fulfillment of criteria's for definition of the status of Strategic Investment.

But unfortunately, this Administrative Instruction was abolished 11 months after its entry into force. By getting a strategic investor title many benefits are also gained as the easiest transfer of state property, lighter licensing equipment for startup work, as well as accelerated administrative procedures[92]. Government of Republic of Kosovo is constantly trying to regulate the investment climate in Kosovo.

This issue except the legislation also will be regulated with sub-legal acts. Based in the Administrative Instruction No. 01/2018 on the manner of making available real estate within the property of the Public Enterprises for the Development and Realization of Strategic Investment Projects.[93] In accordance to this act the way of placement in disposition of immovable properties Owned by Publicly Owned Enterprises and Project Execution for Strategic Investment[94]

[90] Law No.05/L-079 on Strategic Investment in the Republic of Kosovo/ Official Gazette of the Republic of Kosovo/No.6/08 February 2017, Prishtina, page 24.

[91]ibidempage.16.

[92] Law n Strategic Investments in Kosovo, comparison with examples from Albania, Croatia, Serbia and Macedonia, February 2016, Institution GAP, page 3.

[93] Administrative Instruction No. 01/2018, on the Manner of Making available real estate owned by public enterprises for development and implementation of strategic investment.

[94]Administrative Instruction No. 01/2018, on the Manner of Making available real estate owned by public enterprises for development and implementation of strategic investment, page 1.

## 1. Sub-laws acts and its amendment it is defined

Government of Kosovo has taken a hurry by issuing the first sub-legal act Administrative Instruction (GRK) No. 11/2017 About the Form and Contents of the Registry in relation to the projects that have obtained Status of Strategic Investments approved by the Decision No. 12/15, date, 23.11.2017. In this Instruction talk about projects that have acquired the status of Strategic Investments. The investor is initially interested in how to obtain the status and later about the further procedures which are more inner issues. On the same date it was acted also with the Administrative Instruction (GRK) No. 19/2017 for the way of work and the Functioning of the Inter-Ministerial Commission for Strategic Investments, where also in this case are described tasks of the Commission for the Supervision of the application of projects for strategic appointments, where this issue is very well specified also in the Law.

Administrative Instruction (QRK) No. 02/2018 for the ways and methods of the fulfillments of criteria’s for definition of the Status of Strategic Investor is issued by the Government of Republic of Kosovo and approved with the Decision No. 17/24, date 12.01.2018 where with this sub act it is done a detailed and very complex explanation regarding the process of acquiring the status of the strategic investor. Immediately after the thirteen months this sub-legal act is abrogated to be evaluated by the Administrative Instruction (GRK) No. 15/2018. On how to verify the fulfillment of criteria for defining the Strategic Investor Status, approved with the Decision No. 17/81, date 24.12.2018.

With this sub-law act the government was interested in changing some of the technical issues, administrative processes in relation to the fulfillment of criteria for strategic investment although the legal deadline is the same (twenty working days), with sub-legal act.

With new instruction it is facilitated by the Investor not to require the pledge of funding from an internationally-rated financial institution. One flaw of this Administrative Instruction is too long deadline to verify the documentation where the total is required 20 working days. This is a very long time for the investor, considering that in many countries in the region this issue is completed within five days. So, also in the Republic of Kosovo the deadlines for verifying documentation for defining the Strategic Investor Status should be shortened. Also a good UA is that with this UA can be used also the objects of public enterprises for the development of Strategic Investments. While the procedures for issuing permits and licenses with this Administrative Instructions followed by accelerated procedures, which privileges Strategic Investors. Administrative Instruction in question is approved quite late, on 30 January 2018. Such a legal problems create uncertainty for investors. And in the moment that investor understands the legislative plan changes every month then investors will not risk investing in such a place despite numerous facilities.

## Conclusion

Law on Strategic Investments is issued quite late in February 2017. This law states that sub-legal acts shall be issued within 60 days from the day of entry into force of this law, concretely until on April 2017 supposed to be completed the legislative package for strategic investments. By law it is required to derive the Administrative Instruction on the ways and procedures for financing strategic projects prepared by the public authorities. But, unfortunately, still is not fulfilled this judicial gap. Deadline for submitting requests from the investing entity for inclusion in the procedures for obtaining strategic investment status pursuant to this law is 31 December 2020, where there is a short enough time to include strategic investments in energy,

infrastructure, mining, tourism, health, agriculture etc. In Kosovo this year has started with strategic investments where the biggest influx is in energy and this deadline of 2020 is insufficient for obtaining this status. But this deadline the government has earned by gaining strategic investment status will be won by the Interstate Agreement.

In addition to the many procedural and administrative incentives and facilitations related to obtaining the status, the legal package should be supplemented and amended to meet the many requirements for the fulfillment of the Strategic Investor status. Kosovo is ranked among the 10 most reforesting countries in the world, according to the latest World Bank report. This means that Kosovo is a very attractive country for foreign investments.

Literature

Administrative Instruction (GRK) No.11/2017 on the Form and Content of the Register related to projects that have gained the title of Strategic Investment.
https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15939

Administrative Instruction (GRK) No.19/2017 on the Work and Functioning of the Inter - Ministerial Committee for Strategic Investments.
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RR_19-2017_MTI.pdf

Administrative Instruction No. 01/2018, on the Manner of Making Available Real Estate Owned by Public Enterprises for Development and Implementation of Strategic Investment.https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15940

Administrative Instruction No. 15/2018 on the Means and Methods for Verifying the Eligibility for Obtaining the Strategic Investor.

European Bank for Reconstruction and Development.

European Investors Council.

# MARKETING NA DRUŠTVENIM MREŽAMA

**Phd (c) Rialda Muharemi**

## UVOD

Fenomen društvenih mreža i medija je zadnjih godina ostavio dubok trag na celokupno društvo. Potpuno je besmisleno ignorisati činjenicu da društvene mreže, svojim uticajem, zadiru i menjaju samu suštinu marketinga.

Teško je ne primetiti, ili na neki način ne osetiti uticaj društvenih medija i mreža, naročito popularnih aplikacija kao što su Facebook, Twitter, Wikipedia, YouTube i sl. Krajem 2006.godine, društvene mreže su počele da diktiraju način upotrebe digitalne tehnologije širom sveta.

Në nyjen e takimit të gjuhës shqipe me gjuhën gorane, në Shqipëri, fillon kryqëzimi i kulturave përmes kontaktit gjuhësor. Kulturat nuk kanë të njejtën kufi me gjuhët, raporti mes gjuhës dhe kulturës është shumë më i ndërlikuar, kufijtë politikë nuk përputhen me kufijtë gjuhësorë edhe pse njohin një farë efektshmërie. Në këtë mënyrë mund të arrijmë në përfundimin se mes shoqërive të ndryshme mund të kete kryqëzime pak a shumë të theksuara, por mundet që tiparet të caktuara të gjenden në kulturën e të gjitha shoqërive (John Lynos 2001: 400). Në kryqëzimin e kulturave është shumë lehtë të evidentohen interferencat mes njëra – tjetrës, ndërsa në aspektin gjuhësor nuk mund të pretendohet evidentimi dhe përdorimi i nënsistemeve dhe njësive gjuhësore në mënyrë të tillë, por vetëm si sisteme më vete të dallueshme qartë.
***A ruhen ato si dy sisteme gjuhësore?***

Në arealin e Gorës në Shqipëri gjuha gorane dhe gjuha shqipe janë dy sisteme gjuhësore të plota dhe të dallueshme qartazi gjatë procesit të ligjërimit, pasi zhvillimi kulturor, gjuhësor dhe ekonomik ka patur një unitet të dimensionit gjeografik dhe adminsitrativ. Dimensioni administrativ bëri që shqipja të jetë varietet i lartë, sidomos pas vitit 1945, nga ana tjetër dimensioni gjeografik është në harmoni të plotë me dimensionin administrativ, pasi Gora ishte një ishull në detin shqiptar.

Ekzistenca e dy sistemeve gjuhësore të plota është tregues i zëvendësimit të kodeve gjatë procesit të ligjërimit jo vetëm mes anatarëve të etnive të ndryshme, por edhe brenda anëtarëve të një etnie të veçantë. Folësit biling janë ata që me zgjedhjen e gjuhës përcaktojnë situatën, duke mos dashur që situata të përcaktojë zgjedhjen e gjuhës (Hudson 2004: 64), nga ana tjetër duhet të jemi shumë të qartë se në disa raste situata është ajo që përcakton se përdorimi i kësaj apo i asaj gjuhe është i domosdoshëm apo jo. Ajo që propozon Hudson është në rastet kur folësi dëshiron injorimin e situatës. Rasti i propozuar nga Hudson përbën atë që Blom &Gumperz ( 1971) e quajnë *Zëvendësimi i Kodit Metaforik.* Ndërsa në Gorë, në Kosovë, kjo situatë është e ndryshme, pasi gjuha gorane është produkt i një zhvillimi ose asimilimi në kahun e sërbishtes. Që nga viti 1913 e deri në ditët e sotme në këtë areal, gjuha gorane ka qenë pjesë e zhvillimeve kulturore dhe gjuhësore në dy dimensione: në dimensionin e arealit gjeografik dhe në dimensionin e arealit adminsitrativ. Në dimensionin e arelit gjeografik ka vazhdimësi territoriale me një varietet të ngjashëm, me maqedonishten, ndërsa në anët e tjera është në kontakt me shqipen e krahinës së Opojës. Në dimensionin administrative, ajo vazhdon hullinë e zhvillimit nën ndikimin e sërbo – kroatishtes si gjuhë zyrtare administrative deri në vitin 1999. Parë në këtë kontekst etnikumi goran në Kosovë nuk paraqiste shenja të plota të bilinguizmit, madje situata e detyronte të zgjidhte njërin varietet të sllavishtes, qoftë i lartë ose i ulët. Në këtë kontekst, kulturat dhe ndikimi i tyre në arealin e Kosovës ishin të kushtëzuara, por nuk mungonte si ndikimi dhe interferim mes tyre. Pas vitit 1999 e në vazhdim kontaktet fizike, gjuhësore, kulturore dhe ekonomike mes dy pjesëve të Gorës së ndarë në Shqipëri dhe në Kosovë, ka krijuar një situatë të influencës gjuhësore të goranishtes që flitej në zonën e Kosovës[126] mbi formën gjuhësore të gornaishtes që flitej në zonën e Shqipërisë[127]. Kjo situatë mund të shikohet si një mundësi e kujtesës dhe ndikimi në zëvendësimin e formave dhe trajtave gjuhësore të shqipes me forma dhe trajta të sllavishtes, pavarësisht origjinës. Tendencë, e cila mund të konsiderohet, purifikimi të elementit jo vetiak qoftë në formë, qoftë në perceptimin semantic të realiteteve.

Në të gjithë Gorën vihet re një interferencë deri në nivelin gramatikor, por pa e shprishur këtë rrafsh duke mbetur si i tillë i gjuhës gorane. Në disa fshatra të krahinës së Gorës, sistemet gjuhësore të shqipes dhe sllavishtes nuk kanë mbetur të qartë, si në rastin e fshatit Orçikël, ku të dy sistemet gjuhësore janë shkrirë duke prodhuar një sistuatë gjuhësore hibride mes goranishtes dhe shqipes. Gjatë procesit të ligjërimit në një situatë të tillë, kodet gjuhësore zëvendësojnë njëra – tjetrën në mënyrë pak sa të çuditshme, por të paevitueshme si dukuri. Në këtë areal, situatë mund të flitet për asimilimin e dy kulturave, dy gjuhëve duke arritur në shkallën e përkufizimit të Lynos – it kur flet për bilinguizmin; "*Dygjuhësia e vërtetë presupozon shkrirjen (asmilimin) e dy*

---

[126] Një formë e ndikuar nga forma gjuhësore e sërbokroatishtes sidomos në aspektin leksikor, kjo parë në dy drejtime: në ruajtjen e formave të vjetra të trajtave gjuhësore të gjuhës gorane dhe në zhvillimin gjuhësor të kësaj gjuhe sipas modelit gjuhësor të sërbokroatishtes.

[127] Forma e gjuhës gorane e ndikuar nga shqipja sidomos në fushën e leksikut terminologjik të fushave të ndryshme ka bërë që shumë fjalë të saj të kalojnë në fondin e arkaizmave, që me ndikimin e sëbrokrotaishtes ka bërë riaktualizimin e tyre, duke i kthyer në fondin aktiv.

*kulturave*"(John Lynos 2001: 400). Kjo tendencë vihet re edhe në fshatin Oreshkë, si pasojë e martesave të shumta mes goranëve dhe shqiptareve. Problemet e mësipërme aktualizojnë fuqishëm, jo vetëm gjendjen psiko – sociale të shoqërive bilinge, por ato janë tregues të qënsishëm të bashkëjetesës ndëretnike, gjuhësore, kulturore, antopologjike duke i bërë këto shoqëri të qendrusheme në raporte kushtëzimi të dimensionit kohë (historisë) dhe hapësirë (gjeo – politikës). Shoqëritë bilinge janë shfaqje të një pasurisë gjuhësore të krijuar ndër vite, pse jo ndër shekuj. Në gjuhën gorane gjejmë një sërë huazimesh nga turqishtja, të cilat janë bërë pjesë integrale e leksikut të gjuhës gorane. Disa prej këtyre huazimeve mund të përmendim: *belki (ndoshta), bashka (ndarë), insan (njeri), xhadija (shtrigë), ab*$^{p}$*dall (budalla), zeher (helm), fazlla (tepricë), eksik (magut), at (kalë), terbiecës (i paedukatë), shefak (agim), hava (ajër), koshtane (gështenjë), dur (ndalo), çorbë (supë), oxhak (oxhak), karar (vendim, masë), hajvan (kafshë) etj.*

**Përfundime:**

1. Areali i Gorës është një ishull i sllavishtfolësve në detin shqiptar.
2. Bilinguizmi në Gorë është dëshmi e bashkëjetesës ndëretnike mes komunietit goran dhe atij shqiptar në hapësirën Shqipëri – Kosovë.
3. Në këtë zonë bilinguzimi shfaqet me të gjitha tiparet e tij të plota, sidomos në zonën e Shqipërisë si e vetmja mundësi e bashkëjetesës mes etnikumit goran dhe atij shqiptar, sidomos pas vitit 1923.
4. Dygjuhësia shfaqet si shkak - pasojë e interferimit kulturor të etnive, që kanë ruajtur në masën e dy sistemeve të plota gjuhësore të dy gjuhët gjatë gjithë procesit të ligjërimit.
5. Në zonën e Gorës së Kosovës, vihet re një formë diglosie mes gjuhës gorane dhe sërbo – kroate si gjuhë zyrtare, kjo deri në vitin 1999.
6. Pas vitit 2000 në këtë pjesë të Gorës shikohet një tendencë dygjuhësie mes gjuhës gorane dhe shqipes.
7. Në disa fshatra të Gorës në Shqipëri, për shkak të marrdhënieve të forta ndëretnike në aspektin kulturor, politik, ekonomik dhe mbi të gjitha të lidhjeve të gjakut (martesave), janë krijuar situata të shkrirjes dhe asimilimit të kulturave, rrjedhimisht edhe të sistemeve gjuhësore duke krijuar një formë hibride mes dy gjuhëve të ndryshme.
8. Bilinguizmi në Gorë është shfaqje e qartë e pasurisë gjuhësore dhe kulturore, në sistemin e gjuhës gorane mund të gjenden interferencat gjuhësore të ndryshme, që mund të kenë ndodhur në kohë të ndryshme.

**Literaturë**:

1. Bejtja, Bekim, *Gjuha dhe të folurit*, Buzuku. Prishtinë, 2007.
2. Fromm, Erich, *Psikoanaliza seksi dhe karakteri*, Fan Noli, Tiranë, 2009.
3. Hudson, Richard, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2004.
4. Lynos,Yohn, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2001.
5. Martine, Andre, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*", Dituria, Tiranë, 2002.
6. Shkurtaj, Gjovalin, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 2002
7. Shkurtaj,Gjovalin, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003.
8. Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhes shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2002

9. M. Gareth Gaskell, *The oxford Handbook of Psycholinguistics*, Oxford University Press. 2009
10. Dokle, Nazif,*Bogomilizmi dhe etnogjeneza e torbeshëve të Gorës së Kukësit*, GEER, Tiranë, 2009.
11. Dokle, Nazif, Tiranë, *Kukësi vështrim enciklopedik*, Koha, Tiranë, 1999
12. Pulaha, Selami, *Krahina e Sanxhakut të Dukagjinit gjatë shek. XVI,* Tiranë, 1984.
13. AQSHRPSSH, Fondi MPM, vitet 1920, 1922, 1923.

## DEBATET PËR GJUHËN STANDARDE SHQIPE DHE NOCIONI NORMË

PhD.Can.**Jehona Krasniqi-Morina**
Universiteti i Prishtinë “Hasan Prishtina”- Fakulteti i Filologjisë

**Abstrakt:**

Synim i këtij punimi është paraqitja e debateve të shumta rreth standardizimit të gjuhës shqipe,bërë nga njohës të shumtë nga të gjitha trojet shqiptare si, Ernest Koliqi, Martin Camaj, Arshi Pipa, Rexhep Ismajli, Shefkije Islamaj, Idriz Ajeti, Tahir Kolgjini, A.Kostallari, Bardh Rugova etj. Në këtë punim ndër të tjera thuhet se ka pasur edhe refuzime të standardizimit sipas projektit të skicuar në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit, në radhë të parë në diasporë, ndërsa në Shqipëri dhe në Kosovë hapësira për manifestimin e tij ka munguar.Qëllim i këtij punimi është të paraqiten idetë e autorëve të ndryshëm, njohës të gjuhës standarde shqipe, sa i përket standardizimit të gjuhës. Disa nga çështjet që ngriten nga këta kontestues janë se shqipja standarde është gjuhë politike, sepse është krijuar në kohën e diktaturës,pasi është ngritur mbi bazën e toskërishtes, pastaj se shqipja standarde është projekt i dështuar, meqenëse nuk ka arritur të zotërohet nga dy të tretat e folësve të saj, se standardja është gjuhë totalitare, pastaj se ajo është kodifikuar në mënyrë totalitare, nga faktorët politikë dhe me argumente politike. Sa i përket nocionit normë mbështetur tek disa studiues, norma gjuhësore përfshin normën drejtshkrimore, normën orto-epike, normën gramatikore, normën sintaktike dhe normën leksiko-sematike.

**Fjalët kyçe:** *gjuhë standarde, normë, kundërthënie, dialekte, autorë*

## Hyrja

Siç dihet, me Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 u vendos që shqipja do të ketë një normë drejtshkrimore të vetme dhe kështu u përcaktua që do të kemi një gjuhë standarde, ose të quajtur ndryshe, gjuhën letrare kombëtare apo edhe gjuhën letrare të njësuar. Norma u bë e detyrueshme

në të gjitha fushat e jetës publike dhe u pranua nga shqiptarët në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Malin e Zi dhe te arbëreshët. Popuj të ndryshëm, në një shkallë të caktuar të zhvillimit të tyre historik, në kohën e ndërtimit të marrëdhënieve ekonomike e shoqërore, që karakterizojnë një shkallë të lartë të organizimit politik e kulturor, kanë ndier nevojën për të krijuar një formë të veçantë të gjuhës kombëtare, e cila të përdorej në shumë sfera të jetës si mjeti më i përhapur i komunikimit, dhe këtu nuk bëhet fjalë për një komunikim çfarëdo, po për një komunikim, do të thoshim të kulturuar – në fushën e letërsisë, të dijes përgjithësisht e në jetën politiko-shoqërore. Pikërisht kjo formë e gjuhës, e krijuar në mënyrë të ndërgjegjshme e mbi forma të tjera të gjuhës, të cilat gëzonin ndonjë respekt e epërsi të veçantë ndaj të tjerave forma, – ndër popuj të qytetëruar është emërtuar gjuhë letrare, po e njohur edhe me të tjera emërtime – gjuhë e kulturës, gjuhë e përgjithshme, gjuhë kombëtare etj. Kjo, sidomos nga gjysma e dytë e shekullit që shkoi, ka zënë të emërtohet gjuhë standarde.Në rrugën e zhvillimit të tyre kombet dhe shtetet janë kujdesur për të krijuar një formë sa më të njësuar gjuhësore, që t'u shërbejë gjithë anetarëve të shoqërisë, të lehtësojë komunikimin ndërmjet tyre dhe zhvillimin e kulturës kombëtare.Edhe për ne shqiptarët shqipja standarde vijon të kryejë rolin e saj në jetën politike, ekonomike, shoqërore e kulturore dhe është varianti i vetëm që mësohet në shkollë. Po ashtu, në shkollë jepet mësim lënda e letërsisë, e cila përfshin edhe tekste të shkruara në variantet e gegërishtes.

**Qëllimi i studimit**

Ndonëse nga shumëkush standardizimi i gjuhës kombëtare është konsideruar si një fitore e madhe e popullit shqiptar, ka edhe intelektual e studiues shqiptarë të cilët nuk janë pajtuar me gjuhën e njësuar. Që prej 45 vitesh kur edhe u realizua "ëndrra gjuhësore shqiptare", janë parë përpjekje me intensitet, e të ndyshme, nga individë brenda Shqipërisë, por edhe jashtë saj në trojet shqiptare, veçanërisht në Kosovë dhe në emigracion, me qëllim kundërshtimin e gjuhës standarde shqipe. Kontestimet janë parë në mënyrën e formimit, vlefshmërinë dhe të ardhmen e këtij standardi. Madje studiuesi Rexhep Ismaili (2003: 33) thotë se ka pasur edhe refuzime të standardizimit sipas projektit të skicuar në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit, në radhë të parë në diasporë, ndërsa në Shqipëri dhe në Kosovë hapësira për manifestimin e tij ka munguar. Shkrimtarë dhe intelektual në diasporë, si Ernest Koliqi, Martin Camaj, Arshi Pipa, etj. Sipas tij si i rregull kundërshtarë të regjimit në Shqipëri në bazë ideologjike, politike, etj., kanë vazhduar të shkruanin gegnishten letrare.

Ndërkaq Arshi Pipa jepte edhe një vlerësim për gjuhën letrare të kosovarëve duke thënë se ajo nuk është as toskërisht as gegërisht, po më parë: "një mish - mash i veçorive kosovare të të folurit të përziera në klishe të huazuara nga shqipja zyrtare dhe po ashtu nga serbo-kroatishtja" (f. 45). Pipa, tezat kundër gjuhës së standardizuar i shtron në librin e tij "Politika e gjuhës në Shqipërinë Socialiste", ku ndër të tjera ai shprehet se "e ashtuquajtura shqipe letrare e njehësuar, as që i duhet dhe as që e deshi populli shqiptarë, mbasi ishte mësuar me të dy dialektet që kishin jetuar në paqe për një kohë të gjatë"(http://vvvvvv.radiandradi.com/gjuha-letrare-eshte-organizem-i-gjalle-peter-r-prifti 1993/testata-kryesore/gazeta/ (07.02.2017).

**Metoda e studimit**

Gjatë hulumtimit kryesisht jemi mbështetur në metodën e analizës teorike.

Kjo metodë na ka mundësuar trajtimin e problematikës në aspektin teorik. Në këtë rast jemi mbështetur në analizimin e materialeve të ndryshme shkencore pjesë e kësaj fushe, të cilat na kanë shërbyer jo vetëm në verifikimin e normës, por edhe në lehtësimin e nxjerrjes

përfundimtare të problemeve të caktuara në hulumtim. Pastaj gjatë trajtimit të kësaj çështjeje jemi koncentruar edhe në debate të ndryshme televizive, ku njohës të gjuhës shqipe kanë shtruar çështje të shumta gjuhësore sa i përket respektimit të standardizimit të gjuhës së sotme shqipe.

**Konteksti i i debateve për gjuhën standarde shqipe**

Për disa gjuha e sotme standarde trajtohet si një krijim i dhunshëm, i arritur nën diktatin e udhëheqjes komuniste shqiptare në Kongresin e Drejtshkrimit, rrjedhimisht si një mbijetesë e komunizmit, e papajtueshme me realitetin e sotshëm. Shefkije Islamaj shprehet se ndër kontestuesit ka edhe ndonjë të huaj gjerman, francez a anglez, që merr guximin të kontestojë standardin e shqipes, në të vërtetë të bëhet avokat i atyre që nuk ndihen mirë brenda këtij standardi. Ajo shprehet se ky numër është i vogël, po ata janë agresivë. Të gjithë kontestuesit kanë argumente pothuajse të njëjta. Disa nga çështjet që ngrihen nga këta kontestues janë se shqipja standarde është gjuhë politike, sepse është krijuar në kohën e diktaturës, disa shprehen se shqipja standarde është gjuha e Enver Hoxhës, pasi është ngritur mbi bazën e toskërishtes, pastaj se shqipja standarde është projekt i dështuar, meqenëse nuk ka arritur të zotërohet nga dy të tretat e folësve të saj, se standardja është gjuhë totalitare, pastaj se ajo është kodifikuar në mënyrë totalitare, nga faktorët politikë dhe me argumente politike. Ka edhe çështje të tjera për të cilët ata kundërshtojnë. (http://vvvvvv.pamfleti.com/gjuha-standarde-e-kontestuar 7. 2. 2017).

Te Ismaili (2003: 35) gjejmë se një reagim publik lidhur me “njësimin e gjuhës letrare” dhe në raport me “shqiptarët në Jugosllavi” në revistën “Shêjzat” më 1974, me mbititull “Dy dialektet kryesore dhe pikëpamja jonë”, shprehte edhe Tahir Kolgjini nga Stambolli, që ka shtruar pyetjen se si do të arrinte ky popull me shkollim kaq të shkurtë dhe kaq të çalë, ta përvetësonte edhe toskërishten, që sipas tij “âsht imponue me markën, gjuha e unjisuar”. Ajo që do përmendur është se vetë kundërshtimet e shfaqura ndaj gjuhës standarede, ndërkaq janë kundërshtuar nga një dyzinë e studiuesve, disa prej të cilëve ndonëse kanë pranuar ndonjë ndërhyrje të diktuar nga koha e rrethanat, kategorikisht kanë qenë kundër krijimit të ndonjë të ashtuquajturi neostandard.

Studiusi Idriz Ajeti (1985 :44) mendon se në normën e gjuhës shqipe janë thithur e bashkëndërtuar veçori të të gjitha dialekteve të gjuhës sonë, po ashtu sikur kishte porositur parimet konverguese të varianteve letrare të kësaj gjuhe K. Kristoforidhi. “Sipas disa përllogaritjeve raporti i elementeve dialektore brendapërbrenda në strukturën e gjuhës së sotme letrare shqipe sillet nga 13 me 8, që do të thotë 13 veçori dialektore të toskërishtes dhe 8 të gegërishtes letrare” (f.44). Ajeti shprehet se ka shteg që specialistët gjuhësor t’i afrojnë mendimet e tyre rreth çështjeve të hapura, në mangësitë apo dobësitë e natyrës gjuhësore, por ai kundërshton ndryshimet rrënjësore.Sipas tij, të prekësh sot në themelet e gjuhës sonë kombëtare do të thotë që shqiptarët në prag të shekullit XXI parapëlqejnë kthimin e rendit fisnor me një shumësi gjuhës e bajraktarësh, kur në saje të televizonit satelitor (shqiptarët) po komunikojnë me gjithë botën shqiptare në katër anët e saj. Mos po bëhemi gazi i dheut ?! (Ajeti 1994: 227).

Në anën tjeterë edhe disa studiues e profesorë të brezit të tashëm, brenda e jashtë Shqipërisë në paraqitjet e tyre me shkrime apo edhe në emisione televizive kanë porositur që të mbahen duart larg nga standardi i gjuhës shqipe. Emërues i përbashkët në këto raste pothujase ka qenë se aktualisht fronti për gjuhën duhet të jetë ruajtja e saj, ndërsa alarmi për mangësitë e kësaj gjuhe, duket se më shumë e dëmton këtë pasuri kaq të madhe. Disa janë shprehur se shqiptarët janë një popull i vogël dhe për këtë arsye edhe gjuha që flasin ata në rrafshin global përdoret nga shumë pak njerëz dhe për këtë nuk ekziston luksipër të bërë eksperimente me të, por e vetmja gjë që duhet bërëështë që gjuha shqipe të ruhet me kujdes të madh.

Gjuhëtarët kosovarë të brezit të ri, ndërkaq janë shprehur se diskutimet e hapura vetëm sa do ta ndihmonin në konsolidimin e plotë të gjuhës standarde, në mënyrë që ajo sa më mirë t'i kryej funksionet e saja. Profesori Shkumbin Munishi gjatë ligjëratave të mbajtura me studentë të nivelit Master (nëntor 2016) ka thënë se gjuha ndryshon në kohë dhe hapësirë, prandaj duhet parë se cilat ndryshime kanë ndodhur në përdorim. Bardh Rugova në Televizionin "Top-chanel" në Tiranë, (prill 2014) derisa është shprehur për "ndërhyrje" në gjuhën standarde ka thënë se "paskajorja nuk e ka zgjebën, dhe se për të do të diskutohet". Në këtë kontekst studiuesit të njohur R. Ismaili i duket i pafrytshëm barrikadimi në pozitat e krijuara njëherë pa përgjigje për kërkesat që shtrojnë situatat e reja. "Në të vërtetë, ai i vetizolon ata që refuzojnë të reflektojnë për çështjet që sjell zhvillimi, ndërkohë që realiteti shton nevojat për mijëra fjalë të reja"(Ismaili 2003: 50).

**RRETH NOCIONIT NORMË**

Norma është një tërësi e mjeteve të qëndrueshme që përdoren rregullisht në gjuhë. Ndryshe norma mund të kuptohet edhe si një lloj një mase. Sipas F. Rakës me termin normë letrare (1983: 20) mund të kuptohet përdorimi i mjeteve gjuhësore, të pranuar si i drejta prej të gjithëve dhe gjithashtu edhe tërësinë e rregullave sipas të cilave përdoren mjete të ndryshme gjuhësore të ligjërimit dhe në gjuhën e shkruar.

Në fjalorin elektronik shpjegues, Nocioni Normë, që përputhet me botimin e vitit 2002 në Tiranë, "Fjalori i gjuhës së stome shqipe" të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë – Insituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, del me disa përkufizime, por ne po paraqesim vetëm disa.

NORM/Ë, A f. sh. 1. Rregull e caktuar ligjore ose morale për sjelljen në jetë a në shoqëri, e detyrueshme ose e pranuar përgjithësisht; diçka e detyrueshme për t'u ndjekur; rregullat që përcaktojnë jetën e brendshme të një organizate. Normat morale (juridike). 2. Masë e caktuar për diçka; sasia e përshtatshme ose e rregullt për diçka; gjendja e rregullt dhe e zakonshme për diçka. Normat e shpenzimit (e harxhimit). Shmanget nga norma. 3. Sasia e punës që duhet të bëhet ose e prodhimit që duhet të nxirret brenda një kohe të caktuar. Normë ditore. Punë me normë. 4. gjuh. Tërësia e rregullave që përcaktojnë përdorimin e mjeteve të gjuhës letrare në mënyrë të njëllojtë për të gjithë pjesëtarët e një kombi; përdorimi i mjeteve gjuhësore që është ngulitur e është pranuar nga të gjithë pjesëtarët e një kombi si në ligjërimin e folur ashtu edhe në atë të shkruar. Norma e gjuhës letrare kombëtare. Norma gramatikore (leksikore). Norma drejtshkrimore. Norma e drejtshqiptimit., etj.

Përpos tjerash, norma mund të merret edhe si një kod, meqenëse nuk nënkupton vetëm trajtat apo ndërtimet fjalëformuese e sintaksore më të përhapura, që bëhen të detyrueshme për folësit e një gjuhe, por edhe ajo që nënkupton tërësinë e rregullave mbi përdorimin e tyre. Nxënës e studentë bëjnë përpjekje nga më të ndryshmet për zotërimin e normës, jo vetëm duke u përpjekur të shprehen saktë e bukur, por edhe si dhe ta përdorin mirë një normë gjuhësore, duke respektuar të përbashkëtën kundrejt të veçantës. Studiuesi A. Kostallari mendonte se sistemi i gjuhës shqipe standarde është i kodifikuar në disa vepra themelore të gjuhësisë shqiptare "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe" dhe "Fjalori drejtshkrimor", gramatikat e gjuhës standarde shqipe dhe "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe".

Mbështetur tek disa studiues, norma gjuhësore përfshin normën drejtshkrimore, normën orto-epike (tërësinë e rregullave të drejtshqiptimit), normën gramatikore (tërësinë e rregullave të trajtave gramatikore dhe të përdorimit të fjalëve), normën sintaktike (rregullat e lidhjes së fjalëve në fjali dhe të fjalive në frazë) dhe normën leksiko-sematike (rregullat e formimit të fjalëve dhe

të kuptimeve të tyre). Drejtshqiptimi i nënshtrohet drejtshkrimit, sepse procesin e kristalizimit të normës gjuhësore letrare e udhëheq gjuha e shkruar. Burimi kryesor i shmangieve nga shqiptimi letrar është ndikimi i dialekteve. Kriteret në normën drejtshkrimore formohen më lehtësisht, sikurse edhe më lehtësisht mund të përfillen.

Norma letrare nuk duhet të jetë e ngurosur, por elastike. Në këtë kontekst për të pasur një normë sa më të plotë drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore kërkohet një angazhim i madh i të gjitha institucioneve kombëtare e atyre lokale përgjegjëse. Pa dyshim barrën më të madhe duhet ta bartin ata që më tepër janë të thirrur për mbrojtjen e standardit, nisur nga shkollat më të ulëta e deri te ato të niveli më i lartë, pastaj Instituti Albanologjik, Ministria e Arsimit, Drejtoritë Komunale të Arsimit, mediet, etj. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim bartin edhe vetë mësimdhënësit, sidomos ata të gjuhës shqipe, të cilët ndikojnë në formimin e gjeneratave të reja.

**Rezultatet**

Në këtë punim kemi paraqitur këndvështrime të shumta të autorëve shqiptarë sa i përket gjuhës shqipe, standardizimit të saj dhe respektimit nëpër trevat shqiptare. Edhe sot e kësaj dite vërehet se ka kundërthënie të gjuhëtarëve sa i përket gjuhës standarde. Nga punimi i shtjelluar vërejtëm se gjuha standarde shqipe len hapësirë për t'u ndryshuar në raste, dhe se janë bërë përllogaritje se sa është më dominante toskërishtja në gjuhën standarde dhe sa është pjesëmarrja e gëgërishtes tek ajo. Por nga ajo që shtjelluam shihet se ka gjuhëtarë që varietetin e të folmes kosovare e quajnë "mish-mash" por jo gjuhë të miërfilltë. Brezi i ri i gjuhëtarëve , ndërkaq janë shprehur se diskutimet e hapura vetëm sa do ta ndihmonin plotësimin e gjuhës standarde, në mënyrë që ajo sa më mirë t'i kryej funksionet e saja. Po ashtu nga shtjellimi i nocionit të normës drejtshkrimore vërejtëm se institucioneve arsimore i bie barra më e madhe sa i përket respektimit të gjuhës standarde, si dhe të jenë transmetuesit e drejpërdrejtë të saj.

**Përfundime**

Në këtë punim u munduam për aq sa ishte e mundur, ta paraqesim gjendjen aktuale të shqipes standarde në këndëvështrime të autorëve të ndryshëm. Qëllimi i studimit tonë ka qenë hulumtimi i mendimeve të studiuesve të gjuhës standarde shqipe, në Kosovë dhe në vendet ku shqipja flitet.

Më lart thamë që ndryshimet e shumta politike, ekonomike e kulturore e patën ndikimin e vet edhe në shqipen standarde, sidomos në Kosovë. Duke parë se ka mendime të ndryshme rreth standardizimit të gjuhës shqipe, erdhëm në përfundim se kjo temë duhet shtjelluar edhe më tej dhe të shihet nga afër, a ka hapësirë për ndryshim të gjuhës standarde shqipe apo jo. Do të ishte e udhës që studiuesit e gjuhës shqipe të koordinoheshin më shumë mes vete sa i përket kësaj çështjeje,pa dallime hapësinore dhe pa dallime dialektore.

**BIBLIOGRAFI**


- Ahmetaj, Sala. 2002. *"Norma dhe zhvillimi i saj"*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.
- Ahmetaj, Sala. 2004. *"Gjuha standarde dhe strategjia kombëtare"* 50 vjet studime albanologjike. Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- Ajeti, Idriz. 1985. *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*. Prishtinë.
- Ajeti, Idriz. 1994. *Shqiptarët dhe gjuha e tyre*. Prishtinë.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. 1973 *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe.*Tiranë.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë.1976. *Fjalori Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe*. Tiranë.
- ASHAK.2002. *Fjalori i Shqipes së Sotme*. Tiranë.
- Çabej,Eqrem.1988.*Studime gjuhësore V.* Prishtinë.
- Dhrimo, A.Angoni, E.Hysa, E. Lafe, E. Likaj, E. Agalliu, F. Demiraj, Sh.1989.*Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (Morfologjia).* Prishtinë.
- Eco, Umberto. 2007. *Si shkruhet një punim diplome.* Tiranë.
- Instituti Albanalogjik i Prishtinës. 1974. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*.Prishtinë.
- Ismajli, Rexhep. 2003. *Standarde dhe identitete.* Dukagjini, Pejë.
- Ismajli, Rexhep. 2005. *Drejtshkrimet e shqipes.* ASHAK, Prishtinë.
- Kostallari, Androkli. Lafe, Emil. Totoni, Menela, Cikuli, Nikoleta. 1984. *Gjuha letrare shqipe –Elemente të normës së sotme letrare.* Prishtinë
- Memushaj, Rami. 2005. *Shqipja standarde.* Tiranë.
- Memushaj, Rami. 2008. *Hyrje në gjuhësi.* Tiranë.
- Munishi, Shkumbin. 2013. *Probleme të shqipes standarde në Kosovë.* Prishtinë.
- Munishi, Shkumbin.2013.*Pikëpamjet e Androkli Kostallarit për gjuhën standarde shqipe.* Prishtinë.
- Munishi, Zijadin. 1984. *Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit.* Prishtinë.
- Rugova, Bardh. 2009. *Gjuha e gazetave.* Prishtinë.
- Rugova, Bardh. 2009. *Gjuha e gazetave.* Prishtinë.
- Sulejmani, Fadil. 1984. *Praktikumi i gjuhës shqipe.* Prishtinë.
- Xhuvani, Aleksandër. 1968. *Studime gjuhësore*. Prishtinë.
- http://vvv. arkivalajmeve.com/Propozimet-per-standardin.

*ISSN 1800-9794 (Print) ISSN 2337-0521 (Online)*

# ROMANI DR.GJILPËRA TË FAIK KONICËS NË MES REALES DHE FANTASTIKES

**Ma.Fahrije Lushi**

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"

## Hyrje

Nga vetë titulli shihet qartë se brenda këtij trajtimi, bazë kryesore e interpretimit do të jetë teksti, duke marrë pjesë më të veçanta nga romani, do të mësojmë edhe për temat apo qështjet të cilat i trajton Konica brenda "Dr. Gjilpërës. Së pari duhet të tregojmë se "Dr. Gjilpëra" është një prozë satirike, brenda së cilës Konica ironizon me realitetin e shoqërisë shqiptare të asaj kohe, duke vënë në pah dukuritë negative dhe të metat që pengonin drejtë zhvillimit të Shqipërisë. Si një roman që njihet për shumë elemente të ndryshme që përmban brenda vetes "Dr. Gjilpëra", theu gati gjithë normat e të qenurit roman autobiografik, sepse kjo jepet edhe përmes pozicionit të autorit këtu. Brenda romanit "Dr. Gjilpëra", shtjellohen tema të ndryshme por mbi të gjitha në mënyrë dramatike dhe në formë të përshpejtuar jepet fati i njeriut përballë kohës dhe problemeve të atilla rrëfimore, me shumë ngjarje dhe veprime po aq të ngulfatshme, brenda një episode me plotë ngjyrime jetësore. Po ashtu përtej çdo mesazhi në prapavi dalin detaje ku përshkrimi dhe rrëfimi jepen në mënyrë alegorike dhe ironike, duke dhënë botën e brendshme shpirtërore të çdo personazhi. Përmes përceptimeve të qarta si dhe pranisë së dukurive brenda realitet shqiptar, të cilat citohen me një gjuhë figurative, shtresohet dhe më tej vie deri te komikja, e cila pasqyron karaketrizimet e personazheve, si dhe në ballafaqimin e të vërtetes me iluzionin. Shihet qartë edhe fjalori karakteristik që ndërlidh intrigën dhe pikturimin e karaktereve të ndryshme brenda personazheve, e sidomos personazhin më të veçantë Dr. Gjilpëra, përmes të cilit shpalos origjinalitetin e theksit ironiko – satirik, brenda tematikës së veçantë dhe të rrallë në prozën shqipe në atë kohë. Për të theksuar edhe më tej origjinalitetin dhe shijen e veçantë dhe spikante, nga ana e Konicës i cili bëri një rrëfim aq konkret brenda romanit të tij, duke shpërfaqur dukuri të ndryshme shoqërore të cilat e bënë kaq të veçantë romanin në fjalë. Një element i cili vihet re që në hapje të romanit është prania e autorit në të, i cili me gjithë pikëpamjet e tij del hapur përmes personazhit të Dr. Gjilpërës. Janë edhe disa karakteristika të tjera që gjatë tematikës kryesore brenda këtij romani, ku Konica nëpërmjet ironisë dhe satirës arrinë të bëj personifikime nga më të ndryshmet. Duke përmendur figura e personalitete shtetërore të cilët në pozitat kyqe që mbanin arritën që t'i ulin imazhin dhe gjithë vlerat e jetës brenda shoqërisë dhe më gjerë. Konica këtu nuk do të lë pa prekur asnjë nga klasat e shoqërisë, në njërën anë ironia me njerëzit e thjesht dhe në anën tjetër pushtetarët dhe naiviteti i tyre vuri në pah edhe më tepër satirën, që nganjëherë kalon edhe në momente komike dhe shumë të ulëta. Pra kur bëhet fjalë për ambientin ku do të gjalloj Dr. Gjilpëra, me gjithë qëndrimet e tij largëpamëse drejtë zhvillimit të një shoqërie të tillë shqiptare sipas tij duhej çrrënjosje e thellë e atij mentalitetit, të mbetur nga tradita dhe kultura të shumë prej pushtuesve të vendit. Kjo shoqëri, me të cilën aq shumë dëshiron të mishërohet Dr. Gjilpëra, vetë Konica ka disa të meta të cilat ai do mundohet me tërë qenien e tij që t'i ndryshoj, por gjithnjë duke specifikuar ngritjen e shkallës së zhvillimit të përgjithshëm brenda shoqërisë së tij, e cila përkon në dije të reja. Do të marrim një pjesë nga teksti me të cilin e nisi rrugëtimin e tij drejtë prozës moderne në njërën anë, dhe rrëfimit

dramatik të realitetit jetësor në anën tjetër, të cilin e jep duke dhënë disa detaje të mbështetura në satirën. Teksti është në fillim të romanit, dhe ajo që ne na bëri përshtypje janë idetë, mbi të cilat është e mbështetur gjer në fund gjithë tematika e romanit.

"Djali kish një mendje të hapët dhe të gjerë, interesohej në letrat e vjetra dhe në të sotmet, në historinë e mendimeve dhe në historinë e ngjarjeve, po tërhiqej në një mënyrë të veçantë nga mësimi i shkencave. Kur mbaroi gjimnazin, qëndroi dhe u mejtua. Tregtia e mërzitte. Letrat i donte me gjithë shpirt; po sado i ri, kuptohet se letrat, si karrierë, janë të mbjella me gjemba, duan ngè, duan rreth të bukur, dhe instiktet bakale babait tij do t'i vějin pengime në zhvillimin e individualitetit. Kanunin nuk e pëlqente, politikën e urrente. Mbetej mjekësia. Gjilpëra – u – dalldis në mejtime. Mjekësia? do të thotë koqe, plagë, qelbë, mëlçitë të prishura, zorrët të vulosura, gjak bacille, erëra të liga. Po nga ana tjetër, mjekësia është një dituri fisnike, meqë qëllimi i saj është pakësimi i dhembjes. Pastaj mjekësia nuk është si tregtia, në kundërshtim me letrat. Ca shkrimtarë të mirë kanë qenë mjekë; dhe shumë mjekë kanë shijen e artit, të muzikës, të librave të bukur. Gjilpëra e hodhi zarin për mjekësinë; dhe i ati, si shqiptar kish një nderim të trashëguar, në mos për diturinë, për shkallën sociale të mjekut".

Ajo që vihet re në mesin e këtyre rreshtave po edhe brenda gjithë romanit, është figurshmëria dhe stili i veçantë nga ana e Konicës, gjithmonë duke pasë parasysh se romani në përgjithësi është një prozë satirike. Elementet e ndërtimit këtu vihen në pah në mënyra të ndryshme, Konica një herë bën disa krahasime, herën tjetër jep gjykimet e tij, të cilat mbajnë më tepër karakter ironik, sepse në këtë rast ai do të shpreh idetë dhe mendimin e tij lidhur me jetën duke paragjykuar indirekt në një shoqëri të tërë. Mbi të gjitha haptazi del qenia e njeriut më e papërfomësuar, si dhe siatuatat e tilla [128]njerëzore të cilat i arrijnë nga vetmashtrimi apo lakmia e tepërt.

Janë këto pra dy nga tiparet njerëzore që përcjellin veprën dhe në të njejtën kohë, i hapin rrugën e të qenit kritik nga ana e Dr. Gjilpërës ndaj tyre. Dr. Gjilpëra brenda misionit të tij, i kishte paraparë gjithë synimet dhe detyrat e tij drejtë injektimit të një qasje të re, e cila do të shpiente faktorë mjaft të rëndësishëm brenda shoqërisë shqiptare në këtë rast. Si personazhi më i goditur dhe i injoruar shumë herë, Dr. Gjilpëra mbetet gjithmonë aktual në secilën situatë të caktuar brenda romanit, ai do të përshtatet me se cilin ambient, duke u mbështetur gjithmonë në synimet e tij dhe qëllimin kryesorë, parimet drejtë zhvendosjes së mentaliteteve të vjetra, të trashëguara nga kanune e rregulla po ashtu të vjetëruara. Ndryshe nga një këndvështrim tjetër, Dr. Gjilpëra njihet edhe si personazh autobiografik brenda veprës, duke vënë në pah motivimin personal nga ana e autorit. Duke përmendur karakterin e personazhit përkatës brenda romanit, mund të konkludojmë se ky personazh mund të merret si përcaktor i karakterit përgjithësues të romanit në tërësi. Megjithatë tani më e kemi parasysh se vepra e Konicës ka karakter të gjithanshëm, por që romanin më tepër e përshkon ironia dhe satira, si dy ndër figurat karakterizuse brenda veprës së Konicës në përgjithësi. Karakteri i gjithanshëm në radhë të parë, si dhe ana figurative e përmbushur nga ana e Konicës në anën tjetër, e vënë në diskutim së pari tekstin jo vetëm si të tillë, por tematikën që jepet përmes tij, që gjithmonë është i shoqëruar nga ide dhe tema të marra nga aktualitete të kohës që përkonin me ambientet jetësore të shoqërisë shqiptare. Pos këtyre detajeve që përmendëm këtu, tani duhet të sjellim

[128] Faik Konica, Vepra 1, Rilindja, Prishtinë, 1995, f. 80.

edhe dy tregues tjerë po aq të rëndësishëm, e që sjellin një diskurs të veçantë të veprës si tërësi; alegoria dhe mesazhi kritik, që po ashtu gjithmonë jepet i përshkallëzuar në situata të ndryshme. Duke marrë parasysh tani edhe karakterin autobiografik që ka vepra në fjalë, e po ashtu edhe tematikën e saj të përcjellë nga mesazhi kritik dhe alegoria, së pari e vë në pah lidhjen e autorit me tekstin, dhe në anën tjetër, rritë domosdo interesimin dhe vëmendjen nga ana e lexuesit. Nga gjithë kjo themi se Konica, si një nga themeluesit e prozës moderne dhe kritikës brenda letërsisë shqipe, edhe përmes kësaj proze solli qëndrimet e tij prej kritiku, ku në qendër të vëmendjes ka njeriun e thjeshtë, përballë mekanizmave shtetërore në periudha të ndryshme kohore. Për të lidhur këto paragjykime që dhamë në vazhdim marrim disa pjesë nga teksti në vijim, në mënyr që diskutimi të jetë sa më i hapur dhe konkret këtyre pohimeve.

"Durrësi - me shtëpitë e bardha, me kullat rrumbullake të mbetura nga Koha e Mesme, me kodrat e murme prej shkëmbi të prerë maja - maja si nga dora e njeriut që i bëjnë një kurorë të rëndë përmi krye - duket për së largu, për udhëtarin që afrohet nga deti, një qytet përralle dhe bukurie i shtrihur pranë valave. Po i pari kontakt me Barkarët e limanit e prish menjëherë atë lodër të mendjes dhe e vë njerinë përpara një vërtetësie jo aq të pëlqyer. Barkat iu afruan anijes së avullit, dhe dr. Gjilpëra hodhi një sy mi njerëzit që vozitnin: Ishin shëmbëlla shumë të varfra të races së njeriut: njerëz të zinj e të verdhë, të ngrysur, të mvrenjtur, të parrojtur, të pakrehur, probabilisht të palarë, njerëz të mërzitur nga bota dhe nga vetja e tyre, që nuk shihnin. Dr. Gjilpëra u habit shumë, dhe në një italishte të thyer pyeti një officer të anijes si qe e mundur të ndodheshin barkarë nga Malta ose nga Aleksandria në një liman të Shqipërisë - Ç'maltezë more, ç'egjiptianë? Janë thjeshtë shqiptarë".[129]

Këtu Konica dha një pasqyrë rrëfimi nga një këndvështrim i drejtëpërdrejtë me realitetin dhe botën shqiptare, e cila nga larg ngjallte mallin dhe dashurinë, por atakimi me të ishte diqka e pazakontë për udhëtarin i cili vinte nga një vend dhe kulture krejtë tjetër. Për të mos anashkaluar asnji detaj, rrëfimin e nis me një ndenjë të thellë dashurie, duke vënë në pah një nga një bukuritë dhe të veçantat e vendit të tij Shqipërisë, të cilat bukuri i krahason me ato nga Koha e Mesme. Pastaj për të shprehur revoltën dhe pakënaqësitë nga ana e tij Konica, përmendi në detaje pasqyrën e njerëzve të tij duke i krahasuar me Maltezë dhe Egjiptianë, të cilët e dimë mjaftë mirë se çfarë kulture dhe tradita kanë. Nga dëshprimi dhe habia dr. Gjilpëra, do të vazhdoj misionin e tij nga qyteti i Durrësit në drejtim të Tiranës, me qëllim që të ngrisë vetëdijen tek njerëzit, sepse vetëm duke njohur përafër mentalitetin e tyre ai do të provonte ndryshimin. Duke pasë parasysh përshtypjet e para të Konicës, me kthimin e tij pas një kohe përsëri në vendlindje, ne shohim individin e vetëm përballë një turme të gjerë njerëzish që s'dinin gjë për realitetin e tyre jetësor. Kur jemi te shoqëria dhe individi duhet të përmendim disa fakte të cilat japin vlerën shtesë gjithë këtyre supozimeve tona lidhur me misionin dhe në përgjithësi vlerat e romanit në fjalë. Mbi të gjitha ne kemi parasysh së pari kohën kur është shkruar dr. Gjilpëra, mandej motivin si një burim shtesë i informacioneve që lidhen me ambientin dhe rrethanat nëpër të cilat po kalonte shoqëria shqiptare aso kohe. Para së gjithash si temë kryesore kemi individin kundrejt një realiteti të rëndë, të ngulitur nga hamendja dhe primitivizmat e kohërave më të vjetëra, të cilat burimin kryesorë e

[129] Faik Konica, Vepra 1, Rilindja, Prishtinë, 1995, f. 97.

gjejnë nga pushtuesit e ndryshëm të Shqipërisë. Edhe një fakt tjetër që gjithsesi ndërlidhet me këtë që thamë tani me pushtuesit, sepse posa dr. Gjilpëra do të filloj kontaktet e para me njerëzit në Shqipëri, gjëja që më së shumti bie në sy është edhe fjalori i tyre i stërmbushur me barbarizma të ndryshme, ku dominojnë shprehjet në gjuhën turke. Këtu tani fillon ai misioni i shumë përmendur i dr. Gjilpërës, i cili e vë në dritë gjithë realitetin shqiptar, gjithmonë kemi parasysh qëllimin që mbanë në vete ky mission. Konica do të marrë guximin që nëpërmjet misionit të tij dhe mbi të gjitha duke i goditur ato fenomene dhe kontradikta nga realiteti shoqëror, t'u afrohet sa më afër dhe ti trajtoi ato si jo të dobishme dhe të nevojshme për shoqërinë e tij. Konica brenda dr. Gjilpërës mbajti të fshehtat e tij në një fare mënyre, duke vënë para lexuesit të gjitha pikëpamjet e një njeriu të ngritur dhe emancipuar me një kulturë të rrallë prej intelektuali, por edhe një artëdashës i të gjitha dijeve. Duke vënë dr. Gjilpërën gjithmonë si mbrojtësin dhe misionarin në të mirë të gjithanshme ndaj njerëzve, si, kulturën, traditat e tyre përkatëse, po ashtu edhe gjuhën dhe të folmen e tyre, shumë qartë Konica do të konsistoj edhe në ngecjet e zhvillimit të letërsisë shqipe në këtë rast. Konica nga ana e tij përmes dr. Gjilpërës, solli edhe një herë njeriun i cili ka të ngjarë me Plugun personazh ky nga proza "Një ambasadë e Zulluve në Paris", shembullin e njeriut që do të nis të mishërohet edhe me botën që nuk kishte jetuar asnjëherë, vetëm e vetëm që t'u hedhë dritë njerëzve të tij. Ai do të filloi nga njerëzit më të thjeshtë gjerë tek shtresa më e lartë, e cila sipas dr. Gjilpërës ishte e zhytur tejet në rregulla të kanunizuara e primitive, që sipas tij edhe më tej po e rrënonin një shoqëri po aq të prapambetur dhe analfabete, thuajse krejtësisht e papërformësuar. Tani përballë këtyre sfidave në njërën anë, dhe misionit të tij nga ana tjetër, jepet ndikimi dhe idetë e tij brenda kësaj shoqërie. [130]

Dr. Gjilpëra – synimet dhe misioni në Shqipëri

Duke marrë parasysh temën me të cilën Konica e hapi veprën e tij, "Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit", kemi parasysh një rrëfim të pastër nga ana e tij, të cilin rrëfim e mbështet tërësisht në personazhin e tij Dr. Gjilpëra. Kur jemi te pjesa e parë e veprës, i tërë rrëfimi pasqyron formësimin e personalitetit të personazhit përkatës Dr. Gjilpëra, për të kaluar në pjesët tjera të veprës ku personazhi do të shpalos misisonin e tij para një mase të gjërë të shoqërisë. Mbase pjesa e parë sjell informacionin kryesor mbi kryepersonazhin dhe jep disa detaje lidhur me jetën dhe fillimet e karrierës së Dr. Gjilpërës, pjesa përkatëse në vijim paraqet veprimet dhe njohjen me ambientin nga ana e personazhit, ku shoqëria shqiptare jetonte realitetin më të trishtueshëm, të cilin Konica e përçon me tone të forta ironizuese. Për të vënë në pah më së miri këto pikëpamje dhe qëndrime të autorit dhe kryepersonazhit të tij Dr. Gjilpëra, marrim pjesë nga teksti e cila ka të bëj posaqërisht me qytetin e Durrësit, për të vazhduar edhe me Tiranën dhe njerëzit aty. Një prej dukurive që bie në sy dhe që drejtëpërdrejtë do të atakohet me to Dr. Gjilpëra janë; së pari njerëzit e pushtetit dhe disa prej shërbyesve civil, e mandej do të radhiten familjet e agallarëve të asaj kohe në Shqipëri si dhe në fund shtresa më e thjeshtë e shoqërisë.

"Durrësi – me shtëpitë e bardha, me kullat rrumbullake të mbetura nga Koha e Mesme…..

[130] Sabri Hamiti, "Faik Konica: Jam unë", Rilindja, Prishtinë, 1991, f. 89.

Dr. Gjilpëra mori valizen e tij në dorë, zbriti shkallët e pasigurta të anijes së ndryshkur dhe hyri në një barkë me ca udhëtarë të tjerë. Në doganë u doli përpara një turmë e errët, njerëz të verdhë, me fytyra të lodhura, dy policë brutalë i shtyjin me të mëngjër e me të djathtë, dhe udhëtarët hyjtin në binanë e doganës. Këtu doganierët, me fytyra të palara e të thartuara, nisnë të gërvishtin plaçkat. Dr. Gjilpëra kish kapërcyer shumë kufi, po asgjëkundi s'kish gjetur një tërbim kërkonjës aq të madh. Ç'shikojin? Në bëjin hetime policie, si nuk e pati shpjeguar njeri se dokumentet e dëmshme nuk lihen në valizat? Në mundoheshin të gjenin lëndë fiskale për të mbushur arkat e shtetit, si nuk i kish stërvitur guverna të bëjin ndryshimin në mes të dengëve malli, që janë për marketat edhe të një valise udhëtari me plaçka të trupit? Apo në këtë vend të lumtur vallë, mos goditeshin me një takes edhe brekët e udhëtarëve"!
E kemi përmendur edhe më lartë se derisa Dr. Gjilpëra një misionar dhe intelektual me një kulturë evropiane, teksa po kthehej për një vizitë në vendlindje ai do të ndeshet me problem të ndryshme që në hyrje të shtetit shqiptar. Derisa jepen përshtypjet e para të Dr. Gjilpërës, nga udhëtimi i tij për në vendlindje, në anën tjetër shfaqen edhe të metat dhe niveli i ulët i dijes dhe kulturës tek njerëzit që ai i takon. Një prej momenteve ku Dr. Gjilpëra do të shprehë tërë habinë e tij, jepet përmes përshkrimeve të njerëzve punonjës të shtetit, policët ku sipas tij ishin të një rangu shumë të ulët dhe se vetëm në Shqipëri mund të jenë të tillë. Pra, Konica duke vënë personazhin e tij Dr. Gjilpëra, si epiqendër të opinioneve nga ana e tij, dhe duke ngritur njëherësh secilin problem të shoqërisë përballë nivelit të tij, artikulon një përshkrim krejtësisht natyralist të një ambienti shqiptar, të viteve '20-ta, gjithnjë me anë të frymës së tij [131]satirizuese.

Në njërën anë jepet mënyra e të vepruarit të personazhit, ndërsa nga ana tjetër jepet qëndrimi që mbanë vetë Konica i prirur nga ironia dhe satirizimet e ndryshme që bënë, sidomos me nivelet e ndryshme të njerëzve dhe kulturën e mangët të tyre. Duke u përqendruar në njohjet e para, si ajo në rastin e policëve dhe kthimi i tij pas një kohe në vendlindje paraqesin episode më të trishtueshme nga ana e Konicës dhe njerëzit aty. Pasi që misioni që i kishte vënë vetes kishte të bënte me ngritjen e nivelit të dijes dhe kulturës në përgjithësi, Konica do të këmbëngul që personazhi i tij të shndërrohet në një hero të gjithanshëm, pa marrë parasysh se si pritej ai para një mase të gjerë analfabetësh e primitivësh.
Pos këtyre momenteve në vazhdimësi jepen edhe takimet e Dr. Gjlipërës me njerëzit më të lartë siç i quan Konica, "Kamorra shtetërore", ku dalin në pah shumë tipare me të cilat Konica i personifikon vetëm shqiptarët. Disa prej këtyre tipareve janë: ryshfeti dhe haraçi, që secili njeri mund të bëhej servilë i tjetrit vetëm në këmbim të parasë apo ryshfetit. Ndërtimin e këtyre momenteve Konica e bëri, duke filluar me disa përshkrime lirike të cilat marrin menjëherë karakter ironik, satirizues por edhe sarkastik. Kemi parasysh detajet me të cilat jepen këto rrafshe brenda novelës; në njërën anë jepet individi përballë një mase të gjërë, i cili ka një personalitet në vete, ndërsa nga ana tjetër momente po aq dramatike janë njerëzit më të papërformësusar dhe analfabet.
Ja disa rreshta ku përshkruhet komunikimi me njerëzit e Kammorres, mbi të gjitha njeriu më i forte i saj konsiderohej Salemboza si dhe këshilltari dhe agjenti i tij, Abd

[131] Faik Konica, Vepra 1, "Rilindja", Prishtinë, 1995, f. 96, 97.
Sabri Hamiti, "Faik Konica: Jam unë", "Rilindja", Prishtinë, f. 89.

– el Katli dhe Ibn – el Kelbi. Dr. Gjilpëra si njeri i prirur në dijen e kulturën evropiane, do të hamendet me tiparet e njerëzve të Kamorres, me nivelin e tyre të ulët të dijes dhe kulturës në përgjithësi.

"Duhet të dini që Salemboza, si gjithë njerëzit e mëdhenj, ka ca dobësira të vogla; dhe njëra nga këto është se i pëlqen të mësojë ç'bëjnë princët e Avropës në jetën e përditshme që t'i marrë dhe ai për shëmbëll.

Dr. Gjilpëra, i habitur nga këto gjëra aq të ra dhe të papritura, e falënderoi policin dhe nxori një biletë një mijë liretash. Polici iu lut t'i jape bileta më të vogla, se një biletë aq e madhe do të vihej re kur ta thyente, dhe ashtu polici do të shtrëngohej të paguante hise të rëndë.

Abd – el Katli e priti me oborrësi. Ky barbar fjalët i kish të pak, dhe të matura. Hollësia e tij për të gërmuar lajme, duke pyetur tërthori, e habiti dr. Gjilpërën. Abd - el Katli tha se Salemboza kish nevoj për një këqyrje mjekësore; Dr. Gjilpëra u përgjegj se ish gati çdo ditë t'i bënte vizitë Salembozës".

Për t'i dhënë edhe më frymë ambientit të tillë shqiptar Konica, mori gjithë mundin e tij dhe trajtoi një nga një problemet me të cilat frymonte shoqëria shqiptare aso kohe. Si një vend aq afër Evropës e cila jeton një frymë kulture dhe dije aq të lartë, për Konicën, Shqipëria dhe shqiptarët mbeten bota më e paqytetëruar dhe e zhytur në primitivizma, duke filluar nga pushtetarët e deri te shtresa më e ulët e shoqërisë. Ndarja në klasa edhe në vitet e '20-ta, brenda shoqërisë shqiptare do të bëhen simboli i shkallës më të ulët të dijes dhe avancimit të saj në kohë dhe në hap me vendet perëndimore. Brenda dr. Gjilpërës Konica nuk lë gati asnjë temë pa shtruar, ku ndër të gjitha, disa prej të cilave i përmendëm, hynë edhe një prej temave tipike shqiptare të cilën gjithsesi Konica nuk lë pa prekur. Ishin familjet e njohura shqiptare në atë kohë, ato të agallarëve, ku grujaja shqiptare është më e shtypura, dhe si krijesë e tillë ajo duhet të jetë e mbyllur dhe vetëm nën rregullat e burrit. Me anë të personazhit të Zylfikar Agait dhe gruas së tij Arifes në njërën anë dhe personazhit më të goditur dr. Gjilpëra, pasqyron dy botëra të kundërta në Shqipërinë e asaj kohe. Me dr. Gjilpërën konsiston idea e botës së civilizuar perëndimore, ndërsa dy personazhët tjerë përçojnë traditat dhe kanunet e vjetëra që ngjanin më tepër me zakonet turke, të cilat mbeten të paanashkalueshme edhe më tej në Shqipëri. Këtu jepet edhe misioni në veçanti brenda novelës e që ka të bëjë me dijen duke insistuar në vetëdijësimin e njerëzve, se kultura dhe mënyra e të jetuarit të njeriut duhet të jetë parësore, mbi të gjitha.

Një episode tjetër brenda kësaj novele është edhe takimi në mes të "dr-ve ballaknik" që i quan Konica, dhe dr. Gjilpërës.

"Kini shumë të sëmurë në këtë qytet?" pyeti dr. Gjilpëra. "Ka mjaft, po shyqyr Perëndisë, i shërojmë", - tha dr. Emrullahu. "I shëroni?", pyeti përsëri dr. Gjilpëra, me një çudi në zë dhe në sy të tij. – "Vevea i shërojmë", - u përgjigj dr. Protagoras Dhalla. Dr. Gjilpëra. - Me ilaçe i shëroni ata të sëmurët? Dr. Emrullahu. - Tabi me ilaçe. Dr. Protagoras Dhalla. - Me ilaçe, fisika.

Tani nëpërmjet këtyre doktorëve ballkanikë të cilët punonjnë dhe veprojnë në Tiranë, si dhe bisedës dhe kontakteve të tjera që do të ketë dr. Gjilpëra me ta, jepen edhe detaje por edhe disa shtresime figurative ku mbi të gjitha dominon ironia përjashtuese nga ana e autorit. Po ashtu brenda këtij rrëfimi jepen detaje tjera shtesë për të dy doktorët, të cilët nga vetë emri i tyre tregojnë edhe arritjet dhe nivelin e dijes po aq kontradiktuese me ambientin shqiptar. Edhe një fakt tjetër tani nga ana e Konicës ku përmes së folmeve të tyre që njëri përzien me greqishtin dhe tjetri me turqishten, paraqet edhe karakteristikat ndërmjet dialekteve që më tepë tepër konsiston në idenë e

përafrimit të dialekteve nga ana e Konicës. Parimet e tij Konica pikërisht këtu i lidh me pastërtinë që duhet të ketë gjuha shqipe, si një gjuhë mjaft e pasur që nga fillimet e saj, nga folklori dhe gjuha e folur e popullit, e deri në arritjetjet e ndryshme të kultivuara nga arritjet e letërsisë. Bazuar në këto të dhëna dhe informacione mbi të cilat është ndërtuar novela në fjalë, kemi parasysh një figuracion me nivele të ndryshme të teksteve, një herë mund të ketë frymë lirike për të kaluar më pas në frymë epike. Kështuqë, Konica duke ndërtuar diskurset e tij që shpiejnë drejtë shtigjeve të reja të vetë njohjes dhe dijes së gjithanshme, i dha edhe veprës së tij një karakter të tillë të prirur nga idetë dhe fiksionet e tij personale. Me një fjalë Dr. Gjilpëra do të mbetet si personazhi më i afërt i Konicës, nëpërmejt të cilit ndërtoi idetë e tij, duke kërkuar të zakonshmen në jetën shqiptare, dhe duke u njohur me të pazakonshmet, po ashtu brenda gjithë shtresave ekzistente të shoqërisë shqiptare. Ndër të tjera mund të themi se përmes tij, Konica, solli njeriun e ngritur dhe intelektualin e vetmuar përballë një mase të tërë primitive dhe të prapambetur në tradita dhe zakone të kultiviuara nga pushtuesit e Shqipërisë. Pra, janë këto disa nga temat me të cilat Konica i dha një vend kaq meritor veprës së tij, sepse duke diskutuar jeten e njerëzve, traditat dhe zakonet e tyre primitive, solli realitetin e botës shqiptare në përgjithësi. Duke njohur natyrën e veprës së Konicës në veçanti, ne mund të konkludojmë se Konica në mënyrë indirekte preku këtu edhe qështjet që kishin të bënin edhe me zhvillimin e gjuhës dhe letërsisë [132]shqipe në Shqipërinë e kohës së tij.

Përfundime

Për gjatë kohës së këtij punimi jam munduar të vë në pah diskursin letrar, të shtruar në dy rrafshe të ndryshme, brenda romanit "Doktorr Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit", të Konicës.

Duke qenë se çdo vepër e Konicës përmban në vete më tepër një mesazh kritik, të ndërtuar mbi fatet e ndryshme të individit dhe masës së gjërë, në situate të ndryshme, ne erdhëm në përfundim që temat të cilat i trajtoi brenda romanit "Doktorr Gjilpëra", janë tejet sociale dhe të ambieneteve tipike shqiptare.

Mbase Konica personalitetin e tij e kishte krijuar në Evropë dhe botë, u mundua që gjithë atë, frymë të dijes dhe kulturës perëndimore t'a mbillte edhe në shoqërinë shqiptare. Po ashtu ambienti shqiptar i viteteve '20-ta do të shënoj një varg veprash të Konicës, duke mos anashkaluar asnjë detaj që gjithësesi të përkonte me ambientin shqiptar; siç janë veprat: "Dr. Gjilpëra", "Shqipëria si m'u duk", "Shqipëria – kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore", nëpërmjet të cilave solli synimet dhe dëshirën e tij të vetme, ndryshimin e mentalitetit në shoqërinë shqiptare.

Vepra e Konicës mbanë meritat e saj të veçanta nëpër kohë, sepse ajo i konsistoi çdo situate dhe aktualiteti shqiptar të kohës kur është shkruar.

[132] Faik Konica, Vepra 1, "Rilindja", Prishtinë, 1995, f. 111, 112.
Sabri Hamiti, "Faik Konica: Jam unë", "Rilindja", Prishtinë, 1991, f. 99, 100.

## Literatura

Konica, Faik, Vepra 1, Rilindja, Prishtinë, 1995.
Konica, Faik, Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1995.
Konica, Faik, Vepra 1, Dudaj, Tiranë, 2001.
Konica, Faik, Vepra 2, Dudaj, Tiranë, 2001.
Konica, Faik, Vepra 3, Dudaj, Tiranë, 2001.
Konica, Faik, Vepra 4, Dudaj, Tiranë, 2001.
Konica, Faik, Vepra 5, Dudaj, Tiranë, 2001.
Albania 1, "Vjersha, folklor….", Faik Konica, Prishtinë, 2013.
Albania 2, "Propagandë kombtare...", Faik Konica, Prishtinë, 2013.
Albania 3, "Të ndryshme, politikë, polemikë", Faik Konica, Prishtinë, 2013.
Hamiti, Sabri, "Faik Konica: Jam unë", Rilindja, Prishtinë, 1991.
Ikonomi, Ilir, "Faik Konica – Jeta në Uashington", Onufri, Tiranë, 2011.
Instituti Albanologjik i Prishtinës, "Faik Konica – Jeta dhe vepra", Prishtinë, 1997.
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, "Konferencë shkencore për Faik Konicën", Prishtinë, 2006.

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

# ASPEKTE POLITIKE E SOCIALE TË SHQIPËRISË NË VITET 1970-1973 NË FOKUS TË SHTYPIT BOTËROR

**Dr. Ilir Sallata**

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Fakulteti i Edukimit Durrës, Albania

**Dr. Menada Petro**

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Fakulteti i Edukimit Durrës, Albania

**Abstrakt**

Ky punim paraqet një tablo të situatës politike dhe sociale të Shqipërisë në vitet 1970-1973, parë nga këndvështrimi i shtypit të huaj. Gazetat dhe shkrimet nga agjencitë e lajmeve të huaja, pasi përktheheshin nga Agjencia Telegrafike Shqiptare, i servireshin vetëm kupolës së lartë partiake shqiptare. Duhet nënvizuar fakti që një pjesë e shtypit botëror që i ofrohej kësaj kupole kishte një orientim të majtë, duke dalluar qartë tendencat propagandistike. Qëllimi i këtij punimi është që të paraqesë situatën politike dhe sociale në Shqipëri nën optikën e shtypit të huaj; nismat revolucionare dhe ideologjizimin e skajshem të jetës së vendit; tiparet politike dhe natyrën e udhëheqjes partiake; mënyrën e jetesës së qytetarëve shqiptarë që jetonin të izoluar nga perëndimi dhe lindja, duke pasur vetëm një dritare të hapur me Kinën e largët. Gjatë punës hulumtuese, në mënyrë të përgjithshme është aplikuar metoda cilësore duke realizuar një hulumtim: grumbullues, përshkrues dhe vlerësues, duke u bazuar më së shumti në paraqitjen dhe analizën e shkrimeve të shtypit të huaj dhe të fakteve historike. Në të shumtën e rasteve këto tipare të jetës politike dhe sociale të vendit tonë, vërehenin me habi nga gazetarët e huaj por dhe nga lexuesit e interesuar. Shteti ateist shqiptar, për të huajt do të përbënte një rast unikal, duke evidentuar shtypjen dhe goditjen që mori kleri dhe institucionet fetare.Ata krijonin idenë se në Shqipëri zbatoheshin me rigorozitet normat marksiste-leniniste, duke synuar krijimin e "njeriut të ri socialit" i cili do të jetonte në mes të një bote të zhvilluar dhe me përplasje ideologjike lindje-perëndim.

***Fjalë kyçe**: shtypi botëror, tipare politike e sociale, ideologjia komuniste, propaganda.*

Sistemi komunist në Shqipëri përkon me vitet 1944-1990. Për gjysmë shekulli vendi ynë jetoi nën një rend totalitar nga më të egrit në Evropë.

Me të gjitha aspektet e veta, ky sistem la gjurmë të pashlyeshme në popull, gjurmë që do të jehojnë gjatë në histori. Megjithëse anëtare e kampit socialist, Shqipëria kishte mjaft karakteristika të veçanta që ja vlejnë për tu studiuar.

Partia Komuniste Shqiptare me fitoren e vitit 1944, e deri në vitin 1948 u orientua tërësisht drejt Jugosllavisë. Shkëputet nga politika dashakeqe e shoviniste e saj, për tu lidhur ngushtësisht me Bashkimin Sovjetik. Për të mbajtur të pastër vijën marksiste-leniniste, PPSH dënoi hapur revizionistët Hrushovianë, dhe prishi marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik në nëntor të vitit 1961.

Nevoja për ndihmë ekonomike dhe mbështetje në fushën e politikës së jashtme, e detyroi Tiranën zyrtare të orjentohej drejt Kinës së largët. Mirpo edhe me këtë partnere të tretë përplasjet ideologjike, si dhe më parë, çuan në prishjen e marrëdhënieve Shqiptaro-Kineze në korrik të vitit 1978. Prej kësaj kohe Shqipëria shkoi drejt vetëizolimit të plotë. Ndërkohë udhëheqja e lartë partiake e shtetërore mburrej e trumbetonte me të madhe se RPSSH e ndërtonte socializmin plotësisht me forcat e veta.

Fillimi i viteve '70 përshkohet nga ide e nisma euforike revolucionare.
Në çdo fushë të jetës mbizotëronte fjala "revolucionare". Ekonomia, kultura, politika e ideologjia thuhet se marin një "hov të ri e të pa parë". Shqipëria gjoja shquhej si vatër e rëndësishme e lëvizjes revolucionare. Revolucioni Kulturor Kinez pati ndikimet e veta dhe në Shqipëri, duke gjymtuar shumë elementë të traditës së popullit. U godit inteligjenca, u thellua militarizimi në lëmin e arsimit e të kulturës, frontalisht u forcua lufta kundër ndikimeve e shfaqeve të huaja, e qendrimeve liberale ndaj tyre. Ritmet e zhvillimit të forcave prodhuese filluan të pakësohen. Perspektiva pas çarjeve të para në planin ideologjik me RPK, sa vinte po zbehej. Marrëdhëniet politike, ekonomike, ushtarake e kulturore midis dy vendeve filluan te ngushtohen.

**"Ideologjia revolucionare"**

*"Viti 1970 duhet të jetë viti i një sulmi revolucionar të pa parë deri më sot*
*në të gjitha drejtimet…"*
*Enver Hoxha, Plenumi i KQ të PPSH, 1969*

1967. Revolucioni kulturor kinez përshkoi të gjitha hallkat e shoqërisë shqiptare. Nga Kina u importuan modele të gatshme që do të ishin pararojë e saj. Vendi yne u shpall shteti i parë ateist në botë. U mbyllën kisha, xhami e teqe. Një pjesë e klerikëve u internuan, një pjesë u integrua në kooperativa bujqësore, ferma, ndërtim etj. Megjithëse Shqiperia është një vend me besim jo te fortë fetar, dënimi brutal i saj shkaktoi përshtjellim te besimtarët.
Në fillim te viteve '70 situata e brendshme, politike, sociale e ideologjike motivohet me të ashtuquajturin "vrull revolucionar".

"*Midis regjimeve imperialiste e revizioniste, të Evropës Lindore e Perëndimore qëndron Shqipëria socialiste, mike e fuqishme e Kinës*", shkruante gazeta amerikane "Protector of workers". "*I çelnikosur në zjarrin e luftrave të panumërta populli shqiptar, nën udhëheqjen e PPSH dhe timonierit të saj Enver Hoxha, ka fituar shumë beteja të lavdishme në luftën për të arritur çlirimin kombëtar dhe për të ndërtuar një vend të fuqishëm socialist. Enver Hoxhës dhe PPSH-së, i takon lavdia e përjetëshme që trashëguan dhe mbrojtën marksizëm-leninizmin, luftuan me vendosmëri kundër të gjitha formave të oportunizmit, e qëndruan me besnikeri në anën e Kinës, kundër imperializmit të SHBA dhe revizionizmit Sovjetik", perfundon kjo gazetë.*[133]
Pra, nga ky shkrim propagandistik, kuptohet mbështetja qe i behët sistemit dhe del qarte se Shqipëria është i vetmi vend ku zbatohen rigorozisht idetë e socializmit. Bien në sy lavdet dhe elozhet që i thuren Enver Hoxhës, duke mbështetur hapur dhe vendosmërinë e tij në mbrojtjen me fanatizëm të marksizëm-leninizmit dhe luftën kundër dy superfuqive, imperializmit amerikan dhe social-imperializmit sovjetik.

[133] Gazeta "Protector of Workers", New York, 26.5.1970

Nën slloganin e "*revolocionarizimit të çdo fushe të jetës*" nisi dhe fushata elektorale për zgjedhjet e përfaqësuesve në Kuvendin Popullor dhe në pushtetin lokal.
Duke iu referuar këtyre zgjedhjeve, në mënyrë joanalitike "Royter Agency" njofton për një pjesëmarrje pothuajse të plotë, nga ana e atyre që kane të drejtën e votimit midis dy milionë banorëve dhe çdo person mbi 18 vjeç ka të drejtë të zgjedhë ose të zgjidhet, n.q.s. është propozuar zyrtarisht. Fushata elektorale u karakterizua nga një numër i shumtë takimesh të udhëheqjes shtetërore me popullin. Kjo shërbeu për të përgatitur opinionin publik për ndryshimet e ardhshme dhe për të shfrytëzuar energjitë e masave për programin e ri të decentralizimit. Marrëdhëniet me Kinën gjatë pesëvjeçarit 1971-1975, do të jenë akoma më frytdhënëse, propagandohet në popull. Fushata elektorale vuri në pah nevojën për emancipimin e gruas, për goditjen e zakoneve prapanike që karakterizojnë akoma martesën dhe familjen. Populli është pregatitur për një hov përpara, nënvizon kjo agjenci, dhe se ekonomia duhet të lulëzojë nën drejtimin e PPSH-së. [134]

Sipas "Tanjug Agency" zgjedhjet u zhvilluan nën parrullën *"Askush nuk ka tapi tokash, siç nuk duhet të ketë as tapi për postin"*. Rreth 50% e përbërjes së deputetëve ua lëshojnë vendin në parlament, njerëzve që dalin kryesisht nga fabrikat e kooperativat bujqësore.
Një propagande e fuqishme në këtë rast zhvillohet kundër burokratizimit. Në organet shtetërore, ekonomike, politike e kulturore lufta kundër burokratizimit ka marë një hov të madh. Nga direktivat e udhëheqjes së lartë shtetërore, synohet ç'rrënjosja e tij. Pas zgjedhjeve synohen të arrihen gjithashtu: Rritja e normave të punës; goditja ndaj centralizimit të tepruar; shtimi i punës fizike në të mirë të masave, etj. Përveç 264 deputetëve janë zgjedhur rreth 35 mijë anëtarë të këshillave popullorë, gjykatave dhe ndihmës gjyqtarë. [135] Sipas gazetës austriake **"Die Presse"** në zgjedhjet parlamentare kandidatët e vetëm të Frontit Demokratik që drejtohen nga PPSH siguruan rreth 99,99% të votave. [136] Siç shihet, aludimi duket qartë, këtu skemi të bëjmë me zgjedhje pluraliste, por të një partie të vetme, PPSH, për rrjedhojë ajo do të fitonte "unanimisht" në popull.

Në sesionin e parë të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, Sekretari i Parë i KQ të PPSH-së, Enver Hoxha, propozoi që kryetarit të qeverisë, Mehmet Shehu, përsëri t'i besohej mandati për formimin e qeverisë së re. Si kryetar i Kuvendit Popullor u zgjodh Fadil Paçrami, në vend të Behar Shtyllës. Në krye të Presidiumit të Kuvendit Popullor u rizgjodh Haxhi Lleshi, përfundon "Tanjug Agency".[137]

**"Interesi i përgjithshëm, mbi interesin vetiak" Por si jetonin shqiptarët?!...**

"Eksplozioni demografik në Shqipëri" emërtohet artikulli i gazetës polake "Dziennik Ludowy" që flet për popullsinë e vendit tonë. Shqipëria ze vendin e parë në botë për sa i përket kohës së rritjes së popullsisë, e cila aktualisht ka kaluar dy herë numrin e paraluftës. Në qoftë se para çlirimit numri i popullsisë ishte 1.040.355 banorë, në fillim të viteve '70 ai kapi shifrën 2.108.000 banorë. Shkaqet e këtij fenomeni janë:
- Ulja e vdekshmërisë së fëmijëve.
- Zgjatja e jetës mesatare deri në 68 vjeç, që para luftës ka qenë 38 vjeç.
- Transformimet shoqërore, ku popullsia furnizohet me ushqim dhe përfiton një shërbim më të mirë shëndetësor.[138]

Ndërsa gazeta hungareze "Fejer Megyei Hirlap" në mars të vitit 1972 vinte ne dukje se në krahasim me paraluftën niveli ekonomik i popullsisë ka bërë hapa përpara. Vëmendje e veçantë i

[134] "Royter Agency", Lajme mbi Shqipërinë, 21.9.1970
[135] "Tanjug Agency", Lajme mbi Shqipërinë, 24.9.1970
[136] Gazeta "Die Presse", Vjenë 22.9.1970, "Mbi zgjedhjet në Shqipëri"
[137] "Tanjug Agency", Lajme mbi Shqipërinë, 21.11.1970
[138] Gazeta "Dziennik Ludowy" Varshavë, 11.12.1970, "Eksplozioni demografik në Shqipëri"

është kushtuar zonave rurale. Në fillim vitet '70 fshatrat më të humbura kanë sherbimet sociale bazë: arsim e mjekim falas. Shqipëria është një nga vendet e rralla të botës ku një ngritje e rregullt e pagave është e shoqëruar, brenda 25 viteve, nga ulja e vazhdueshme e çmimeve. Me shtimin e shërbimeve shoqërore falas ose me çmime të ulta: farmaci, transporte e banesa është rritur niveli i jetesës së popullsisë në përpjestime të konsiderueshme. Qeveria shqiptare ka hequr dhe taksat e drejtpërdrejta, çka e bën Shqipërinë të vetmin vend në botë ku qytetarët e saj nuk paguajnë asnjë taksë direkte. Në fshatrat më të humbura, është arritur të instalohet drita elektrike. 25 tetori i vitit 1970, shënon datën e përfundimit të elektrifikimit të plotë të vendit. Shqipëria është i pari shtet në Ballkan që e përfundon një gjë të tillë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se të gjitha fshatrat dhe qytetet janë të lidhura me sistemin unik qendror. Kjo sepse pjesët malore të vendit paraqesin shumë vështirësi për ngritjen e shtyllave të tensionit të lartë. Janë ndërtuar 37 hidrocentrale të vegjël e të mëdhenj si dhe 14 centrale me motorë diezel. Në Shqipëri ka gjithsej 2.546 fshatra, ku 60% e tyre lidhen me sistemin energjitik, 30% me hidrocentrale lokale, e 10% me motorë diezel. Ndihmesë të madhe për këto punime ka dhënë Kina, me kredi në valutë të konvertueshme, që shërben për blerjen e pjesëve të nevojshme të hidrocentraleve, nga vendet perëndimore.[139]

"Institute of International Studies" në Zvicër, në një studim për arsimin në Shqipëri shkruan se, ai ka të veçantat e veta. Arsimi përshkohet nga trekëndëshi revolucionar: mësim-punë-kalitje. Për fëmijët nga 8 deri 14 vjeç shkolla është e detyruar, nga 14-18 vjeç 50% e nxënësve ndjekin shkollën e mesme të përgjithshme, ndërsa 15% ndjekin shkollat profesionale dhe bëhen punonjës të kualifikuar. Pjesa tjetër fillojnë të mësojnë zanate. Shqipëria ka, në mënyrë proporcionale, më tepër universitarë se p.sh. Greqia apo Spanja. Universiteti i Tiranës ushtron të gjitha disiplinat e zakonshme. Të rinjtë hyjnë aty pasi të kenë bërë një vit punë në prodhim. Bazë e të gjitha strukturave arsimore është ideologjia marksiste-leniniste*"*.[140]

"Emancipimi i gruas shkon me ritme të shpejta. Gratë përbëjnë më shumë se 40% të popullsisë aktive në prodhim. Ky përpjestim është në kuadrot e mesme dhe më pak në kuadrot e lartë".[141] "Popullsia mbrohet nga çdo ndikim e ideologji e huaj. Regjimi në fuqi, mendon se edhe për dy breza çdo shqiptar do të jetë një njeri i ri dhe shoqëria plotësisht e solidarizuar".[142] "Mirëpo ky system ka dhe anën tjetër të monedhës. Mijëra të rinjë e të reja në kuadrin e batalioneve të rinisë, punojnë në kushte kaq të rënda sa s'mund të besohet, duke ndërtuar rrugë e hekurudha".[143]

Lidhur me organizimin e punës, gazeta "Magjunardana Politika" e Beogradit shprehet se për shpejtimin e ndërtimit të disa objekteve, nëpër rrethe e kooperativa bujqësore janë organizuar aksione masive politike, ekonomike me titullin "Aksione të punës sulmuese me goditje të përqëndruar". Ato kanë për qëllim që në një periudhë të shkurtër të përfundojnë objekte të rëndeshishme për një zonë të caktuar, si dhe për revolucionarizimin e mëtejshëm të masave, që ishte bërë tashmë një shprehje e zakonshme.[144]

Sipas gazetës "Arbeiter Zeitung", organ i Partisë Socialiste Austriake, "stimuli financiar është inegzistent dhe e vetmja kënaqësi është shpërblimi me fletë lavdërimi ose medalje. E gjithë dita e punës, aksionet vullnetare i lenë fare pak kohë pamjes së jashtme. Në përgjithësi shqiptarët

---

[139] Gazeta "Fejer Megyei Hirlap", Butapest, 10.3.1972, "Hapi i madh Shqiptar"
[140] "Newsletter of the Institute of International Studies", Zvicër, 7.1.1973
[141] Revista "Africazia", Paris, 24.8.1970, "Përvoja Shqiptare"
[142] Gazeta "Zhurnal de Geneve", Zyrih, 11.8.1970, "Shqipëria Evropiane"
[143] Gazeta "*Daily News"*, Ankara, 2.9.1970, "Aleatja e Kinës po ndjen ndryshime"
[144] Gazeta "Magjunardana Politika", Beograd, 1.2.1971

vishen thjeshtë. Duan dhe i pëlqejnë gjërat e bukura, fustanet me ngjyra, këmishat me modele të ndryshme, por nuk kanë ku ti gjejnë. Pothuajse të gjithë janë të veshur njësoj”.[145]

“*Nga politika shtetërore synohet uniformizmi i masave*”, nënvizon gazeta polake “Politika” në tetor të vitit 1970. Sipas saj një copë basme që shitet në dyqanet e metrazhit mund ta shikoje: perde nëpër dritare, mbulesë për tryezën e deri tek fustane për gratë. Revolucionarizimi i jetës hoqi shumë zbukurime te femrat. Syzet e diellit, çanta e varur në krah u quajtën ndikime të huaja, ndaj duhej të hiqeshin. Gratë në shumë aspekte u afruan me burrat. Ato i shihje në bujqësi, blektori, ndërtim. Vajzat e reja me pushkën në krah dhe uniformën ushtarake marshonin nëpër paradat e ushtrisë. Me goditjen e pronës private, çdo gjë ishte pronë e masave. Pasja e makinës personale, konsiderohet krim ndaj atdheut. Në rrugë shumë rrallë të ze syri autovetura, me përjashtim të atyre që u përkasin zyrtarëve të lartë. Qarkullojnë vetëm autobuza e biçikleta kineze. Goditet dembelizmi, në rrugë nuk ka lypsa, pasi secili punon sa për të jetuar e për t’u veshur me të njejtën uniformë. Ajo që të bie në sy, në kryeqytetin e banuar prej 160 mijë banorë është një përzierje e shekullit XVI dhe XX. Në prani të uzinave moderne, tekstile e mekanike, të ndërtuara me ndihmat kineze, dallohen karrocat që tërhiqen nga qetë, ndërsa kasollet e vjetra qëndrojnë pranë ndërtesave moderne. Shqiptarët bëjnë një jetë të thjeshtë e me pretendime jo të mëdha. Në qyetet e vogla dhe në fshatra, familjet banojnë në ambjente aspak të bollshme. Megjithëse ndërtohet një numër i konsiderueshëm apartamentesh, shumica e tyre kanë hapsira të vogla, ku njerëzit organizojnë jetesën në mënyrë fare modeste.[146]

“*Shqipëria është vendi i të pamundurës. Nuk mund të krahasohet me asnjë vend tjetër, pasi gjithçka është e ndryshme. Përpjekjet vigane për të kapërcyer hendekun, që i ndan me të tjerët, u lejon pa dyshim shqiptarëve të jenë më të lumtur se në të kaluarën, sepse tani hanë sa ngopen dhe flenë në një strehë. Megjithëse për botën kjo gjë është nga më elementaret…*”- shkruan gazeta franceze “L’Humanite”.[147]

Pa dyshim në fillim të viteve ’70 disa ndryshime qenë arritur. Por sa vlenin keto ndryshime krahasuar me vendet Perëndimore? Ç’të mira i sillte vendit politika ngulmuese për të krijuar njeriun e ri? Ngjarjet në vijim do të tregojnë që shumë elementë e direktiva politike të kohës do të ishin të gabuara dhe do ta çonin vendin drej rrënimit. Fakti që Kina kishte një peshë të madhe në fillim të viteve ‘70 e më pak në vijim, do të tregonte që prishja me të, do të ishte me pasoja të rënda për Shqipërinë. Situata e brendshme në rrethanat e izolimit ekstrem me botën, u përkeqësua dukshëm. Vendi agravoi drejt amullisë ekonomike e varfërisë. Për këtë, pa dyshim, ndikoi dhe mungesa e tolerancës në fushën sociale, pasi lufta e klasave deri në fund vazhdoi e ashpër. Rrjedhimisht, sistemi që po gërryhej nga brenda, s’kishte rrugë tjetër veçse fundin. Revolta e heshtur popullore po rritej. Regjimi shihej me urrejtje dhe i paaftë për të përmirësuar gjendjen në vend.

**Kongresi VI i Partisë së Punës së Shqipërisë, 1-7 nëntor 1971**

Për këtë Kongres shkruan gazeta franceze “Le Monde”. Më 1 nëntor 1971 filloi punimet organi më i lartë partiak, Kongresi VI i PPSH, të cilin e hapi antari i Byrosë Politike dhe Sekretari i Komitetit Qendror Hysni Kapo. Referatin mbi punën e KQ të PPSH e mbajti Enver Hoxha. Në të paraqitej një vazhdimësi e vijave të përgjithshme në politikën e brendshme dhe të jashtme. Si gjithnjë goditen ashpër shtetet kapitaliste e revizioniste, duke mbështetur fuqimisht RP të Kinës. Ka përpjekje për përmirësimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë e vendet e tjera ballkanike. Mbështetje i jepet dhe vendeve ku ka regjime të ngjashme, ose atyre shteteve me të cilat mbahen marëdhënie diplomatike në nivel ambasadash. Gjithashtu i jepet kurajo partive komuniste të botës për një lëvizje dhe ndryshim të situatës në vendet e tyre, për të ndërtuar dhe

[145] Gazeta “Arbeiter Zeitung”, Vjenë, 19.9.1971
[146] Gazeta “Politika”, Varshavë, 31.10.1970, “Flirt jo guximtar” nga Maria Turski
[147] Gazeta “L’Humanite”, Paris, 24.5.1972, “Një maji në Shqipëri” nga Andre Dryesne

ata sistemin socialist. Përsa i perket politikës së brendshme synohet thellimi i mëtejshëm i revolucionarizimit të masave.

Lufta kundër burokratizimit, zakoneve prapanike dhe të ashtuquajturave mbeturina fetare vihenin në themel të politikave në vijim. Ashpërsimi i luftës së klasave dhe asgjesimi i çdo kundërshtari, të brendshëm e të jashtëm shihenin si të vetmet mjete, për të lulëzuar socializmi në Shqipëri.[148]

Ky Kongres rikonfirmoi zbatimin e përpiktë të ideologjisë marksiste-leniniste dhe të internacionalizmit proletar. Rruga kryesore drejt socializmit vazhdonte me të njëjtën kembengulje dhe naivitet, pa marrë parasysh rrugët dytësore e kthesat që mund të haseshin përpara drejt ecjes.

**"Feja opium për popullin" Shqipëria i pari shtet ateist në botë…**

Një nga elementët që solli shembëlltyra e Revolucionit Kulturor Kinez në Shqipëri ishte ndalimi me ligj i funksionimit të institucioneve fetare. Në vazhdimësi të goditjes së fesë, pika kulmore arriti me letrën e hapur të KQ të PPSH-së, drejtuar popullit shqiptar, duke e konsideruar fenë si ideologji reaksionare, si "opium për popullin". Në të gjithë vendin u mbyllën e u shkatërruan, u kthyen në muze e qendra kulturore gjithsej 2168 kisha, xhami e institucione të tjera fetare. Një pjesë e klerikëve u përfshinë në proçesin e punës prodhuese. Megjithatë feja vetë nuk ishte e mundur të zhdukej, me një dispozitë të partisë, kisha tashmë ishte shtyrë në një egzistensë katakombe.

Sipas gazatës austriake "Volgs Zeitung" njoftime të pakta tronditëse mbi besimet fetare në Shqipëri, në botën e jashtme, i japin të arratisurit. Shumë priftërinjë, madje të rangjeve të larta, ishin kthyer në punëtorë krahu. Priftërinjtë të cilët nuk ishin në gjendje të punonin për shkak të moshës, iu ofrua të bënin ndonjë punë tjetër të rëndomtë.[149]

Në këto vite ndodh një ngjarje që bëri jehonë në shtypin e huaj.

"*Ekzekutohet një prift shqiptar pasi ka pagëzuar një foshnje duke injoruar legjislacionin e ashpër të Shqipërisë mbi ateizmin*", shkruan gazeta greke "Eleftheros Kozmos" më 29 mars 1973. Në të thuhej se prifti Shtjefën Kurti, u dënua me vdekje, me pushkatim, sepse kishte pagëzuar foshnjen fshehtas në qytetin e Lushnjes.[150]

Ndërsa gazeta belge "La Libre Belgique" më 28 mars 1973, shton se prifti ishte internuar në kampin e punës në Lushnje, bashkë me prifterinjtë e tjerë që vuanin dënimin. Ai iu bind kërkesës që bëri nëna e fëmijes për pagëzimin e të birit. Megjithëse ceremonia u zhvillua në fshehtësi të madhe, ajo u diktua dhe u sinjalizuan autoritetet përkatëse.[151]

Për ekzekutimin e priftit katolik reagoi dhe shtypi Italian. Sipas gazates "Il Corriere Della Sera", theksohet se pushkatimi i këtij prifti tregon se totalitarizmi i Enver Hoxhës në Shqipëri mund të arrijë në përbindësh çka tregonte se në diktaturën e egër fshiheshin dobësitë ekstremiste, për të qendruar në pushtet.

Gjithnjë sipas këtij organi, shtypi zyrtar në Shqipëri, sajon se Shtjefën Kurti paska bërë pjesë në një nga "bandat e financuara nga Vatikani" kundër regjimit komunist në Shqipëri. Megjithatë nuk përcaktohet natyra e fajeve për të cilat prifti ka qenë përgjegjës.[152]

Ndërkaq Papa Pavli VI, më 2 prill 1973 sulmoi ashpër qeveritë komuniste, përfshirë këtu edhe atë të Shqipërisë. Ai dënoi goditjen që i është bërë fesë në vendin tonë.[153] Ky fakt erdhi pasi vrasja e priftit mori përmasa të mëdha në shtypin e kohës.

[148] Gazeta "Le Monde", Paris, 3.11.1971, "Kongresi VI i PPSH"
[149] Gazeta "Volgs Zeitung", Vienë, 20.1.1973, "Persekutimi i krishterëve 1973"
[150] Gazeta "Eleftheros Kozmos", Athinë, 29.3.1973, "Ekzekutimi i priftit shqiptar"
[151] Gazeta "La Libre Belgique", Bruksel, 28.3.1973
[152] Gazeta "Il Corriere della Sera", Romë, 30.3.1973, "Pushkatohet një prift"
[153] Gazeta "Il Corriere della Sera", Romë, 3.4.1973

Për vrasjen e priftit reagoi dhe një vend i largët si Kili në gazetën “El Merkurio”. Ajo nga një këndvështrim tjetër nënvizon se, Vatikani nuk u përgjigjet sulmeve të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, që thotë se prifti Shtjefën Kurti u pushkatua sepse ishte spiun i Vatikanit. Këtu theksohet vetëm se qeveria shqiptare nuk ka justifikime për vdekjen e 450 priftërinjve katolikë që jetonin në Shqipëri pas çlirimit. Prej vitesh, Vatikani dhe bota mbarë nuk dinë asgjë për fatin e komunitetit katolik shqiptar dhe të shërbyesëve shpirtërorë. [154]

Parë nga kjo ngjarje, opinioni publik i jashtëm ka lajme e burime përgjegjëse sipas të cilave liria e besimit sulmohej rëndë në Shqipëri. Eleminimi i institusioneve fetare, nuk mund të shërbente si mjet për formimin e “njeriut të ri”. Kështu, ai privohej nga liritë dhe të drejtat e tij, bëhej më i ngushtë nga ana shpirtërore e ndrydheshin ndjenjat e natyrshme njerëzore.

### *Bibliografia*

Gazeta “Protector of Workers”, New York, 26.5.1970
Revista “Africazia”, Paris, 24.8.1970
Gazeta “Zhurnal de Geneve”, Zyrih, 11.8.1970
Gazeta “Daily News”, Ankara, 2.9.1970
“Royter Agency”, Lajme mbi Shqipërinë, 21.9.1970
Gazeta “Die Presse”, Vjene 22.9.1970
“Tanjug Agency”, Lajme mbi Shqipërinë, 24.9.1970
Gazeta “Politika”, Varshavë, 31.10.1970
Tanjug Agency, Lajme mbi Shqipërinë, 21.11.1970
Gazeta “Dziennik Ludowy” Varshavë, 11.12.1970
Gazeta “Magjunardana Politika”, Beograd, 1.2.1971
Gazeta “Arbeiter Zeitung”, Vjenë, 19.9.1971
Gazeta “Le Monde”, Paris, 3.11.1971
Gazeta “Fejer Megyei Hirlap”, Butapest, 10.3.1972
Gazeta “L’Humanite”, Paris, 24.5.1972
“Newsletter of the Institute of International Studies”, Zvicër, 7.1.1973
Gazeta “Volgs Zeitung”, Vienë, 20.1.1973
Gazeta “La Libre Belgique”, Bruksel, 28.3.1973
Gazeta “Eleftheros Kozmos”, Athinë, 29.3.1973
Gazeta “Il Corriere della Sera”, Romë, 30.3.1973
Gazeta “Il Corriere della Sera”, Romë, 3.4.1973
Gazeta “El Merkurio”, Santiago, 2.5.1973

[154] Gazeta “El Merkurio”, Santiago, 2.5.1973, “Ekzekutohet prifti katolik”

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

# MITI DHE ANTIMITI TE FAN NOLI-MITI,LEGJENDA,RRËFIMI

**Saranda Buzhala**
Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"

*"Gjithë letërsia botërore vjen nga miti dhe rikthehet te miti"* [155], thotë Viola Isufaj në librin e saj mbi mitin kadarean. Sot, jo kot thuhet që miti është vetë letërsia, duke pasur parasysh që ndikimi i mitit në krijimet letrare, në shtrirje dhe kohë të ndryshme, ka qenë i madh. Kësisoj, mitologjia, përveçse ka qenë një faktor që ka ushtruar, ajo po ashtu vazhdon të ushtrojë një ndikim të madh mbi kulturën dhe jetën ideologjike të çdo shoqërie.

Kur flasim pwr fillimet e krijimtarisë letrare, mund tw pohojmw qw ato janw orale dhe etno-fetare. E, njwkohesisht, duhet pasur parasysh qw ato kanw filluar si këngë, si

[155] V. Isufaj, *Rikthimi i mitit në veprën e Kadaresë,* f. 31.

tregime të shkurtra që në historinë e letërsisë zënë vendin e gjenezës. Ndwrkaq, miti është parë si paraardhës i mitit letrar.

I studiuar nga dijetarw tw fushave tw ndryshme, miti wshtw bwrw object trajtesash, duke u dhwnw pwrkufizime tw shumta pwr tw. Fjala mit vjen wshtw me etimologji greke, "mythos", që ka kuptimin e diskursit, historisw, rrëfimit tradicional, besimit, etj. Duhet ta kemi parasysh që po flasim jo vetëm për mitin si kuptim i parë i ekzistencës dhe fjalës, por edhe për mitin letrar, përmes të cilave përdorime edhe ia ka dalë të mbijetojë.

Sepse rrëfimet mitologjike s'mund të kenë lindur pa disa premisa materiale e shpirtërore zhvillimi, prandaj mendohet të kenë qenë të paraprira nga një kohë paramitologjike, e cila kohë, siç e ka vërtetuar shkenca, i përket periudhës së paleolitit.

Pa syshim qw ka pasur dallime dhe qwndrime tw ndryshme, rreth kwsaj çwshtjeje. Sofistët e kanë interpretuar mitin si alegori, ndërsa Platoni kishte një qasje filozofike dhe simbolike për mitologjinë popullore. Aristoteli, veçanërisht në Poetikën e tij, e shihte mitin si fabul.

Më vonë, interpretimet alegorike të mitit dolën në krye. Stoikët shihnin tek hyjnitë greke personifikimin e ceremonive kushtuar zotave, edhe Epikurianët mendonin se mitet, të cilat ata i shihnin si bazë e 'fakteve' natyrore, kanë qenë përdorur nga klasat sunduese dhe e priftërinjve për vetë fundin e tyre. Neo-Platonistët e vlerësonin mitin me termat e kategorive logjike. Euhemerus argumentonte se protagonistët mitikë nuk ishin asgjë më shumë se personazhe historike të cilët u mveshën me një aureolë hyjnore. [156]

Përgjatë Rilindjes, interesi mbi mitologjinë dhe antikitetin doli dhe një herë në qendër. Miti u pa pozitivisht si një seri alegorish të lyera me një lustër moralizuese; si manifestim i ndjenjave dhe pasioneve që shoqëronin emancipimin njerëzor; apo si shprehje e alegorisë religjoze, filozofoke dhe të vërtetës

Filozofia e Romantizmit mbi mitin, e trajton atw thelbësisht si fenomen estetik, në kundërshtim me pikëpamjet e mëparshme. Ndwrkaq, gjysma e dytë e shekullit të nëntëmbëdhjetë vjen me dy shkolla të kundërta të intepretimit të mitit. [157]

---

[156] Meletinsky, E. The Poetics of Myth, Routledge, New York, 2000, f. 1-2.
[157] Meletinsky, E. The Poetics of Myth, Routledge, New York, 2000, f.13.

Si fillim, propozoj ta definoj mitin si rrëfim. Sepse ai, çfarëdo tjetër që të jetë, është një rrëfim që mund të duket i vetëkuptueshëm. Para së gjithash, kur na kërkohet ta emërojmë mitin, shumica prej nesh së pari mendojnë për rrëfimet për zotat dhe heronjtë grekë dhe romakë. Megjithatë, miti gjithashtu mund të merret më gjerësisht si një besim apo kredo[158]. Pra, sipas Rober A.Segal, sa i përket përmbajtjes së këtyre rrëfimeve, thotë që ato mund të jenë nga fusha të ndryshme, nga folkloristika, religjioni, etj. Dhe, përfundimisht pajtohet që mitin ta konkretizojë si një rrëfim për diçka të rëndësishme, rrëfim ky që mund të bëhet në një kohë të kryer (Eliade), apo në një të tashme e të ardhme,(Bronislaë Malinoëski).

Mircea Eliade në veprën "Aspekte të mitit", propozon këtë përkufizim të mitit, të cilin e konsideron si më pak të papërkryerin për shkak se është përkufizimi më i gjerë. "Miti rrëfen një histori të shenjtë; ai tregon një ngjarje e cila ka ndodhur në kohët primordiale, në kohët e zanafillës përrallore"[159], duke vazhduar se "Mitet nuk tregojnë vetëm origjinën e botës, të kafshëve, të bimëve, të njeriut, por edhe të të gjitha ngjarjeve primordiale në saje të të cilave njeriu është bërë ai që është sot, ia vlen të thuhet një qenie e vdekshme, seksuale, e organizuar në shoqëri."[160]

Për M. Eliade dhe C. Levi-Straus çshenjtërimi i mitit, kalimi nga ai etno-religjioz në atë letrar, sjell një degradim dhe degjenerim të tregimit mitik, të organizimit strukturor të tij. Për këta studiues, lidhjet mes dy formave shprehëse (mitit dhe letërsisë) janë opozicionale.

Ndërsa Pierre Brunel ka një tjetër mendim për këtë çështje. Sipas tij, letërsia dhe arti luajnë një rol të rëndësishëm në konservimin e miteve. Përmes kodit letrar mitet mund të mbijetojnë, duke fituar kuptime dhe modifikime përgjatë kohëve. Në këtë kuptim Jean Rousset do të propozonte si shembull figurën e Don Zhuanit. [161]

Ndwrkaq, Roland Barthes te "Miti Sot" bwn njw pwrvijim tw gjerw tw mitit, duke e elaboruar atw si njw thwnie, si rrwfim, si sistem semiologjik, si ligjwrim i vjedhur, etj. Me çka pwrfundohet se gjithçka mund tw jetw mit, pasi t'I ketw plotwsuar disa prej kushteve tw kwrkuara. "Duhen kushte tw veçanta qw ligjwrimi tw shndwrrohet nw mit", pohon Barthes te

[158] Rober A Segal," Myth, very short introduction", Oxford University Press Inc., New York, 2004 fq. 4.
[159] Mircea Eliade, Aspects dy mythe, Editions Gallimard, 1963, fq. 18.
[160] Mircea Eliade, Aspects dy mythe, Editions Gallimard, 1963, fq. 18
[161] Pierre Brunel, Mythocritique, Presses Universitaires de France, Paris, 1992, fq.38.

“Mitologjitw”[162], duke vazhudar se miti nuk mund tw jetw object, concept ose ide: ai wshtw njw mwnyrw shenjimi, eshte njw formw.

1.2. Betoveni dhe faktet

Libri "Betoveni e Revolucioni francez" nis me ndarjen e parë, që përfshin Introduktën dhe hapet me titullin "Cështja". Siç vepron rëndom, Fan Noli do të nisë me njjoftimin e asaj për të cilën do të flitet, me lëndën dhe vështirësitë e punës së vënë përballë.

"Kur plasi Revolucioni francez më 1789, Betoveni ishte gjashtëmbëdhjetëvjeçar, tridhjetekatër kur u bë Napoleoni perandor I Francës më 1804 dhe dyzetë e pesë kur epoka e Meternikut u inaugurua me Kongresin e Vjenës më 1815. Vjetët eparë të rinisë I kaloi në Bon, krahina Rhinit, ku edhe lindi më 1770; pjesën tjetër të jetës në Vjenëm ku komponoi dhe vdiq më 1827."[163]

Kështu bëhet hyrja në historinë e personazhit qendror të librit të tij, Betoveni, dukë kaluar më pas të detaje të tjera rreth Revolucionit francez si dominantë e kohës. Revolucioni preku të gjitha fushat e jetës, sociale, politike, ekonomike, kulturore, etj., duke dominuar për më tepër se një shekull Evropën. E, megjithatë, pa u prekur nuk mbeti as muzika dhe vetë figura e Betovenit, shkalla e ndikimit të së cilës periudhë në veprën e tij, siç e pohon edhe Fan Noli, do të tentohet të shihet.

Por, ndeshja me idetë mospajtuese rreth qëndrimit të tij ndaj frymës së këtij Revolucioni, na çon te dy figura, Shindleri dhe Vinsent d'Indi. Shindleri ishte biografi i parë i Betovenit, i cili tregon se Betoveni ishte simpatizant dhe radikal i ideve të reja. "Por, çështja pat qenë lënë pas dore për shtatëdhjetë vjet me radhë, dhe pat mbetur atje ku e pat lënë Shindleri kur botoi të parën biografi të Betovenit më 1840."[164]

Mirëpo, figura tjetër, që ishte kompozitor eminent francez, në biografinë e botuar më 1911, pohon se Betoveni nuk ka qenë ndikuar kurrë nga idetë e Revolucionit francez. E, kundër tij doli një tjetër frëng, Romen Rolani, i cili pohonte se Betoveni ishte një "pinjoll autentik i Revolucionit francez".

Por, kjo çështje nuk u çua tutje nga ndonjë tjetër figurë, për t'iu dhënë ndonjë sqarim përfundimtar.

---

[162] Roland Barthes, Mitologjitw, fq.239.
163 Fan Noli, Vepra 5,Rilindja, Prishtnë, 1988, fq. 155.

[164] Fan Noli, Po aty, fq. 156.

E, në këtë mes, duke pasur parasysh idealet e Revolucionit francez: liria, barazia, vëllazëria, demokracia, etj., që janë edhe sot çështje me rëndësi, sipas autorit, pa dyshim që çon peshë edhe qëndrimi i kësaj figure të madhe karshi këtyre idealeve.

Por, Fan Noli, kur shtron këtë problematikë, ai vë në pah që para tij janë edhe vështirësitë e çështjes në fjalë, të cilat ai i krahason me ato të mitologut dhe të antropologut.

"Nga njëra në një mori e madhe mitesh fantastike, kurse nga ana tjetër një vandak i tërë faktesh fragmentare. Vëzhguesi i rastit është i lirë të zgjedhë sipas ëndjes, ai mund të marrë mitet de të thurë një tregim brilant, të mirë për treg dhe të kënaqshëm për çdo njeri; ose mund të të nxjerrë faktet dhe të hartojë një tezë të pahonepsur, që nuk e ha pazari, por të mirë vetëm si një dokument djersitës shkollari të kënduar;ose sipas atij zakoni të vjetër eklektik und t'u hipë të dy kuajve: të marrë edhe mitet, edhe faktet, dhe ashtu si t'i vijë më mirë, të ndërtojë një tjetër monstrum hibrid, që nuk i përket as historisë, as mitologjisë, të cilin tregu mund ta përtypë si një kuriozitet ekzotik."[165]

Por, pavarësisht që ka fakte që përkrahin herë njërën figurë, e herë tjetrën, të cilat e vështirësojnë shumë zgjidhjen e çështjes në fjalë, Fan Noli, përmes metodës së vëzhgimit, që është ajo e vërtetimit të fakteve, do të tentojë të vërë në pah se cila është e vërteta më e besueshme.

1.3.Treguesit paratekstualë

“Paratekstualiteti dërgon te çdo marrëdhënie që një tekst mban me paratekstin e tij (parathënie, vërejtje, ilustrime…)”[9], duke i ndihmuar kështu linjës intertekstuale për t’u kuptuar më lehtë apo edhe për t’u orientuar. G. Genette e sheh si të rëndësishëm paratekstin, kur flet për pesë tipat e marrëdhënies transtekstuale.

"Betoveni dhe Revolucioni francez" është i ndërtuar mbi kriterin e ndarjes së titujve përkatës për çështje të ndryshme, të cilat Fan Noli i trajton, duke i grupuar ato sipas karakterit të tyre. Si tregues paratekstualë i paraprijnë fillimisht të dhënat mbi botimin e librit në origjinal, e që ishte gjuha angleze, "Bethoven and the french Revolution", by bishop Fan

---

[165] Fan Noli,Po aty, 157.

S.Noli, Mus. B., Ph.D. International Universities Press, Neë York, 1947. Këto pa dyshim shërbejnë si të dhëna fillestare, që informojnë lexuesin mbi librin ën fjalë, si botim i parë dhe origjinal, duke vënë në pah edhe detaje mbi autorin, me këtë rast. Pra, Fan Noli këtë libër e kishte disertacion doktorate, me të cilin edhe e fitoi titullin PhD. këtyre të dhënave u qëndrojnë në krah edhe detajet mbi përkthimin në shqip, si dhe lekturimin- Nebill Dino dhe Alqi Krsto, përkthyes, dhe Mehmet Gjevori, lektor.

Pas këtyre treguesve, vjen një kushtim: "Kujtimit të tim eti, Stylian Jorgji Nlit, Kantor i Kishës Shqiptare të fshatit qytezë, Ibrik-Tepe, Thraka Lindore, Mësuesit tim të parë të muzikës, F.S.N[166]". Si tregues i jashtëm, ky kushtim jep detaje dhe të dhëna mbi babanë e tij, i cili ishte kantor i kishës në fshatin e tij të lindjes, Ibrik Tepe. Përveç këtyre, në faqen pasuese, ende pa u futur në tekst, qëndron një pjesë e Ludëig Van Bethovenit, e marrë nga një letër dërguar Brajtkoph Hertelit, më 2 nëntor 1809.[167]

"Edhe diçka! S'ka asgjë që do të mund të mësoj menjëherë! Sido që të jetë, unë, që nga mituria kam pasë dëshirë të madh t'i kuptoj gjërat e urta dhe të mira të kohëve të kaluara. Është mëkat për një artist, nëse ai nuk pandeh mungesën e një dëshirë të tillë si njëlloj faji, dhe, nuk përpiqet ta plotësojë këtë boshllëk."[168]

Kësisoj, kjo në një formë do të jetë motoja e tij, gjatë gjithë rrugëtimit të "Betoveni dhe Revolucioni francez", duke tentuar, me një gjakim për dijen dhe urtinë, të proklamuar nga vetë Betoveni, të vërë në pah të vërtetën.

Pas të dhënave të jashtme, vjen pjesa pasuese e ndarjes së titujve të librit. Është karakteristike se të gjitha pjesët, përveç titullit, kanë edhe nga një pjesë të shkëputur, në formë thënieje, që qëndron sipër tekstit. Kështu, libri nis me Introduktë, që është ndarja e parë, duke u paraprirë nga një thënie e Meternikut, "Kur ftohet Franca, teshtin gjithë Evropa".[169]

---

[166] Fan Stilian Noli,Po aty, fq. 149.
[167] Këtë të dhënë e jep vetë Fan Noli, në formë fusnote në "Betoveni dhe Revolucioni francez", Vepra 5, Rilindja, Prishtinë, 1988.
[168] Fan Noli, Po aty, fq. 151.
[169] Fan Noli, Po aty, fq. 155.

Pas saj, vjen pjesa e dytë, Burimet, që po ashtu paraprihet nga një pjesë e marrë nga Shën Mateu, XVII, 2. "Dhe ai qe transfiguruar përpara atyre: dhe fytyra e tij ndriçoi si dielli, dhe veshja e tij qe e bardhë si drita"[170].

Pjesa e tretë është Betoveni njeri, dhe sipër mban një pjesë nga letra e Betovenit dërguar Petersit, më 5 qershor 1822.

"Ajme! Sado brilane të duket zulma e tij, artisti nuk e gëzon atë privilegj që rë hetë ditën mysafir i Jupiterit n'Olimp. Fatkeqësisht, bota e rëndomtë vetëm rrallë e zvarris padëshirë poshtë këtyre lartësive të pastra qiellore".[171]

Pjesa e katërt është Betoveni rebel, dhe ka këtë shkrim sipër tekstit: Freiheit uber Alles-Beethoven. (Liria mbi çdo gjë-Betoven). [172]

Ndërsa, përfundon me Bibliografinë, e cila përmban letra, komente dhe recensione, nga figura të ndryshme, si: George Bernard Shaë, Thomas Man, Jan Sibelius, Ernest Njuman, etj. , që i ajnë kushtuar librit më serioz mbi problemin e ideologjisë politike të Betovenit të Nolit.

## 1.4. Nga miti tek antimiti

Noli ka pasur qejf të madh, që si krijues historian të merret më shumë me heronjtë dhe prej piedestalit të tyre të lartë e të paprekshëm t'i zbresë në mesin e njerëzve të thjeshtë, tek do të jetojnë, të gëzohen dhe të vuajnë, të ngadhënjejnë dhe të dështojnë bashkë me ta. Dhe mendimin e tij të këtillë e frymëzon besimi i patundur[173] se "njeriu i vërtetë është më interesant se të gjithë heronjtë legjendarë të marrë së bashku, për asryen e thjeshtë se këta të fundit janë pjellë e imagjinatës së adhuruesve të heronjve "[174]

[170] Fan Noli, Po aty, fq. 163
[171] Fan Noli, Po aty, fq. 179.
[172] Fan Noli, Po aty,fq. 209.
[173] Shkrimtarë dhe periudha, Rexhep Qosja, akademia e Shkencave e Shqipërisë, tirnaë, 2005, fq. 256.
[174] Betoveni dhe Revolucioni francez, Rilindja, Prishtinë, 1968, fq.68.

Dhe, kështu, Noli duke rrëzuar mitin paraprak, krijon antimitin. Te miti gjejmw skemwn tripwmasore: i shenjuari, shenjuesi dhe shenja. Mirwpo, ai wshtw njw sistem i veçantw, nw kuptimin se ai ndwrtohet duke u nisur nga njw varg semiologjik qw ekziston para tij: wshtw njw sistem semiologjik dytwsor. [175]

E, meqw Barti nw kwtw rast e sheh mitin si njw metaligjwrim, i cili flet pwr ligjwrimin-objekt, antimiti i Nolit do tw jetw miti i ri i metaligjwrimit dhe ligjwrimit-objekt. Sepse, do tw injorojw edhe shkrimin, edhe imazhin e kwtij shkrimi, pwr tw ndwrtuar imazhin e ri tw shkrimit dhe tw imazhit.

Duke e rrwzuar sistemin semiologjik dytwsor, Noli ndwrton njw sistem tw tretw, qw wshtw anitmiti, apo miti i ri personal.

Teksa kritikon glorifikimin me çdo kusht të heroit, ai e zbret nga piedestali aristokrat, që domosdoshmërish ata e kanë vënë veten, për t'i dhënë përmasa shumë njerëzore. Megjithatë, Noli duke demitizuar mitizon, sepse, pavarësisht që ai e sheh Betovenin nga çdo lakesë e mundshme njerëzore dhe e zhvesh nga elementet që e bëjnë atë hyjnor, ai do ta krijojë mitin e ri, ai i Betovenit njeri, siç do ta gjejmë të trajtuar në nëntitullin "Miti i ri, Miti personal".

E, ideja e përmbysjes së mitit mbi figurën e Betovenit nis nga origjina e tij.

"*Rishqyrtimi i njëmendtë i heroit dhe heroizmit, si një kthim nga vetvetja dhe rivlerësim i punëve personale, fillon pikërisht me shqyrtimin e prejardhjes së heroit. Kjo është kritika e parë që i bën Noli legjendës mbi origjinën fisnike dhe aristokrate të domosdoshme të madhështisë së heroit.*"[176] Kësisoj, Noli shpreh hapur mendimin se jo domosdoshmërish njeriu i lartë duhet të ketë prejardhje fisnike e aristokrate. Duke e parë këtë ide si më shumë si paragjykim dhe si pretekst për të glorifikuar dhe më shumë për të mitizuar heroin, studiuesi Raifi mendon se Noli, tashmë përmes argumenteve, provon se udhëheqësit e popullit, krijuesit e mëdhenj, jo më çdo kusht dalin nga derë e madhe.

"*Tani vijmë të Betoveni, si bir i Feudalizmit Mesjetar, që besonte në epërsinë e gjakut aristokrat dhe në urdhrat e medaljet e mbretërve të aristokracisë. Fjala 'Van' përpara emrit të Betovenit nuk është një titull fisnikërie në gjuhën e Flandrës, sikurse është 'Von' në gjuhën*

[175] Roland Barthes, Mitologjitw, fq. 245.
[176] Mensur Raifi, :Fan S.Noli dhe Migjeni", Rilindja, Prishtinë, 1979, fq. 81.

*gjermane, po Betoveni ua mbushi mendjen miqve të tij aristokratë në Vjenë se ajo kishte po atë kuptim*."[177]

Megjithatë, kjo nuk do t'i shkojë gjatë Betovenit, sepse do të demaskohet, duke "u shembur përralla e fisnikërisë së tij", siç e pohon Noli.

"*Shindleri besnik e pranon me pahir se mjeshtri hiqej si fisnik teksa ishte nga klasa e borgjezisë së vogël. Përralla e fisnikërisë së Betovenit u shemb kur Gjykata aristokrate Landhaus, i kërkoi atij dokumente për të provuar fisnikërinë e tij. Ai s'kishte të tilla dokumente. Për pasojë, çështja e të nipit të tij u hodh në Gjykatën popullorë të Vjenës, Betoveni u zemërua shumë përpara këtij çgradimi dhe shkroi me dorën e tij këtë vërejtje në Fletoret e Bisedimeve: "Natyra ime tregon se unë nuk i përkas vegjëlisë*"[178]

E, nisur nga legjenda se heroi është gjithmonë hyjnor ose të paktën me prejardhje aristokrate, edhe Niçja me Ibsenin, megjithëse rridhnin nga borgjezia e vogël, kanë provuar me çdo kusht dhe me dëshirë shumë të madhe që të vërtetonin dhe bindnin masën që kishin prejardhje fisnike. Ndikimi i madh duhet të ketë qenë nga disa legjenda, siç i përmend Noli, se "*qytetërimi modern është pjell*ë e klasave të larta", dhe se "tipi më i lartë i heroit është luftëtari, gjahtori i kokave dhe kanibali", por që autori i quan absurditete.

Kwsisoj, Noli luan me formwn dhe konceptin, qw nw kwtw rast wshtw shenjuesi i mitit. Pra, shenjuesi, Betoveni, ka njw pasuri paraprake dhe kwrkon njw lexim. Dhe, duke qenw pjesw e njw historie, ky mit ka njw vlerw tw veten, qw nwnkupton njw tw shkuar, njw kujtesw, njw rend faktesh, ideshe, etj., mirwpo, duke kaluar nw shenjues mitik, duke u bwrw formw, kuptimmi zhvishet nga konteskti i vet.[179] Dhe, kjo lojw mes kuptimit dhe formws e pwrcakton mitin. E, megjithatw, kwsaj forme, Noli ia jep njw kuptim tw ri, njw shenjues tw ri mititk, pwrmes antimitit. E zhvesh, duke e 'veshur' swrish.

1.5. Nga anitimiti te miti

Fan.S.Noli, pasi e zhvesh mitin e parë, mitin mbi Betovenin idhull, aristokrat e hyjnor, tenton të krijojë një mit të ri. Dhe, kështu, nga anitmiti vijmë te miti, tani te miti i ri. Duket sheshit se Nolit i pengon ky glorifikim i pamatur i heroit, që s'ka të bëjë me të

---

177 Fan Noli, Vepra 5,fq. 251.
178 Fan Noli, Vepra 5, fq.252.
179 Roland Barthes, *Mythologies*, translated from the French by Annette Lavers, Farrar, Straus and Giroux, United States of America, 1972, fq. 253.

vërtetën. Me fuqinë e argumenteve ai e bën heroin të zbresë prej lartësive legjendare në tokë. Ai ia pret krahët e idhulltarisë dhe i jep përmasa reale.[180]

Nw gjirin e mitit, koncpeti do tw ngulw njw histori krejt tw re[181], pohon Barti, ashtu siç do t'i japw Noli, pwrmes konceptit tw ri, njw histori ndryshe mitit tw ri tw Betovenit. Dhe, duke kaluar nga kuptimi te forma, imazhi humbet dije,...sepse dija qw pwrmban koncepti mitik wshtw njw dije e turbullt.[182] Kwsisoj, koncepti mbushet me dijen e re.

Dhe, miti i ri nis fillimisht me pamjen e tij. Duke demitizuar legjendën mbi pamjen e bukur të heronjve, Noli i jep pamjen e re heroit, pra Betovenit, që është shumë larg nga ajo e statujave, apo e imagjinatës së idhujtarëve të Betovenit.

*"Betoveni i vërtetë është i shëmtuar si majmun. I pazhvilluar si kërcu, me një fytyrë të zeshkët e vrarëlije, me një hundë të mprehtë e fllashkë, me sy të vegjël e të dobët, shëmbë katarosh, flokë të zeza dhe kreshtë, duar të shkurtra e gishta të trashë, - ai dukej si ari i palëpirë, si totem krye-gorgonë, si gogol fantastik, ose mishërim i njeriut origjinal të shpellave.* "[183]

Siç na e thotë Noli te "*Betoveni dhe Revolucioni francez*", Betoveni ishte i vetëdijshëm për pamjen e tij. Ai madje këtë e pranon edhe në letrat e tij. Madje, sipas Nolit, edhe Shindleri, që me shumë përkushtim ishte marrë me çështjen e Betovenit, nuk tenton fare ta zbukurojë atë.

"*Përkundrazi, mbasi e përshkruan shumë a pak si është, ai shton se kur qeshte Betoveni, sytë e tij të vegjël bojë-kafe fundoseshin në gropat e tyre, kryet i zmadhohej, fytyra i zgjerohej dhe dukej si majmun pa bisht që zgërdhihet.*"[184]

Dhe, kësisoj, miti i Betovenit hero, me pamje të fisnikut rrëzohet, për t'i lënë vend një mitit të ri, i cili i jep tipare shëmtie. E, Noli nuk do ta lërë anash as pamjen trupore të Betovenit, në këtë shkallë përmbysjeje tiparesh. Duke pohuar se ai ishte njeri i thjeshtë mbi të gjitha, dhe pjesë e turmës që prekej nga sëmundje nga më të ndryshmet dhe më të shëmtuarat, Noli edhe një herë tenton ta sjellë në sytë e njerëzimit Betovenin të humanizuar.

---

[180] Mensur Raifi, Fan S.Noli dhe Migjeni, Rilindja, Prishtinë, 1979, fq.83.
[181] Roland Barthes, Mitologjitw, fq. 251.
[182] Po aty.
[183] Fan S. Noli, Vepra 5, fq. 180.
[184] Shindler-Moshel, II, f.192-3 (Cituar sipas: Fan S. Noli, Vepra 5, Prishtinë, 1988, fq. 180.)

"*Legjenda tjetër që të dërmon është që të gjithë heronjtë, fizikisht, janë yrenkë tipikë herkulianë. Sipas rregullit, nuk janë ashtu. Për shembull, Betoveni ishte një gërmadhë trupore, vetëm e vetëm një ulog. Ai na rrfëen vetë se ka qenë gjithë jetën shëndetligë. Në vogëli i ka pasë rënë lija, që ndikoi edhe në sytë e tij e ia prishi edhe fytyrën. Në letrat e tij ai ankohet vazhdimisht për veshët e dobët, për sytë e mahisur, për astmën, cermën e këmbëve, përdhesin, të verdhët, oreksuon, të prerët e barkut dhe dhembjën e zorrëve. Në vjetët e tij të fundit u paralizua nga shurdhësia dhe diarreja kronike. Më në fund vdiq prej cirozës së mëlçive.*"[185]

Megjithëkëtë, në tendencën për të mitizuar, Noli do ta fusë pikërisht faktin që Betoveni kishte shumë sëmundje dhe pasiguri trupore, për ta parë si heroizëm përpjekjen e tij për t'i mposhtur ato. E, komponimi i gjithë atyre kryeveprave me gjithë këtë barrë trupore mbi supe gjatë jetës së tij, bën që Betoveni të jetë mit në vete.

Studiuesi Raifi mendon se është me shumë rëndësi të shihet se në çfarë mase ka arritur Noli ta humanizojë figurën legjendare dhe të mitizuar të Betovenit dhe ne çfarë mase ka krijuar një mit të ri. Sot, në gjithë botën, miti është një realitet i dytë për njeriun. Secili mitolog, sado lucid që të jetë, demitizon një mit dhe automatikisht krijon një tjetër.[186]

Siç e pohon edhe Barti, te "Mitologjitw", edhe mitologu ka një mitologji të veten. Prandaj, edhe Noli, i gjendur përballë legjendash dhe faktesh, Betovenit të shëmtuar realisht, duke i dhënë përmasa humane, ia vesh edhe petkun e heroit. Sepse, ai në të vërtetë e kishte të destinuar të ishte një hero.

Betoveni i Nolit nuk është hero i bukur as i zhvilluar si Herkuli, po ja se punët e tij janë cok "Herkuliane". Ai njëmend nuk është esull përpara verës së bekuar, as virgjin përpara Omfalive vieneze, por është në mënyrë të vet, si Bruti, hero-vrasës-i-titranëve.[187] . Por, megjithatë, Noli e pranon se asgjë s'mund t'i dëmtojë perënditë, rrjedhimisht asgjë s'mund ta dëmtojë perëndinë Betoven. Dhe, kështu miti i përmbysur i Betovenit aristokrat, rikthehet në lojë si mit i humanizuar.

"*Betoveni e ndjente se ai ishte një nga këto karaktere të fuqishme (për të ndezur shpirtin e publikut të një koncerti) dhe Fati e kishte paracaktua atë për këtë detyrë*

[185] Fan S.Noli, Po aty. Fq. 181.
[186] Mesur Raifi, vepër e cit. Fq.87.
[187] Mensur Raifi, Po aty, Fq. 88.

*herkuliane. Tani Fati i troket në derë dhe e urdhëron të përmbushë misionin e tij të shenjtë. Ai është gati të ndërmarrë detyrën më të vështirë të jetës së tij. Ai di se si të dredhojë. Ai i vë sopranot të bërtasin për fitoren, ashtu si gratë e liga të Parizit kur shikonin gijotinën që shkurtonte kokat e Marie Antuanetës dhe të Luigjit XVI.*"[188]

Dhe, kur e kemi parasysh që Noli i ka adhuruar heronjtë që në vegjëli, na qartësohet fakti se përse ai tenton me çdo kusht të krijojë mitin e ri të heroit të tij. Pasi e zhvesh nga elementet e panevojshme, e zbret në tokë, Noli sërish ia lë epitetin e heroit, i cili ka mitin e tij, atë të përkushtimit, të stërmundimit, të tejkaluar me talent dhe me faktin e të qenit njeri.

1.6. Çmitizimi si përmbysje e së mëparshmes

Pa dyshim që përpjekja e Nolit ishte që të përmbyste idetë e idhulltarëve mbi hyjnizimin.

Dhe, kështu ai çmitizon, duke thyer mite të mëparshme, për të sjellë mitin e ri. Betoveni pijanik, i shëmtuar, ulog, dashnor, gaztor, nogul i madh, paternal e autodidakt, janë disa nga titujt, përmes të cilëve autori vë në pah vese e atribute të ndryshme njerëzore, që çojën drejt çmitizimit të kësaj figure.

Fan Noli, duke qenë kundër hyjnizimit dhe adhurimit të verbër të figurave njerëzorë, të cilët vishen me petk hyjnor dhe konsiderohen si të tillë, komplet pjesën e tretë të "Betoveni dhe Revolucioni francez" e titullon "Betoveni njeri". Kjo zgjedhje ishte jo rastësore, sepse tendenca e autorit ishte që të tregonte fillimisht që Betoveni, para së gjithash, ishte vetëm njeri, dhe po ashtu, që, duke vënë në pah faktin e parë, ta përforconte atë përmes potencimit të dobësive të ndryshme njerëzore, e në këtë rast të Betovenit.

E, sigurisht që heronjtë nuk mund të jenë pijanikë, që është tendenca e parë çmitizuese e Nolit. Përgjatë rreshtash te "Betoveni pijanik", Noli, siç vepron rëndom, përmes faktesh dhe citimesh ballafaqon mendime të ndryshme të njerëzve që kishin qenë pranë Betovenit, se a kishte qenë apo jo ai pijanik. Kësisoj, përveç thyerjes së fizikut mitik te heroit, Noli bën edhe thyerjen e virtyteve, për t'i mundur glorifikimet, të cilat ai nuk i donte aspak.

Trekëndëshi që na e ofron Noli përbëhet nga Shindleri, Thajeri dhe Karl Holci. Duke pasur mendime të ndryshme, sa i përket pijes së Betovenit, Noli tenton të vërë në pah këtë dobësi të "idhullit" në fjalë.

[188] Fan S.Noli, vepër e cit. Fq. 198.

Shindleri flet për shprehinë e Betovenit për të pirë, por duke mos e parë atë si pijanik, siç e paraqiste në anën tjetër mjeku i tij i fundit, Dr. Vavrusku.

"*Pija e dashur e Betovenit ishte uji i freskët i burimit, që në verë ai e pinte në sasira poyhua të pacaktuara. Nga verërat prferonte më tepër ato të Hungarisë, të variantit Ofener. Fatkeqësisht, ai donte me tepër verën për burar, që u bënte dëm të madh zorrëve të tij të dobëta. Por këshillat nuk kishin asnje vlerë në këtë rast.*"[189]

Megjithatë, përveç mjekut të tij, edhe Karl Holci, që ishte një prej sekretarëve dhe farkëtarëve të mjeshtrit, e vërteton teorinë se Betoveni ishte pijanik. Por, këtu debati thellohet, ngase Shindleri e fajëson pikërisht Holcin për pijen e Betovenit, duke e akuzuar se ai e kishte lejuar atë, kur mund ta ndalte.

Por, në anën tjetër, Thajer e shfajëson Holcin, duke pohuar se "*Alkoolizmin Betoveni e kishte faktikisht në gjak. I ati dhe gjyshja e tij ishin pijanikë të pashpresë.*"[190]

Fan Noli, përkundër debateve që ekzistonin rreth asaj se kishte qenë apo jo Betoveni pijanik, e jep një pjesë nga letërkëmbimi i Betovenit me senatorin Brentanos nga Frankfurti.

"*Ju rekomandoj mikun tim me vlerë, të parin artist të verës në Europë, zotëri Neberikun. Ai është mjeshtër që ka plot sukses në të porositur të verërave të shijshme llojesh të ndryshme, madje aq sa meriton duartrokitjet më të përzemërta.*"[191]

Kësisoj, nga përmbysja e së mëparshmes, Noli na ofron një pamje të re, një imazh të ri, i cili na njofton me Betovenin njeri, me çdo ves njerëzor, duke e bërë atë të zakonshëm dhe larg glorifikimeve e hyjnizimeve. Duke çmitizuar, Noli edhe një herë mitizon, sepse çdo njeri e ka një mit të vetin, ashtu edhe Betoveni, por tani jo ai idhull, por si njëri.

## 1.6. Mitizimi i atributeve njerëzore

[189] Fan S. Noli, vepër e cit. Fq. 182-183.
[190] Thjaer, Edicioni anglisht, III, f. 196.(cituar sipas Fan S.Noli, Vepra 5,fq. 185.)
[191] Kalisher Shedlok, I. f.399, (cituar sipas Fan S.Noli, Vepra 5, fq. 187.)

Sipas studiuesit Rexhep Qosja, nuk janë dashur shumë vite që Noli të shkundet prej "revolucionarizmit" të filozofisë niçeane dhe të formojë me kohë botëkuptimet e veta origjinale mbi shoqërinë dhe historinë, mbi rolin e individit, të heroit dhe të masës. Me kohë ai e ka kuptuar se historia nuk është arenë e supernjerëzve, e heronjve, ashtu sikundër nuk ëshyë kultura e përbotshme vetëm fryt i punës së shtresave të larta.[192] Prandaj, përgjatë gjithë tekstit të "Betoveni dhe Revolucioni francez" ai do të ndjekë pikërisht këtë teori. Përmbys klishe, krijon mite të reja.

Figurën e Betovenit e shëtit nëpër atribute të ndryshme njerëzore, herë duke e çmitizuar, e herë duke krijuar një mit të ri. "*Betoveni ishte gjithnjë në dashuri, por në periudha të shkurtra kohore, kurrë më tepër se shtatë muaj*"[193]. Kështu, ai vuante dhe ndjente, duke ushqyer më së shpeshti dashuri platonike, herë për shtresa të larta, e herë për varfanjake, për beqare e nganjëherë edhe për gra të martuara.

Noli, thyen klishe, tabu e legjenda, sepse vetëm kështu heroi i tij zbret nga glorifikmet dhe merr atribute njerëzore, e ky është miti që Noli dëshiron të krijojë, mitin personal.

Por, tipi i tij gaztor, shpeshherë, sipas Nolit, e shpëtonte nga situata të rrezikshme, në të cilat ai gjendej për shkak të proçkave dashurore. Duke përmbysur legjendën se Betoveni nuk ishte kurrë i buzëqeshur dhe se portretet e tij e nxjerrin gjithmonë serioz, Noli krijon mitin e ri të Betovenit, ai të Betovenit gaztor, të buzëqeshur, i cili edhe në kohën kur po operohej lëshon batutë.

Madje, Betoveni ishte njeri si të gjithë të tjerët, ndoshta edhe më i thjeshtë seç mund të pandehej një njeri. Pinte pa masë, dashuronte shpesh dhe e kthente secilën situatë në humor.

Mirëpo, ai nuk donte shumë njerëz rreth vetes, siç duan dhe kane heronjtë zakonisht. Madje, thuhet se ai sillej shumë keq më të gjithë rreth tij, në mënyrë shumë mizore. Prandaj, edhe ishte pothuajse vetëm, duke mos lënë njeri afër. E, pikërisht në këtë fatkeqësi është e veçanta. Kështu përmbyset një mit i vjetër, për t'i lënë vend një të riu.

Sipas legjendës, heroi nuk ishte kurrë në shkollë dhe s'ka diplomë e as titull të ndonjë instituti mësimor. Heroi merr mësimet nga Ati i tij i shenjtë, me anë të zbulimeve ose të çdo

[192] Rexhep Qosja, Shkrimtarë dhe periudha, fq.255.
[193] Fan S.Noli, vepër e cit. Fq. 189.

procesi tjetër mrekullues, që fatbardhësisht përjashton pyetje prozaike, provim, raport, tezë dhe disertacion.[194]

E, megjithatë, ai vazhdonte të ishte një hero, një mit. Sepse, ndonëse nuk kishte shkollim, diploma e mirënjohje akademike, ai nuk kishte lënë pa lexuar tekst të kohës dhe ishte njeri me kulturë të gjerë si rrallëkush.

Duke përmbysur supozimet e disanashme pro et contra, Noli thekson mendimin e Rizlerit rreth kësaj çështjeje, duke e parë si më se të drejtë: "*Kushdo që e quan Betovenin pa edukatë, ka një mendim të gabuar për edukatën"*. [195]

1.8. Jetëshkrimi i demitizuar

"*Për të studiuar jetën e Betovenit, pikësëpari duhen spastruar pa mëshirë tw gjitha legjendat dhe të mbahen vetëm faktet. Atëherë Betoveni na del njeri i vërtetë. Dhe njeriu i vërtetë është më interesant se të gjithë heronjtë legjendarë të marrë së bashku, për arsyen e thjeshtë se këta të fundit janë pjellë e imagjinatës së adhuruesve të heronjve*."[196] Prandaj, edhe kur flitet për jetëshkrimin e Betovenit, Noli tenton që t'i lërë anash legjendat, duke vënë në pah vetëm fakte dhe argumente, ashtu që biografia e tij të jetë prej njeriu dhe jo prej heroi.

Sa i përket pjesës "Revolucioni francez", Mensur Raifi mendon që Noli e ka zgjedhur ta vërë në titull vetëm duke pasur parasysh pozicionimin kohor, pra duke u bazuar në zhvillimet e kohës. Megjithatë, Zana Dh. Shuteriqi mendon se qëllimi se përse e ka shkruar Noli librin "Betoveni dhe Revolucioni francez" është pikërisht përçimi i frymës demokratike të Revolucionit, që ia kishte dalë të ndikonte në të gjitha sferat e jetës, te të gjithë artistët, e po ashtu edhe te vetë Betoveni. E, pjesa e katërt është pjesa më e rëndësishme e librit të muzikologjisë së Nolit, mendon studiuesja Shuteriqi, sepse vetëm aty vjen në thelbin e çështjes Noli, duke e trajtuar Betovenin revolucionar.

E, pikërisht lidhur me Revolucionin francez është një pjesë e kapitullit që Noli e ka titulluar "Betoveni rebel", me qëllimin e vetëm për të akuzuar, shembur autoritete të vjetra e për të krijuar të reja, mendon studiuesi Raifi. Çështja se a ishte pro apo kundër Revolucionit, na del vetëm nga jetëshkruesi i tij Shindler, i cili pohon me bindje se Betoveni ka pasur një ideologji republikane, se ai besonte në parimet e Revolucionit francez dhe se ai u frymëzua

[194] Fan S.Noli, vepër e cit. Fq. 202.
[195] Rizler, Betoven f.44 (citua sipas F.S.Noli, Vepra 5, fq. 206.)
[196] Fan S.Noli, Vepër e cit. Fq. 256.

nga to për të kompozuar kryeveprat e tij. Por, pati edhe tendenca të tjera, që të paraqisnin jetën e kësaj figure, që po nuk u zhveshën nga karakteri legjendar i dhënë, e humbin Betovenin njeri brenda vetes.

Duke përmendur edhe karakteristika të tjera të Betovenit, Noli e çon në fund jetëshkrimin e tij, të bazuar gjithmonë në faktet që i kishte para vetes, të parë tashmë si një njeri të thjeshtë, i cili nuk di të dashurojë për kohë të gjatë, por që megjithatë dashuria e tij e përjetshme mbetet nipi i tij; që nuk kishte asnjë lloj bukurie të jashtme, por që nuk linte grua të cilën nuk tentonte ta kishte kushtimisht; që vuante nga shumë sëmundje, të cilat e kishin dërmuar dhe shtrirë për tokë, por që prapëseprapë adhurohej dhe himnizohej; që nuk dinte të sillej me askënd rreth vetes, por që megjithatë kishte tre njerëz që nuk iu ndanë kurrë deri në fund; që konsiderohej i mrrolur dhe pa humor, kurse e vërteta ishte që ia kthente në situatë komike gati çdo moment.

Sipas Nolit, "Piktura e tij më e mirë duhej të përmbante tri nga karakteristikat e tij kryesore: Dashurinë e jashtëzakonshme për të nipin; shëmtinë e tij fizike, të shoqëruar me egoizmin dhe arrogancën e tij' dhe muzikën e tij revolucionare.[197]"

E, Betoveni i tillë nolian, tashmë arrin mitin e tij, atë të heroit të jetës, atë personal e individual.

1.9. Betoveni antifetar dhe antiçifut

Më tutje, për të thyer autoritete të tjera, Noli paraqet edhe anën tjetër të Betovenit, duke e quajtur antifetar dhe antiçifut.

Fillimisht, Betoveni është quajtur antiçifut nga Vensan d'Endi. Noli bazën e kësaj akuze e sheh në disa shaka të Betovenit, që ai i kishte bërë për çifutët në letrat e tij. Betoveni, në letrën që ia shkruan botuesit Hofmeister, thotë:

"Dhe meqenëse ju nuk jeni as çifut, as italian, s'ka dyshim se do të bimë në ujdi"[198]

Duke e dëshmuar kështu se ai e ka pasur të vështirë të gënjejë një çifut ose italian. Por më tutje, ai ka edhe një tjetër shaka, tani me botuesin Shlesinger. E, më poshtë edhe një vërejtje për Krishtin. Megjithatë, Noli mendon se edhe nëse ai ka qenë antisemit, nuk është aq

---

[197] Fan S.Noli, Vepër e cit. Fq. 257.
[198] Letër dërguar Hofmeisterit, 15 dhjetor, 1800, Kastner-Kap, fq.35 (Cituar sipas Fan S. Noli, Vepra 5, Prishtinë, 1988, fq.250.)

e rëndë sa kanë vlerësuar mendimtarët e kohës, sepse ai ka pasur shokë të ngushtë çifutë, më të cilët ka pasur letërkëmbime deri në vdekje.

Por, një thyreje e mitit, po kaq e vërtetuar sa edhe te "Betoveni fisnik" është edhe te "Betoveni fetar".

"Muzika reaksionare që ka shkruar Betoveni për lavdinë e Kongresit të Vjenës është aq e keqe sa do të humbisnim kohën kot po të merreshim me të. Ai e shkroi atë vetëm për të fituar ca para dhe disa nga bashkëkohësit e tij e dinin fare mirë se ç'po bënte."[199] E, ai i cili e vuri re këtë gjë ishte Tomasheku, i cili e quan muzikë të keqe e programatike muzikën fetare të Betovenit, duke pohuar se qëllimi i tij i vetëm ishin paratë.

Ai tallej me fenë, thotë Noli, "madje, edhe pasi piu kungatën, vdiq duke qesëndisur atë. Qëndrimi tij ndaj fesë është fakti më i rëndësishëm që ai ushqente pikëpamje politike radikale."[200]

1.10. Karakteri revolucionar

"Betoveni dhe Revolucioni francez" është studimi i parë shqiptar i shkencës muzikologjike, për një kompozitor të madh botëror. E, megjithatë, ky libër fillimisht është parë jo vetëm si libër i muzikologjisë. Por, edhe sot mbetet një ndër librat më seriozë dhe më të paanshëm të shkruar për kompozitorin e madh, Betovenin.

Duke pasur parasysh faktin që Noli gjithë jetën e tij mbeti i lidhur ngushtë me idealet e demokracisë, e kemi më të lehtë ta kutpojmë se përse pikërisht karakteri revolucionar dhe ndikimi i kësaj periudhe kohore do të vihet në pah në krijimtarinë e Betovenit.

Fan.S.Noli jetoi në një nga periudhat më të vështira të historisë së atdheut onë, në kohën kur do të sigurohej pavarësia kombëtare dhe kur u shtrua çështja e ndërtimit të një shteti demokratik shqiptar. Ai jetoi në kohën kur Revolucioni i Tetori hapi një epokë të re, epokën më të përparuar në historinë e njërëzimit, atë të triumfit të proletariatit dhë të ndërtimit të socializmit. Në Shqipëri, në këtë kohë, u bënë përpjekje të mëdha për një regjim demokratik-sigurisht borgjez- dhe për të dalë nga prapambetja e rëndë mesjetare. Sikundër dihet, Noli luajti një tol të madh drejtues në ato përpjkeje, të cilat dështuan, sepse ky

[199] Fan S. Noli, Vepra 5, Prishtinë, 1988, fq. 253.
[200] Fan S.Noli, Vepër e cit, fq.256.

revolucion nuk e ndoqi me konsekuencë rrugën e vet, për shtypjen e feudalizmit dhe nuk u mbështet sa duhet në masat popullore.[201]

Ai ishte pro përdorimit të dhunës, për të arritur transfomrime në Shqipëri, por kur u gjedn në krye të pushtetit revolucionar, dështoi pikërisht për shkak të mospërdorimit deri në fund të dhunës. Megjithatë, shpresa e tij për të bërë ndryshime në Shqipëri nuk u shua edhe pasi emigroi në BRSS, ku gjithë shpëtimin e shihte në masat e vegjëlisë, siç reflektohet edhe në poezitë "Rent or Maratonomak", "Anës lumenjve", etj.

E, duhet pohuar se idëtë e Revolucionit francez patën jehonë në mbarë Evropën, pothuajse në të gjitha sferat e jetës. i ndikuar nga ky Revolucion ishte edhe i madh Betoven.

Për të dëshmuar gjithë ato që thotë në librin e tij, Noli shfrytëzon burime të ndryshme, Rolandin, Shindleri e Thejerin, megjithatë ndër më të besueshmet mbetetn letërlëmbimet e Betovenit.

Pasi Noli e zhvesh nga elementet hyjnore e mitike, tenton të shfaqë karakterin e vërtetë të Betovenit. "Gjithçka ka të bëjë me kapitullin e tretë i shërben Nolit për të treguar pastaj në kapitullin e fundit se si një Betoven "rebel", revolucionar, nuk mund të jetë i tillë në qoftë se nuk është jashtë miteve fantastike."[202] E, duke mos e ndarë Revolucioni nga ateizmi, autori nuk do të hezitojë të na paraqesë Betovenin si njërin ndër ta, pavarësisht që të tjerët para tij nuk e kishin pranuar një gjë të tillë.

Dhe, karakteri i tij revolucionar, vihet në pah edhe nga adhurimi i madh për demokracinë antike, nga ateizmi i tij, sepse Revolucioni ishte gjallëruar edhe nga figura ateiste të kohës, nga dahsuria e madhe që kishte për autorë si: Plutarku, Olatoni, Aristoteli, Ciceroni, Kanti, etj. . dhe, ç'është më e rëndësishmja, nga krijimet e tij, si opera "Fidela", simfonitë III dhe IX, ku, përveç tjerash, trajtohet edhe çshtja e muzikës fetare të Betovenit. [203]

Pavarësisht gjithë këtyre faqeve, në të cilat Noli e bën çmitizimin e Betovenit, ai përmes fjalisë që e vë fare në fund e mitizon sërish këtë figurë të madhe të muzikologjisë, duke na treguar edhe një herë se ne mund të jemi vetë miti, pavarësisht veseve njerëzore që mund t'i kemi. Asgjë nuk mund t'i dëmtojë perënditë, përfundon duke thënë Noli.

[201] Revista "Nëntori", viti XXI, nr. 10, Tiranë, 1974, fq.103-106. (Cituar sipas F.S.Noli, Vepra 5, fq. 290.)
[202] Revista "Nëntori", viti XXI, nr. 10, Tiranë, 1974, fq.103-106. (Cituar sipas F.S.Noli, Vepra 5, fq. 299.)
[203] Kjo muzikë, sipas Nolit, ishte shkruar nga Betoveni vetëm për shkak të kërkesave të shtresave të larta dhe nevojave të tij materiale.

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

**ZHVILLIMI I TË MENDUARIT KRITIK PËRMES ZHGJIDHJES SË PROBLEMEVE MATEMATIKORE (MODELI PISA)**

**Msc. Ajeta Memishaj**

Testimi ndërkombëtar PISA i zhvilluar në Shqipëri, por edhe në Kosovë dhe në vende të tjera të rajonit ka treguar se nxënësit kanë shumë vështirësi në zgjidhjen e problemeve matematikore. Në punim tonë do të fokusohemi në evidentimin e shkaqeve që çojnë në vështirësitë e zgjidhjes së problemeve matematikore të këtij modeli, si model i të meduarit kritik. Evidentimi do të jetë fokusuar në disa aspektet, që mendojmë se mund të jenë shkaqe reale të tyre si:

1. Modeli pedagogjik i ofruar në traditën tonë mësimore, në tekstet shkollore.
2. Mënyrat dhe teknikat e mësimdhenies së shkollës shqipe sot.
3. Harmonizmi i njohurive me zgjidhje praktike të problemeve matematikore në jetën e përditshme.

Një vëmendje të veçantë do t'i kushtohet edhe të dhënave të raporteve të PISA Albania dhe Kosovo në lidhje me njohuritë matematikore.

**Qëllimi dhe metoda studimore**: Punimi do të ketë si qëllim evidentimin e shkaqeve të vështirësve të hasura në zgjidhjen e problemeve matematikore të modelit PISA si model i të menduarit kritik si dhe përmirësimin e punës në të ardhmen nga mësuesit e Sistemit Arsimor Parauniversitar në Shqipëri dhe Kosovë. Metodologjia kryesore e punimit hulumtimi mbi të dhënat e PISA në këtë fushë, po ashtu nxjerrja e të dhënave nga përvoja me nxënësit me të cilit punojmë.

**Rezultatet dhe rekomandimet**: Nga hulumtimi ynë paraprak, është vënë re se nxënësit hasin vështirësi në zgjidhjen e këtyre problemeve për shkaqe të ndryshme, që përmblidhen në një shkak të vetëm, atë të mosintegrimit të njohurive me praktikën. Puna më e madhe në zhvillimin e të menduarit kritik përmes integrimit të njohurive me punën praktike.

**Fjalët kyçe:** PISA, të menduarit kritik, probleme matematikore, Sistemi Arsimor Parauniversitar etj.

**HYRJE**

Matematika është një nga shkencat kryesore, që nuk gjen zbatim vetëm në libra, por ka një përdorim të gjerë, kryesisht në jetën e përditshme. Ajo është një shkencë që evolon, këtë na e dëshmojnë shpikje të ndryshme matematikore. Matematikanët nuk mjaftohen me zbulimet e vjetra nga matematikanët e mëparshem. Praktika nxjerr çdo ditë detyra të reja për shkencetarët në të gjithë botën. Historia e matematikës ndahet në 4 peiudha të mëdha:

a. Lindja e matematikës, matematika e Egjyptit të lashtë;
b. Matematika elementare;
c. Periudha e matematikës së lartë klasike;
d. Periudha e matematikës modern.

Matematika u shfaq si rezultat i vështrimeve dhe përvojës të njerëzve në përballje me problemet dhe nevojat praktike. Sistematizimi dhe përmbledhja e njohurive matematikore ka filluar relativisht vonë. Kinezët e lashtë, civilizimi i Inkëve, pastaj në Indi kishte një zhvillim të konsiderueshëm të matematikës. Në Greqinë antike matematika përjetoi një zhvillim të paparë nga një plejadë e tërë matematikanësh siç janë : Pitagora, Talesi, Platoni, Eudoksi, Euklidi, Arkimedi, etj. Grekët e vjetër matematikën e kuptonin në sensin e gjeometrisë dhe të parët ishin ata që të vërtetat matematikore të cilat ato i quanin teorema i vërtetonin. Njohuritë matematikore të grekëve të vjetër më vonë i përvetësuan dhe i pasuruan arabët të cilët quhen edhe themelues të algjebrës. Çështja e përvetësimit të njohurive matematikore kanë bërë që të lindin edhe problemet e mënyrave të transmetimit të tyre, pra të teknikave të të mësuarit në fushën e matematikës. Në historinë e pedagogjisë botërore njihen dy drejtime themelore të mësimdhënies, natyrisht edhe në fushën e matematikës. Modeli lindor dhe modeli peredimor.

Modeli lindor i bazuar në përvetësimin e njohurive teorike, pa patur fokus zabtimin praktik të tyre, ndërsa modeli perendimor kishte si fokus përvetësimin e njohurive dhe zbatimin praktik të tyre në jetën e përditshme.

1. **Modeli pedagogjik i ofruar në traditën tonë mësimore në tekstet shkollore.**

Matematika në ditët e sotme përjeton një zhvillim marramendës dhe është e shpërndarë në shumë degë të specializuara të cilat janë mjaft abstrakte.

Modeli pedagogjik tradicional në shkollat shqiptare dhe në Europen Lindore krijoi një traditë të zhvillimit teorik në përvetsimin e njohurive matematikore, por jo vetëm.

Kjo krijoi dy probleme kryesore:

1. Raport pedonal mësues – nxënës, ku në qendër ishte mësuesi dhe nxënesi u shëndrrua në një dëgjues që duhet të mbante mend çdo gjë dhe riprodhonte çdo informacion në mënyre perfekte, e thënë ndryshe, niveli i mësimdhënies dhe i mësimnxënies ngel në nivelin e riprodhimit.
2. U krijua një traditë e mosaktualizimit të njohurive në jetën e përditshme.

Krahas modelit pedagogjik lindor kemi modelin pedagogjik perendimor i cili dallon plotësisht nga ai lindor në dy aspekte:

1. Raporti mësues – nxënës. Nxënesi në qendër dhe mesuesi udheheqës.
2. Raporti i zbatimit të njohurive në jetën e përditshme

Një nga modelet më të suksesshme të modelit perendimor është dhe Pisa.

Modelet pedagogjike tradicionale dhe moderne:

Modeli pedagogjik është një proces kompleks dhe shumë i rëndësishëm në zhvillimin e arsimit në një vend. Ai në vetvete përfshin një sërë komponentesh:

1. Kurikula
2. Raporti program – tekst, shkollë – komunitet, mësues – nxënës, nxënës – tekst.

Medeli tradicional paraqet një sjellje të niveleve të ulëta dhe të thjeshtë të fushave njohëse emocionale dhe psikomotore.

- Ky model kërkon komunikimin e fakteve dhe të rregullave në nivelin e të njohurit dhe të kuptuarit nëpërmjet disa veprimeve zbatuese që mund të përvetësohen përes vëzhgimit , përsëritjes përmëndësh , ushtrimet ( Musai. B. 2003)
- Në këtë mësimdhënie sigurohet një shkallë e lartë kontrolli nga ana e mësuesit në klasë e cila është e përqendruar në përmbajtjen e lëndës sepse siguron mësimdhënie , ritëm në të nxënë, korrigjim dhe vlerësim të përgjigjeve të nxënësve. (Sina. R. 2014)

Roli i mësuesit

1. Kontrolli i detyrave të shtëpisë.
2. Kontrolli i dijes.
3. Shpjegon temën e re.
4. Përmbledh njohuritë e reja.

5. Cakton detyrat e shtëpisë.

Roli i nxënësit

1. Nxënësit janë kryesisht dëgjues, madje të vëmendshëm, spepse pak minuta më pas duhet të riprodhoj ato qe ka dëgjuar nga nga goja e mësuesit
2. Nxënësit kur vjen radha për tu kontrolluar ngrihen para klasës , riuprodhon mekanikisht njohuritë që ka përvetësuar , kryen njdonjë ushtrimë apo problem në tabelë
3. Nxënësit motivohen pak për nxitjen maksimale të krijimtarisë së ttij
4. Nxënësin nuk shpalosin sa duhet individualitetin e tij.

Modeli pedagogjik modern paraqet sjellje të niveleve të larta, më të ndërlikuara në - objektiva:

- Në nivelet e analizës, sintezës dhe vlerësimit të fushës njohëse
- Në nivelert e organizimit dhe karakterizimit të fushës emocionale
- Në nivelet e artikulimit dhe natyralizmit të fushës psikomotore

Mësimdhënia moderne nënkupton ndryshimin e roleve të mësuesit dhe nxënësit me qellim kryesor –lehtësimi i të nxënit. (Musa. B. 1998)

Roli i mësuesit paraqitet në këtë mënyrë: mësuesi orienton, udhëzon, ndihmon, nxit nxënësit të bëjnë pyëtje, biseson, diskuton dhe shkëmben ide, stimulon të mënduarit kritik të nxënësit, menaxhon, organizon, mbykqyr dhe mështet; është partner në omunikimin dhe ndërveprimin në klase, ushtron nxënësit për një vlerësim të pavarurtë arritjeve në veprimtarinë e tyre.

Në modelin pedagogjik modern kthehet në qendër të vemendjes duke u shëndrruar në epiqendër të gjithe veprimtarisë së mësimdhënies dhe mëismnxënies. Rolet e nxënësit shfaqen në këto trajta: nxënësi përfshihet, vepron, bën pyetje dhe kërkon përgjigje, diskuton, arsyeton dhe argumenton, përfshihen në mënyrë aktive në procesin e nxenies dhe me metoda intëraktive, nënësit kanë të drejta të marrin nisma.

Krahasimi i dy modeleve tradicionale dhe modern nuk mund të jetë i plotë nëse do të qendrojmë vetëm në nivelin e roleve të nxënësit dhe mësuesit. Në këtë kontekst e shikojmë të udhës të bëjmë edhe një krahasim mes kurrikulave. Kjo është e nevojshme, sepse kurrikula është baza e gjithë modelit pedagogjik.

**Ku është e fokusuar kurrikula tradicinale?**

- Fokusohet në inpute, tek mësuesit, lëndët akademike dhe në vlerësime përgjithësuese.
- E ndarë sipas lëndëve dhe udhëzuar sipas tyre.
- E ngurtë në strukturë dhe në shpërndarjen e kohës
- Ekskluzivisht udhëzuese dhe e centralizuar

- E fokusuar në nevojat "skolastike"
- Kujdeset për memorizimin dhe riprodhimin e saktë të dijes së parafabrikuar.
- I jep përparësi perspektivës teorike, metodologjisë konformiste, uniformitetit dhe metodologjisë jashtëkatedrës.

**Ku është e fokusuar kurikula moderne?**

- Fokusohet në output-e, në rezultatet e të mësuarit/nxënit dhe tek nxënësit.
- E përcaktuar ndërmjet fushës se gjerë të të nxënit dhe metodologjisë kroskurrikulare
- Fleksibël në strukturë dhe shpërndarje kohore
- Lejon fleksibilitet, bazuar në nivele dhe në lloje të ndryshme të autonomisë lokale në kuadër të disa parimeve dhe standardeve cilësore.
- E hapur ndaj komunitetit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës
- Kujdeset për aftësi intelektuale të një niveli të lartë, nxitjen dhe promovimin e aftësive sociale, emocionale, shpirtërore teknologjike, praktike, motorike, artistike etj.
- Fokusohet në vlerësimin e formatit të përmbajtjes dhe të progresit i jep përparësi metodologjisë pjesëmarrëse dhe ndërveprimin.
- I jep përparësi metodologjisë komplekse nëpërmjet të cilave teoria është e lidhur me praktikën, aplikimin dhe zgjidhjen e problemeve
- Kujdeset dhe edukon krijimtarinë
- Kujdeset për individualizimin e të mësuarit

Siç edhe kemi thënë edhe më përpara realiteti kurrikular, zakonisht duket më shumë si një enigmë e elementeve me karakteristika të të dyja llojeve: tradicionales dhe modernes. E thënë kështu kjo nuk kundërshton një kalim evident të bërë rishtas në këto vite nga një model kurrikular i orientuar drejt tradicionales tek një model më inovativ. Natyrisht që nuk është e vërtetë që kurrikula tradicionale nuk ka nxitur dhe promovuar kreativitetin, pasi ne nuk do të kishim pasur mundësi të bënim progres si specie nëse të gjithë kurrikulat e të shkuarës në mënyrë sistematike do të bllokonin përpjekjet tona për të zbuluar "territore" të reja dhe të përmirësonim jetën tonë. Në kundërshtim me përfundimet e nxjerra nga shumë zhvillues të traditës moderne, tradicionalistët gjithashtu kanë krijuar kushte për të zhvilluar aftësi emocionale, sociale dhe intelektuale të një niveli të lartë megjithëse përpjekjet e tyre kanë qenë krejt të ngathëta dhe të bazuara në shpenzim energjish dhe përpjekjesh të shumta. Është thelbësore që ne t"i konsumojmë të gjitha këto krahasime ndërmjet "tradicionales dhe modernes" dhe të pranojmë se ajo që dominon punën kurrikulare në të gjithë botën është një

model i përzier që manifestohet ndryshe i varur nga kushtet kulturore sociale dhe mjedisore që na rrethojnë. 11 Cilave sfida mund t"u paraprijnë hartuesit e kurrikulave dhe çfarë mundësish të reja mund të mirëpresim në të ardhmen? Studiuesit e huaj vërejnë me mprehtësi se "... meqenëse nuk mund ta parashikojmë të ardhmen, kjo nuk do të thotë që na lejohet ta injorojmë atë".

**Metodat dhe teknikat e mësimdhenies së shkollës shqipe sot.**

Metodat kanë rëndësinë e vecantë në teorinë dhe praktikën mësimore pai ato përcjellin ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor. Ato konsiderohen mënyrë, mjet dhe formë veprimi në procesin e zhvillimit të një ore mësimore.

sMetodat ndahen në ato verbale, ilustrative, demostrimit, eksperimentale dhe laboratorike Mënyrat dhe teknikat e mësimdhënies në shkollat shqipe sot është kanë marrë një zhvillim pasi nxënësit janë në qëndër dhë mësuesit janë nxitës dhe mbykqyrës. Disa nga teknikat janë: stuhi mendimesh, marëdhënia pyetje – përgjigjë, di – dua të di – mësova, harta e koncepteve, imagjinata e drejtuar, tryeza e rrumbullakët, kubimi.

**Nivel i lartë i të menduarit dhe problem – zgjidhja.**

Përmbajtja kurrikulare e nxit fëmijën të vëzhgojë, të sistemojë, të mbledhë, të krahasojë, të vlerësojë evidenca., të bëjë pyetje, të identifikojë informacionin themelor, të përmbledhë esencën e një problemi, të sugjerojë zgjidhje, të japë gjykime të bazuara mbi informacione të sakta. Këto veprimtari ndihmojnë në arritjen e niveleve të larta të të menduarit, të tilla si: aftësia për të përmbledhur, për të analizuar, për të bërë konkluzione dhe deduksione, si dhe për të interpretuar me gjuhë figurative.

**Modeli PISA**

PISA merr në studim nxënës të moshës 15 vjeçare pasi në shumicën e vendeve arsimi i detyrueshëm përfundon, dhe ky është qëllimi i PISA-s. Këto dije të detyrueshme a do t'i shërbejnë në jetë nxënësve dhe a do të dijnë ato t'i vendosin ato njohuri në jetë. PISA është studimi më i madh ndërkombëtar në botë për arsimin. Ajo mat arritjet e nxënësve në Lexim, Matematikë dhe Shkencë.

**Rëndësia e pjesëmarrjes në PISA**

Pjesëmarrja e Shqipërisë dhe Kosovës.

Shqipëria morri pjesë për herë të parë në modelin Pisa në vitin 2000, nuk ka marr pjesë rregullish në testimët të janë bërë nga Pisa, bëri një shkëputje për vitët 2003 dhe 2006, për arsye të ndryshme dhe më pas morri pjesë përsëri në vitin 2009 , 2012 dhe 2015.

Ndërsa Kosova morri pjesë për herë të parë në vitin 2015.

Meqënëse nuk ka një shtrirje të rregullt të të dhënave, në këtë studim do të përqendrohemi më shumë te vlerësimi i fundit, PISA 2015, si dhe te vlerësimet që ka marrë pjesë Shqipëria, vendi te i cili e kemi fokusuar këtë studim dhe kemi interesin. Shqipëria, në krahasim me vitet e mëparshme, ka pësuar rritje të theksuar të arritjeve të nxënësve në këtë test. Ekziston një lidhje mes përmirësimit të kësaj përformance dhe ndryshimeve të sistemeve të arsimit, ku kjo lidhje do të jetë dhe pikë kryesore e këtij punimi.

Aftësia në matematikë ka qënë në fokus në PISA 2012. Vlerësimi i tyre është bërë në këto nënfusha të matematikës: formulimin, përdorimin, interpretimin, ndryshimet dhe marrëdhëniet mes madhësive, hapësirë dhe formë, ana sasiore, të panjohurat dhe të dhënat (OECD, 2013). Në Pisa 2000 ndarja është bërë duke marrë parasysh ndarjen në 6 nivele ,pavarësisht se në PISA 2009, PISA 2012 dhe PISA 2015 kemi 7 apo 8 nivele vështirësie. Kjo ndarje është bërë për efekt unifikimi të niveleve për secilën prej aftësive që merr në studim PISA dhe ky unifikim është bërë duke u bazuar në pikët që i përkasin secilit prej niveleve të vështirësisë.

**Përqindjet e nxënësve shqiptarë në secilin prej nivele të vështirësisë në matematikë**

| **Pisa** | **Vendet pjesëmarrëse** | **Niveli 1 Më pak se 357.77 pikë** | **Niveli 2 357.77-420.07 pikë** | **Niveli 3 420.07-482.38 pikë** | **Niveli 4 482.38-544.68 pikë** | **Niveli 5 544.68-606.99 pikë** | **Niveli 6 Mbi 606.99 pikë** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pisa 2009 | Shqipëria | 40.5% | 27.2% | 20.2% | 9.1% | 2.6% | 0.4% |
| Pisa 2012 | Shqipëria | 32.5% | 28.1% | 22.9% | 12.0% | 3.6% | 0.8% |
| Pisa 2015 | Shqipëria<br>Kosova. | 26.3 %<br>48.7% | 27.0 %<br>29.0% | 25.4%<br>16.5% | 14.8 %<br>5.1% | 5.4 %<br>0.7% | 1.1 %<br>0.0% |

Nxënësit shqiptarë kanë pësuar rritje në performancën e tyre, por natyrshëm lind pyetja cilët prej faktorëve e ka dhënë këtë ndryshim. Ndryshimi i shpeshtë i kurrikulës sa mund të jetë i mirë pasi orientohet drejt cilësisë, po ashtu edhe i dëmshëm pasi të njëjtët nxënës janë të detyruar të studiojnë në sisteme të ndryshme arsimore.

Pjesëmarrja në PISA është e rëndësishme, sepse rezultatet mund të përdoren për të vlerësuar:

• sa mirë janë të përgatitur nxënësit në Kosovë dhe në Shqipëri në këtë fazë të përfundimit të shkollës?

• cilat janë drejtimet në të cilat duhet të përmirësohen shkollat tona, sistemet qeverisëse dhe politikat arsimore në të ardhmen?

**Pisa në Kosovë dhe Shqipëri**

- Një mundësi për t'u angazhuar me politikat e arsimit dhe kolegët e arsimit nga e mbarë bota
- Për të nxjerr dobi maksimale, transparenca dhe dialogu publik janë thelbësor
- Përgatitja para nxjerrjes së rezultateve dhe planifikimi i hershëm i shpërndarjes janë gjëra të rëndësishme.
- Është i rëndësishëm angazhimi i të gjithëve : politikëbërësve, mësimdhënësve dhe shkollave, nxënësve dhe prindërve, mjeteve të informimit, komunitetit hulumtues

Një  shembuj të problemit matematikorë të trajtuar në modelin Pisa: Këtu shihni një fotografi të një ferme me çati në formën e një piramide.



Më poshtë, për nxënësit, jepet modeli matematikor i **çatisë** së fermës, ku janë shtuar matjet.




Kati i papafingos, katërkëndëshi ABCD në model, është katror. Shtyllat tek të cilët mbështetet çatia janë brinjët e bllokut (prizmit drejtkëndor) EFGHKLMN. E është në mes të AT, F në mes të BT, G në mes të CT dhe H në mes të DT. Të gjithë brinjët e piramidës në model kanë gjatësi prej 12 metra.

**PYETJA 1:** Llogarisni sipërfaqen e dyshemesë së papafingos ABCD. Sipërfaqja e dyshemesë së papafingos ABCD = m$^2$

**PYETJA 1:** Llogarisni gjatësinë e EF, atë të brinjëve horizontal të bllokut. Gjatësia e EF = __ m

**Pyetja 1**: Përgjigja në mënyrë të saktë në këtë pyetje korrespondon me një vështirësi prej 492 pikësh në shkallën e PISA-s për matematikën. Në vendet e OBEZH-it, 61 % e nxënësve i janë përgjigjur në mënyrë të saktë. Për t'iu përgjigjur pyetjes në mënyrë të

saktë, nxënësit duhet të mbështeten në aftësitë nga grupi (kllasteri) i kompetencave të shumëzimit.

**Pyetja 2**: Përgjigja në mënyrë të saktë në këtë pyetje korrespondon me një vështirësi prej 524 pikësh në shkallën e PISA-s për matematikën. Në vendet e OBEZH-it, 55 % e nxënësve i janë përgjigjur në mënyrë të saktë. Për t'iu përgjigjur pyetjes në mënyrë të saktë, nxënësit duhet të mbështeten në aftësitë nga grupi (kllasteri) i kompetencave të lidhjeve.

**Përfundimet:**

1. Matematika është një ndër shkencat që kërkon gërshetimin e njohurive terike me zbatimin praktik, kjo gjë është vënë re që në lashtësi.
2. Modelet pedagogjike, shpeshherë, kushtëzojnë teknikat e mësimdhënies, kjo sidomos në matematike, por pa lënë edhe fushat e tjera të shkencës.
3. Tradita arsimore në botë, deri më sot, njeh dy modele kryesore, atë lindor dhe atë perendimor.
4. Modeli pedagogjik i ofruar në traditën mësimore shqiptare ka qenë i fokusuar në zotërimin e njohurive teorike, ndonjëherë edhe përtej asaj që planifikonte kurrikula.
5. Modeli pedagogjik i sotshëm është në harmoni me modelin perendimor, kjo ka bërë të mundur edhe reformimin e sistemit kurrikular.
6. Teknikat e mësimdhenies janë në përputhje të plotë me parimet e kurrikulës me kompetenca, duke e bërë nxënësin jo më një object, por një subject mëson, zotëron, vepron dhe është i aftë për jetën.
7. Një tregues i rëndësishëm i dallimit të modeleve pedagogjike, në traditën tonë arsimore, janë rezulatet e PISA – së.
8. Rezulatet e PISA –së janë tregues edhe i mangësive dhe arritjeve të sistemit tonë kurrikular, sidomos kjo në fushën e matematikës.
9. Duke krahasuar rezualtet e PISA –së nga një testim në një tejtër vihet re se kemi një përmirësim të dukshëm në Shqipëri nga vitin 2012 në vitin 2015.
10. Rezulatet PISA – së tregojën së në Kosovë ka ende shumë punë për të bërë, kjo nuk do të thotë se në Shqipëri nuk ka punë për të bërë.

11. Në shembujt e marrë në shqyrtim vihet re se mangësitë në dhënien e përgjigjeve lidhen me aktualizimin e njohurive me zbatimin e tyre praktik.

**Literaturë:**


1. Basic Education Program, *Modele detyrash nga programi Pisa*, Prishtinë 2014
2. Bardhyl, Musai, *Metodologjia e mësimdhënies*, CDE, Tiranë 2014
3. Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Programi i lëndës së matematikës, kl.II,* Tiranë, 2004 (format pdf).
4. Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Programi i lëndës së matematikës, kl. X, (për shkollat profesionale),*Tiranë, 2009 (format pdf).
5. Mula, Melinda, *Matematika dhe mësimdhënia e matematikës (udhëzues për klasat 6 – 9),* MASHT, Prishtinë, 2011 (formati pdf).
6. MAST, *Kosova në PISA 2015, Ndikimi i vlerësimit të nxënësve në cilësinë e arsimit*, Prishtinë, 2015.
7. Mema, Kadija, *Shqipëria dhe Pisa: Çfarë ndryshimesh duhen bërë për një prezantim më të mirë të nxënësve tanë në matematikë?* (Punim doktorature), Tiranë, 2018 (foramti pdf).
8. Xhajkovska, Branka, *MATEMATIKA nëpërmjet lojës*, *Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore Hap pas hapi*, Shkup, 2016.

Shaska, Bedri; Shaska, Tanush, *Mësimdhënia e matematikës nëpërmjet problemeve klasike,* Albanian Journal of Ma

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

# TREATMENT OF CHILDREN WITH DISABILITIES IN ALBANIA BEFORE THE 90S

**Dr. Orneda Gega**

Universiteti i Durrësit Fakulteti i Edukimit

**Abstract**

In order to accomplish this work, were used documents of the Central State Archive, various studies, reports and statistical data from INSTAT, focusing on the treatment of children with disabilities for the pre-communist period and length of time.

The purpose of this paper is to reveal through documents the forms of treatment of children with disabilities in Albania and throughout the communist regime.

During this paper, will we answer some questions?

What was the document that determined whether a child was an anomaly or not?

How were these children treated initially?

What was the model by which they were treated?

What was the institution that treated them?

How Much Can They Be Integrated into Society?

The research findings highlighted the fact that in 1928 the treatment of children with disabilities was directly related to the determination made by Binet on child development since fetal birth, 0-6 months, 6-2 years and a half, 30 months, 2 years of age up to 15 years old by determining what are the developmental characteristics for each age.

Through the above definition it could be possible to assess whether the child's intelligence is related to "premature or delayed".

Later in the following years 1936, 1937, there were documents containing information on how the children were diagnosed and treated by the doctor in cases of illnesses such as malaria, swine, bronchopneumonia, pneumonia, diarrhea, poisoning, dermatitis, egzema. , who recommended the measures advisable, but these documents did not address the cases of children with disabilities.

After the 1950s, the only way to treat people with disabilities was through a medical model and set up in institutions. In these institutions, the number of persons with disabilities was very low compared to their total number, the latter being related to the Albanian mentality because the first of their careers was their own family.

*Key words: treatment, integration, institutions, medical model, disability.*

**ABTRAKT**

Për të realizuar këtë punim janë përdorur dokumeta të Arshivës Qëndrore të Shtetit, studime të ndryshme, raporte si dhe të dhëna statistikore nga INSTAT, fokusuar në trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar për perjudhën para dhe gjatëregjimit komunist.

Qëllimi i këtij punimi është të zbulojë nëpërmjet dokumentave se cilat ishin format e trajtimit tëfëmijëve me aftësi të kufizuar në Shqipëripara dhe gjatë perjudhës së regjimit komunist.

Gjatë këtij punimi do ti përgjigjemi disa pyetjeve?

- *Cili ishte dokumenti i cili përcaktonte nëse një fëmijë paraqiste anomali ose jo?*
- *Si trajtoheshin këta fëmijë fillimisht?*
- *Cili ishte modeli nëpërmjet të cilit trajtoheshin ata?*
- *Cili ishte institucioni i cili i trajtonte ato?*
- *Sa mund të integroheshin ato në shoqëri?*

Rezultatet e hulumtimit theksuan faktin se në vitin 1928 trajtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuarlidhej drejtpërdrejtë me përcaktimin e bërë nga Binet mbi zhvillimine fëmijës që nga krijimi i fetusit, 0-6 muaj, 6-2 vjeç e gjysëm, 30 muajsh, 2 vjeç e me radhë deri në 15 vjeç duke përcaktuar se cilat janë karakteristikat zhvillimore për çdo moshë.

Nëpërmjet përcaktimit të mësipërm mund të bëhej e mundur që të vlerësohej nëse inteligjenca e fëmijës lidhet me "*parapjekurinë a në vonim*".

Më vonë në vitet pasardhëse 1936, 1937 gjendeshin dokumenta të cilët përmbanin të dhëna se si identifikoheshin dhe trajtoheshin fëmijët nga mjeku në raste të sëmundjeve të tilla si: sëmundja e malarjes, gripë, broncopneumonia, pneumonia, diarreja, helmimet, dermatits, egzema etj., i cili rekomandonte masat e këshillueshme, por këto dokumenta nuk trajtonin rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Pas viteve ’50 mënyra e vetme e trajtimit të personave me aftësi të kufizuar ishte nëpërmjet modelit mjekësor dhe të vendosur nëpër institucione. Në këto institucione numri i personave me aftësi të kufizuar ishte shumë i pakët krahasuar me numrin total të tyre, kjo e fundit lidhej me mentalitetin shqiptar pasi për ta institucioni i parë që kujdesej ishte vetë familja e tyre.

*Fjalët Kyçe: trajtim, integrim, institucione, modeli mjekësor, aftësi e kufizuar.*

- ***FILLIMET E TRAJTIMIT TË PROBLEMATIKAVE QË HASNIN FËMIJËT GJATË REGJIMIT KOMUNIST…….***

Sipas dokumentave arkivorë, në vitin 1928 me “*shëndetësi shpirtënore-mendore, kuptojmë zhvillimin e shpirtit dhe të mendjes siç e pranon psyho-fisiologija, shkencë e bazueme në eksperiencë* ” [204]

Fusha e shëndetësisë shpirtërore-mendore shikohej si një fushë tepër e gjërë dhe përfshintegjithçka që lidhet me jetën shpirtërore të njeriut.

*Qëllimi i shëndetësisë shpirtërore-mendore ka të bëjë me ndihmën që mund ti jepet shpirtit dhe mëndjes së jeriut, dhe përgjithësisht për drejtuar jetën shpirtërore -mendore sipas zotësisë së vetë individit, kështu mund të shërohet dhe të bëhet individit i aftë.*[205]

Në këtë dokument theksohen anët negative dhe pozitive të shkencës së re, kështu ana pozitive ka të bëjë me faktin që ndihmon shpirtin dhe mëndjen njerëzore duke e drejtuar individin sipas qëndrimit dhe aftësisë që ka, në mënyrë që të bëhet sa më e aftë dhe ajo që është më e rëndësishme të shërohet. Ndërsa ana negative lidhet me faktin që ne nuk jemi të aftë të parandalojmë dhe të luftojmë shkaqet që mund të sjellin probleme mendore.

Ky dokument e krahason gjëndjen shpirtërore të njeriut me drejtimin e një anije. Kështu, për të qënë të aftë për të drejtuar një anije, duhet të njohim mekanizmat e anijes, hollësirat ë lëvizjes së mekanizmave e përgjithësisht duhet të njohim gjithçka që lidhet me funksionimin e kësaj anijeje. E njëjta gjë ndodh edhe me shëndetësinë për ta drejtuar mirë duhet të dimë si

[204] AQSH, F.251, V.1928, Dosje 318, Fq. 1
[205] AQSH, F.251, V.1928, Dosje 318, Fq. 2

është e ndërtuar ajo, si funksionon, cilët janë shkaqet pët të cilët ndonjëherëe humb ekuilibrin dhe e detyron që të rrëzohet, si dhe duhet të dimëse si është e mundur që ti luftojmë dhe ti zhdukim këto shkaqe.

Gjëndja shpirtërore mendore është më e ngatërruara, më e hollë dhe më e prehtë, dhe mund të thuhet se është një labirint i vërtetë.

Profesori Z. Legendre thotë "*Afro të gjthë njerëzit kanë nji të came e të metë të vogël e të madhe në gjykim e në llogjikë. Ndryshimi asht në këtë; se disa munden me e mshehë këtë të came e të metë më mirë nga të tjerët*"

Ky mendim mbi mos-ekuilibrimin e njerëzve, fsheh diçka nga e vërteta, diagnostikimin apo egzminimin siç gjëndet nëpër dokumenta se si bëhet evolucioni fiziologjik i zhvillimit shpirtëror e mendor dhe se si rritet truri në perjudhën e zhvillimit, sipas Binet.

Pra, në dokumetat arkivorë të vitit 1928 për çdo moshë nga perjudha e krijimit të fetusit deri në moshën 15 vjeçare përcaktoheshin se cilët ishin karakterisikattë cilat kishin të bënin me një zhvillim normal.

Foshnja kur gjëndet në barkun e nënës, është gjithmonë në një gjumë pa ëndrra. Lëvizjet e kësaj foshnje janë krejt automatike dhe nuk varen nga zhvillimi i trurit.[206]

*Fëmija* pas lindjes nuk shfaq ndonjë shenjë që mund të thuhet se kupton.

*Në perjudhën 0-6 mujore* zhvillimi i trurit shtohet me një mesatare të madhe. Prekja, lëvizja, vullneti dhe shfaqja e kuptimit përparojnë, duke dëshmuar se sistemi nervor, pak nga pak prefeksionohen.

*Në perjudhën 6 muajsh – 2 vjeç e gjysëm*, truri, palca e kurrizit vazhdojnë të perfeksionohen. Kështu shtohen ndjenjat, kuptimi dhe lëvizja.

*Fëmija 30 muajsh* fillon të flasë, para se të mbushi 2 vjeç fëmija përgjigjet kur e pyesin për syrin, hundën, gojën etj. Gjithashtu di të zbatojë një porosi të vogël.

*Në moshën 2 vjeçare* fëmija fillon të jetëi pastër si dhe fillon të kryejë nevojat e veta fizike në banjo.

*Në moshën 3 vjeçare* fëmijët janë të aftë që të përsërisin dy numra, të përsërisin gjashtë rrokje, të tregojnë emrat e familjarëve, të njohin familjarët.

*Në moshën 4 vjeçare*fëmijët janë të aftë të tregojnëse cila është gjinia e tyre, tëemërojnë një çelës, një thikë, lekët, të përsërisin tre numra, të barazojnë dy vija, të tregojnë e të shpjegojnënjë figurë, të numërojnë lekët,

[206] AQSH, F.251, V.1928, Dosje 318, Fq. 3

*Në moshën 5 vjeçare* fëmijët mund të barazojnë dy kutia që kanë peshë të ndryshme, të tregojnë kush ka peshë më të madhe, të kopjojnë, të përsërisin fraza me dhjetë rrokje, të numërojnë katër lekë.

*Në moshën 6 vjeçare* fëmijët kuptojnë se cilaështëdora e djathtë, cili është veshi i majtë, të përsërisi një frazë prej 16 rrokjesh, të emërojë objekte, të zbatojë porosi, të thotë moshën e tij, të kuptojë mëngjesin nga mbrëmja.

*Në moshën 7 vjeçare* fëmijët janë në gjëndje të tregojnë vëndet që në figurëjanë bosh, të llogarisi gishtat, të kopjojë një romb, të përsërisi 5 numra.

*Në moshën 8 vjeçare*fëmijëtmund të lexojnë, të mbajnë mënd çfarë lexuan, të japi shumën e përgjithshme të lekëve që ka numëruar, të emërojë katër ngjyra, të numërojë mbrapsh nga numri 20 deri te 0, të shkruajë një pjesë duke ia diktuar.

*Në moshën 9 vjeçare*fëmijëtjanë në gjëndje të tregojnëdatën e saktë, të shkruaj ditët e javës, me dhënë kusurin prej 20 lekësh, me vendos në rregull pesë kutia sipas peshës së tyre.

*Në moshën 10 vjeçare*fëmijëtjanë në gjëndje tënumërojnë muajt e vitit, të krijojnë dy fraza,

*Në moshën 15 vjeçare*fëmijëtjanë në gjëndje të përsërisin shtatë numra, të përsërisi një frazë prej 26 rrokjesh, të shpjegojë një figurë, të zgjidhi një problem psikologjik.

Nëpërmjet këtij përcaktimi mund të përcaktohet nëse inteligjenca e fëmijës është më e zhvilluar se normalja apo është më e vonuar se normalja.

Nëse një fëmijë ka një zhvillim i cili në raport me moshën kronologjike dy vite me pak atëherë duhet konsideruar si fëmijë anormal.

Në momentin që diagnostikohej një fëmijë si anormal sipas dokumetave arkivorë ishin mjekët ata të cilët trajtonin rastet.

Më vonë në vitet pasardhëse 1936, 1937 gjendeshin dokumenta të cilët përmbanin të dhëna se si identifikoheshin dhe trajtoheshin fëmijët nga mjeku në raste të sëmundjeve të tilla si: sëmundja e malarjes[207], gripë, broncopneumonia, pneumonia, diarreja, helmimet, dermatits, egzema etj., i cili rekomandonte masat e këshillueshme.[208] por jo trajtim të fëmijëve më nevoja të veçanta.

## 〉 *SITUATA E ARSIMIMIT TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË VITET 1944-1990, PERJUDHA E REGJIMIT KOMUNIST*

[207] AQSH, F. 402. V. 1936; Dosja 321 Fq 1
[208] AQSH, F. 402. V. 1937; Dosja 721 Fq 3

Mund të themi se Shqipëria[209] ka trashëguar nga e kaluara një mentalitet i cili nuk favorizonte në asnjë aspekt trajtimin dhe arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky mentalitet buronte nga një nivel i ulët social - kulturor që karakterizonte familjet, shoqërinë dhe së fundmi politikën e asaj kohe. Këta tre elemenetë të rëndësishëm kanë ndikuar në mënyrën e trajtimit, vlerësimit dhe arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë kësaj periudhe. Në shumë zona, lindja e një fëmije me aftësi të kufizuara konsiderohej një mallkim apo dënim i zotit dhe për pasojë familjarët ndjeheshin të turpëruar përballë shoqërisë, inferior, të paragjykuar. Për shumë familje të pasurit e një fëmije me aftësi të kufizuara konsiderohej një turp dhe ndëshkim nga zoti. Këta fëmijë mbaheshin të izoluar në shtëpi, "larg syve të botës", larg nga komuniteti. Familja ishte i vetmi institucion që siguronte kujdes për fëmijët me aftësi të kufizuara në këtë periudhë. Nga ana tjetër edhe shoqëria me qëndrimet e sjelljen e saj, paragjykimin, stereotipizimin, indiferentizimin, diskriminimin, përjashtimin e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre e ka përkeqësuar e rënduar së tepërmi situatën e tyre.
Gjatë viteve të regjimit komunist, aftësia e kufizuar në Shqipëri konsiderohej si një problem shëndetësor. Ata trajtoheshin kryesisht si të sëmurë, që do të thotë se ata kishin nevojë vetëm për trajtim dhe kujdes shëndetësor. Ky ishte modeli mjekësor duke lënë jashtë vëmendjes çdo nevojë tjetër të tyre për arsimim, për argëtim etj. Kjo vërtetohej më së miri me faktin se të gjitha institucionet e kujdesit për individët me aftësi të kufizuara në ato vite ishin nën varësinë Ministrisë së Shëndetësisë dhe ishte e vështirë të mendohej arsimimi, punësimi dhe përfshirja e tyre në radhët e shoqërisë.[210]

Përjashtim bënin vetëm personat me aftësi të kufizuar të cilët kishin përfunduar arsimin e lartë. Kështu, ka pasur profesione të veçanta për persona me aftësi të kufizuara që mbaronin arsimin e lartë, si ai i ekonomistit/financierit, për të cilët më tej garantohej edhe vëndi i punës. Po kështu ka patur procese pune dhe reparte të veçanta, ku bëhej i mundur punësimi i personave me aftësi të kufizuar. [211]

Ndërkohë përsa i përket aftësimit të tyre social, shoqëror, integrimin e tyre në shoqëri për atë perjudhë mund të flitet fare pak. Sipas Raporteve studimore rezultonte se asnjë përpjekje nuk u bë në atë kohë për të aftësuar personat me aftësi të kufizuara të luajnë një rol në shoqëri. Sistemi i përfitimeve të asaj kohe ishte i mjaftueshëm për të mbuluar nevojat bazë të tyre

---

[209] Ëorld Vision, E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithpërfshirës, mars 2012 Fq, 16
[210] http://medpak.org/ëeb/ëp-content/uploads/2016/09/nje-bote-ndryshe2.pdf
[211] Raport, Vlerësim I gjëndjes së riaftësimit dhe përfshirjes sociale për personat me aftësi të kufizuara në njësitë administrative vendore Laç, Lezhe, Vau I Dejës "*Të jesh aktiv pa barriera*" Tiranë Korrik 2015

(Olsen, 2000), kur krijohej mundësia, personat me aftësi të kufizuara të rënda dërgoheshin në institucione rezidenciale, pamja e të cilave e transmetuar nga mediat ndërkombëtare shokoi mbarë opinionin në fillim të viteve ’90.Rreth 200 persona me aftësi të rënda mendore, mbaheshin të izoluar në 6 institucione rezidenciale. Numri i vogël i personave më aftësi të kufizuara në institucione lidhet si me mungesën e burimeve financiare, por edhe me traditën e familjes shqiptare për t’u kujdesur e “mbrojtur” personin me aftësi të kufizuar (Flagler, 2009)[212]

Orientimi i këtyre shërbimeve ishte kryesisht në drejtim të kujdesit për nevojat e përditshme të individëve me aftësi të kufizuar, sigurimi i strehimit dhe ushqimit, asistimit të tyre zakonisht përmes një strukturë të institucionalizuar, pa bërë asnjë përpjekje për riaftësimin dhe integrimin e tyre. Këta individë konsideroheshin totalisht të varur,të paaftë, duke inspiruar në këtë mënyrë ndjenja keqardhjeje dhe mëshire për ta. Ata shpesh shikoheshin si invalidë, trajtimi arsimor i të cilëve nuk përbënte një konsideratë primare për shtetin dhe shoqërinë. Si në shumë vende të tjera europiane edhe në Shqipëri kujdesi për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara është zhvilluar jashë sistemit arsimor dhe tradicionalisht për shumë vite, ata kanë qëndruar jashtë këtij sistemi. Aftësia e kufizuar trajtohej si një sëmundje dhe nuk kishte asnjë formë tjetër trajtimi për të.[213]

Kjo tablo sigurisht që nuk mund të ishte ndryshe edhe kur flitej për politikën e shtetit të asaj kohë.[214] Nuk kishte asnjë politike sociale që mbështeste dhe favorizonte drejtpërsëdrejt fëmijët me aftësi të kufizuara. Shoqëria shqiptare e asaj kohe nuk ishtë një shoqëri që i mirëpriste fëmijët me aftësi të kufizuara. Fëmijët me aftësi të kufizuara ishin objekt i keqardhjes së njerëzve, apo i ndonjë veprimi bamirësie apo dashamirësie. Gjatë periudhës së viteve 1950 dhe 1970, një rrjet insitucionesh të përkujdesjes për individët me aftësi të kufizuara u ngritën si një përgjigje e nevojave të tyre për trajtim mjekësor e përkujdesës.Në këto institucione ofrohej përkujdesje mjekësore. Statusi i këtyre individëve ndryshoi nga të qënit tërësisht të përjashtuar dhe të denigruar, ata “u trajtuan” dhe “u konsideruan” si të vlefshëm për t’u ndihmuar. Kjo ishte një pikënisje e rëndësishme për t’u shënuar në historinë e përkujdesjes së fëmijëve dhe të rinjëve me aftësi të kufizuara. Por nevojat e tyre sociale dhe e drejta për arsimim, ishin çështje të panjohura për politikën shtetërore të asaj kohe.

[212]Raport studimi, Përkujdesi shoqëror për personat me aftësi të kufizuara mendore, Tiranë Qershor 2011
[213] World Vision, E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithpërfshirës, mars 2012 fq. 15
[214] World Vision, E E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithpërfshirës, mars 2012 Fq, 16

*REFERENCAT*


- ✓ AQSH, F.251, V.1928, Dosje 318
- ✓ AQSH, F.402.V.1936; Dosja 321
- ✓ AQSH, F.402.V.1937; Dosja 721
- ✓ Historia e arsimit (2002) ISP
- ✓ Raport studimi, Përkujdesishoqërorpërpersonat me aftësi të kufizuara mendore, Tiranë Qershor 2011
- ✓ Raport, Vlerësim i gjendjes së riaftësimit dhe përfshirjes sociale për personat me aftësi të kufizuara në njësitë administrative vendore Laç, Lezhë, Vau i Dejës "Të jesh aktiv pa barriera" Tiranë korrik 2015
- ✓ World Vision, E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithpërfshirës, mars 2012
- ✓ http://medpak.org/web/wp-content/uploads/2016/09/nje-bote-ndryshe2.pdf


## FORMAT E PASHTJELLUARA FOLJORE TE „DICTIONARIUM LATINO-EPIROTICUM (1635) I F.BARDHIT


**Dorentina Xhafa**

Doktorante në Departamentin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, UT



### Abstrakt

Trajtesat gjuhësore të veprave të autorëve të vjetër të gjuhës shqipe janë të shumta dhe u përkasin fushave të ndryshme. Duke qenë se janë baza për studimin e historisë së gjuhës, ato janë parë në këndvështrime të ndryshme të gjuhësisë historike. Një ndër katër autorët e parë dhe me disa vepra të shkruara në shqipe, është Frang Bardhi. Fjalori i tij latinisht-shqip (*Dictionarium latino-epiroticum*) i vitit 1635 konsiderohet si vepra me të cilën zë fill edhe leksikografia shqipe dhe kishte si qëllim "*...me ndimuem mbë nja anë giuhënë tanë, gji po bdaretë e po bastardhonetë sā mā parë të ve e mā fort me ndimuem gjithë atyne gji janë nd urdhëni të Tinëzot e të Shintesë Kishë Katolike e s'dinë giuhënë latine...*" Punimi ynë, "Format e pashtjelluara foljore te *Dictionarium latino-epiroticum* (1635) i F. Bardhit", e trajton veprën në gji të gramatikës historike, duke e parë më së shumti si një objekt për studim morfonologjik. Në këtë punim janë marrë në shqyrtim format e pashtjelluara foljore. Për secilën prej tyre (për pjesoren dhe për format analitike të formuara me të si bazë) fillimisht janë sintetizuar mendimet e autorëve për prejardhjen dhe evolucionin e tyre. Pos pasqyrimit të formave të pashtjelluara foljore që gjenden te ky fjalor, kemi bërë studimin e

tyre sidomos në vështrim krahasues me format foljore të *Mesharit* të Gjon Buzukut. Krahasimet janë mbështetur kryesisht në ndërrimet e zanoreve të temës. Pra, janë vënë në qendër të vëmendjes së punimit ato forma, të cilat, përveç ndryshimit që kanë me shqipen e sotme, paraqesin qoftë një fazë evoluimi, qoftë një fazë ruajtjeje të formave foljore, të cilat kanë interes për evolucionin historik të formave foljore të shqipes.

**Fjalë kyçe:** forma të pashtjelluara, pjesore, temë, prapashtesë, zanore.

## Objekti dhe qëllimi

Gjuhëtarët kanë diskutuar mbi mjaft probleme lidhur me format e pashtjelluara foljore të shqipes[215]; lidhur me pjesoren dhe kuptimet gramatikore të saj; me formantet e trashëguara indoevropiane dhe me krijimet brenda shqipes; mbi faktin nëse ka pasur shqipja apo jo një paskajore të mirëfilltë sintetike si gjuhët e tjera indoevropiane; nëse e ka pasur apo jo dialekti i Jugut paskajoren analitike të tipit *me punue* që e ka gegërishtja; si dhe ç'ndryshime janë krijuar midis dialekteve në fushën e formave të pashtjelluara. Synimi i studimit tonë nuk është kritika mbi këto studime, pavarësisht se kemi bërë një përmbledhje të disa prej mendimeve të autorëve sidomos mbi çështjet e evolucionit të grupeve të zanoreve, por është pasqyrimi i formave të pashtjelluara foljore te *Fjalori* i Bardhit, parë edhe në këndvshtrimin krahasues me Buzukun. Si bazë për punimin na ka shërbyer botimi kritik i fjalorit nga Bardhyl Demiraj, i botuar në vitin 2008.

## Hyrje

Sistemi foljor i gjuhës shqipe përfshin disa forma të pashtjelluara, prej të cilave disa janë të trashëguara kurse disa të tjera janë krijuar në zhvillimin e brendshëm të gjuhës. Kështu, përveç pjesores, që është një formë sintetike, në këto forma përfshihen edhe format analitike të tipit *pa punuar / pa punue*; përcjellorja *duke punuar / tue punue* dhe paskajorja *me punue*. Ka edhe disa forma të krijuara mbi bazën e mbiemrave prejpjesorë të emërzuar. Të tillë janë: paskajorja e tipit *për të qenë*, format *me të parë*, *një të dalë* dhe forma e gegërishtes e rasës kallëzore *ta pamen*.[216]

Punimi ka dy pjesë: I. pjesorja dhe II. format analitike me bazë pjesoren. Klasifikimi i tyre është bërë në bazë të prapashtesave, përkatësisht më: *-n*; *-ë*; *-të*; *-m*; *-në/-rë*; prapashtesa *-n$^{d}$ë*; *-un/-ur*; *-jtë*; *-tun/-tur*; *-jtun/-jtur*; *-mun* dhe *-nun*.

# FORMAT E PASHTJELLUARA FOLJORE

## I. Pjesorja

Termi *pjesore* (lat. *participium*) nënkupton format foljore që kanë natyrë të dyfishtë: foljore dhe emërore a mbiemërore, domethënë ato i përkasin pjesërisht sistemit foljor e pjesërisht sistemit emëror.[217]

[215] I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1969; F. Agalliu, *Pjesorja në gjuhën shqipe*, SF 2, 1972; B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes*, Prishtinë, 1998 etj.
[216] Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, f. 443-444.
[217] Topalli, *Sis. fol.* f. 444.

Gjuhëtarët tanë janë marrë me studimin e pjesores dhe një prej tyre, Aleksandër Xhuvani, jep pikërisht mendimin se shqipja nuk e ka pasur ose do ta këtë bjerrë pjesorën aktive sikurse ka bjerrë infinitivin dhe se shqipja e sotme ka vetëm një pjesore, atë të kohës së shkuar të përfektit dhe në çdo funksion të saj, si në formimin e kohëve të përngjitura, ashtu edhe në ndërtimin e lokucioneve të tjera, është e pandryshueshme ose e palakueshme, domethënë nuk shkon mbas gjinisë së ndonjë elementi të fjalisë, sikurse pjesorja e shkuar e gjuhëve latine.[218]

Selman Riza mbështet tezën e studiuesve paraardhës se në shqipen e lashtë trajta që merret sot vetëm si pjesore duhet të këtë qenë fillimisht edhe një formë e vjetër e infinitivit.[219]

Te *Fjalori* i Bardhit kemi një numër të madh foljesh që dalin në pjesore. Kryesisht temat e pjesoreve janë të njëjta me të kryerën e thjeshtë.

Foljet që dalin pa ndryshime zanoresh në të tashmen e dëftores kanë të njëjtën temë për të gjitha kohët; gjithashtu edhe për pjesoren, si: *çkul-ë, çpraz-unë, dëlir-unë, ec-unë, fal-ë, ftofunë, hapunë, hipunë, lagunë, lefunë, lidhunë etj.*

Tema e pjesores ndryshon nga e kryera e thjeshtë te foljet që në të kryerën e thjeshtë pësojnë apofoni kuantitative /-e-/, /ie/, /je/ ~ /-o-/ si te: *dierr- ~ dora*; *hjedh- ~ hodha*; *hjek- ~ hoqa*; *miel ~ mola*; *pështiell- ~ pështolla*; *piek- ~ poqa*; *piell- ~ polla*; *riep- ~ ropa*; *riedh- ~ rodha*; *viedh- ~ vodha*.

Tema e pjesores ndryshon nga e kryera e thjeshtë edhe te grupi i foljeve që dalin me të dyja llojet e apofonisë: kualitative dhe kuantitative: *dal ~ del ~ dola ~ dal*-ur; *marr ~ merr ~ mora ~ marrë*. Këtu zanorja bazë e këtyre foljeve është *-e-* ja e vetës së dytë e të tretë; zanorja *-o-* e së kryerës së thjeshtë shpjegohet me apofoninë kuantitative /*e*/ ~ /*ē*/, ku /ē/-ja ka dhënë /*o*/; kurse zanorja *-a-* e pjesoreve shpjegohet me apofoninë kualitative /*e*/ ~ /*o*/, ku /*o*/-ja ka dhënë /*a*/. Tema e pjesores me /*a*/ është shtrirë në vetën e parë të numrit njëjës për të krijuar dallimin me dy vetat e tjera.[220]

Foljet e zgjedhimit të tretë me tog zanor dalin në pjesore me zanore të diftonguar. Këto folje janë të shumta, si p.sh.: *afruem, besuem, biruem, bumbëlluem, çirkuem, çmuem* etj. Te të gjitha foljet që i gjejmë edhe te Buzuku, edhe te Bardhi, togu zanor /*-uo-*/ te Buzuku, te Bardhi ka evoluar në /*-ue-*/. Kemi pranuar se diftongimi i këtyre zanoreve ka ndodhur pikërisht në pjesore nga prapashtesa -n, e cila, duke u lidhur me zanoren *-o* të temës, ka krijuar lidhjen *-on*, ku zanorja zbërthehet në diftong (**blo-n > blue/blua-r*). Tema me zanore të diftonguar, kur ishte në fazën *-oų*, është shtrirë edhe dy vetat e para të së kryerës së thjeshtë, ku gjysmëzanorja *-ų-* e diftongut *-oų* është kthyer në fërkimoren *-v-*, meqënëse është ndodhur ndërmjet dy zanoreve, njëra e temës dhe tjetra e mbaresës vetore (**bloų -a > blova, *bloų-e > blove*).[221]

Në këtë grup përfshihen edhe format që pësojnë ndërrimin /e/ ~ /ye/, si: *gënjyem, këcyem, këthyem, ngallënjyem, shembëllyem, shërbyem, shkëlqyem*. Për këtë ndërrim fonetik, përgjithësisht nga gjuhëtarët, është pranuar teza e Majerit që e shikon diftongun *-ye-* si një zhvillim të mëtejshëm të diftongut *-ie-* me buzorëzimin e elementit të parë. Ndër këta gjuhëtarë është edhe Çabej, i cili thotë: ne, *ie* dhe *ye*, mund t'i shqyrtojmë së bashku, meqë kjo e dyta, siç shënohet te Meyeri e te Pekmezi, ka dalë historikisht nga e para me labializim të *i*-së. Nga një shqyrtim i rasave respektive shohim që *je*-ja, ashtu si *ie, ye* tek autorët e vjetër gegë të vjetrit ruhen të pandryshuar gjer te Bogdani.[222]

---

[218]Xhuvani, A., *Pjesorja në shqipet,* në Vepra I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980, f. 247.

[219]Riza, S., *Çështja e paskajores në shqipe,* Vepra 4, Prishtinë, 2004, f. 45-55.

[220]Topalli te *Sis. fol.* f. 447.

[221]Po aty, f. 448.

[222]E. Çabej, *Studime gjuhësore* IV, 1977, f. 120.

Disa folje të parregullta dalin në pjesore me temë të ndryshme nga e kryera e thjeshtë si: *ardhunë, dashunë*. Edhe këtu ndryshimi i zanores së temës shpjegohet me apofoninë kualitative, ku zanorja bazë është -e-ja e së kryerës së thjeshtë, kurse -a-ja e pjesores, që vjen nga -o-ja është zanorja e ndryshuar me apofoninë kualitative (/e/ ~/o/ =/e/ ~ /a/).

Gjithashtu, më trajta supletive dalin edhe format: *dhanë, kienë, ngranë,ndenjunë, pām, pasunë, prūm, rām.*

Pjesorja e shqipes, ashtu siç është analizuar edhe nga gjuhëtarët që janë marrë me këtë çështje[223], karakterizohet nga prapashtesa të shumta. Kështu, janë trajtuar si prapashtesa: prapashtesa *-n*; prapashtesa *-ë*; prapashtesa *-të*; prapashtesa *-m*; prapashtesa *-në/-rë*; prapashtesa *-n$^{d}$ë*; prapashtesa *-un/-ur*; prapashtesa *-jtë*; prapashtesa *-tun/-tur*; prapashtesa *-jtun/-jtur*; prapashtesa *-mun*; prapashtesa *-nun*.

Te *Fjalori* i Bardhit këto prapashtesa i gjejmë me shkallë të ndryshme përdorimi. Kështu, do të paraqesim më poshtë, sipas përdorimit më të madh, prapashtesat me të cilat janë formuar pjesoret (dhe format e tjera analitike me bazë pjesoren) në këtë tekst:

**- Me prapashtesën -m**

Kjo prapashtesë ka përdorimin më të madh. Burimi i kësaj prapashtese nga disa gjuhëtarë[224] është parë me burim nga një **-meno/-mo*, sipas shpjegimit të dhënë më parë nga gjuhëtarë të huaj. Është vënë re gjithashtu përdorimi i dendur i kësaj prapashtese tek autorët e vjetër. Këto trajta të pjesores me -m janë quajtur kështu participle të vjetra.

Burimi i saj nga indoevropianishtja është pranuar edhe nga K. Topalli, por, sipas tij, kjo prapashtesë nuk buron nga **-meno*, sepse kjo do të jepte në shqipe *-më* dhe jo *-m*. Kësisoj, burimin e saj ai e sheh te prapashtesa indoevropiane *-mo*. Forma e saj e parë dëshmon se kemi të bëjmë me një formë rasore, mbaresa e së cilës ka rënë në gjuhën shqipe. Kjo mund të jetë rasa emërore e gjinisë mashkullore. Ndërsa prapashtesa *-meno* mund të jetë reflektuar te një prapashtesë tjetër që formon emra prejfoljorë.[225]

Kështu, kemi një numër të madh trajtash që dalin me këtë prapashtesë: *bām, besuem, biruem, bumbëlluem, çirkuem, çmuem, çpeituem, dëftuem, dërguem, dëshëruem etj*.

Kjo prapashtesë ka ruajtur gjatësinë e zanoreve të temës si te: *bām, hīm,* lām, *mbërrīm, mbshām, mënīm, ngām, grīm, nxēm, nxīm, pām, pëgām, përtërīm, pīm, prēm, prūm, rām, shkrīm, shtȳm, thām, vrām, vūm, xbēm* edhe pse krijon rrokje të mbyllura.

Në grupin e foljeve që dalin me zanoret *-o* dhe *-ō* të diftonguara (*dërguem, dhunuem, forcuem, këcyem* etj.) kjo prapashtesë u është ngjitur këtyre temave pasi ka përfunduar procesi i diftongimit të temës nga sonantja *-n*, që është një prapashtesë më e hershme se *-m*-ja në këto fjalë[226]. Ky diftong, te Bardhi del *-ue-*, ndërsa te Buzuku *-uo-*; p.sh.

Buzuku: *afruom* (20 43), *besuom* (186 22), *çmuom* (306 62), *dëshëruom* (250 20), *forcuom* (288 22) etj.

Bardhi: *afruem* (115 4), *besuem* (16 13), *çmuem* (78 22), *dëshëruem* (17 3), *forcuem* (12 29) etj.

**- Me prapashtesën –unë**

[223]Shih autorët e cituar më lart.

[224]Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 399, Xhuvani, A. *Pjesorja në shqipet*, në Vepra I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980, f. 248; B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes*, Prishtinë, 1998, f. 36 etj.

[225]Topalli, *Sis. fol.* f. 460.

[226]Po aty, f. 459.

Është një prapashtesë mjaft e përdorur te Bardhi. Për formimin e kësaj prapashtese mendimet përputhen vetëm për burimin e prapashtesës -në (që e marrin foljet me tema në zanore ose tog zanor), ndërsa për burimin e -u-së mendimet janë të ndryshme. Për këtë Demiraj, Domi dhe Bokshi mendojnë se kjo zanore, në krye të herës do të jetë shtuar për lehtësi shqiptimi pas temash foljore, që dilnin me dy bashkëtingëllore, si bart-u-në, derdh-u-në etj., e më pas është shtrirë edhe te pjesoret e foljeve me temë në bashkëtingëllore, si hap-u-në etj.[227]

Edhe për këtë, Topalli mendon se forma e pjesores me prapashtesën *-unë / -urë* paraqet një krijim brenda fushës së pjesores, ku një prapashtesë e re i shtohet formës së pjesores kur prapashtesa e saj e vjetër e ka humbur fuqinë e saj. Prandaj, *hapunë* e *dekunë* janë formuar nga pjesoret *hapë* e *dekë* duke u shtuar këtyre formave prapashtesën *-në*; pra, hapë + *-në*. Si rrjedhim, zanorja *-u-* nuk është një tingull anaptitik, se pjesorja nuk formohet nga tema e së tashmes pa mbaresa (*hap, vdes*); por ajo përfaqëson prapashtesën -ë të pjesoreve me temë në bashkëtingëllore, që janë zgjeruar me prapashtesën *-në*. Kthimi i zanores së patheksuar *-ë* në *-u* është një dukuri e njohur e gjuhës shqipe. Ky proces mund të këtë nisur në temat me bashkëtingëllore grykore e buzore (*djegunë, hapunë*) dhe më vonë do të jetë përgjithësuar duke u marrë si pjesë e prapashtesës.[228]

Sidoqoftë, kjo prapashtësë është mjaft e përdorur te Bardhi dhe del në një numër të madh foljesh si: *avitunë* (6 7), *bdeshunë* (158 7), *begenisunë* (2 22), *brītunë* (12 13), *davitunë* (49 26), *derdhunë* (91 10), *dëlirunë* (45 11), *diegunë* (14 4), *druetunë* (85 23), *dhimtunë* (89 29), *grabitunë* (107 8), *grishunë* (41 21) etj.

**- Me prapashtesën -ë**

Për burimin e saj Xhuvani shpjegon se foljet që u mbaron tema me *l, ll, r, rr* e kanë trajtën e shkurtër të pjesores më *ë* si në toskërishte, ashtu edhe në gegërishte. Por ka edhe raste në gegënishte që te pjesoret më *-ur*, që nuk përdoret trajta e plotë më *-ur*, por trajta e shkurtuar më *-ë* si: *djegë, falë, lidhë* etj.[229]

Demiraj mendon se te pjesoret e tipit *dal-ë, marr-ë* etj. kemi gjurmë të pranisë së hershme të prapashtesës indoevropiane **-no*, që në shqipe e dëshmojnë pjesoret e disa foljeve me temë në bashkëtingëllore. Këto pjesore kanë qenë formuar me prapashtesën *-në* < **-no*. Nga kjo ka mbetur vetëm zanorja fundore /*-ë-*/, kurse bashkëtingëllorja /*-n-*/, e prirë nga bashkëtingëllorja e temës foljore /*-l-*/ ose /*-r-*/ i është nënshtruar një evolucioni fonetik, që ka përfunduar me mënjanimin e saj. Kjo pjesore me /-ë-/, më vonë, është shtrirë me analogji edhe te folje të tjera me temë në bashkëtingëllore.[230]

Topalli thotë se për origjinën e kësaj prapashtese duhet mbajtur parasysh se një *-ë* e patheksuar e gjuhës shqipe mund ta ketë burimin ose nga një *-ā* si mbaresë e emrave të rasës emërore të gjinisë femërore, ose te një rrokje *-on* < *-om* e rasës kallëzore dhe e gjinisë asnjanëse. Forma të tilla, që dalin me zanoren -ë, paraqesin formën e rasës kallëzore, ku mbaresa *-om* e trashëguar ka dhënë *-ë* në gjuhën shqipe.[231]

Kjo prapashtesë është përdorur gjithashtu te Bardhi dhe gjejmë rastet:
*Dalë* (96 20), *dierrë* (89 25), *falë* (21 11), *folë* (209 11), *këlbazë* (168 3), *marrë* (5 12), *mbëledhë* (1 28), *mbërshëlë* (12 8), *mbiellë* (142 24), *mielë* (62 11), *nçelë* (82 19), *nxierrë* (15

---

[227]Demiraj, *Gram. his.*, f. 404; B. Bokshi, *Pjesorja ...* f. 27; Domi, *Morf. his*., f. 64.
[228]Topalli, *Sis. fol.* f. 467.
[229]Xhuvani, A., *Pjesorja në shqipet*, në Vepra I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980, f. 249.
[230]Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe,* Tiranë, 2002, f. 404.
[231]Topalli, *Sis. fol.* f. 452.

4), *përmierrë* (57 11), *përshtiellë* (79 16), *piellë* (82 16), *siellë* (115 3), *shkelë* (9 27), *shqerrë* (175 18), *thirrë* (197 15), *vielë* (184 4), *viellë* (64 14), *vierrë* (113 7).

**- Me prapashtesën -n$^{d}$ë**

Për burimi e kësaj prapashtese, gjuhëtarët kanë mendime të ndryshme. M. Domi thotë se e ka burimin nga një *-n-* e dyfishtë, e cila është formuar nga një *-n* e temës dhe nga një *-n* mbaresë.[232] Demiraj mendon se prapashtesa *-në* në këto pjesore del nga evolucioni i një grupi bashkëtingëllor, i cili dikur duhet të ketë qenë */*nn*/ ose */*nt*/, ku elementi i parë */-*n*-/ ka qenë fundorja e temës foljore, kurse elementi i dytë */-*n*-/ ose */-*t*-/ ka qenë pjesë përbërëse e formantit të pjesores *-*no*- ose *-*to*-.[233] Ndërsa I. Ajeti dhe K. Topalli mendojnë se ky formant është i trashëguar dhe e ka burimin nga prapashtesa *-nt* e gjuhës indoevropiane, e cila me evoucionin /*nt*/ > /*nd*/ > /*nn*/ ka dhënë *-n*(*ë*) në gjuhën shqipe.[234]

Me këtë prapashtesë te Bardhi dalin pjesoret:
*Kienë* (212 4), *përzanë* (94 14), *lanë* (72 2), *nxanë* (20 13).

**- Me prapashtesën -jtun(ë)**

Kjo është një prapashtesë e formuar nga bashkimi i prapashtesave *-jtë* dhe *-unë*. Kjo duket më qartë, sepse te Bardhi, për të njëjtën folje kemi edhe mbaresën *-unë* (*druetunë* 85 23), edhe mbaresën *-jtunë* (*drueitunë* 91 15); që te Buzuku del *druoitunë* (326 10). Foljet e tjera me këtë prapashtesë janë:
*Mbaitunë* (18 5) ~ *bāitunë* (133 21), *muitunë* (101 6), *prueitunë* (111 6), *ruoitunë* (17 12) ~ *ruitunë* (110 17) ~ *rueitunë* (131 11).

**- Me prapashtesën -të**

Përgjithësisht mendohet se kjo prapashtesë është prapashtesë e mirëfilltë pjesoreje.
Te Bardhi gjejmë këto raste:
*Sëmutë* (2 16), të cilën të Buzuku e gjejmë edhe *sëmutë* (266 23), edhe *sëmunë* (32 83); *thatë* (6 24); dhe *votë* (58 2), që gjenden po kështu edhe te Buzuku.

**- Me prapashtesën –tunë**

Edhe kjo prapashtesë është e përbërë nga dy prapashtesa pjesoresh: *-të* + *-në* ose *-të* + *-unë*.[235] Te Bardhi e gjejmë në këto raste: *ditunë* (65 12), *dridhtunë* (119 10).

## II. Format analitike me bazë pjesoren

Mbi bazën e formave sintetike të pashtjelluara, që sot funksionojnë si pjesore, janë krijuar këto forma analitike: përcjellorja *tue punue* / *duke punuar*, forma mohore *pa punue* / *pa punuar* dhe paskajorja e tipit *me punue*. Dallimi i këtyre formave të pashtjelluara ka karakter sintaksor: format sintetike pa tregues gramatikorë të paravendosur kanë kuptim pjesor, kurse

[232]Domi, *Morf. hist*., Tiranë, 1961, f. 64.
[233]Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 405.
[234]I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike),* Prishtinë, 1969, f. 91;Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe,* Plejad, Tiranë, 2010, f. 452.
[235]Topalli, *Sis. fol.* f. 468.

format analitike me tregues gramatikorë kanë marrë kuptime të tjera (përcjellore, paskajore, mohore), në varësi të elementit analitik që kanë përpara.[236]

Studiuesit janë marrë shumë me paskajoren dhe sidomos me burimin e elementit *me*. Kështu S. Riza shpjegon se duke qenë se për nga domethënja, infinitivi dhe participi janë fort të largët, ndija gjuhësore e shqiptarëve, pasi infinitivi i lashtë erdhi e kreu funksionin e participit, diferencoi morfologjikisht infinitivin prej participit duke e shoqëruar të parin me prepozicionin *me*.[237]

Fakti që tipi i paskajores *me* + pjesore ka qenë dikur i përbashkët dhe i përhapur në mbarë arealin shqipfolës dhe që dalëngadalë është dobësuar në dialekte jugore të toskërishtes e që u kufizua më vonë dhe u ruajt vetëm në dialektet e gegërishtes, duke u shndërruar në një tipar gegizmi është mbështetur nga Xhuvani, Domi, Bokshi, Demiraj etj. Riza thotë se nuk kemi të bëjmë me një huazim të veçantë nga gegërishtja, por me një mbeturinë të një procesi të tërë, i cili do ta ketë pasur pikënisjen e vet në gegërishten veriore, ku u përgjithësua, kurse pikarritja e vet në toskërishte, përkundrazi nuk u përgjithësua dot.

Praninë e trajtës *me* Riza e shpjegon historikisht si një rezultat antonimik që u zhvillua nga konstrukti i infinitivit privativ të ruajtur gjer në ditët tona në mbarë shqipen nëpërmjet trajtës *pa* + pjesore; domethënë që përdorimi i infinitivit me predispozicionin *me* rrjedh prej përdorimit të tij me predispozicionin *pa*.[238]

Si një dukuri gjuhësore dikur të përbashkët dhe jo si një gegizëm e sheh edhe F. Altimari, i cili e argumenton me gjurmët e gjetura në arbërishte.[239]

Demiraj mendon se paskajorja e tipit *me ba* ka mundësi të ketë zëvendësuar një paskajore më të vjetër, e cila duhet të jetë zhdukur që herët pa lënë gjurmë; kur në disa gjuhë ballkanike ajo ka ardhur duke u zhdukur në një nga dialektet e shqipes ajo ka qenë shumë e gjallë, ndërsa më vonë mbarë shqipja (sidomos toskërishtja) ka krijuar një formë foljore perifrastike (të tipit *për të bërë*), e cila përdoret në një numër funksionesh sintaksore që janë karakteristike për paskajoren.[240]

Në punimin e tij për formën *pa* + pjesore Agalliu mendon se forma e pashtjelluar mohore i është larguar pjesores si në numër, ashtu edhe në dendurinë e përdorimit, duke u kryqëzuar me përcjelloren, pa u shndërruar në një variant të dytë të saj. Kështu, forma e pashtjelluar mohore nuk mund të quhet as edhe një variant i përcjellores. Veç kësaj, ai thotë se kuptimi mohor është inherent për këtë trajtë, ndryshe nga paskajorja e përcjellorja ku ai del si opozicion i kuptimit kohor, shprehur përkatësisht me pjesëzën *mos* ose me mungesën e saj.[241]

Ndërsa Topalli mendon se paskajorja me *me* është zhvillim i brendshëm i dialektit gegë dhe se pjesëza *me* që qëndron para foljes ka origjinë parafjalore. Në rastin e formës mohore *pa punuar* dhe të paskajores gege *me punue* identifikimi i këtij elementi me parafjalët përkatëse është i qartë, meqënëse parafjalët *pa* dhe *me* përdoren edhe sot si të tilla; ndërsa për elementin *tue* përpara përcjellores mendon se vjen nga parafjala *tuk* që është një variant i parafjalës *tu* (khs. *te* e *tek*); kurse zanorja *e* është trajta e shkurtër e bashkuar me parafjalën.[242]

Sidoqoftë, pavarësisht burimit, gjendja që pasqyrohet te Bardhi është e tillë:

Kemi një numër të madh formash analitike me bazë pjesoren (përkatësisht paskajore); ku përcjellorja (e tipit *tue punue*) dhe mohorja (*pa punue*) zënë një vend më të vogël. Duke qenë

---

[236]Po aty, f. 481.
[237]Riza, punimi i cituar, f. 126.
[238]Po aty.
[239]Altimari, *dis. e cituar*, Tiranë, 2001.
[240]Demiraj, *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*, SF 1, 1969, f. 90.
[241]Agalliu, F., *Vëzhgime mbi formën gramatikore pa + pjesore*, SF 3, 1983, f., 121.
[242]Topalli te *Sis. fol.* f. 489.

se janë me bazë pjesoren, prapashtesat e pjesoreve me të cilat ndërtohen janë paraqitur në pjesën për pjesoren; ndërsa ndryshimet që këmi vënë re në krahasim me Buzukun janë:
Buzuku e ka *me shpërble**në*** (38 70), ndërsa Bardhi: *me çpërblē**m*** (124 26), pra është e njëjta folje, por me prapashtesë të ndryshme.
Buzuku e ka *me gjiell**ë*** (350 46), ndërsa Bardhi: *me gjellu**në*** (137 28).
Buzuku e ka *me ŋbëljedh**unë*** (362 19), ndërsa Bardhi paraqet dy forma: *me mbëledh**ë*** 1 28 (me prapashtesën **-ë**) dhe *me mbëliedh**unë*** 13 24 (me prapashtesën **-unë**).
Buzuku paraqet dy forma për: *me pi**të*** (60 31) dhe *me pi**në*** (152 64), ndërsa Bardhi ka vetëm një formë: me pī**m** (8 19).
Kështu, përveç ndërrimeve fonetike të temave të zanoreve të temave, shohim se ka edhe dallime në prapashtesa midis këtyre dy autorëve.

## Përfundime

Në *Dictionarium latino-epiroticum* (1635) të F. Bardhit në krahasim me shqipen e sotme ka ndryshime, të cilat lidhen me kohën në të cilën është shkruar, por sigurisht që pasqyrojnë njëkohësisht edhe tipare dialektore. Edhe në krahasim me Buzukun ka evoluim të formave të pashtjelluara foljore; me karakter morfologjik, por më së shumti fonetik.

Vihet re një evoluim i togjeve të zanoreve, por edhe i disa grupeve të bashkëtingëlloreve. Kështu, në krahasim me Buzukun, Bardhi paraqet një fazë më të evoluar edhe nga pikëpamja e kohës, duke paraqitur edhe veçori dialektore.

## Literaturë

Agalliu, F., *Pjesorja në gjuhën shqipe,* SF 2, 1972.
Agalliu, F., *Vëzhgime mbi formën gramatikore pa + pjesore*, SF 3, 1983.
Ajeti, I., *Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike),* EBSH i Rep. soc. të Serb., Prishtinë 1969.
Atimari, F., *E ashtuquajtura e ardhme arbëreshe kam + lidhore*, *Dispensë*, Tiranë, 2001.
Bardhi, F, *Dictionarium Latino-Epiroticum* (*Romae 1635*) *per R.D. Franciscum Blanchum,* botim kritik nga Bardhyl Demiraj, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes*, Prishtinë, 1998.
Buzuku, Gj., *Meshari (1555),* pj. I, II, botim kritik, punuar nga E. Çabej, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, Tiranë, 1968.
Çabej, E., *Studime gjuhësore* IV, Rilindja, Prishtinë, 1977.
Demiraj, Sh., *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe,* SF. 1, 1969.
Demiraj Sh. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe,* Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.
Domi, M., *Morfologjia historike e gjuhës shqipe,* Tiranë 1961.
Riza, S. *Çështja e paskajores në shqipe,* Vepra 4, Prishtinë 2004.
Topalli, K., *Sistemi foljor i gjuhës shqipe,* Plejad, Tiranë, 2010.
Xhuvani, A., *Pjesorja në shqipet,* në Vepra I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

# PËRDORIMI I PAJISJEVE TEKNOLOGJIKE NË ORËT MËSIMORE,NDIKIMI I TYRE NË REZULTATET E TË NXËNIT

**MSc. Matej Bushaj**

ShMU "E.Gjoni" Gjakovë, Kosovë

**Brikenë Elshani**

Prishtinë, Kosovë

**Islam Sejdiu**

Podujevë, Kosovë

**Abstrakti**

Qëllimi i këtij punimi është të studioj përdorimin e pajisjeve teknologjike në orët mësimore, si dhe ndikimin e tyre në rezultatet e të nxënit në lëndë të ndryshme, të shihet ndryshimi i rezultatit aty ku përdoren pajisjet teknologjike dhe aty ku nuk përdoren këto pajisje.

Ky studim shtron çështjen e rëndësisë së përdorimit të pajisjeve teknologjike në lëndë të ndryshme, si nxitëse në orën e mësimit. Në studim shtrohet domosdoshmëria e këtij përdorimi, për të rritur rezultatet e të nxënit në orët mësimore.

Ky studim synon të vërtetoj hipotezën se duke përdor pajisjet teknologjike në orët mësimore në lëndë të ndryshme, rriten rezultatet e të nxënit. Për të vërtetuar këtë hipotezë, kemi ngritur pyetjet kërkimore të hulumtimit: Si ndikon në të nxënit e nxënësve përdorimi i pajisjeve të teknologjisë në orët mësimore? A rritet produktiviteti i orës së mësimit në lëndë të ndryshme, duke aplikuar integrimin e pajisjeve teknologjike?

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura dhe për të vërtetuar hipotezën, është përdorur metoda sasiore, përmes anketimit. Janë anketuar mësimdhënës të Shkollave të Mesme të Ulëta (konkretisht, mësimdhënës që japin mësim në klasat e nënta) në regjionin e Gjakovës, në Kosovë.

Nga rezultatet e hulumtimit është arritur në një përfundim se është e domosdoshme që në orën e mësimit, në Shkollat e Mesme të Ulëta, në lëndë të ndryshme, të aplikohet përdorimi i pajisjeve teknologjike në orët mësimore për të arritur rezultate më të mira në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, njëherit edhe për të krijuar për nxënësit një mjedis atraktiv, nxitës dhe motivues.

**Fjalët kyçe*:*** *përdorim, pajisje teknologjik, mësimdhënie, mësimnxënie, rezultatet e të nxënit.*

## HYRJE

Duhet theksuar se që nga kohët e lashta edhe sot e kësaj dite shoqëritë njerëzore kanë punuar dhe punojnë që ti ndryshojnë kushtet e jetës, punës dhe shkollimit. Shkenca e cila ka mundësuar këto ndryshime ka qenë Teknologjia. Fjala teknologji rrjedhë nga dy fjalë greke tekno – logos, "Tekno- që do të thotë mjeshtri dhe Logos- që do të thotë dije apo shkencë". ( Hajrullahu, 2013: 7 )

Shoqëria e bazuar në dituri nevojitet që të ketë aftësi të mira komunikuese dhe sociale, të jetë mirë e informuar, dhe të jetë gjithmonë e gatshme të mësoj gjëra të reja. Për t'u bërë pjesëtar të kësaj shoqërie qytetarët duhet të investojnë në mënyrë aktive në këtë shoqëri dhe ti ndjejnë përfitimet e ofruara nga ajo. Ata poashtu duhet që në mënyrë kreative ti arrijnë dituritë dhe eksperiencat duke krijuar zgjidhje origjinale për problemet.

Në kohën bashkëkohore gjithnjë e më shumë po ka ndikim teknologjia informative dhe e komunikimit (TIK), ajo po ka ndikim në gjitha sferat shoqërore. Ky ndikim nuk e anashkalon as arsimin. Arsimimi dhe dituria janë baza e zhvillimit te të gjitha shoqëritë njerëzore dhe ato janë e drejta fundamentale për çdo individ pa marr parasysh racën, gjininë, moshën etj.

Përderisa dominojnë metodat tradicionale të cilat e fuqizojnë njohurinë enciklopedike dhe jo atë praktike, mungesa e mësimdhënies interaktive dhe inovacioneve bëjnë që teknologjia informative e komunikimit të shfrytëzohet si reformator për ti plotësuar kërkesat globale për mësimdhënie sa më pragmatike dhe për ti ndjekur trendet bashkëkohore arsimore ku nxënësi vendoset në qendër të vëmendjes dhe ku ju krijohet mundësia për të zhvilluar të menduarit kritik dhe zgjedhja e problemeve

Arsyeja dhe nevoja e aplikimit të TIK-ut në arsim niset nga fakti i përgatitjes së brezave të reja për tu bërë të aftë dhe të suksesshëm në këtë shoqëri të udhëhequr nga informacionet. Aftësitë e komunikimit, procesimit, mendimit kritik dhe zgjedhjes së problemeve si dhe puna në grupe janë parakushte për zhvillimin e shoqërisë teknologjike dhe socio-ekonomike të këtij shekulli. Arsimimi në këtë mjedis të përsosur do të bëjë më shumë se vetëm lexim, shkrim apo përvetësim të shkathtësive aritmetike. Duhet të ofrojë edhe shkathtësi pune organizative në grupe që do ti ndihmon të rinjtë ta arrijnë potencialin e tyre njerëzor në shoqëri.

## RISHIKIMI I LITERATURES

Sot, çdo lami e punës dhe e veprimit njerëzor lidhet me shfrytëzimin e kompjuterit. Prandaj, aftësimi për punë me kompjuter është nevojë e kohës për të gjithë, pavarësisht nga profesioni i zgjedhur. ( Dika & Rodiqi, 2000: 2 )

Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie nënkupton përdorimin e kompjuterëve dhe software-ve në mënyrë produktive, shfrytëzimin e internetit dhe përdorimin e rrjeteve kompjuterike për qëllime të mësimdhënies dhe të nxënies. Aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, ofron përfitime të mëdha për nxënësit dhe rritë aftësitë konceptuese dhe përceptuese të tyre gjatë orës së mësimit duke lehtësuar të nxënit. ( Mexhuani, 2014: 7 )

Aplikimi i teknologjisë sigurisht që ka lehtësuar jetën në ditët e sotme. Teknologjia sot është bërë pjesë e fushave të ndryshme dhe tanimë ajo zë vendin e saj dhe në sferën e edukimit. (https://cio.pcworld.al/a-mundet-teknologjia-te-ndihmoje-mesuesit-te-shpjegojne-dhe-nxenesit-te-kuptojne/ )

Teknologjia e re ka ndryshuar mënyrën si ne mësojmë, sepse duke përdorë mjete si faqet e internetit, aplikacionet, lojërat e të mësuarit, dhe librat elektronikë, ndihmojnë nxënësit të mësojnë sipas ritmit të tyre. ( https://shkolladigjitale.com/si-ndikon-teknologjia-te-femijet/ )

Çështje kryesore sipas studimeve të shumta është përqendrimi në shfrytëzimin e TIK nga mësimdhënësit dhe nxënësit për qëllime arsimore, sesa shfrytëzimi praktik i kompjuterëve bashkë me mjetet dhe programet e tij. (Brown, 1997: 37)

Klasat me shumë kompjuterë kanë më shumë përparësi se sa një kabinet tradicional i kompjuterëve. Në këtë lloj të klasave, ku monitorët e kompjuterëve janë të futura në tavolina dhe tavolinat të organizuara në grupe nga tre ose katër, nxënësit munden të shohin më lirshëm njëri-tjetrin dhe mësimdhënësin dhe të komunikojnë më lirshëm. (Egbert & Hanson-Smith, 1999: 67 )

Nëse shkolla nuk ndryshon së bashku me shoqërinë si teknologjia, ata do të edukojnë një grup nxënësish që nuk i kanë aftësitë teknologjike për të konkurruar dhe arritur sukses në arsimin e lartë ose në tregun e punës, të dyja në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (Basset, 2005).

Sistemet kompjuterike do të ndryshojnë botën tonë. Teknologjia informative e krijon një shoqëri krejtësisht të re me mundësi dhe rreziqe të reja. ( Doracak për ECDL, 2005: 28)

**Metodologjia**

Metodologjia e përdorur në këtë studim ka pasur për qëllim të studioj ndikimin që ka integrimi ndër lëndor i teknologjisë me lëndët e tjera mësimore, përmes aplikimit të pajisjeve teknologjike në lëndë të ndryshme gjatë orës së mësimit.

*Objektivat e studimit*

- ✓ Të nxjerrë në pah rëndësinë e përdorimit të pajisjeve teknologjike brenda orës mësimore në lëndë të ndryshme në shkollë.
- ✓ Të hulumtoj rrethë ndikimit që ka përdorimi i pajisjeve teknologjike në rritjen e rezultateve të të nxënit tek nxënësit në lëndë të ndryshme në shkollë.
- ✓ Të hulumtoj rrethë ndikimit që ka përdorimi i pajisjeve teknologjike në lëndë të ndryshme.

**Pyetjet kërkimore**

Ky punim shkencor kërkon t'i përgjigjet pyetjes kërkimore:

- ✓ A ndikon në rritjen e rezultateve të të nxënit në orët mësimore, në lëndë të ndryshme, përdorimi i pajisjeve teknologjike?

**Hipotezat**

Hipoteza kryesore: Përdorimi i pajisjeve teknologjike në orët mësimore në lëndë të ndryshme rrit rezultatet e të nxënit

**Hipoteza me rezultat negativ**: Përdorimi i pajisjeve teknologjike në orët mësimore në lëndët e ndryshme nuk ka asnjë ndikim në rritjen e rezultateve të të nxënit.

**Variablat**

Në rezultatet e të nxënit në orën mësimore ndikojnë shumë faktor objektiv dhe subjektiv. Integrimi ndër lëndor dhe integrimi i pajisjeve teknologjike gjithnjë e më tepër është duke u aplikuar në shkollat tona, dhe shihet se po ndikon pozitivisht në nxënien cilësore të nxënësve. Për qëllimet e studimit tonë, vëmendja është përqëndruar në integrimin e pajisjeve teknologjike në lëndën e Teknologjisë dhe lëndëve të tjera. Pra, për të vërtetuar hipotezën, vëmendja është përqendruar në dy variabla:

- ✓ Variabli i pavarur – integrimi i pajisjeve të teknologjisë në lëndët e ndryshme në orët mësimore
- ✓ Variabli i varur – rritja e rezultateve të të nxënit në orë mësimore

**Metodat dhe instrumentet**

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura për këtë studim synojnë mbledhjen e të dhënave sasiore rrethë ndikimit të pajisjeve teknologjike në zhvillimin e intelektit dhe mendimit kritik të nxënësve, si dhe rëndësinë që ka ndërlidhja e teknologjisë me lëndët e tjera në orën mësimore.

Për të matur rëndësinë që ka përdorimi i pajisjeve teknologjike në orën e mësimit në lëndë të ndryshme, është përdorur si instrument matës pyetësori.

Synimi i pyetësorit të përdorur për këtë studim ka qenë mbledhja e të dhënave paraprakisht të strukturuara, me përgjigje të renditura sipas shkallës Likert (gjithmonë; shpeshherë; ndonjëherë; asnjëherë).

**Kampionimi**

Të dhënat u siguruan nga Drejtoritë Komunale Arsimore në komunën e Gjakovës.

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të testuar hipotezën e ngritur për këtë studim, për hulumtimin tonë kemi ngritur një kampion, për fillim u morën informata për

gjendjen e kabineteve në të gjitha shkollat, pra domethënë gjithsej në 39 shkolla të Arsimit të Mesëm të Ultë në Komunën e Gjakovës.

Pastaj u përzgjodhën 18 shkolla si mostër në të cilat u përzgjedhën mësimdhënësit që japin mësim në klasat e nënta në Arsimin e Mesëm të Ultë në Komunën e Gjakovës, gjegjësisht në lëndët: Gjuhë Shqipe, Gjeografi, Biologji, Matematikë dhe Teknologji.

Fillimisht u morën të dhëna për të ditur popullatën nga ku do të merrej kampioni. Të dhënat u morën për mësimdhënësit që japin mësim në këto lëndë.

Nga të dhënat e siguruara, rezultoi se në komunën e Gjakovës, në këto lëndë japin mësim 340 mësimdhënës.

Pasi u siguruan të dhënat rrethë popullatës së mësimdhënësve, u planifikua kampionimi me të cilin u morën të dhënat. Përzgjedhja e shkollave u bazua në përfaqësimin proporcional, bazuar në variablin shkolla urbane dhe shkolla rurale.

Faza e dytë e kampionimit të përdorur përfshin përzgjedhje e mësimdhënësve që japin mësim në klasat e nënta në Komunën e Gjakovës. Edhe përzgjedhja e mësimdhënësve ishte e qëllimshme, në mënyrë që përfaqësimi të ishte i shtrirë pothuajse në të gjithë popullatën e mësimdhënësve që japin mësim në klasat e nënta të Arsimit Mesëm të Ultë në Komunën e Gjakovës.

Pra, për këtë hulumtim, nga 68 paralelet e komunës së Gjakovës janë përfshirë 39 paralele, kampioni i mësimdhënësve të klasave të nënta, të përzgjedhur, përbëhet nga 195 mësimdhënës ose 57 % e popullatës. Nga këta, përsa i përket shkollës ku japin mësim, 107 mësimdhënës ose 55 % e numrit të përgjithshëm, japin mësim në zonat urbane, ndërsa 88 mësimdhënës ose 45 % e numrit të përgjithshëm, japin mësim në zonat rurale.

Për sa i përket gjinisë së mësimdhënësve që morën pjesë në studim, 96 ose 49 % janë femra dhe 99 ose 51 % janë meshkuj.

Për sa i përket vjetërsisë në punë të mësimdhënësve që morën pjesë në studim, 68 mësimdhënës ose 35 % i përkasin grupit me nga 0 – 10 vite eksperiencë pune si mësimdhënës, 85 mësimdhënës ose 44 % i përkasin grupit me nga 10 – 20 vite eksperiencë pune si mësimdhënës dhe 42 mësimdhënës ose 21 % i përkasin grupit me nga 20 vite e më shumë eksperiencë pune si mësimdhënës.

Për sa i përket mësimdhënësve sipas lëndëve që morën pjesë në studim në secilën lëndë: Gjuhë Shqipe, Gjeografi, Biologji, Matematikë dhe Teknologji, është i barabartë me 39 mësimdhënës ose 20 %.

Poashtu nga këto 39 paralele si mostër janë marrë 6 paralel me të cilat është mbajtur një test ku kanë marrë pjesë 148 nxënës.

**Etika e përdorur në studim**

Gjatë punës sonë hulumtuese është kujdesur që të ruhet etika e hulumtuesit.

Për realizimin e studimit u respektuan çështjet etike të cilat lidhen me:

a) Lejen e informuar të subjektit
b) Konfidencialiteti
c) Shmangia e keqpërdorimit të të dhënave

**Analiza e të dhënave**

Analizimi i pyetësorëve është bërë në mënyrë të përpiktë dhe detale. Vëmendje iu përkushtua përmbajtjes dhe temave që pjesëmarrësit përmendën, si një mënyrë për të nxjerrë rezultatet e këtij hulumtimi. Kjo formë e analizave është bërë për të siguruar besueshmërinë në analizat e të dhënave. Për të arritur deri te raportimi i gjetjeve në hulumtim kemi përdorur metodën statistikore dhe metodën përshkruese. Për të analizuar si duhet këtë problem kemi përdorur metodën statistikore e cila është përdorur për gjetjen e rezultateve të cilat i kemi paraqitur përmes grafikëve dhe metodës përshkruese. Përmes metodës përshkruese kemi bërë edhe përshkrimin e të dhënave, si dhe kemi paraqitur rekomandimet për autoritetet relevante përkitazi me veprimtaritë që duhet ndërmarrë për përfshirjen e pajisjeve të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe në përmirësimin e rezultateve të të nxënit në arsim. Nga të dhënat e mbledhura në teren, u pa se mësimdhënësit në kampionin e përzgjedhur, mendojnë se integrimi i pajisjeve teknologjike në lëndët tjera ( të përmendura më lartë ), ka ndikim pozitiv në ngritjen e rezultateve të të nxënit.

**REZULTATET**

Ne si fillim kemi dërguar pyetësorë në të gjitha shkollat e Mesme të Ulta të Komunës së Gjakovës për të parë gjendjen e kabineteve të informatikës dhe pajisjet që disponojnë këto shkolla, nga rezultatet e fituara shihet se gjendja në kabinetet e shkollave të mesme të ulëta në Komunën e Gjakovës është jo e mirë, andaj mbetët shumë për të dëshiruar që kjo gjendje të përmirësohet.

Në rezultatet e pyetësorëve rrethë pyetjes se: a janë të pajisura shkollat me pajisje teknologjike?, i cili pasqyron gjendjen e të gjitha Shkollave të Mesme të Ulta të Komunës së Gjakovës po i paraqesim në një tabelë dhe një grafikon dhe kemi këto rezultate:

| | | |
|---|---|---|
| Disponojnë pajisje teknologjike | 17 | 44 % |

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

| | | |
|---|---|---|
| Disponojnë pajisje teknologjike pjesërisht | 8 | 20 % |
| Nuk disponojnë pajisje teknologjike | 14 | 35 % |
| Gjithsejtë | 39 | 100 % |




Në rezultate e pyetësorëve rreth pyetjes se: a janë të pajisura shkollat me pajisje teknologjike i cili pasqyron gjendjen e shkollave mostër të përzgjedhura po i paraqesim në një tabelë dhe një grafikon dhe kemi këto rezultate:

| | | |
|---|---|---|
| Disponojnë pajisje teknologjike | 7 | 39 % |
| Disponojnë pajisje teknologjike pjesërisht | 4 | 22 % |
| Nuk disponojnë pajisje teknologjike | 7 | 39 % |
| Gjithsejtë | 18 | 100 % |




Në vijim po i paraqesim rezultatet në mënyrë të përshkruar:

Të pajisura mirë kemi 39 % të shkollave, të pajisura pjesërisht kemi 22 % të shkollave dhe pa pajisje teknologjike fare kemi 39 % të shkollave ( kuptohet pajisje që përdoren në orët mësimore)

Në rezultatet e pyetësorëve rrethë pyetjes: se sa përdoren pajisjet teknologjike në orët mësimore në lëndët: Gjuhë shqipe, Gjeografi, Biologji, Matematikë dhe Teknologji po i paraqesim në mënyrë grafike dhe përshkruese ku kemi këto rezultate:




Për secilën lëndë kemi parametra të ndryshëm edhe pse mostrat janë marrë në të njëjtat shkolla, në vijim po i paraqesim rezultatet në mënyrë të përshkruar.

1. Gjuhë shqipe kemi këto rezultate: 25 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "gjithmonë", 33 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "shpesh", 42 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "asnjëherë".
2. Gjeografi kemi këto rezultate: 31 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "gjithmonë", 24 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "shpesh", 45 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "asnjëherë".
3. Biologji kemi këto rezultate: 35 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "gjithmonë", 22 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "shpesh", 43 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "asnjëherë".
4. Matematikë kemi këto rezultate: 25 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "gjithmonë", 27 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "shpesh", 48 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "asnjëherë".

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

5. Teknologji kemi këto rezultate: 43 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "gjithmonë", 18 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "shpesh", 39 % e mësimdhënësve të përzgjedhur në studim janë përgjigjur me alternativën "asnjëherë".

Gjatë hulumtimit ne kemi realizuar një teste me nxënës. Testi ka qenë i përbashkët për lëndët e cekura më lartë në 6 paralele, pasi kemi analizuar edhe përgjigjet e dhëna nga nxënësit në test, rezultatin po e paraqesim në mënyrë grafike dhe përshkruese, ishte si vijon:




1. Gjuhë shqipe: në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "gjithmonë" testi është plotësuar 86 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "shpesh" testi është plotësuar 81 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike nuk aplikohet "asnjëherë" është plotësuar 76 %, Ndryshimi në mes të përdorimit "gjithmonë" dhe "asnjëherë" është 10 %.

2. Gjeografi: në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "gjithmonë" testi është plotësuar 81 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "shpesh" testi është plotësuar 76 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike nuk aplikohet "asnjëherë" testi është plotësuar 62 %, Ndryshimi në mes të përdorimit "gjithmonë" dhe "asnjëherë" është 19 %.

3. Biologji: në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "gjithmonë" testi është plotësuar 77 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "shpesh"

testi është plotësuar 71 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike nuk aplikohet "asnjëherë" testi është plotësuar 60 %, Ndryshimi në mes të përdorimit "gjithmonë" dhe "asnjëherë" është 17 %.

4. Matematikë: në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "gjithmonë" testi është plotësuar 73 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "shpesh" testi është plotësuar 69 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike nuk aplikohet "asnjëherë" testi është plotësuar 65 %, Ndryshimi në mes të përdorimit "gjithmonë" dhe "asnjëherë" është 8 %.

5. Teknologji: në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "gjithmonë" testi është plotësuar 88 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike aplikohet "shpesh" testi është plotësuar 83 %, në paralelet që përdorimi i pajisjeve teknologjike nuk aplikohet "asnjëherë" testi i arritshmërisë është plotësuar 67 %, Ndryshimi në mes të përdorimit "gjithmonë" dhe "asnjëherë" është 21 %.

**Rezyme**

Teknologjia në përgjithësi dhe Teknologjia e informimit dhe e komunikimit në veçanti paraqet njërin nga lëmenjtë kryesor në jetën bashkëkohore të njeriut, është pjesë e pandarë e veprimtarisë së përditshme të tij dhe sinonim i gatishmërisë për t'u marrë me problemet e të tashmes dhe të ardhmes.

Teknologjia dhe informatika tanimë janë shumë të zhvilluara dhe njëkohësisht dita e ditës po ecin me hapa shumë të shpejtë duke treguar progres të dukshëm. Duke e parë që edhe zhvillimet në vend kanë një progres të vazhdueshëm dhe të shpejt, me qëllim që të jemi në hap me kohën dhe në mënyrë të drejtpërdrejt tu përgjigjem kërkesave të nxënësve në vazhdimësi duke ju ofruar një qasje në teknologji për të gjithë nxënësit, të adaptohen dhe të pajisen kabinetet ekzistuese dhe njëkohësisht të bëhet zgjerimi i kapaciteteve si i kabineteve të informatikës ashtu edhe pajisja me kompjuter në përgjithësi.

Mbesim me shpresë që jo vetëm në komunën e Gjakovës, por në tërë shtetin tonë Republikën e Kosovës të bëhen ndryshime pozitive në kabinetet e teknologjisë nëpër shkollat tona të mesme të ulëta, në mënyre që nxënësit tonë të kenë më shumë qasje në pajisjet teknologjike moderne.

**PËRFUNDIMI**

Nga rezultatet e këtij studimi dhe shfrytëzimit të literaturës, arrihet në përfundimin se:

Duke përdor pajisjet teknologjike në orët mësimore në lëndë të ndryshme, rriten rezultatet e të nxënit.

Përdorimi i pajisjeve teknologjike në orët mësimore ka një ndikim të dukshëm në ngritjen e rezultateve të të nxënit në lëndët e ndryshme. Mesatarja e ndryshimeve për të gjitha lëndët e hulumtuara të cilat përdorin gjithmonë pajisjet teknologjike dhe atyre qe nuk përdorin pajisjet teknologjike qëndron në 15 %.

**Rekomandime**

Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Drejtorive Komunale të Arsimit, iu rekomandojmë të pajisin me pajisje teknologjike kabinetet ekzistuese dhe njëkohësisht të bëhet zgjerimi i këtyre kabineteve nëpër të gjitha shkollat e komunës së Gjakovës, me qëllim që të jemi në hap me kohën dhe në mënyrë të drejtpërdrejt tu përgjigjemi kërkesave të nxënësve për t'iu ofruar një qasje në pajisje teknologjike për të gjithë.

## REFRENCAT BIBLIOGRAFIKE


1. Bassett, P. (2005). Reengineering schools for the 21st century. Phi Delta Kappa, 87(01), 76-78
2. Brown, J. D., ( 1997 ) Computers in language testing: Present research and some future.
3. Doracak për ECDL, (2005) Botimi i tretë smartbits, "Viprint" , Prishtinë
4. Dr. Dika, A., Mr. Rodiqi, S., (2000) Kompjuteri për të gjithë, shtypi "Albina Gold" Shkup.
5. Hajrullahu, I., (2013) Teknologjia e kl 6, Prishtinë
6. Joy Egbert and Elizabeth Hanson-Smith., ( 1999 ) CALL Environments: Research, Practice, and Critical Issues.
7. Lepaja, S. & Ahmedi, L., (1998) Kompjuterika dhe Komunikimet, "Prograf", Prishtinë,.
8. Metthews, M. & Ross, L. (2010) Metodat e Hulumtimit
9. Mexhuani, A., (2014) Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie.
10. Sivakova, D., ( 2007 ) Ndikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përmirësimin e mësimit, Bitola,
11. Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë, 2007-2017
12. Varosanec, S., ( 2007 ) Zbatimi i kompjuterit në mësim. Zagreb,

# VERIFIKIMI I SAKTËSISË SË KANUNIT TË BOTUAR NGA GJEÇOVI DHE TË ATIJ QË ZBATOHEJ NËPËR MALËSI

**Dr. Nexhat Çoçaj** – UBT – Prishtinë

Në nëntëdhjetë vjetorin e vrasjes së Shtjefën Gjeçovit dhe në 86 vjetorin e botimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit me siguri se do të rishqyrtohen temat që kanë të bëjnë me veprimtarinë letrare e shkencore të Patër Gjeçovit. Andaj, verifikimi i saktësisë së Kanunit të Lekë Dukagjinit, më ka tërhequr në masë të madhe qysh me kohë kur po përgatisja veprën "Të pathënat për Gjeçovin", meqë vërtetë ende nuk është thënë ajo që duhet për këtë autor.

Interesimi i Gjeçovit për të verifikuar pjesët e botuara në "Hyllin e Dritës", do t'i hasim që në fillim, por pas përfundimit të botimit në "Hyllin e Dritës" ai do të merret edhe për një kohë, madje deri në vitin e vrasjes , duke e rishikuar kanunin e në veçanti në ato vende ku nuk kishte pasur mundësi të mbledhtë të dhëna gjatë publikimeve të pjesshme.

Thirrjet e tij në fund të pjesëve që botonte në "Hyllin e Dritës", në njërën anë , dëshmitë që ruhen nëpër fletoret me dorëshkrimet e Gjeçovit në bibliotekën "Marin Barleti" dhe dy prej tyre në Muzeun Historik të Shkodrës e të pa publikuara deri më tash janë dëshmi se vet Gjeçovi nuk ka pushuar asnjëherë në verifikimin e neneve të kanunit, me qëllim të përgatitjes së versionit final, për botim, siç e pohon edhe redaktori i botimit të vitit 1933 Patër Gjergj Fishta.

Një letër e kryemësuesit të Prefekturës së Kosovës z. Kelë Vila, që flet për mënyrën e verifikimit të kanunit, është e dhëna tjetër se Patër Gjeçovi ishte interesuar që versionet e botuara t'ua lexonte të gjithë personave që merreshin me pleqni dhe t'i jepnin vërejtjet e tyre, për ta plotësuar dhe kompletuar sa më shumë kryeveprën e tij.

Andaj, shqyrtimi në këtë këndvështrim i Kanunit të Lekë Dukagjinit, është përpjekja ime e re e qasjes ndaj veprimtarisë madhore të Patër Gjeçovit.

Fjalët kyçe: *Patër Gjeçovi, Kanuni i Lekë Dukagjinit, verifikimi, dorëshkrime, fletore, pleqnarë etj.*

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

# VERIFIKIMI I SAKTËSISË SË KANUNIT TË BOTUAR NGA GJEÇOVI DHE TË ATIJ QË ZBATOHEJ NËPËR MALËSI

Dr. Nexhat Çoçaj – UBT – Prishtinë

Për Kanunin e Lekë Dukagjinit, deri më tash kanë shkruar shumë studiues shqiptarë dhe të huaj, duke filluar nga botimi i pjesës së parë në numrin e parë të revistës “Hylli i Dritës” (tetor 1913) e vazhdojnë të merren edhe sot për rëndësinë dhe peshën e kësaj kryevepre të Patër Gjeçovit. Andaj, do të përpiqem të flas shkurt me pak fjalë vetëm për një aspekt, që nuk është folur dhe nuk është shkruar edhe aq deri më tash. E ky aspekt është mënyra e verifikimit të kanunit nga vet autori, pas botimit në të përkohshmen “Hylli i Dritës” pjesë – pjesë. Ky verifikim në ato zona, ku nuk kishte mbledh materialin për këtë kryevepër, përmes takimeve me pleq, që merreshin me zbatimin e kanunit, e në disa raste, duke i shfrytëzuar edhe lidhjet e tij me institucionet shkollore, përfshi këtu edhe zonat e thella, ku u hapën shkollat shqipe. Por, a është kjo e vetmja mënyrë e verifikimit të kanunit nga ana e Patër Gjeçovit, sigurisht se jo, sepse ai në masë të madhe edhe i ka shfrytëzuar njohjet, me klerikët, pleqnarët dhe atdhetarët e çështjes kombëtare, që e kanë vlerësuar punën dhe kontributin e tij në këtë fushë.


**Vëllau i shpifun.**

§. 1. Vëllau i shpifun, mbas Kanûnit, thirret njaj, i cilli i lèn nânës me burrë të dytë.

§. 2. Vëllau i shpifun së kà tager trashigimi as perkasie, në plâng të burrit të parë të nânës.

(Vijon).

Oroe: Tuci i Dód Prengës së Madh, i Gjomarkaj, kje kopil.

**Faksimil i shënimit të Gjeçovit, në "Hyllin e Dritës: nr. 6 , 1921 fq. 273.**

Sipas të dhënave të nxjerra nga e përkohshmja “Hylli i Dritës”, Kanuni i Lekë Dukagjinit është botuar në 33 numra të kësaj reviste për gjashtë vite të botimit të saj (1913-14 dhe 1921-1924). Duke mos dashur të ndalem te përmbajtja e botimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit në të përkohshmen “Hylli i Dritës”, në njërën anë dhe në anën tjetër botimi i plotë i kanunit katër vite pas vdekjes së Patër Gjeçovit, mund të them se studiuesit duhet t’i kushtojnë një vëmendje më të madhe ndërhyrjeve të vet autorit në të përkohshmen “Hylli i Dritës”, përkatësisht të gjenden këto të përkohshme, që kanë qenë kopje personale të Gjeçovit, në të cilat ai ka shkruar në korniza vërejtjet dhe sugjerimet, në lidhje me plotësimet dhe ndryshimet eventuale, pas letrave që vazhdimisht merrte Gjeçovi gjatë viteve sa u botua Kanuni i Lekë Dukagjinit në të përkohshmen “Hylli i Dritës”.

Në të përkohshmen “Hylli i Dritës” nr. 6 të vitit 1921, që ruhet në Bibliotekën “Marin Barleti” në Shkodër, ruhet një shënim, që me gjasë kjo e përkohshme është kopje e bibliotekës personale të Gjeçovit, ku jepet një shënim plotësues në lidhje me një ngjarje, që ka ndodhur në Mirditë e që lidhet me temën që trajton ajo pjesë e botuar në tetor të vitit 1921, edhe pse siç kuptohet nga dorëshkrimi i Gjeçovit, shënimi është bërë në vitin 1922.

Ky shënim, që sipas krahasimeve të dorëshkrimeve të Gjeçovit, rezulton të jetë i tij, mbase është dëshmia më e mirë që tregon se Gjeçovi, për kryeveprën e tij “Kanuni i Lekë Dukagjinit” ka punuar pothuaj se gjithë jetën dhe çdo herë është angazhuar, që të nxjerr më të mirën e mundshme në dritë.

Nisur nga kjo gjurmë jam përpjekur që për një periudhë të gjatë të shoh të përkohshmen "Hyllin e Dritës" nëpër biblioteka se mos rastësisht është edhe ndonjë numër tjetër i kësaj të përkohshme, kopje personale të Gjeçovit, në mos po takoj ndonjë shënim tjetër. Sipas drejtuesit të bibliotekës së Shkodrës, z. Quni një pjesë e librave të bibliotekës personale të Gjeçovit ruhen në këtë bibliotekë dhe gjatë punës sime hulumtuese nuk arrita të gjej ndonjë shënim tjetër në lidhje me këtë temë, në bibliotekat ku ruhen ekzemplarët e kësaj reviste. Por ka shumë të ngjarë që shumë fletore apo kopje të revistës "Hylli i Dritës" të kenë mbetur në bibliotekat e bashkëveprimtarëve e mendimtarëve të Gjeçovit, që me siguri ai vetë ua ka dhënë për t'i parë ndryshimet e që më pak edhe kanë mbetur në bibliotekat e tyre dhe në këtë mënyrë, edhe kjo çështje duhet shikuar në të ardhmen.

Në anën tjetër thirrja e përsëritur disa herë nga redaksia e revistës me sugjerim të autorit, gjithashtu le për të kuptuar se nga ana e vet Gjeçovit, në veçanti është bërë verifikimi i Kanunit të Lekë Dukagjinit, pas botimit të tij në "Hyllin e Dritës" në forma nga më të ndryshmet. Në radhë të parë Gjeçovi është nisur që ta bëjë verifikimin e Kanunit, duke i analizuar ngjarjet, që kanë ndodhur në praktikë në malësitë e Veriut, pastaj përmes kontakteve me pleq, mësuesve dhe inspektorë të arsimit, në vendet ku ai nuk kishte mundësi të shkonte vet. Ndër këto vende mund t'i veçojmë fshatrat e Lumës, fshatrat e Dibrës, të Hasit të Tropojës, por edhe vendeve tjera, ku ai nuk kishte mundësi të depërtonte, meqë puna nuk e kishte rastisur që të jetë në ato fshatra të thella.

Pas shumë thirrjeve, që Patër Gjeçovi u kishte bërë lexuesve përmes revistës "Hylli i Dritës", që t'i japin sugjerimet dhe plotësimet, ai kishte bërë përpjekje, që të gjente edhe forma tjera të bashkëpunimit me njerëz që merreshin me ndarjen e drejtësisë, apo siç ishin të njohur në popull "pleqnarë".

Kështu në revistën "Hylli i Dritës" nr. 2 të 1 nëntorit të vitit 1913, fq. 57, përkatësisht në vazhdimin e dytë të botimit të kanunit të Lekës Dukagjinit, në fund jepet edhe ky shënim

*"Ju lutna Meshtarve t'Maleve t'Shqypnisë qi kto shinime e vrojtime Kanûnit, rend e rend si t'botohen n'ket Perkohshme, t'i kundrojnë me ligjë e doke t'Kanûnit t'Malit t'vet, tuj; vûu n'dorë ndërlikimet qi munden me ndollë ndërmjet atyne ligjeve e ktyne qi botohen prejë nesh. Kto vrojtime, mandej, munden me u dergue drejt P. Shtjefen Gjeçov n'Gomsiqe, a se Drejtimit t'ksajë Perkoshme.*

*Mâa tepër, per ksaj herë, i lusim qi t'na dergojnë me shkrueme saa pleqnië qi mahen n;mend se n'Famullië t'tynë janë bâa per pûnë Kishet, tujë shenjue, per deer kû t'mûndet, vjetin e pleniiës, êmnat e pleqve t'Meshtarit, edhè gjygjin e bâam. Drejtimi."*[243] *Edhe në vazhdimin e pjesës së tretë "Familja" e përkohshme në "Hyllin e Dritës" në fund ka shprehur qëndrimin e saj, duke i kërkuar lexuesve, që për çdo vërejtje ose sugjerim t'i drejtohen redaksisë, apo vet autorit.*

*"Me gjithkta bashkë me oroe e çortime qi jemi tuej mledhë, kemi me qitë nji botim t'dytë t'»Kanûnit«, kû kan për t'u mârrë n'kujdes e shênjue ndryshimet ndërmjet ktij kanûni e ati t'Malevet tjera t' Shqypniës. Drejtimi"*[244]

Nga kjo shkresë e publikuar në të përkohshmen "Hylli i Dritës" kuptojmë shumë gjëra:

- Së pari Patër Gjeçovi ka dashur që përmes botimit të Kanunit të përfshi sa më shumë të dhëna të mbledhura jo vetëm nga pleqnarët, që në atë periudhë kohore janë marrë me zbatimin e të drejtës zakonore, përkatësisht të Kanunit të Lekë Dukagjinit, por edhe me familjet, që mbi kurrizin e tyre i kanë bartur pasojat e kanunit;

[243] "Hylli i Dritës", viti 1. nr. 2 , 1 nëntor 1913, fq. 57.
[244] "Hylli i Dritës", viti 1. nr. 3, 1 dhetuer, 1913, fq. 96.

- Së dyti ai si mbledhës dhe kodifikues ka dashur që përmes botimit në të përkohshmen t'ua mundësojë të gjithë njohësve të kanunit, që ta japin kontributin e tyre, përmes sugjerimeve dhe këshillave, shumë të rëndësishme;

- Së treti Patër Gjeçovi përmes botimit pjesë - pjesë, do t'u mundësonte edhe klerikëve fetarë, priftërinjtë, hoxhallarë, dervishë e shehlirë, që të japin kontributin e tyre dhe në veçanti intelektualëve dhe mësuesve, që punojnë në vende të thella të malësive, ku ende "jeton" fuqia e kanunit.

Nëse bëhet një krahasim në mes të botimit të pjesëve të kanunit me botimin e plotë të vitit 1933, rezulton se në esencë është e njëjta përmbajtje, por organizimi struktural i pjesëve ndryshon në mes vete. Kemi shumë raste, që gjatë botimit të parë një libër të botimit final ta gjejmë në disa vazhdime të ndërprera, përkatësisht të botuara jo në mënyrë kronologjike siç e gjejmë në botimin final të vitit 1933.

Nga kjo del se Gjeçovi pas botimit të "Kanunit të Lekë Dukagjinit" në "Hyllin e Dritës", ka vazhduar të merret edhe më shumë në dhënien e fizionomisë së plotë të kryeveprës, jo vetëm të Gjeçovit, por të gjithë krijuesve shqiptarë sa i përket të drejtës zakonore.

Se Patër Gjeçovi, pas botimit në vazhdime të "Kanunit të Lekë Dukagjinit" na e dëshmon në parathënien e tij edhe At Gjergj Fishta, i cili në mes tjerash thekson se Shtjefën Gjeçovi në vazhdën e punës së tij folklorike, kishte nisë mbledhjen e materialit dhe me të nisë botimin në të përkohshmen "Hylli i Dritës", kur nisi edhe ta botonte. Që në botimin e pjesëve të para vihen re interesimi i studiuesve të huaj dhe ky interesim bëri, që Gjeçovi edhe më shumë të interesoj që ta realizonte në tersi projektin, që ia kishte ngarkuar vetit. Fishta një parathënien e botimit të plotë të Kanunit, thekson: "– Nderkaq A. Shtjefni vijote pa i a dá kurr nder rmime e studjime mbí kanûn, edhè pat shtue materjal tjeter të rí kshtû, qi botimi definitiv i kanunit do të kishte dalë, nen ç'do pikpame, nji veper pernjimend fort e interesantshme. Veç shka se u vrá mizorisht në Jugoslaví, e i hupen edhè dorshkrimet, posë qi vepra i mbet pa krye. Tash, Françeskâjt i kan bâ bashkë kto studjime t'A. Shtjefnit Konst. Gjeçov, të botueme rresht mbas rreshti në «Hýll të Dritës», e po botojn tok në nji liber: të sugurtë se me ket veper i ngrefim nji pomendore të padekshme êmnit t'Autktorit, e nji shërbim të pëlqyeshëm marë komit shqyptár."[245] Përkatësisht në Bibliotekën "Marin Barleti" në Shkodër, në kutinë e dorëshkrimeve të Gjeçovit, ku ruhen gjashtë fletore me dorëshkrime të Gjeçovit dhe mesa kam arritur të kuptojë në këto shënime janë kryesisht të dhënat e Kanunit të Lek Dukagjinit, në versionin, që janë botuar në revistën "Hylli i Dritës".




Ndërsa në Muzeun Historik të Shkodrës në mesin e shumë thesareve, që ruhen janë edhe dy fletore me dorëshkrime të Gjeçovit. Në njërën fletore janë të dhëna kryesisht për festat e motmotit të mbledhura nga Patër Gjeçovi nga viti 1896 deri më 1928, që në bazë të datave këto të dhëna janë shkruar kryesisht gjatë viteve sa shërbeu në Has. Ndërsa fletorja tjetër që mban titullin "Kanuni i Lekë Dukagjinit ner male të Shqipnisë"[246], përmban të dhëna që kanë të bëjnë kryesisht me riorganizimin e pjesëve të Kanunit të Lekë Dukagjinit në revistën "Hylli i Dritës". Pra, në këtë fletore, po qese shikohet me vëmendje, shihet se Gjeçovi, ka shtuar edhe disa gjëra, që i kanë munguar botimit të versionit të revistës.

[245] At Gjergj Fisha, Parathënie e Kanunit të Lekë Dukagjinit, Shkodër, 1933.
[246] Fletorja që mban këtë titull, ruhet në Muzeun Historik në Shkodër.

Në këtë fletore që ka mbi 120 faqe shihen përpjekjet e Gjeçovit për riorganizimin e kapitujve, ndryshimin e neneve e herë -herë edhe ndryshimin e ndonjë paragrafi. Duke shfletuar këtë fletore, mendoj se edhe Fishta i madh kur e ka përgatitur për shtyp Kanunin e mbledhur dhe kodifikuar e ka pasur në dorë e mbase edhe ndonjë tjetër fletore, në të cilën ka pasur edhe më tepër ndryshime.

**Dorëshkrimi i Gjeçovit, në Kanunin e Lekë Dukagjinit**

Mbështetur në këtë fletore lirshëm mund të them se Gjeçovi jo vetëm gjatë kohës sa e botoi në vazhdimi "Kanunin..." u mor me të, por gjatë gjithë jetës punoi për këtë vepër duke mbledhur dhe duke bërë plotësime nga do që ishte. Mbështetur në shënimet e kësaj fletoreje nuk mund të themi se kur dhe ku u bënë këto ndryshime, sepse vetëm në disa fletë e gjejmë të shënuar vitin 1924, por edhe diku - diku edhe vitin 1928. Prandaj, vërehet se janë ndryshime, që në fakt mungojnë në botimin e parë (fjala është për kohën kur u botua në revistë), dhe disa ndryshime mungojnë edhe në botimin e plotë nën përkujdesjen e Patër Fishtës. Prandaj, në këtë nismë do të doja që studiuesve t'ua kujtoj se kur bëhet fjalë për Kanunin, nuk mund të anashkalohet edhe përpjekja e Gjeçovit, që ta plotësojë këtë vepër në baza të të dhënave të mbledhura në terren. Në bazë të kësaj fletoreje, mund të them se kuptohet fakti se Gjeçovi, ka marrë në konsideratë çdo shënim që ka mbledhur, apo ka marrë përmes letërkëmbimeve, që rezultojnë të jenë të shumta.

Gjithashtu në bazë të relacioneve të shumta, shihet se Gjeçovi mbante një komunikim të vazhdueshëm jo vetëm me klerikë fetarë, por edhe me atdhetarë e në veçanti zhvillonte biseda të gjata me të shpërngulurit e përkohshëm nga Kosova, që ishin të vendosur në Shtoj të Shkodrës, por edhe gjithandej në Shkodër, në fshatrat e Krujës e të Durrësit, në Has e Tropojë, ku ishin të vendosur shumë të shpërngulur nga Kosova me dhunë. Gjithashtu Patër Gjeçovi komunikonte vazhdimisht me anëtarët e kryesisë së Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, bashkëpunëtorë i së cilës ishte edhe Gjeçovi.[247] Sipas disa kujtimeve të veprimtarëve kosovarë, Gjeçovi me ta pos situatës politike, gjente rastin që të bisedonte edhe për të drejtën zakonore dhe sa herë që dëgjonte për dike, se gjatë kohës sa ka qenë në Kosovë kishte marrë pjesë aktive në pleqërime të ndryshme. Komiteti i Kosovës, dha një kontribut të madh në fushatën kundër pushtimit italian dhe në përgatitjen e Kongresit të Lushnjes. Në anën tjetër,"....kontributin e Komitetit të Kosovës e madhëruan edhe bashkëpunëtorët e këtij komiteti siç ishin P. Gjergj Fishta, P. Shtjefën Gjeçovi, Bajram, Fevziu, Sali Nivica, Kristo Floqi etj, të cilët me shkrimet dhe botimet e tyre i dhanë gjallëri e aktualitet problemit të Kosovës..."[248] Tahir Zajmi në librin e tij flet edhe për disa veprimtarë tjerë të çështjes shqiptare, të cilët vinin herë pas here në Shkodër, për t'u konsultuar me Komitetin e Kosovës dhe më pas ktheheshin përsëri në Kosovë, për të qenë në ballë të organizimeve kundër pushtuesve. "Një nga veprimtarët dhe organizatorët e kryengritjeve në Kosovë kundër pushtuesve serb ishte edhe Sadik Rama i Gjurgjevikut, pleqnar i urtë dhe njohës i thellë i kanunit të Lekë Dukagjinit." [249] Sadik Rama, si veprimtar i çështjes kombëtare disa herë ishte takuar me Pater Gjeçovin në Shkodër dhe kishin biseduar edhe për çështjen e Kanunit të Lekë Dukagjinit, për ndryshe pse Tahir Zajmi ta prezantonte në librin e tij njohës i thellë i kanunit. Kjo dëshmi, na jep mundësinë për të kuptuar se Patër Gjeçovi, karshi punës patriotike angazhohej edhe për verifikimin dhe plotësimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit edhe me të dhënat që zbatoheshin në zemër të Kosovës, në Drenicë dhe gjetiu.

---

[247] Tahir Zaimi, Tallazet e jetës dhe lotët e zêmrës, Bruxelles, 1970, fq. 87

[248] Tahir Zaimi, Lidhja e II e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës, Bruxelles, 1964, fq. 25.

[249] Tahir Zaimi, Lidhja e II e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës, Bruxelles, 1964, fq. 86.

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

"Meqë Isa Boletini ishte dhëndër i gjyshit tim, dhe ishte bashkëveprimtar, që nga viti 1912, pa vdekjes së Isa Boletinit qëndrimi i gjyshit Lah Ahmeti dhe Halit Ahmeti në Kosovë ishte bërë e pamundur, andaj ata sikurse edhe shumë të tjerë atdhetarë u shtrënguan, që të dalin në Shqipëri përmes Hasit. Pas qëndrimit disa muajsh në Has, ata kishin ardhur dhe ishin vendosur në Gurëz të Laçit. Prej vitit 1920 e deri më 1931 kanë jetuar vetëm, ndërsa pas vitit 1931, me ndihmën e Tafil Boletinit u bashkuan edhe anëtarët tjerë dhe që nga ajo kohë familja jonë jeton në Gurëz. Siç më tregonte babai im, në këtë shtëpi Gjeçovi sa ka shërbyer në Kurbin, kishte ardhur disa herë dhe ka qëndruar herë pas here në familjen tonë për të mbledhur të dhëna për Kanunin, meqë gjyshi im ishte plenar i njohur."[250] Sipas Ramadanit, Gjeçovi kishte mbledhur të dhëna edhe nga kosovarë tjerë, që ishin vendosur në fshatrat e Krujës dhe të Durrësit, me të cilët mbante takime të përhershme jo vetëm për çështjen e kanunit, por edhe rreth organizimit të aktiviteteve tjera kombëtare.


Bicaj, me /1923

I nderti Zotni
At St. Gjeçov O.F.M.
Shkodër.

U falem nderit për mirë-
sinë qi patët Z. Uej tue më a
dërguë Hyllin e Dritës, dhe me an-
ë të kësaj dishmoj se ku do qi
e këndova pjesën e ligjës së shty-
punë si në Kala të Dodës pran
Z.Z. Osman Litës, Mulla Osmanit
e në Bicaj Z.Z. Sheh Xhemalit e
Islam Salihut të cilët merren
me këto ligjë, vërtetojn se ligja
qi këta përdorin êsht nji për
nji si e çfaqun prej Z. s'Uej
por vetëm në do ndryshime
të vendit.

Të fala
Kel Vila
Kov. Insp. Arsimit Pref. Kos.

**Faksimili i letrës së Kel Vilës, 1929.**

Sipas dëshmive të letërkëmbimeve të njerëzve që kanë bashkëvepruar në fushën e shpërndarjes së librave, dhe të shtypit të kohës në fshatrat e Prefekturës së Kosovës edhe në territorin e Shqipërisë, mund të kuptojmë se Patër Gjeçovi mbante lidhje të fuqishme me shumë njerëz dashamirës të librit dhe të artit. Por edhe mbajtja e lidhjeve për sjelljen e librave deri në Kukës e pastaj përcjellja e tyre nga malet e Pashtrikut në gjithë Kosovën. Por, gjithsesi karshi shpërndarjes së librave, Gjeçovi e shpërndante edhe të përkohshmen "Hylli i Dritës", në të cilën kohë më parë kishte botuar pjesë – pjesë Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Ardhja e tij në Kosovë, në fillim të vitit 1926, në një mënyrë, i kishte ndihmuar atij që të jetë në krye të detyrës atdhetare, por edhe në krye të punës, që ia kishte parashtruar vetit për t'i bërë përmirësimet dhe plotësimet në Kanunin e Lekë Dukagjinit, varësisht nga të dhënat e reja, që arrinte t'i mbledhtë përmes njerëzve, me të cilët bashkëpunonte vazhdimisht.

Pos aktivitetit të shpërndarjes së librave, në fshatrat e Prefekturës së Kosovës, Gjeçovi bënte përpjekje që ta shpërndante edhe revistën "Hylli i Dritës", përmes së cilës revistë ai dëshironte që të komunikonte me të gjitha zonat ku ishin hapur shkollat.

Një ndër bashkëpunëtorët e Gjeçovit ishte inspektori i arsimit për Prefekturën e Kosovës Kel Vila nga Shkodra, me të cilin duhet të ketë njohje edhe para ardhjes së Kelit në Kukës. Kështu përmes letrës së Kel Vilës inspektor i Arsimit në vitin 1929, pa datë të saktë, arrijmë të kuptojmë se edhe fshatrat përtej kufirit furnizoheshin me libra e gazeta të kohës përmes Gjeçovit, përkatësisht përmes njerëzve që ai i angazhonte:

"I nderti Zotni at Sh. Gjeçov O.F.M. Shkodër

Ju falem nderit për mirësinë qi patët z. Uej tue ma dërgue Hyllin e Dritës, dhe me anë të kësaj dishmoj se ku do qi këndova pjesën e ligjës së shtypun si në kala të Dodës pranë z. Osman Litës, Mulla Osmanit e në Bicaj z. Sheh Xhemalit, Islam Salihut, të cilët merren me këto ligje, vërtetojnë se ligja qi këta përdorin është një për nji si e çfaqun prej z. Uej, por metën në do ndryshme të vendit."[251]

---

[250] E dhënë gojore në maj 2018 e Ramadan Isuf Haliti, i lundur më 1949 në Gurëz të Laçit.

[251] AQSH, Fondi 58, Dosja 100, fl. 37. Letër e Kel Vilës, inspektor i Arsimit të Prefekturës "Kosova".

Kryeinspektori i arsimit në Prefekturës Kosovës Kel Vila, shqyrtime dhe vlerësime rreth Kanunit të Lekë Dukagjinit, do të ketë pasur edhe me zonat tjera, meqë sipas kujtesës popullore ai vet personalisht, por edhe mësuesit që jepnin mësimin në zonat e veriut, interesoheshin që gjatë kontakteve me banorë t'ua lexonin atyre "Hyllin e Dritës" dhe të merrnin mendime në lidhje me kanunin.

Kel Vila gazetën "Hyllin e Dritës" shumë herë për këtë qëllim e përcillte edhe në Kosovë, përkatësisht në Prizren ku ishte rritur përmes njerëzve me të cilët ishte rritur. Dhe kjo dëshmon se me rastin e ardhjes së Gjeçovit në Kosovë, ai kishte angazhuar edhe shumë të njohur të tij që ta ndihmonin në mbledhjen e ndryshimeve sado të vogla që të ishin vendimet kanunore, që gjallonin ende në popull.

Hasan Kraja, nga Vlahna, gjatë një bisede të gjatë në lidhje me të drejtën zakonore në Has, pat deklaruar se "Mësuesit në kohën sa Petër Gjeçovi ishte me shërbim në Malësinë e Gjakovës dhe në Has, shumë herë kishin analizuar pjesë të kanunit dhe i kishin dhënë vërejtjet e tyre. Mbaj mend se flitej se si pleqnarët e Hasit, disa herë ishin takuar me Patër Gjeçovin, në Teqenë e Sheh Tahirit në Planejë. Flitej nga të gjithë se Gjeçovi kishte bashkëpunuar për këtë çështje edhe me Bajraktarin e Hasit Mehmet Alinë, me Sali Qarrin, Hysen Selman Bardhoshin, me Ahmet Zenelin e Qunit e pleqnarë tjerë të Hasit."[252]

Ndërkaq në fshatrat e Tropojës, Gjeçovi kishte verifikuar kanunin vetëm përmes mësuesve, që në atë kohë jepnin mësim në shkollat shqipe në Bujan, në Kolgecaj e në vende tjera dhe sipas të dhënave (shih dorëshkrimet e Gjeçovit), ai kishte shkuar në Bujan të Malësisë së Gjakovës më 18 qershor 1926, ku ishte takuar me disa pleq të Mulosmanëve për t'i mbledhur disa pleqni të pleqnarëve të kësaj kulle siç ishin Binak Alia dhe më pas i biri i tij Shaban Binaku. Më pas me përfaqësuesit e Malësisë së Gjakovës ishte takuar në Gjakovë si me Sali Manin, e në veçanti pas vitit 1927, kur ai kthehet në Gjakovë me grupin e tij emigrantë prej Mitrovicës.

Gjatë angazhimit të Gjeçovi për verifikimin e kanunit, por me gjasë takimet për çështjen e kanunit, ishin më sporadike, se sa ato për çështjen e marrjes së vendimeve për mos lejimin e shpërnguljes, siç shihet në fletorët e Gjeçovit, në btë cilat ka mbajtur shënime për çdo ndryshim, të cilat i ka pasqyruar në një version më të plotë, siç e pohon edhe At Gjergj Fishta.

Pavarësisht mendimeve të disa studiuesve, të cilët theksojnë se Gjeçovi para se të vinte në Kosovë, përkatësisht pas hapjes së ekspozitës arkeologjike në Itali, vet kishte kërkuar që të inkuadrohet në institucionet e shtetit për t'i mbrojtur vlerat arkeologjike të Shqipërisë, që ishin në rrezik për t'u zhdukur. Ai këtë mos pranim të detyrës, për të qenë një zyrtar shteti mbase e ka bërë edhe për ndonjë arsye tjetër, por mbi të gjitha arsyeja, që ai nuk largohet nga Kosova edhe atëherë kur shumë nga miqtë e tij i bëjnë thirrje, që të mos shkojë më në Kosovë, por të qëndrojë përgjithmonë në Shqipëri, ku është më e sigurt jeta e tij. Dhe ky shqetësim i miqve të Gjeçovit vjen pasi Gjeçovi u kishte treguar miqve mbi vuajtjet e popullit shqiptar në Kosovë, që po vuanin nën regjimin sllav. Dhe gjithsesi u kishte treguar edhe për bastisjet, po i bëheshin atij dhe presioni që i bëhej për ta ndërruar shtetësinë.

Nga këto letërkëmbime, fare lehtë mund të kuptojmë se Gjeçovi, pas bastisjeve të njëpasnjëshme më nuk mbante gjëra me vlerë në Qelën e tij, por i përcillte për në Shkodër. Ndonëse shumë nga ato gjëra personale, sot ruhen në AQSH dhe në disa institucione tjera kulturore në Shkodër, mendojmë se një numër i madh i dorëshkrimeve dhe gjërave personale edhe mund të jenë në dokumentet e personaliteteve, me të cilat Gjeçovi kishte marrëdhënie të mira bashkëpunimi.

---

[252] Deklaratë e Hasan Krajës nga Vlahna, dhënë autorit në prill të vitit 2009.

Kështu nga letërkëmbimi i At Tomë Bicajt, famullitar në Laç, i cili më datën 5 tetor 1929 i shkruan një letër Patër Gjeçovit, ku në mes tjerash thekson se nga Patër Çiril, duke u kthye prej Shkodrës në Peshkash, duke kaluar këtu pari më dha lajmin e gëzueshëm se t'i gjendesh në Guhadol e ma zen besë fort u gëzova. Patër Toma në vazhdim shkruan: "Mirë se të ka pru Zoti, shpresoj se ke me ndej për naj kohë të gjatë, kështu tuj e hekë mendjen faret, e mos me u kthye ma në atë dhe në vend tanin, për fat të keq sot për sot i tjetërkujt, d.m.th. kam me pas ma përsngati me u përmallue me ty...."[253]

Nga kjo letër mund të kuptohen shumë gjëra, por mbi të gjitha mësohet fakti se Patër Gjeçovi në Shqipëri ka qenë në fillim të muajt tetor të vitit 1929 edhe pse itinerarin e lëvizjes së tij nuk kemi të dhëna tjera, të cilat mund të na dëshmojnë për lëvizjen e tij, por kujtesa e hasjanëve e kujton mjaftë mirë këtë ardhje të Gjeçovit në Shqipëri, të cilët kanë theksuar shumë herë se Gjeçovi ka kaluar në Shqipëri dhe atë kurrë nuk shkonte vetëm, por shoqërohej herë me Murat Pogën e herë me Kel Vilën, i cili e priste në Kukës.

Me gjasë e kësaj date, apo një -dy ditë më parë (pra e fillimit të tetorit 1929) është edhe letra e patër Çiril Canit, që gjithashtu kërkon nga Patër Gjeçovi, që të ketë kujdes për jetën e tij. Ai në këtë letër që ruhet origjinali në AQSH thekson mes tjerash: "Shumë i dashtuni P. Gjeçov.

Mjerisht dje kur u nisa nuk paç fatin e bardh me t'pa, por t'jesh i sigurt se për herë t'kam n'zemër. Ruju se duhesh persgjallit ma prej atdheut e sivllazneve, qi aq fort i ke përzemër. Po t'falem me shnet tuj turue t'mira sa kokrra ranet janë, i joti P. Çiril Cani"[254]

Këto letra dhe shumë korrespondenca tjera, ku pjesa më e madhe e tyre ruhen në Arkivin e Shtetit, janë dëshmia më e mirë, që Patër Gjeçovi, sa herë që ka ardhur në Shkodër, apo ka kaluar kufirin çështjen e fatit të shqiptarëve të mbetur jashtë Shqipërisë politike e ka diskutuar dhe me shumë të drejtë e ka ngritur si çështje edhe në institucionet shtetërore të vendit dhe ato fetare.

Me shpresën se në një të ardhme, do të thellohemi më shumë në këtë fushë, të zbardhjes së fakteve rreth përpjekjeve të vet Gjeçovit, për ta bërë Kanunin sa më të kompletuar, më të qëndrueshëm ndaj rrebesheve të kohës, po e mbyll këtë projekt ide për të vazhduar kërkimet edhe në të ardhmen, i bindur se për Gjeçovin ka ende shumë për t'u thënë e për t'u shkruar.

Në anën tjetër në fund më duhet të theksoj se çështja e përpjekjeve të Gjeçovit, për t'i verifikuar disa paragrafë të Kanunit të Lekë Dukagjinit, nuk është shqyrtuar as nga akademikët e njohur, që kanë përgatitur librin "E drejta zakonore shqiptare"[255] mbi bazën e Kanunit të Lekë Dukagjinit, prandaj besoj se me shfletimin e të gjitha dorëshkrimeve që rihen nëpër arkiva e biblioteka, kemi arsye që të presim edhe shumë vepra origjinale nga Gjeçovi dhe jetëshkrimin e tij të plotë, për gjithë veprimtarinë atdhetare. Ndërsa për çështjen e verifikimit të kanunit, përkatësisht plotësimin e atyre pjesëve që i ka botuar në "Hyllin e Dritës" dhe botimin final të vitit 1933, ftoj studiuesit që të bëjnë më shumë për këtë temë, sepse çdo rresht i shtuar i plotësuar nga Gjeçovi, ka arsyet e veta dhe domethënien e madhe për trashëgiminë e të drejtës zakonore.

[253] AQSH, Fondi 58, Dosja 100, letër e Patër Tomë Bicajt, 05. XI. 1929.
[254] AQSH, Fondi 58, Dosja 100, letër e Patër Çiril Çanit, tetor 1929.
[255] Aleks Buda (redaktor përgjegjës), E drejta zakonore Shqiptare, Tiranë, 1989.

# ARSIMI NË TERRITORIN E PREFEKTURËS SË KOSOVËS

**Zog Çoçaj**
Student i shkollës së doktoraturës Universiteti i Tetovës- Fakulteti i Historisë

Abstrakti

Ky punim trajton një temë të pashtjelluar deri më tash, ndonëse për arsimin janë shkruar disa artikuj nëpër shtypin e kohës si dhe per arsimimin në përgjithësi,mirpo puni do të ketë trajtim të veçant të arsimit në Prefekturën Kosova duke mos e anashkaluar edhe Lumën dhe Tropojen. Prefektura e Kosovës dha kontributin e saj në shkollimin e shumë personaliteteve të shquara si të Shqipërisë ashtu edhe të Kosovës.

Në kuadër të kësaj teme, jam fokusuar që përmes literaturës dhe dokumenteve të shfletuara në arkivin e shtetit në Tiranë dhe dëshmive tjera, të flas konkretisht për arsimin në territorin e Prefekturës Kosova.

Në kuadër të kësaj teme kam veçuar disa nga personalitetet e njohura të arsimit në kësaj prefekture, sfidat e shkollimit dhe mungesen e gjerave elementare për shkollim. Arsimimi në Prefekturën e Kosovës luajti një rëndësi shumë të madhe sepse pjesa dërmuese e nxënëseve ishin emigrant nga Kosova që u larguan me dhunë nga regjimi i asaj kohe.

Fjal: Prefektura,Kruma,Luma,Hasi,Tropoja, shkollë, nxënës, atëdhetarë,shkollim etj.

## Hyrje

Ashtu si në fushën e historisë, që territori i Prefekturës së Kosovës, që ka një traditë të lavdishme, të shoqëruar me beteja e luftëra të suksesëshme kundër armiqëve të popullit tonë, ashtu edhe në fushën e arsimit, tri krahinat e kësaj prefekture, kanë një histori të ndritëshme të jetës kulturore dhe të arsimit.

Rrugëtimi i arsimit shqip në këtë trevë që nga koha e Skënderbeut, I cili kishte prejardhjen nga Hasi për të vazhduar me fikurat e ndritëshme të arsimitnë Has si : Pal Hasin, Andrea Bogdanin, Pjetër Bogdanin, Pjetër Mazrekun duke vazhduar edhe me figura tjera të ndritura të arsimit shqip si Sheh Tahirin, Dervish Salihun, Osman Nikoliqi, Niman Ferizi, Lazër lumezi, pastaj të krahinës së Lumës me Riza Spahinë.

Në rrjedhat e zhvillimeve historike të kombit shqiptar, krahina e Hasit, në veçanti nga trevat tjera shqiptare, ka qenë zonë, ku zhvillimet historike kanë kaluar përmes kurrizit të saj, për të cilat zhvillime deri më sot pak është shkruar. Andaj, duke parë se Hasi, ishte bartëse e ngjarjeve historike, e të periudhës së gjysmës së parë të shekullit XX, do të flas për një periudhë historike që la gjurmë në historin tonë kombëtare e kjo periudhë është përiudha e arsimit në Prefekturën e Kosovës.

Arsimi në territorin e Prefekturës Kosova

Ashtu si në fushën e historisë, që territori i Prefekturës së Kosovës, që ka një traditë të lavdishme, të shoqëruar me beteja e luftra të suksesshme kundër armiqve të popullit tonë, ashtu edhe në fushën e arsimit, tre krahinat e kësaj prefekture, kanë një histori të ndritshme të jetës kulturore dhe të arsimit. Rrugëtimi i shkollës shqipe në territorin e Prefekturës së Kosovës, ka një histori të gjatë dhe fillon që në kohën e Skënderbeut, që ishte me prejardhje nga Hasi për të vazhduar më pas me hasjanët e famshëm Pal Hasin, Andrea Bogdanin, Pjetër Bogdanin, Pjetër Mazrrekun e më vonë edhe me patriotët tjerë, që nuk iu ndanë asnjëherë shkrimit dhe msimit të gjuhës shqipe si Sheh Tahirin, Dervish Salihun, Osman Nikoliqi, Niman Ferizi, Lazër Lumezi, pastaj në Krahinën e Lumës me Riza Saphinë e shumë të tjerë arsimdashës, të cilët secili në bazë tëmundësive të tyre bënë përpjekje të vazhdueshme për të hapur shkolla në gjuhën shqipe.[256] Populli i krahinave të prefekturës së Kukësit ka tradita të hershme në mësimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, por të dhëna të dokumentuara kemi që nga shek. XVI. Fundi i këtij shekulli dhe ata të mëvonshmit u përcollën nga një radhë figurash të njohura lëvruesish të gjuhës shqipe, si Pal Hasi, Pjetër Mazreku, Ndre Bogdani, Pjetër Bogdani. Lukë Bogdani, Gjon Kazazi, Tahir efendi Jakova etj. Të gjithë këta, me veprat që shkruan, krijuan një traditë të tërë, që njihet, tanimë, si "traditë hasjane" (më saktë kosovare), sepse shumica e tyre vijnë nga ajo krahinë.[257]

I pari i kësaj tradite relativisht të gjatë, krijuar në kushte të vështira historike, është Pal Hasi, i cili sipas një dëshmie të Pjetër Budit pat shkruar, përkthyer a përshtatur disa krerë të një libri

[256] Nexhat Çoçaj, Parathënia e librit, Internati "Kosova" 90 vjet në Krumë, Prizren, 2018, fq. 11.
[257] Shefqet Hoxha, Riza Spahiu e shkolla e Kolesianit (1911- 1951), "GEER", Tiranë, 2001.fq.8

fetar me emrin "Dita e gjygjit". Siç duket, ky frat prej Hasi pat jetuar e vepruar në fundin e shek. XVI a në fillim të shek. XVII.[258]

Në shek. XVII punuan në Has ose jashtë tij disa pinjoj familjesh të njohura hasjane, Mazreku e Bogdani, të cilët, kush më pak e kush më shumë, na kanë lënë ndihmesa me vlerë në lëvrimin e shqipes. Njëri prej Mazrekajve, Pjetri, në një relacion që i dërgonte Romës më 1635, jepte një listë prej 32 fjalësh, e cila ka rëndësi, sepse na sjell trajta fjalësh shqipe të përdorura në atë shekull, para fjalorit të Frang Bardhit (1635) dhe është si të thuash, përpjekja e parë në historinë e gjuhësisë shqiptare për një analizë etimologjike të Balëve.[259]

Ndihmesë të madhe për lëvrimin e shqipes në shek. XVII ka dhënë, sidomos, trinomi bogdanian: Ndreu Pjetri Luku. Ndërsa i pari, Ndreu (fill. i shek. XVII-1683), pat shkruar një gramatikë latinisht-shqip, që besohet si e humbur', Pjetri (1630-1689) ka lënë veprën voluminoze "Çeta e Profetëve", e cila u botua, së pari, në Padovë, më 1683. Në hyrje të kësaj vepra, krahas shumë kushtimeve, gjendet edhe një vjershë prej njëzet strofash katërshe, nënshkruar nga Lukë Bogdani, kushëri i Pjetër Bogdanit. Më 1641, Ndre Bogdani, famullitar i Gurit të Hasit, mbante në qelën e tij dy gjakoj, të cilëve, krahas latinishtes, u mësonte edhe gjuhën shqipe. Te ky pohim na çon fakti se ky siç thamë më sipër është autor i një gramatikë dygjuhëshe, si dhe thëniet e të nipit, Pjetrit, se i ungji e kishte ndihmuar atë për të shkruar veprën "Çeta e Profetëve".[260]

Në shek. XVIII kemi përsëri një "Doktrinë të Krështërë" nga Gjon Kazazi, për të cilin shumë nga studiuesit theksojnë se është nga Gjakova, por që në fakt ai është nga Kushnini i Hasit, meqë në atë periudhë edhe vet Gjakova ishste fshat i territorit të Hasit.

Gati njëqind vjet pas veprës së Kazazit, Tahir efendi Jakova (1835) botoi disa vjersha fetare shqip me alfabet arab me titullin "Emni Vehbije", pak vite më vonë Sheh Tahir Shehu nga Planeja hartoi një libër me shkrime juridike, i cili libër vetëm një kopje ruhet në Teqenë e Planejës dhe ende nuk është deshifruar, ndërsa në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit bejtexhiu nga Lubizhda e Hasit Dervish Salihu ka shkruar mbi tridhjetë ilahi, shumë prej të cilave në gjuhën shqipe.[261]

Ky aktivitet i gjatë letrar në Krahinat Verilindore shqiptare nuk mund të zhvillohej shkëputur mësimit të gjuhës shqipe, por të dhënat për trajtimin e këtij problemi, sidomos për trevën e prefekturës së Kukësit, nuk janë të begata. Asgjëmangut, një skicë gjithsesi jo e plotë mund të ravijëzohet.

"Pothuaj pas 23 vjetësh, përsëri Ndre Bogdani, tani Arqipeshkëv i Shkupit, me 15 nëntor 1664, i rekomandon Kongregacionit Propagandës Fide, nga Janjeva, për mësues të shkollës katolike të asaj qendre, një mazrekas, kushëri të tij. Dhe, pa kaluar asnjë vit, kërkesa e tij është pranuar. Tani, më 1665, misionari apostolik, Pjetër Mazreku jep mësim në atë shkollë

[258] Po aty, fq. 8.
[259] Po aty, fq. 8.
[260] Po aty, fq. 9.
[261] Nexhat Çoçaj, Hasi enciklopedi entografike, vëll. I, në dorëshkrim.

dhe, madje, më 25 qershor 1666, njofton eprorët se detyrën e filluar po e kryente me shumë zell“.[262]

Duke ndjekur vazhdën e lavdishme të kohës së Skënderbeut për të ngjallur ndjenjat e atdhetarizmit shqiptar, të bashkimit kundër pushtuesit osman, padyshim një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe punëtorët e arsimit që luftuan me armë e pendë për lirinë dhe arsimin tonë të shtrenjtë.[263] Ndonëse, institucioni i shkollës, në këto krahina është më i ri, apo nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, kullat e malsorëve të këtyre anëve kishin shërbyer shkolla, në të cilat janë mësuar, e ushtruar në frymën kombëtare. Oda shqiptare e këtyre malësive, ishte më shumë se odë burrash, sepse jo vetëm përmes këngëve epike, por edhe përmes rrëfime u mësua historia e përgjakshme e këtyre banorëve, të cilët ku më shumë e ku më pak e kaluan kohën, duke e trashëgua artin luftarak dhe duke e mbajtur gjallë, frymën dhe ndjen kombëtare. Pra, kullat e Malësisë së Gjakovës, të Hasit e të Lumës, e mbajtën ndezur në çdo etapë të historisë flakadanin e atdhedashurisë. Me këtë rast duhet t’i përmendim disa nga kullat shkolla të brezave të krahinave të Prefekturës së Kosovës siç ishin Kulla e Mic Sokolit, Binak Alisë në Bujan, Kulla e Ali Ibrës, në Malësi të Gjakovës, Kulla e Sylë Kurpalit, Kulla e Mehmet Ali Bajraktarit, Kulla e Qarrit e Kullat në Perollaj, Golaj, në Has, Kullë Luma, Kulla në Domaj, Kullat në Bicaj, Kolesajan e shumë kulla tjera, të cilat në një formë apo në një formë tjetër ishin shkolla të vërteta kombëtare, ku u skalitën me dhjetra e qindra luftëtarë të lirisë, që i dhanë emër e namë këtyre krahinave.

Përpjekjet për ruajtjen e traditës së gjuhës shqipe, në krahinat, që e përbëjnë prefekturën e Kosovës e kanë vazhduar edhe më tej rrugën e dijes, por mjerisht për një periudhë të gjatë kohe mungojnë dëshmitë e shkruara, sepse siç e thotë Pjetër Budi i Gurit të Bardhë të Matit, ai kishte mësuar të shkruaj shqip nga Pal Hasi, por për Pal Hasin, ende nuk dihet se çfarë ka shkruar e ku janë sot ato shkrime. Në anën tjetër as Gramatika e Andrea Bogdanit, e as shkrimet e vjetra. Kjo prfekturën gjatë rrugëtimit të dijes, në aspektin e shkrimit fillon me Pjetër Bogdanin, me doktorin e parë të shkencave teologjike në viset e verilindore, por edhe me kryengritësin më të rreptë ndaj forcave okupuese turke, që lidhi bashkëpunim me forcat Austro- Hungareze, përkatësisht me forcat e udhëhequra nga Gjeneral Pikolominin.[264] por një gjë është e çartë se tradita e arsimit dhe e shkrimit të shqipes në Has ka ndikuar në avancimin e arsimit shqip dhe është e pamundur që të bëhet ndonjë studim apo vështrim për historinë e shqipes e të mos flitet për kontributin e hasjanëve, që dhanë gjatë shekujve. Gjatë shekullit XIX në disa fshatra të Lumës, Hasit e Malësisë së Gjakovës, kanë funksionuar disa shkolla laike, kryesisht fetare, të cilat udhëhiqeshin nga klerikët fetarë, në të cilat pos mësimit fetarë, mësohej gjuha turke dhe disa lëndë tjera mësimore e më vonë nisi të mësohej fshehtazi edhe

[262] Jashar Rexhepagiq, Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918, Prishtinë, 1970, fq. 49.
[263] Sami Ferizi, Me pushkë e penë për arsim e dije, botuar në gazetën “ Kukësi i Ri” më 11 shkurt 1987.
[264] Gjeneral **Enea Silvio Piccolomini** (1640–1689) mori pjesë së bashku me forcat kryengritëse shqiptare të udhehqura nga Pjetër Bogdani. Vdiq në Prizren në vjeshtën e vitir 1689 dhe u varros në Prizren në oborrin e Xhuma Xhamisë, varr që është edhe sot ndër dëshmitë e bashkëpunimit me ushtrinë Austro- Hungareze, me qëllim çlirimin e vendit.

gjuha shqipe, por në atë masë sa të thuhet se shkollat shqipe ishin të përhapura edhe zonat verilindore, përkatësisht në territorin e Prefekturës së Kosovës.

Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të shqiptarëve në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që të hapen shkolla në gjuhën shqipe Turqia, nuk ia mundësoi popullit. Në dokumentet programatike të Lidhjes, arsimi dhe shkolla zënë vend të veçantë. Në vendimin e degës së Lidhjes Shqiptare në Dibër (14 tetor 1978) kërkohet që:

Neni 2: të gjithë nëpunësit që do të jenë në Shqipëri duhet të dinë gjuhën e vendit;

Neni 3: të përhapet arsimi dhe në shkolla të mësohet edhe gjuha shqipe;

Neni 5: të ndahet një sasi e miaftueshme nga të ardhurat e përgjithshme të vilajetit për t'u shpenzuar për përparimin e arsimit si dhe për ndërtime publike.[265]

Ministria e Arsimit e Perandorisë Osmane u krijua më 1857, ndërsa në vitin 1869 u nxorr ligji mbi arsimin laik, kurse në Kushtetutën e Perandorisë Osmane ( 23. XII. 1876), sipas nenit 15, ku thuhet" Mësimet janë të lira. Çdo qytetarë otoman, brenda kufijve të ligjit ka të drejtë të hapë shkolla publike apo private", ndërsa mësimi u proklamua i lirë, nën kontrollin e shtetit. Mirëpo ligjet e kësaj kushtetute nuk u zbatuan në jetë për shqiptarët.[266]

Në vitin 1873, siç na dëshmon salnamia (vjetorja) e Vilaietit të Prizrenit, në Lumë kishte 6 shkolla fillore turke, por ato ishin institucione mësimore-fetare fare,[267] çfarë ishin edhe në zonat tjera të territorit të Prefekturës së Kosovës si në Planëje, në Gjonaj, në Damjan, në Rogovë, në Tregtan, në Helshan, në Bujan, në Tropojë e në vendbanime tjera ku kishte xhami.

Shkolla e parë, në këtë zonë mendohet të ketë qenë shkolla në Zym, ku në vitin 1900 ka ekzistuar një abetare, e cila mban datën 20 maj 1900 dhe njihet si Abetarja e Zymit.[268] Kjo do të thotë se në këto krahina ka pasur shkolla edhe në gjuhën shqipe, ani pse ato shkolla mësimin e kanë zhvilluar në ambientet e kulteve fetare.

Në vitin shkollor 1901-1902, me nismën e përpjekjet e klerikut lumjan, Sulejman Laçi, i cili ishte nasi[269] për arsimin në Prizren, u hapën në krahinën e Lumës 12 shkolla laike-tutke, të cilat kishin si mision të "zbutnin" krahinën e pabindur dhe të panënshtruar të Lumës, si dhe

---

[265] Shefqet Hoxha, Riza Spahiu e shkolla e Kolesianit (1911- 1951), "GEER", Tiranë, 2001, fq. 12.
[266] Jashar Rexhepagiq, Shkollat dhe arsimi në Kosovë nga fundi i shekullit XVIII gjer më 1918, "Kosova" Nr. 1, Prishtinë 1972, f. 110 & Emin Pllana, Kosova dhe reformat në Turqi, Prishtinë, 1978, f. 43.
[267] Shefqet Hoxha, Riza Spahiu e shkolla e Kolesianit (1911- 1951), "GEER", Tiranë, 2001, fq. 14.
[268] **Abetarja e Zymit** (20 maj 1900) u gjet në Arkivin Qendror të Republikës së Shqipërisë: nën siglën F. 65, D. 163, Koleksioni i fondeve personale para vitit 1912, Jak Speci, që ka 80 faqe, por i mungojnë kopertinat. E njohur si Abetarja e Zymit, ajo ka 80 faqe, 33 germa e tinguj, duke e bere abc-në me te vjetër qe ne ruajmë sot. Abetarja i përket gjysmës se dyte te shekullit te 19-të, është e realizuar me germa latine dhe ne nje material shpjegues qe shoqëron abetaren e shaptilografuar, zbulohet se ajo i është dhuruar Lumo Skendos nga profesor Luigj Shala, i cili e gjeti ne Prizren ne 20 maj te vitit 1900. Sipas specialisteve, ne rrethanat e sundimit osman, ky tekst ka vlere si një nder abetaret e para te shqipes ne Kosove. (Ndue Ballabani & Frrok Kristaj, Abetarja e Zymit (20 maj 1900), Famullia e të Ngriturit të Shën Marisë në Qiell, 2013.)
[269] Nasi – këshillëtar.

t'u kundërviheshin përpjekjeve të patriotëve për hapjen e shkollave në gjuhën amtare. Këto shkolla u hapën në katundet Bicaj, Kolesjan, Lusën, Vile, Fshat, Brekijë, Shtiqën, Surroj, Bardhoc, Ujmisht, Arën e Radomirë.[270] Në programet e këtyre shkollave lëndët fetare zinin vendin kryesor, por jepeshin edhe elemente të gjeografisë e historisë osmane, të gramatikës së turqishtes, aritmetikë, këndim-shkrim dhe mësime morali. Tekstet silleshin nga Stambolli dhe paguheshin nga nxënësit, përveç teksteve të fesë që shpërndaheshin falas.

Gjatë luftërave për liri në trevën e Hasit, në vitet e para të shekullit XX (1903 – 1908), mësohej gjuha shqipe në male, nëpër shtëpi e kasolle të hasjanëve,[271] ku në trevat tjera të okupuara të Kosovës, as që bëhej fjalë për një aktivitet të tillë kombëtar. Ndërsa nga historiku i shkollës në Golaj, mësohet se ndër mësuesit e parë në këtë shkollë ka punuar Osman Nikoliqi, patriot dhe njëri ndër ideologët e Rilindjes në Shqipërinë e Veriut. Në shkollën e Golajt, sipas dëshmive të kohës, shkrim lexim ka mësuar edhe Shotë Galica, gjatë kohës sa ajo kishte qëndruar në këtë fshat. Shota Galica gjatë qëndrimit të saj në Golaj të Hasit, sa herë që takohej me bashkëluftëtarë u thoshte atyre: ”Jeta pa dije është si lufta pa armë”. Andaj, ajo gjatë vitit 1922/23, kur luftëtarët shqiptarë, që po përgatiteshin për një kryengritje të fuqishme kombëtare, iu bashkua bashkëluftëtarëve për të mësuar shkrim – leximin e gjuhës shqipe, përkatësisht alfabetin e gjuhës shqipe.[272]

Në vitet 1905-1906, në qytetin e Gjakovës arsimdashësit shqiptarë si Osman Nikoliqi, Riza Thaçi, Haxhi Tahiri e tjerë organizoheshin grupe – grupe dhe mësonin gjuhën amtare nën ndjekjet e rrepta të osmanlinjve. Në këto kurse mësoi edhe Sylejmani, i cili në vitin 1909 – 1910 ka shkruar disa artikuj të thjeshtë në kalendarin "Besa Kombtare", që dilte në Sofie, me titull "Si po përhapet shkrimi e këndimi në popullsinë shqiptare të Gjakovës dhe në Malësinë e saj."[273]

Gjatë viteve 1910 – 1911, lëvizja për arsim në zonën e Prefekturës së Kosovës bëhet më aktive. Madje kjo është periudha, ku në fshatrat e krahinave të Prefekturës së Kosovës: Lumë, Has e Malësi të Gjakovës do të hapen shkollat e para në gjuhën shqipe, duke mos llogaritur shkollat fetare, në të cilat edhe më herët mësohej edhe gjuha shqipe pos mësimeve fetare. "Qeveria xhonturke, e alarmuar për këtë problem, në pranverë të vitit 1911 dërgoi në Gjakovë me qëllim agjitacioni e presioni për të detyruar popullin e atjeshëm, që të heqë dorë nga përdorimi i gjuhës shqipe me germa latine, ministrin e brendshëm Haxhi Adil, i cili duke përdorur dhunën dhe demagogjinë, synonte që t'i bindet ose ta detyronte parinë e vendit të bënte kërkesa për alfabetin shqip me germa arabe e jo me germa latine dhe si shpërblim u premtoi atyre se qeveria turke do t'u paguaj të gjitha dëmshpërblimet për shkatërrimet e shkaktua nga ekspeditat ndëshkimore të Shefqet Pashës në këto krahina."[274]

[270] Shefqet Hoxha, Riza Spahiu e shkolla e Kolesianit (1911- 1951), "GEER", Tiranë, 2001, fq. 15.
[271] Sami Ferizi, Shkolla e Krumës fole e edukimit patriotik e revulucionar të brezit të ri, botuar në Revistën pedagogjike Nr. VI, f. 145.
[272] Edi Shukriu, Gra të shquara shqiptare, Prishtinë 2000, f. 64.
[273] Selim Matoshi, Një shekull dritë (arsimi në Tropojë në shekullin XX), Tiranë, 2004, fq. 30.
[274] Selim Matoshi, Po aty. 30.

Kërkesat e shqiptarëve për shkollat shqipe, nga ana e Qeverisë turke u kundërshtuan dhe në vend të këtyre kërkesave, ata kërkuan që fëmijët e malësorëve të regjistroheshin në shkollat ushtarake turke. Por propozimet e tilla as që u pranuan nga malësoret, sepse ishin të bindur se vetëm me anë të shkollave shqipe vendi mund të përparojë dhe do të mund të çlirohet. Lufta për hapjen e shkollave shqipe në krahinat e Prefekturës së Kosovës lidhet ngushtë me Plakun e Maleve Bajram Currin, i cili karshi angazhimit për luftë të armatosur, ai ishte i angazhuar edhe për hapjen e shkollave shqipe, me qëllim që fëmijët e malësorëve atdhetarë të shkollohen dhe atdhedashuria e tyre të mbillet brez pas brezi.

### 3.1.2. Hapja e shkollave në gjuhën shqipe prioritet i Prefekturës së Kosovës

Si vazhdë e përpjekjeve të rilindrasve për përhapjen e shkollave në gjuhën shqipe në krahinat verilindore, vazhdoi edhe në vitet e fundit të sundimit të tokave shqiptare nga Perandoria Osmane. Gjatë këtyre viteve, pavarësisht përpjekjeve të shumë atdhetarëve, nuk u krijuan mundësi për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Kërkesat për zhvillimin e arsimit shqip në krahinat verilindore u pasqyruan denjësisht në Kuvendin e katër bajraqeve të Malësisë së Gjakovës si të Krasniqes, Hasit, Gashit dhe Rekës në fund të prillit 1912, kuvend ky që u mbajt në Krasniqe, ku në mes tjerash në memorandumin prej 10 pikësh të këtij kuvendi, ishte edhe kërkesa për hapjen e shkollave shqipe me alfabetin latin.[275] Ndërkaq N. Koleci, në lidhje me këtë kërkesë shton se më 9 maj 1912, një ndër kërkesat e kryengritësve të Hasit e të Malësisë, ishte që të hapen shkolla shqipe dhe të lihet i lirë mësimi i gjuhës shqipe në alfabetin latin.[276]

Sipas të gjitha dëshmive, shkolla e parë në territorin e Prefekturës së Kosovës, është hapur në Golaj të Hasit e më pas në Kolesjan, në Krumë e në vendet tjera. Përpjekjet për të pasë shkollë në këtë fshat janë të hershme[277], pra që në kohën e sundimit turk, kur më 1905, në Nikoliq, ishte hapur një mejtep, kur banorët e fshatrave përreth pos mësimeve fetare mësonin fshehurazi edhe gjuhën shqipe, ndërsa më 1908 një shkollë fetare, mejtep hapet edhe në fshatin Golaj, me iniciativën e hoxhës së fshatit Niman Ali Dautit,[278] i cili nga pasuria e tij e patundshme për ngritjen e kësaj shkolle, e cila më pas u bë vatër e atdhetarëve të shquar të

[275] Shukri Rahimi, Kryengritjet shqiptare në Kosovë më 1908 – 1912, botuar në Kosova Nr. 1. Prishtinë 1972, f. 79.
[276] Niko Koleci, Kryengritja e përgjithëshme shqiptare, f. 42.
[277] Isa Halilaj, vepra e cituar, f. 169.
[278] Po aty, f. 169 & Sami Ferizi, Zhvillimi i arsimit dhe mësimit pedagogjik në Rrethin e Kukësit në vitet 1912-125 (punim në dorëshkrim i shtypur me makinë shkrimi, që autori e kishte përgatitur për një botim të veçantë dhe që në vitin 1995 ia dha Besim Muhadrit për të shikuar mundësinë e botimit të një vepre. Në këtë dorëshkrim ipen edhe shumë të dhëna tjera për zhvillimin e arsimit në Rrethin e Hasit)

kombit. Në këtë shkollë- mejtep, përveç mësimit fetar, nxënsit e këtij fshati mësonin edhe alfabetin e gjuhës shqipe nga mësuesit patriotë Mehmet Daklani, Niman Ferizi, Osman Nikoliqi, të cilët edhe u përpoqën që këtë mejtep ta shndërrojnë në shkollë kombëtare.[279] Mësuesi atdhetar Osman Nikoliqi me të rinjtë e fshatit Golaj, paralel me shkollën e mejtepit, në shtëpinë e Sadik Ramës ua mësonte të rinjve alfabetin e shqipes. Përpjekjet e mësuesve atdhetarë u kurorëzuan në vitin 1911/1912, kur në shkollën e ngritur në Golaj paralelisht mësohej edhe gjuha turke edhe shqipe. Në vitin 1916 shkolla e fshatit në Golaj u dogj, por mësimi nuk u ndërpre në asnjë çast, nga se tash në shkollën e këtij fshati përpos nxënësve, që i ndiqnin mësimet, shkrim leximin në gjuhën shqipe nisën ta mësojnë edhe shumë atdhetarë nga shumë vise të Kosovës. Në vjeshtën e vitit 1919, nga pushtuesit serbë, nuk u lejua fillimi i mësimit në shkollën e Golajve, mirëpo pas tërheqjes së serëve nga Hasi i Shqipërisë, në tetor të vitit 1922, mësimi në gjuhën shqipe në këtë shkollë filloi përsëri. Sipas kujtimeve të nxënësve të kësaj shkolle, shkolla ishte hapur falë kontributit të Bajram Currit dhe të atdhetarëve tjerë, të cilët çështja kombëtare i kishte bashkuar me hasjanët. Sipas dokumenteve, që i posedon historiku i kësaj shkolle në vitin shkollor 1922, kjo shkollë kishte 35 nxënës. Ndërkaq referuar dëshmive të mësuesëve dhe nxënësve të kësaj shkolle, në vitin 1923, në këtë shkollë hyjnë për të mësuar gjuhën shqipe edhe luftëtarët e lirisë. Këtë atmosferë e përshkruan Ibrahim Çavolli, duke sjellë para opinionit kujtimet e mësuesit atdhetar Sali Morina, i cili në mes tjerash kujtonte vjeshtën e ftohtë të këtij viti: “ Çetat patriotike, që po e mbrojnë me heroizëm tokën e lashtë, vatrat e tyre dhe nderin. Ata luftojnë për atdheun, po në kohën e lirë i kushtohen mësimit dhe mësojnë gjuhën shqipe. Kështu një deri sa unë isha në shkollë, dëgjoj trokitje në derë dhe më pas me radhë hyjnë në klasë nxënësit. Nxënës të çuditshëm, me armë dhe rrethatore fishekësh në brez Të rreptë në luftë, por të urtë në mësim... midis tyre edhe heroina Shota Galica.”[280] Mësimin e atdhetarëve në shkollën e Golajt e dëshmon edhe Isuf Duraku, nxënss i kësaj shkolle, pre vitit 1924/25, ndërsa pas një viti do të jetë nxënës i internatit “ Kosova” në Kolgecaj deri më në maj 1930 e pastaj kalon në Krumë.[281] Në shkollën në Golaj pos mësuesve Osman Nikoliqit e Sali Morinës prej vitit 1922 e deri më 1938, kanë punuar edhe mësuesit Mark Gashi, Latif Jaku, Qazim Saraqi, Bajram Nura, Shaban Ferri, Shukri Bulica etj.[282]

Përafërsisht ngjashëm me shkollën e Golajve është edhe historia e shkollës së Kolesjanit, e cila dëshmohet se është hapur në vitin 1911. “Hapja e shkollës shqipe në Kolesjan të Lumës, më 1911, qe një ngjarje e madhe për malësorët e këtyre anëve, të cilat e kishin dëshiruar por s’kishin mundur ta kishin më parë një shkëndi të tillë, e cila do të ndriçonte jo vetëm mendjet e vocrrakëve, por edhe të të rriturve.[283] Por edhe shkolla e Kolesjanit, sikurse shkolla e Golajve e më vonë edhe ajo e Krumës dhe tek tuk ndonjë shkollë tjetër në këto anë, patën

[279] Sami Ferizi, punim i cituar f. 6.
[280] Ibrahim Çavolli, Sali Morina, patriot e veteran i arsimit, artikull i botuar në revistën pedagogjike “ Mësuesi” më 23 maj 1979, në Tiranë.
[281] Besim Muhadri, intervistë me Isuf Durakun ( 1911- 1992): Njeriu që gjithë jetën mbeti i harruar e i antemuar, “Etja” mars 1992. Isuf Duraku, pas mbarimit të shkollës në Tiranë, për një kohë ( 1932 – 1941) do të puni mësues në shkollën në Bicaj dhe në Kukës.
[282] Isa Halilaj, vepra e cituar, f. 171 dhe Sami Ferizi, punim i cituar..
[283] Shefqet Hoxha, Riza Spahiu e shkolla e Kolesianit (1911- 1951), “GEER”, Tiranë, 2001, fq. 35.

ISSN 1800-9794 (Print) ISSN 2337-0521 (Online)

fatin e njejtë që të punojnë jo rregullisht, siç punon shkollat në qendrat tjera të Shqipërisë, por me ndërprerje, për shkak të pushtimeve që do ta përfshijnë këtë territor. Prof. Sh. Hoxha në librin e tij kushtuar mësuesit të parë të Lumës Riza Spahiut thekson se gjatë viteve 1911-1921 Luma u pushtua tri herë nga serbët, poashtu edhe nga austro-hungarezët gjatë Luftës së Parë Botërore dhe për pak kohë edhe nga bullgarët. Andaj, në kushte dhe rrethana të tilla shkolla e Kolesjanit punoi edhe fshehtas, prandaj me të drejtë është quajtur “shkollë kaçake”.[284]



| Pasqyrë e shërbimevet dhe e rrogave | | | | | | | | | | Emnime | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Vendet e shërbimit | Cilësija e shërbimit | Koha e shërbimit Prej | Deri | Shkaku i ndërrimit të vendit | Rroga mujore | Koha e vazhdimit të rrogës Prej | Deri | Shkaku i ndryshimit të rrogës | Data e shkresave t'autoritetit | Nr. | Data |
| Krumë | Mësues | 8-I-1914 | 10-IV-1915 | okupacioni serb | Fr. ari 120 | 8-I-1914 | 10-IV-1915 | | | 18 (Vendim Kësh.) | 22-I-1 |
| Gjakovë | " | 1-III-1916 | 30-IX-1918 | " | 120 | 1-III-1916 | 30-IX-1918 | | | 101 ( " " ) | 8-VI-19 |
| Tiranë | " | 10-VI-1921 | 30-VIII-1922 | Mbyllet shkolla | 260 fr. ari | 10-VI-1921 | 30-VIII-1922 | | | | |
| Shkodër | " | 1-IX-1922 | 31-V-1923 | s'dihet | 220 " " | 1-IX-1922 | 30-IX-1923 | | | 898/III | 16-VII-1 |
| Himarë | " | 1-VI-1923 | 30-IX-1923 | " | 220 " " | — | — | | | | |
| Tropojë | " | 1-X-1923 | 15-IV-1925 | " | 200 " " | 1-X-1923 | 15-IV-1925 | ngushtic budjeti | | | |
| Kolgecaj | " | 16-IV-1925 | 31-III-1926 | " | 180 " " | 16-IV-1925 | 30-IX-1929 | " " | | | |
| Gjolaj | " | 1-IV-1926 | 31-III-1927 | " | 180 " " | — | — | " " | | | |
| Kolgecaj | " | 1-IV-1927 | 30-IX-1928 | " | 180 " " | — | — | " " | | | |
| Kukës | " | 1-X-1928 | 30-IX-1929 | " | 180 " " | — | — | " " | | | |
| Krumë | Drejtor | 1-X-1929 | 30-IX-1930 | " | 235 " " | 1-X-1929 | e këndej | gradim | Nr. 4249/II dt. 20-IX-1929 | | |
| Kukës | Kryemësues | 1-X-1930 | 30-IX-1931 | " | 235 " " | — | " | | | | |
| Krumë | Drejtor | 1-X-1931 | 31-X-1935 | " | 235 " " | — | | | | | |
| Bicaj | Kryemësues | 1-XI-1935 | e këndej | | 235 | | | | | | |

Lista e veprimtarisë arsimore të Ibrahim Kolçit, që origjinali i kësaj liste dhe ditari i tij personal, ruhen në Arkivin e Kosovës

Mësues i parë i shkollës së Kolesianit ishste Riza Spahiu,[285] i cili dha një kontribut të çmuar në arsimimin e brezave jo vetëm në Kolesjan, por në gjithë Lumën e më gjerë. Sipas dokumentacion që ka publikuar Sh. Hoxha shkolla e Kolesjanit ka nisur punën nga gushti i vitit 1911. Në atë kohë shkolla e Kolesjanit kishte 15 nxënës të cilëve Riza Spahiu nisi t’ua mësojë fëmijëve edhe alfabetin e gjuhës shqipe dhe në këtë mënyrë mund të thuhet se nisi hapat e par shkollimi në gjuhën shqipe në Lumë.

Në vitet e para të shkollës së Kolesjanit u përdor alfabeti i Stambollit, ndërsa librat ishin botime të shoqatave në Rumani, por vinin edhe nga Shkodra.[286] Në vitin e dytë shkollor të kësaj shkolle 1912 – 1913, me ndryshimin e rrethanave historike, mësimet e shqipes nisën të jepeshin edhe haptas, pasi që nga qendra e kazasë së Shtiqnit ishte larguar administrate turke.

[284] Shefqet Hoxha, Po aty.

[285] Riza Spahiu (1891- 19 ) U lind në Kolesjan. I ati i Rizait ishte njëri ndër patriotët më të shquar të krahinës së Lumës Islam Spahia, i cili ka kontribuar shumë në çështjen kombëtare. Rizai mësimet e para i mori në mejtepin e fshatit, për të vazhduar më pas shkollimin në Prizren. Gjatë kohës sa Rizai i ndiqte mësimet në shkollën turke, ran ë kontakt me shkronjat shqipe, pra me mësimin e gjuhës shqipe dhe në këtë mënyrë gjuhën shqipe pothuaj se e përvetëoi fshehtazi. Sipas kujtimeve të tij, aimë pas kishte ra në kontakt me mësuesin e gjuhës shqipe Lazër Lumezi, i cili i kishte ndihmuar edhe më shumë që të mësonte gjuhën shqipe. Rizai pasi mbaroi shkollën e mesme në Prizren dhe pasi kreu kursin pedagogjik në Shkup, në vitin 1911 emrohet mësues i shkollës turke në Kolesjan. Për disa vite mësuesi Riza Spahiu punoi pa pagesë vetëm e vetëm që t’ua mësonte gjuhën shqipe fëmijëve.

[286] Shefqet Hoxha, Riza Spahiu e shkolla e Kolesianit (1911- 1951), “GEER”, Tiranë, 2001, fq. 41.

Në Lumë pos shkollës së Kolesinait në vitin 1914 hapet një shkollë shqipe edhe në Bicaj, e cila vazhdoi punën deri në vitin 1915. Mësuesi I kësaj shkolle ishte prizrenasi Ibrahim Gota.

Po në këtë kohe kemi edhe hapjen e shkollës në Krumë të Hasit, pasi lulëzimi i Krumës ishte pothuajse në rënie e sipër, nga fundi i shekullit XIX, por megjithëqë Kruma ende kishte mbetur një qendër tregtare e njohur për tregtarët shqiptarë nga të gjitha viset, kur qyteti i sotëm Kukësi (më 1910) ishte një vendbanim i vogël me gjithsej 12 shtëpi dhe ishte fshat blegtoral.[287] Roli i Krumës në zhvillimin e tregtisë, të lëvizjes së tregtarëve, vend i preferuar i shumë udhëtarëve botëror, nuk kaloi pa lënë edhe gjurmët e veta në traditën e arsmit. Referuar dokumentit që ruhet në Arkivin e Kosovës, në Fondin e Ibrahim Koçit[288] me signaturë XXXIV, K.1-24, të cilin e citon Abdullah Vokrri në librin për mësuesin patriot Ibrahim Kolçin shton: Pas largimit nga kalaja e Dodës, Ibrahim Kolçivjen me detyrë në Krumë. Aty do të punojë prej 8 janarit të vitit 1914 deri më 10 prill 1915.[289] A. Vokrri në vazhdim shton se kjo shkollë fillore e përzier u hap me kërkesën e banorëve të këtij mjedisi dhe se deri në hapjen e kësaj shkolle ishte zhvilluar një aktivitet i dendur. Paria e Krumës i kishte bërë përgatitjet e duhura, mirëpo Ministria e Arsimit nuk ishte treguar gjithaq e efikase. Në të vërtetë kjo shkollë do të hapet vetëm pas intervenimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila atëherë shkëmbeu shumë shkresa me Ministrinë e Arsimit. Në shkresën e Ministrisë së Punëve të Brendshme me nr. 5842, drejtuar Ministrisë së Arsimit thuhej: ”Luteni të keni mirësinë e të merrni parasysh lutjet e popullit të atij qarku, që kërkojnë çeljen e shkollave, meqë gjendja e arsimit dhe e kulturës atje është fare e dhimbshme”[290]

Në përgjithësi në territorin e krahinave të Lumës e të Hasit shkollat në gjuhën shqipe nisën të hapen në periudhën e Qeverisë së Ismail Qemajlit, nga se në këtë kohë në Shqipëri mund të thuhet se ishte lulëzimi i hapjes së shkollave si në qytete, ashtu edhe në fshatra. Por, rrugën e mbarë të hapjes së shkollave në Shqipëri e ndërpreu Esat Pashë Toptani, i cili pas ardhjes në

[287] Isa Halilaj, Në rrugën e diturisë, Tiranë 1998, f. 189.
[288] Ibrahim Kolçi, u lind në vitin 1888 në Gjakovë. Pas mbarimit të mejtepit në Gjakovë, me ndihmën e Bajram Currit, me të cilin kishte lidhje familjare, Ibrahimi i vazhdon mësimet në shkollën Normale të Shkupit, të cilën e kreu në vitin 1909/1910. Pasi diplomoi në këtë shkollë, ai niset për në Staboll, ku do të regjistrohet në Shkollën e Lartë të Diplomacisë, por nuk arriti ta kryejë këtë shkollë dhe kthehet në atdhe, ku e fillon punën si mësues. Fillimisht filloi të punoi në Kala të Dodës në vitin 1911/12, ndërsa më 1913/1914 në Krumë. Pas largimit nga Kruma për një kohë do të punojë në Pejë, gjithashtu mësues deri në riokupimin e Kosovës nga Serbia. Për një kohë jetoi jashtë atdheut, më pas u kthya në Tiranë, Shkodër Himarë, ndërsa në vitin 1923 kthehet në Malësinë e Gjakovës, përkatësisht në tropojë, ku fillon punën si mësues. Deri më 1925. Një vit shkollor Ibrahim Kolçi punon mësues në Kolgecaj, ndërsa në vitin shkollor 1816/27 fillon punën në shkollën e Golajve. Në vitin 1927/28 sërish kthehet të punoi në Kolgecaj, prej nga pa dëshirën e tij e transferojnë në shkollën e Kukësit, ku punoi, ndërsa në vitin 1929 kthehet në Krumë, në detyrën e drejtorit të shkollës. Në vitin 1930 deri më 1931 përsëri e kthejnë në Kukës, prej nga që nga 1 tetori i vitit 1931 sërish kthehet në Krumë në detyrën e drejtorit të shkollës deri më 1 tetor 1935. Pas këtij viti e gjemë në Bicaj në detyrën e kryemësuesit deri sa më 1941 ai sërish kthet në Kosovë. Duhet shtuar se në vitin 1934, atij i vdes xhaxhai në Krumë, ku edhe varroset, ndërsa që nga viti 1927 ai së bashku me famljen jetojnë në Shqipëri. Gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij në Krumë, ai ka mbajtur ditar, në të cilin në mënyrë besnike përshkruhen të gjitha ngjarjet, që kanë ndodhur në Krumë dhe në përgjithësi në Has. Ibrahim Kolçi për ndryshe pos punës dhe kontributit në fushën e arsimit, do të mbetet edhe një kronistë shembullor i të gjitha ngjarjeve që kanë ndodhur në Has. Ditari i tij është një libër i veçantë për krahinën e hassit e në veçanti për Krumën.
[289] Abdulla R. Vokrri, Ibrahim Kolçi – mësues e patriot, Prishtinë 1993, f. 23.
[290] Po aty f. 23.

pushtet nisi t'i mbyll shkollat shqipe e me gjasë këtë fat e përjetoi edhe shkolla e Krumës, pas dorëheqjes së Ismail Qemajlit nga kreu i qeverisë, që ai e drejtonte. Këtë dorëheqje I. Qemajli e ofroi më 22 janar të vitit 1914[291] dhe mendojmë se menjëherë pas kësaj ngjarje duhet të jetë mbullur edhe shkolla e Krumës, sepse në kohën e Esat Pashë Toptanit, Ceno Bej Kryeziu emrohet prefekt i Krumës, i cili në këtë detyrë ishte deri në evakouimin e ushtrisë serbe nga Shqipëria dhe hyrjes së trupave austriake në Krumë.[292] Populli i Krumës, po në përgjithësi i Hasit, mbylljen e shkollës e përjetoi rëndë dhe duke qenë se ky popull është lindur dhe rritur me dëshirën për të luftuar me armë në dorë të gjithë armiqtë e huaj, por edhe ata që i ndihmojnë të huajve për ta robëruar vendin. Populli i Hasit pasi i kuptoi qëllimet ugurzeza për mbylljen e shkollës, u orvatën në forma të ndryshme, që ta mbrojnë shkollën, por ishte e kotë një përpjekje e tillë, sepse tradhtarët e vendit siç ishte Esat Pashë Toptani dhe Ceno Bej Kryeziu, nuk lejonin që populli shqiptar të përjetoi dritën e diturisë përmes shkollave. Ibrahim Kolçi, pak ditë para se të largohej nga Hasi, më 10 mars të vitit 1914 do ta mbaj një mbledhje me popullin e Krumës me ç'rast do t'u drejtohej banorëve e në radhë të parë disa myftive destruktivë, të cilët ishin mjaftë aktiv gjatë asaj kohe në Krumë me këto fjalë:"*Ju nuk mund të bëheni predikues të fesë e as fetarë të mirë pa e mësuar gjuhën shqipe...Lutjet në gjuhë të huaj nuk ju bëhen kabull. Ato më parë duhet kuptuar e pastaj zbatuar në jetë"*[293] Gjatë kohës sa Ibrahim Kolçi punoi në Krumë, ai përpos mësimit që e zhvillonte me nxënësit e tij, kishte raporte të mira edhe me banorët e sjellshëm dhe guximtarë, siç i quan ai në ditarin e tij, që ruhet në Arkivin e Kosovës, dhe përpiqej që të rriturve t'ua mësojë shkrim–leximin në gjuhën shqipe. Madje gjithnjë sipas ditarit të tij, punën që e kishte filluar me banorët e Krumës, për t'ua mësuar gjuhën shqipe jashtë lokaleve shkollore, do ta vazhdojë kudo që do të punojë në të ardhmen si mësues. Sipas dëshmive arkivore, Ibrahim Kolçi në shkollën e Krumës do të rikthehet përsëri për të punuar si mësues, madje edhe do të emrohet drejtor i këtij institucioni.

Pas çlirimit të tokave të pushtuara nga Serbia, në zonën e Prefekturës së Kosovës, nisi të shtohet interesimi për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Njëri ndër më të interesuarit nga atdhetarët shqiptarë të zonës së veriut për hapjen e shkollave ishte Bajram Curri, i cili pothuaj se për secilin cep të krahinave të Lumës, Hasit e Malësisë së Gjakovës do ta gjejmë që të interesohet për hapjen e shkollave dhe mbarëvajtjen e arsimit. Në anën tjetër edhe populli kishte fituar bindjen e plotë tek qëndrimi, guximi, vizion i dhe gatishmëria e tij për arsimin e banorëve të këtyre anëve e bashkë me te edhe të fëmijëve kosovarë. Por, në anën tjetër kontributi i madh i Bajram Currit në këtë drejtim është edhe fakti, që sa më shumë kosovarë, që kanë mbaruar në çfarëdo mënyre shkollat në çfarëdo gjuhë t'i inkuadronte në shkollat e kësaj ane, që në fillimet e veta vërtetë kishte nevojë për mësues atdhetarë.

Në hapjen e shkollave shqipe në krahinat verilindore në Lumë, Has e Malësi, kontribut të madh ka dhënë Komiteti i "Mbrojtjes Kombëtare i Kosovës", i cili komitet për çlirimin e Kosovës nga okupuesit serbë e shihnin si zgjidhje të vetme hapjen e shkollave dhe aftësimin

[291] Po aty f. 25.
[292] Jusuf Osmani, Vrasjet në Pragë: e Cana Beut – 1927 dhe e Alqiviadh Bebit – 1928, Prishtinë 1997, f. 8.
[293] Abdulla R. Vokrri, Ibrahim Kolçi- mësues e patriot, Prishtinë 1993, f. 26.

e kuadrove për arsimimin e masës së pashkolluar. Në këtë kuadër duhet të veçohet kontributi i Hoxhë Kadri Prishtinës (kryetar) i këtij komiteti, kontributi Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Niman Ferizit, Osman Nikoliqit, Ali Kelmendit e shumë atdhetarëve tjerë.


Ministria e Luftës
Nr. 886
Zyra e Shtatit Madhnor
Sek.I.
Tiranë, 9/II 922.
Mbi dergimin e tre mësuesave në Lumë Has e në Malci të Gjakovës.
Z.Kolonel Bajram Beg Curri me nji shkresë na lajmeron se në vise të Lumës, të Hasit e të Malcis së Gjakovës triё shkolla fillore kanë mbetë të mbylluna prejë se s'kà mësuesa e lutet qi të dergohen tre mësuesa.
Per kompetencë kemi nderin të ju lajmerojmë ç'ashtjen.
Ministri i Luftës
Ministris së Arsimit
MINISTRIA E ARESIMIT BOTUER
MËRRITUN MË 9/II/922
NR. 298 TË LIDH.......

Dëshmi nga Ministria e Arsimit

"Na katundi Kolesjan kemi lutje për zotninë tuej që t'na dërgoni nji mësues prej mësuesve të Gjakovës, se na ka mbetun shkolla mbyll prej se zotnia e juaj urdhnuet e emnuet mësuesin e parë që kishim Riza Spahinë, për në xhandarmarinë e Lumës si nëntoger..." Kolesjan, 25 dhjetor 1921, Letër drejtuar Bajram Currit.[294]

Më 9 shkurt 1922, pra një muaj pasi u themelua Prefektura e Kosovës, nga Ministria e Arsimit kuptojmë se Kolonel Bajram Curri përmes një shkrese lajmëron se në vise të Lumës, të Hasit e të Malësisë së Gjakovës tri shkolla fillore kanë mbetun të mbylluna prej se s'ka mësuesa, e lutet që të dërgojë tre mësues.[295]

Por, meqë Ministria e Arsimit  as me këtë datë nuk ndërmarrin asgjë, për të siguruar mësues të gjuhës shqipe në Prefekturën e Kosovës, Bajram Curri, sërish më 12 shkurt 1922 nga Kruma, ku vepronte ai me çetën e tij i drejtohet Ministrisë së arsimit në Tiranë për të dërguar mësues të shqipes edhe në Prefekturën e Kosovës në Krumë,[296] e cila kërkesë realizohet më 12 tetor 1922 dhe në Krumë të Hasit rihapet shkolla e parë shqipe, që do t'i ketë 30 nxënës nga shumë vise të Kosovës përpos atyre nga fshatrat e Hasit.[297] Rihapja e shkollës në Krumë u mirëprit jo vetëm nga hasjanët, por nga kosovarët, të cilët egërsisht ndiqeshin prej regjimit të Jugosllavisë së vjetër, të cilët kishin dëshirë që fëmijët e tyre të shkollohen dhe të edukohen në frymë kombëtare. Menjëherë pas hapjes së kësaj shkolle numri më i madh i nxënësve, që i ndiqnin mësimet ishte pikërisht nga Kosova, e në veçanti nga Gjakova, por një

[294] Shefqet Hoxha, vepra e cituar, fq. 4.
[295]*Fondi 195, Viti 1922, Dosja 2, fl. 130.*
[296] Sami Ferizi, Shkolla e Krumës – fole e edukimit patriotik e revolucionar të brezit të ri, botuar në revista pedagogjike nr. VI, f. 146.
[297] Gani Mazrreku & Musë Dida, 65 vjetori i shkollës së parë shqipe në Krumë, Tiranë, 1987. f. 9.

numër i konsiderueshëm i nxënësve ishin nga Prizreni, që u regjistruan në gjeneratën e parë siç ishin Sylejman Vrenezi, Ibrahim Spahiu, Selajdin Guncati e disa të tjerë, të cilët përmes fotografive, që i kanë ruajtur dëshmojnë për numrin e madh të nxënësve nga Kosova, që u regjistruan në këtë shkollë.

Fillimi i punës së shkollës fillore kombëtare në Krumë shoqërohej edhe me mungesën e lokalit shkollor, prandaj mësimi fillimisht u zhvillua në kushte shumë të vështira, apo siç shprehet veterani i arsimit Sami Ferizi, herë në kodër e herë te lisi e për një kohë mësimi u mbajt edhe në xhaminë e Krumës. Pavarësisht prej të gjitha këtyre vështirësive, hapja e shkollës shqipe në Krumë, ishte ngjarje historike, që i dha zemër dhe shtytje atdhetarëve, që ishin të gatshëm me armë në dorë për ta mbrojtur çështjen kombëtare.[298]

Sipas një dëshmie të vitit 1923 në Prefekturën e Kosovës kishte gjithsej 8 shkolla ishin në të cilat ishin të angazhuar këta mësues: Në Bicaj – Niman Ferizi, Në Shtiqen Qazim Bakalli, Në Kolesjan Riza Spahija, në Në Kalis Mahmut Rrotulla, Në Kukës Ndrek Çukalaj, në Golaj – Mark Gashi, në Krumë Iljaz Prishtina, në Krasniqe Osman Shaqiri.[299] Ndonëse në këtë shënim nuk jepen të dhëna tjera, mund të supozohet se këta mësues në këtë kohë ishin kryemësues, pasi që ka dëshmi se kishte edhe mësues tjerë në shkollat e Prefekturës së Kosovës.

Përderisa në gjithë vendin në vitin shkollor 1920/21, kishte gjithsej 534 shkolla fillore e të mesme dhe në vitin arsimor 1921/22 574 shkolla,[300] në gjithë Malësinë e Gjakovës nuk kishte asnjë shkollë. Edhe shkollat ekzistuese në të shumtën e rasteve ishin katandisur në kurse kundër analfabetizmit. Prandaj edhe kërkohej mësimi i detyruar, mësues të aftë , buxhet i mjaftueshëm për modernizim të shkollave.[301] Kjo gjendje e rëndë e shkollave ekzistuese ishte edhe në shkollat tjera të territorit të Prefekturës së Kosovës, meqë e gjithë zona mbahej në këtë periudhë nën sundimin Jugosllav, ku vendin e shkollave e kishin zënë postat policore dhe ushtarake serbe, të cilat bënin përpjekje që të “blenin” njerëz, për të realizuar planet e tyre drejtë depërtimit më në thellësi të tokës shqiptare.

Me t’u liruar tokat e pushtuara nga Serbia, misioni atdhetar, që ia dha vetit administrata lokale dhe populli i Prefekturës Kosova ishte interesimi për popullin e Kosovës, që ta vazhdonin shkollimin e nisur në kohën e Austro-Hungarisë, sepse vetëm me shkollim në gjuhën amtare, mund të jenë më të aftë për ta luftuar regjimin shovinist sllav.

Në vitin shkollor 1924/25 në kuadër të Prefekturës së Kosovës figurojnë të jenë 21 shkolla fillore me gjithësej 25 mësues një konvikt (internat) , ndërsa numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në këto institucione shkollore është 931 nxënës që të gjithë të gjinisë mashkullore.[302]

298 Sami Ferizi, Po aty.
299 AQSH, Fondi 195, viti 1923, Dosja 25 Fleta 9.
300 AQSH Fondi, 195, Dosja 12, dok. 524/14 të datës 11. 07. 1920.
301 Selim Matoshi, Një shekull dritë (arsimi në Tropojë në shekullin XX), Tiranë, 2004, fq. 46.
302 AQSH, Fondi 159, Dosja 40, viti 1924, fl. 8-9.

Në vitin 1922 në gjithë Prefekturën e Kosovës punon 13 institucione shkollore: 1. Bicaj; 2. Shtiqën; 3. Kolesian; 4. Plotstan; 5. Kalis; 6. Kukës; 7. Golaj; 8. Nikaj ; 9. Mertur; 10. Has; 11. Gash; 12. Krasniqe; 12. Pitushë.[303] Përderisa një vit më parë, pra në vitin 1921 në territorin e kësaj prefekture ishin vetëm 8 shkolla.[304] Ndërsa në vitin 1928 në territorin e Prefekturës së Kosovës funksiononin 20 institucione shkollore, me një personel prej 35 punëtorëve arsimor, përfshi këtu edhe punonjësit e Internatit "Kosova".[305]

Me përpjekje të vazhdueshme , u arrit që të hapet për herë të parë në historinë e kësaj treve shkolla e parë laike në fshatin Bujan (Dojan) më 4 janar 1923 konkretisht në shtëpinë e Ali Jakupit me 40 nxënës e me mësues Osman Shaiqin (Mane Shaqja) nga Gjakova.[306] Veprimtaria e kësaj shkolle zgjati deri muajin tetor të vitit 1923, e cila më pas pas hapjes së Internatit "Kosova" do të kalojë në Kolgecaj. Pas hapjes së shkollës së Bujanit, në Malësinë e Gjakovës brenda një periudhe të shkurtër, pra në janar 1923 do të hapet shkolla e Gashit, pastaj në shkurt 1923 shkolla e Merturit, në Raje do të hapet në tetor të këtij viti, kur edhe do të hapet edhe shkolla e Bytyqit.

Hapjet e shkollave në krahinat e Prefekturës së Kosovës, ende pa u mbushur viti i funksionimit të Prefekturës së Kosovës, shiheshin me sy të mirë nga banorët e në veçanti nga të shpërngulurit me dhuna nga tokat e tyre, meqë shpresonin se të paktën fëmijët e tyre do të kenë mundësi që t'i ndjekin mësimet në gjuhën shqipe dhe në këtë mënyrë nisi të shtohej brenda një kohe të shkurtër që në qendër të prefekturës në Krumë , por edhe në nënprefektura disa dyqane të zejtarëve nga Kosova, të cilët erdhën dhe u vendosën me familjet e tyre.

**Burimet dhe literature krzesore**

Nexhat Çoçaj, Parathënia e librit, Internati "Kosova" 90 vjet në Krumë, Prizren, 2018, fq. 11

.Hoxha, Shefqet, Riza Spahiu e shkolla e Kolesianit (1911- 1951), "GEER", Tiranë, 2001.

Nexhat Çoçaj, Hasi enciklopedi entografike, vëll. I, në dorëshkrim.

Jashar Rexhepagiq, Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918, Prishtinë, 1970, fq. 49.

Sami Ferizi, Me pushkë e penë për arsim e dije, botuar në gazetën " Kukësi i Ri" më 11 shkurt 1987.

[303] AQSH, Fondi 195, viti 1922 dosja 46, fleta 27.
[304] AQSH, Fondi 195, viti 1922 dosja 9, fleta 14.
[305] AQSH, Fondi 195, viti 1928 dosja 135, fleta 112.
[306] Elez Qerimi, vepra e cituar, fq.164.

Edi Shukriu, Gra të shquara shqiptare, Prishtinë 2000, f. 64.

Selim Matoshi, Një shekull dritë (arsimi në Tropojë në shekullin XX), Tiranë, 2004, fq. 30.

Shukri Rahimi, Kryengritjet shqiptare në Kosovë më 1908 – 1912, botuar në Kosova Nr. 1. Prishtinë 1972, f. 79.

Niko Koleci, Kryengritja e përgjithëshme shqiptare, f. 42

Ibrahim Çavolli, Sali Morina, patriot e veteran i arsimit, artikull i botuar në revistën pedagogjike " Mësuesi" më 23 maj 1979, në Tiranë.

Besim Muhadri, intervistë me Isuf Durakun ( 1911- 1992): Njeriu që gjithë jetën mbeti i harruar e i antemuar, "Etja" mars 1992. Isuf Duraku, pas mbarimit të shkollës në Tiranë, për një kohë ( 1932 – 1941) do të puni mësues në shkollën në Bicaj dhe në Kukës.

Abdulla R. Vokrri, Ibrahim Kolçi – mësues e patriot, Prishtinë 1993, f. 23.

Jusuf Osmani, Vrasjet në Pragë: e Cana Beut – 1927 dhe e Alqiviadh Bebit – 1928, Prishtinë 1997, f. 8.

Sami Ferizi, Shkolla e Krumës – fole e edukimit patriotik e revolucionar të brezit të ri, botuar në revista pedagogjike nr. VI, f. 146.

Gani Mazrreku & Musë Dida, 65 vjetori i shkollës së parë shqipe në Krumë, Tiranë, 1987. f. 9.

Selim Matoshi, Një shekull dritë (arsimi në Tropojë në shekullin XX), Tiranë, 2004, fq. 46.
Shaqir Lusha & Dan Poga, Internati "KOsova" 90 vjet në Krumë, "Bogdani", Prizren, 2018, fq. 23.

Ali Rexha, Agimi, "Rilindja", Prishtinë, 1985, fq. 263.

Ismet Shaqiri, Më kujtojet… I,"Rilindja", Prishtinë, 1977, fq. 11.

*Fondi 195, Viti 1922, Dosja 2, fl. 130.*

AQSH, Fondi 195, viti 1923, Dosja 25 Fleta 9.

AQSH Fondi, 195, Dosja 12, dok. 524/14 të datës 11. 07. 1920.

AQSH, Fondi 159, Dosja 40, viti 1924, fl. 8-9.

\ AQSH, Fondi 195, viti 1922 dosja 46, fleta 27.

AQSH, Fondi 195, viti 1922 dosja 9, fleta 14.

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

AQSH, Fondi 195, viti 1928 dosja 135, fleta 112

AQSH Fondi 195, Viti 1922, Dosja, 58.

AQSH, Fondi 195, Viti 1924, Dosja 14, fl. 15.

## VARIETETET GJUHËSORE NË PARLAMENTET E SHQIPËRISË DHE KOSOVËS - PËRKIME DHE DIFERENCA

**Prof. asoc. dr. Haki Hysenaj**

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Abstrakt

Duke u nisur nga konstatimi se pranimi formal i varietetit të kodifikuar përvetësohet përmes ndërmjetësve dhe autoriteteve, siç janë qeveria, sistemi arsimor, mjetet masive të komunikimit, institucionet fetare dhe estabilishmenti kulturor (Fishman) hulumtimi "***Varietetet gjuhësore në parlamentet e Shqipërisë dhe Kosovës-përkime dhe diferenca***" përqendrohet në studimin e varietetit të folur të shqipes standarde nga kuvendarët e legjislacioneve të parafundit të dy qeverive shqiptare, të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Si institucion i rëndësishëm i shtetit, kuvendi ka ndikim në zhvillimin dhe përhapjen e varietetit të gjuhës standarde. Ky ndikim vërehet në Shqipëri dhe në Kosovë. Zhvillimet jo gjithmonë janë të njëjta, prandaj hulumtimi ynë mëton të vërë në pah përkimet dhe diferencat në zhvillimin dhe përhapjen e këtij varieteti.

Në fokus të hulumtimit janë përzgjedhjet leksikore, regjistrat dhe stilet e përdorura nga kuvendarët e të dyja shteteve. Këto struktura hulumtohen në situata të ndryshme gjuhësore të përdorimit të varietetit standard dhe të varieteteve të tjera që dalin në diskursin ligjërimor të kuvendarëve të Shqipërisë e të Kosovës. Gjuha e këtij institucioni identifikohet si gjuhë e administratës.

Hulumtimi është josistematik dhe i rastit, ndërsa realizimi i tij mbështet në matjet empirike të varieteteve të folura në këto dy institucione.

**Fjalët kryesore**: varietet gjuhësor, përzgjedhje leksikore, stil, regjistër, gjuhë e administratës, përkime, diferenca.

### 1.Hyrje

Studimi i gjuhës së folur standarde në institucionet e shtetit në të gjitha gjuhët e standardizuara paraqet një fushë të rëndësishme hulumtimi. Për këtë gjë janë bërë hulumtime

në gjuhën angleze, frënge, gjermane. Matjet kanë provuar nivelin e zënies e të përhapjes së standardit të këtyre gjuhëve.

Teorikisht për rëndësinë e këtyre hulumtimeve flasin Pierre Guiaraud (1997), Wiliam Labov (1972), Richard Hudson (2002). Ndërsa në shqipe probleme që lidhen me këtë fushë studimi kanë prekur Rugova (2015), Munishi (2015), Paçarizi (2011), ndërsa në Shqipëri Rami Memushaj, Shezai Rrrokaj, Gjovalin Shkurtaj e ndonjë tjetër.

Punimi ynë ka të bëjë me gjuhën e folur në institucionin e kuvendit, në Kosovë dhe në Shqipëri. Kjo për faktin se gjuha e përdorur në institucionet e shtetit, përfshirë këtu edhe kuvendin, është varietet publik që gëzon prestigj ndaj varieteteve të tjera. Dy variantet e realizimit të saj, i shkruari dhe i foluri, në shumicën e rasteve, në të dy kuvendet shqiptare, në atë të Shqipërisë dhe të Kosovës, realizohen në varietetin standard. Në radhë të parë, ky konstatim vlen për fjalimet e shkruara paraprakisht, sepse, siç do të shihet në këtë punim, gjuha e debateve, që nënkupton "*të folurit si prodhim i drejtpërdrejtë*", ngërthen në vete edhe zgjedhje të tjera gjuhësore jo të normuara.

Praktikisht, gjuha e kuvendit e identifikon varietetin standard të shqipes, i cili, duke qenë me prestigj ndaj varieteteve të tjera, mendohet se ka impakt mbi rrjedhat e standardit dhe si e tillë, krahas gjuhës së institucioneve të tjera publike, ndikon edhe në përvetësimin dhe përhapjen e këtij varieteti të shqipes.

Mirëpo, siç do të shihet në këtë punim, gjuha e folur në këto dy institucione shpesh është e përzier edhe me variante gjuhësore jostandarde. Alternativat gjuhësore reflektojnë zgjedhjet personale, të cilat në radhë të parë përcaktojnë individualitetin e folësve kuvendarë. Në shumë raste këto zgjedhje janë pjesë e idiomave dialektore, që dalin të varura nga domeni i përdorimit e ndonjëherë edhe nga niveli i formalitetit të bisedës (Rugova. B. & Sejdiu-Rugova, 2015: 85).

Hulumtimi ynë tregon se këto zgjedhje nuk e ulin (vështirësojnë) nivelin e diskursit, ndërkohë që në situata të ndryshme reflektojnë edhe ngjyresa ekspresive, duke e bërë kështu gjuhën e këtij institucioni më "*liberale*" e më të pasur. Përzgjedhjet e këtilla gjuhësore janë më të shumta në varietetin e folur në Kuvendin e Shqipërisë.

Për ta ilustruar këtë konstatim do të përmendim shembujt: "*Me ty besoj e mbyllëm herën e kaluar* ***përsheshin*** *me atë* ***lugën e madhe*** *sa jeni dy veta*". Ky shembull është vetëm një nga shembujt e shumtë që ilustron përdorimin metaforik të njësive **përsheshin** dhe **lugën e madhe,** artikuluar nga Edi Rama (shih: https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=VsaKEkMgoDA)**.** Sipas Pierre Guiraud, stili është i definuar edhe nga pozitat e personave dhe të gjinive (Guiraud, 1997 :17).

Në rastet si ky, ndonëse zgjedhja gjuhësore nuk është e karakterit dialektor, shënjuesit leksikorë: **përshesh**, **lugë e madhe** ose edhe në rastin tjetër: **kazan politik, tepsi**... shënjuesit e përmendur bartin ekspresivitet të caktuar, duke anuar edhe nga njëjtësimi me stilin satirik.

Para së gjithash, stili informativ është karakteristik për gjuhën e këtij institucioni. Guiraund stilin e sheh si *"shmangie gjuhësore"* (Po aty, f. 83). Pavarësisht kësaj, zgjedhjet si në shembujt më lart, ndikojnë në zëvendësimin e stilit informativ me stile të tjera, që do të thotë se zgjedhjet gjuhësore ndikojnë në ndërrimin e stileve të ligjërimit (style-shifting) https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=ykyveA1yëvo.

Duhet thënë që në krye të herës se varieteti i gjuhës së folur në Kuvendin e Shqipërisë shquhet për përdorim më të dendur regjistrash e stilesh të ndryshme. Në këtë mes, stili ekspresiv, në situatat kur realizohen debate deputetësh, është më i shpeshti.

Bazuar në funksionin shprehës të gjuhës (Rugova. B. & Sejdiu-Rugova, 2015: 80), në këtë institucion del shumë i përdorshëm edhe stili ironik, i cili, në situata të caktuara, reflekton edhe konotacione të sarkazmës. Shembuj tipik për këtë tip stili do të përmendnim shprehjet: "**atdheu i kryeministrit**"(shih.https://www.youtube.com/results?search_query=Fjalori+%22perl%C3%AB%22n%C3%AB+Kuvend%3AQen+i+madh.

Ndërsa, në gjuhën e kuvendarëve të Kuvendit të Kosovës përdorimi i stileve është më i kufizuar. Në këtë mes, të shprehurit ekspresiv është pak i pranishëm. Ndërsa, regjistrat leksikorë, që identifikohen si zgjedhje gjuhësore, përdoren zakonisht në debatet gojore midis kuvendarëve. Përdorimi i tyre del të jetë i përcaktuar nga rrethana të ndryshme që shoqërojnë debatin. Provokohet nga funksione të caktuara gjuhësore që ata kryejnë, por edhe nga situatat folëse. Megjithatë, këto zgjedhje përgjithësisht nuk bartin kuptime të dyta, që do të thotë se komunikimi edhe në këto rrethana në Kuvendin e Kosovës realizohet më i drejtpërdrejtë.

Por në rastet: ***mos u zgërdhi***, ***paçavra, banda kriminale, rrugaçë, hajna, terroristë*** ose ***kapje e shtetit, polici e kapur, gjyqësi e kapur, autostradë e krundeve (shih. https:/www.you tube.comëatch?v=OU467OjHoRc***) këto zgjedhje identifikohen si mjete gjuhësore, të cilat përdoren për fyerje, sharje dhe etiketime. Këto dhe të tjera të ngjashme tejkalojnë semantikën e figurshme të ironisë dhe kalojnë në sarkazëm. Regjistrat e këtillë janë gjithnjë e më të shpeshtë edhe në gjuhën e kuvendarëve kosovarë. Ky shtim regjistrash rritet krahas kundërshtive politike gjithnjë e më të mëdha midis grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, prandaj konstatimi *se zhvillimet gjuhësore të grupeve të caktuara shoqërore janë të përafërta* (Heller, Monica&Richard J. Wastts, 2007: 162) përligj këtë përfundim.

Gjuha e kuvendit, në radhë të parë, nënkupton shkëmbimin gjuhësor ndërmjet anëtarëve të këtij institucioni. Megjithatë, ky varietet gjuhësor i përdorur në të i takon sferës publike të komunikimit, prandaj kryen edhe funksionin e tërheqjes së vëmendjes e të bindjes edhe të publikut të gjerë. Ky qëllim arrihet duke shfrytëzuar funksionet themelore të gjuhës, si atë *informativ, ekspresiv e nxitës* (Rugova. B. & Sejdiu-Rugova, 2015: 80).

Analiza jonë tregon se këto funksione janë pjesë organike e diskursit politik të anëtarëve të këtyre dy kuvendeve. Informimi është padyshim aspekti kryesor i gjuhës së këtij institucioni. Ky mision realizohet më besnikërisht në situatat kur kuvendarët i lexojnë tekstet e përgatitura paraprakisht. Analiza tregon se në këto raste kuvendarët përpiqen të realizojnë varietetin gjuhësor standard, duke u përpjekur që "*sinjalet vizuale*" t'i shndërrojnë sa më besnikërisht në "*sinjale akustike*".

Nga ana tjetër, në këto situata stili i ligjërimit zakonisht reflekton neutralitet, prandaj gjuha e folur përfaqëson varietetin standard të shqipes, natyrisht me nuanca të ndryshme gjuhësore të karakterit rajonal, përdorimi i të cilave kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm sociolinguistikë.

Në rastin tonë, funksioni ekspresiv i gjuhës së folur zakonisht del në pah në situatat kur deputetë të caktuar shprehin emocione, të shumtën e rasteve me ngjyresë pezhorative. Tekstet e këtyre fjalimeve janë të pashkruara, prandaj gjuha e përdorur realizohet spontanisht, që do të thotë se ajo nuk u nënshtrohet parimeve e rregullave preskriptive. Fjalimet e këtij lloji paraqesin më së miri shkallën e përvetësimit të varietetit standard të shqipes së folur dhe për më shumë edhe evoluimin që mendohet të ketë ndodhur në shqipen standarde në këta dhjetëvjetëshat e fundit.

Hulumtimi ynë tregon se varieteti gjuhësor i folur i kuvendarëve të Shqipërisë ka elemente të shumta ekspresive dhe zakonisht realizohet në debatet midis pjesëtarëve të grupeve të ndryshme politike. Matjet sasiore të mjeteve gjuhësore që shprehin emocion, fillimisht në formë humori, në varietetin gjuhësor të përdorur në këtë institucion, njëjtë si edhe në Kuvendin e Kosovës, por në rastin e parë me vëllim më të madh, gradualisht tejkalojnë nivelin normal të përdorimit dhe, bazuar në të gjeturat tona, më pas gjenerojnë konotacione të ironisë e të fyerjes, e madje ndonjëherë kalojnë edhe në nivelin e sarkazmës.

Në Kuvendin e Shqipërisë janë të njohura fjalimet me sens humori midis Edi Ramës dhe të kundërshtarit të tij politik, Sali Berishës. Në fakt humori ka ndikim në gjendjen shpirtërore të pjesëmarrësve në ligjërim. Alison Ross gjuhën e humorit e përcakton mjaft me ndikim, pasi, sipas tij, satira politike *"transformohet"* në shaka, përmes së cilës krijohen miqësi brenda një grupi dhe përjashtime brenda grupit tjetër (Ross, Alison. 2005 :xi). Këtë aftësi të përdorimit të gjuhës në këtë funksion, sipas matjeve tona, e kanë disa nga kuvendarët e Shqipërisë. Edi Rama përdor një regjistër të pasur leksikor për diskursin e humorit me qëllime të caktuara. Variablat gjuhësore, të përdorura prej tij për këtë qëllim, plotësojnë në masë të madhe *"kërkesat e normës"* së varietetit standard. Po nga matjet tona del se edhe Sali Berisha zgjedh regjistra të caktuar për këtë tip diskursi. Madje, Berisha përzgjedhjen e njësive leksikore e bën nga leksiku i profesionit të tij primar, si: **psikollogji, xhelozi, rendiment, këshillë medikale...** (shih. https://www.youtube.com/ëatch?v=3XnNGll6YJk).

Nga ana tjetër, zgjedhjet leksikore: ***plehra, fundërrinë, këlyshë, kodosh, budallenj*** (shih. https://www.youtube.com/ëatch?v=nQ8uqf_5PyI), ose: ***qen i madh, fshesë e hekurt, plak idiot*** (shih: https://www.youtube.com/ëatch?v=nQ8uqf_5PyI ), si dhe: "***Jepini një rrotë sallami të mbyllë gojën***", "***...e mori piperonin në gojë***" (shih. https://

https://www.youtube.com/results?search_query=Ky+parlament+duhet+t%3Bi+drejtohet+drejtesise) janë disa nga treguesit gjuhësorë të stilit ironik dhe metaforik, të përdoruar në debatet spontane midis kuvendarëve të Kuvendit të Shqipërisë. Por, në disa nga regjistrat e ironisë, siç shihet nga shembujt e përmendur, shpërfaqet sarkazma si mjet i denigrimit të bashkëdebatuesit. Rastet e këtilla janë të shpeshta në varietetin gjuhësor të gjuhës së kuvendarëve të Shqipërisë.

Fishman thekson se varieteti standard përhapet nga të ashtuquajturit ndërmjetës, ku bëjnë pjesë institucionet qeveritare, arsimore, kulturore, mjetet e komunikimit masiv (Fishman, 1978: 45). Ndonëse, kuvendi nuk paraqet institucionin kryesor për përhapjen e varietetit standard, megjithatë gjuha e përdorur në të nuk ka dyshim se ndikon në përhapjen dhe zhvillimin e këtij varieteti. Gjuha e përdorur në këtë institucion reflekton qartazi ndryshimet që kanë ndodhur në gjuhë, qoftë ajo edhe gjuhë e administratës, pas rënies së ish-sistemeve shoqërore në Shqipëri dhe në Kosovë dhe pas ndryshimeve të tjera të mëdha që ndodhën në të dy vendet. Në këtë mes, një studim për gjuhën e administratës tashmë të dy shteteve të pavarura shqiptare do të mund të përcaktonte shkallën e zhvillimit edhe të terminologjisë administrative dhe kahet e zhvillimit e të pasurimit të saj.

Studimi "***Varietetet gjuhësore në parlamentet e Shqipërisë dhe Kosovës-përkime dhe diferenca***" bazohet në korpusin e hartuar nga inserte fjalimesh e debatesh të kuvendarëve të këtyre dy kuvendeve, të plasuara në rrjetin social www. youtube.com.

## 2. **Korpusi dhe subjektet folëse**

Kohëzgjatja e materialit të analizuar është 2 orë e 30 minuta. Shumica e fjalimeve janë lexime të materialeve të përgatitura paraprakisht. Për qëllime të analizës kemi analizuar edhe gjuhën e debateve d.m.th. gjuhën spontane të folur nga deputetët. Të folurit spontan reflekton origjinalitetin e varieteteve gjuhësore që përdorin folësit e një gjuhe të caktuar ( Labov, 1972), që do të thotë se debatet e përzgjedhura për analizë gjuhësore shpërfaqin gjuhën e natyrshme të deputetëve, e cila del të mos jetë gjithnjë gjuhë rregullash.

Këto materiale i kemi transkriptuar dhe mbi bazën e tij kemi përshkruar varietetin gjuhësor që përdoret në këto institucione.

Për të përzgjedhur subjektet e këtij hulumtimi është dashur të përcaktohemi për ndonjë kriter të qëndrueshëm. Jemi mbështetur në vlerësimin e aktivitetit të deputetëve, të bërë nga organizata të ndryshme joqeveritare. Çdo përcaktim tjetër përzgjedhjes sonë i jepte konotacion subjektiv. Prandaj, për rastin e Shqipërisë si kriter kemi zgjedhur matjet e bëra nga Instituti i Studimeve Politike (shih: https://www.zemraetiranes.alp=606-deputetet), kurse për përzgjedhjen e subjekteve folëse të Kuvendit të Kosovës jemi bazuar në matjet e bëra nga Instituti Demokratik i Kosovës (shih: https://www.google.com/search?rlz=1C1OPRB_enXK575XK575&q).

Instituti i Studimeve Politike, nga 140 deputetë sa ka Kuvendi i Shqipërisë, ka identifikuar 20 prej tyre të kenë qenë më aktivët në seancat plenare në legjislaturën e parafundit. Është periudha 2013-2017. Ne kemi analizuar vetëm gjuhën e 5 deputetëve më aktivë: Edi Rama, Sali Berisha, Ben Blushi, Jozefina Topalli dhe Erion Braçe.

Instituti Demokratik i Kosovës, nga 120 deputetët e Kuvendit, më aktivët në legjislaturën e parafundit ka renditur: Faton Topallin, Smajl Kurteshin, Time Kadrijajn, Bekim Haxhiun dhe Shaip Mujën.

Sipas biografisë së kandidatëve, të gjithë kanë përgatitje të lartë shkollore dhe para se të hynin në politikë kanë ushtruar profesione të tjera.

Për të argumentuar pohimet e cekura për segmente të veçanta të varieteteve gjuhësore të të dyja kuvendeve, ndonjëherë kemi shfrytëzuar edhe sekuenca të pakta të fjalimeve politike të disa deputeteve të tjerë. Të gjitha rastet shënohen besnikërisht në punim.

## 3. Të gjeturat

Siç u pa edhe më lart, përmes këtij hulumtimi kemi provuar të përshkruajmë varietetet gjuhësore të përdorura në dy kuvendet shqiptare, në atë të Shqipërisë dhe të Kosovës. Hulumtimi ka qenë i shtrirë në analizimin e realizimit fonetik të këtyre varieteteve, në përshkrimin e përzgjedhjeve leksikore, të stileve dhe të regjistrave të caktuar gjuhësorë.

Vështruar nga aspekti fonetik analiza e materialit të përzgjedhur ka dëshmuar se realizimi i varietetit të gjuhës së folur standarde në dy kuvendet shqiptare ka përkime të shumta, por edhe diferenca. Përkime dhe diferenca fonetike dalin edhe brendapërbrenda të njëjtit varietet.

Në rastin e gjuhës së folur në Kuvendin e Shqipërisë dallimet hetohen në shqiptimin e njësive tingullore. Ato, në radhë të parë, pasqyrojnë origjinën e deputetëve. Në këtë mes, varieteti gjuhësor i Jozefina Topallit dhe i Sali Berishës identifikojnë folësit me më së shumti variacione shqiptimore të karakterit lokal, ndërkohë që 3 subjektet e tjera varietetin e shqipes standarde e realizojnë mbi bazën e modelit vokal të toskërishtes, të përzier ndonjëherë edhe me pak elemente që tashmë e shquajnë të folmen e Tiranës.

Kurse, në rastin e Kosovës, identiteti dhe origjina e subjekteve, gjuha e të cilëve ka qenë objekt studimi, dalin shumë të theksuara pikërisht në shqiptimin e tyre. Secili nga folësit bart elemente shqiptimore lokale, duke shënuar kështu diferenca edhe brenda *"llojit"*. Ndërsa, po brenda llojit kanë të përbashkëta dukuritë fonetike e fonologjike të gegërishtes përgjithësisht, në radhë të parë gjatësinë e tingujve zanorë dhe hundorësinë. Kjo e dyta del me pak vlerë funksionale krahasuar me gjatësinë. Pastaj, në këtë mes, duhet përmendur edhe rrafshimin e disa kundërvënieve fonologjike që kanë përfshirë gegërishten, posaçërisht gegërishten verilindore, si dhe tkurrjen e grupeve të ndryshme vokalike e konsonantike.

Krahasuar me varietetin e gjuhës standarde të folur në Kuvendin e Shqipërisë duhet theksuar se dallimi qenësor i varietetit të folur në institucionin gjegjës në Kosovë ngreh krye në *paaftësinë e kuvendarëve të Kosovës për shndërrimin e sinjaleve vizuale në sinjale akustike,* që nënkupton të folurit e mbështetur në lexim (Paçarizi, 2011:188-199). Këtë lloj shqiptimi Paçarizi nuk e sheh si "*dispersim të gjuhës së përbashkët*" (Po aty, f. 186), ndërsa Munishi, duke folur për nxënien dhe përhapjen e standardit të shqipes, parapëlqen zhvillimin e tij edhe me "*elemente të varieteteve të ndryshme të shqipes"* (Munishi, 2015: 172).

Matjet tona tregojnë se fjalimet e shkruara paraprakisht në gjuhën standarde ndonjëherë lexohen me vështirësi nga kuvendarët e Kuvendit të Kosovës. Këto vështirësi shpjegohen me problemet sociolinguistike dhe psikolinguistike (Paçarizi, 2011: 164), me të cilat ndeshen folësit e varietetit standard të shqipes, të cilët varietet nativ e kanë dialektin e gegërishtes.

Nga ana tjetër, diferencat e kësaj natyre gjuhëtarët e ndryshëm i përligjin edhe me faktin se *"shqiptimi në një masë më të vogël është subjekt i standardizimit*" (Hudson, 2002: 54). Kjo ka ndodhur edhe me rastin e standardizimit të gjuhës shqipe. Shkrimi nuk ka plotësuar kërkesat e shqipes së folur. Nga ana tjetër, gjatë realizimit të varietetit të folur dallimet lidhen edhe me faktorë të tjerë. Në radhë të parë gjuha e folur reflekton mendimin personal, jo tekstin e shkruar (Hysenaj, 2015: 296), prandaj gjuha e debateve shpërfaq nivelin e përdorimit të varietetit standard dhe të varieteteve të tjera jostandarde, të cilat, në situata të caktuara, identifikohen me regjistra dhe stile të veçanta. Në rastin e Kosovës, në këto situata gjuhësore, pasqyrohet më së miri realiteti gjuhësor i përdorur në këtë institucion shtetëror.

Në anën tjetër, edhe përzgjedhjet leksikore për efekte ligjërimi në aspektin kualitativ janë të përafërta, ndërkohë që në aspektin sasior kuvendarët e Kuvendit të Shqipërisë i përdorin më dendur. Fjalët **efendi**, **kazan**, **tepsi**... janë karakteristike për stilin joformal të shumë kuvendarëve të Shqipërisë, ndërsa fjalët: **spiun**, **bashkëpunëtor**, por edhe shprehjet: **"je bo si Skënderbegi**", ...**l'pin gishtin**", "**miza mas veshit**" .... janë pjesë e diskursit agresiv gjuhësor të deputetëve të Kuvendit të Kosovës (http://www.kosovalive360.com/brengos-diskursi-agresiv-gjuhesor-i-politikaneve.html).

Dallimi më kualitativ dhe më sasior midis varietetit gjuhësor të përdorur në Kuvendin e Shqipërisë dhe të Kosovës qëndron në shumëllojshmërinë e përdorimit të regjistrave dhe të stileve të ligjërimit.

Shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës mjaftohen me fjalimet e shkruara, të cilat nuk reflektojnë saktësisht varietetin e folur të tyre. Duke hezituar të jenë pjesë debatesh, shumica prej tyre ligjërimin brenda kuvendit e realizojnë në stilin formal, natyrisht të realizuar sipas modelit shqiptimor që tashmë është "*standardizuar*" në të folmen e Kosovës. Përjashtim bëjnë një numër i vogël deputetësh. Duke marrë pjesë në debate, që kushtëzohen nga situata e faktorë të ndryshëm, këta kuvendarë përdorin njësi të ndryshme gjuhësore dhe rrëshqasin në stile të tjera ligjërimi. Studimi ynë tregon se më i zakonshmi është stili ironik dhe ai zhvlerësues, për të cilët janë dhënë shembuj të mjaftueshëm në kuadër të këtij punimi.

Zgjedhjet gjuhësore për realizimin e tyre ndonjëherë përfaqësojnë edhe idioma të ndryshme dialektore që lidhen me origjinën e folësve.

Ndërsa, varieteti gjuhësor i përdorur në Kuvendin e Shqipërisë shquhet për realizim më të përafërt me varietetin e gjuhës standarde. Sa i përket përdorimit të regjistrave e të stileve të ligjërimit, analiza jonë dëshmon se deputetët e këtij institucioni janë më të lirshëm në këto përzgjedhje. Madje, përzgjedhjet gjuhësore janë jo vetëm të karakterit idiomatik, por edhe të fushave të tjera, që lidhen ndonjëherë edhe me profesionin e pjesëmarrësve në debate.

Debatet verbale brenda këtij kuvendi i takojnë stilit joformal të ligjërimit, prandaj gjuha e përdorur është e mbushur me zgjedhje gjuhësore që potencojnë ironinë, fyerjen, zhvlerësimin e kundërshtarit politik përmes gjuhës diskriminuese. Edhe për këtë çështje janë dhënë shembuj të mjaftueshëm në përshkrimin e bërë në kuadër të këtij punimi.

Çështja e fundit e trajtuar në këtë punim lidhet me gjuhën e përdorur nga dy deputetet femra të këtyre kuvendeve. Përgjithësisht është e pranuar se femrat janë më të kujdesshme në përdorimin e varietetit standard. Matjet tona tregojnë të kundërtën. Jozefina Topalli e Kuvendit të Shqipërisë dhe Time Kadriaj e Kuvendit të Kosovës, në varietetet e tyre gjuhësore, madje edhe në rastet kur lexojnë materiale të përgatitura paraprakisht, reflektojnë gjuhë të karakterit dialektor. Shtrirja e hulumtimit në varietetin gjuhësor të përdorur edhe nga deputete të tjera të këtyre kuvendeve sigurisht se do të përmbyste këtë konstatim. Madje, një studim i tillë do të dilte interesant për shumë aspekte.

Për fund do të thoshim se matjet tona vërtetojnë se dy kuvendet shqiptare, ai i Shqipërisë dhe i Kosovës, në stilet formale të ligjërimit përdorin varietetin standard të shqipes, natyrisht me modele të ndryshme shqiptimi, regjistra dhe stile që dallojnë në përmasa të caktuara mes vete. Këto variete kanë prirjen e zhvillimit dhe të pasurimit të mëtejmë me zgjedhje regjistrash të rinj dhe rifunksionalizim regjistrash gjuhësorë të idiomave të ndryshme dialektore.

Nga ana tjetër, përdorimi i stileve të ndryshme të ligjërimit, përpos stilit informativ, gjuhën e këtij institucioni e largojnë nga ngurtësia e gjuhës së administratës dhe e bëjnë më të pranueshme nga folësit e shqipes standarde. Edhe këtu duhet parë prirjet e akëcilit institucion, gjë që nuk është bërë në kuadër të këtij punimi.

## LITERATURA


1. Rugova, Bardh & Sejdiu, Rugova (2015). Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe, Trembelat, Prishtinë.
2. Guiraud, Pierre (1997). Stilistika, Prishtinë.
3. Heller, Monica & Richard J. Wastts (2007). Style and Social Identities, Berlin.
4. Ross, Alison (1998). The language of Humor, London and Neë York.
5. Fishman, Joshua A. (1978). Sociolinguistika jezika, Svijetlost, Sarajevo.

6. Labov, Wiliam (1972). Sociolinguistic Paternss. Univeresity of Pensylvania Press. Në: http//ëëë. upenn.edu/pennpres/book/
7. Paçarizi, Rrahman (2011). Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë, PEN, Prishtinë.
8. Munishi, Shkumbin (2015). Shqipja në epokën e globalizmit. ZEROPRINT, Prishtinë.
9. Hudson, Richard A. (2002). Sociolinguistika, DITURIA, Tiranë.
10. Hysenaj, Haki (2015). *Shkarjet ortoepike në shqipen e folur dhe statusi i tyre*. Në: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare.

## INTEGRITETI LËNDOR MIDIS GJUHËS SHQIPE DHE LETËRSISË NË SISTEMIN ARSIMOR TË MESËM TË ULËT DHE TË MESËM TË LARTË

**Jola Male**

Mësuese e lëndës: “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, pranë shkollës 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit”, Tiranë.

**ABSTRAKT**

Në këtë artikull do të marrim në shqyrtim integritetin lëndor midis gjuhës shqipe dhe letërsisë në sistemin arsimor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Gjuha dhe letërsia janë parë gjithmonë në të njëjtin dimension, nën funksionin e njëra tjetrës dhe gjithmonë së bashku, në ciklin e mesëm të ulët. Për një periudhë disa vjeçare në ciklin e mesëm të lartë gjuha u hoq nga programi mësimor dhe zhvillohej vetëm lënda e letërsisë, në të cilën ndërfutej vetëm pjesa e tekstit joletrar si njohuri e përciptë gjuhësore. Mirëpo, duke parë se shkëputja nga njohuritë bazë gjuhësore po krijonte boshllëqe në formimin tërësor të nxënësve, gjuha u ripërfshi në programin mësimor të ciklit e mesëm të lartë (gjimnaz), tashmë në një mënyrë më të reformuar, ku gjuha dhe letërsia u perceptuan si dy lëndë më vete, me dy libra të ndryshëm dhe secila me vlerësim më vete.

***Qëllimi*** i këtij punimi konsiston analizën dhe përqasjen e organizimit kurrikular të këtyre dy disiplinave gjuhë dhe letërsi, si lëndë mësimore.
***Metoda*** e përdorur është ajo e vëzhgimit dhe analizimit të teksteve mësimore të klasës së IX dhe të X, si një nga instrumentet bazë të procesit të mësimdhënies, dhe të të gjitha instrumentave të tjerë që bashkëveprojnë në ndërtimin e një ore mësimore.
Pra, në ciklet arsimore të cilat janë vazhdimësi të njëra tjetrës kemi dy perceptime të ndryshme të gjuhës dhe letërsisë në arritjen e kopetencave gjatë procesit mësimor.
***Rezultatet*** e punimit do të përqëndrohen në funksionalitetin dhe marrëdhënien integruese të gjuhës dhe letërsisë në: tekstet shkollore, në organizimin e procesit të të nxënit, në realizimin e kopetencave didaktike- mësimore dhe në performancën e nxënësve.

**Fjalët kyçe**: gjuhë, letërsi, integritet ndërlëndor, ciklet arsimore, tekstet shkollore;

***"Letërsia dhe gjuha në funksion të njëra- tjetrës"***

- **Si bashkëjetojnë këto dy disiplina mësimore me njëra- tjetrën;**

Gjuha është elementi kryesor mbi të cilën mbështeten shumë studiues sot, Todorov një nga përfaqësuesit e strukturalizmit do të thoshte se: "*gjuha është modeli kryesor për të gjithë strukturat kuptimore, jo vetëm për shkak të natyrës së shenjës dhe të sistemit, por sepse mendja njerëzore dhe universi, kanë gjithashtu, një strukturë të përbashkët, që është vetë gjuha.*"[307]
Ndërthurja gjuhë dhe letërsi, në vetvete krijon në tekst "efekte surprizë", ky është pikërisht objekti i studimit të këtyre lëndëve në shkollat tona. Lënda "Gjuhë shqipe dhe Letërsi" synon t'i afrohet çdo lloj teksti përmes formave të tij gjuhësore, pra, në tërësi nuk pretendon të përcaktojë veçoritë thelbësore, thjesht në terma gjuhësore. Por, shkon edhe më tej duke dashur të interpretojë këto terma gjuhësore duke u mbështetur te konteksti dhe lloji i tekstit, te lexuesi i tij, etj
Sot arsimi, jo vetëm në vendin tonë, por kudo, ka përqafuar metodat bashkëkohore, teknikat moderne, gjithëpërfshirëse që një orë mësimore apo një lëndë të mos mbetet nën kornizat e një informacioni që, duhet nxënë. Tekstet mësimore po ashtu janë hartuar me të njëjat kritere bashkëkohore. Shumë studiues janë përpjekur ta shohin shkollën në shumë dimensione për të arritur në të shumë kërkuarin *"sukses"* të mësimdhënies.
Në këtë punim do të studiojmë një nga instrumentet kryesore për arritjen e një mësimdhënieje të standarteve bashkëkohore, *teksti mësimor*.
Si objekt studimi është marrë teksti :

- "*Gjuhës shqipe IX*", me autorë Rita Petro, Adelina Çerpja, Idriz Metani,"Albas", Tiranë, 2016;
- "*Gjuhë shqipe X"* me autorë: Linda Mëniku, Rita Petro, Aljula Jubani, "Albas", Tiranë, 2016;
- *"Letërsi X"* me autorë: Sabri Hamiti, Ardian Marashi, Dhurata Shehri, "Albas", Tiranë, 2018;

[307] *Ann Jeferson, David Roby, "Teoria letare moderne. Metodat e interpretimit" ,"Albas", Tiranë, 2010*

Janë përzgjedhur këto dy tekste mësimore meqë njëri përmbyll njërin cikël arsimimi dhe tjetri nis fill ciklin e ri, atë të mesëm të lartë, duke përbërë njëkohësisht dhe kalimin e nxënësve nga një konceptim të lëndëve në një të vetme, në perceptimin në dy lëndë të ndryshme.

- ***"Gjuhës shqipe IX"*:**

Teksti është ndërtuar në mënyrë të tillë, për të integruar gjuhën me letërsinë. Duhet marrë parasysh fakti se këto dy lëndë mund të organizohen në procesin e mësimdhënies në funksion të njëra- tjetrës, por ato nuk kanë një lidhje organike e logjike të *pandashme* me njëra- tjetrën. Nëse hyjmë në brendësi të tekstit gjuha dhe letërsia vijnë të ndara nga njëra- tjetra, ku secila pjesë ka peshën e saj të rëndësisë në tekst dhe në programin lëndor. Pyetja e shumë diskutuar mund të jetë, përse këto dy lëndë janë konceptuar në një libër, të ndarë në dy pjesë dhe është emërtuar "Gjuha shqipe IX"?

Duket sikur njëra disiplinë, pikërisht letërsia, merr funksionalitet dytësor në mënyrën se si është perceptuar lënda në aspekt kurrikular.

Për sa i përket çështjes së integritetit të njohurive gjuhësore me njohuritë letrare, ai zbehet në momentin që, shohim një libër të ndarë në dy pjesë:

- Pjesa e parë "Teksti dhe llojet e tij"
- Pjesa e dytë "Njohuri gjuhësore".

Po të futemi në brendësi të librit dhe të shohim më konkretisht do të evidentojmë se:

Në pjesën e parë të librit që përbën edhe pjesën e *letërsisë* përveç realizimit të të gjitha nënlinjave letrare, veçoritë gjuhësore realizohen përmes rubrikës "Reflektimi gjuhësor dhe stilistik", ku nxënësi rimerr njohuritë gramatikore në situata të ndryshme letrare.

Ndërsa në pjesën e dytë (atë gjuhësore) është bërë kujdes që nxënësi të kuptojë funksionet gramatikore apo sintaksore në fragmente të shkëputura nga tekste të ndryshme letrare, por edhe nga tekste joletrare si përshkruese, rrëfimtare, argumentuese, etj.

- ***"Gjuhë shqipe X" dhe "Letërsi X" :***

Gjuha dhe letërsia qëndrojnë si dy lëndë më vete me dy libra mësimor të ndryshëm.

Gjuha X është organizuar përmes rubrikave: - Gjuha shqipe, origjina dhe leksiku;

- Strategjitë e të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit;
- Teksti dhe llojet e tij, gramatikë dhe drejtshkrim;
- Media

Letërsia X është organizuar përmes rubrikave: - Letërsia, gjinitë dhe llojet letrare;

- Letërsia Antike Greke dhe Romake
- Letërsia gojore shqiptare
- Eposet në Mesjetë
- Rilindja dhe Humanizmi Europian
- Humanizmi shqiptar
- Klasicizmi
- Tragjediani shqiptar

Synimi kryesor i të dy lëndëve përqëndrohet në integrimin konceptual të tyre me njëra tjetrën, për të realizuar njësimin e lëndës së gjuhës me atë të letërsisë dhe anasjelltas.

Pavarësisht se janë hartuar në dy tekste mësimore jo të njëjtë, autorët janë kujdesur që lidhja integrale e letërsisë me gjuhën të mbetet e pa cënuar. Pra, njohuritë janë integruar në varësi të

tematikave që trajtohen, për shembull: tematikat e kulturës gjuhësore, pasuria leksikore e gjuhës shqipe është konkretizuar me tekste letrare të folklorit shqiptar.

Vëzhgimi që po bëjmë për këtë tematikë na shtron pyetjen:

Cili organizim ndërlëndor është më produktiv?

Në aspektin e tekstit shkollor edhe pse të konceptuara ndryshe nga njëri cikël mësimor në tjetrin, vihet re se nuk ka diferencë të theksuar, sepse integriteti tematik i njohurive mbetet thelbësor, si parë në këndëvështrimin e një lënde të vetme, si e perceptuar në dy lëndë të ndryshme.

Atëherë le të ndalemi në produktivitetin e rezultateve të të nxënit:

Në sistemin e mesëm të lartë (gjimnaz) nxënësi nuk trajtohet më si një "lexues i vogël", i cili duhet të evidentojë mesazhin didaktik- rreth së mirës dhe së keqes, apo reales dhe ëndërrimtares, etj, në tekstet letrare. Tashmë kemi një lexues, i cili analizon, interpreton, komenton pjesët letrare të shkëputura nga vepra të ndryshme, pra thellohet gjerësisht në thelbin e asaj që është përkufizuar si shkencë për letërsinë.

Gjithashtu lënda e gjuhës nuk mbetet më në kornizat e disa rregullave drejtshkrimore, morfologjike apo sintaksore që u jepet theksi riprodhues, por shpjegohen, zberthehen, analizohen gjerësisht përmes aparatit të reflektimit, ushtrimeve të cilat thellojnë konkretizimin teorik të njohurive .

Thelbësisht në të dy ciklet mësimore pavarësisht konceptimit lëndor dhe programit kurrikular të secilës, integriteti gjuhë dhe letërsi është i pranishëm dhe rrënjësor.

Ajo çka mendoj se është më pozitive në konceptimin në dy lëndë te ndryshme, është hapësira e zhvillimit të kopetencave didaktike dhe aftësive krijuese, analitike, kritike të nxënësësit është më e gjerë dhe më e pavarur. Pra, saktësia shkencore që të ofron gjuha të mos cungojë, aftësinë interpretative si në analizë letrare, por edhe në shkrimet krijuese që të ofron letërsia dhe anasjelltas.

Shtrirja kohore dhe përpunimi në mënyrë specifike të veçorive shkencore, analitike, komentuese, shprehëse të dy disiplinave, ndikon më pozitivisht në kopetencat e të menduarit dhe të mësuarit për nxënësin.

Së fundi, nëse do të ndaleshim në performancën e nxënësve gjatë orës mësimore vihet re se duke u trajtuar veçmas dy disiplinat, atyre iu jepet lirshmëri vepruese dhe zhvilluese në më shumë kopetenca didaktike sesa kur ato janë të bashkëngjitura. Gjithashtu ndodh që prirja zhvillimit të të menduarit dhe të të mësuarit për nxënës të ndryshëm është e ndryshme për secilën disiplinë, kjo prirje zhvilluese nuk ndodh të jetë e baraspeshuar si për gjuhën dhe për letërsinë. Kështu që vlerësimi për arritjet e kopetencave të të nxënit në secilën lëndë është mirë të jetë i ndarë dhe specifik.

Parimet e inegritetit dhe të gjithëpërfshirjes, (me gjithëpërfshirje kuptojmë ndërveprimin e letërsisë me arte të tjera dhe vështrimin e gjuhës në shumë dimensione si e folur, e shkruar, si gjuhë estetike, artisike, etj) janë ndërtuar për zhvillimin e intelektualitetit të nxënësit duke mos e lënë atë në nivel njohës e riprodhues, duke mos i sjellë njohuritë të segmentuara, por duke i ndërfutur me njëra tjetrën në mënyrë që kapaciteti i nxënësve të arrijë në nivele të larta jo vetëm arsimore, por edhe kulturore e shoqërore.

John Dewey në studimet e tij filozofike mbi edukimin dhe arsimimin ka theksuar se: "Nëse japim mësim si dhamë dje, u kemi vjedhur fëmijëve të nesërmen". [308]
Arsimi si proces nisi me qëllimin dhe dëshirën e vetë qenies njerëzore për të mësuar, për të njohur, për të kuptuar e për t'u zhvilluar dhe vazhdon të ketë një vijueshmëri, ndër shekuj, duke e zgjeruar qëllimin dhe objektivin e vet dhe duke ecur në një rrugëtim përpjekës gjithmonë për të arritur më të mirën.
Gjithë ky pasion për përhepjen e diturisë dhe vlerës nëpërmjet mësimit ka ndodhur që 2000 vjet më parë, ndërsa sot 2000 vjet pas, arsimi dhe vlera ende kërkohen nëpër kohë.

## BIBLIOGRAFIA


- Ann Jeferson, David Roby, "Teoria letare moderne. Metodat e interpretimit", "Albas", Tiranë, 2010
- Rita Petro, Adelina Çerpja, Idriz Metani, "*Gjuhës shqipe IX*", "Albas", Tiranë, 2016;
- Linda Mëniku, Rita Petro, Aljula Jubani, "*Gjuhë shqipe X"*, "Albas", Tiranë, 2016;
- Sabri Hamiti, Ardian Marashi, Dhurata Shehri, *"Letërsi X"*,"Albas", Tiranë, 2018;
- John Dewey, "Shkolla dhe Shoqëria", Plejad, Tiranë, 2003.


# De-mythologisation- the path towards the historical truth in Albanian Drama and Literature


1. **Erenestina Gjergji Halili**
Department of Literature
University of Tirana, Rr. e Elbasanit, Tirana, Albania

2. **Eljon Doçe**
Department of Literature
University of Tirana, Rr. e Elbasanit, Tirana, Albania



## ABSTRACT

This papper takes into consideration the issue how much the mythical matter is transformed into dramatic literature matter in Albanian drama and literature. We will only talk about this aspect into our analysis regarding various dramas that have selected.


[308] John Dewey, "Shkolla dhe Shoqëria", Plejad, Tiranë, 2003.

**The purpouse** of this papper is to emphasized a very specific and identifiable aspect, where the drama naturally tends towards the myth.
**The method** used is the textual analysis of the mythological archetypes in Albanian drama and literature. Albanian and non-Albanian mythology in the modern Albanian drama, with the rituals and beliefs that it has used, with different figures that it has collected from the popular mentality, from the psychology on how highly most of the psychological phenomena are considered and evaluated, has served not only to increase the level of emotions af the works, not just the power of sugestion or surprise.
**The results** of our analysis shows that while maintaining individual experiences, we can try to embody the myth, to wear his uncomfortable clothes enabling thus the perception in the light of contemporary experience, the relativity of our problems, their relationship with "roots" and the relativity of "roots" itself.
**As a conclusion** we can state that only in relation to this broad and complex significance as defined by the literal meaning and its under tones, the dramatic situation and the progress of action, from the symbols and the actions of the characters, the reader can turn to himself, to his time to reflect on these two together.

**Key words:** *mythology, drama, Albania, Kosovo, folklore, heritage.*

## 1. Introduction

Although the today's society is dominated by the deep and continuous processes of knowledge of the existence of the world, the sophistication of the relations between the thinking and acting becomes increasingly larger. This sophistication comes from the numerous irrational processes, from ta huge number of inside and outside phenomena (which often put him on inferiority, fear, uncertainty, experience thrilling, mystery). Thus, the mythological structures are used by the playwrights as provoking emotional elements, as opportunities to create situations and conditions of pursuing moody sensory nature fantasy harassment, capture of attention in surprise, causing fear, empathy, delirium, increased level of hypnosis, illusion, magic, effects ( these always taken from the esthetic perception). Overcoming of what is reasonable rational, harmonious, clearness, logic through irrational, instinctive, mental disturbance, unfounded, chaotic, is realized in many modern dramas precisely through the mythological process, which involves the understating of the subject, is then extends to the way the events are presented, to achieve then the structure of the characters thinking and then the ways in which the message is transmitted to the perceiver/reader. As is known, myths (from Ancient Greek "mythos"- words, speech, conversation, story, teaching, legend etc.) have been and remain on human stories about the peoples activities during pre-civilization times that are intertwined with the presence of various gods in accordance with different times and various places, where miraculous

happenings are intertwined, in many occasions, with the human heroic feats. While the term "mythology" comes from union of the old Greek word "mythos" and "logos" ( doctrine, words), which is used at least in three meaning: 1) as a science or theory that examines the myths 2) as a set of myths of people 3)as a specific spiritual creativity that processes myths. Within the structure of a myth coexist and interact simultaneously faith and religion, knowledge and history, synthesis and philosophy, art and esthetics. Myth is the truth and lies at the same time, knowledge and ignorance, reality and illusion.

As genuine spiritual structure of different peoples, in different times and space, myths appear as recognized stages of social development in two basic meanings: a) as transcended realities that existed as well as religion, faith and b) as made up realities, where fantasy, fiction, and creation turns them into phenomenon, which have strong impacts on the processing of human social conscience.

In his books "Mythology, folklore, literature" and "Metatheoretical Esthetics. Classics or Neo-classic?" Alfred Uçi explains that the mythological creativity by its diffusive and mutual nature considers subject and object as benig equal without distinguishing one from the other, hence the marked sign. Meanwhile, the myth has as its own fature the internal enlightenment and hypnotic character. Death and life, the alive or the dead are placed in the same reality. This means that the myth does not give the figures as symbols, metaphors, signs, but as something real, something that coexists and interacts with people, thus as tangible reality in which the phrase appears inseparable from what it expresses. Of course, the drama that has become the subjekt of myths characters or subjects or mythical figure in not equivalent to the myth in terms of experiencing and cohabitation between the creature and the dead, between the real and the phantasmagoric. The problem here is to prezent the issue how much the mythical matter is transformed into dramatic literature matter. We will only talk about this aspect into our analysis regarding various dramas that have benig chosen. It should also be emphasized a very specific and identifiable aspect, where the drama naturally tends towards the myth: the mythological thinking mainly operates with concrete sensory impressions. The early man used to concider the creatures of his imagination and beliefs as weird creatures, with mysterious power that hustle and bustle with him by expressing different types of feelings, extraterrestrial and superpower powers, sudden impact, which cannot be perceived by senses and underdeveloped minds. Even the characters in the Albanian dramas of mythical subjects are in the role of early human mythical man. But, an essential thing changes: the

recipient. Today's reader can never be indentified with the action of the mythical character, or with the ways the early recipient perceived (percepton with strong religious elements). Rather, he distances himself from the logical action of the reason and the scientific knowledge.

It is known that mythological thought, as a rule, is accompanied by emocional and affective experiences. This is because the heroic feats and tragic fatalities that are told in myths are extarordinary, filled with horror, fear, surprise, intence events and extreme situations that overwhelm the consciousness of the person who perceive it. Being located on the Balkan Peninsula, with no less aktive connections and communications with countries of the Mediterranean region, certainly to many Albanians rites, myths, beliefs, in some element share affinities with rituals, myths, Thracian-Iliyrian beliefs, with Greek beliefs a bit away, which is an evidence of a fellowship of their appearance.

Kosovo Albanian plawrights have used the mythological material in favor of attractive dramatic subjects, in orden to create characters with great expressive force. This path that has been followed has been in favor of the creating such psychological conditions that show deep emotions, in favor of decoding from which from the early semantics of the myth is moved to the universal idelogical-philosophical parallels that bear the esence of the beng itself. Such an approach, as assumed, increases significantly the impact on the reader, which is part of understanding and feeling of this mythological subject, either from their own personal experiences, whether from community experiences, ethnic, and national.

From the most obvious approaches in the field of use of mythological matter of Albanian modern and postmodern drama in Kosovo, religious ethnology is widely used by some writes as B. Musliu, R. Qosja, T. Dervishi, M. Kraja.

## 1. From mythology to drama

1) From the ancient primitive mythology of different people from various pre-civilized periods, mainly the Neolithic period, and that are then absorbed and circulated in different countries and people with wide impact on social consciousness of different historical periods, religjion, philosophy, morals, art etc.

2) From the classical Greek and Roman mythology, with no less elements of reproduction of the earliest myths and the presence of new myths.
3) From the monotheistic religions mythology, mainly from the Bible and the Qur'an, but also from boks and ther "holies", where stories about creation, God, prophets, etc., where there is a genuine form of myth, strongly mixed with beliefs, theological doctrines, rites, etc.
4) From the mythological arsenal of our times, even those resources, which, for it's structure, have affinities with the way the myths are established and operate.

What relates to the Kosovo Albanian drama and our argument is that the myth in various dramatic Works by the Albanian authors, is always placed in a balance of revaluation process of recognition and knowledge.

In his book "The Birth of Greek tragedy", publishing house "Eugen, Tirana, 1001, the distinguished philosopher Friedrich Nietzsche, considered as the basic strukture of Greek tragedy to essential origins: the Dionysian origin and the Apollonian origin. Myth as the source of subjects emerges as a cause and consequence of action of heroes, gods and others. Its structure was syncretism: reality and religjion.

Friedrich Nietzche noted that Gods, as part of the implementation of religion, had several functions: a) the punishment of offenders. b) granting of the right, c) salvation from disaster, death, and disease of kings, princes and heroes. Sacral sentences of Gods are represented directly from them in the form of prayers and worships, as messianic message, as a philosophy of life, as a moral stand and legal right, as they are shown as charitable figures in the stage action exercising the right to award or take privileges or benefits (beneficent). Recognition of the Gods and giving by them of the didaskalic part to the tragic characters was done at the end of the tragedy, when they, came down to the stage by a crane which was placed in front of heroes. This solution was called Deus ex machine-God from the machine. This direct testimony the religious of the act of reception by the general public, which he took as the "truth" (through illusion and hypnotic effect). This also explains why the ancient Greek collectively participate in major festivities of Dionysius where tragedies were played, because the show was at the same time an artistic aesthetic act and a religious act. Even chatharsis was two-sided, aesthetic and religious, as a spectator and as a believer; an artistis source or a given information and argument in order to explain the historical processes of civilization periods early or late.

Myths of Albanian modern playwrights, but also ‘’realistic’’, traditional, are considered by different angles: as part of religion, as part of the early polytheistic mythology, as esoteric phenomenon, as it is transfigurated in the Albanian folklore. As compared with optics pluralistic in his assessment studies today, according to Alfred Uçi, different scholars “equate myth with religjion, others equate it with philosophy, while others tie the esence of the myths with a quite irrational and illogical origin, and others perceive it as the foundation of any underlyimg mental structure, logic, science and of any intellectual reason”. But, the research we have done to the Albanian drama in Kosovo, rarely if ever, turns out to be a myth conceived as syncretic structure, which implies the presence and the interoperable coexistence of religion and philosophy, the morality of art, scientific knowledge of esoteric phenomena etc. However, it is taken only in the values of creating a new artistic aesthetic reality, with genuinely literary functions, and used sometimes as a metaphor and as an element with synthesis and universal force, sometimes as emotional situation, sometimes as allegory, once as a ritual, effect and many times as a concrete literary figure. As we take in consideration, dramas such as ‘’Coast of grief’’, ‘’A reprize of freedom’’, ‘’The man with Zymrydi eyes’’, ‘’Public dinner’’ of Teki Dervishi, ‘’Rrakullima’’ and ‘’The source of Rooster Inn’’ of Beqir Musliu, ‘’Gof’’ Anton Pashku, ‘’Beselam, why sacrifice’’, ‘’Gala’’, ‘’Living Sfinga’’ of Rexhep Qosja, ‘’Paper moon’’ Mehmet Kraja, ‘’Hijesina’’ of Islam Nabi, ‘’Me and God’’ and Ekrem Kryeziu etc., the aesthetic and critical analysis distinguish the use of myths and mythologicial material on various traits, despite the fact that the authors have used the diffusive and operational character between the subject and the object, what is believed and what is not believed. On the the other hand, they have conceived it’s functions always in the artistic and illusionist conventions, therefore decomposing the direct mythical reality and taking it as true but not as implication, drift, so as an artistic expression possibility. By utilizing the awesome power that the overall sensory mythological content in these dramas gives, the authors provide opportunities for imaginative recreations and phantasmagoric realities, by creating strange humans or unreal environments, which cause emotional affective reactions. In turn, these emotions significantly increase the degree of affective experiencing of dramatic work by the reader.

Meanwhile, this mythological subject is taken by these authors in ther contents. Here we would like to mention their natural attempt to create fictional realities, illusory, non-existent, to create another reality: the reality “dreamer”.Within this reality the above

mentioned playwrights have insisted also on creating expected or anxious situations in detecting suppressed desires or aspirations that are expected to occur (to a character or a grup of personages). Of course, these are conceived as an essential part of modern or postmodern typology of dramas in order to expand the hypnotic effect to the reader, as increased artistic expressivenes. For example, although the tetralogy of the The witch of Rooster Inn of Beqir Musliu, a virtual and factious reality is created, why not a dreamer reality, in contrary, the content of the saga of Halil Garria is seen in the firts holiness characteristic of the myth, specifically in the case of related saga of the oath and given word. Nine of witchcraft trials and hearings conducted by the spiritual sourer from the Rooster Hani discover even beter the inside of this mythological tetralogy, which was taken as the subject of a criminal case. ’’What are you doing my lord?- he says. -All things, as it seems, start with me and from me...Here I want to awake ballads... From them I have to suck a charm that always seems to be cold..Black...Oh my Lord, help me to draw at least the Halil Garria face and then let’s start to hollow out the plague in my face...” By camouflaging the autor own voice through the voice of the The witch of Rooster Inn, Beqir Musliu explains indirecly the purpose or, expressed in a more direct way, the access to material that is the subject of mythological drama: “The anger of the artistic body also reaches the highest point-explains he in the didaskalic part of the drama- thus two scenes are faced into two categories of the meaning of myth and legend of Halil Garria from its inception to its modernization of the vizual and transformation in terms of the requirements of this theatres’ game which, obviosly, is the The witch of Rooster Inn. Mythology is closely related to the rite and ritual. In his work “Tales of identity”, the theorist and the reprezentative of the critic mythical-symbolist literature Northop Fray argues the presence of archetypes in the works of different authors in different periods that provides recycling invariant unlikely literary charachter of a class or way for the perception of dramatic situations. Since the rite, according to him, is as sequence of temporary acts with a certain sense, contrary, is exaclty the myth that transforms into a archetypal rite of huamn behavior and atitude towards this or that object with which it comes into interactive relationships. Myth comes sometimes as an original way of telling the dramatic work, mainly in the structuring of the subject, while the rite and the archetype help in exposing he significance of this story. Hence, beyond the concrete analysis of the plays, we come to the view that favorite charachters in modern Albanian drama of Kosovo authors, there are heroes of the Albanian cultural anthropology calendar that often come out of the

early tales and legends, the ‘’epic of the heroes’’, without excluding, of course, ther human figures that constitute the biblical and curanic myths.

Albanian and non-Albanian mythology in the modern Albanian drama, with the rituals and beliefs that it has used, with different figures that it has collected from the popular mentality, from the psychology on how highly most of the psychological phenomena are considered and evaluated, has served not only to increase the level of emotions af the works, not just the power of sugestion or surprise, but also an original and contemporary way of presenting the relationship between the individual and the grup of people, between the common conscience and sublimed reason, between the reality and the illusion, dream and the non-dream, between the utopia and the truth.

If we refer to the argument in the drama “Paper moon” of Mehmet Kraja, these balances are good and clearly stated. The drama did not point out direcly to a myth, nor is based on any story, legend or ritual ethnological concrete from the Albanian tradition. It is a myth originating from the biblical scripture of Old Testament and it confront the God and the Devil into the human genesis, the episode of Eden with Adam, Eve and the serpent-devil, as it can be taken as a pattern of human settlement archetypal between God and Satan: which should choose and the temptation whom to avoid. So the drama has a character called Mephitis ( Mephistopheles, otherwise the Devil Satan) and another character called Maestro (generally means man, especially the Kosovo-man). A pillar placed between man and where he will be gripped, is a reminiscent of Jesus Kalvary, a biblical metaphor of crucifixion.

And so, the drama is developed as a challange of Mephitis to the Human, where the latter wins over the violence used on him, and even joke with the powerfull, make fun of invading Mephitis as invader and violator of the Kosovo Man. Against here, of course, we do not have a direct form of biblical myth of the genesis or retelling of old Albanian and European legends or stories, which the man and the devil are found, Mephitis (remember, the legend of Doctor Faustus, from which Goethe got inspired and created his masterpiece ‘’Faust’’). Quite the opposite the biblical myth and ancient European legend is presented only as a form of schematised, as a literary paradigm, as a strand. It is reconsidered and re-lifted by a scheme and a strand in a new way of appearance being turned into something completely different as regards the subject and original literary structure, where the characters not only are metaphors, but are also symbolized.

Despite their archetypal nature is preserved, they are adapted and reorganized matching an “another” reality, the conflict: Serbs conquering Kosovo. At “The Moon”, the playwright also exceeds the meaning of its known mythological significance of her. Although in the mythology it is identified as “daughter” of the Earth, as the “girlfriend” of the Sun and many other definitons, among which stands out its extraordinary beauty, the pale light, the lord and captivating power it has, contrary in the drama it that gets a more symbolic value and is placed in contradictory functions with its mythological origins. So, it is no longer a moon of “beautiful”, “stunning”, “poetic”, “lyrical”, “miraculous” power etc., but an ugly, nasty, hideous, lying, even tragic moon. Why? Because for now its meaning is inverted, is transformed. Turn into a pure simbol, moon now appears as “made of paper”, meaning being artificial. Further, it means the promising Europe, but often indiferent, that looks from far away the tragedy of the pople of Kosovo and the Serb genocide. Beautiful words for Freedom, Rights of People, and criticism towards Nationalistic Violence that sometimes articulated with witty and ironic tones, attribute contrasting qualities to the mythological simbol of the moon, and turn it into a simbol of indifferences and unfulfilled promises. Thus, the case takes another function and the mythical brand, meaningfulness. In such cases, the reader distinguishes especially in drama “the secondary images, which brings cohesion historical values to the present day, through a conceptual and emotional depth.

Regarding the catharses and provocative effect of the myth to contemporary readers, prominent director of the twentieth centry, Jerzy Grotowski (1969) in his famous book “For a poor theatre”, explains: “In the first place, it would be a good thing to counterview the myth and not identify with”.

In other words, while maintaining individual experiences, we can try to embody the myth, to wear his uncomfortable clothes enabling thus the perception in the light of contemporary experience, the relativity of our problems, their relationship with “roots” and the relativity of “roots” itself. If the situation is brutal, if we lose ourselves naked, exposing and touching the most intimate psychic layers, the masks of everyday life itself cracks and falls. Secondly, even though we have lost “the mutual sky” of trust and unbreakable barriers that surround us, we are left with perceptual ability of the human organism. Only myth, embodied in the tangible reality of the actor, in his living organism, can function as taboo. Rape of a living, exposure led to an excess cruelty, restores us to concrete mythical situation in a common experience of human truths.

Only in relation to this broad and complex significance as defined by the literal meaning and its under tones, the dramatic situation and the progress of action, from the symbols and the actions of the characters, the reader can turn to himself, to his time to reflect on these two together. In this way the symbol is seen as myth and metaphor as any other ethno-culture and universal substratum. According to the researcher Mark Tirta, "the unitary character of the ethnic Albanian mythology faces directions. It is experienced in places of objects of cults of nature, the cult of family life and the tribe". Is widespread, for example, the cult of the serpent (remember the drama of A.Shkreli "Snake house" where mythical figure of the snake is a sign of prosperity and protection of the guest house, but on the other hand, thanks to the semantic transformations that the writer makes, it is immediatly returned to a human-snake metaphor, that stings and poisons the lives of honest ant ethical man). In some cult the drama of the mother is, or the cult of the breasts of women. A number of rituals are used by playwrights as a show of the Albanian identification with the nature, social organization, that of the tribal community, expressed through the name of inherited beliefs, the cult of the dead and death in general, in celebration of agricultural and livestock, the cult of the peaks (drama "Gof" A.Pashku, with the pinnacle of the Haut Mountains, that symbolizes the upper part, immaculate, and the noble identity of the Fatherland, the Nation, awareness).

In other dramas, additional rites, ritual as the scarecrow for a rain to save crops, or fire rituals, ritual of foot around the house when the verge is violated, or the dragon mythology, dragons, fairy tales, holy shepherd, verge mother, the time, motherhood, hob, rites and crafts, etc., cult numbers are brought. The wealth of rits, myths and beliefs, even if time "mythological" is locked, appears as a fragment socio-physiological and antropological, which still lives and transmitted from generation to generation.

## 2. Conclusions

Beliefs, rituals, either in its archaic forms or remodeled forms, are part of the family functioning, which should be referred to the birth rites, beliefs and myths about fate, happiness and disasters, pictures, and superstitions, reminiscent associated with death and the body of the dead, the interaction between the life-death-after death. Dissemination of the Albanian mythology with figures such as the dragon, witch, time, the mother of verge, and others related to the soil fertility, abundance of crops, farming, vineyards, orchards, livestock, removal of disasters and evil forces, are also prevalent and popular devotions such as those

on the Day of Summer, Day of Vangjelizmoit, or Novruz Day or Our Lady Day, St.George, St. John's starch etc. Al these and more are indicative of real and mythical ethno-folkloric among Albanians. Their rudimentary forms can be found in the way they are respected even today not only in the rural communities, but also in civil, customary and common structures that can be found in their roots deep into the centuries. Of course, this entire clause of myths, rituals, beliefs, tales, legends etc. Has turned itself into a source of subjects, human relationships, artistic images, and likely has enough artistic chances and expressiveness in many of the modern Albanian dramas in Kosovo.

**References**

1. Alfred Uçi, (2008) Classics or Neoclassic? Metateorike esthetics of art, the Albanian Academy of Sciences, Vol. II, Tirana, 2008.

2. Alfred Uçi, Mythology, folklore, literature, Naimi, Tirana, 2008

3. Beqir Musliu, The source of Rooster Inn, Renaissance, Pristina, 1989.

4. Jerzi Grotowski, For a poor theatre, Simon and Shuster, New York, 1969.

5. Northop Frye, Anatomy of criticism, Pristina, 1990.

5. Stefan Çapaliku, Modern aesthetic, GVG Ombra, Tirana, 2003.

## POZITA E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS NËN MBRETËRINË JUGOSLLAVE DHE SHPËRNGULJET E TYRE MË 1933

**Ma. Sc. Sami Gashi** (Phd Candidat)
Gjimnazi "Remzi Ademaj", Prizren

**Abstrakti**

Punimi trajton pozitën e shqiptarëve të Kosovës nën Mbretërinë Jugosllave dhe ofron disa të dhëna për shpërnguljen e shqiptare nga Kosova në Shqipëri më 1933. Kalimthi janë shikuar edhe proceset që e karakterizuar pozitën e shqiptarëve si kolonizimi dhe arsimi.

**Fjalë kyqe:** shpërngulje, shqiptarët, Kosovë, Shqipëri.

Në periudhën midis dy luftërave botërore Mbretëria SKS më pas Mbretëria Jugosllave ndoqën një politikë hegjemoniste dhe shoviniste ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe në viset tjera të ish - Jugosllavisë.

Gjatë viteve 1918-1941 çetnikët u shfrytëzuan nga regjimi jugosllav për të vënë në jetë politikën shtetërore shoviniste të shkombëtarizimit të Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare. Ata u aktivizuan për shtypjen e lëvizjes së armatosur kryengritëse të popullsisë shqiptare për çlirim e bashkim kombëtar në vitet 1918-1928, më tej për shpronësimin dhe shpërnguljen me dhunë të shqiptarëve si dhe për kolonizimin e tokave të tyre.[309] Si rrjedhojë Mbretëria Jugosllave ishte shndërruar në një burg ku shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Preshevë, Medvegje, Bujanovc, në Mal të Zi ndonëse për nga numri nuk ishin simbolik ishin në pozitë tejet delikate dhe mjaftë të vështirë.[310]

Kolonizimi dhe reforma agrare në Kosovë kanë pasur qëllim kryesisht nacional - politik dhe karakter eksploatues. Qëllimi ishte të thehet kompaktësia nacionale e popullsisë shqiptare, të shpërngulen shqiptarët në drejtim të Turqisë dhe Shqipërisë, të kolonizohet Kosova e veçmas rreth kufirit me Shqipërinë me qëllimin që të ndërpritet vazhdimësia e popullit shqiptar.[311]

Më 18 mars 1930 Hasan Prishtina iu drejtua përmes një Memorandum Komitetit të Lidhjes së Kombeve për minoritetet si përfaqësues i shqiptarëve që jetoninë në territorin e Mbretërisë Jugosllave. Përmes këtij memorandum i kundërvihej reagimit të qeverisë mbretrore jugosllave, se ankesat e shqiptarëve të paraqitura nga H. Prishtinës janë të pabazuara pasi shqiptarët në Jugosllavi gëzojnë liri të plotë, kanë shkolla dhe ushtrojnë të drejtat politike. Këto deklarata nuk i përgjigjeshin aspak fakteve. Përkundrazi, e vërteta ishte se në tërë Jugosllavinë nuk kishte asnjë shkollë shqipe, se elementi shqiptar ishte i shtypur. Përmes këtij memorandumi H. Prishtina i lutej të lartit komitet të ketë mirësinë të bindet për vërtetësinë e ankesave shqiptare, dhe të dërgohej një komision hetimor neutral në vend për të

---

309 Marenglen Verli, *Bandat çetnike serbe*, në:*Shqipëria dhe Kosova historia e një aspirate*, vëllimi I, Botimpex, Tiranë, 2007, f. 146

310 Masar Kodra, *Pozita ekonomike dhe politike e kombësisë shqiptare të Maqedonisë midis dy luftërave botërore II,* në: Jehona nr. 5, viti XI, Shkup, 1973, f. 97

311 Dr. Jusuf, Osmani, *Kolonizimi i refugjatëve kolonë – optantë nga Shqipëria në Kosovë në vitet 1933-1935,* në: Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, IAP, Prishtinë, 1996, f. 29

konstatuar gjendjen reale ku një pakicë prej një milion banorësh kërkon ndihmë në luftë për ekzistencën kombëtare.[312]

Informacionet nga Kosova, bënin të ditur për dhunë, dhunime e masakra barbare ndaj shqiptarëve të Kosovës në kohën kur po planifikohej që të mbahej Konferenca Ballkanike në Athinë me qëllimin që të krijohej një bashkëpunim midis kombeve të Ballkanit. Ishte mjaft ironike që në njërën anë të flitej për bashkëpunim e mirëqenie të minoriteteve e në anën tjetër vazhdonin masakrat ndaj shqiptarëve në Jugosllavi.[313]

Në përpjekjet për t'i shkombëtarizuar trevat shqiptare, qarqet drejtuese të Beogradit i mohuan popullsisë autoktone shqiptare edhe të drejtat më elementare demokratike e nacionale siç ishte e drejta për arsim në gjuhën shqipe.[314] Meqë mungonin shkollat shqipe në Kosovë, shumë fëmijë të moshës shkollore mbeteshin pa arsim, një pjesë merrte rrugën e kurbetit për t'u shkolluar, ndërsa fare pak shqiptar (6,5 për qind djem e 0,5 për qind vajza) ndiqnin shkollat serbe. Programet e tekstet mësimore ishin hartuar me synimin që t'i serbizonin fëmijët shqiptarë.[315]

Tirana zyrtare në vitet e Mbretërisë e zhvilloi veprimtarinë në të mirë të çështjes së Kosovës edhe në sektorin e arsimit. Nuk ishin të pakta për kushtet e atëhershme të Shqipërisë, përpjekjet për arsimimin jo vetëm të fëmijëve të emigrantëve të ardhur nga Kosova, por edhe të atyre fëmijëve dhe të rinjve kosovarë që rrezikonin duke kaluar ilegalisht kufirin për t'u shkolluar në Shqipëri, ku kishin të garantuar edhe akomodimin në konvikte. [316]

Si rezultat i gjendjen së rëndë shumë shqiptarë nga Kosova dhe viset e tjera u shpërngulën me dhunë nga autoritetet e Mbretërisë Jugosllave duke u vendosur në Turqi, Shqipëri e vende të tjera.

Si rezultat i presionit jugosllav të shpërngulurit nuk lejoheshin as ta shisnin pasurinë e tyre.

Gjendja e të shpërngulurve në Shqipëri ishte e rëndë edhe nga mungesa e ndihmës shëndetësore ku shumica e emigrantëve vuanin nga malarja.[317]

Shpesh fëmijët e shqiptarëve të ikur nga Kosova gjindeshin në mes të katër rrugëve e një numër i konsiderueshëm edhe në Strehën vorfnore të Tiranës.[318] Në gjendje të rëndë ishin edhe emigrantët e vendosur në Berat, ndërsa emigrantët e vendosur në Reskovec e kishin

---

[312] Marenglen Verli, *Veprimtaria diplomatike e Hasan prishtinës për çështjen e Kosovës* në: *Aspekte rreth krijimit dhe zgjidhjes së çështjes shqiptare (shek. XIX-XX)*, vëllimi I, Klean, Tiranë, 2014, f. 108, 119-120

[313] "Mjerimet e Kosovës shqiptare", *Vullneti i popullit*, Tiranë, viti I, nr. 85, 20 korrik 1930, f. 1, 4

[314] Marenglen Verli, *Disa materiale interesante rreth spastrimit etnik të viseve shqiptare në Jugosllavi*, në: *Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Botimpex, Tiranë, 2007, f. 178

[315] *Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi i III*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë, 2007, f. 489

[316] Marenglen Verli, *Interesimi i shtetit shqiptar për shqiptarët në Jugosllavi në vitet 20 – 30 të shek. XX*, në: *Aspekte rreth krijimit dhe zgjidhjes së çështjes shqiptare (shek.XIX-XX)*, vëllimi I, Klean, Tiranë, 2014, f. 131

[317] Arkivi Qendror i Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme (152), viti 1933, Dosja 761, Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Drejtorinë e Reformës Agrare dhe Drejtorinë e Shëndetësisë, mbi masat e marra për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të emigrantëve

[318] AQSH, Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme (152), viti 1933, Dosja 763, Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Kryesinë e Këshillit të Ministrave, mbi dërgimin e fëmijëve të emigrantëve në strehën vorfnore, fl. 1- 20

fatin që ta kenë pranë mjekun e komunës, ndërsa ata të fshatrave të tjera pothuajse shumë pak nga shërbimi shëndetësor.[319]

Sipas një dokumenti të diplomacisë italiane të datës 20 shkurt 1933 ndër të tjera shkruan se në gjysmën e dytë të muajit janar në Shqipëri u shpërngulën 30 familje, 22 prej të cilave ishin nga Kosova, 7 nga Manastiri dhe 1 nga Greqia.[320]

Më 30 nëntor 1933 Ambasada e Shqipërisë në Beograd e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë se Ministria e Punëve të Jashtme Jugosllave e kishte lejuar udhëtimin në Shqipëri të familjes së Halil Arifit pasi paraprakisht ishte detyruar të japë deklaratë për heqjen e nënshtetësisë jugosllave.[321]

Në vitin 1933 nga Kosova në Shqipëri ishin shpërngulur gjithsej 181 familje shqiptare.[322]

**Burimet**


- Arkivi Qendror i Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme (152), viti 1933, Dosja 761, Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Drejtorinë e Reformës Agrare dhe Drejtorinë e Shëndetësisë, mbi masat e marra për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të emigrantëve
- AQSH, Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme (152), viti 1933, Dosja 763, Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Kryesinë e Këshillit të Ministrave, mbi dërgimin e fëmijëve të emigrantëve në strehën vorfnore
- AQSH, Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme (152), viti 1933, Dosja 761,Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Drejtorinë e Reformës Agrare dhe Drejtorinë e Shëndetësisë, mbi masat e marra për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të emigrantëve
- Osmani, Dr. J. (2016). *Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918 – 1941, Dokumente: Shpërngulja 3,* Dukagjini, Prishtinë


**Literatura**

319 AQSH, Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme (152), viti 1933, Dosja 761,Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Drejtorinë e Reformës Agrare dhe Drejtorinë e Shëndetësisë, mbi masat e marra për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të emigrantëve, fl. 8

320 Dr. Izber Hoti, *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve (1930 – 1941)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1997, f. 113

321 Prof. Dr. Jusuf Osmani, *Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918 – 1941, Dokumente: Shpërngulja 3*, Dukagjini, Prishtinë, 2016, f. 241 -242

322 Hakif Bajrami, *Shpërngulja e shqiptarëve në Turqi gjatë viteve 1912-1941*, në: "Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndej" simpozium i mbajtur në Prishtinë më 20-21 janar 1994, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 1995, f. 144

- Bajrami, H. (1995). *Shpërngulja e shqiptarëve në Turqi gjatë viteve 1912-1941*, në: “Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndej” simpozium i mbajtur në Prishtinë më 20-21 janar 1994, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë
- *Historia e Popullit Shqiptar, vëllimi i III*, (2005)Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë
- Hoti, Dr. I. (1997). *Qëndrimi i diplomacisë italiane ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve (1930 – 1941)*, Instituti i Historisë, Prishtinë
- Kodra, M. (1973). *Pozita ekonomike dhe politike e kombësisë shqiptare të Maqedonisë midis dy luftërave botërore II*, në: Jehona nr. 5, viti XI, Shkup
- Osmani, Dr. J. (1996). *Kolonizimi i refugjatëve kolonë – optantë nga Shqipëria në Kosovë në vitet 1933-1935*, në: Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, IAP, Prishtinë
- Verli, M. (2007). *Disa materiale interesante rreth spastrimit etnik të viseve shqiptare në Jugosllavi*, në: *Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Botimpex, Tiranë
- Verli, M. (2007). *Bandat çetnike serbe*, në: *Shqipëria dhe Kosova historia e një aspirate*, vëllimi I, Botimpex, Tiranë
- Verli, M. (2014). *Veprimtaria diplomatike e Hasan prishtinës për çështjen e Kosovës* në: *Aspekte rreth krijimit dhe zgjidhjes së çështjes shqiptare (shek. XIX-XX)*, vëllimi I, Klean, Tiranë
- Verli, M. (2014). *Interesimi i shtetit shqiptar për shqiptarët në Jugosllavi në vitet 20 – 30 të shek. XX*, në: *Aspekte rreth krijimit dhe zgjidhjes së çështjes shqiptare (shek.XIX-XX)*, vëllimi I, Klean, Tiranë

*ISSN 1800-9794 (Print)* *ISSN 2337-0521 (Online)*

**MARRËVESHJET NDËRKOMBTARE DHE ÇËSHTJA E KOSOVËS GJATË VITEVE 1991/1995**

**Lulzim Nika** [323]

## Abstrakt

Çështja e Kosovës, nga fillim i i shembjes së komunizmit jugosllav dhe atij socialist, ishte nënçmuar, nuk ishte trajtuar në mënyrë realitete dhe meritore. Diplomacia ndërkombëtare, përballë arrogancës së politikës nacionaliste të Serbisë, kishte qenë inferiore, për çka, ndodhën edhe luftërat në ish Jugosllavi, me protagonist, politikën pushtuese, ekspansionite të Serbisë. Në këtë rrafsh, çështja shqiptare në ish Jugosllavi, dhe veçmas çështja e Kosovës u sakrifikuan, ashtu siç kërkoi dhe imponoi Serbia. Ishin të kota, përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës që, edhe ata sikur edhe popujt tjerë në ish Jugosllavi të vendosnin në paqe dhe me marrëveshje edhe me Serbinë për të ardhmen e tyre.

Shpërbërja e ish Jugosllavisë, e filluar nga viti 1991, është një prej zhvillimeve më dramatike me të cilat u përballë Evropa Juglindore dhe përgjithësisht, diplomacia ndërkombëtare e kohës. Ideatorët, arkitektët e diplomaciaë evro-perëndimore, sikur nuk kishin pasur fuqi, guxim dhe vendosmëri diplomatike që, me kohë dhe në mënyrë të qartë t'i kishin dhënë vlerësimet për, domosdoshmërinë e shpërbërjes edhe të ish Jugosllavis., e cila me të gjitha standardet ndërkombëtare kishte qenë krijesë e pa natyrshme. Serbia, politika e saj nacionaliste i imponoi diplomacisë ndërkombëtare, evro-perëndimore që, shqiptarët të mos merrnin pjes si akter në Konferencën e Londrës ( 1991), që, të injoroheshin në mënyrë dramatike dhe përulëse edhe në Konferencën e Dejtonit ( Ohajo, 1995 ). Vendimet e diplomacisë evro-perëndimore, që, shqiptarët të mos ishin akter, protagonist të fatit të tyre në Konferencëën e Londrës dhe në Konferencëne Dejtonit, sikur edhe në shumë konferenca dhe tubime tjera ndërkombëtare për zhvillimet në ish Jugosllavi, e fuqizoi ndjenjën dhe projektin e nacionalizmit serb, ndërsa, i dëshproi shqiptarët, të cilët me të drejtë e krijuan bindjen se, Perëndimi dhe jo vetëm BE-ja po i sakrifikojnë, po ia mbajnë anën Serbisë!

Prandaj, siç ka dokumentua historia e zhvillimeve në ish Jugosllavi, shqiptarët, si rezultat, në radhëtë parë të dhunës së pa shembullt të Serbisë, por edhe të braktisjes nga ana e Evropës, u detyruan që, vet, me forcat dhe mundësitë e tyre t'i kërkojnë zgjidhjet për të ardhmen e tyre,

[323] MR i shkencave të Historisë dhe PhD Kandidate

jashtë sundimit të Serbisë. Historia, e zgjidhjes së çështjes së Kosovës erdhi si rezultat i luftës së popullit të Kosovës, trupave të NATO-së me forcat ushtarake, paramilitare, policore të Serbisë.

Fjalët çelës: 1. Kosova; 2. Londra; 3. Dejtoni; 4. Diplomacia; 5. Shqiptarët.

## Hyrje

Në Konferencën e Hagës për Jugosllavinë më 1991, ku dhe u vulos shpërbërja e saj, Kosova nuk u trajtua si pjesë konstituive e shtetit jugosllav, edhe pse dihej abrogimi i njëanshëm i statusit të saj bërë më 23 mars 1989 nga Kuvendi i Serbisë. Ibrahim Rugova ishte i ftuar zyrtarisht të marr pjesë në Konferencen e Hagës për Paqen në Jugosllavi. Ky është kontakti i parë i përfaqësuesve shqiptar të Kosovës në këtë Konferencë. Në intervisten qe dha para gazetarëve, ai tha “Ne jemi ftuar qe të zhvillojmë një takim me dy nenkryetarët e Konferences se Paqes për Jugosllavinë. Ky është më shumë një takim ku do të shikojmë se në çfarë raportesh pastaj do të inkuadrohemi në Konferencen e Hagës. Ne do të kerkojmë që të jetë pjesëmarrës Komisioni ynë Kushtetues dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë”. Përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës në këtë konferencë kishin për qellim të paraqesin pikëpamjen e tyre se nuk janë pakicë sipas realitetit etnik në Jugosllavi, sepse ishin populli i tretë për nga numri i popullsisë në federatën Jugosllave[324]. Nga kjo konferencë doli edhe Komisioni i Banditerit, i cili Kosovën nuk e llogariti as si term gjeografik e lëre më si njëri nga tetë subjektet që kanë përbërë Federatën Jugosllave.[325] Komisioni i Banditerit padrejtësisht e injoroi çështjen e Kosovës, duke pranuar aneksimin e dhunshëm nga Serbia, edhe pse rrjedhat e ngjarjeve të mëtejme e bënë të pavlefshëm këtë vendim.[326] Në të kundërt, katër republikave jugosllave, Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës e Hercegovinës dhe Maqedonisë iu njoh subjektiviteti shtetëror.

## Konferenca e Londrës dhe çështja e Kosovës

[324] Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Dosja 1609, Tiranë, 1991.

[325] Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe Shkatërrimi i Jugosllavisë, (Rilindja), (2008), Prishtine, f.450.

[326] Edita Tahiri, Konferenca e Rambujesë (procesi negociator dhe dokumentet), Pejë, 2001, f. 17.

Konferenca e Londrës që vazhdoi punimet në Gjenevë (1992-1995)[327] shqiptarët i shqyrtoi vetëm aq sa iu deshën asaj për informacion burimor. Aty merrnin pjesë pesë delegacione shqiptare (delegacioni nga Shqipëria, si shtet fqinj i Jugosllavisë, delegacioni nga Kosova, delegacioni nga Lugina e Preshevës, delegacioni nga shqiptarët e Malit të Zi dhe delegacioni nga shqiptarët e Maqedonisë.[328] Në këtë kohë disa senatorë dhe kongresmenë i kishin shkruar letër presidentit Bush për domosdoshmërinë e hapjes së çështjes së Kosovës në Konferencën e Londrës të organizuar për Jugosllavinë. Në letrën origjinale të tij kongresmeni William H. Zeliff, JR, drejtuar presidentit, Bush duke potencuar "situatën e rëndë ku në bazë të ekspertëve parashihet afrimi i luftës mes shqiptarëve dhe serbëve e ndër të tjera kërkohet edhe përfshirja e liderit të shqiptarëve të Kosovës Ibrahim Rugova në Konferencën e Londrës dhe që mundësisht të pritet në një takim në shtëpinë e Bardhë Ibrahim Rugova për t'u informuar rreth gjendjes në Kosovë".[329] Në përgjigjen zyrtare për brengosjen e kongresmenit Zeliff, Shtëpia e Bardhë i përgjigjet, duke theksuar se "Konferenca e Londrës është organizuar për t'i treguar të gjithë akterëve të përfshirë në konfliktin jugosllav vendosmërinë tonë dhe të partnerëve, që nuk do të lejojmë eskalimin e dhunës në Kosovë".[330] Mirpo në të njejtën kohë, gjegjësisht me 20 Gusht 1992, i ashtuquajturi President i Komitetit për Kosovë e Metohi në Kuvendin e Serbisë Momcillo Trajkovic e kishte kundershtuar mundësin për pjesmarrje të shqiptarëve nga Kosova në një takim me Këshilltarin e Ambasades të SHBAve në Beograd James Swigert, duke thënë se " pjesmarrja e shqiptarëve ne konferencen ndërkombëtare për Jugoslavinë në Londres do të ishte një preqedant i cili do të i inkurajonte forcat seperatiste dhe do të dergonte drejt konfliktit". Ai kishte shtuar se: "Propozimi për ti dhënë Kosovë e Metohisë një status special është shembull tipik i përzierjes në punet e brendëshme të një shteti tjeter dhe faza e parë drejt ndarjes të Kosovës dhe Metohisë", dhe kishte theksuar se esenca e të gjitha problemeve në Kosovë ishte që ana shqipëtare insitonte në krijimin e një shteti tjeter të shqiptarëve në Ballkan.[331] .Ibrahim Rugova kishte marrë një

---

[327] Philip E. and David Auerswald, The Kosovo Conflict. A Diplomatic History Through Documents, Kluwer Law International Cambridge / The Hague, 2000

[328] Arkivi I Ministris së Puneve te Jashtmë Republikes së Shqiperis,Dosja, 1609, B.vV11/2.

[329] William H. Zeliff.JR 1st District, New Hampshire, Congress of the United States House of Representatives Washington, DC20515-1901, August 4, 1992; The White House, Washington, October 23, 1992.

[330] Memo for Arnold Kanter – state, Paul Wolfowitz – OSD, Barry McCaffery – JCS, on Presidential Messages on Kosovo, November 18 1992, National Security Council, Washington DC 20506.

[331] Memo on Serb official opposes Kosovo participation in London talks, 20 August 1992- Bush Presidential Library

letër nga organizatorët e Konferencës, ku ndër të tjerat thuhet: "Nëse planifikoni të vini në Londër në kohën e Konferencës (26-28 gusht), atëherë jam i lumtur t'ju informoj se do të jetë e mundur për ju dhe delegacionin tuaj që të keni qasjen në qendrën e konferencave, me që nuk do të jetë e mundur që t'i mundësojmë delegacionit tuaj qasjen në vetë sallën e mbledhjeve. Organizatorët do të sigurojnë sallone dëgjimi ku do të transmetohet zhvillimi i Konferencës zyrtare në mënyrë të drejtpërdrejtë''.[332] Vendimet e Konferencës së Londrës nuk sollën ndonjë përparim drejt dialogut në hapësirën e Jugosllavisë, në Kosovë gjendja vetëm shkonte drejt keqësimit dhe rritjes së brutalitetit të pushtuesit jugosllav.[333] Këtë e dëshëmojnë edhe raportet e organizatave ndërkombëtare dhe shtypi i kohës që përshkruente një gjendje të rëndë ë diskriminimit të popullsisë shqiptare në Kosovë.

"Shqiptarët e pritën me zhgënjim të hidhur rolin që u ishte caktuar në Londër."[334]

Në dhjetor 1992, në një "Paralajmë të Kërshëndellave, Presidenti Bush e informoi Millosheviqin se agresioni serb në Kosovë do të sjellë deri te një reagim ushtarak unilateral të SHBAve". Këtë paralajmërim administrate e Presidentit Clinton e perseriti në disa raste gjatë vitit 1998.[335]

Kosova mori pjesë në Konferencë me atë që u njoh si "dhoma-jehonë'', por pa ndonjë angazhim thelbësor për çështjen e saj. Kjo kishte për qëllim që më vonë të bartet si problem minoritar në Konferencën e Gjenevës. Ky injorim u ndje edhe më thekshëm në Konferencën e Paqes në Dejton më 1995. Mosshqyrtimi i çështjes shqiptare edhe në këtë Konferencë ishte një injorim, por edhe nënçmim i faktorit shqiptar në Ballkan, edhe përkundër asaj se Kosova ishte deklaruar në favor të ruajtjes së integritetit territorial të shteteve fqinje duke hequr dorë nga pretendimet territoriale si p.sh. në raport me Maqedoninë, si dhe duke përjashtuar agjendën panshqiptare, e duke kërkuar pavarësinë në vend të bashkimit me Shqipërinë.[336]

---

332 Marc Weller, Shtetësia e kontestuar, vep. e cit., f.103.

333 Jane Holl Files – Electronic Files Electronic Messages – Kosovo [1] [0A/ID CFO1566] Kosovo[2][OA/ID CFO1566] Kosovo [3] [OA/ID CFO1566] Kosovo [4] [OA /ID CFO1566] Electronic Messages - Kosovo [OA/ ID CF 01746] London Conference [1], [2], [3]. Jane Holl Files –Subject Files Balkans [OA/ ID CFO1747]

334 Volfgang Petritsch, Robert Pihler, Rruga e gjatë në luftë, vep. e cit., f. 78

335 Memo for Arnold Kanter – state, Paul Wolfowitz – OSD, Barry McCaffery – JCS, on Presidential Messages on Kosovo

336 Marc Weller, Shtetësia e Kontestuar, vep. e cit., f. 61.

Milloshevïqit iu lejua që të nënshkruajë Marrëveshjen e Dejtonit në emër të serbëve të Bosnjës e Hercegovinës, duke përcaktuar kështu personalisht, fatin e saj të mëtejmë në atë Konferencë. Ndërkohë, kishte kërcënuar me mosvajtje në Konferencën e Paqes në Dejton po qe se aty do të flitej edhe për Kosovën.[337]

Nga ana tjetër, Milloshevïqi në emër të Jugosllavisë së cunguar në Dejton parashtronte zgjerimin e Serbisë, ide kjo, që nga lëvizja "Dora e Zezë'' apo "Unioni i Vdekjes'', themeluar më 1882 nga mbretëria serbe për të krijuar Serbinë e Madhe, e cila synonte daljen në detin Adriatik. Milloshevïqi parashtroi kërkesën që territoret e banuara kryesisht me serbë në Kroaci e Bosnjë e Hercegovinë, do të duhej të shkëputeshin. Serbia pretendonte se cilado popullatë serbe do të duhej ta kishte të drejtën të shkëputej nga etnitetet e posapavarësuar, argument ky që u kundërshtua nga Komisioni i Banditerit i cili u themelua për ta këshilluar Konferencën Ndërkombëtare për Jugosllavinë për çështjet e pranimit të shtetësisë dhe të trashëgimisë.[338] Tani shqiptarët e Kosovës, po i hidhnin sytë përqark me dhimbje e habi, duke parë shtetet e pavarura të krijuara. Këtu dhe filloi humbja e durimit, teksa shihej qartë mohimi i të drejtave të shqiptarëve, shkruan Medeline Olbrajt në librin e saj.[339]

Kjo ishte traumë për shqiptarët, pasi u vërtetua se politika e Rugovës për qëndresë pasive kishte dështuar. Dhe jo vetëm kaq, por edhe ideja e tij, që ata do të "shpërblehen" nga vendet perëndimore për "sjelljen e tyre të mirë" kishte qenë krejtësisht e gabuar.[340]

Përmbyllja e Marrëveshjes së Dejtonit pa u përmendur Kosova, dëshmoi haptazi dështimin e rezistencës pasive. Në vend të shpërblimit për veprim të përgjegjshëm te politikes se Rugova, Kosova u injorua plotësisht. Kështu më 1996 në pyetjen që iu bë Rudolf Perina, shef i Misionit diplomatik të SHBA-ve në Beograd dhe pjesëmarrës në Konferencën e Dejtonit, se pse Kosova nuk u ftua në këtë Konferencë, ai do të përgjigjet: "Në Dejton janë ftuar ata që kanë luftuar". Me këtë u bë më se e qartë se diplomacia nderkombëtare nderhynë vetëm në ato raste kur konflikti eskalon.

Nuk ishte aspak zhvillim real, i pritur dhe i drejtë që Marrëveshja e Dejtonit nuk e përfshiu Kosovën. Një pakicë serbe në Kosovë nuk mund të sundojë 90% të shqiptarëve

---

337 Ramë Buja, Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë, vep. e cit., f.275.
338 Marc Weller, Shtetësia e Kontestuar, vep. e cit., f. 58.
339 Madeleine Albright, Zonja Sekretare, vep. e cit., f. 443.
340 Tim Judah, Kosova luftë dhe hakmarrje, Prishtinë, 2002, f. 159.

atje.[341] Mospërfshirja e Kosovës në Marrëveshjen e Dejtonit vetëm sa ka hapur shtegun për luftën e ardhshme, do të shprehet Joshka Fischer në librin e tij.[342] Kurse Vollfgang Petritsch në librin e tij gjykon se përllogaritjet e bashkësisë ndërkombëtare në Dejton, për mospërfshirjen e Kosovës në këtë konferencë ishin fatale, duke vërë në rrezik edhe baraspeshën e brishtë të fuqive të mëdha.

## Përfundim

Mos përfshirja e Kosovës në gjtjen e zgjidhjeve diplomatike në tryezën e bisedimeve në Konferehjncat ndërkombëtare, ishte model, dhe alternativë e gabuar e diplomacisë evro-perëndimore. Sa më shumë që kalonte koha, sa më shumë që regjimi serb po zhvillonte politikën e aparthejdit në Kosovë, aq më tepër, zgjidhja e çështjes së Kosovës, përmes luftës po bëhej realitet i pa evitueshëm për popullin e Kosovës. Ndërkohë që, regjimi i Serbisë, trimërohej, fuqizohej me heshtjen, oportunizmin, indiferencën e diplomacisë evro-perëndimore.

Në përfundim mundë te konkludojmë se çështja e Kosovës nuk u trajtua ne nivelin e duhur as nga konferenca e Londres e as nag ajo e Hages dhe e Gjeneves . Prandajë shiquar në retrospektiven historike çështja e Kosovës ishte shumë e komplikuar se sa ishte trajtuare në këto Konferenca.

## Burimet dhe Literatura

### Fondet arkivore

1. George H.W. Bush Presidential Library, College Station, TX, USA

2. Fondi Bush Presidential Records Staff and Office Files, National Security Council Craig Chellis Files – Subject Files(41) CSCE [ Conference on Security and Cooperation in Europe] – Yugoslavia Crisis [OA/ ID CFO1441]

3. Blair Dominey Files – Subject Files Yugoslavia [OA/ID CF00232]

---

[341] Paskal Milo, Ditari i një Ministri të Jashtëm, Konflikti i Kosovës 1997-2001, "Toena", Tiranë; 2009, f. 31.

[342] Fischer, Joschka, Vitet e kuq-gjelbër, Koha, Prishtinë, 2008.

4. Jane Holl Files – Electronic Files Electronic Messages – Kosovo [1] [0A/ID CFO1566] Kosovo[2][OA/ID CFO1566] Kosovo [3] [OA/ID CFO1566] Kosovo [4] [OA /ID CFO1566] Electronic Messages - Kosovo [OA/ ID CF 01746] London Conference [1], [2], [3]. Jane Holl Files –Subject Files Balkans [OA/ ID CFO1747]

5. DCI Interagency Balkan Task Force [3] [OA/ID CFO174] Kosovo [OA]/ID CFO1747]

**Literatura**

1. Philip E. and David Auerswald, The Kosovo Conflic. A Diplomatic History Through Documents, Kluwer Law International Cambridge/The Hague, 2000, f. 18.
2. Christopher R. Hill, Outpost Life on the Frontlines of American Diplomacy, Simon & Schuster, New York Edition Octomber 2014, f, 124-125.
3. Buxhovi, Jusuf, *Kosova nga Konferenca e Londrës deri të protektorati ndërkombëtar*, "Faik Konica", Prishtinë, 2012.
4. Demi, Leonard: *Shqipëria dhe diplomacia amerikane*, Onufri, 2000, Tiranë
5. Di Lellie, Anna, *The case for Kosova*, Anthem Press, London & New York, 2006.
6. Fischer, Joschka, *Vitet kuq-gjelbër*, Koha, Prishtinë, 2008.
7. Gecaj, Bajram, *Konferenca e Rambujesë,* AIKD, Prishtinë, 2009.
8. Glenny, Misha, *Historia e Ballkanit, 1804-1999*, Toena, Tiranë, 2007.
9. Grup autorësh *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë, 1990.
10. H. Henry & Jr. Perritt, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës- Rrëfim prej brenda për një kryengritje*, Prishtinë, 2008
11. Malkolm, Noel, *Kosova, një histori e shkurtër*, Koha & Shtëpia e librit, Prishtinë-Tiranë, 2001.
12. Nacional Archives of the United States, Georg H. Bush Presidential Library, Department of State Press Release, December 1992.